Aspekte të historisë së komunizmit në Shqipëri përmes materialeve arkivore dhe burimeve sekondare

Tekst për përdorim në arsimin parauniversitar

Enriketa PANDELEJMONI
Gentiana KERA
Valentina DUKA

Konrad Adenauer Stiftung

MALUKA

Copyright © autorët
Të gjitha të drejtat e këtij botimi janë të rezervuara

Arti grafik / Graphic Designer
Kleida Maluka

Botim i parë “Maluka”, Tiranë 2020

ISBN 978-9928-260-36-9

Ky botim u realizua me mbështetjen e Konrad Adenauer

Konrad
Adenauer
Stiftung

Përmbajtja e botimit është përgjegjësi e autorëve
dhe nuk pasqyron qendrimin e Fondacionit Konrad Adenauer

PËRMBATJA

Dy fjalë për lexuesit **7**

KAPITULLI I - **VENDOSJA E SISTEMIT KOMUNIST** **9**

1.1 Çlirimi i Shqipërisë dhe vendime të Kryesisë së Frontit Antifashist Nacional-Çlirimtar 9
1.2 Zgjedhjet e 2 Dhjetorit 1945 23
1.3 Njohja e qeverisë shqiptare në arenën ndërkombëtare 33

KAPITULLI II - **PERSEKUTIMET NË VITET E PARA TË SISTEMIT KOMUNIST** **38**

2.1 Terrori komunist dhe statistika të të dënuarve në Shqipëri 1945-1955 38
2.2 Gjyqi i Opozitës dhe i deputetëve 69
2.3 Sigurimi i Shtetit dhe platforma agjenturore e tij 176

KAPITULLI III - **GJYQET DHE DËNIMET E KLERIT** **183**

KAPITULLI IV - **IDEOLOGJIA DHE PROPAGANDA** **241**

KAPITULLI V - **JETA NË KOMUNIZËM** **261**

5.1 Kultura dhe arti 261
5.2 Indoktrimi i fëmijëve dhe të rinjve 270
5.3 Gruaja dhe jeta familjare gjatë sistemit komunist 287
5.4 Zhvillimet në fushën e ekonomisë 304

DY FJALË PËR LEXUESIT

Ky vëllim është produkt i një bashkëpunimi midis autoreve dhe Fondacionit Konrad Adenauer në një projekt akademik, i cili si qëllim primar kishte vënien në dispozicion të mësuesve dhe nxënësve të sistemit parauniversitar, të materialeve arkivore dhe burimeve të tjera të shkruara historike për të plotësuar mangësitë që ka kurrikula aktuale e lëndës së historisë. Teksti do të jetë me interes edhe për studentët e Masterit Profesional për Mësuesi në lëndën e Historisë, të cilët do të mund të orientohen me burime primare dhe sekondare mbi periudhën komuniste nga perspektiva të ndryshme.

Gjatë 45 vjetëve të periudhës komuniste, Shqipëria u kthye në një vend të "socializmit real", çka do të thoshte vendosje e sistemit njëpartiak në qeverisjen e vendit. Regjimi komunist shqiptar e siguroi konsolidimin e tij brenda pak vjetësh, gjatë të cilëve ai asgjësoi dhe shtypi çdo formë opozite në vend. Në këtë mënyrë, udhëheqja komuniste shqiptare i çeli rrugën zbatimit pa asnjë kundërshtim, të modelit stalinist të ndërtimit të komunizmit. Kështu, Shqipëria iu nënshtrua një centralizimi të skajshëm dhe u ekzaltua lufta e klasave. Por lufta politike nuk u kufizua vetëm kundër kundërshtarëve, por ajo u zhvillua edhe brenda radhëve të veta. Në të vërtetë lufta brenda llojit ishte pjesë e filozofisë së partive komuniste të ndërtuara sipas modelit bolshevik leninist. Ky sistem politik antidemokratik që iu imponua shqiptarëve sundoi në Shqipëri për 45 vjet duke lënë gjurmë të thella në jetën politike, ekonomike, kulturore dhe atë shoqërore. Në fushën ekonomike, u zhduk prona private, u vu në jetë politika e mbështetjes në forcat e veta, u zhdukën sipërmarrësit e vegjël dhe klasa e menaxherëve, politika këto që e çuan të gjithë ekonominë e vendit në amulli. Në fushën sociale, shoqëria shqiptare iu nënshtrua një politizimi të skajshëm. Ideologjia marksiste–leniniste ndërhynte në çdo aspekt të jetës së shqiptarëve. Regjimi komunist arriti të kryente këtë ideologjizim të jetës shoqërore përmes institucioneve shtetërore, Partisë së Punës së Shqipërisë dhe levave ndihmëse të saj.

Në planin e politikës së jashtme, regjimi komunist shqiptar u orientua krejtësisht kah bllokut komunist. Ndërkohë, ai mbajti një qëndrim tejet armiqësor dhe ushqeu gjithnjë dyshime të shumta ndaj demokracive perëndimore. Megjithatë, edhe pse Tirana zyrtare orbitoi rreth bllokut komunist, politika e saj e jashtme njohu zhvillime të shumta, të shoqëruara këto me ndryshime rrënjësore në qëndrimin ndaj aleatëve të vetë komunist herë pro jugosllav, herë pro sovjetik herë pro kinez dhe në fund e izoluar plotësisht.

Për të njohur më mirë periudhën e sundimit komunist, ne përgatitëm këtë vëllim i cili ka karakterin e një teksti ekstra-kurrikular, që ofron për mësuesit dhe nxënësit e historisë mundësi për t'u thelluar në njohuritë historike mbi periudhën e komunizmit në Shqipëri (1945-1990). Nxitja për të punuar mbi këtë tekst erdhi nga pesha e vogël që periudha e komunizmit zë në tekstet shkollore dhe ato jashtëshkollore. Ky tekst synon ofrimin e materialeve origjinale arkivore për t'u mundësuar nxënësve dhe mësuesve zhvillimin e projekteve të ndryshme në klasë.

Materialet e tekstit janë përzgjedhur nga arkiva të ndryshme, si Drejtoria e Përgjithshme e Arkivit Qëndror, Arkivi i Ministrisë së Jashtme, Arkivi i Ministrisë së Brendshme, Arkivi i

Autoritetit për Informin e Dosjeve të Ish-Sigurimit të Shtetit, apo dhe nga tekste edukative dhe indoktrinuese të asaj periudhe, me qëllimin e pasqyrimit të materialeve burimore historike, në mënyrë që mësuesit dhe nxënësit të lexojnë dhe të shfletojnë informacionin e bollshëm të strukturave shtetërore të politikës, dhunës dhe propagandës shtetërore. Njëkohësisht, ata njihen dhe me aspekte të jetës sociale, edukative dhe kulturore përgjatë komunizmit, prandaj dhe burimet arkivore, të cilat ju kemi vënë në dispozicion në këtë tekst e përmbushin këtë qëllim.

Duke marrë në konsideratë faktin që informacioni, botimet dhe librat edukativë mbi periudhën e komunizmit në Shqipëri, janë akoma jo aq të shumtë, ky tekst ekstrakurrikular do t'u shërbejë mësuesve të historisë të sjellin në klasë informacione më të detajuara mbi periudhën e komunizmit nëpërmjet shembujve konkretë që dokumentat e tekstit pasqyrojnë. Teksti u mundëson mësuesve dhe nxënësve materiale të bollshme mbi një shumëllojshmëri temash që lidhen me periudhën e komunizmiot në Shqipëri. Për shembull, në tekst ka material mbi një tematikë aq shumë delikate në Shqipëri, siç është data e çlirimit të vendit, 28 apo 29 Nëntori. Kur u vendos data e çlirimit të Shqipërisë nga ushtritë nazi-fashiste? Një tjetër aspekt i pasqyruar në tekst është njohja ndërkombëtare e qeverisë komuniste dhe marrëdhëniet e saj me aleatët antifashistë pas Luftës së Dytë Botërore. Gjerësisht teksti ka të pasqyruar materiale arkivore mbi terrorin dhe dhunën e ushtruar ne Shqipëri nga strukturat shtetërore nëpërmjet materialeve të bollshme arkivore të gjyqeve dhe proceseve hetimore për njerëzit e dënuar si agjentë të shtetit, armiq të popullit. Po ashtu në tekst jepen statistika të detajuara të numrit të të dënuarve në dekadën e parë të regjimit komunist (1945-1955), ku bie në sy numri i lartë i njerëzve të dënuar me dënim me vdekje për krime politike.

Nxënësit dhe mësuesit e historisë me anë të këtij teksti do të gjejnë gjithashtu informacione dhe burime mbi indoktrinimin politik, kuturor dhe edukativ, të botuara në organet e shtypit komunist dhe revistat e kohës. Së fundmi, teksti pasqyron dhe periudhën e izolimit të Shqipërisë në arenën ndërkombëtare, por dhe vitet e fundit të komunizmit, ku burime prej tekstit do t'ju mundësojnë nxënësve të njihen me përpjekjet e shtetit komunist për t'u hapur me botën dhe zbutur pozicionimin ideologjik të Shqipërisë në arenën ndërkombëtare.

Materialet arkivore në këtë tekst janë shkruar ashtu siç paraqiten në origjinalin e tyre në arkiva, dhe nuk janë përshtatur në gramatikën shqipe. Lexueset dhe lexuesit mund të hasin dhe vështirësi në leximin e parë të tyre. Por kemi preferuar të mos ndërhyjmë në tekst dhe të jemi rigoroze në respektimin e tekstit në origjinal.

Duam të falenderojmë Fondacionin Konrad Adenauer dhe ish drejtorin e tij, Z. Walter Glos për mbështetjen e projektit. Një falenderim të veçantë edhe për drejtorin aktual, Z. Thobias Rüttershof, për mbështetjen e mëtejshme në botimin e këtij teksti dhe vlerësimin e projektit. Po ashtu falenderojmë Znj. Zheni Korçari dhe Znj. Julia Demishago për gadishmërinë për të na mbështetur përmes kontaktve të vazhdueshme dhe të dobishme në përpilimin e këtij teksti. Një tjetër falenderim shprehim për Z. Kastriot Dervishi, që na ka ndihmuar me dokumenta të shumta arkivore.

Tiranë, 20 shkurt 2020

KAPITULLI I

VENDOSJA E SISTEMIT KOMUNIST

1.1 Çlirimi i Shqipërisë dhe vendime të Kryesisë së Frontit Antifashist Nacional-Çlirimtar

BULETIN I LUFTËS NACIONAL CLIRIMTARE

Populli Shqipëtar feston ditën e 28 Nëndorit

(Burimi: Buletini i Luftës Nacional Çlirimtare, Tiranë, 28 Nëntor 1944)

Pjesë e shkëputur nga Buletini i LNÇ, Tiranë, 28 Nëntor 1944, Fl. 1-3.

"Pas pesë shekuj robërie të rëndë, në qytetin e Vlorës më 28 Nëntor 1912, u ngrit flamuri kombëtar. Kudo populli shqipëtar e festoi këtë ditë të lirisë plot gëzim. Indipendencën n'atë kohë e fituam. Përpjekjet patriotike patën një frut. Kaluan që atëhere 27 vjet gjer më 7 Prill 1939 kur pazarllëku për Shqipërinë mori fund: Vendi i ynë u bë preja e fashizmit. Populli i ynë ra në një skllavëri edhe më të rëndë, që ishte pjella e këtyre tregtar flamujsh të cilët ikën më vrap duke tradhëtuar aqë keq dhe e lënë në mëshirën e okupatorit fashist.

Pesë vjet robërie më të rëndë se kurdoherë kaloi populli shqiptar, ky popull i shumëvuajtur. Dita e zezë mbuloi vëndin t'onë.

Por në dejt e popullit shqipëtar zjen gjaku për liri. Që në ditët e para u mundua t'i dalë zot vëndit të vet dhe vetvehtes. Që atë ditë filloi rezistencën e tij, e cila më pas u bë armë në luftën e vazhduarshme kundër okupatorit dhe tregëtarëve të zakonshëm të politikës, të cilët mundoheshin t'a mbanin të skllavëruar, të shtypnin ndjenjat e tij liridashëse dhe përparimtare.

Na me luftën t'onë pesëvjeçare i treguam botës se jemi pasardhës të denjë të traditave luftarake dhe liridashëse të stërgjyshërve t'onë, që u përpoqën, në Kuvendin e Lezhit, më 1444, më 1878, më 1912, në Luftën e Vlorës më 1920 për të na lënë një Shqipëri të Lirë.

Pesë vjetët e robërisë kaluan. Me luftë e gjak, përpjekje, sakrifica dhe heroizma, sot i tërë populli shqipëtar feston ditën e 28 Nëntorit i lirë dhe krenar.

Festa e Flamurit këtë vit ka një ndryshim rrënjësor nga ajo e vitit 1912. Sot e festojmë këtë ditë me një Shqipëri të Lirë me të vërtetë..."

Fjala e Gjeneral-Kolonel Enver Hoxhës

"Popull shqipëtar,

Në një ditë të shënuar si këjo, më 1912, pas aqë kohë robërije lindi Shqipërija indipendente....

Pas kaqë luftrash heroike kundër fashizmit, flamuri i Kuq i Vlorës i lyer me gjakun e herojve të popullit të rënë në këtë luftë anti-fashiste valon sot krenar në qiellin e Shqipërisë së Lirë, pesë vjet kanë kaluar nga robëria e rëndë fashiste, pesë herë nëper rrugët e qyteteve të Shqipërisë, në çdo Njezetëetetë Nëndor është derdhur gjak i bijve heroikë që përlesheshin me bajonetat e okupatorit e të trathëtorve. Dita e Flamurit u bë dita dy herë e shenjtë, dita e çlirimit dhe e bashkimit të popullit shqipëtar."

FJALIM ME RASTIN E DITËS SË PAVARËSISË DHE TË ARDHJES SË QEVERISË DEMOKRATIKE NË TIRANË

Enver Hoxha VEPRA 1 (19) fq. 421-422.

(dokument i ripërpunuar, ku togfjalëshi "dita e çlirimit" është zëvendësuar me "dita e pavarësisë").

"Popull shqiptar,

Në një ditë të shënuar si kjo, më 1912, pas aq kohe robërije, lindi Shqipëria indipendente....

Pas kaq luftërash heroike kundër fashizmit, flamuri i kuq i Vlorës, i lyer me gjakun e herojve të popullit të rënë në këtë luftë antifashiste, valon sot krenar në qiellin e Shqipërisë së lirë. Pesë vjet kanë kaluar nga robëria e rëndë fashiste, pesë herë nëper rrugët e qyteteve të Shqipërisë, në çdo 28 Nëntor është derdhur gjak i bijve heroikë, që përlesheshin me bajonetat e okupatorit e të trathëtarëve. Dita e Flamurit u bë dita dy herë e shenjtë, dita e pavarësisë dhe e bashkimit të popullit shqipëtar."

AQSH, Fondi 489 (Presidiumi i Kuvendit Populllor), Viti 1945, D. 39, Fl. 1.

KRYESIJA E KËSHILLIT ANTIFASHIST NACIONAL-ÇLIRIMTAR

P R O C E S V E R B A L i M B L E D H J E S së V-të
mbajtur në Tiranë, të Mërkurë, me 9 Maj 1945, n'orën 19.

Kryeson Sh. Dr. Omer Nishani

Bëhet thirrje emërore e anëtarëve të Kryesisë së Këshillit Antifashist Nacional-Çlirimtar dhe ndodhen pranë shokët: Kol. Baba Mustafa Xhani (Nënkryetar), Koço Tashko (Sekretar), Sami Baholli (Sekretar), Gjen. M. Bedri Spahiu (Min. i Asistencës Sosiale), Gjen. M. Dali Ndreu, Gjen. Kol. Enver Hoxha (Kryeministër), Dr. Ing. Gaqo Tashko, Gogo Nushi, Prof. Gjergj Kokoshi, Kol. Haxhi Lleshi (Min. i P. Brëndëshme), Kol. Hysni Kapo, Kol. Islam Radovicka, Liri Gega, Manol Konomi (Min. i Drejtësisë), Dr. Medar Shtylla (Ministër i Ekonomisë), Gjen. M. Myslim Peza (Nënkryetar i Qeverisë), Nako Spiru, Qiriako Harito, Kol. Ramadan Çitaku (Min. i Financavet), Prof. Sejfulla Malëshova (Min. i Shtypit, Propagandës dhe Kul. Populllore), Siri Shapllo, Ingj. Spiro Koleka (Min. i P. Botore), Gjen. M. Spiro Moisiu, Dr. Ymer Dëshnica (Ministër i Shëndetësisë); mungojnë shokët: Gjen. L. Koçi Xoxe (Nënkryetar), Hasan Pulo (Nënkryetar), Kol. Kristo Themelko, Olga Plumbi, Kol. Tuk Jakova.

Kryetari, passi konstatoj shumicën, çeli mbledhjen dhe njoftoj rendin e ditës që përbëhet prej një pike si vijon: Disa vendime rreth festimit të ditës së kapitullimit të Gjermanisë.

Shoku Kryetar me një ligjëratë të shkurtër, pasi shpiegoj rëndësinë që ka për gjithë botën kapitullimi i Gjermanisë, i cili i jep fund luftës në Evropë dhe që, me shdukjen e bishës naziste, bota ka për të jetuar tash e tutje në paqë, theksoj se kjo ditë e kapitullimit është ndër më të shënuarat e prandaj duhet konsideruar edhe prej neve Shqiptarëve si një ditë feste kombëtare, sepsé edhe neve bëjmë pjesë në blokun e math antifashist të Kombeve të Bashkuar që e luftuan këtë bishë deri sa ajo dha shpirtin e saj. Për këtë arye proponoj që Kryesija e Këshillit Antifashist Nacional-Çlirimtar të marrë vendim që dita 9 maj të mbetet për sot e për të arthmen ditë feste kombëtare dhe të bëhen festime për këtë ngjarje gazmore prej gjithë popullit.

Shoku Ramadan Çitaku pyet në se festimi do të vazhdojë për një ose për më tepër ditë.

Sh. Kryetari: Vendimi jon do të jetë që dita 9 maj të caktohet si ditë feste kombëtare për sot e për të arthmen. Sa për festimet për këtë eveniment, ato mund të vazhdojnë për disa ditë.

Sh. Prof. Sejfulla Malëshova shpiegon rëndësinë që ka kapitullimi i Gjermanisë dhe është dakord që kjo ditë të përkujtohet për vit si një festë kombëtare dhe sot populli të lihet i lirë t'a festojë në mënyrë demostrative.

Sh. Nako Spiru proponon që të caktohen dy dit feste zyrtare dhe populli t'a festojë për tri dit.

Sh. Prof. Gjergj Kokoshi proponon që shkollat të kenë tri dit pushim dhe zyrat dy ditë.

Sh. Kryetari thotë se Kryesija e Këshillit Antifashist N.Çl. këtu ka për të vendosur më parë caktimin e ditës 9 maj si ditë feste kombëtare që ka për t'u festuar si e tillë për çdo vjet. Sa për festimin e tashmë, ditët dhe mënyra e tij, ato janë në sërën e dytë.

Këndohet e aprovohet vendimi si vijon:

V E N D I M

Me rastin e kapitullimit pa kushte të Gjermanisë Naziste; me rastin e festës së madhe të popujve liridashës.

KRYESIJA E KËSHILLIT ANTIFASHIST NACIONAL-ÇLIRIMAR

V e n d o s i :

Dita 9 maj të shpallet festë kombëtare.

Tiranë, me 9 Maj 1945.

Sh. Kryetari: Sa për festimin që duhet të festojmë sot këtë ngjarje kaqë të gëzueshme, proponoj që të bëhen tri dit festë zyrtare tuke filluar që sot dhe populli të marrë pjesë të gjerë në këto festime.

Pranohet me unanimitet.

Mbyllet mbledhja n'orën 19.30.

S e k r e t a r i : K r y e t a r i :

AQSH, Fondi 489 (Presidiumi i Kuvendit Populllor), Viti 1945, D. 39, Fl. 15.

Mbledhje e gjashtë seancë e III-të
E shtundë më 19 Maj 1945 ora 15
Kryeson Dr. Omer Nishani

Bëhet thirrja emërore e shokëve anëtar të Këshillit Antifashist Nacional-Çlirimtar, dhe ndodhen pranë shokët: Gjen. L. Koçi Xoxe (Nënkryetar), Hasan Pula (Nënkryetar), Koço Tashko (Sekretar), Sami Baholli (Sekretar), Gjeneral-Major Bedri Spahiu, Gjeneral-Major Dali Ndreu, Gogo Nushi, Prof. Gjergj Kokoshi, Kolonel Haxhi Lleshi, Kolonel Islam Radovicka, Liri Gega, Manol Konomi (Ministër i Drejtësisë), Dr. Medar Shtylla (Ministër i Ekonomisë), Gjeneral-Major Myslim Peza, Nako Spiru, Ollga Plumbi, Qiriako Harito, Ing. Spiro Koleka (Ministër i P. Botore), Gjeneral-Major Spiro

Moisiu, Kolonel Tuk Jakova, Dr. Ymer Dishnica (Ministër i Shëndetësis); mungojnë shokët: Enver Hoxha (Kryeministër), Dr. Ing. Gaqo Tashko, Kolonel Hysni Kapo, Kolonel Kristo Themelko, Kolonel Ramadan Çitaku (Ministër i Financavet), Prof. Sejfulla Malëshova (Ministër i Shtypit, Propagandës e Kul. Populllore) dhe Prof. Siri Shapllo.

Kryetari pasi konstatoj shumicën, deklaroj mbledhjen e çelur dhe vuri në bisedim Vendimin për dekretimin e kuadrove të gjyqtarëve.

Sh. Manol Konomi pas pyetjes së Sh. Qiriako Harito për sa u përket dy Kryetarve të Gjykatë së Naltë, thotë se: "Sh. Andrea Sahatçi, është shumë i zoti me drejtësi dhe i afërmë i lëvizjes, gjithashtu dhe Sh. Salim Luniku është i mirë në drejtësi, edhe me gjith që është quajtur si nga njerëzit e Shefqet Vërlacit, nuk është përzjerr, s'ka marrë pjesë.

Sh. Sami Baholli pyet pse nuk është marrë Sh. Faik Shatko, i cili është i drejtësisë dhe ka qënë me lëvizjen.

Sh. Ymer Dishnica ve në dukje cilësit dhe zotësin në drejtësi të Sh. Andrea Nathanail, i cili është dhe i vetmi që ka qënë i afërmi i lëvizjes.

Sh. Manol Konomi: "Është e vërtetë, por po të mernim këtë si Kryetar, atëhere A. Sahatçiu do t'a linim fare se s'mund të bëhej anëtar, kurse, si thashë, kemi mungesë kuadri".

Sh. Bedri Spahiu: "Do të thosha dhe unë për atë të Gjinokastrës, se ay është pakë si ballist, po si tha sh. Manol mungojnë gjykatësit.

Këndohet proponimi i Ministris së Drejtësisë mbi emërimin e trupit gjyqësor të Shqipërisë dhe dekretohet si vijon (shif bashkëngjitur listën anekse).

Vihet në bisedim Ligja mbi disa dispozita në lëndë pensioni:

Sh. Koçi Xoxe pyet se çfarë është përjashtimi që bëhet në art. 1 për pensione me shtesë katër vjeçare.

Sh. Qiriako Harito shpjegon se kur ardhi Italia ka pushuar një pjesë nëpunës, nga të cilët nuk kish mbesim, dhe mbasi midis këtyre kish dhe që nuk u binte pension sepse nuk e kishin mbushur kohën e shërbimit për të fituar të drejtën e pensionit, u ish njohur një shtesë kohe shërbimi deri në katër vjet. Kjo u pa e arsyeshme t'u njihet dhe me këttë ligjë: mbasi siç thuhet dhe në raportin justifikues këta janë viktimat e parë të fashizmit. Gjith'ashtu duhet të merret parasysh ligja e pensioneve të nëpunsave të ish Parlamentit; dhe ajo që shton katër vjeçorin në gjashtë.

Sh. Bedri Spahi: "Të shihen ato ligje".

Sh. Qiriako Harito: "Po të pranohet në parim, atëherë i marim ato ligje dhe e themi në art. e parë: me përjashtim të ligjeve Nr. kaqë". (pranohet).

Sh. Hasan Pulo për sa u përket mos njohjes së pensioneve të deputetëve etj., që përmenden në art. 2 e gjen t'arsyeshme, sepse këta pa lënë vetë pension kanë marrë, d.m.th. kanë marrë pensionin e nëpunësit të vogël ose të një mësuesi, kjo s'është e drejtë dhe duhet t'i kthejnë se nuk i kanë marrë nga arka e Shtetit, por nga arka e pensionistave.

Sh. Kryetar: "Ka patur një ligjë dhe pagesa është bërë në bazë të asaj ligje".

Sh. Qiriako Harito: "Edhe Arka e pensioneve ka qenë vetëm aty nga viti 1925 gjer më 1929 pastaj u bashkua me Arkën e Shtetit se do të ish në deficit". Pastaj shpjegon se art. 4 ka për qëllim t'i 'apë të drejtë Komisionit t'i rishqyrtojë ato pensione që mund të jenë lidhur duke u bazuar në akte të simulura. Edhe për sa i përket art. 5 thotë se ky artikull nuk ka për qëllim t'u pres krejt pesionin atyre oficerave që kanë ardhur nga Turqia, por u zbret shumat e mbëdha që u janë dhënë disave duke u njohur, me të padrejtë, shërbimet e bëra në Turqi, sikurse shpjegohet dhe në raportin justifikues.

Sh. Kryetar: "Mbasi Shteti Shqiptar u nda prej Turqisë dhe këta oficera qëndruan këtu dhe hyn në shërbim të Shtetit shqiptar, kish arësye, logjika e donte që t'u njihshin disa të drejta. Tashti t'u hiqet kjo e drejtë, s'më duket e arësyeshme".

Sh. Gjergj Kokoshi: "Këta të kohës së Turqisë janë dhe të pakë, është e kotë të bëhet një ligjë për 10 a 15 veta".

Sh. Qiriako Harito: "Njëfarë pensioni u bje, por jo pensione të privilegjuara; edhe pikërisht këtu synon kjo ligjë: u bje këtyre privilegjeve; sepse kanë ardhur dhe nëpunës civil, mësues etj. dhe këtyre nuk u jepej. Pse t'a kishin këtë privilegjë vetëm oficerët?".

Sh. Gjergj Kokoshi: "Pa drejtësia atëhere nuk u bë pse u dhanë këtyre, por pse nuk u dhanë dhe të tjerëve. Një ligjë e tillë është bërë dhe në Jugosllavi, po atje përfituan dhe nëpunësit e tjerë".

Sh. Spiro Moisiu thotë se ajo ligjë nuk ish e drejtë se një oficer i ardhur nga Turqija për një kohë të shkurtër që kish shërbyer këtu merrte tri të katërtat e rrogës pension, kurse oficerët e tjerë me 15 vjet shërbim nuk u takonte aqë pension.

Sh. Kryetar: "Për ata që kanë shërbyer një kohë të shkurtër, për shembëll shërbeu 5 vjet këtu dhe t'i jepet pension nuk themi, por ka që mund të kenë shërbyer 15 vjet në Shqipëri dhe me atë të kohës së Turqisë, u jepej një pension, këtyre të mos u pritet".

Sh. Qiriako Harito: "Po si thashë, ligja u njeh një farë pensioni".

Sh. Islam Radovicka: "Me sa di unëm kur u shpall independenca e Shqipërisë është bërë një deklaratë nga qeverija e asaj kohe, ku thuhesh se: "gjithë oficerët shqiptarë që janë në forcat e ushtrisë turke, të kthehen n'Atdhe dhe u njihen të gjithë të drejtaat e tyre". Edhe ligja u bë në këtë bazë, caktonte se ata oficerë që muarën pjesë në ushtërinë shqiptare në vitin 1913 dhe kishin mbushur 10 vjet shërbim në Shqipëri, kishin të drejtë pensioni, duke u njohur dhe kohën e okupacioneve si vazhdim nëpunësie. Kështu gjith kjo kategori që ardhi më 1913 kishin të drejtë pensioni dhe mernin si mbas gradës që kishin; një nga këta për shëmbëll është i ati i të ndjerit Qemal Stafa që ish major dhe kur dolli në pension merte 300 fr. në muaj; më von u bë një ligjë tjatër dhe ja u pakësuan, d.m.th. së mernin jo tri të katërtat e rrogës, po më pak; sa për ata që s'muarë pjesë më 1913 po ardhnë më vonë më 1920 ose më pas, nuk e kishin këtë të drejtë. Tashi sa për atë kategorin e parë që u qe njohur kjo e drejtë, nuk ësht e arësyeshme t'u pritet.

Sh. Qiriako Harito: "Si e thashë dhe më parë kjo ligjë, është bërë, pikërisht, për ato privilegje që u ishin bërë një kategorie. Kish njerës, që po të mos u merrej

parasysh shërbimi i kohës së Turqisë, nuk u takonte pension fare, kurse këta, në bazë të asaj ligje mernin pensione skandaloze!

Sh. Koço Tashko: "Kjo ligjë është bërë në vitin 1923, d.m.th. në pragun e kryengritjes së 1924. Atëherë kam qenë në Amerikë dhe e mbaj mënt që ka bërë një përshtypje të madhe në shqiptarët e atjeshmë njohja e shërbimit të bërë në Turqi nga Shteti Shqiptar! Faik Konica dhe Fan Noli kanë bërë një fushatë për këtë pa-drejtësi; të legalizohet sot prej nesh, s'më duket aspak e arsyeshme".

Sh. Kryetar: "Tashti po e vemë në votë dhe po të jetë ashtu si thotë Sh. Qiriako Harito, se nuk mbeten këto familje pa pension, e pranojmë në parim".

Sh. Bedri Spahi: "Po të jetë se u takon pension atyre familjeve, e pranojmë".

Sh. Kryetar: "Me atë konditë, pranohet" (pranohet).

Sh. Gjergj Kokoshi është i mendimit që shërbimi gjatë kohës së luftës të njihet dyfish.

Sh. Spiro Moisiu përkrah mendimin e Sh. Gjergj Kokoshi edhe kërkon të meret parasysh si kohë shërbimi e vlefshme për pension edhe perioda që nga nxjerrja nga radhët e ushtërisë gjer sa ka dalë në ilegalitet.

Sh. Qiriako Harito shpjegon se ushtarakëve u është marrë parasysh për efekt pensioni koha që nga 7 prill 1939 gjer në datën e Konferencës së Pezës.

Sh. Islam Radovicka kërkon të merret parasysh dhe për civilat sepse oficerët kanë qenë shumë të pakë në radhët e U.N.C.; shumica përbëhej nga civilët.

Sh. Haxhi Lleshi është i mendimit të pranohet ligja siç është paraqitur duke përfituar vetëm ata që ju përgjigjnë thirrjes së Pezës dhe u hodhën në U.N.Ç. me kohë, e jo ata që qëndruan në shërbim të okupatorit e merrnin rroga.

Sh. Spiro Moisiu insiston në mendimin e shfaqur më parë dhe sjell shembëll vehten si dhe të tjerë që mund t'a kenë marë vesh më von thirrjen e Pezës.

Sh. Manol Konomi thotë se ligja në bisedim është e drejtë, për civilat është dhe më i butë se për ata t'ushtrisë, se civilat përfitojnë dhe pas Konferencës së Pezës, përjashton vetëm prefektat, nënprefektat e kryetarët e komuneve, për të cilat ka arësye sepse këta kanë mbajtur poste politik, prandaj kërkon të pranohet si ashtë.

AQSH, Fondi 489 (Presidiumi i Kuvendit Populllor), Viti 1945, D. 52, Fl. 1.

KRYESIJA E KËSHILLIT ANTIFASHIST NACIONAL-ÇLIRIMTAR

Vendim Nr. 81 d. 9-7-1945
për dhanien e dekoratave

Në bazë të propozimit të Kryetarit të Qeverisë Demokratike të Shqipërisë dhe Komandant' i Përgjithëshëm i Ushtrisë Kombtare së Shqiprisë Gjeneral-Kolonel Enver Hoxha,

Kryesija e Këshillit Antifashist Nacional-Çlirimtar,

V E N D O S I:

I.

Dhanien e dekoratave personave të poshtëshënuem me kategori e grada si vijon:

Dekorohen me Urdhërim e "Heroit Kombëtar" dëshmorët:
1) Qemal Stafa
2) Vojo Kushi
3) Perllat Rexhepi
4) Kajo Karafili
5) Misto Mame
6) Reshit Çollaku
7) Asim Zeneli
8) Ali Demi

Dekorohen me Urdhërin e "Flamurit" dëshmorët:
1) Fetah Ekmekçiu
2) Mustafa Kaçaçi
3) Duleman Çela

Dekorohen me Urdhërin e "Flamurit":
1) Dr. Omer Nishani
2) Hasan Pulo
3) Sejfulla Malëshova
4) Dr. Ymer Dëshnica
5) Ing. Spiro Koleka
6) Dr. Medar Shtylla
7) Manol Konomi
8) Koço Tashko
9) Qirjako Harito
10) Gogo Nushi
11) Liri Gega
12) Ollga Plumbi
13) Nako Spiru

-2-
14) Siri Shapllo
15) Prof. Gjergj Kokoshi
16) Kadri Baboçi
17) Kost Boshnjaku

18) Sali Mborja
19) Refat Spahiu
20) Haki Stërmilli
21) Faik Shehu
22) Hetem Bajrami
23) Mark Ndoja
24) Zia Dibra
25) Hafës Ali Musaj (Elbasan)
26) Miho Lako
27) Pilo Peristeri
28) Sotir Vulkani

Dekorohen me Urdhërin "Ylli Partizan" Grad. I-rë Ushtarakët:

1) Gjeneral-N/Kolonel Koçi Xoxe
2) " - Major Spiro Moisiu
3) " " Bedri Spahiu
4) " " Myslim Peza
5) " " Mehmet Shehu
6) " " Dali Ndreu
7) Kolonel Hysni Kapo
8) " Tuk Jaakova
9) " Krito Themelko
10) " Ramadan Çitaku
11) " Haxhi Lleshi
12) " Baba Mustafa Xhani
13) " Tahir Kadarea
14) " Gjin Marku
15) " Shefqet Peçi

Dekorohen me Urdhërin "Ylli Partizan" Grad. II-të Ushtarakët:

1) Kolonel Islam Radovicka
2) N/Kolonel Rahman Perllaku
3) " Beqir Balluku
4) " Qazim Kondi
5) " Hito Çako
6) " Pëllumb Dishnica
7) " Nexhip Vinçani
8) Major Teki Koloneci
9) " Jaho Gjoliku
10) " Mestan Ujaniku
11) " Riza Kodheli
12) " Rahman Ruçi

AQSH, Fondi 489 (Presidiumi i Kuvendit Populllor), Viti 1945, D. 108, Fl. 1

KRYESIJA E KËSHILLIT ANTIFASHIST NACIONAL-ÇLIRIMTAR

Mbledhje e 14-të Seancë e I e Kryesisë së Këshillit Antifashist Nacional-Çlirimtar
Mbajtur në Tiranë më 5-11-1945 ora 15
Kryeson Dr. Omer Nishani

Bëhet thirrja emërore dhe ndodhen pranë shokët: Gjeneral-Leit. Koçi Xoxe (Nënkryetar), Kolonel Baba Mustafa Xhani (Nënkryetar), Hasan Pulo (Nënkryetar), Koço Tashko (Sekretar), Sami Baholli (Sekretar), Gjeneral-Major Bedri Spahiu, Gjeneral-Major Dali Ndreu, Gjenerl-Kol. Enver Hoxha, Gogo Nushi, Prof. Gjergj Kokoshi, Haxhi Lleshi, Kolonel Islam Radovicka, Kolonel Kristo Themelko, Manol Konomi, Dr. Medar Shtylla, Gjeneral-Major Myslim Peza, Nako Spiru, Olga Plumbi, Qiriako Harito, Kolonel Ramadan Çitaku, Ingj. Spiro Koleka, Gjeneral-Major Spiro Moisiu, Kolonel Tuk Jakova; dhe mungojnë vetëm shokët Dr. Ing. Gaqo Tashko, Kolonel Hysni Kapo, Liri Gega, Prof. Sejfulla Malëshova, Prof. Siri Shapllo, e Dr. Ymer Dishnica.

Sh. Kryetar massi konstaton shumicën, deklaron mbledhjen e hapur.

Me proponimin e Sh. Ramadan Çitaku, më parë vihet në bisedim Projekt-Ligja mbi krijimin e fondit të shpenzimeve për zgjedhjen e Asamblesë Kushtetuese.

Këndohet Projekt-Ligja dhe pranohet si vijon:

Neni 1.

Në gjendjen e parapamjevet të shpenzimevet të ushtrimit financjar 1945/46 të Ministrisë së Punëve të Mbrendshme, krijohet titulli i II-të "Shpenzime të pa rendshme" Kat. I. "Shpenzime efektive" e rubrika "Shpenzime të ndryshme" me Kap. 10 "Shpenzime çdo natyre për zgjedhjen e Asambles Kushtetuese si blemje e arkave për vota, shkresori, shtypshkrime, benzinë, transport, qira automjetesh, shpërblime shoferash dhe shpenzime udhëtime e djete gjyqtarësh e nëpunsash të deleguem për këte qëllim etj." tue shenjue nji fond prej fr.shq. 1.000.000.- (njimiljon).

Neni 2.

Fondi i fr.shq.1.000.000 (njimiljon) krijue si mbas nenit 1 të kësaj ligje, paksohet nga Kap.35 "Fond Rezervë për plotësim fondesh e për shpenzime të pa parapame në budget" të gjendjes së parapamjevet të shpenzimevet të ushtrimit financjar 1945/46 të Instituteve të Nalta e Ministrisë së Financavet.

Neni 3.

Me zbatimin e kësaj ligje ngarkohet Ministrija e Financavet e Ministrija e Punëve të Mbrendëshme.

Neni 4.

Kjo ligjë hyn në fuqi nga data e botimit të saj në Gazetën Zyrtare.

Vihet në bisedim Projekt-Ligja mbi amnisti dhe falje për faje ordinare të kryera deri në çlirimin e Shqipërisë.

Sh. Dr. Manol Konomi shpjegon se fjala edhe ditën 17 Nëntor 1944, që përmenden në nenin e parë, ka për kuptim që është brënda dhe dita e 17-të, që u çlirua Tirana.

Sh. Gjergj Kokoshi e Spiro Koleka janë të mendimit se për të dhënë atë kuptim mund të thuhet inklusive.

Sh. Qiriako Harito proponon *që në vënd të datës 17 Nëntor 1944 të bëhet 28 Nëntor 1944 që u çlirua Shkodra* se mund të ketë nonjë dhe brenda këti intervali të vogël, dhe kështu të mund të përfitojë dhe ky. (përkrahet).

Sh. Manol Konomi shpjegon se është marrë parasysh që data e çlirimit të Kryeqytetit përfaqëson atë të çlirimit të gjithë Shqipërisë, prandaj ish vënë data e 17 Nëntorit. Sa për atë të Shkodrës ka dhe vende të tjera që janë çliruar ma vonë.

Sh. Tuk Jakova thotë se *kur shkoj okupatori prej Shkodre nuk ngeli maa ushtëri e huaj në ndonjë vënd të Shqipërisë, prandaj duhet të bëhet 28 Nëntor 1944* (pranohet).

Sh. Spiro Moisiu pyet se ç'do të bëhet për ato faje që janë kryerë para kësaj date, porse janë zbuluar më vonë. Edhe sjellë shëmbëll nonjë vjedhje që mund t'i jetë bërë nonjerit pse mungonte, ish p.sh. në Ushtërinë Nacional-Çlirimtare.

Sh. Manol Konomi shpjegon edhe një herë se qëllimi i kësaj ligje është të falet një pjesë e vogël. Këtë e bëjmë nga nevoja, thotë, për të mos mbushur burgjet.

Mbi pyetjen që i bën Sh. Sami Baholli, pë sa i përket paragrafit të tretë në Nenit 3, shpjegon se qëllimi i kësaj dispozite është për të evituar burgimin e atyre që janë falur me ligje të më parëshme.

Gjithashtu, mbi pyetjen e Sh. Hasan Pulo, ep disa skjarime për sa i përket nenit 5, duke vënë në dukje se një pjesë e fajtorëve janë të lirë, një pjesë ishin hedhur në luftë me ne, si edhe që disa falje tipike e për çështje morale nuk mund të fallen, e prandaj, përfundon Sh. Manol Konomi, janë bërë këto dallime në këtë nenin (përkrahet).

Këndohet Ligja dhe pranohen nen për nen si vijon:

Neni 1. –

Amnistohen të gjitha fajet ordinere të kryera deri edhe ditën 28 Nëntor 1944, për të cilat ligja parasheh një ndëshkim me burgim të rënë ose burgim, që në maksimum nuk kalon të gjashtë vjetët, ose një ndëshkim gjobor, të bashkuar ose jo me ndëshkimet e sipërtreguara.

Përjashtohen fajet financiare për të cilat zbatohet neni 4 i kësaj ligje.

AQSH, Fondi 489 (Presidiumi i Kuvendit Populllor), Viti 1945, D. 108, Fl. 37-42.

Mbledhje 14-të Seancë e 5-të e Kryesisë së Këshillit Antifashist Nacional-Çlirimtar
Mbajtur në Tiranë me datë 9 Nëntor 1945 ora 15
Kryeson Dr. Omer Nishani

Bëhet thirrja emërore dhe ndodhen pranë shokët: Kolonel Baba Mustafa Xhani (Nënkryetar), Hasan Pulo (Nënkryetar), Koço Tashko (Sekretar), Sami Baholli (Sekretar), Gjeneral-Major Bedri Spahiu, Gjeneral-Major Dali Ndreu, Gjeneral-Kolonel Enver Hoxha, Gogo Nushi, Prof. Gjergj Kokoshi, Kolonel Haxhi Lleshi, Kolonel Islam Radovicka, Kolonel Kristo Themelko, Manol Konomi, Dr. Medar Shtylla, Gjeneral-Major Myslim Peza, Nako Spiru, Olga Plumbi, Qiriako Harito, Kolonel Ramadan Çitaku, Ingj. Spiro Koleka, Gjeneral-Major Spiro Moisiu, Kolonel Tuk Jakova; edhe mungojnë vetëm: Gjeneral-Leitn. Koçi Xoxe (Nënkryetar), Dr. Ingj. Gaqo Tashko (Ministër i Bujqësisë dhe i Pyjeve), Kolonel Hysni Kapo, Liri Gega, Prof. Sejfulla Malëshova, Prof. Siri Shapllo e Dr. Ymer Dishnica.

Sh. Kryetar mbasi konstaton shumicën deklaron seancën e hapur dhe ve në bisedim Projekt-Ligjën mbi të kremtet zyrtare.

Sh. Tuk Jakova thotë se është haruar në këtë projekt dita e një Majit, prandaj, si anëtar i Sindikatave, proponoj të shtohet.

Sh. Kryetar e ve në votë dhe pranohet unanimisht të shtohet dhe dita e 1 Majit.

Sh. Baba Mustafa Xhani proponon të shtohet dhe dita e Novruzit.

Sh. Gjergj Kokoshi pyet se ç'farë kriteri është ndjekur në caktimin e festave. A janë pyetur Komunitetet fetare?

Sh. Manol Konomi shpjegon se u janë kërkuar Komuniteteve dhe ata i kanë sjellë. Prej atyre të Komunitetit Mysliman u shkurtua një për t'ja dhënë Bektashinjëve. Edhe nga ata të Orthodhoksëve e Katolike u nxuar një.

Sh. Bedri Spahiu: "Dita e 28 Nëntorit koencidoj me çlirimin e Shqipërisë, d.m.th. me rënien e Shkodrës, prandaj proponoj që emërtimi i festës së 28 Nëntorit të bëhet: Ditë e Indipendencës dhe e çlirimit të Shqipërisë. (nuk përkrahet).

Sh. Bedri Spahi insiston të vihet në votë.

Sh. Kryetar e ve në votim dhe nuk pranohet (votojnë pro vetëm pesë).

Sh. Baba Mustafa Xhani: "Si shihet në këtë Projekt-Ligjë gjithë Komunitetet kanë nga 6-7 ditë të kremte. Ne, Komuniteti Bektashian si të rinj me statut kërkuam vetë, dy ditë: edhe Këshilli Ministruer masi ka aprovuar Statutin t'onë, ka aprovuar dhe të ditët feste. Këto janë: Matemi, dita që ra shehit Iman Hyseni; edhe Novruzi, dita e lindjes së Aliut". Edhe insiston të shtohet dita e Nevruzit që nuk është në Projekt-Ligjë, por jo të merret nga ato të Komunitetit Mysliman, por pse kjo ditë është në Statut që ka aprovuar Këshilli Ministruer.

Sh. Gjergj Kokoshi: "Është mirë që të shtohet".

Sh. Kryetar e ve në votë dhe pranohet të shtohet dita e Nevruzit.

Sh. Myslim Peza është i mendimit të shtohet ditë e Shingjergjit që e feston gjithë

populli pse dolli nga dimri me vetë me gjë të gjallë. Edhe të hiqen dy netët e mira (Berat dhe Mirazh), mbasi këto dy ditë dhe më parë nuk kanë qenë.

Sh. Kryetar e ve në votë dhe pranohet të mos bahet ky ndryshim.

(Bëhen pesë minuta pushim dhe pasë pesë minutash, seanca hapet).

Sh. Ramadan Çitaku: Është haruar të vihet dita e Çlirimit të Shqipërisë. Është vënë dita e Konferencës së Pezës që mori formën Lufta N.Ç., është vënë dita e Kongresit të Përmetit ku lufta merr formë më të gjërë, edhe ish e drejtë të viheshin dhe të festohen këto ditë, por është haruar, si thashë, dita e çlirimit, dita e përfundimit të Luftës së madhe që bëri populli shqiptar. Këtë ditë duhet t'a kujtojë populli dhe t'a festojë brez pas brezi, të mbetet si një ditë historike. Dita e 28 Nëntorit 1912 është e drejtë të festohet, por edhe kjo e Luftës së dytë, e Luftës së madhe duhet të shtohet (përkrahet). Vetëm është çështja e datës. *Me sa di unë, pas mes natës së 28 Nëntorit 1944, armiku qe çdukur nga e gjithë Shqipëria, d.m.th. dita e 29 Nëntorit u gdhi duke qenë Shqipnija e çliruar. Prandaj proponoj që dita 29 Nëntor të shtohet në ditët e festave kombëtare*. Ne kemi vënë ditën e mbarimit të luftës së përbotëshme, e të mos vemë ditën e çlirimit të Shqipërisë, më duket do të ishte gabim".

Sh. Hasan Pulo: "Nuk kam kundërshtim përsa tha Baca. Po desha të di në se e kanë gjith ata Shtete që kanë lëftuar dhe kanë hequr të zezat më shumë dhe prej nesh?".

Sh. Ramadan Çitaku: "Në Jugosllavi, ditën e çlirimit të Beligradit e mbajnë si festë të përgjithëshme. Edhe në mos e kanë gjetkë ne mund t'a bëjmë, dhe ne kemi lëftuar më shumë nga të tjerët".

Sh. Hasan Pulo: "Gjithë Shtetet një ditë kanë feste të independencës së tyre".

Sh. Ramadan Çitaku: "Pamë në Bullgari që me gjithse nuk bënë luftë dhe ditën e çlirimit e kanë bërë festë".

Sh. Koço Tashko shpjegon se çlirimi ndahet më dysh: çlirimi i përgjithshëm dhe çlirimi t'onë; çlirimi t'onë pa çlirimin e përgjithëshëm nuk do t'ish gjë. Prandaj është i mendimit që të pranohet si dita e 9 Majit, ashtu dhe ajo e 29 Nëntorit si festa kombëtare (përkrahet).

Sh. Dr. Ymer Dishnica e Qiriko Harito janë të mendimit të shtohet dhe dita e 29 Nëntorit si festë kombëtare, sepse kjo është dita e fitores së madhe të popullit shqiptar.

Sh. Gjergj Kokoshi kërkon të jetë vetëm dita e 9 Majit masi lufta ishte e përbashkët dhe dita e çlirimit të jetë e përbashkët.

Sh. Spiro Moisiu duke u bashkuar me proponimin e Sh. Ramadan Çitaku shton se përveç që dita e 29 është ditë çlirimi i Shqipërisë, po është dhe dita që popullit ju sigurua regjimi i tij.

Sh. Myslim Peza ve në dukje se kur u çlirua Shqipëria më 28 Nëntor 1912, nuk ka lëftuar kurkush, kurse për çlirimin e kësaj radhe populli lëftojë gjashtë vjet rrjesht, prandaj kjo ditë ka rëndësi shumë më të madhe.

Sh. Ramadan Çitaku duke treguar dhe njëherë historin e çlirimit të Shkodrës me 29 Nëntor, insiston që të pranohet si festë kombëtare.

Sh. Koço Tashko kërkon pranimin e propozimit të Sh. R. Çitaku. dhe duke u bashkuar me mendimin e Sh. Myslim Peza për sa i përket rëndësisë së ditës së çlirimit të Shqipërisë, ve në dukje se këtë herë Shqipëria u çlirua në bazë të Luftës t'onë, kurse më 1912 fitoj independencën në bazë të marrëveshjeve diplomatike.

Sh. Gjergj Kokoshi shton se përveç rolit diplomatik, janë vrarë dhe shqiptarë për t'u fituar independenca e Shqipërië.

Sh. Tuk Jakova shpjegon se dita e 29 Nëntorit është një datë historike e çquar dhe do të lozë një rol me rëndësi në ndërgjegjen e popullit shqiptar. Në këtë ditë do të mbahen fjalime dhe të kujtohen sakrificat e mëdha që ka bërë populli; me këtë datë është lidhur seicili: kush ka dhënë djalin, kush atin, vëllanë etj. Data e 28 Nëntorit 1912, është një etapë tjetër, pas pesëqind vjet robërije është fituar vetë-qeverimi dhe është e drejtë të festohet. Po edhe 29 Nëntori, duhet të festohet se dhe për këtë është bërë sakrifica dhe punim i madhë (përkrahet).

Sh. Haxhi Lleshi shprehet për pranimin e proponimit të Sh. Ramadan Çitaku. "Në festimin e 9 Majit marim pjesë, thotë, si gjithë popujt, se po të kish triumfuar ana tjetër do të shtypeshim dhe ne si gjithë të tjerët. Po 29 Nëntori është një gëzim shumë i madh vetëm për popullin shqiptar.

Sh. Kryetar sqaron mendimet e shfaqura dhe vë në dukje se Shqipëria e kish humbur independencën e saj, kështu 29 Nëntori është një çlirim i dytë i Shqiptarëve të cilën e fituan me gjak. Prandaj e ve në votë dhe pranohet me shumicë.

Këndohet Projekt-Ligja dhe pranohet si vijon:

Neni 1.

Dita e Djelë është ditë pushimi për gjithë Zyrat Shtetnore e parashtetnore.

Neni 2.

Pëveç ditës së Djelë të çdo jave janë të kremte zyrtare:

a) të Kremtet Kombëtare

1. – Përvjetori i shpalljes së Pamvarësisë Shqiptare (28 Nëntor).
2. – Përvjetori i Çlirimit të Shqipërisë (29 Nëntor).
3. – Përvjetori i fitorës (9 Maj).
4. – Përvjetori i mbledhjes së Kongresit të Përmetit (24 Maj).
5. – Përvjetori i formimit të Shtabit të Përgjithëshëm të Ushtrisë Nacjonal-Çlirimtare (festa e ushtrisë – 10 Korrik).
6. – Përvjetori i mbledhjes së Konferencës së Pezës (16 Shtator).

b) Të Kremte civile.

Dita e vitit të ri (1 Janar).

Dita e 1 Majit.

c) Të kremte fetare.

1. – Dita e parë dhe e dytë e Bajramit të Math.
2. – Dita e parë dhe e dytë e Bajramit të Vogël.
3. – Nata e Mirë e Miraxhit.
4. – Nata e Mirë e Beratit.
5. – Dita e Nevludit.
6. – Dita e Matamit.
7. – Dita e Novruzit.
8. – Dita e parë dhe e dytë e Pashkëve Orthodhokse.
9. – Dita e parë dhe e dytë e Pashkëve Katholike.
10. – Dita e Ujit të Bekuar (6 Janar).
11. – Dita e Ungjillizimit të Shën Mërisë (25 Mars).
12. – Dita e Shënteve Pjetër e Pavl (29 Qershuer).
13. – Dita e të Ngjiturit të Zonjës në qiell (15 Gusht).
14. – Dita e Gjith Shënjtorve (1 Nëntor).
15. – Dita e parë dhe e dytë e Krishtlindjeve (25 e 26 Dhjetor).

Neni 3.

Në ditët e kremte të caktuara në dy nenet e mësipërme nuk mund të ndërpritet funksionimi i zyrave të sigurimit botuer, të telegrafave, telefonave e të radios dhe të spitaleve e ambullancave.

Zyrat e postave n'ato ditë do të fonksionojnë vetëm prej orës 9 - 12 por vetëm për ato dega që do të caktohen prej Ministrisë së Punëve Botore.

Neni 4.

E Djela dhe ditët kremtore llogariten për fillimin e afateve ligjore si edhe kur takojnë në vazhdim të tyne, por kur fundi i nji afati takon ditën e Djelë ose nji ditë kremtore, afati mbaron me ditën jo kremtore që e pason.

1.2 Zgjedhjet e 2 Dhjetorit 1945

AQSH, Fondi 489 (Presidiumi i Kuvendit Popullor), Viti 1945, D. 88, Fl. 1-2.

Mbledhje e 12-të Seancë e I e Kryesis së Këshillit Antifashist Nacional-Çlirimtar

Mbajtur në Tiranë më 1 Tetor 1945 ora 15.

Bëhet thirrja emërore dhe gjenden pranë shokët: Gjen. Leint. Koçi Xoxe (Nënkryetar), Kolonel Baba Mustafa Xhani (Nënkryetar), Hasan Pulo (Nënkryetar), Koço Tashko (Sekretar), Sami Baholli (Sekretar), Gjeneral-Major Bedri Spahiu, Gjeneral-Major Dali Ndreu, Gjeneral-Kolonel Enver Hoxha, Dr. Ingj. Gaqo Tashko, Gogo Nushi, Prof. Gjergj Kokoshi, Kolonel Haxhi Lleshi, Kolonel Islam Radovicka, Kolonel Kristo Themelko Manol Konomi, Gjeneral-Major Myslim Peza, Olga Plumbi, Qiriako Harito, Kolonel Ramadan Çitaku, Prof. Sejfullah Malëshova, Prof. Siri Shapllo,

Ingj. Spiro Kolek, Gjeneral-Major Spiro Moisiu, Kolonel Tuk Jakova, Dr. Ymer Dishnica; mungojnë vetëm: Kolonel Hysni Kapo, Liri Gega, Dr. Medar Shtylla, Nako Spiru.

Sh. Kryetar mbasi konstaton shumicën, deklaron mbledhjen e hapur dhe i njofton se qëllimi i kësaj mbledhje është: 1) për marien e vendimit për caktimin e ditës së zgjedhjeve; 2) për emërimin e Komisionit qendror të zgjedhjeve.

Këndohen propozimet dhe pranohen unanimisht, duke abstenuar vetëm një, si vijon:

Në mbështetje të nenit 2 të "ligjës Nr. 124 datë 28 Shtator 1945 mbi zgjedhjen e përfaqësuesave të Popullit për Asamblenë Kushtetonjëse" dhe mbi propozimin e Kryetarit të Qeverisë Demokratike,

Kryesia e Këshillit Antifashist Nacional-Çlirimtar,

V e n d o s i:

I.

Zgjedhjet për përfaqësues të Popullit për Asamblenë Kushtetonjëse të bëhen me 2 Dhjetor 1945, ditën e Dielë, duke filluar prej orës 7 të mëngjezit deri në orën 19 të mbrëmjes.

II.

Ky vendim hyn në fuqi me shpalljen në Gazetën Zyrtare.

Në mbështetje të nenit 7 të Ligjës nr. 124 d.28 Shtator 1945 mbi zgjedhjet e përfaqësuesave të Popullit për Asamblenë Kushtetonjëse,

Kryesija e Këshillit Antifashist Nacional-Çlirimtar,

V E N D O S I:

I.

Emërimin e Komisjonit Qendror të Zgjedhjeve i përbërë prej personave që viijojnë:

1) Andrea Saatçi	Kryetar
2) Andrea Nathanail	Sekretar
3) Faik Dishnica	Antar
4) Xhavid Gjata	"
5) Vasil Avrami	"
6) Halim Budo	"
7) Spiro Stringa	"

II.

Emërohen si zevendësa të tyre, personat që vijojnë:

1) Salim Luniku	Zev. Kryetar
2) Irakli Moçka	" Sekretar
3) Neki Delvina	" Anëtar
4) Sotir Kuneshka	" "
5) Vasil Bidoshi	" "

6) Karaman Ylli " "
7) Eqrem Çabej " "

III.

Ky vendim hyn në fuqi me njëherë.

Mbyllet mbledhja në orën 16.
S e k r e t a r i : K r y e t a r i :

AQSH, Fondi 14 (KQ i PPSH), Viti 1945, D. 147, Fl. 34.

23 Tetor 1945

Nako Spiro

Kemi bërë që në çdo nënprefekturë të organizohen konferenca me bajraktarët dhe fshatarët e pasur më familjet e Dëshmorëve me miqt e Lëvizjes N.Ç. dhe të Partisë konferenca të pregatitura rreth fushatës elektorale dhe duke u ngarkuar dhe punë të bëhen konferenca dhe me gjith mësuesit dhe fshatarët që kanë bërë shkollë të mesme dhe nënpunësit konferenca të tjera me organizatën e gruas dhe të rinisë (nënprefekturë për rast se do të kishim) shoqe të gjitha mblidhen.

Milka Selenica

AQSH, Fondi 14 (KQ i PPSH), Viti 1945, D. 147, Fl. 35.

Milka Selenicës
Shkodër
Përgjegje radiogramit datë 23 tetor

Me Bajraktarët dhe fshatarët e pasur të mos bëhen konferenca të veçanta. Ata të marrin pjesë në konferenca bashkë me popullin. Për të punuar me këta të dërgohen elementa nëpër shtëpit e tyre dhe të bëjnë punë individuale.

Shokët që bëjnë konferenca në çdo shtresë të përgatiten mirë.

Nako Spiru

Arkivi i MEPJ, Viti 1945, D. 21, Fl. 37-38.

Përgjegja e Kryetarit të Qeveris Sonë

I ndershmi Zotni,

Kam nderin ti përgjigjem notës së Zotnis s'uaj që më drejtuat më datë 12 Nendor 1945 në lidhje me njohjen e Qeverisë Demokratike të Shqipërisë dhe lu lutem të kini mirësinë t'i transmetoni Qeverisë së Zotnis s'uaj sa vijon:

"Qeveria Demokratike e Shqipërisë e bazuar në parimet demokratike, të cilat Asambletë përfaqësonjëse të popullit i kanë konsoliduar në ligjë, i ka mbrojtur dhe do t'i mbrojë këto parime me gjithë forcën e saj pse këto janë të lidhura ngushtë me ekzistencën e vet.

Ligjet tona demokratike u kanë siguarur njerëzve të Shqipërisë të gjitha liritë dhe të drejtat që mund të gezojë një njeri në vendim më Demokratik. Ligja për zgjedhjet e asamblesë Kushtetonjëse, ligjë nga më demokratiket, ka parashikuar dhe u ka siguruar të gjitha liritë dhe të drejtat individëve ose grupeve anti-fashiste dhe Qeverija e jonë duke u mbështetur dhe duke i zbatuar përpikshmërisht këto ligje u dha mundësinë të gjithëve, individë ose grup, të marin pjesë direkte në këtë eveniment historik të vendit tonë duke zgjedhur dhe duke u zgjedhur. Fshehtësija dhe liria e votës do të observohet me rigorozitetin më të math. Liria e shtypit ka qenë dhe do të jetë një nga parimet themeltare të demokracisë sonë.

Qeverija jonë që nuk ka penguar kurrë hyrjen në vendin tonë të korrespondentëve të huaj, por që kur do herë ka pranuar kërkesat e tyre dhe iu ka dhënë të gjitha lehtësitë, me kënaqësi do të vazhdojë t'i lejojë të vinë të shofin zhvillimin e zgjedhjeve dhe të konstatojnë "de visu" se sa me skrupolozitet observohen ligjet tona demokratike dhe se qeverija e jonë është garancia më e sigurt për t'i mbrojtur dhe për t'i venë në zbatim këto ligje.

Për sa i përket traktateve ose marrëveshjeve që mund të jenë lidhur në mes Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Shqipërisë para datës 7 Prill 1939, referohemi letrës që ju kemi drejtuar më 13 Nëndor 1945 me anën e së cilës ju kërkojmë të na dërgoni kopjet e instrumentave të këtyre traktateve ose marrëveshjeve për të shikuar brendinë e tyre me qenë se shumica e arshivës së Ministrisë Punve të Jashtme të Shqipërisë është djegur ose grabitur nga okupatori. Por ne shpresojme te kjo kështu që qeverija jonë të marrë shpejt në shqyrtim të gjitha marrëveshjet që mund të ekzistojnë në mes dy vendeve t'ona.

Duke i pasur si themele të shëndosha të gjitha këto parime Demokatike, dhe duke i mbrojtur dhe zbatuar përpikshmërisht me gjithë forcën e veta, qeverija e jonë shpreson se Qeverija e Shteteve të Bashkuar t'Amerikës do të vendosë sa më parë marrëdhëniet diplomatike me Qeverinë t'onë, marrëdhënie që do të forcojnë edhe sa më shumë miqësinë që ekziston në mes të dy popujve t'anë, dhe populli shqiptar që, pa rezerva dhe gjithë çkishte për kauzën e Aleatëve, do të marri të drejtën e fituar me gjakun e tij që derdhi gjatë luftës së përbashkët për liri e demokraci. Ju

sigurojmë gjithashtu se populli shqiptar, ashtu si ka qenë i pari në luftë është dhe do të jetë kurdoherë në radhë të parë për të mbrojtur paqen dhe independencë dhe integritetin tokësor të vendit të tij.

Ju lutem pranoni nderimet e mia më të çquara

Kryeministër i Shqipërisë
Gjeneral-Kolonel Enver Hoxha

Arkivi i MEPJ, Viti 1945, D. 21, Fl. 41-42.

The Foreign Service of the United States of America

Tiranë, 19 Nëndor 1945
Nr. 34.
Përkthim jo zyrtar

I Ndershmi Gjeneral-Kolonel Hoxha:

Dyke lexuar tekstin e notës së Shteteve të Bashkuara drejtuar juve mbi njohjen e Qeverisë s'Uaj sikundër u botua në fletoren "BASHKIMI" datë 17 Nëndor 1945, e gjeta një fjalë me rëndësi të lënë jashtë. Ky mund të ketë shpëtuar jasht në përkthim të tekstit anglisht në gjuhën shqipe ose mund të jetë gabim shtypi.

Teksti i notës që iu dorëzua Z. S'Uaj në pjesën përkatëse thotë kështu:

> "... accordingly asks assurances .... that all democratic individuals and groups in Albania shall enjoy freedom of speech and the right lawfully to present and support their candidates;"

"BASHKIMI" thotë si vijon:

> "..... dhe prandaj kërkon sigurim... që të gjithë individët dhe grupet në Shqipëri të gëzojnë lirinë e fjalës dhe të drejtën e plotë ligjore për të paraqitur dhe përkrahur kandidatët e tyre;"

kështu, që nga sa duket, lihet jashtë kuptimi i fjalës "democratic", që figuron n'anglisht. Lenja e kuptimit të fjalës "democratic" prej botimit të tekstit të notës së Shteteve të Bashkuara në gjuhën shqipe, dhe besoj se dhe Ju bashkoheni me mua e shtrembon shumë kuptimin e kësaj fraze të posaçme edhe i epet popullit Shqiptarë një ide e gabuar mbi pozitën e Qeverisë s'eme në këtë çështje me randësi.

Une po ta' theksoj Z. S"Uaj këtë munges në version shqipë të notës së Shteteve të Bashkuara si asht botue për nji konsiderim t'uajin në çdo mënyrë që mund t'a shifni të përshtatun.

I juaji me respekte
H.T. Fultz,
Zëvendës Përfaqësonjës Amerikan

Arkivi i MEPJ, Viti 1945, D. 21, Fl. 45.

I ndershmi Zotni,

Jam dakord me Zotnin e juaj për çështjen e fjalës Demokratik, që është haruar të vihet në përkthimin e Notës inglish. Për këtë gjë kam dhënë urdhër që ta korrektojnë me një shënim të veçantë në gazetë.

Gabimi ka rrjedhur se është shtypur përkthimi shqip që më keni dërguar Zotnija e juan bashkangjitur me notën inglisht, dhe ku është harruar të vihet fjala demokratik, kurse në tekstin inglisht ekziston.

Mbetem me nderime të shquara
etc, etc, etc.

AQSH, Fondi 14 (KQ i PPSH), Viti 1945, D. 147, Fl. 67.

Nr. 87 13 Nëndor 1945

Koçi Xoxe

Fushatat elektorale vazhdon në të gjithë qarkun. Kudo zhvillohen konferenca e metingje në fshat lagje krahina e nënprefektura. Pjesëmarrja e popullit është e gjerë. Parashikojmë që edhe n'ato vende që nuk kanë qenë të lidhura me në përqindja e votimit të jetë e madhe.

Në Vlorë kemi ni kandidat indipendent Jani Konomin dhe tani që kemi filluar nga pjesa e dyt e fushata ta demaskojmë me shtyp apo jo.

T'u shkruejmë juve për shtypin.

Sami Gjebero

AQSH, Fondi 14 (KQ i PPSH), Viti 1945, D. 147, Fl.72.

Nr. 83 Tiranë më 21/XI/1945

GJITHË QARQEVE

Nga ana e pushtetit gjithë fotografët të lajmërohen që më 2 Dhjetor të marrin shumë fotografi të manifestimeve, në qendrat e votimit etj. Gjithashtu ata që kanë aparate të bëjnë sa më shumë fotografi. Ekipet në fshatra të kenë aparat të fotografojnë grupet e fshatarve që venë në votime, veçanërisht ku ka dëborë.

Dy kopje të çdo poze t'a dërgojnë seksionit të kulturës, njëra t'i dërgohet Ministrisë së Kulturës.

Nako Spiru

AQSH, Fondi 14 (KQ i PPSH), Viti 1945, D. 147, fl.75

Nr. 87 Tiranë 27/XI/1945

Gjithë qarqeve

Mobilizoni sa më shumë gazetarë e fotografë për në sallat e votimeve mundësisht edhe për fshatra. Gazetarët të marrin shënim emnat e votonjësve më karakteristikë dhe fjalët që mund të thonë përpara kutisë ase edhe përjashta. Interesojuni veçanërisht për nënat ase farefisin e dëshmorëvet të vjetër e të rinj. Interesojuni ç'thonë dhe si votojnë njerëzit e reaksionarëve të arratisur ose të dënuar. Interesojuni ç'thonë dhe si votojnë gratë të rinjtë pleqtë ushtarët invalidët e luftës të sëmurët dhe veçanërisht personalitetet politike dhe ushtarake. Në rrugë, në sallat e votimit ose në oborre të merren shënim fjalët e popullit pro ose kundër në lidhje me votën. Fotografët të bëjnë fotografitë më interesante rrugës kur vete populli në votim ose në oborret e qendrave elektorale dhe veçanërisht brënda në sallë. Të fotografohen përpara kutisë njerëzit që kanë të bëjnë me figura patriotësh të rilindjes, të kohës Zogut dhe të luftës Nacional-Çlirimtare.

Nako Spiru

AQSH, Fondi 14 (KQ i PPSH), Viti 1945, D. 147, Fl.74.

Nr. 36/1 26 Nëndor 1945

Koçi Xoxe

Në lidhje me zgjedhjet, ditët e fundit vrehet nji lëvizje e reaksionarëve. Shihet të bëjnë ndonji mbledhje të fshehtë dhe flitet për nji demonstratë zogiste. Sot u dëgjua se në Tiranë do të hidhen trakte dhe do të bëhet demonstratë me rastë të festës së flamurit.

Shokët janë vën në lëvizje. Në rast demonstrate zogiste, ne pa kompromentuar organet e pushtetit ose të mbrojtjes, do të mobilizojmë popullin kundra tyre. Mitingjet e djeshme ku folën kandidatët e Frontit patën sukses. U dallua gruaja me pjesmarrjen e saj. Do ju vëmë në dijeni mbi çdo gjë të re.

Spiro Pano

AQSH, Fondi 14 (KQ i PPSH), Viti 1945, D. 147, Fl.7.

Nr. 42/I 16 Tetor 1945

Koçi Xoxe

Më 15 u bë mitingu për Asamblenë në Kukës. Morrën pjesë rreth 800 vetave. U pa nji farë interesimi. Mendohet të marin pjesë në votime edhe grat. U bisedua veçanërisht me parinë dhe premtuan se do të bëjnë çmos që të votojnë dhe gratë dhe se ato do ta japin shembullin. Për parullat që do të hidhen do t'u njoftojmë më vonë. Për datën 25 tetor kemi organizuar mitingje në çdo komunë. Fillojnë konferenca në çdo katund për të popullarizuar ligjet.

Dashnor Mamaqi

AQSH, Fondi 14 (KQ i PPSH), Viti 1945, D. 147, Fl.14.

Nr. 521/VIII 18 Tetor 1945

Radiogram

Dashnor Mamaqit Kukës

Të popullarizohet Asambleja e zgjedhjet e jo ligji por fryma e ligjit se radiogrami i juaj kështu thotë popullarizimin e ligjit.

Koçi Xoxe

AQSH, Fondi 14 (KQ i PPSH), Viti 1945, D. 147, Fl. 27.

Nr. 36 Tiranë 22/X/1945

Kuksit, Vlorës, Durrsit

Në numrin e fundit të gazetës t'uaj që ka dalë gjatë Tetorit s'eshtë shkruar asgjë për zgjedhjet.

Kini parasysh se shtypi lot një rol të math në propagandën t'onë.

Nako Spiru

AQSH, Fondi 14 (KQ i PPSH), Viti 1945, D. 147, Fl.16-17.

KOMITETI QARKOR I Vdekje Fashizmit
PARTIS KOMUNISTE SHQIPTARE Liri Popullit
Durrës
Nr. Extra

KOMITETIT QËNDROR TË P.K.SH.
Tiranë

Ditë e mërkurë në të gjithë Qarkun e Durrësit u zhvilluan metingje në qytete e krahina, të cilat çelën fushatën e madhe elektorale për A.Kushtetuese. Metingjet kanë shkuar mirë në të tre qytetet: Krujë, Shijak e Kavajë ku unë, Riza Hoxha e Kiço Kasapi qemë si të deleguar të Frontit të nënprefekturës dhe drejtuam aty zhvillimin e këtyre metingjevet. Në Kavajë pjesëmarja e popullit ka qenë më e madhe se çdo herë tjetër dhe manifestimet më të gjalla. Në të gjitha krahinat e të katër nën prefekturave u zhvilluan po këtë ditë metingje të njëjta ku përsëri të deleguar të Frontit çelën fushatën elektorale. Pjesëmarja e popullit në disa prej këtyre krahinavet ka qenë e mirë dhe me një përqindje shumë herë më të madhe se tjera herë. Në disa prej tyre, nga mos lajmërimi i mirë i popullit dhe nga shkaku i punës (lëvrimit të tokavet) me të cilën janë të nxënë tashti katundarët, pjesmarrja e popullsisë nuk ka qenë gjithë aqë e madhe.

Ka patur grumbullim populli më shumë dhe janë zhvilluar mitingjet më mirë e më me enthusiazmë në krahinën e Ishmit, Ndroqit e të Prezës (Shijak); në krahinën e Kryevidhit (Kavajë); në krahinat e Milotit, Mamurasit e Urës Zezë (Krujë) si dhe në krahinën e Shënavlashit.

Të Dielën ora 4 mbas dite kemi organizuar metingun këtu në Durrës për çeljen e fushatës së zgjedhjeve. Presim të vijë atë ditë edhe shoku Nako Spiru, sikundër kemi biseduar e kemi d'akord me të kur ishte këtu.

Në lidhje me fushatën e zgjedhjevet për A.Kushtetuese kemi organizuar ekipe nga ana e Frontit në të gjithë qarkun: 7 ekipe këtu në Durrës, 6 ekipe në Kavajë; tre në Shijak e tre në Krujë. Prej të 7 ekipevet të Durrësit do të dërgojmë dy në Shijak, dy në Krujë e një në Kavajë. Ekipet i kemi organizuar mirë dhe të hënën i nisim nga i gjithë qarku për në krahinat e ndryshme ku do të qëndrojnë 15 ditë.

Në një mbledhje që patëm të K.Qarkor kemi caktuar një plan të gjërë pune në lidhje me fushatën elektorale.

Gjer më tani nuk është dukur asnjë shenjë organizimi a dalje opozite në të gjithë Qarkun. Vetëm Gjergj Kokoshi një ditë që ka ardhur këtu në Durrës ka marë kontakte me disa elementë të cilët nuk janë të lidhur mirë me lëvizjen t'onë, por të lëkundshëm, që kanë kredi edhe në popull sidomos tek tregëtarët si bije fjala: Vasil Bakalli, Dhimitër Gjergo, e dy të tjerë. Nuk kemi mundur të mësojmë mirë bisedimin që kanë patur, por kemi në vëzhgim gjithë lëvizjet e tyre.

Nër katunde fshatarët çfaqin disa vështirësira në lidhje me pjesmarrjen e gravet në votime, por pjesa më e madhe e tyre me rastin e mitingjevet që u zhvilluan aty kanë premtuar se do t'i bijen pa tjetër dhe se do të votojnë të gjithë për Frontin.

Do t'u mbajmë në korrent vazhdimisht mbi punën që do të zhvillohet në lidhje me fushatën elektorale si dhe me anë shkresash të shkurtëra e informative, ashtu edhe me radiogram kur të jetë nevoja.

Në vend të Qazim Domit për të cilin është mejtuar nga ana e Komitetit Qëndror me propozimin t'onë, për t'u vënë në listën e kandidatëvet të këtij Qarku, Neve jemi të mejtimit që të vihet shoku Fadil Dashi. Ky ka simpati më shumë nga Qazimi dhe një gjë e tillë u provua dhe me rastin e zgjedhjes së Komitetit Ekzekutiv të n/

prefekturës në Shijak ku Fadili fitoi vota më shumë se Qazimi. Si figurë e vjetër patrioti është më i njohur Qazimi, por Fadili gëzon më shumë simpathi si luftëtar nga më të parët në rrethin e Shijakut dhe që ka kontribuar më shumë në lëvizje nga Qazimi. Neve kemi besim se ky do të fitojë vota më shumë nga Qazimi besim këtë që na i kanë përforcuar edhe shokët e organizatës Shijakut. Në propozimet që i janë bërë nga ana e Kryesisë së Frontit, Sekretariat janë shënuar të dy këta si kandidatë. Në qoftëse, pra se do të shifet i arsyeshëm propozimi i jonë, na lajmëroni.

Komunikuam edhe në të tri celulat e tjera që kishin mbetur pa u komunikuar vendimin e K.Qëndror në lidhje me dënimet e dhëna për H.Ballhysën, S.Çelën e gjithë të tjerët. Kemi vënë në lidhje të posaçme gjithë të përjashtuarit dhe do t'u japim gjithë ndihmën që të përmirësohen; gjithashtu jemi duke vështruar edhe qëndrimin e tyre dhe punën që bëjnë. Një pjesë e tyre nuk është zhveshur akoma nga fryma e familjaritetit. Vazhdojnë të rrinë akoma sëbashku megjithse nuk kanë ndonjë lidhje organizative.

Në raportin mujor që së shpejti do t'u përcjellim do t'u vëmë në korent edhe më mirë mbi qëndrimin dhe punën e tyre. Gjithashtu do t'u shkruajmë gjatë edhe për gjithë organizatën e Qarkut.

Durrës 19/10/45

Të fala shoqërore
P.Komitetin Qarkor
A.Çarçani

Arkivi i MEPJ, Viti 1945, D. 11, Fl. 128-129.

Si e kanë shikuar antarët e Misjonit Englez gjëndjen t'onë

Për politikën t'onë. – Politikën t'onë të jashtme antarët e Misjonit Britanik e kanë quajtur të majtë ektreme të drejtuar nga Lindja në sferën e influencës Ruse, një politikë të adoptuar nga Jugosllavija, një kopje të politikës së sajë dhe një besnike të pa përkulur të Mareshallit Tito dhe të Bashkimit Sovjetik. Ata janë shprehur hapur në popul kundra kësaj politike duke e quajtur pro Ruse. Z. Major V. Robinson, Atashe i shtypit pranë Misjonit Britanik në Shqipëri, në raportin me titull "Raport Nr. 1 1946 për periudhën e dyfishtë Janar-Shkurt" dhe që u është shpërnarë në dy kopje Ministrisë së Informacjonit Londër, Ministrit Nalt Madhnis së tij Tiranë (t'i dërgohet atij n'Itali po të jetë e mundur) dhe një kopje dega e Atashes së shtypit, shkruan tekstualisht kështu: "Shqipërija është një shtet totalitar në të cilin, politika e Qeveris synon të bëjë çdo njeri pro Rus dhe për këtë qëllim përdor çdo mjet propagande. Asgjë smund të bëjë për të ndruar këtë situatë deri sa mos jetë një ndryshim politik i përnjë hershëm dhe i plotë'.

Në një rast tjetër duke dashur të përcaktojë politikën t'onë Atasheja e shtypit Major Robinson shkruan kështu në një Memorandum mbi punët e Atashes së

shtypit në Shqipëri, të cilën ja dërgon z. H.B.M. Ministër, Tiranë dhe që mban datën 14 Janar 1946: "Të gjith mjetet e shtypit janë në duart e Shtetit dhe politika e Shtetit është e hapur pro Ruse dhe e maskuar si anti-Britanike".

....

Gjenerali Hodgson vetë, në Raportin e tij me titull "Turi Shqipërisë së Jugut 2-6 Prill, harta 1:200000 Shqipërija duke folur për pritjet që i bëri populli në Jugë shkruan midis të tjerave: "Asortimenti i gjith-anëshëm (ose uzak) i thirrjeve ishte i dukshëm duke thirrur "Urra" për Zotin Churchill, Zotin Roosevelt dhe Marreshallin Stalin, Misjonin Britanik dhe Komandantin e sajë", dhe më poshtë duke folur për këto manifestime ay thotë: "objekti i rregullit të këtyre demostratave është ndofta jo vetëm që të më impresionojnë mua me popullarizimin e shumtë të Qeverisë, por gjithashtu t'i jepej popullit impresjoni që çdo gjë qe e mirë në marrdhënjet e Qeveris me Aleatët e Perëndimit..."

1.3 Njohja e qeverisë shqiptare në arenën ndërkombëtare

Arkivi i MEPJ, Viti 1945, D. 21, Fl. 3-4.

Caserta, Mars 22, 1945

MEMORANDUM

Zyra e Këshilltarit Politik të Shtetevet të Bashkuara në Caserta ashtë udhëzuar nga Departamenti i Shtetit (Ministria e Jashtme) me i konfirmue Gjeneral Kolonel Enver Hoxhës, Komandantit të Përgjithshëm të U.N.C.SH., Tiranë, informatat qe ju banë verbalisht më 20 Janar 1945 Nenkolonel Kadri Hoxhës, përfaqësuesit të F.N.C. Bari, Itali, tue i komunikue Gjeneral Hoxhës deklaratën e poshtëshënuarë e cila shpreh qendrimin e Qeverris të Shtetevet të Bashkuara përsa i përket kërkesës të cilën aji i drejtoi Presidentit të Shtetevet të Bashkuara më 21 Dhetuer 1944 për njoftjen e "Qeverris Demokratike të Shqipërisë" si qeverri e Shqipërisë.

Si dihet mirë, populli i Shtetevet të Bashkuara ka treguar gjithmonë nji interes të veçant në fatet e popullit shqiptar. Aji i di mirë vuajtjet dhe sakrificat e Shqipëtarëvet gjatë luftës tashmë, dhe trimërinë e patriotëve shqipëtarë në resistencën e tyre kundër anmiqëvet agresorë, megjithatë Qeverria e Shtetevet të Bashkuara e gjenë të nevojshme të mos shtroj problemin e përgjithshëm të njoftjes zyrtare të çdo qeverrije në Shqipëri tash për tash. Ajo kujton se, si një prerekuizitë të shqyrtimit të ksaj çeshtje, duhet të informohet ma plotësisht përsa i përket konditavet dhe zhvillimevet në Shqipëri dhe karakterit representativ të autoritetevet ekzistente.

Kjo Qeverri nuk ka ndër mend me dërguarë nji mision ushtarak në Shqipëri, siç ka marrë vesht se po ban Qeverrija Britanike, dhe njësitë speciale amerikane tash

atje, natyrisht nuk mundet të pretendohet se përballojnë nevojat e reja që lindin në fazën e tashme. Prandaj Departamenti i Shtetit do dëshironte qe në nji datë t'afërme të shpresohet se prezenca e përfaqësuesëve të till në Shqipëri ka për të qenë agreabël për autoritetet e tashme dhe se atyre kanë me ju akordue kortezitë dhe lehtësitë e duhura qe kanë me qenë të nevojshme me i ndihmue ata qe të plotësojnë misionin e tyre.

Gjeneral Hoxha sigurisht kam me kuptue se çdo vonesë i rregullimit të çashtjes si masipër kishte me kontribue vetem me axhurnue (shtytur për ma vonë) nji vendim nga kjo qeverri mbi veprimin qe ajo kishte marrun përsa i përket njoftjes.

c.c.(oficeri komandues, ndoshta)

Arkivi i MEPJ, Viti 1945, D. 21, Fl. 34.

The Foreign Service of the United States of America
Tiranë 12 Nëndor 1945
Nr. 31.

I ndershëm Zoti Gjeneral-Kolonel Hoxha,

Qeverija e Shteteve të Bashkuara, mbasi e shqyrtojë kërkesën e autoriteteve Shqiptare për një njohje, më ngarkojë t'ju njoftoj gadishmërinë e sajë të hyjë në marrëdhanje dipllomatike me regjimin e tanishëm të Shqipërisë.

Duke vendosur marrëdhanje zyrtare me Qeverinë Shqiptare, Qeverija e shteteve të Bashkuara dëshiron të veprojë në pajtim me detyrimet dhe parimet për të cilat është angazhuar në deklaratën e Krimesë në lidhje me Europën e çliruar dhe prandaj kërkon sigurime që zgjedhjet e arthme për Asamblenë kushtetonjëse të zhvillohen mbi baza me të vërtetë të lira, me vota të mshehta dhe pa kërcënime apo friksime; që të gjithë individujt dhe grupet në Shqipëri të gëzojnë lirinë e fjalës dhe të drejtën e plotë ligjore për të paraqitur dhe përkrahur kandidatët e tyre; dhe që korrespondentët e shtypit të huaj të lejohen të hyjnë në Shqipëri të vëzhgojnë dhe të raportojnë lirisht mbi zgjedhjet dhe mbi veprimtarinë e Asamblesë Kushtetonjëse.

Qeverija e Shteteve të Bashkuara gjithashtu dëshiron që autoritetet Shqiptare të konfirmojnë që traktatet dhe marrëveshjet që ishin në fuqi midis Shteteve të Bashkuara t'Amerikës dhe Shqipërisë më 7 Prill 1939 të mbeten në fuqi. Qeverija e Shteteve të Bashkuara, nga ana e vet, konfirmon vleftësinë e vazhdimit të fuqive t'atyre instrumentave.

Me t'i marrë këto sigurime të kërkuara, Qeverija e Shteteve të Bashkuara do të jetë gati të bëjë shkëmbimin e përfaqësonjësve diplomatikë.

Gjithashtu jam i porositur t'ju këshilloj se proponimi i tanishëm i Qeverisë së Shteteve të Bashkuara për sa i takon vendosjes së marrëdhënjeve diplomatike nuk duhet të pandehet se paragjykon konsiderimin, në ndonjë datë të mëvonshme, të çështjeve të tjera me karakter ndërkombëtar që prekin Shqipërinë.

Do të jem fort i lumtur t'i transmetoj Qeverisë s'ime përgjigjen t'uaj rreth proponimeve të parashtruara më sipër.

Me nderime
H.T. Fultz.

Arkivi i MEPJ, Viti 1945, D. 6, Fl. 2.

Sot, n'ora 8 ne mengjez, Kryeministri i Shqiperise. Z. Gjeneral Kolonel Enver Hoxha priti n'audience Shefin e Misionit Ushtarak Sovjetik, Z. Kolonel Sokolof i cili paraqiti kete note:

I ndershmi Zoti Kryeminister,

I ngarkuar nga Qeveria Sovjetike, kam nderin t'ju komunikoj:

"Qeveria Sovjetike gjat ketyre vjetave te luftes kunder okupatoreve gjermane dhe italjane, ka ndjekur me vrejtje dhe me simpathi luften e tij. Me kete lufte, populli shqiptar dhe dhe ay kontributin e tij per triumfin e aleatve mbi armikun e perbashket. Qeveris Provizore Shqiptare qe ka besimin dhe perkrahjen e popullit shqiptar, ka pasur suksese me rendesi ne rindertimin e Shtetit Demokratik ne Shqiperi.

"Duke marre parasysh kete note dhe deshire me vendet e tjera demokratike per te siguruar paqen dhe sigurine, Qeveria Sovjetike vendosi te lidhij marredhenje diplomatike me Shqiperine dhe te shkembeje perfaqesues diplomatike.

Marr kete rast te shfaq nderimet e mia te larta.

SOKOLOF (СОКОЛОВ)

Qeveria Demokratike e Shqiperise vendosi te lidhe maredhenje diplomatike me Bashkimin Sovjetik.

Sot, ora me 9, u mblodh Keshilli Ministerial dhe, passi mori njoftimin me kenaqesi vendosi te lidhe me nje here maredhenje diplomatike.

8 Nentor 1945.

AQSH, Fondi 14 (KQ i PPSH), Viti 1945, D. 146, Fl.15.

TEPËR URGJENT E KONSPIRATIV
SEKRETARIT POLITIK TË QARKOREVET (PERSONALE)
(Radiogrami pasi të këndohet e të kupëtohet të griset.)

Me qenë se Shqipërija nuk u thirr në konferencën e San Franciskos dhe qeverija e jonë akoma nuk është njohur nga aleatët, me gjithë se e ka kërkuar zyrtarisht të

njihej, është e nevojshëm që i tërë populli shqipëtar nër mitingje e manifestime të gjera, të shprehi vullnetin e tija në konferencën e San Franciskos, duke treguar se populli i jonë këtë të drejtë e ka fituar me luftën e tij heroike, krah për krah me aleatët kundra fashizmit, nënë udhëheqjen e qeverisë së tija, që është e vetmja qeveri që përfaqëson popullin.

Për këtë arësye e tërë organizata e Partisë duhet të mobilizohet dhe të vërë në lëvizje të gjitha organizatat antifashiste dhe të nxisi masat e gjera të popullit, për mitingje e manifestime sa më të gjera. Duhet të tregoni kujdesin më të madh që këto manifestime të dalin nga poshtë, nga vetë masat e popullit dhe në asnjë mënyrë të mos duket si dishka e kurdisur nga juvet. Keto mitingje e manifestime duhet të shpërthejnë në të gjithë qarkun dhe të bëni çmos që në qendër të Prefekturës dhe të N/Prefekturavet më kryesore, të mblidhet sa më tepër popull i ardhur nga të gjitha katundet që harihet qyteti dhe nga N/Prefekturat që janë afër qytetit. I gjithë populli i Qarkut duhet të jetë në këmbë për këto manifestime. Ju duhet ta kupëtoni mirë rëndësinë e tyre dhe kujdesin që duhet të tregoni për të pasur sa më tepër sukses. Në këtë mënyrë ne duhet t'i tregojmë botës se i tërë populli është me qeverin e tij demokratike dhe kërkon më këmbëngulje pjesmarrjen e Shqipërisë në Konferencën e San Franciskos. Mitingjet dhe manifestimet duhet të zgjatin me ditë e jo me orë. Nër mitingje duhet të theksohet pjesëmarrja e jonë në Konferencën e San Franciskos dhe natyrisht prej këtej duhet të hidhet edhe parulla për njohjen e qeverisë s'onë si e vetmja qeveri e popullit dhe për popullin. Prej këtyre mitingjevet duhet t'i bëhen telegrame Qeverisë, në të cilat telegrame të kërkohet pjesëmarja e jonë në konferencën e San Franciskos. Të mos harrohet që nëpër telegramet të shënohet numuri i popullit që mer pjesë dhe vendi ku bëhet mitingu, të mos harohet as katundi më i fundit pa bërë telgram e pa u shënuar. Telegramet të firmosen nga komisjone të dala nga populli dhe numuri i firmavet, në bazë të pjesëmarjes së gjerë të popullit, mund të harijë gjer më 100. Nër mitingje duhet të flitet për luftën dhe përpjekjet e popullit t'onë luftë e cila e ka vënë krahas me të gjithë popujt liridashës, gjithashtu edhe për qeverinë t'onë si e vetmja qeveri që ka dalë nga populli dhe që e përfaqëson popullin. Duhet të kujdeseni që manifestimet të dalin nënë flamurin e bllokut antifashist, të theksohet fryma e jonë demokratike, lidhja e jonë e qëndrueshme me popujt liridashës dhe më tepër se gjithshka t'u theksohet se ne jemi e do të jemi me bllokun antifashist. Kini parasysh artikujt e Bashkimit, dëgjoni radjo Tiranën dhe theksoni para popullit se si edhe shtypi i huaj i Turqisë, Jugosllavisë, Italisë etj. Po flasin sot për mos thirrjen e Shqipërisë në konferencën e San Franciskos dhe këta flasin se e kanë dëgjuar luftën t'onë dhe i njohin sakrificat t'ona në këtë luft. Me të marrë radiogramin ja filloni përnjëherësh punës dhe kujdesuni që manifestimet të jenë sa më të gjera dhe madhështore, i gjithë populli duhet të ngrihet më këmbë e të manifestojë.

Parullat:

Kërkojmë pjesëmarrjen t'onë në konferencën e San Franciskos

Duam njohjen e qeverisë nga aleatët

Rrofshin aleatët e Mëdhenj
Rroftë Vllazërimi i popujvet përparimtarë
Rroftë qeverija e jonë demokratike
Rroftë Kryetari i Qeverisë e Komandanti i ynë Enver Hoxha
e të tjera parulla si këto, por gjithmonë në këtë frymë dhe të jenë të përgatitura e të shkruara nëpër pankarta.

AQSH, Fondi 14 (KQ i PPSH), Viti 1945, D. 146, Fl. 4.

Berat 26.3.45
Koci Xoxe
Me 25 mars me rastin e metingut të Rinis Anti-fashiste të këtij qyteti populli së bashku me rinin kërkuan njohjen e Qeverisë dhe pjesëmarrjen në konferencën e San Franciskos. Mbasdite shpërtheu në manifestim më tepër se 7000 veta qytetar të cilët kërkonin me këmbengulje njohjen e Qeverisë dhe pjesëmarrjen në Konferencën e San Franciskos. Nga turma doli një komision ku iu drejtua nji telegram qeverisë e cila të transmetonte zërin e popullit ndër Aleatët e Mëdhenj.
Llambi Kudra

AQSH, Fondi 14 (KQ i PPSH), Viti 1945, D. 146, Fl. 8.

Tiranë më 10/XI/1945
Gjithë qarqeve
Me rastin e njohjes së Qeverisë nga Aleatët të organizohen manifestime, ku të çfaqet dashurija kundrejt Aleatëve, sidomos kundrejt Bashkimit Sovjetik. Si vijë për këtë çështje për tashti do t'u vlejë teksti i përgjegjes që u jepet nga Qeverija Aleatëve dhe që botohet nesër në Bashkimi.
Nako Spiru

KAPITULLI II

PERSEKUTIMET NË VITET E PARA TË SISTEMIT KOMUNIST

2.1 Terrori komunist dhe statistika të të dënuarve në Shqipëri 1945-1955

Arkivi i MEPJ, Viti 1945, D. 11, Fl. 131-132.

SI E KANË SHIKUAR ANTARËT E MISJONIT ANGLEZ GJENDJEN T'ONË

Gjëndjen t'onë të Mbrendhshme. - Regjimin t'onë popullor e kanë quajtur pro komunist. Kanë thënë se këtu dominon Partija Komuniste, s'ka liri fjale, shtypi propaganda, s'lehet e lirë opozita, ka shtypje, burgosje, internime. Regjimin t'onë e quajnë një fashizëm të dytë me një ngjyrë të kuqe, regjim totalitar, ku burgosjet, rrahjet, internimet, vrasjet janë në rendin e ditës. Kanë folur me përbuzje për gjyqet e popullit kundër kriminelëve të luftës, duke i quajtur të paaftë, të papjekur dhe të drejtuar prej njerëzve pa eksperiencë, vendimet e tyre i quajnë krime gjyqsore.

Nuk e gjejnë më vend qëndrimin e shtypit t'onë karshi reaksjonarve klerikalë katolikë dhe thërresin për një betejë t'ashpër të shtypit t'onë karshityre, flasin me ngulmim për një opozitë të fortë në Veri dhe kudo gjetkë. Trumbetojnë zbulimin e organizatës gjoja demokratike "Bashkimi Kombëtar" dhe flasin me ngulmim për një shtypje të padrejtë që u bëhet atyre. E nxjerrin të pa vend dhe të padrejtë arrestimin e Gjergj Kokoshit, Suat Asllanit dhe Musine Kokalarit me shokët e tyre, duke i akuzuar autoritetet tona qeveritare se me qëllim kërkojnë t'u hedhin atyre "përgjegjsinë se janë ndërlikuar me organizata terroriste, ose se gjoja kanë pranuar pretendimet Greke mbi Vorio-Epririn. Për të gjitha këto ata janë frymëzuar nga rrethi aristokratik i Majorit Robinson, i cili shprehet kështu në raportin e tij: "Raport Nr. 1 1946 periudhë e dyfishtë Janar-Shkurt dhe e shpërndarë: dy kopje Ministrit të Informacjonit në Londër, një kopje Ministrit të Nalt-Madhnis së tij Tiranë (t'i dërgohet atij n"Itali po të jetë e mundur), nje kopje Atashes së Shtypit; dhe pikërisht paragrafin e II-të, ku flet mbi situatën politike: "Ky vit pararqet një situatë politike të qetë në dukje. Aristokracia që në evidencë në raste të ndryshme si darka e vitit të ri, në ballo në Dajti dhe asnjeri nuk dukej nervoz në krahasim me gjysmën e vitit 1945, në fund të Janarit situata u ndrrua e tëra dhe një terror i përgjithshëm mbretëroj kudo...". Më poshtë ai vijon: "Në mes të Janarit ishte plot me goditje kundër elementëve të tjerë katolike si pregatitja për arrestimin dhe gjyqin e shumë

priftërinjve dhe të tjerë në shkurt...” dhe pastaj “Gjergj Kokoshi, Suat Asllani dhe Musine Kokalari ishin njerëzit më të njohur në arrestimet e Tiranës, dy nëpunës të UNRRA-s, Lory Post dhe Shaban Balla janë midis t’arrestuarve”.

Majori Robinson shprehet më hapur në raportin e tij, datë 16 Shkurt 1946 që ka për subjekt Legata, Zonjusha Brooks, gazeta, filam, situata politike që i është drejtuar Zotit Ruthven Murray, Seksjoni Ballkanik M.C.I. London, i cili thotë pikërisht kështu: “Kam bërë një përpjekje të madhe për një mot të tërë të bind vehten t’ime se Qeverija Shqiptare tenton të ngrejë ekonominë e popullit, t’a nxjerrë atë nga të prapambeturit dhe eksploatimi, të qeverisi në interes të popullit dhe jo në interes të pasanikëve, duke ballancuar në këtë mënyrë veprimet e padrejta dhe të ashpra të metodës së tyre për të qëndruar në fuqi. Këto përpjekje tani kanë pushuar. Tiranija e vërtetë në këtë vend, qeverisja me terror, spiunllëku dhe të shtrënguarit e popullit të spiunojë për njëri tjetrin, arrestime dhe rrahjet në burgjet, gjyqet e pjekur kundër patriotëve të ndershëm si kriminelë lufte, krimet gjyqsore të njoftuna si ekzekutime, fallsifikime i vazhdueshëm i lajmeve dhe i fakteve, zhdukja e së vërtetës dhe e ankimit, duan të thonë se nuk ka asnjë diferencë midis këtij regjimi dhe fashizmit, veçse ky është i kuq në vend të atij të ziu.

Ata pardje vranë Lef Nosin, Anton Arapin dhe Maliq Bushatin.

Arkivi i MEPJ, Viti 1945, D. 11, Fl. 133-134.

Largimi i Misjonit Britanik dhe shpifjet e ndryshme

Të influencuar nga rrethi i tyre reaksjonar dhe nga arisokracija e kalbur, ata e shihnin gjendjen t’onë shumë të ashpër dhe shtypëse. Kishin filluar të flitnin poshtë e lartë se është një regjim komunist dhe shfaqnin hapur këtë duke u mundura të vini në lidhje me grupe të ndryshme reaksjonare. Herë pas herë kishin sugjeruar dhe çfaqur pa kënaqësi për shoqërimin, për mes lënjes së lirë të shkojnë poshtë e lartë Shqipërisë. Z. Hill shkruan se “Qeverija i arreston ata që takohen me Englezët”. Kishin sugjeruar në komandën e tyre se këtu nuk mund të shkohet në këtë mënyrë dhe bënin shpifje të çdo lloji për regjimin tonë.

...

Pas largimit nga Shqipëria Gjeneral Hodgson vazhdoj punën e luftës propagandistike edhe jashtë kundra vëndit t’onë. Filloj të raportoj keq për gjëndjen t’onë të brendshme dhe bënte mijra shpifje të ndryshme edhe në lidhje me marrëdhëniet e Qeveris me UNRRA dhe kishte sugjeruar:

1. – Heqja e UNRRA-s nga Shqipëria,
2. – Kishte raportuar për keq përdorimin e automjeteve të sjella nga UNRRA për shërbime ushtarale nga Qeverija Shqiptare.
3. – Qeverija Shqiptare nuk e rrespekton siç duhet marrëveshtjen me UNRRA-s

4. Të 26 nëpunësat që janë pushuar nga puna me urdhër të Qeveris Shqiptare e kishte veshur me ngjyrë politike, si një masë e Qeverisë kundra tyre dhe katolikëve.
5. – Kishte akuzuar shefin e Misjonit UNRRA-s Z. Hill për qëndrim jo korrekt karshi Qeveris që kështu t'i plotsoheshin qëllimet e raportet e tija të këqija.

Në një kabllo-gram që i dërgon Gale Jackson në Ëashington datë 19 Prill 1946 zyra e PRDG i thotë kështu: "Dje intervistova Brigadier Hodgson, i cili përsëriti çështje që ju mund t'i quani të tilla si:

a) Heqja e gjith antarve të Misjonit që janë katolikë dhe flasin Anglisht.
b) Keq përdorimi i të gjitha maqinave të UNRRA-s nga Qeverija.
c) Ndalimi i triskave të rasionit nacionalistave që janë të një shikimi të kundërt politik. Përmbi këtë subjekt u është referuar qendrës së UNRRA-s dhe Komanda e Përgjithshme e Mesdheut nga ndërlidhsi i UNRRA-s me të Ricard Saul.

Arkivi i MPB, Fondi 1, Viti 1945, D. 1086, Fl. 1-7

REPUBLIKA POPULLORE E SHQIPËRISË — Vdekje Fashizmit
GJYKATA USHTARAKE E TIRANËS — Liri Popullit
Nr. 24 i Librit Themelòr

P R O Ç E S - V E R B A L

Prokurorija e kësaj Gjykate me akt-akuzën datë 31 Janar 1946 na referon për gjykim bashkë me aktet tre të pandehurit: 1) LEF NOSI nga Elbasani, 2) Patër ANTON HARAPI, nga Shkodra dhe 3) MALIQ BUSHATI, po nga Shkodra, t'akuzuar pse si kriminela lufte dhe armiqë të popullit: dy të parët në cilësinë e tyre anëtarë të Regjencës në kohën e okupasionit nazist, kanë bashkëpunuar dhe i kanë shërbyer këtij okupatori në dëm t'interesave të larta t'Atdheut dhe janë përgjegjës për të gjitha krimet, çkatërrimet dhe dëmet materiale të kryera në vëndin t'onë dhe i treti ka përgatitur, në bashkëpunim me tradhëtarë të tjerë, terrenin për okupimin e Shqipris nga Italia Fashiste, ka sabotuar rezistencën e popullit Shqiptar, në cilësinë e tij Kryeministër në kohën e okupasionit fashist ka bashkëpunuar në mënyrën më të ngushtë me okupatorin në dëm të popullit shqiptar dhe ka mobilizuar e suvencionuar forca armate për kundra luftës Nacional-Çlirimtare, etj.etj.

Aktet u regjistruan nën Nr. 24 të Librit Themelòr të këtij vjeti dhe për ditë gjykimi të çështjes u caktua data 1 Fròr 1946, ora 9, duke iu njoftuar të pandehurve që ndodhen t'arrestuar.

Tiranë, më 31 janar 1946

Sekretari: — Kryetari:

Sot, ditën dhe orën e caktuar, Gjyqi u formua nga:
Major Irakli Bozo Kryetar,
" Tonin Jakova Anëtar,
" Gjon Banushi "

me pjesëmarrjen e Prokurorit Major Misto Treska, duke qënë i asistuar prej Sekretarëve Aspirant Thoma Rino e Kapter Zalo Xhomaqi dhe filloi gjykim'i çështjes botërisht, faqësisht e me dyer të çelura në sallën e Kino-Theatër "KOSOVA".

U sollën nga burgu rregullisht të shoqëruar tre të pandehurit Lef Nosi, Patër Anton Harapi e Maliq Bushati, të cilët, duke qënë të lirë, u vunë në vëndet e posaçëm.

U muar identitet'i të pandehurve që thanë se quhen:

1) LEF NOSI, i bir'i Stilianit dhe i Anes, lindur më 1873 n'Elbasan, atje banues, me punë private, me arësim të mesëm, i pamartuar, i padënuar.

2) Patër ANTON HARAPI, i bir'i Loros dhe i Luçìs, lindur më 1888 në Shkodër, atje banues, fetàr, me arësim të naltë, i pamartuar, i padënuar.

3) MALIQ BUSHATI, i bir'i Hysenit dhe i Qamiles, vjeç 56, lindur e banues në Shkodër, me arësim të mesëm, pronàr, i divorcuar, i padënuar.

U caktuan përfaqësonjësit mbrojtës të tyre: të parit Av. Zoi Xoxa, të dytit Av. Spiro Stringa dhe të tretit Av. Vasil Xhai. Të pandehurit pranuan të përfaqësohen nga këta avokatë.

U këndua akt-akuza e përgjithëshme e Prokurorit.

Prokurori Major Misto Treska përsëriti akt-akuzën.

Meret në pyetje i pandehuri LEF NOSI, i cili tha: "Kur Ushtërija italiane okupoi Shqiprinë unë u ndodha n'Elbasan; këtë okupim e prita me hidhërim; çdo shqiptar duhej të luftonte okupatorin. Unë e kam luftuar por jo me pushkë, vetëm me propagandë.

Nuk është e vërtetë që unë kam marë inisiativën dhe të kem qënë Kryetar i Komisionit për mbledhjen e leshit në favor t'okupatorit, por kam qënë vetëm një anëtar i thjeshtë i këtij Komisioni dhe këtë detyrë e pranova mbasi m'a caktoi Prefekti dhe me qënë se atëhere isha kthyer nga internimi prej Italie".

Prokurori tha: "I pandehuri Lef Nosi ndodhej i internuar n'Itali por ky qëndronte në Hotelet më të mirë të Romës dhe nuk ishte në gjendjen e t'internuarve të tjerë; kur u kthye u bë me një herë kryetar i Komisionit për mbledhjen e leshit në favor t'okupatorit italian".

I pandehuri: - Unë n'internim rrinja bashkë me Hysejn Plagraricën. Nuk është e vërtetë që të kem marë të holla nga Fashizmi. Në korrik të vjetit 1940 jam kthyer nga Italia; n'atë kohë Kryeministër ka qënë Vërlaci. Nuk mbaj mënd që në këtë kohë të kem ardhur në Tiranë.

Me Mid'hat Frashërin jam takuar në Tiranë kur u ktheva nga Italia, në Librarin' e tij. Por me 'të kam biseduar vetëm për çështje librash.

Çështja e Ballit Kombtar më është parashtruar nga Et'hem Haxhiademi, i cili erdhi n'Elbasan dhe më thirri, duke më vënë në dijenì se këtu do të formohej një degë e

Ballit Kombtar dhe si Kryetar i saj të isha unë; unë nuk e pranova këtë detyrë, por mbassi insistoi dhe se si m'a mbushi mëndjen dhe e pranova. U bashkova me Ballin dhe u bëra Kryetar i Degës n'Elbasan, mbassi këta të Ballit më erdhën më parë dhe Et'hem Haxhiademi mundi të më kandisë".

Prokurori: - Lëvizja Nacional-Çlirimtare kishte filluar shumë më përpara aktivitetin e saj, duke dhënë dhe prova në luftë kundra okupatorit dhe në veprime të tjera. Të pandehurit Lef i kishin shkuar mjaftë herë shumë njerëz të Lëvizjes Nac. Çl. dhe e kishin ftuar që të bashkohej duke i shpjeguar edhe qëllimin e programin që kishte Lëvizja. Me gjithë këtë, ky nuk ka pranuar".

I pandehuri: - Me të vërtetë Lëvizja Nac.Çl. e ka filluar veprimtarinë e saja më përpara se Balli Kombëtar, por këtë veprimtari e bënte ky e lypte dhe se n'Elbasan nuk kishte nonjë zhvillim.

Këndohet një dekllaratë e Piro Dodbibës e ndodhur midis akteve që vërteton se dekllaruesi ka shkuar tek i pandehuri i thirur prej këtij të fundit dhe se ky e ka këshilluar dhe më në fund kërcënuar që të largohesh nga veprimtarija që bënte në favor të Lëvizjes.

I pandehuri tha: Me Piro Dodbibën nuk kam pasur ndonjë lidhje, (karshi demostratavet fshihen këto dy fjalë). Me Prefektin e Elbasanit Musa Pukën s'kam pasur ndonjë lidhje, karshi demostratavet Prefekti mbante qëndrim favorizuës. Nuk di pse u vra; S'më ka ardhur keq për vrasjen e Musa Pukës. Dekllaratat e Piro Dodbibës i kundërshtoj, kjo gjë nuk ka ndodhur kurrë, për inate mund t'i bëjnë. Ramadan Çitaku ka biseduar me mua për me bashkëpunuar kundra okupatorit të dy palët Balli e Lëvizja Nacional Çlirimtare, unë i kam thënë të meresh vesh me Tiranën me krerët e Ballit për një bashkëpunim të këtillë. Nuk rashë në marëveshje pse një gjë e tillë varej nga qendra. Nuk kam urdhëruar forcat e Ballit n'Elbasan për të luftuar kundra okupatorit pse aty Balli s'kishte forca; një çetë që ishte lozte rolin e vet sikurse dhe çeta e Muzhaqit. Neve kishim çetën e Sif Sinanit të tjerat ishin lidhur me Shefqet Verlacin. Çetat tona s'kanë lëftuar; ndihmë prej nesh mernin; unë një herë kam dhënë ndihmë 20 Napolona. Ramadan Çitaku ka ardhur n'Elbasan dhe është fjalosur me mua në vjetin 1942. Partizanët e kishin filluar luftën kundra okupatorit qysh në vjetin 1941. Neve vinim në Tiranë në vitin 1942, po bisedimet i bënim të fshehta. Balli Kombëtar ishte një organizatë me qëllim që të lëftonte okupatorin. U formua në vjetin 1941 ose 1942.

Fishta e Gurakuqi i bënë një telegram këtij Kongresi; me të cilin e lajmëronim se ishim gati të bashkëpunonim me të.

Në Kabinetin që u formua në Durrës kam qenë Ministër i Ushqimevet, po unë nuk ushtrova ndonjë funksion pse ushqime s'kishte.

Gjatë kohës që unë kam qenë Kryetari Ballit n'Elbasan, s'është bërë ndonjë luftë prej Ballit. S'është vrarë ndonjë trathëtar. Ua thashë më parë se nuk di pse e thoshin parullën Vdekje trathëtarëvet. Organizata e Ballit Kombëtar, bënte prapagandë kundra okupatorit. Në fillim delnin trakte të regullta dhe sa kohë isha unë. Pastaj u prishën se mereshin me punë partish. Unë fort rallë n'Elbasan kopjonja dhe

shpërndanja trakte që vinin nga Tirana. Nuk di ç'parullë tjetër kishte Balli Kombëtar. Nik thoshte se s'ka ardhur koha me luftue dhe në qendrën e Elbasanit s'na është thënë një gja e tillë.

Prokurori: I pandehuri, kërkon ta çkëputnjë Ballin e Elbasanit nga ay i Tiranës, kurse kjo s'është e vërtetë, parullat e Ballit Kombëtar këta kanë mundur t'i fusin në shpirtin e atyre që nuk kishin kuptuar Luftën Nacional Çlirimtare; parullat e Ballit ishin: S'ka ardhë koha me luftue, Italia mjafton të dërgojë ushtri të regullë dhe 200 Ariplana, po të luftojmë digjemi, parullat e Ballit Kombëtar ishin kundra Lëvizjes Nacional Çlirimtare. I pandehuri Lef Nosi bën sikur nuk i di, po Balli Kombëtar kishte marëveshje me Italianët dhe monumentin e kësaj marëveshjeje e të bashkëpunimit të Ballit me italianë e gjejmë në protokollin që lidhi Ali Këlcyra me Gjeneral Dalmazzon. Ali Këlcyra ishte një nga krerët e Ballit Kombëtar. Në kohën e Qeveris Maliq Bushati, e cila ka pasur për program ngritjen e një Gjindarmërije ku të grumbulloheshin forca të popullit, Balli Kombëtar e ka favorizuar këtë program, dhe i pandehuri Lef Nosi bën sikur nuk i di këto, ky mbrohet me armë shumë të dobëta po këto armë kthehen kundra tij, Balli Kombëtar vrau, luftoj, torturoj dhe dogji; Balli Kombëtar ishte pregatitur prej okupatorit, ay nxori dekallogun e famëshëm, këto Lef Nosi nuk i di.

I pandehuri: Prokurori akuzon Ballin Kombëtar, unë nuk di ç'bënin krerët e Ballit, për këto ata të qendrës së Ballit duhet ta dijnë dhe s'përgjigjem unë.

Prokurori: I pandehuri Lef Nosi kërkon të ndahet nga Balli, kërkon të çkarkojë përgjegjësinë e tija.

I pandehuri: U largova nga Balli kur duhet, u largova pse në Shqipëri nuk kishte mundësi për dy Parti. Le të ish Partija e Lëvizjes Nacional Çlirimtare, se ajo bënte aksione. Krerët e Ballit Kombëtar ishin Mit-hat Frashëri e Ali Këlcyra. Për Ali Këlcyrën pata dëgjue se ish në kontakt me Gjeneralin italian Dalmazzon. Nuk di ç'shejtan bëri me këtë. Tek Mit-hat Frashëri në Tiranë kam shkuar dy tre herë, unë në Tiranë rinja në Hotel Internacional. Mit-hat Frashërin nuk e kam parë n'ilegalitet. Kam dëgjuar se Ali Këlcyra bënte pjesë në Qendrorin e Ballit. Kur ay bëri marëveshjen me Italianët unë e quajta trathëti, nuk e quajtaa të mirë dhe u largova.

Prokurori: I pandehuri nuk u largua nga organizata e Ballit Kombëtar. Ky ka qenë i lidhur pazgjidhëshmënisht me Italinë. Ne i dimë mirë qëllimet e imperializmit Italian, Paktin Titoni-Venizellos. Qeverija e Durrësit në të cilën i pandehuri ishte Ministër, ishte një Qeveri proitaliane, ajo kujtonte dhe thoshte se Shqipërija nuk mund të jetojë pa mbrojtjen e Italis, po populli shqiptar nuk ishte me këtyë Qeveri, këtë e provoj dhe koha; populli shqiptar bëri Kongresin e Lushnjes, bëri luftën legjendare të Vlorës, pas kësaj Musolini shkruante 3 artikuj "restare e Valona", "xa marezzo", kjo ishte politika e imperializmit Italian, këta kanë qenë përkrahësit e imperializmit italian. Kaq e vërtetë është se Kongresi i Durrësit ka qenë një Qeveri pro imperializmit italian sa të këtillë e quajti edhe Kongresi i Lushnjes, i vili edhe e rëzoj këtë qeveri. Këta akoma s'e kishin kuptuar se fashizmi kish financuar Mustafa Krujën, Lef Nosin e tjer, për të plotësuar qëllimet imperialiste në Shqipëri. Këta u

bënë shërbëtorë të fashizmit dhe Balli Kombëtar ku ka bërë pjesë Lef Nosi këtë politikë ndoqi. Këta kanë qenë pseudo-patriotë.

I pandehuri: Nuk mund t'ua them unë se prapaganda e Ballit Kombëtar ka penguar Lëvizjen Nacional Çlirimtare. Natyrisht gjersa erdhi në kundërshtim, ka qenë kundra. Unë për pjesën t'ime e quaj se ka vepruar kundra.

Ardhjen e Gjermanëvet e konsiderova si okupasion. Iku një okupator dhe erdhi një tjetër. Detyra e popullit shqiptar ishte të vazhdonte luftën. Edhe unë vetë si shqiptar duhet t'a bëja këtë detyrë. Me popullin isha po vetë s'luftova, populli luftoj. Okupatori gjerman ka pasur vegla, siç ka natyrisht çdo okupator. Ishte p.sh. vegël e okupatorit Xhafer Deva po jo Ibrahim Biçakçiu. Nuk besoj që në qeveri të kish vegla t'okupatorit me qëllim trathëtije.

Prokurori: Trathëtia e të pandehurit fillon që nga Qeverija e Durrësit e gjer tek Regjenca. Ndërsa populli luftonte okupatorin këta e quanin vepër patriotike të luftonin popullin shqiptar e të mbaheshin në vrimat e okupatorit.

I pandehuri: Kam ardhur në Tiranë sipas një letre t'Ibrahim Biçakçiut, ay më erdhi vetë n'Elbasan. Unë i thashë së pari se nuk vinja,

Arkivi i MPB, Fondi 1, Viti 1945, D. 1086, Fl. 364-373.

Sot, ditën dhe orën e caktuar, Trupi Gjykues u formua si më parë, me pjesëmarrjen e Prokurorit Major Misto Treska, duke qënë i asistuar prej Sekretarit Aspirant Thoma Rino dhe filloi vazhdim' i gjykimit botërisht e faqësisht.

U sollën nga burgu rregullisht të shoqëruar tre të pandehurit Lef Nosi, Patër Anton Harapi e Maliq Bushati, të cilët, duke qënë të lirë, u vunë në vëndet e posaçëm.

Përfaqësonjësat mbrojtëse të tyre ndodhen prezent.

Përfaqësonjësi mbrojtës i të pandehurit Lef Nosi, Z. Av. Zoi Xoxe, ay i të pandehurit Patër Anton Harapi Z. Av. Spiro Stringa dhe ay i të pandehurit Maliq Bushati Z. Av. Vasil Xhai kënduan mbrojtimet e fundit, të cilat duke i pasur shkruar i dorëzuan për t'u bashkëngjitur dosjes.

Mori fjalën Prokurori dhe tha: "Unë mbassi ndëgjova avokatët mbrojtësa, dua të theksoj disa pika që këta janë mbështetur.

Për sa i përket pikës që i pandehuri Lef Nosi është cilësuar si miob, kjo është në kundërshtim me realitetin. Lëvizja Nacional-Çlirimtare i hapi syt si intelektualëve ashtu edhe gjithë popullit, të vegjël e të mbëdhenj. Kështu miopiteti politik i Lef Nosit nuk ka si justifikohet për deri sa i gjithë populli u ngrit në luftë kundra okupatorit e tradhëtarëve dhe Lef Nosi qëndroi kundra. Gjithashtu dolli në shesh se ky u shërbeu okupatorit e tradhëtarëve. Kjo përforcohet edhe nga fakti se ky mori pjesë në Regjencë.

Për Patër Anton Harapin them se mbrojtja tha që duhet marë parasysh veprimtarija e tij e mëparëshme. Neve Patër Antonin e kemi prurë këtu për të

dhënë llogari mbi fajet e veprat që ka kryer në dëm të popullit. Patër Anton Harapi del përçarës i elementave dhe kjo faktohet nga letrat e Mark Gjon Markajt, të cilat, për hir të së vërtetës, ranë në dorën e popullit.

Për sa thotë mbrojtja se dënimet duhet të jepen kundra atyre që kanë lyer duart me gjak, unë them se duart me gjak i kanë lyer këta, për shkak se me urdhërat e këtyre janë bërë të gjitha vrasjet e çkatërrimet në popull.

Për të pandehurin Maliq Bushati mbrojtja tha se okupimi i Shqipris prej Italis Fashiste ishte pregatitur po nga njerzit që bënin pjesë në regjimin zogist. Unë them se edhe Maliq Bushati ka qënë deputet i Zogut i emëruar nga Abdurrahman Krrosi. Fakti që Maliq Bushati u bë Ministër i Punëve të Brëndëshme, Kryeministër dhe Zëv. Ministër i Partis Fashiste provon se ky që në kohën e Zogut ka marë pjesë në pregatitjen e okupimit të Shqipris nga Italia Fashiste.

Prandaj insistoj në kërkimin t'im që kam bërë në pretencë.

U pyetën për herë të fundit të pandehurit dhe prej tyre:

I pandehuri LEF NOSI, tha: "Unë s'kam gja për të thanë se të gjitha sa kisha për të thanë i kam thanë ma parë, vetëm paraqes nji listë që përmban emnat e personave qi unë kam shpëtue dhe kam lirue nga burgu".

I pandehuri PATËR ANTON HARAPI, tha: "Falnderoj drejtësinë e Popullit që më jep fjalën e fundit në këtë kohë të kritikshme për mua. Fjala ime e fundit asht kjo: nuk shëmbet Shqipnija pse gjykohet për dek Patër Anton Harapi. Gjithashtu nuk prishet Shqipnija në se nuk gjykohet për dekë Patër Anton Harapi. Kur para 40 vjetve në Shkodër u përpiqsha me ba Shqipninë shumë gjysha na thoshin se nuk e duen Shqipnin, na nuk i kemi vue në litar këta. S'kërkoj, Z.Kryetar, nji tolerancë; unë simbas mundit kam derdhë djersë me ba Shqipnin. Franca e gjytetnueme asht shëmbulla e revolusioneve popullore dhe gjykon Petain dhe e fal, për këtë nuk e njofin për të keq por ia njofin për të mirë. Kujtoj se edhe Shqipni kur gjykon regjentat besoj se sikur t'i fali këta nuk ka me qënë ligsì për Shqypnin por besoj se ka me qënë mirë. Unë qi kurse kam hy në gojën e ujqve Hausding-ut, etj. jam përpjek me ba mirë e me mujt me shpëtue nonji jetë prej egërsinave. Por me qënë se ishin bisha t'egra nuk kam mujt me i zbutë por prapë me mundin t'im kam pështue mjaftë. A ka pas shqyptarë të marrë si unë qi për me pështue njerëz me shkue me u fut në gojën e ujkut? Ka pakë që sakrifikohen moralisht. Këtë e kam thanë edhe në ligjëratën t'ime. Mua më shtyni marrija me shkue e me u përpjek për me u lehtësue vujtjet disa familjeve dhe kam ba mjaftë punë morale, sikurse jueja qi asht materiale. Gja tjetër nuk kam. Rrnoftë Shqypnija".

I pandehuri MALIQ BUSHATI, tha: "Unë qi më 1910 kam fillue aktivitetin t'im patriotik që kurse kam qënë student në Stanboll. Jam kenë ndër të vetmit mysliman të Shkodrës qi kam shkue në luftë për çlirimin e Shkodrës. Kam qënë dhe kam bashkëpunue me Muço Qullin për mbrojtjen e Atdheut. Kam botue "Populli" me frymë popullore. Në kohën e Fan Nolit kam qënë sëmurë e s'kam marë pjesë në politikë. Kam qënë kundra Zogut dhe Musa Jukës. Unë nuk jam implikuar në pregatitjen e 7 Prillit, sikurse u zbulua në kohën e Zogut kur u arrestuan Giro-ja se unë s'kam qënë në listën që iu gjet këtij e që përmbante emnat e atyne qi

bashkëpunonin për ardhjen e Italis. Kam gabue që kam marë pjesë në Qeverin Vërlaci por kam mendue me i ba mirë popullit. Kur kam qënë Kryeministër unë kam lirue të burgosunit e Kampo Romanos dhe jam përpjekun me i ba mirë popullit. Në kohën e okupasionit gjerman unë s'jam ngatrrue me politikë dhe s'kam marë pjesë në nonjë organizatë, sado qi Neubaher më ka thirr. Unë jam përpjekun me ba mirë e me lirue njerëz. Nuk asht e vërtetë qi të kem organizue vrasjet e Ulqinit mbasi n'Ulqin unë s'kam qënë veç dy-tri herë qysh përpara. Kur kam qënë ilegal nuk kam pasun lidhje me kërkënd dhe për këtë s'ka asnji fakt. Nuk kam zhvillue asnji aktivitet kundra pushtetit popullor dhe as qi kam qënë në lidhje me organizatat ose me t'arratisun. Unë kërkoj drejtësi".

V E N D I M. – Mbassi gjykim' i çështjes mori fund, Gjykata, bashkërisht, vendosi që për deklarimin e vendimit përfundimtar të shtyjë seancën gjyqsore për më datën 12 Fròr 1946, ora 9 para dreke, duke iu njoftuar të pandehurve dhe përfaqësonjësave të tyre prezentë.

Tiranë, më 11 Fròr 1946.

Sekretari: Anëtar: Anëtar: Kryetari:

Sot ditën dhe orën e caktuar, Trupi Gjykues u formua si ma parë, me pjesëmarrjen e Prokurorit Major Misto Treskës, dhe asistuar prej Sekretarëvet Aspirant Thoma Rinos e Kapter Zalo Xhomaqit, filloj vazhdimi i gjykimit botërisht e faqësisht.

U sollën nga burgu të pandehurit Lef Nosi, Patër Anton Harapi e Maliq Bushati, të cilët duke qënë të lirë u vunë në vëndet e tyre të posaçme, duke qënë t'asistuar prej përfaqësuesavet të tyre mbrojtës Av. Qerim Çela për Lef Nosin, Av. Spiro Stringa për Patër Anton Harapin dhe Av. Vasil Xhaj për Maliq Bushatin.

Mbi këtë mbasi nuk mbeti gjë tjetër gjykimit ju dha fund dhe u dekllarua ky:

V E N D I M

"N' EMËR TË POPULLIT SHQIPTAR"

Gjykata Ushtarake e Tiranës e formuar prej:
Major Irakli Bozos K r y e t a r,
Major Tonin Jakovës A n t a r,
Major Gjon Banushi A n t a r,

me pjesëmarrjen e Prokurorit të Popullit Major Misto Treska, e asistuar prej sekretarëve Aspirant Thoma Rino e Kapter Zalo Xhomaqi, sot më datën 12 Fròr 1946, e mbledhur në sallën e Kino-Theatër "Kosova", duke gjykuar të pandehurit:

1) LEF NOSI, i bir' i Stilianit dhe i Anës, lindur më 1873 n'Elbasan, atje banues, pronar, i pamartuar, me arësim të mesëm, i përfaqësuar nga av. Z. Zoi Xoxe dhe nga av. Z. Qerim Çela;

2) PATËR ANTON HARAPI, i bir' i Loros dhe i Luçìs, lindur më 1888 në katundin Shirokë të Shkodrës, banues në Shkodër, fetàr, me arësim të lartë, i përfaqësuar

nga Av. Z. Spiro Stringa;

3) MALIQ BUSHATI, i bir' i Hysejnit dhe i Qamiles, vjeç 56, lindur e banues në Shkodër, pronar, me arësim të mesëm, i divorcuar, i përfaqësuar nga z. Av. Vasil Xhai.

T' a k u z u a r :

Sipas akt-akuzave të Prokurorit, si kriminela lufte, armiq të popullit dhe sabotatorë të pushtetit, në bazë të neneve 14 e 15 të ligjës Nr. 41, datë 14 Janar 1945 mbi organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Ushtarake dhe nenit 1 të ligjës Nr. 21, datë 15 Dhjetor 1944 mbi sabotatorët e luftës e të pushtetit.

G J Y K A T A,

Passi shqyrtoi akt-akuzat e proçes-verbalet e Prokurorit;

Passi shqyrtoi proçes-verbalet mbajtur nga Komisioni Hetues për krimet e kriminelave të luftës dhe ato të Mbrojtjes së Popullit;

Passi ndëgjoi apollogjin' e të pandehurve;

Passi ndëgjoi dokumentat që vërtetojnë akuzat e tre të pandehurve;

Passi ndëgjoi deponimet e dëshmitarëve të mbrojtjes e t'akuzës të bëra me betim para gjyqit;

Passi ndëgjoi pretencën e Prokurorit;

Passi ndëgjoi mbrojtimet e akovatëve;

Passi ndëgjoi fjalën e fundit të sejcilit të pandehur;

Passi studjoi të gjitha dokumentat e tjera që ndodhen në dosjerët e tyre;

Passi studjoi dhe mejtoi çështjen në fakt e në të drejtë;

O B S E R V O N:

Nga tërësija e provavet të marruna gjatë zhvillimit të gjykimit, u provua në mënyrë të plotë se të pandehurit Maliq Bushati dhe Patër Anton Harapi, kanë pregatitur okupasionin fashist, para datës 7 Prill 1939 duke ardhur në kontakt dhe në marrëveshje me agjentët e fashizmit Melonin dhe Giovani Girron, që ndodheshin në Shqipëri, dhe nga jashtë me trathëtarët e grupit të Mustafa Krujës dhe Bashkimit Kombëtar si Bahri Omarin, Kol Tromarën, Qazim Koculin etjer, për të përmbysur Zogun dhe për të sjellë një Mbret nga shtëpija e Savojës.

Patër Anton Harapi ka qënë përfaqësuesi Bashkimit Kombëtar për qarkun e Shkodrës. Kjo akuzë provohet me atribuimet e Kol Tromarës, Javer Hurshitit si dhe me pohimin e tërthortë të Maliq Bushatit.

Mbas 7 Prillit 1939 të pandehurit e sipërmë kanë bashkë-punuar me okupatorin fashist duke sabotuar Pushtetin e Popullit, (kanë pritur ushtrinë fashiste italiane në Shkodër si çliruese, siç e pohuan edhe vetë, kanë kërcënuar luftëtarët e Lirisë të mos luftojnë, siç provohet me dekllaratën e Qemal Mato Alikajt).

Patër Antoni ka ardhur në Tiranë si delegat i Klerit Katolik, për të marrë pjesë n'Asamblenë për ofrimin e Kurorës së Skënderbeut, Viktor Emanuelit, ndërsa Maliq Bushati mer pjesë në Qeverinë e parë trathëtare të Shefqet Vërlacit, (si Ministër i Mbrëndëshëm). Në këtë periodë Maliq Bushati pranoj fuzionimin e Ushtrisë e të

Gjindarmërisë e Doganave. Është përgjegjës për gjithë veprimtarinë e Ministrisë së Mbrëndëshme. Ka urdhëruar që t'u mbyllin gojën gjithë atyre që flasin kundra fashizmit, në rast të kundërtë do të meren masa ndëshkimore estreme (vërtetohet me shkresën Nr. 37 Res Dat. 8/V/1939). Ka urdhëruar çarmatimin e popullit shqiptar (teli-shifër Nr. 279 Res Dat. 8/VII/1939). Me telin shifër Nr. 724/9 Res Dat. 27/XI/1939 drejtue gjithë Prefekturavet urdhëron festimin për dorëzimin e Flamurit me shënjat e liktorit. Me telin shifër Nr. 183 Res Dat. 10/V/1939 urdhëron popullarizimin e Statutit, bashkimin e Kuroravet dhe ku theksohet tekstualisht: "Në fjalimet do t'i bahen elozhe Mbretit, Duçes, Staraçes, Parianit dhe Mëkëmbësit të Përgjithshëm të Mbretit. Ka urdhëruar arrestime të ndryshme si p.sh. Nuhi Zejnel Axhesin, pse kishte zhgaravit fotografin e Viktor Emanuelit e të Duçes dhe Bajram Nazif Çelin si Komunist, këto vërtetohen me shkresat Nr. 164 Dat.7/VI/1939 drejtuar Ministrisë së Ekonomis Kombëtare dhe me shkresën Nr.1702 Res Dat. drejtuar Ministris së Bujqësis dhe të Pyjevet. Me shkresën Nr. 2749 Dat.11/XI/1940 drejtuar Kryesis së Këshillit Ministruer, Maliq Bushati propozon dekorimin me dekoratën Oficeri madh i Kurorës së Skënderbeut, N/Kolonelin fashist Ramirres, pse qe i pari që shkeli në tokën shqiptare ditën e okupasionit. Është përgjegjës për mobilizimin e mercenarëvet të cilët i hodhën në luftës Greke, për interesat e fashizmit italian. Ka urdhëruar arestime e internime në masë duke i dërguar n'Ishujt e Italis si dhe spiunimin e tyre kur ktheheshin nga internimi: shkresa Nr. 44/141 Res Dat. 14/VI/1941 drejtuar gjithë Prefekturavet e që përmban emrat e këtyre t'internuarvet. Ka dërguar fonde sekrete për zhvillimin e spiunazhit, kjo vërtetohet me shkresën Nr. 1659/122 Dat. 14/XI/1940 drejtuar Prefekturavet Gjinokastër dhe Korçë. Ka urdhëruar t'italianizonte shkollat dhe mbylljen e tyre ku zhvilloheshin Lëvizje Antifashiste si p.sh. Tregëtaren e Vlorës, Normale Elbasanit etjera, sikundër u provue dhe nga deponimet e dëshmitarit Rasim Guqi. Ndërsa Patër Anton Harapi, mbrënda në Kuvëndin Françeskan bën pjesë në Redaksinë e Rivistës Hylli i Dritës dhe propagandonte parullat e mëdha dhe helmatonjëse të fashizmit. Mashtronte popullin shqiptar për një Shqipëri të madhe; i ngrinte lavda Duçes dhe Mbretit Viktor Emanuel; nxiste popullin e Malësis së Shkodrës për t'u mobilizuar kundra Malit të Zi n'interes të fashizmit italian (Memorandumi i Duçes e Viktor Emanuelit për popullsinë Hot e Grudë).

Në Kabinetin e trathëtarit Mustafa Kruja, në të cilin Maliq Bushati ishte Ministër Shteti, i pandehuri Lef Nosi kthehet nga pseudo-internimi, me përkrahjen e Mustafa Krujës, bëhet Kryetari Komisionit për mbledhjen e Leshit, për të fornizuar ushtrinë fashiste italiane, siç u provua prej deponimevet të N/Kolonel Kadri Hoxhës dhe pohimit të tij.

Me formimin e organizatës trathëtare të Ballit, bëhet Kryetari Komitetit Qarkor t'Elbasanit, formon çetat bashibozuke të Sif Sinanit, Haki Blloshmit e Nezir Muzhaqit. Saboton mbledhjen e Sopotit. Organizon postat e gjindarmërisë kujslinge në vendet e çliruara nga Ushtrija Nacional Çlirimtare. Propagandon parulla helmatonjëse të Ballit dhe në bashkëpunim me Prefektin kujsling Musa Pukën, urdhëron shtypjen e

demostratavet eë popullit. Këto provohen pjesërisht me pohimet e tij, me deponimet e Kapiten Mexhit Çelës dhe Ferid Agalliut, me dekllaratat e Piro Dodbibës dhe të Foto Dushkut.

Mbas rënies të trathëtarit Mustafa Kruja, i pandehuri Maliq Bushati bëhet Kryeministër dhe Zav.Ministër i Partisë Fashiste Shqiptare, formon një qeveli kukëll me këtë program: "Kush vret një ushtar italian lot një gur të kufirit të Shqipërisë së madhe që Duçia i madh i fashizmit krijoj dhe do t'a mbrojë krahas me ne. Italianë dhe Shqiptarë kanë interesa të njëjta. Ay që trubullon vllazërimin e popullit shqiptar me popullin italian "trathëton Shqipërinë dhe i shërben armikut". Organizon një ushtri dhe gjindarmëri pseudo-shqiptare në shërbim t'okupatorit. Bashkë-punon me ushtritë fashiste n'operacione në të gjitha anët e Shqipërisë, si operasioni Libohovës, Mallakastrës, Pezës, Skraparit etjera. Jep urdhëra arestimesh në masë, internime në ishujt e Italis. Krijon Porto Romanon e Ujët e Ftohtë, mbasi gjithë burgjet e Shqipërisë mbushen plot. Kjo veprimtari midis të tjerash provohet me shkresën Nr. 135/5 Dat. 24/III/1943 drejtur Ministris së Mbrëndëshme, për bashkëpunimin e forcavet mercenare të Ballit e të Gjindarmëris me ato t'okupatorit, kundra Lëvizjes Nacional Çlirimtare; si dhe me pohimet e tij të pjesëshme.

Maliq Bushati mer nisiativën për bashkëpunimin e Qeveris të kryesuar prej tij me Ballin Kombëtar përfaqësuar nga Antarët e Komitetit Qendror Ali Këlcyra dhe Nuredin Vlora dhe me trupat e autoritetet fashiste (Dalmazzo e Jacomoni). Këto provohen me protokollin e nderit "Al Ecelenca Dalmazzo Komandant' i fuqivet Armate në Shqipëri" së bashku me 7 lidhje të bëra në data të ndryshme. Programi i këtij protokolli ishte: 1) Të luftonin për asgjësimin e Lëvizjes dhe Ushtrisë Nacional Çlirimtare, 2) Të sigurojnë komunikasionet ushtrisë fashiste italiane nga sulmet e Ushtrisë Nacional Çlirimtare, 3) Balli Kombëtar të godiste mbas shpine Ushtrinë Nacional Çlirimtare dhe 4) Të krijonin një aparat për marjen e fuqis shtetnore me anën e një grusht shteti.

I të njëjtit mendim i pandehuri Lef Nosi vazhdon të qëndrojë Kryetar' i Komitetit Qarkor të Ballit n'Elbasan deri në kapitullimin e Italisë.

Me ardhjen e okupasionit nazist Lef Nosi në bashkëpunim me agjentat e Gestapos Fon Shajger dhe Nubaher, mer nisiativën bashkë me të tjerë, për formimin e Komitetit Ekzekutiv; bëhet Kryetari Asamblesë kujslinge, thëret Patër Anton Harapin dhe i telegrafon Papës në Romë për t'i dhënë këtij leje në bashkëpunim me gjermanët që të bëhet Antar' i Regjencës; ndërsa edhe vetë i pandehuri Patër Anton Harapi në marrëveshje të plotë me Lef Nosin dhe i një mejtimi me pjesën reaksionare të Klerit Katolik dhe me autorizimin e tyre vihet në krye të trathëtisë. Shpallin nën okupasionin nazist "indipendencën dhe neutralitetin e Shqipërisë". Formojnë tre qeveri kujslinge: 1) të Rexhep Mitrovicës, 2) të Fiqri Dines, qeveri e krijuar në Tufinë, ku ka marë pjesë, Patër Antoni,

Lef Nosi, Mehdi Frashëri, Mid'hat Frashëri për Ballin Kombtar, Abaz Kupi e Fiqri Dineja për Legalitetin dhe për indipendentët Gjon Marka Gjoni, i shoqëruar gjer në Tiranë prej Maliq Bushatit që ishin të njëj mendimi, të gjithë së bashku kurdisën

qeverinë e koalicionit të të gjithë reaksionit të brëndshëm. Grumbullojnë elementat bashibozuke të Ballit Kombtar, Legalitetit e të Gjon Marka Gjonit dhe formojnë regjimentin "Kosova". Frymëzojnë dhe nxisin gjithë reaksionin që në bashkëpunim të ngushtë me forcat e okupatorit nazist të bëhen operasione në stil të gjerë për çfarosjen rrënjësisht të Lëvizjes Nacional-Çlirimtare, duke marrë parasysh gjithë çkatërrimet, humbjet në njerës e në material që do t'i vinin popullit shqiptar (operasioni i math i Dimrit dhe ay i Qershorit si dhe gjithë operasionet e tjera lokale). Financojnë hordhitë e Hitlerit, të Ballit Kombtar e të Legalitetit. Kontribuan me nazistat arrestime dhe internime në masë, si në Durrës, Vlorë, Korçë, Gjirokastër, Tiranë, Shkodër, etj. për në kampet e vdekjes të Gjermanis e të Prishtinës. Organizuan terrorin e math të 4 Shkurtit sidhe shpërnguljet e detyrueshme të popullsis në mes të dimrit, të detyruar të strehohen nëpër shpella. Dhanë udhëzime për marëveshje me reaksionin grek, kundra forcave antifashiste të popullit shqiptar dhe të popullit grek sidhe për nënshtrimin e krahinave të Korçës e të Gjirokastrës nën sundimin e reaksionit të lartëpërmendur.

Janë përgjegjës për çkatërrimet e pasuris të Shtetit e të popullit (molave, urave, rrugëve, kantierëve dhe uzinave elektrike), për djegien dhe rrënimin e mijrave banesave të popullit si dhe për çdukjen e madhe të gjës së gjallë.

Të pandehurit, si anëtarë të Regjencës, kanë aprovuar ndëshkimin me varje të Kolë Lakut si dhe të dy personave të tjerë, kjo akuzë provohet me pohimin e tyre dhe me atribuimin e Mahmut Golanit.

I pandehuri Patër Anton Harapi ka propaganduar të ngrejë me çdo kusht një aparat shtetnor kuisling dhe për këtë gjë nxit gjithë popullin të bashkohet kundra Ushtëris dhe Lëvizjes Nacional-Çlirimtare, duke tentuar të përçajë Frontin Nacional-Çlirimtar simbas propagandës së Goebels-it, duke i cilësuar luftëtarët e liris si terrorista e të shitur në të huaj. Kjo gjë provohet nga fjalim' i tij që u ndëgjua në disk dhe q'ësht shumëfishuar në gazetarinë dhe në broshura të shtypit t'okupatorit.

Të pandehurit Lef Nosi, patër Anton Harapi e Maliq Bushati kanë vazhduar rrugën e tradhëtis deri në fund, me gjithë që janë këshilluar si prej aleatëve të mbëdhenj, prej Frontit Nacional-Çlirimtar dhe prej patriotëve si Fan Noli, këta edhe kur pjesa më e madhe e Atdheut ishte çliruar prej Forcave Nacional-Çlirimtare u kanë qëndruar besnikë gjermanëve gjer në fund. Për t'organizuar forcat e mbeturinave të reaksionit në Veri të Shqipris, me anën e lidhjes së Shkodrës, në bashkëpunim edhe me forcat çetnike. Kanë urdhëruar vrasjen e shumë elementave të Lëvizjes Nacional-Çlirimtare me anë të kriminelit Hasan Isufi. Këto provohen me deponimet e dëshmitarëve Mark Ndoja, Arif Gjyli, me deklaratën e Gjovalin Lukës, me ketrën e Patër Anton Harapit drejtuar Javer Hurshitit, me katër letrat e Mark Gjon Markajt drejtuar Patër Palit, me programin e Besëlidhjes i firmuar prej Maliq Bushatit etj., me deklaratën e ulqinakëve, me deklaratat e Shefqet Dibrës, Ismail Barbullushit, Avokat Bojaxhiut, Sadedin Mandìs dhe Muhamet Lahit e Muhamet Uruçit etj.

Edhe mbas çlirimit të Shqipris të tre të pandehurit kanë qëndruar t'arratisur dhe kanë qënë në lidhje me kriminela lufte, të cilët kanë tentuar të sabotjnë pushtetin si

për shëmbull tentativa e sulmit mbi Koplik e Shkodër, për të shkaktuar ndërhyrjen e reaksionit të jashtëm dhe për të krijuar një luftë civile. Kjo provohet me faktin se këta u kapën mbas një viti dhe nga deponimet e dëshmitarit Mark Ndoja për sa i përket të pandehurit Patër Anton Harapi.

Nga analizim'i provave të paraqitura prej përfaqësonjësave të të pandehurit rezulton se këta kanë mundur më të rrallë t'i sjellin miqve të tyre nonjë favor krejt personal, porse ky favor nuk ësht veçse një pikë ujë në mes t'oqeanit të tradhëtis që kanë kryer në dëm t'Atdheut dhe të mjerimeve e të çkatërimeve q'i kanë sjellë krejt popullit mbarë. Këto favore nuk janë të një natyre e grade sa që të lehtësojnë të pandehurit nga llomi i tradhëtis që janë futur; deklaratat e deponimet e atyre pakë dëshmitarëve që janë prezantuar përmbajnë frymën e miqsis, të regjionalizmës ose janë bërë në mënyrë t'atillë që këta dëshmitarë të justifikojnë veprimtarinë e tyre antipopullore e kolaboracioniste, si për shëmbull deponimet e Hysni Pejës i cili theksoi më fortë justifikimin e qëndrimit të tij në kohën kur ka qënë Komandant i Përgjithëshëm i Gjindarmëris Kuislinge, se sa lehtësimin e veprimtaris antipopullore e fashiste të të pandehurit Maliq Bushati.

Përmbajtja e deponimeve dhe (anullohet fjal' e fundit) deklaratave të dëshmitaarëve mbrojtësa të të pandehurve përgënjeshtrohet në mënyrën më kategorike nga vet pohimet e të pandehurvet, nga dokumentat e shumta q'u përmëndën në trupin e këtij vendimi dhe që këto nuk janë veçse një pjesë fare e vogël e dokumentave të ndodhura n'arqiva të ndryshme ose të çdukura, përgënjeshtrohen sidomos nga vet ngjarjet që janë zhvilluar në kurriz të popullit e të Atdheut gjatë pesë vjetëve okupasioni dhe që jo vetëm që kanë hyrë në dijenin e Trupit Gjykues por që dihen edhe botërisht: 50.000 të vrarë e të plagosur nga popullsija civile e nga radhët e Ushtëris Nacional-Çlirimtare; 18.000 shqiptarë t'internuar ose të burgosur në burgjet e në fushat e përqëndrimit të Shqipris, n'ishujt e Italis dhe në kampet e internimit të nazizmit gjerman; 47.000 shtëpi për banim të djegura ose të rrënuara, me mijëra bagëti të trasha ose të vogla të plaçkitura; gati krejt ekonomija, financa e komunikasionet të çkatërruara. Për këto vepra të pandehurit janë përgjegjësa moralë, mbassi këta me pozitën e tyre kanë qëndruar në kulmin e tradhëtis.

Sado që përfaqësonjësi i Lef Nosit Av. Z. Zoi Xoxe në mbrojtjen e tij u mundua duke ndarë veprimtarinë e të përfaqësuarit të tij në dy perioda: para vjetit 1942 dhe mbas. Për periodën e parë t'a paraqes të kaluarën e tij si patriotike, dhe për periodën e dytë se i pandehuri ka qënë i frymëzuar prej një qëllimit të mirë porse i tregua miob në parashikimin e ngjarjeve. Si për periodën e parë ashtu edhe për periodën e dytë i pandehuri Lef Nosi ka qënë i udhëhequr prej një parimi politik; gjithënjë ka qënë koshient i vijës së tij politike antipopullore, pse nuk ka si shpjegohet që Lef Nosi, anëtar i Qeveris së Durrësit më 1918 dhe fillo-italian e proteksionist që n'atë kohë, të mbledhë lesh për ushtërinë e okupatorit italian, për bashkëpunim me krerët e Ballit që dhe këta ishin të shitur tek Italia, të arrijë n'apogjen e tradhëtis së Kryetar i Asambles Kuislinge dhe si anëtar i Regjencës dhe bashkë me Patër Anton Harapin të frymëzojnë, t'aprovojnë e të financojnë operasione me stil të gjerë

kundra forcave t'ushtëris Nacional-Çlirimtare që njëkohësisht patën reperkusone edhe karshi popullatës së pafajshme të të gjithë Shqipris. Pretendon Z. Avokat se ky trup gjykues është i prekur që Lef Nosi nuk ishte në radhët e idealizmës shqiptare, porse Trupi Gjykues ka bindjen se Lef Nosi nuk mund t'ishte me popullin dhe për të mirën e popullit, porse konsekuent në gjithë vazhdën e tradhëtis së tij. Prandaj nuk mund të pretendohet se Lef Nosi u gabua dhe u bë miob në parashikimin e ngjarjeve, mbassi nuk është nonjë njeri i thjeshtë por me arësim të lartë dhe nga ana tjetër gabimi në politikë është tradhëti.

N'analizimin e mbrojtjes t'Avokat Z. Stringës Gjykata observon: Se Patër Antom Harapi ka qënë konsekuent në vijën e tij antipopullore e antipërparimtare, qysh më 1936 çfaqet për një diktaturë fashiste, bën pjesë në "Bashkimi Kombtar" që ka si parim marëveshjen e lidhur midis Bashkimit Kombtar, përfaqësuar prej Qazim Koculit e Ali Këlcyrës dhe Grupit të Zarës i përfaqësuar prej Mustafa Krujës (shif dokumentin e botuar në Gazetën "Roja Kombtare" Nr. 7, datë 13 Prill 1943 që riprodhon tekstin e marëveshjes), bashkëpunon me klerin fashist deri në fund dhe sado që avokati mbrojtës kërkon që në gojën e Conte Ciano-s të kallzojë se gjoja ideja e bashkimit personal të Shqipris me Italin gjeti kundërshtime nga ana e klerit katolik të Shkodrës, porse Z. Avokat nuk na paraqiti nonjë dokument për këtë çështje; nga ana tjetër dokumentat e "Hyll'i Dritës" të gjithë kohës s'okupasionit fashist italian e përgënjeshtruan në mënyrë kategorike dhe më kot përpiqet Z. Avokat që artikullin "Përgjegje Cordignano-s" kërkon t'ia veshë Patër Anton Harapit gjoja me pseudonimin "KRITIKUS", kurse para këtij gjyqi nuk dolli as më e vogla indicje që të provojë se me të vërtetë i pandehuri Patër Anton Harapi ka shkruar me pseudonimin KRITIKUS. Pretendon Z. Avokat se Patër Anton Harapi nuk është politikan, por një letrar, një idealist; porse nga i gjithë rezultati i gjykimit u provua se Patër Anton Harapi ka qënë marë me politikë bile me politikën më të lartë. Pretendon gjithashtu Z. Avokat se Patër Anton Harapi hyri në kurth dhe s'e kuptoi dot përgjegjësinë me rastin që hyri në Regjencë; kjo rrëzohet në mënyrë të katërçiptë, mbassi Patër Anton Harapi jo vetëm që u konsultua me klerin reaksionar katolik, porse rrëzohet edhe nga përmbajtja e fjalimit të reçituar në disk. Pretendon gjithashtu Z. Avokat se Patër Anton Harapi nuk figuron anëtar i Ballit, i Legalitetit dhe i Indipendentëve dhe se kjo gjoja u vërtetua nga letra q'i drejton Javer Hurshitit; porse Patër Anton Harapi ka qënë mbi të gjitha politikat, kundra Lëvizjes Nacional-Çlirimtare dhe kuftës së popullit shqiptar, krahas me Hausding-un, Fitztum-in etjerë oficerë të Gestapos, siç provohet dhe nga përmbajtja e letrës e nga fotografit.

Avokati mbrojtës i të pandehurit Maliq Bushati Z. Xhai kërkon t'a paraqesë të përfaqësuarin e tij se "nuk ishte i kualifikuar të loste një rol të gradës së parë dhe se lokalizma dhe miopia politike e shtyri të bjerë në kurth të Giro-s, porse ky argument përgënjeshtrohet kategorikisht pse ky pranoi me koshiencë të shesë Atdheun për të holla dhe po të ishte kaqë naiv nuk do të harrinte në pozitat politike kyç dhe të dorës së parë gjatë okupasioneve. Maliq Bushati është konseguent në vijën politike tradhëtare të tij që nga fillimi deri në fund.

Veprimtarija e të pandehurve u provua plotësisht dhe parashikohet prej neneve 14 e 15 të ligjës Nr. 41, datë 14 Janar 1945 mbi organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Ushtarake, dhe prej nenit 1 të ligjës Nr. 21, datë 15 Dhjetòr 1944.

Me qënë se të pandehurit nuk përfitojnë nga shkaqet lehtësore të nenit 16 të ligjës Nr. 41.

P r a n d a j,

Në bazë të neneve të naltëpërmendura Gjykata i konsideron fajtorë si kriminela lufte, armiq të popullit dhe sabotatorë të pushtetit popullor dhe n'bazë të nenit 18, gërma "g" të ligjës Nr. 41, konform me kërkimin e Prokurorit,

V E N D O S I :

Ndëshkimin e fajtorëve: 1) LEF NOSI, i bir'i Stilianit dhe i Anës, lindur më 1873 n'Elbasan; 2) PATËR ANTON HARAPI, i bir'i Loros dhe i Luçis, lindur më 1888 në Shirokë të Shkodrës e 3) MALIQ BUSHATI, i bir' i Hysejnit dhe i Qamiles, vjeç 56, nga Shkodra, M E V D E K J E, humbjen e të drejtave të tyre qytetare e politike dhe konfiskimin e pasuris së lujtëshme e të palujtëshme.

Ky vendim, në bazë të nenit 31 të ligjës Nr. 41, datë 14 Janar 1945, i dërgohet Gjykatës së Lartë Ushtarake për aprovim.

Tiranë, më 12 Fròr 1946

Sekretarët: Anëtar: Anëtar: Kryetar:

Arkivi i MPB, Fondi 1, Viti 1945, D.1086, Fl. 392.

USHTRIJA NAC.ÇL. SHQIPTARE
PROKURORIJA E GJYKATËS SË NALTË USHTARAKE
Nr. 9

VDEKJE FASHIZMIT
LIRI POPULLIT

K O M U N I K A T Ë
GJYKATËS SË NALTË USHTARAKE

KËTU

Prokurorija e Gjykatës së Naltë Ushtarake, mbasi shqyrtoj akt-gjykimin e Gjykatës Ushtarake të Tiranës Nr. 24 Datë 12/II/1946 me të cilin është vendos ndëshkimi i Maliq Hysejn Bushati me VDEKJE në bazë të Nenit 14 e 15 të ligjit Nr. 41 dat 14 Janar 1945 dhe prej nenit 1 të ligjit Nr. 21 dat 15 Dhjetor 1944.

Vë re se

NË FAKTË: Maliq Hysenj Bushati ka vepruar kundra interesave të naltë t'Atdheut dhe kundra independencës e integritetit toksor para datës 7 Prillit 1939 tue patur

lidhje me agjentët e Serbo-mëdhenjvet në Shqipëri, Konsullin Jugosllav Miliçiç në Shkodër. Ka bashkëpunuar me agjentët e fashizmit si Giovanin Giron dhe Salvatore Melonin, në lidhje me grupet trathtare jashtë shtetit (Bashkimi Kombëtar) dhe me grupin e Mustafa Krujës, për të pregatitur okupasionin e Shqipërisë nga trupat fashiste. Ka marë pjesë në Qeverinë Kuislinge si Ministër i Mbrendshmë në Kabinetin e Shefqet Vërlacit. Ka kryer arestime, internime, çarmatosjen e popullsisë, mobilizimin e Milicisë, fuzionimi i ushtrisë shqiptare me atë të Italisë etj. Ka qenë kryeministër i Qeverisë Kuislinge si dhe Zav. Ministër i partisë Fashiste Shqiptare, ka kryer operacione të ndryshme, internime e burgime (Kampo Romano). Ka inspiruar, dhe ndihmuar në vepra kriminale e Hasan Isufin kriminel me damkë në Shkodër. Ka marë pjesë në ekzekutime e tortura, tue qenë dhe vetë, ju ka shërbyer si informator (bashkëpunimi i tij me SIM-in dhe me Gestapon). Ka sabotue pushtetin.

NË TË DREJTË: Veprimtarija e të pandehurit në mënyrën e sipër treguar para shikohet si faj nga nenet 14 e 15 të ligjit Nr. 41 dat 14 Janar 1945 dhe prej nenit 1 të ligjit Nr. 21 dat 15 Dhjetor 1944, mbi organizimin e funksionimin e Gjykatave Ushtarake në bazë të të cilit nen ay cilësohet kriminel lufte dhe armik i popullit e sabotator i pushtetit, dhe është e ndërshkuarshme prej nenit 18 të kësaj ligje.

Për këto arësye dhe për ato që do parashtroj në rast nevoje verbalisht në Këshillë është e mejtimit që akt-gjykimi Nr. 24 Datë 12/II/1946 të Gjykatës Ushtarake të Tiranës t'Aprovohet, nga Gjykata e Naltë Ushtarake.

Tiranë, më 11/II/1946

P R O K U R O R I :
(N/KOLONEL PËLLUMB DISHNICA)

Arkivi i MPB, Fondi 1, Viti 1945, D. 1086, Fl. 393.

USHTRIJA NAC.ÇL. SHQIPTARE
PROKURORIJA E GJYKATËS SË NALTË USHTARAKE
Nr. 9

VDEKJE FASHIZMIT
LIRI POPULLIT

K O M U N I K A T Ë
GJYKATËS SË NALTË USHTARAKE

KËTU

Prokurorija e Gjykatës së Naltë Ushtarake, mbasi shqyrtoj akt-gjykimin e Gjykatës Ushtarake të Tiranës Nr. 24 Datë 12/II/1946 me të cilin është vendos ndëshkimi i Pater Anton Harapit me VDEKJE në bazë të Nenit 14 e 15 të ligjit Nr. 41 dat 14 Janar 1945 dhe prej nenit 1 të Ligjit Nr. 21 dat 15 Dhjetor 1944.

Vë re se

NË FAKTË: Pater Anton Harapi me cilësin e tij si Antar i Këshillit të Naltë të Regjencës asht bërë organ i ndërgjegjëshëm i armikut; ka bërë pjesë në Bashkimin Kombëtar dhe ka qenë në marëveshje me Italinë fashiste para 7 Prillit për okupimin e Shqipërisë. Ka qenë inisjator i krijimit të Kom. Ekzekutiv dhe t'ashtuquajturës Asamble Kombëtare të cilat vuloseshin dhe letigjimojshin okupasionin gjerman në Shqipëri dhe përçajshin popullin në luftën e rezistencës, ka ndihmuar okupatorin me formimin e organizatave trathtare e mercenare si Kuesturë, Gjindarmëri, B. Kombëtar, Legalitet e Divizionin S.S. Skënderbeg e tj. Është bërë vegël e armikut duke i shërbyer si axhitator, propogandist, publikist (fjalime e artikuj e tj.) Ka sabotue luftën Çlirimtare të popullit shqiptar tue punue me kriminela lufte ndërkombëtarë si General Filzyhum komandant i përgjithshëm i Gestapos dhe shumë komandanta të tjerë gjermanë.

NË TË DREJTË: Veprimtarija e të sipërpërmendurit në mënyrën e sipër treguar parashikohet si faj nga nenet 14 e 15 të ligjit Nr. 41 dat 14 Janar 1945 dhe prej nenit 1 të Ligjit Nr. 21 dat 15 Dhjetor 1944, mbi organizimin e funksionimin e Gjykatave Ushtarake në bazë të të cilit nen ay cilësohet kriminel lufte armik i popullit e sabotator i pushtetit, dhe është ndërshkuarshme prej nenit 18 të kësaj ligje.

Për këto arësye dhe për ato që do parashtroj në rast nevoje verbalisht në Këshillë është e mejtimit që akt-gjykimi Nr. 24 Datë 12/II/1946 të Gjykatës Ushtarake të Tiranës t'Aprovohet, nga Gjykata e Naltë Ushtarake.

Tiranë, më 11/II/1946

P R O K U R O R I :
(N/KOLONEL PËLLUMB DISHNICA)

Arkivi i MPB, Fondi 1, Viti 1945, D. 1086, Fl. 3924.

USHTRIJA NAC.ÇL. SHQIPTARE
PROKURORIJA E GJYKATËS SË NALTË USHTARAKE
Nr. 9

VDEKJE FASHIZMIT
LIRI POPULLIT

K O M U N I K A T Ë
GJYKATËS SË NALTË USHTARAKE

KËTU

Prokurorija e Gjykatës së Naltë Ushtarake, mbasi shqyrtoj akt-gjykimin e Gjykatës Ushtarake të Tiranës Nr. 24 Datë 12/II/1946 me të cilin është vendos ndëshkimi i Lef Stilian Nosit me VDEKJE në bazë të Nenit 14 e 15 të ligjit Nr. 41 dat 14 Janar 1945 dhe prej nenit 1 të ligjit Nr. 21 dat 15 Dhjetor 1944.

Vë re se

NË FAKTË: Lef Stilian Nosi gjat okupacionit fashist italjan, në bashkëpunim me trathtarin Mustafa Kruja, ka qenë si kryetar i Komisionit të Elbasanit për mbledhjen ndihmave të leshit për ushtrinë fashiste. Ka qenë Kryetar i Komitetit Qarkor të Ballit Elbasan. Mbas kapitullimit t'Italisë ka marë insiativën për krijimin e Komitetit Ekzekutiv kuisling, për krijimin e Asamblesë Kombëtare kuislinge i së cilës u bë kryetar.

Ka qenë antar i Regjencës për gjithë kohën e okupacionit nazist në Shqipëri. Ka inspirue, urdhënue, ndihmue okupatorin në vepra kriminale si: vrasje tortura, arestime, dhe burgime në masë, internime dhe shpërngulje popullsish në kampet e shfarosjes në Gjermani, Prishtinë etj. Ka bashkëpunuar ngushtë me Konsullin Schieger. Ka inspiruar organizatën e Ballit dhe të Legalitetit si dhe gjithë formacionet teroriste të okupatorit Gjindarmëri, Polici, regjimenti Kosova. Mbas çlirimit të Shqipërisë, ka sabotuar pushtetin duke ndenjur i aratisur së bashku me kriminel lufte të tjerë dhe duke bashkë punuar me ta për rëzimin e pushtetit popullor.

NË TË DREJTË: Veprimtarija e të sipërpërmendurit në mënyrën e sipër treguar para shikohet si faj nga nenet 14 e 15 të ligjit Nr. 41 dat 14 Janar 1945 dhe prej nenit 1 të ligjit Nr. 21 dat 15 Dhjetor 1944, mbi organizimin e funksionimin e Gjykatave Ushtarake në bazë të të cilit nen ay cilësohet kriminel lufte dhe armik i popullit e sabotator i pushtetit, dhe është e ndërshkuarshme prej nenit 18 të kësaj ligje.

Për këto arësye dhe për ato që do parashtroj në rast nevoje verbalisht në Këshillë është e mejtimit që akt-gjykimi Nr. 24 Datë 12/II/1946 të Gjykatës Ushtarake të Tiranës t'Aprovohet, nga Gjykata e Naltë Ushtarake.

Tiranë, më 11/II/1946

P R O K U R O R I :
(N/KOLONEL PËLLUMB DISHNICA)

Arkivi i MPB, Fondi 1, Viti 1945, D.1086, Fl. 395.

Vdekje fashizmit
Liri Popullit

P. T.
GJYKATËS SË NALTË USHTARAKE

T i r a n ë

I nënshkruemi Patër Anton Harapi, kam nderin me parashtrue sa ma poshtë :

Gjykata Ushtarake e Tiranës, me vendimin e sajë datë 12 të muejit vazhdues, më ka ndëshkue me vdekje.

Tue përsëritë gjith ç'ka kam thanë gjatë rrjedhimit të gjykimit, dhe për sa të tjera që do të konstatojë në dobinë t'ime ajo e Nderta Gjykatë, lutem të keni mirësinë me vendos që të më falet jeta, në rast të kundërt t'i propozohet Asambles Kushtetonjëse

falja e jetës s'eme.
Tiranë, më 12/2/1946
Me nderime :
(Patër Anton Harapi)

Arkivi i MPB, Fondi 1, Viti 1945, D. 1086, Fl. 396.

M'ANËN E GJYKATËS USHTARAKE TË KORP'ARMATËS I-rë
GJYKATËS SË NALTË USHTARAKE

T i r a n ë

I nënshkruemi Maliq Bushati, kam nderin t'u parashtroj sa vijon:

Me vendimin datë 12/II/1946 të Gjykatës Ushtarake të Korp' Armatës I-rë jam dënuar me vdekje.

Për arësyet që kam treguar gjat zhvillimit të Gjyqit si dhe për ato t'inserueme në mbrojtjen e avukatit mbrojtës dhe ma tepër për faktin se në kohën e okupimit gjerman jam tërhequr krejt nga jeta politike tue treguar një pendim të thellë për fajet e mija të maparëshme, lutemi që në virtut të nenit 33 të ligjës Nr. 41 datë 23/I/1945 mbi organizimin e funksionimin e Gjykatave Ushtarake të kini mirësinë t'i propozoni Kryesis s'Asamblesë Kushtetonjëse faljen e jetës s'ime.

Tiranë, më 12/II/1946.
Me nderime
I d ë n u e m i :
(Maliq Bushati)

AQSH, Fondi 14 (KQ i PPSH), Viti 1957, D. 15, Fl. 1-6.

REPUBLIKA POPULLORE E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
Nr. 15 Sekret. Tiranë, më 23.1.1957

APARATIT TË KOMITETIT QENDROR TË P.P.SH.
(Drejtorisë Administrative)
T I R A N Ë

Bashkangjitur po ju dërgojmë një relacion mbi të dënuarit në të gjithë Republikën që nga viti 1945 gjer më 1955.

Pasi të mbaroni punë lutemi të na i ktheni.

Zv. M I N I S T R I
/ Riza Taushani /

PERSONAT E DËNUAR NË GJITHË REPUBLIKËN NGA VITI 1945 (përfshirë) GJER NË VITIN 1955 (përfshirë) SI DHE LLOJET E DËNIMEVE TË ZBATUARA

Nga viti 1945 gjer në vitin 1955 (përfshirë) në gjithë Republikën, për krime të ndryshme, janë dënuar gjithsejt 97.278 persona.

Sipas llojit të dënimeve, këta janë dënuar në këtë mënyrë:

1.545 ..... me vdekje
55.976 ..... me burgime të ndryshme
18.029 ..... me gjobë
20.343 ..... me punë korrektonjëse
1.375 ..... me dënime të tjera.

Në dënime të tjera përfshihen: vrejtje e ashpër, qortimi, internimi, dëbimi, humbja e nëpunësisë, vendosja në një institut edukimi edhe korrektimi.

Të ndarë sipas gjykatave personat janë dënuar në këtë mënyrë:

NGA GJYKATAT ORDINARE (CIVILE):

Janë dënuar 78.510 persona, prej të cilëve:

372 ..... me vdekje
40.472 ..... me burgime të ndryshme
17.409 ..... me gjobë
20.044 ..... me punë korrektonjëse
213 ..... me dënime të tjera

NGA GJYKATAT USHTARAKE :

Janë dënuar 18.390 persona, prej të cilëve:

1.173 ..... me vdekje
15.026 ..... me burgime të ndryshme
730 ..... me gjobë
299 ..... me punë korrektonjëse
1.162 ..... me dënime të tjera

NGA GJYKATAT SPECIALE:

Janë dënuar me burgim 478 persona.

TË NDARË SIPAS VITEVE, LLOJIT TË DËNIMEVE DHE GJYKATAVE QË I KANË DHËNË, KEMI KËTË PASQYRË:

1) NGA GJYKATAT ORDINARE:

Në vitin 1945 janë dënuar 640 persona, prej të cilëve:

3 ..... me vdekje
440 ..... me burgime të ndryshme
206 ..... me gjobë
4 ..... me punë korrektonjëse (punë e detyruar)
6 ..... me dënime të tjera

Në vitin 1946 janë dënuar 3.951 persona, prej të cilëve:

31 ..... me vdekje
2.544 ..... me burgime të ndryshme
1.365 ..... me gjobë
42 ..... me punë korrektonjëse
17 ..... me dënime të tjera

Në vitin 1947 janë dënuar 7.908 persona, prej të cilëve:

24 ..... me vdekje
2.992 ..... me burgime të ndryshme
3.122 ..... me gjobë
1.866 ..... me punë korrektonjëse
17 ..... me dënime të tjera

Në vitin 1948 janë dënuar 9.908 persona, prej të cilëve:

23 ..... me vdekje
3.764 ..... me burgime të ndryshme
3.807 ..... me gjobë
2.314 ..... me punë korrektonjëse

Në vitin 1949 janë dënuar 13.207 persona, prej të cilëve:

32 ..... me vdekje
5.704 ..... me burgime të ndryshme
3.657 ..... me gjobë
3.794 ..... me punë korrektonjëse
20 ..... me dënime të tjera

Në vitin 1950 janë dënuar 12.900 persona, prej të cilëve:

32 ..... me vdekje
7.504 ..... me burgime të ndryshme
2.184 ..... me gjobë
3.172 ..... me punë korrektonjëse
8 ..... me dënime të ndryshme

Në vitin 1951 janë dënuar 8.983 persona, prej të cilëve:
76 ..... me vdekje
5.570 ..... me burgime të ndryshme
1.127 ..... me gjobë
2.205 ..... me punë korrektonjëse
5 ..... me dënime të tjera

Në vitin 1952 janë dënuar 6.954 persona, prej të cilëve:
57 ..... me vdekje
3.923 ..... me burgime të ndryshme
797 ..... me gjobë
1.130 ..... me punë korrektonjëse
48 ..... me dënime të tjera

Në vitin 1953 janë dënuar 4.754 persona, prej të cilëve:
39 ..... me vdekje
2.604 ..... me burgime të ndryshme
426 ..... me gjobë
1.649 ..... me punë korrektonjëse
36 ..... me dënime të tjera

Në vitin 1954 janë dënuar 4.655 persona, prej të cilëve:
19 ..... me vdekje
2.629 ..... me burgime të ndryshme
445 ..... me gjobë
1.520 ..... me punë korrektonjëse
42 ..... me dënime të tjera

Në vitin 1955 janë dënuar 4.470 persona, prej të cilëve:
36 ..... me vdekje
2.799 ..... me burgime të ndryshme
273 ..... me gjobë
1.348 ..... me punë korrektonjëse
14 ..... me dënime të tjera

2) NGA GJYKATAT USHTARAKE:
Në vitin 1945 janë dënuar 3.285 persona, prej të cilëve:
577 ..... me vdekje
2.415 ..... me burgime të ndryshme
53 ..... me gjobë
31 ..... me punë korrektonjëse
209 ..... me dënime të tjera

Në vitin 1946 janë dënuar 4.621 persona, prej të cilëve:

217 ..... me vdekje
3.232 ..... me burgime të ndryshme
499 ..... me gjobë
113 ..... me punë korrektonjëse
560 ..... me dënime të tjera

Në vitin 1947 janë dënuar 3.260 persona, prej të cilëve:

125 ..... me vdekje
2.729 ..... me burgime të ndryshme
101 ..... me gjobë
66 ..... me punë korrektonjëse
239 ..... me dënime të tjera

Në vitin 1948 janë dënuar 602 persona, prej të cilëve:

24 ..... me vdekje
520 ..... me burgime të ndryshme
17 ..... me gjobë
15 ..... me punë korrektonjëse
26 ..... me dënime të tjera

Në vitin 1949 janë dënuar 819 persona prej të cilëve:

51 ..... me vdekje
746 ..... me burgime të ndryshme
11 ..... me gjobë
11 ..... me dënime të tjera

Në vitin 1950 janë dënuar 1.451 persona, prej të cilëve:

25 ..... me vdekje
1.370 ..... me burgime të ndryshme
7 ..... me gjobë
5 ..... me punë korrektonjëse
44 ..... me dënime të tjera

Në vitin 1951 janë dënuar 1.196 persona, prej të cilëve:

30 ..... me vdekje
1.087 ..... me burgime të ndryshme
7 ..... me gjobë
19 ..... me punë korrektonjëse
53 ..... me dënime të tjera

Në vitin 1952 janë dënuar 1.428 persona, prej të cilëve:

53 ..... me vdekje
1.313 ..... me burgime të ndryshme
16 ..... me gjobë
33 ..... me punë korrektonjëse
13 ..... me dënime të tjera

Në vitin 1953 jnë dënuar 809 personam prej të cilëve:
33 ..... me vdekje
750 ..... me burgime të ndryshme
9 ..... me gjobë
14 ..... me punë korrektonjëse
3 ..... me dënime të tjera

Në vitin 1954 janë dënuar 491 persona, prej të cilëve:
19 ..... me vdekje
462 ..... me burgime të ndryshme
4 ..... me gjobë
3 ..... me punë korrektonjëse
3 ..... me dënime të tjera

Në vitin 1955 janë dënuar 428 persona, prej të cilëve:
19 ..... me vdekje
402 ..... me burgime të ndryshme
6 ..... me gjobë
1 ..... me dënim tjetër

3) NGA GJYKATAT SPECIALE:
Prej vitit 1949 deri në fund të vitit 1955:
478 ..... me burgime të ndryshme

SHËNIM:

Pasqyra e sipërme mbi numurin e përgjithëshëm të personave të dënuar është nxjerrë në bazë të njoftimeve që kanë dhënë gjykatat ordinare për vitet 1945, 1946, 1947 dhe të dhënave statistikore që ka kjo Ministri nga viti 1948 e këndej; nga njoftimet e gjykatave ushtarake për vitet 1945 deri më 1951, nga të dhënat statistikore të Ministrisë për vitet 1952 e këndej, që kurse u krijua shërbimi statistikor pranë kësaj Ministrije edhe për këto gjykata, si dhe nga të dhënat e Ministrisë së P. të Brendëshme përsa u përket gjykatave speciale.

Të dhënat për sa i përket gjykatës popullore dhe asaj të Qarkut Gjinokastër për vitet 1945, 1946 dhe 1947, janë marrë nga buletinat e zyrës së regjistrit të gjendjes gjyqësore pranë kësaj Ministrije, pasi siç dihet në fund të vitit 1953 të gjitha aktet dhe regjistrat e këtyre gjykatave u dogjën aksidentalisht.

Një pjesë e të dënuarve janë përsëritësa, kanë kryer krime në kohra të ndryshme, pra janë dënuar më shumë se një herë, por në numurin e përgjithëshëm të të dënuarve ata janë llogaritur si persona të veçantë me gjithë se janë të njëjtit. Po të zbriten këta, numuri i përgjithëshëm i të dënuarve zvogëlohet. Duke filluar nga viti 1952 gjer në fund të vitit 1955, në bazë të skedave të penalitetit që ka Ministrija, numuri i të dënuarve me përsëritje arrin në 2.734. Duke e zbritur këtë nga numuri i përgjithëshëm, persona të dënuar mbeten 94.544. Ky numur duhet zvogëluar afërsisht prap me të njëjtin numur përsëritsash po të hiqen ata që janë dënuar më shumë se një herë nga viti 1945 gjer në vitin 1951, për të cilën periudhë nuk kemi shënime.

Gjithashtu në personat e dënuar përfshihen edhe ata që i kanë pas kryer krimet para çlirimit, por janë gjykuar mbas çlirimit me autorizim të Ministrisë së Drejtësisë, në bazë të ligjës Nr. 34 dt.5.XI.1945 "Mbi amnisti dhe falje të fajeve të kryera para çlirimit". Numuri i këtyre është i vogël, 124 persona.

Në numurin e të dënuarve me vdekje përfshihen edhe ata që nuk janë ekzekutuar, sepse u është falur jeta nga Presidiumi i Kuvendit Populllor.

Nga studimi i të dhënave të mësipërme rezulton se:

Shumica e dënimeve me vdekje janë dhënë nga gjykatat ushtarake (1.173), kurse gjykatat ordinare kanë dhënë 372.

Numuri më i math i dënimeve me vdekje është dhënë nga gjykatat ushtarake gjatë viteve 1945 (577), 1946 (217) dhe 1947 (125). Ky numur, siç shihet, ka qenë më i lartë më 1945 dhe ka ardhur duke u zvogëluar në vitet 1946 dhe 1947. Dënimet më të shumta me vdekje gjatë këtyre viteve shpjegohet me faktin se, sidomos në dy vjetët e parë, gjykatat ushtarake si gjykata të popullit kanë gjykuar numurin më të math të armiqëve të popullit dhe të kriminelave të luftës.

Në vitet e tjera dënimet kapitale të dhëna nga gjykatat ushtarake kanë qenë më të pakta dhe janë dhënë kryesisht për krime të rënda kundra popullit dhe shtetit që hyjnë në kompetencën e tyre.

Dënimet kapitale të dhëna nga gjykatat ordinare në vitet e para mbas çlirimit kanë qenë më të pakta dhe janë dhënë sidomos për krimin e vrasjes. Duke filluar nga viti 1949 dhe veçanërisht në vitin 1951 shihet një rritje e numurit të dënimeve kapitale, gjë që shpjegohet me faktin se gjykatat ordinare kanë zbatuar këtë lloj dënimi edhe për krimet e rënda në dëm të pasurisë socialiste.

Dënimi me burgim është zbatuar, në një shkallë që ka ardhur gjithnjë duke u rritur, nga gjykatat ordinare duke filluar nga viti 1945 gjer në vitin 1950 kur është haritur numuri më i math i tyre. Pastaj nga viti 1951 numuri i të dënuarve me këtë lloj dënimi ka ardhë duke rënë nga 7.504 që ishte në vitin 1950, në 5.570 më 1951, në 3.922 më 1952, në 2.604 më 1953, dhe me një shtesë të vogël në krahasim me vitin 1953, në 2.629 më 1954 dhe 2.799 më 1955.

Ulja e numurit të të dënuarve me burgim që konstatohet nga viti 1951 shpjegohet në radhë të parë me uljen e kriminalitetit në përgjithësi duke filluar nga ai vit.

Në numurin e përgjithëshëm të të dënuarve një vënd me rëndësi zë edhe ai i të dënuarve me gjobë dhe me punë korrektonjëse, gjithsejt 38.372. Kjo vërteton se për krime të një rëndësije të vogël dhe për persona me rrezikëshmëri shoqërore të pakët, gjykatat kanë zbatuar gjërësisht këto lloj dënime si më të përshtatëshme dhe me efekt edukonjës.

AQSH, Fondi 14 (KQ i PPSH), Viti 1948, D. 181, Fl. 45.

PARTIJA KOMUNISTE SHQIPTARE
KOMITETI PARTIS RRETHIT
K R U J Ë
Nr. 14/6 Pr. Rez. Kruj 10/8/948.
KOMITETIT QENDROR PARTIS K.SH.
(Drej. Organ. Inspek.)

Tiranë

Me shkresën Nr. 75 dat.3/8/948 u kemi njoftuar për arratisjen e Kasem Kersit Sekretar i B. Celulës të lokalitetit Noje, që mbante me vete dhe Teserën e Partis me nr. 013041.

Ky mbasi kreu aktin që vrau atë fshatarin e tij u aratis me vëllan dhe me një kushërin e tij. Qëllimi për të cilin e vrau këtë nuk ishte vetëm se e kishte hasmë; por se Kasemi ka qenë dhe i implikuar me të arratisurit; dhe duke e par se nga ana e Partis i kërkohej llogari për punën atje gjithashtu dhe nga ana e Sigurimit mbasi ai ishte më par i besuar, por që kohët e fundit u zbulua, duke dashur të maskohej nënë hakmarje e vrau atë dhe u arratis.

Nga ana e organeve të shtetit nuk asht mar ndonjë masë karshi familjes e fare fisit tij, me gjith që nga forcat e mbrojtjes gjyrmohet në afrit e atij lokaliteti.

Në lidhje me këtë dhe me operasionin që ka filluar sidomos këto ditët e fundit në Rrethin tonë mendojmë, që për t'i dhënë një grusht të shëndosh Reaksionit të arratisur të mirren disa masa ekstreme (pushkatime) qoft në njerës të t'aratisurve në familje dhe në strehusa të tyre, mbasi shofim që një dyshim të krijohet nga ana e qeveris dhe menjëher dalin në mal duke gjetur mbështetje në elementet armiqë.

Në lidhje me operimin që filloj tani jemi në lidhje të ngushta me shokët e Komandës e të Mbrojtjes e nëpërmjet Seksionit u japim ndihmën që duam, duke mobilizuar Partin në bazë për informasion e për udhëheqje.

Kemi bindje se në këtë mënyrë që punohet që mendojmë të bëhet do të korrim suksese në luftën kundër kriminelave t'aratisur.

P. KOMITETIN E PARTIS K.SH. RRETHIT
(Ilo Prifti)

AQSH, Fondi 14 (KQ i PPSH), Viti 1948, D. 181, Fl. 47.

PARTIJA KOMUNISTE SHQIPTARE
KOMITETI P. RRETHIT DUKAGJIN V.F. L.P.
Nr. 8/1 Res. Kodër-Shëngjergji më 15/VIII/48.

Komitetit Qendror P.K. Shqiptare
(Drejtoris Organizimit Inspektimit)
T i r a n ë

Në lidhje me Radio Gramin t'onë Nr. 8, Res dat, 14/VIII/48, me të cilën ju kemi njoftue për ilegalizën e 3 Personave, ju njoftojm sa, posht vijionë.

Ilegalizimi i tyre me sa jemi njoftue asht shkaktue për këto arsye Zyra Ushtarake e Rrethit t'onë i ka kërkue për t'u paraqit me u kontrollue si të gjith datlindjet tjera, këta nuk jan paraqitur atë-herë Zyra në fjal i ka dhan urdhën kshillit lokalitetit për të shoqrue me policë deri në qendër, kur policija ka shkue me kërkue këta jan largue. Elementat e ilegalizuem gjat të gjith kohës që prej çlirimit si dhe gjat okupacionit nuk kan majt qëndrim të mirë politik. Elementat e ilegalizuem jan këta; Prel Marku i nipi Bajraktarit Shalës asht dënue nga gjygjet t'ona me 10 vjet burgim, me rastin e amistës fundit ka përftue duke u largue para afatit caktuer.

2) Sadik Marku djali i Mark Sadikut Shalës i cili ka ken Krytari i Rinis Dukagjinit gjat regjimit Zogut ashtu dhe gjat okupacionit, dhe ky ka kan në burgë por ka përfitue nga amnistija.

3) Marash Kola ky ka kan fill mbas shlirimit në burg por për munges provash ka marr pa fajsin, mbasi ësht lirue nga burgu mbas do kohet asht marr në shërbim nga Komiteti Ekzekutiv, si nëpuns i grumbullimit në kohën kur asht ilegalizue ka pas me vedi nji shumë të hollash prej afro 70.000 lekësh të cilat do t'i çonte me i derdh në Bankë në Shkodër.

Ilegalizimi i tre personave të sipër në gjet disa ditë mbas ilegalizimit të 5 personave nga lokaliteti Theth, te cilet kan kalue kufinin në sa tre të sipërmendë nuk kan kalue kufinin.

Për t'i pre hovin ilegalizimeve tjera ne jemi të mendimit qi të merren disa masa të shpejta familjeve të tyre mbasi deri tani nuk asht marr as nji mas me gjith qi ka nji koh prej tre javësh qi jan ilegalizue 5 të parët mos marrjen e masave dot i lan shkak shtimit të parullave rreaksionit nji herit dhe ilegalizimit të noj personit tjetër.

Masat që ne mendojm të merren jan këto: internim i familjeve dhe rrekuizimin e pasuris deri në dorzimin e tyre.

Në lidhje me ilegalizimin e tre të fundit nga ana e jon jan marr masa për dorzimin e tyre mbasi gjinden në territorit t'onë duke dërgue njers posaçëm nji herit i kemi dhan dhe afat

AQSH, Fondi 14 (KQ i PPSH), Viti 1948, D. 181, Fl. 49.

PARTIJA KOMUNISTE SHQIPTARE
KOMITETI I P.K. RRETHIT BICAJ
Nr. 87/7 Prot.

VDEKJE FASHIZMIT
LIRI POPULLIT
Bicaj 19/X/948.

KOMITETIT QENDROR TË PARTIS KOMUNISTE SHQIPTARE

T I R A N Ë

Vijon Relacjoni i jon Nr. 87/4 dat 30/9/48.

Në Rrethin t'onë siç ju kemi lajmue her mbasë here dhe me telegram deri tashë jan aratis 26 veta ndër të cilët gjatë prej tyre kan marr me vehte dhe familjet e tyre, ndërsa njeni ka marrë edhe baktija.

Situata me gjith skjarimet e vazhdueshme t'onat paraqitet e shqetsueme në dy krahina në Shishtavec e Qendër e sidomos në katundetë Topojan, Brokij, Kollovoz, Turaj, Xhaferaj, Kolesjan, e Novosoj.

Komiteti i partis për këtë qështje ka ba tri herë mbledhje specjale dhe në këtë mbledhje ka dalë që t'u bante skjarimi i masavet në këto krahina e për ma tepër në fshatrat e naltë përmendura, gjithashtu u muarë vendim që të merrnim masa për arestimin e nji pjese të elementave të dyshimtë prej të cilve nji pjesë janë kapë dhe për disa të tjerë nuk na ka ardhë aprovimi nga drejtorija e sigurimit të shtetit akoma por që deri me aprovimin për kapjen e tyre i keni nënë shiqim të mësheftë që të mos na ikin.

Për sa i përketë skjarimit politik të krahinave të sipërme ka qenë i vazhdueshëm por efektetë nuk kanë qen dhe aqë të kënaqëshme me përjashtim fare të vogël.

Prej të gjith këtyre elementave qi kanë ikur neve dishojshin vetëm për 4-5 veta dhe jo për ma tepërë mbasi elementi tjetër që ashtë aratis nuk na lente të dishojm për ikje, me gjith se si qëndrimë ato ishin indiferentë në pjesën ma të madhe.

Ikja e tyre ma tepër ashtë ba nga se kanë inflojencën agjenta jugosllav të cilët kanë mujt të kalojnë kufirin dhe të takohen me elementa të pa kënaqurë në vendin tonë tuej u dhanë këtyre se do i gjejmë vendin Kosovës se në Jugosllavij na kanë premtue se për deri në 30-40 familje mundë të strehohen vetëm në Dragashë (Jugosllavij) qoftë me shpija qoftë dhe për furrnizim mbasi do ju japinë tok. Nji parull e till ka inflojencuar mjaftë për ikjen e tyre.

Nga ana e tjetër këto kanë përfitue mjaftë nga mungesa e forcave ushtarake t'onave për sa i përket policis qofë edhe për repartet e mbrojtjes që ndodhen në kufij, këta na e tregojnë faktetë së elementave që u aratisën kan dal jo vetëm me familje edhe me kafshë të ngarkueme por edhe me _____, e për por ksaj këto në shumë raste kalojn prapë kufirin e dalin ndonji herë në Shqipnij.

Të gjith elementi që ashtë arratis kanë kaluar kufirin dhe ndodhen në Rrethin e Dragashit me përjashtim të Lutfij Spahiut me dy tre shok të tjer të cilve u kanë dërguar dhe makin me Dragashë dhe i kan marr për në Prizren.

Neve propozojm që përveç masavet që do marrim nga ana e jonë për skjarimin e masave, kapjen e ndonji elementi që dishojm dhe internimin e familjeve të atyre që janë aratis, kërkojm që të forcohet kufini ma tepër tuej dërgu forca tjera të Mbrojtjes mbasi me këto forca i jepet rastë qëdo elementi të kaloj kur të doj kufirin.

P. KOMITETIN E P.K. RRETHIT BICAJ

(Rushit Milaimi)

AQSH, Fondi 14 (KQ i PPSH), Viti 1948, D. 181, Fl. 51.

KOMITETI QARKOR I P.K.SH
PESHKOPI Peshkopi, më 27/X/47

KOMITETIT QËNDROR TË PKSH
Tiranë

Ju njoftojmë se pretenca e prokurorit kundra grupit të tradhtarëve është punuar në këtë mënyrë:

Herën e parë u punua në Komitetet e Partis të N/Prefekturës dhe prej aty në celula u punua në fshatra dhe në vendet e punës e në nëpunsit e sektorëve të ndryshmë; vetëm se në N/Prefekturën e Qendrës pretenca e prokurorit nëpër fshatra është punuar me ngadalë, duke nxjerrë si preteks se kemi bërë shumë konferenca në popull dhe populli është mërzitur. Kjo e metë u konstatua dhe u godit me një herë.

Populli dënimin e këtyre tradhtarëve e kriminelëve e ka pritur mirë dhe e ka aprovuar duke treguar urrejtjen kundër tyre, kundër anglo-amerikanëve për veprimtarinë kriminale karshi vendit t'onë. Nga ana tjetër kanë çfaqur dashurinë e miqësinë për Bashkimin Sovjetik e Jugosllavinë Demokratike të cilët na mbrojnë para shpifjeve të pa drejta të imperialistave anglo-amerikanë e këlyshëve të tyre si Greqija etj.

Përveç punimit që është bërë nga ana jonë por edhe vetë populli është interesuar për të gjetur gazetën që ka pretencën për t'a këndue shumë herë, kjo është arrijt nga puna që kanë bërë shokët e Partisë, një interesim i tillë nga ana e popullit ësht dukur sidomos në N/Prefekturën e Zerqanit.

Është digjuar nga populli që të thuhet se kur do të dalë në gjyq Fahik Shehu që të japë llogari për tradhëtinë që i ka bërë popullit e atdheut, dhe ta sjellin këtu ta pushkatojnë.

Në disa katunde gjat punimit të pretencës është konstatuar që të mërzitej populli mbasi pretenca ka qenë shumë e gjatë, por në shumicën tjetër e kanë dëgjuar e vëmendje dhe me interesim.

Për Komitetin Qarkor të P.K.SH.

Jaqi Nesho

AQSH, Fondi 14/ AP OU (KQ i PPSH), Viti 1951, D. 1, Fl. 228.

SEANCA E DATES 20 SHKURT
DHE MBETEN VETEM ANETARET E BYROSE POLITIKE TE KQ

SHOKU KOMANDANT. – Tani te shohim nje propozim te Mehmetit ne lidhje me masat qe duhet te marrim per ate qe ngjau ne legaten Sovietike.

SHOKU MEHMET SHEHU. – Çeshtja qendron ketu. Mbreme ne oren 7 e 47' nga rrugica qe eshte mbrapa Legates Sovietike eshte hedhur nje dinamit i mbeshtjelle ne leter dhe i lidhur me nje fitil. Dinamiti u hodh brenda ne oborr dhe ka plasur e ka thyer deren, penxheret dhe ka bere nje zhurme te forte. Me nje here kane vajtur forcat per ndjekje po nuk kane gjetur gje. Pastaj kane rene pas shenjave dhe kane kapur disa njerez qe ishin atje. Dyshimet tona rreth kesaj ngjarjeje jane se mund te jete vazhda e nje proçesi, po pavaresisht ne se eshte ndonje nga ata qe mendojme ne apo jo, ne duhet te zbulojme pa tjeter burimin dhe njerezit e ketij atentati. Duke marre parasysh se ky nuk eshte nje aksion I thjeshte, po nje ngjarje politike e kalibrit te madh, bile me e madhe se nje atentat qe mund te behej kunder ndonjerit nga ne, eshte e nevojshme politikisht qe ne te marrim masa repressive te jashtezakonshme pa marre parasysh ligjet ne fuqi. Nje mase e tille ne e kemi marre edhe kur u vra Bardhok Biba dmth kemi pushkatuar dhe jashte ligjeve ne fuqi. Une mendoj qe kjo mase qe do te marrim duhet te jete ne nje shkalle te tille qe elementi qe perpunohet, elementi reaksionar i tipit Kasaruho etj, sonde t'i arrestojme. Te arrestojme rreth 100 ose 150 veta, nga te cilet nja 10 ose 15 prej tyre ti pushkatojme duke zgjedhur sigurisht nga ata me kryesoret mbasi kane dashur te organizojne atentate te tjera. Kjo mase do te proçedohet edhe me nje mase tjeter spastrimi nga Tirana te familjeve reaksionare Brenda nje muaji. Ne duhet terrorit ti pergjigjemi me terror. Ne dhe kete mund ta bejme me plot ndergjegjie dhe me gjakftohtesi. Ne i kemi pregatitur listat e arrestimeve dhe po te jeni edhe ju dakord, veprojme qe sonde. Qysh mbreme ne kemi marre masa per ruatjen e te gjithe njerezve sovietike qe ndodhen ketu si keshilltare, profesore duke ju vene nga njerezit tone per ti shoqeruar. Pjesa kryesore e tyre do te armatosen, pastaj kemi menduar te veme roje edhe ne te gjitha objektet ku punojne dhe banojne keta, rrotull ketyre do te bejme pastrimin qe te heqim familjet e dyshimta si dhe njerez te tjere qe punojne afer tyre, pse kemi vene re qe jane future tek ata njerez te poshter dy shofere te mire. Keto masa mendojme ti marrim kudo ku ka sovietike qe jane ketu rreth dyqind veta prej tyre. Do te marrim gjithashtu masa ne kete rast edhe disa masa me te mira per mbrojtjen e legatave te demokracive popullore, te cilat sot per sot kane vetem nje roje, me gjithe se ne keto masa do te behen edhe mjaft harxhime, po ne do ta bejme se jane masa te domosdoshme dhe duhet ti marrim.

TE GJITHE ANETARET E BYROSE. – (nje zeri) Te gjithe jemi dakord me keto masa.

SHOKU MEHMET SHEHU. – do te ishte mire qe ne si byro politike ti benim nje telegram shokut Stalin ku ti tregonin se si ka ndodhur kjo ngjarje, kjo fatkeqesi

e madhe me mire dhe ti premtojme e ta sigurojme se luften kundra armiqve te jashtem e te brendshem do ta vazhdojme akoma me me shpejtesi.

TE GJITHE SHOKET ANETARE TE BYROSE POLITIKE. – (Aprovojne edhe kete propozim te dyte te shokut Mehmet Shehut).

SHOKU BEQIR BALLUKU. – po per çeshtjen e atyre qe do te pushkatojme ne duhet te gjejme edhe nje motivacion.

SHOKU MEHMET SHEHU. – Kete gje e lidhim me ate qe donin te benim ne 8 Shkurt.

SHOKU KOMANDANT. – Motivacioni te mos thuhet per atentat.

SHOKU MEHMET SHEHU. – per kete gje duhet te flitet pak edhe me gjykaten dhe prokurorine ushtarake.

(Mbyllet senaca e dates 20.2.1951).

AQSH, Fondi 490 (Këshilli i Ministrave), Viti 1951, D. 1290, Fl. 4.

REPUBLIKA POPULLORE E SHQIPËRISË
Kryeministria
Tiranë, 2.3.1951

KOMITETIT EKZEKUTIV K.P. RRETHIT
SKRAPAR

Dërgohen n'atë qytet të dëbuar nga Tirana familjet e disa reaksionarëve të pushkatuar këto kohët e fundit për aktivitet terrorist kundra Pushtetit Populllor. Keto janë

1) Familja e Jonus Kacelit

Interesohuni per sistemimin e sajë në ndonjë ndërtesë gjithashtu t'u gjendet ndonjë punë sa për të siguruar bukën e gojës.

SEKRETAR'I PERGJITHSHËM
(Firma)

2.2 Gjyqi i Opozitës dhe i deputetëve

AIDSSH, N= 1081-A. VITI 1961, D. 3.

REPUBLIKA POPULLORE E SHQIPËRISË Vdekje Fashizmit – Liri Populllit
P R O K U R O R I J A E
GJYKATËS USHTARAKE E NALTË
Nr. 38 i R.P.

L e t ë r - r r e s h t i m

K o n d r a :

Gjergj Kokoshi bir i Jaçim dhe i Viktore vjeç 42 nga Shkodra-Tiranë me profesion Profesor

A k u z o h e t

Si Armik i Popullit dhe Sabotator i Pushtetit.

Me qenë se faji i tij parashikohet prej Nenevet 1 të Ligjit Nr. 21 datë 15.XII.1944 dhe 15 parag. II të Ligjit Nr. 41 datë 14.I.1945.

Ne Prokuror' i Gjykatës Ushtarake në bazë të Nenit 20 parag. III të Ligjit Nr. 41.

U r d h ë r o j m ë

Rreshtimin e tij për një kohë të pa caktuar në burgun e Tiranës.

Organet e M. P. Policis dhe çdo fuqi e armatosur ngarkohet me zbatimin e këtij letër-rreshtimi.

P R O K U R O R I
(Kap. Irë Nevzat Haznedari)

KRYETARI
(Major Frederik Nosi)

Tiranë më 10.V.1946

AIDSSH, N= 1081-A. VITI 1961, D. 3.

REPUBLIKA POPULLORE E SHQIPËRISË
GJYKATA USHTARAKE E NALTË
Nr. 5 Regj. Them.

VDEKJE FASHIZMIT
LIRI POPULLIT
Tiranë më 8.VIII.1946

Drejtoris së Burgut të Ri

T I R A N Ë

Ju njoftojmë se kjo Gjykatë me vendimin e saj Nr. 5 Regj. Dat 2.VII.946 ka vendosur ndëshkimin e GJERGJ KOKOSHIT nga SHKODRA me 30 VJET BURGIM, HUMBJEN E TË DREJTAVE QYTETARE DHE POLITIKE SI DHE KONFISKIMIN E PASURIS.

Ky vendim ka marrë formën e preme.

Ndëshkimi i fillon më datën 23/I/1946 dhe i mbaron më Dat. 23/I/1976.

Për KRYETAR' I GJYKATËS USHTARAKE
(Major Frederik Nosi)

AIDSSH, N= 1081-A. VITI 1961, D. 3.

REPUBLIKA POPULLORE E SHQIPËRISË
PROKURORIJA E GJYKATËS USHTARAKE TË NALTË
Nr. 5 Regj. Them.

VDEKJE FASHIZMIT
LIRI POPULLIT

A K T - A K U Z Ë
(KOMUNIKATË)

GJYKATËS USHTARAKE

Sikurse do të konstatohet dhe nga proces-verbalet e mbajtura prej Seksionit të M.P. të Tiranës, që bashkangjitur paraqiten, i pandehuri GJERGJË KOKOSHI i biri Jaçim dhe i Viktores, vjeç 42, nga Shkodra me profesion ose efektiv Prefesor i rreshtuar më datën 23 Janar 1946. akuzohet se i pandehuri ka bashkëpunuar me Suat Asllani, Qenan Dibrën, Sami Çeribashin dhe elementa të tjerë, të Ballit, Legalitetit, e tjerë.

2) Ka udhëzuar dhe frymzuar këta në mënyrën e veprimit për të tërhequr sa më shumë elementa duke i mashtruar e duke i premtuar ndihma të reaksionit të jashtëm.

3) Ju ka treguar mënyra organizimi në krijime grupesh, të cilët të lidheshin ndër mjet njëri tjetrit; i rezistencës, i monarkistave, e tjerë, të lidheshin gjithashtu me gjith t'aratisurit kriminela lufte mbrenda e jashtë Shqiprisë.

4) I ka mësuar të përpilojnë nota (kërkesa) për Misionin e huaj dhe me anën e këtyre t'a paraqitnin si të turbull këtu, duke kërkuar ndërhyrjen e ndihmave të tyre.

5) Ka shfrytzuar vendin, emrin dhe kredinë që i kishte dhënë Fronti duke e përdorur për të sabotuar e për të përmbysë Pushtetin.

6) Gjith aktiviteti e propoganda e tij ka qemë për të, për të përmbysur me forcë pushtetin popullor, në lidhje me të sipërmit e me reaksionin grek e ndërkombtar.

Mbasi faji i tij parashikohet i ndëshkushëm prej Nenevet 1 të Ligjit Nr. 21 dat. 15.12.44, dhe 15 e II. të Ligjit Nr. 41 D.14/I/1945 është parë e nevojëshme që ky të gjykohet

P r a n d a j :

Kërkoj gjykimin e tij nga ana e asaj Gjykate dhe mbasi t'i faktohet faji që akuzohet, në përfundim të vendoset ndëshkimi i tij në bazë të Nen. 18 të Ligjit Nr. 41. Dat. 14.1.945, mbi Organizimin e funksionimin e Gjykatave Usht.

Tiranë 19.VI.1946

P R O K U R O R
(Kap. I-rë Nevzat Haznedari)

AIDSSH, N= 1081-A. VITI 1961, D. 3.

P R O C E S - V E R B A L

Sot më datën 1/Prill/1946 ditën e Hënë përpara meje Major Gjon Banushit, Prokuror' i Gjykatës Ushtarake të Tiranës, i asistuar prej Sekretarit Aspirant Thoma Rinos, u muar në pyetje i pandehuri Gjergj Kokoshi, i biri i të ndyerit Jaçim dhe i Viktores, vjeç 42, lindur në Shkodër e banues në Tiranë, Lagja e Re rruga Kostandin'i Math Nr. 52, me profesion Profesor, i pa martuar, Doktor në letrat e bukura, i pa dënuar, i arrestuar me datën 23 Kallnuer 1946, i cili mbasi u pyet dekllaroj: Reth datës 15 të muajit Tetor të vjetit 1945 kam filluar aktivitetin t'im politik për formimin e një Partije, e cila do të kishte funksionin e një opozite demokratike konstruktive. Për këtë kam biseduar me disa elementa emërat e të cilëvet nuk mund t'i përmënd mbasi çështja mbeti në heshtje dhe nuk ka rëndësi, të gjithë këta persona m'u përgjigjën se ishte vonë dhe e kotë që t'ja fillonim kësaj pune.

Një ditë ose dy para Bajramit jam takue me Shaban Ballën në Këshillin e N/ Prefekturës dhe ay shprehi dëshirën që të takohesh me mua dhe me qenë se një dit ose dy ma von ishte Bajram, i thashë se me rastin e festës d.m.th. ditën e parë të Bajramit do të vij në shtëpi dhe me këtë rast mundet dhe të bisedojmë. Ditën e parë të Bajramit reth orës 10 në mëngjes shkova në shtëpinë e Shaban Ballës ku gjeta vetëm Shabanin dhe më von erdhi Sami Çeriibashi, të cilin unë nuk e njifsha dhe ma prezantojti Shabani. Në këtë mbledhje fjalën e mora unë, u vura në dukje Shabanit dhe Samiut se unë mendoja për formimin e një opozite e cila kishte për qëllim që të mblidhte në gjirin e saj elementin që nuk kishte aderuar në Frontin Demokratik, dhe mbasi të kishin një organizim të nxirshin përfaqësuësit e tyre në Parlament për mbarëvajtjen e popullit Shqiptar. Në këtë mbledhje u bisedua prej Samiut ose prej Shabanit për grupin e Rezistencës, por se çfarë u bisedua mua nuk më kujtohet. Në takimin që kam pasur me Sami Çeribashin mua më ka lënë përshtypjen se ay është një njeri i ndershëm porse nuk është në korent të reformave të mëdhaja ekonomike që janë duke u bërë sot në botë. Gjithashtu dhe për Shaban Ballën unë e di për njeri të ndershëm. Në këtë mbledhje u vendos që të bëhesh një mbledhje tjetër dhe kjo u bë mbas 2-3 ditësh. Në këtë mbledhje mernin pjesë Sami Çeribashi, Avukat Qenan Dibra, Xhahit Koka, Mehmet Beshiri, Profi Çoka, Shaban Balla dhe unë. Në fillim të mbledhjes shkova unë dhe më von erdhën të tjerët me radhë dhe mbasi u bashkuem të gjithë Mehmet Beshiri mori fjalën dhe tha se neve të tre d.m.th. Mehmeti, Qenani dhe Xhahiti ishin të grupit Monarhist, kurse Shabani, Samiu dhe Profi të Grupit të Rezistencës. Mbas këtij fjalën e mora unë duke i njoftuar ata se për formimin e një opozite ishte nevoja që të përpilloja një Program e të bëhesh dhe një lutje, të cilat të nënshkrueme prej disa njerëzvet të ndershëm me qëndrim politik korekt do t'i dërgoheshin Ministris së Mbrëndëshme. Programi i kësajë Partije do t'ishte pak a shumë si ay i Frontit mbasi edhe neve do t'ishim me Bllokun e math Anti-fashist d.m.th. me Anglinë, me Bashkimin Sovjetik dhe me Shtetet e Bashkuara

t'Amerikës, gjithashtu dhe na do të bajmë po ato reforma ekonomike që ban Fronti por në një masë më të vogël, gjithashtu duhet që na ta ruajm Shqipërinë nga Jugu dhe nga Veriu. Kam thënë se kryeministri Bullgaris ka ba para do kohe një dekllaratë në të cilën ka thanë se duan s'duan Aleatat e mëdhenj Bullgarija do të bashkohet me Jugosllavinë. Këtë rrugë ndjek edhe Qeverija jonë dhe kjo don me bashkue Shqipërin me Jugosllavinë, ky bashkim është kundra vullnetit të popullit Shqiptar, populli Shqiptar don që Shqipërija të mbetet Shtet indipendent dhe sovran, na duhet ta rujm një shtet të tillë, por pa Gjirokastër e pa Korçë nuk ka Shtet Shqiptar. Mbasi Jugosllavija na ndihmon për me rujt integritetin toksor çashtjen e Kosovës duhet me e lanë mënjanë për tani. Kur ata më pyetën për çështjen e Programit që duhet të paraqitim unë i thashë se çështja e Programit është një çështje sekondare por ajo që na intereson më tepër është që të mbledhim disa firma dhe t'i paraqesim një kërkesë Qeveris duke kërkuar shtytjen e zgjedhjevet për një kohë të mjaftushme deri sa të pregatiteshim. Kur u bisedua çështja e Programit dhe e shkresës se kujt do t'i dorëzoheshin këto Shaban Balla insistonte që këto duhet t'i dërgoheshin Misionevet Anglo-Amerikane mbasi t'ishin përkthyer në gjuhën Inglisht, kurse unë këtë e kam refuzuar dhe kam insistuar që kjo t'i dërgohesh Qeveris Shqiptare d.m.th. Ministris së Mbrëndëshme mbasi kisha dëgjue prej një njeriut që s'mund t'ja zë në gojë emërin i cili kishte bisedue me Gjeneralin Hoodston se kërkesa duhet t'i drejtohesh Ministrisë së Mbrëndëshme të Qeveris Shqiptare. Kështu u vendos që Programi i opozitës së bashku me kërkesën t'i dërgohesh Qeveris Shqiptare. Mbs kësaj u bisedua për të marrë pjesë në mbledhjen e tretë ku unë si Gjergj do të thritja Vangjel Meksin dhe Suat Asllanin të tjerët nuk më kujtohen. Në këtë mbledhje u bisedua dhe çështja e Kosovës. Mohoj që të jetë përmëndur në këtë mbledhje çështja e t'aratisurvet me sa mua më kujtohet.

Një ditë në mbrëmje në orën e caktume kam shkue me maqinën e Shaban Ballës të cilën e dirizhonte Shabani në Misionin Englez për me takua me Gjeneralin Hoodston, por mbasi haritëm atje me qënë se Gjenerali ishte i zanun atëhere unë bisedova me dy Majorat Englez të Misionit emërat e të cilëvet nuk më kujtohen, biseda u bë për çështjen e Ligjit elektoral që ishte i bërë prej Frontit, prandaj shkaku për të cilin unë u largova qe pse Fronti ishte një paravento dhe mbrapa tij mshifej Partija Komuniste. Gjithashtu u kam thanë se jeshë mundu që më parë për formimin e një opozite por njerzit me të cilët kam bisedue dhe që emërat e tyre nuk mund t'i përmënd më kanë thënë se është tepër vonë, prandaj hoqa dorë. Nuk më kujtohet që t'u kem thënë, ose edhe mund t'u kem thënë, dy Majorave Englezë që tani me qënë se juve jeni të dispozuar për me shty datën e zgjedhjevet duke bërë hapa pranë Qeveris Shqiptare, sikurse u keni thënë dhe këtyre, unë jam gati që ti hy kësaj pune përsëri për formimin e opozitës. Të nesërmen ose të pas nesërmen mbrëma, nuk më kujtohet me siguri data, i kam thënë Shaban Ballës për të bërë një mbledhje e cila u bë në shtëpinë e Shaban Ballës dhe që këtë e kemi përmëndur më lart.

Nuk më kujtohet që kur kam qënë në Misionin Englez së bashku me Shaban Ballën të kem biseduar me dy Majorat që shkresën dhe Programin t'ja dorëzonim

Misionevet Anglo-Amerikane dhe për njoftim Ministris Mbrendëshme. Kemi biseduar se kjo duhet t'i dërgohesh pa tjetër Anglo-Amerikanëvet dhe përsa i përket Qeveris këtu u ndanë mendimet unë kam pretenduar që t'i çohesh Qeveris ndërsa ata kanë thënë se jo se mund të na arestojnë, ndërsa unë kam insistuar që t'i dërgohesh Qeveris pa tjetër duke marë parasysh dhe arestimin; ky bisedim është bërë në mbledhjen që kemi bërë në shtëpinë e Shaban Ballës mbasi ishim takuar me Majorat Englezë nesër mbrëma ose të pasnesërmen.

Mbas disa ditësh jam takuar me Sami Çeribashin në Kafe Metropol dhe atje kemi biseduar mbi çështjen e Kosovës, dhe mbi një notë e një Program që ata i kishin dërguar Misioneve Anglo-Amerikane, unë nuk mbaj mënd se çfarë përgjigje i kam dhënë. Biseda ka vazhduar ndonjë orë aproksimativisht dhe nuk është e vërtetë ta kem pyetur pse mua nuk më thirë në mbledhjen e tretë. Nuk mbaj mënd tjetër pikë se çfarë është bisedue me gjithë që janë bisedua dhe çështje të tjera por unë nuk i mbaj mënd.

Nuk kam biseduar asnjë herë me Suat Asllanin.

Unë me Musine Kokalarin jam takuar një herë rrugës dhe në Librarinë e saj kam vajtur 5-6 herë. Në takimin që kam pasur rrugës me të unë i kam thënë asaj se këtu nuk ka kurkush me u tund me kuptimin që të dalin njerz e të punojshin për një opozitë; gjithashtu i kam thënë se nacionalizmi në Shqipëri ka mbarue. Tjetër gjë nuk kam biseduar, është bisedue dhe për pika të tjera por nuk i mbaj mënd (këtu i pandehuri di dhe nuk i kallzon; Prokurori). Mbasi u përmënd nga ana e Prokurorit, i pandehuri thotë: Në bisedat që kam pasur me Musine Kokalarin i kam thënë se nacionalistat dhe jo nacionalizmi Shqiptar vdiqnë dhe nuk meritojnë mbasi nuk po bëjnë asnjë sakrificë dhe nuk është e vërtetë që t'i kem thënë se nuk kanë bërë asnjë sakrificë.

Unë nuk është e vërtetë që të jem marë vesh ose të kem biseduar me njerzë të tjerë nga antarët e Këshillit Antifashist ose me të tjerë për vepra kundra Frontit. Mandej i pandehuri e kthej dhe tha nuk mbaj mënd. Mbasi u përmënd nga ana e Prokurorit në fund i pandehuri tha se kundërshtimi në kryesinë e Këshillit Antifashist nuk do të paraqitesh vetëm nga unë, por edhe nga të tjerët të cilët nuk patën kurajon të flisnin por është e vërtetë se kanë thënë se neve dimë të flasim në Kafene por jo atje ku duhet.

Në bisedat që kam bërë në Librarinë e Musinesë herë mbas here s'mbaj mënd çkam biseduar veçse për libra dhe nuk mbaj mënd as çfarë i kam thënë dhe as çfarë më ka thënë.

Me Suat Asllanin nuk mbaj mënd se çfarë kam biseduar, por kam biseduar, takimet i kam bërë rrugës, në Zyrë dhe në shtëpi. Nuk kam biseduar për çështjen e Pushtetit, mandej kthehet dhe thotë, mund të kemi biseduar por nuk mbaj mënd. Mund t'i kem biseduar dhe për çështje opozite. Me gjithë që kemi biseduar shpesh herë unë nuk di gjë se ç'opinion ka dhe çfaqte Baltazar Benusi, me gjithë që në disa argumenta kemi pasur një vijë politike si unë si ay, por disa herë binim në kundërshtim. Në pikat që kemi qënë dakord nuk i mbaj mënd, gjithashtu nuk i mbaj

mënd dhe në pika që kemi qenë kundra.

Vasil Bidoshin e njof si person por nuk kam biseduar as nuk kam shkëmbyer pikmaje politike me të. Gjithashtu dhe me Kol Dhimitrin nuk kam bisedue ndonjë herë mbi politikë, e njof këtë por për politikë nuk kam folur.

Unë kur i kam shënuar emërat e këtyre njerzëvet në listë nuk kam biseduar me ta por di qëndrimin politik të tyre nga opinioni i përgjithshëm si njerzë të ndershëm. Unë me këta njerzë do të bisedojsha dhe do t'i kandisja.

Në kohën kur filluan arestimet unë kam pyetur Shaban Ballën se në ç'mënyrë u diktuen këta që u arestuan, gjithashtu e kam pyetur në qoftë se do të arestojnë çfarë do të themi, këtë e kam bërë me qëllim që çfarë do të thotë dhe këtë e bëra për kuriozitet. Nuk është e vërtetë që unë t'i kem thënë të mos kallzojmë gjë dhe t'i mohojmë të gjitha ose të kemi kordinuar mendimet t'ona.

Thënjet e mija si ma sipër mbasi i këndova dhe i këndova dhe janë konform i vërtetoj me nënshkrimin t'em me vullnet të lirë dhe pa ndonjë shtërngim.

Tiranë, më 1/IV/1946.

I pandehuri: Sekretari: Prokurori:

AIDSSH, N= 1081-A. VITI 1961, D. 3.

PROCES – VERBAL

Sot në datën 23/Janar/1946, në zyrat e Seksionit të M.P. Tiranës, u-muar në pyetje GJERGJ KOKOSHI, i biri i të ndyerit Jaçim dhe i Viktores, lindur në Shkodër në Janar 1904 e banues në Tiranë, me profesion profesor, i cili, mbassi u-pyet deklaron:

P.P. Jashtë kam dëgjuar se flitet kundra Frontit, se s'ka liri, është diktaturë, por nuk dij gjë pozitive.

P.P. Sami Qelibashin e njoh. E kam njohur për Bajram në shtëpinë e Shaban Ballës, Nëntor 1945.

P.P. Qenan Dibrën e njoh, e kam njohur personalisht po në Bajramin e më sipërmë dhe po në shtëpimë e Shaban Ballës. Aty kam qënë unë (Gjergji), Shabani, Sami Qelibashi, Qenan Dibra, Xhahit Koka, Beshiri. Nuk mbaj mënt të më ketë thirur Shaban Balla. Aty kemi ndenjur më shumë se një orë.

P.P. Në shtëpinë e Shabanit kemi biseduar për formimin e një opozite konstruktive. Është biseduar se si duhesh të formohesh një opozitë. Kjo munt të formohesh në dy mënyra: ose të viheshin kandidatura në gjithë qarqet, ose t'i kërkoheshe Ministrisë së P. Brëndëshme me anën e një shkrese formimin e një partije. Pranoj të kemi biseduar mbi çështjen e Kosovës e mbi këtë kam thënë: Çështja e Kosovës nuk është një çështje thjeshtësisht shqiptare si e kujtojnë shovinistët shqiptar, as nuk është një çështje thjeshtësisht jugosllave si e mendojnë shovinistat jugosllavë.

P.P. Një element shovenist është që e shtron punën e Kosovës në kundërshtim se si e shtrova unë më sipër. Një element i tillë mund të kërkojë dhe një luftë kundra Jugosllavisë, për të marrë Kosovën.

P.P. Në mbledhje u bisedua rreth çështjes së Kosovës, por unë nuk mbaj ment se ç'farë opinioni kanë shprehur ata.

P.P. Kemi biseduar për formimin e një partije e do të qitnim e një program. U bisedua që programin do t'a firmonin edhe elemente të tjerë. Kemi biseduar për ta bërë edhe lutjen.

P.P. Me Sami Qelibashin jam takuar edhe herë tjetër rrugës. Jam takuar edhe një herë në kafe Metropol edhe kemi biseduar mbi punën e Partisë a u-bë gjë apo jo. Për takimin në kafe Metropol ishim takuar më parë dhe e kishim lënë takimin n'atë kafe.

P.P. Pranoj të kem biseduar në shtëpinë e Shabanit që lutjen t'ia dorëzonim Ministrisë së Brëndëshme, por nuk mbaj ment që të jetë folur për t'ia u-dorëzuar Englezëve. Në shtëpinë e Shabanit u-bisedua që të bëheshe një mbledhje tjetër m'e gjerë.

P.P. Pranoj se në shtëpinë e Shabanit kemi bërë mbledhje.

I Pyeturi
(Gjergj Kokoshi)
Tiranë, me 23/1/1946.

AIDSSH, N= 1081-A. VITI 1961, D. 3.

RELACJON MBI GJERGJ KOKOSHIN

Gjergj Kokoshi, ësht nga Shkodra dhe banues në Tiranë, me profesjon Arsimtar (Profesor), ka qen pjestar i Lëvizjes Nac.Çli. Gjat regjimit Anti-Popullor të Zogut, ka qen kundërshtar i këtij regjimi. Prej këndej del se Gjergj Kokoshi, ësht nji element aventurjer i politikës, ambicjoz dhe se qëllimi i tij qëndron anti-popullorë.

Aji njihet mir si një politikan i tillë (aventurjer) dhe këtë e ka faktuar me veprimtarin e tijë si në kohën e Zogut, si gjat okupacjonit ashtu dhe sot me Çlirimin e Shqipris dhe vumjen e Pushtetit në duart e popullit. Aji ka patur nji farë simpathije në popullë por me zbëlimin e Organizatës Klandestine të cilën aji e hudhëheqte i humbi dhe ajo pak kredi që kishte në Popull, dhe Populli kuptoji se Gjergj Kokoshi, ishte nji vegël e të hujve të cilët dojshin që me anën e Gjergjit të rëzojshin Pushtetin Popullorë dhe të bijshin në fuqi regjimet anti-popullore të më parshme. Gjergji ka qen nji nga udhheqsit kryesor të Organizatës klandestine të Sami Qeribashit, me shokë faktë ky që u vërtetua përpara Gjyqit të Popullit. Gjergji ësht dënuar nga Gjyqi i Popullit me 30 vjet burgim.

Personat në lidhje me të jan:

Sami Qeribashi, Shaban Balla, Ali Kavaja, Ivzi Golja, Tut Meniku, Mehmet Ali

Beshiri, Xhait Koka, Talat Drini, e Qenan Dibra, të gjith këta të dënuar me vdekje nga Gjyqi i Popullit, pse bashk me Gjergjin ishin organizatorët e grupit klandestin për rëzimin e Pushtetit Popullor; Mesine Kokolari, Suat Asllani, Kol Rodhe, Nefail Skikuli, Prof Çoka, Enver Hasa, Andon Dukagjini, Konstantin Kote, e tjer, ishin dhe këta udhheqsa kryesor të këtij grupi dhe kan mar vendime si mbas veprimtaris anti-popullore që kan zhvilluar në lidhje me këtë grup. Për veç këtyre u than ma nalt Gjergj Kokoshi, ka patur lidhje edhe me elementa të tjer të cilët sot ndodhen të lirë si me: Mirash Ivanaji, Ollga Plumbi, Shefqet Beja, Llazar Treska, Visarjon Xhuvani, Gaqo Opari, Anglo Abaxhoglu, Muztafa Çizmja, Besim Bogdani, Llambi Llambiti, Baftjar Kokona, Qazim Kika, Nuska Vjerdha, Demir Ali Zoti, Fatbardha Prodani, Ollga Nikolla, Xhelal Meniku, Kadri Luga, Reshat Petrela, Islam Koçi, e Qazim Xhepa.

BAFTJAR KOKONA, ish Ballist, ka qen në grupet klandestine, ka propaganduar kundër Pushtetit Popullor, ka qen burgosur dhe dënuar në lidhje me veprimtarin e tija anti-pushtet. Personat në lidhje me të jan: Sabri Hamzaraji, Vehap Çela, Zihni Struga, Xhemal Beshiri, (Ballist) Isuf Beshiri, Nuri Hamzaraji, Hamdi Havariqi, Qazim Havariqi, Zydi Deljallisi, Vasif Biçaku, Zija Dejlegjeri, Ferid Baholli, Ejup Hamzaraji, Risto Dinko, Fisnik Çano, Ibrahim Sukaj, Fadil Vokopola, Ramazan Beshiri, Eqrem Bajrami, Qemal Begeja, Ari Çarçani, Enver Paraku, Haxhi Keqi, (të 21 jan të rij ballista), shtojm se Baftjari ka patur lidje dhe me elementa të tjer që sot ndodhen të burgosur dhe që me këta aji e ka zhvilluar aktivitetin e tij anti-pushtet, si me Osman Kazazin, Reshtë Beqirin, Abdullah Berberin, Mysine Kokolarin, Lani Pëllumbin, Liri Jorgji Priftin, Asti Hobdarin.

SUAT ASSLLANI, element kundërshtar i Pushtetit t'onë, nji nga krerët e organizatës klandestine të Sami Qeribashit, me shokë, i dënuar për pjes marjen në këtë organizatë, për veç pjestarve të asaj organizate të cilët që të gjith kan mar dënimin e merituar, aji ka pas lidhje dhe me elementa të tjer reaksjonar që jan të lir si me Baltazar Benuin, (Demo Kristjan) Lak Vilën, (ballist) Av. Vasil Avrami, (ish ministër në kohën e Zogut urren Pushtetin) Anastas Shundin, (i dyshimët) Athanas Meksin, (i dyshimët) Xhemal Kusin, (ballist) Av. Kost Bidoshin, (zervist) (bashkpuntor në organizatën klandestine Sami Qeribashit me shok) Eqrem Hdan, (ballist) Niko Lerën, (zervist) Av. Ali Erebarën, (fashist'i orës për organizator mbledhjes klandestine, përmendet si i tillë në proçes që jan mbajt pran këtij Seksjoni)

LLAMBI LLAMBIRI, element me tendenca filo greke (zervist) për këtë punë aji ka qen burgosur dhe prej italjanve. Ka lidhje me elementa të Misjonit Anglo-Amerikan, urren Pushtetin t'onë; Ka lidhje me shum elementa reaksjonar të dyshimët si me: Pilo Kasnecin, (element anti-parti) Vildon Bankën, (i ri ballist) Agim Çaçin), (i ri ballist) Ali Bakijun, (element kundër Pushtetit t'onë) Kland Borshin, (i ri ballist) Islam Petrelën, (i dyshimët) Selfo Bregu, (i ri ballist) Muhamet Prishtina, (i ri ballist) Fiqiri Hamzaran, (zervist) Siri Gabeci, (i dyshimët) Ismet Çanon, (i dyshimët) Niko Qendron, (zervist) Skënder Çilkën, (simpathizant i Demokracive Përendimore) Vasil Kaçi, (zervist) Fatosh Kokoshin, (ballist) Sokrat Papajin, (zervist) Besim Bogdanin, (ballist) Jani Dadon, (zervist) Koço Dilon, (zervist) Vasil Xhain, (zervist) Jani Abaxhoglun, (zervist) Sotir Çomon, (zervist).

Besim Bogdani. – Ka ndihmuar lëvizjen N.Çl. por me çlirimin e Shqipnis ai filloj të marë kontakte me elementa të dyshimtë dhe të mos e shohi me sy të mirë pushtetin t'onë. Besimi ka lidhje me Myzejen Veli Mullan (reaksionare), Llambi Llambirin (zervist), Sokrat Papan (zervist), Aqif Gabecin (ballist), Parid Deranin (i ri ballist) i burgosur dhe i dënuar për veprimtari anti-pushtet), Qazim Kikën (ballit), Niko Qendron (zervist), e Qazim Xhepën filo-gjerman.

Ollga Plumbi. – Elemente e dyshimtë: në bisedime tregohet e pa kënaqur, asht simpathizante e demokracive perëndimore, shoqrohet gjithnjë me elementa të klasës së naltë dhe që nuk e shohin me sy të mirë pushtetin t'onë si me: Odhise Paskalin, Elsa Gjikondin, Nazmi Qoftën, Razije Kallullin, Jolldëz Stafën, Bediha Këlliçin, Ollga Nikollën, Mila Vangjelin, Mediha Frashërin, Fatbardha Gegën e Andromali Adamin që të gjithë elementa të dyshimtë.

Llazar Treska. – Ish kryetar' i Komitetit Ekzekutiv Prefekturës Tiranë dhe i hequr prej andej për shkak të qëndrimit kundërshtar që ka mbajtur kundër pushtetit t'onë tue marë pjesë në organizata klandestine (në atë të Sami Qeribashit me shokë), tue mos zbatue reformat e pushtetit. Ka lidhje me elementa qi nuk e shohin me sy të mir pushtetin t'onë, si me: Irfan Majunin (Depotet), Shefqet Bejën (ish Depotet), Dr. Isuf Dashin e Skënder Çilkën (simpathizant i demokracive perëndimore).

Visarjon Xhuvani. – Element i dyshimt me tendenca anti-popullore, simpatizant i demokracive perëndimore, ka lidhje me shumë elementa të tjerë si me: Zef Lashovën, Vasil Avramin, Dr. Kristo Kristidhin, Spiro Stringën, Jani Dadon, Tefik Delliallisin, (i burgosur kohë e fundit) Ali Erebarën, Av. Dhimitri Bogaçen, Av. Vasil Dilon.

Shtojmë se Visarioni ka pasur lidhje me elementa të misioneve të huaja anglo-amerikane si me: Smith Thoma Stefanin etjer.

Shefqet Beja. – Ish deputet, i burgosur dhe tani pse nuk paguente tatim fitimet dhe tani i liruar. Ai nuk e shikon me sy të mirë pushtetin t'onë dhe bile ai pat kundërshtue përsa i përket buxhedit financiar të shtetit, ai përhap parrulla kundër pushtetit dhe reformave të tijë.

Shoqërohet me elementa të shtresave të nalta tregtarësh dhe bejlerësh si me: Hamit Bega tregtar i tatuar dhe simpatizant i Ballit Kombëtar, Qamil Turkeshi zogist dhe tani i burgosur përse nuk paguen tatim fitimet, Murat Qosen ballist, Ibrahim Keçin i dyshimt, Guljelm Llukën tregtar i prekur nga reformat, Muharrem Qosen tregtar i prekur nga reformat, Ramazan Kullezi, Teodor Çokën, Riza Dardhën nga Berati, të tre tregtar të prekur nga reformat, urrejnë pushtetin t'onë kanë dalë tani kohët e fundit nga burgu pse nuk kishin pague tatim fitimet, Leonard Kraja reaksionar, Kel Koçobashin fashist i orës parë, Ali Veliun i dyshimt, Ramazan Jella feodal i prekur nga reforma, Hysen Shehu i dyshimt i prekur nga reformat e pushtetit t'onë, Muharrem Vllamasi fashist i orës parë, Sheh Karbunara i dyshimt, Kol ___ali i dyshimt, Dr. Sazani i dyshimt, Shefki Kondi, Ymer Keçi, Mazar Dervishin, (ballist) Eqrem Bej Vlorën, (ballist).

ABULLAH SHERI, element reaksjonar, gjat okupacjonit ka qen antar i organizatës trathtare të Ballit Komtar, dhe bile nji element aktiv i ksaj organizate, sot urren

pushtetin t'onë, dhe ka lidhje me elementa të tjer të dyshimët, si me Nexhmedin Shehin, (i dyshimët) Mustafa Menikun, (ballist) Sinan Petrelën, (zogist) Hysen Zalen, Nexhat Kënaton, (ballist) Vehip Petrelën, (i dyshimët) Ilami Rusin, (i dyshimët) e Arqile Llambiri, (zervist).

XHELAL MENIKU, Element reaksjonar, (feudal) i dyshimët, i prekur nga Reformat, ka qen pjestar aktiv i organizatës s'Ballit Komtar, dhe sot mban lidhje me elementa reaksjonar, si me Qazim Xhepën, (inxhinjer fillo gjerman në kulm) Abdullah Sherin, (ballist) Reshat Asllanin, (reaksjonar, simpathizant i Demokracis Perëndimore) Fatos Kokoshi, (ballist i burgosur dhe i dënuar për veprimtari anti-pushtetë).

ISLAM KOÇI, ka qen polic në kohën e Zogut, i lidhur ngusht me Abaz Kupin, po këtë gjë e ka vazhduar dhe gjat okupacjonit si spiun i Hysni Demës, aji ka mar pjes në luftime kundër partizanve në Tujan si mercjonar i Legalitetit, përhap parulla kundër Pushtetit t'onë dhe për këthimin këtu në Shqipri të Zogut, Abaz Kupit, e Mehdi Frashërit, që jan (si mbas parullave të tijë) nacjonalista të kullut, ka lidhje me elementa të tjer reaksjonar, si me: Myslym Pëllumbin, (zogist) Kadri Lugën, (zogist) Reshat Petrelën, (zogist) e Fadil Spahiju, (zogist).

KADRI LUGA, element reaksjonar urren Pushtetin t'onë merr pjes në mëledhje klandestine si p.sh. në mëledhjen e bër në kafen Fadil Sopotit, e cila krysohesh nga Gjergj Kokoshi, Kadriju gjat okupacjonit ka qen antar aktiv i çetave mercenare të Legalitetit, dhe ka mar pjes në luftime kundër partizanve. Sot ka lidhje me: Islam Koçin, (zogist) Reshat Petrelën, (zogist) Medi Shehun, (shofer në Misjonin e U.N.R.R.A.-së, dhe dyshohet të jet spiun) Myslym Pllumbin, (zogist) Fadil Sopotin, (zogist).

RESHAT PETRELA, ka qen antar aktiv i organizatës trathtare të Legalitetit, ka luftuar në ç'do mënyr lëvizjen t'onë Nac.Çli. edhe sot po atë qëndrim mban, merr pjes në mëledhje klandestine (si në kafen e Fadil Sopotit që krysohej prej Gjergj Kokoshit) përhap parulla kundër Pushtetit t'onë dhe reformave të tijë. Aji ka lidhje me elementa të tjerë reaksjonar si me Dr. Kapiten Fehta Bekteshin, (i dyshimët) Shaban Urën, (ballist) Flora Noçkën, (e dyshimët e lidhur ngusht me fashistat) Qazim Asllanin, (i dyshimët) Islam Koçin, (zogist) Mehdi Sheun, (shofer në Misjonin e U.N.R.R.A.së, dyshohet të jet spiun i tyre) Myslym Pllumbin, (zogist) Fadil Sopotin, (zogist) Man Toptanin, (ballist ish oficer i vjetër) Taip Pezën, (ballist i burgosur dhe i dënuar për veprimtarin e tij anti-pushtet) Rexhep Zenelajin, (zogist) e Stefan Miçen, (kafexhi i dyshimët).

MIRASH IVANAJI, intelektual, i cili nuk shef me sy të mir Pushtetin t'onë, del në proçesin e Shaban Ballës (i ekzekutuar) i cili thot tekstualisht për të kështu: Gjergj Kokoshin ma kishin prezantuar Englezët si njerijun e tyre ata (Englezët) më kishin kallzue se kishin dhe shum të tjer elementa të tyne si p.sh. Suas Asllanin, Vasil Avramin, Mirash Ivanan. Gjat regjimit të Zogut ka qen Ministri i Arsimit mandej u arratis bashkë me të dhe më 1945, u riatdhesue. Aji shifet të ket takime me elementa reaksjonar si me: Sali Taganin, (ballist) Prof. Muza Dizdari, (i burgosur për veprimtari anti-pushtetë) Gjergj Kokoshi, (i burgosur për veprimtari anti-pushtetë) Ali Kacelin, (ballist) Ram Kacelin, (i burgosur tashti në fund) Llazar Treskën, Maliq Qosen, (ballist)

Muhamet Hoxhën, (ish drejtor i Shkollës Teknike zogist i flakët) Mustafa Demnerin, (ballist) Jonuz Tafajin, (ballist).

Në orën 9.30 të datës 3/XI/45 në dyqanin e DANE ZDRAVËS ishte duke ndejtur Prof. GJERGJ KOKOSHI, MYFTAR BEJ VRIONASI, SYBI BEJ VRIONASI, SHAHIN BEJ VRIONASI të cilët po bisedonin kokë më kokë, fjalën e mbante gjithëmonë Prof. KOKOSHI. Daneja në kohën e okupasjonit fashist ka pas bërë pjesë në Partin Fashiste Shqiptare. Me formimin e organizatës së Ballit Kombëtar, ky ishte elementi më aktiv që propagandoi kodra L.N.Çl. Ka pasur lidhje me elementet e Ballit Kombëtar si BIÇAKÇIUN, i cili shkonte shpesh herë në dyqanin e tija. – Ky kishte mbajtur konferenca në mbledhjet e Ballit Kombëtar. – Dyqani i tij kishte qenë gjatë okupasjonit çerdhja e elementëve reaksjonar, këtu ishte parë të shkonte edhe krimineli ARIF PEZA (tash i aratisur politik). – Daneja ka një të vëllan e tij t'aratisur, që ka qenë eksponent i Ballit Kombëtar.

Qysh prej Çlirimit të Tiranës e deri më sot shihen të vijnë në dyqanin e tij çdo llojë reaksjonarësh dhe sidomos ata të grupit të RIAZI BEJ VLORËS. – Gjithashtu ky takohet me të gjithë reaksjonarët që klanë relacjone me Anglo-Amerikanët.

Në orën 11.10 po të kësaj date në Bar-Sahati GJERGJ KOKOSHI po bisedonte me Dr. TRESKËN. – Dr. Treska gjatë okupasjonit nuk ka pas një qëndrim të mirë dhe sidomos në kohën e gjermanve hapte parulla disfatiste në dëm të luftës t'onë. – Ishte simpatizues i gjermanve dhe i lëvdonte trimërit e tyre. E shoqja e tij ësht gjermane dhe shoqërohet shumë me të shoqen e ADEM BALLÇIT.

Inform. të dt. 3/XI/945 nga Sek. V-të

AIDSSH, N= 1081-A. VITI 1961, D. 3.

REPUBLIKA POPULLORE E SHQIPRIS
KOLEGJI USHTARAK I GJYJATËS LARTË
Nr. 187 Vendimit Tiranë me _____ 1955.

V Ë R T E T I M:

Vërtetohet se i qujturi Qemal Hasan Biçaku, i dat lindjes 1920, lindur në Elbasan e banues në Tiranë, me profesjon të lirë, me rigjin dhe gjendje shoqrore pronar i madh (çifligar) i martuar me fëmij, i pa dënuar ndonji herë, arrestuar me 26.I.1946, me vendimin e formës së prerë Nr. 5 datë 2.7.1946 të ish Gjykatës së Lartë Ushtarake është dënuar në 30 vjet burgim për krimin e pjesmarrjes në nji organizatë anti pushtet që drejtohej nga Sami Çeribashi dhe që kish për qëllim grumbullimin e elementit reaksjonar dhe rrëzimin me dhunë të Pushtetit tonë Popullor.

Vërtetohet njisija me dispozitivin origjinal të vendimit.

Toger Murat Qazimi

V.O. me dekretin Nr. 1963 datë 23-XI-1954 dënimi ju këthye në 15 vjet burgim.

Gjykatës Nalt Ushtarake
Tiranë

Vendimi datë 2-VII-946 i gjykatës s'Uej përmban dënimin e të nënshkruemit Qemal Hasan Biçoku i dat-lindjes 1920 nga Elbasani, banues në Tiranë, i martuem, me fëmijë.

Ju drejtohem me këtë lutje për lirim kondicionel tue parashtrue sa vijon:

Jam arrestue me datë 20-I-46 si pjesmarrës në organizatën e Sami Qeribashit dhe dënue me 20 vjet burgim. Më datë 26-XI-54 dënimi m'u zbrit në 15 vjet burgim, për konseguencë kam plotsue afro 2/3 e dënimit tim, konditë këjo e lypun prej ligjës për kërkesën time.

Koha e dënimit të vuejtun prej 9 vjet burg, me sjelljet e qëndrimin tim të mirë, m'ep shpresë se në mue ekzistojnë konditat e duhuna.

Konditat fizike të trupit tim s'janë të mira. Kam qenë ndër kampe pune për 5 vjet rrjesht dhe përfundimisht nga Komisioni mjeksuer i M.P. Mbrend. jamë përjashtue nga puna si krejt i pa aftë pse vuej nga sëmundjet: Calcule rénale, Tachycardie e cholecistite forme urticaire; sëmundje të cilat më kan mposhtun shumë fizikisht.

Edhe gjendja e familjes time asht e vajtueshme. Guerja e sëmuetë T.B.C. si dhe dy fëmij të mitun nën 10 vjeç, pa asnji ndihmë, presin nga unë mjetin me përballue nevojat elementare të jetesës.

Në dritën e fakteve të thanuna ma sipër më lind e drejta me shpresue se ekzitojnë në mue konditat e duhuna në vështrim të K.P.P. dhe K.P. e me kërkue nga Ju shpalljen e vendimit për lirimin tim kondicionel.

I burgosuni (Qemal H. Biçaku)
Tiranë 20/II/55

AIDSSH, N= 1081-A. VITI 1961, D. 3.

Gjykatës së Naltë Ushtarake
Tiranë

I nënshkruari Qemal Hasan Biçaku, nga Elbasani, efektiv i burgut Nr. 5 Tiranë, parashtroj kërkesën që vijon:

Më datë 25 shkurt i kam paraqitur asaj gjykate një lutje për lirimin t'im nga burgu me kusht. N'atë lutje janë parashtruar të gjitha arsyet që lyp rasti.

Me qënë se kanë kaluar 4 muaj pa marrë asnjë njoftim rreth fatit të lutjes s'ime, lutem të më njoftohet nëse këtë lutje e keni parasysh apo mos është rasti që unë t'i drejtohem ndonjë gjykate tjetër.

Nuk dyshoj që ju të më orientoni përkatësisht.

Tiranë, 17/V/55

Me nderime i burgosuri
(Qemal H. Biçaku)

AIDSSH, N= 1081-A. VITI 1961, D. 3.

REPUBLIKA POPULLORE E SHQIPËRISË
KOLEGJI USHTARAK I GJYKATËS LARTË
Nr. 12 Rregj. Them.

Nr. 12 i Vendimit
Datë 9 Nëndor 955

V E N D I M
N'EMËR TË POPULLIT

Këshilli Gjyqësor i Kolegjit Ushtarak të Gjykatës Lartë i formuarë nën kryesinë e:

Aranit Çelës	Kryetar i Gjykatës Lartë me anëtarë:
N/Kolonel Sotir Spiron	Antar " "
M a j o r Hilmi Telegrafin	" " "

me asistimin e sekretarit Aspirant Emin Hoxha dhe pjesëmarrjen e Prokurorit N/Kolonel Faik Minarolli, në seancën gjyqësore me dyer të hapura, sot më datën 9/XI/1955 shqyrtoj lutjen që i përket Qemal Biçakut, i biri i Hasanit, i datë lindjes 1920, lindur në Elbasan, banues në Tiranë, origjinë dhe gjendje shoqërore pronar i math (çifligar), me profesion të lirë, i martuarë me fëmijë, i dënuarë me 20 vjet burgim (me dekretin Nr. 1963 datë 23/XI/1954 të Presidiumit Kuvendit Populllor zbritur në 15 vjet burgim) për krimin e pjesëmarrjes në një organizatë kundër pushtetit populllor, i arrestuarë më datën 26/I/1946.

I dënuari kërkon lirim para kohe me kusht për arësye: Në burg ka mbajtur qëndrim të mirë, ka plotësuarë gjysmën e dënimit dhe vuan nga sëmundje si "Calcule renale" etj.

Këshilli Gjyqësor mbasi dëgjoj mejtimin e Prokurorit N/Kolonel Faik Minarollit, i cili kërkoj t'i refuzohet kërkesa e të dënuarit Qemal Biçakut për lirimin e tij para kohe me kusht, dhe mbasi shqyrtoj materialin e çështjes;

V Ë R E N

I dënuari Qemal Biçaku nuk mund të lirohet para kohe me kusht. Gjat vuajtjes së dënimit me burgim të dhënë kundra tij nga ish Gjykata e Lartë Ushtarake, nuk ka treguar me sjelljet e tija se është përmirësuar. Ai në burg nuk ka mbajtur qëndrim të mirë, kështu ky i dënuarë nuk është penduarë për veprën kriminale që ka kryerë në dëm t'interesave të pushtetit populllor. Pëveç sa sipër i dënuari Qemal Biçaku ka bërë pjesë në një organizatë kundër pushtetit populllor që udhëhiqej nga tradhëtari Sami

Qeribashi. Këto të dhëna të lidhura ssë bashku tregojnë rrezikshmëri shoqërore që paraqet ky i dënuarë, dhe si pasojë në favor të tija nuk ka vend të zbatohet neni 57 i K.P.

Për këto arësye:
Këshilli Gjyqësor i Kolegjit Ushtarak të Gjykatës Lartë në mbështetje të Nenit 354 të K.P.P.

V E N D O S I
Rrefuzimin e kërkesës së të dënuarit Qemal Biçaku për lirim para kohe me kusht.

Tiranë më 9/XI/1955

A N T A R A N T A R KRYESONJËS KËSHILLIT GJYQËSOR

AIDSSH, N= 1081-A. VITI 1961, D. 3.

REPUBLIKA POPULLORE E SHQIPËRISË
PROKURORIJA E GJYKATËS USHTARAKE
TË NALTË

VDEKJE FASHIZMIT
LIRI POPULLIT

Nr. 5 Regj. Them.

A K T - A K U Z Ë

(KOMUNIKATË)
GJYKATËS USHTARAKE

K Ë T U

Sikurse do të konstatohet dhe nga proces-verbalet e mbajtura prej Seksionit të M.P. të Tiranës, që bashkangjitur paraqiten, i pandehuri LLAZAR PAPAPOSTOLI, i biri i DHIMITRIT dhe i FOTINIS, vjeç 31 nga ZIÇISHTI I BILISHTIT, me profesion ose efektiv nëpunës, i rreshtuar më datën 23 Janar 1946, akuzohet se Ka marë pjesë në organizatën teroriste Fashiste të Grupit Monarkist, i cili kërkonte për të rëzuar Qeverinë me forcë dhe ndërhyrjen e reaksionit si dhe të binte në fuqi Qeverinë e Zogut.

2) Ka qenë ndërlidhës i reaksionit të jashtëm në dëm të interesave të larta t'Atdheut.

3) Ka marë pjesë në të gjitha mbledhjet dhe vendimet e sala nga kjo organizatë për atentate kundra udhëheqsave të pushtetit të popullit dhe sabotazhe në dëm të rindërtimit.

Mbasi faji tij parashikohet i ndëshkushëm prej Nenevet 1 të Ligjit Nr. 21, dhe prej 15. II; të Ligjit Nr. 41, dat 14 Janar 1945, është parë e nevojëshme që të gjykohet.

P r a n d a j :

Kërkoj gjykimin e tij nga ana e asaj Gjykate dhe mbasi t'i faktohet faji që akuzohet, në përfundim të vendoset ndëshkimi i tij në bazë të Nenit 18, të Ligjies Nr. 41, dat 14.I.945, mbi organizimin e funksionimin e Gjyka.Ushta.

Tiranë, më 10.VI.1946. P R O K U R O R I:
(Kapiten i I-rë Nevzat Haznedari)

AIDSSH, N= 1081-A. VITI 1961, D. 3.

REPUBLIKA POPULLORE E SHQIPËRISË Vdekje Fashizmit – Liri Popullit
P R O K U R O R I J A E
GJYKATËS USHTARAKE E NALTË
Nr. 33 i R. P.

L e t ë r - r r e s h t i m
K o n d r a :

Llazar Papapostoli bir'i Dhimitrit dhe i Fotini, vjeç 31 nga Ziçishti / Bilisht, me profesion nënpunës

A k u z o h e t

Si Sabotator i Pushtetit dhe armik i Popullit.

Me qenë se faji i tij parashikohet prej Nenevet I të ligjës Nr. 41 datë 15.XII.1944 dhe 15 Parag.II të Ligjës Nr. 41 datë 14.1.1943

Ne Prokuror' i Gjykatës Ushtarake në bazë të Nenit 20 Parag. III të Ligjës nr. 41.

U r d h ë r o j m ë :

Rreshtimin e tij për një kohë të pa caktuar në burgun e Tiranës.

Organet e M.P. Policis dhe çdo fuqi e armatosur ngarkohet me zbatimin e këtij letër –rreshtimi.

P R O K U R O R I
Kap. I-rë (Nevzat Haznedari)

KRYETARI
OSE ANTARI
Major (Frederik Nosi)

Tiranë më 10.V.1946

AIDSSH, N= 1081-A. VITI 1961, D. 3.

REPUBLIKA POPULLORE E SHQIPËRISË
GJYKATA USHTARAKE E NALTË
Nr. 5 Regj. Them.

VDEKJE FASHIZMIT
LIRI POPULLIT
Tiranë, më 8/VII/1946

Drejtoris së Burgut të Ri

T I R A N Ë

Ju njoftojmë se kjo Gjykatë me vendimin e saj Nr. 5 Regj. Dat 2/VII/1946 ka vendosun ndëshkimin e LLAZAR DHIMITRI PAPAPOSTOLI nga Ziçisht, Bilisht, me 10 VJET BURGIM, humbjen e të drejtave qytetare e politike, si dhe konfiskimin e pasuris.

Ky vendim ka marë formën e preme.
Ndëshkimi i fillon më datën 23/I/1946 dhe i mbaron më dat 23/I/1956.

Për KRYETAR' I GJYKATËS USHTARAKE
(Major Frederik Nosi)

P R O Ç E S - V E R B A L

Sot me dt.18/9/1946 (tetëmbëdhjetë i nëndëti njëmij e nandëqind e dyzet e gjashtë), në zyrën e Drejtoris së Burgut Ushtarak Tiranë, merret në pyetje, i burgosuri Lazar Papapostoli, me pseudonimin Lary Post, vjeç 31, i biri i Dhimitrit dhe i Fotinës, lindur në Ziçisht të Bilishtit, i martuar dhe pa fëmij, me arsim të lartë dhe me nënështetësi Shqiptare, i cili deklaron:

Kam mbaruar shkollën fillore me tre klasë, në katundin t'im Ziçisht. Nga viti 1927-1930, kam punuar në shtypshkronjën e Çekrezit, Tiranë. Më 1930 fitova bursin e Kryqit të Kuq Amerikan (atëhere quhej bursi i shkollës) mbasi kalova nëpër nji provim. Këtu mora degën e inxhinjeris. Në teknikë njifesha mirë me Fultzin, mbasi dinja mirë Anglishten, ky më mbante në zyrë, në muajt e vakancave dhe e ndihmonja për plotsimin e diftesave dhe në vjeshtë për regjistrimin e studentave.

Me 1937, me ndërmjetësin e xhaxhait t'im, Mina Papas, q'ishte n'Amerikë, shkova atje për të studjuar më lart. Si vajta n'Amerikë, u regjistrova n'universitetin shtetnor t'Illinois, në Urbana-Champaign. Këtu bëra katër vjet në degën e Historis Politike t'Europës, Sociologji dhe Shkenca Politike (Arte Liberale).

Universitetin e mbarova në Qershorin e 1941-së. Prej kësaj date e gjer në fillim të janarit 1942 kam qindruar n'Arho-Illinois.

Kur kam arrijtur n'Amerikë kam takuar Fultzin, i cili më këshillonj që të shkonja n'Universitetin Shtetnor t'Illinoizit. Në këtë kohë Fultzi ka qenë Drejtor-i Edukatës së të rriturve (të emigrantave t'ardhur nga shtetet e huaja, që nuk dinin gjuhën Anglishte). Kjo gjë bëhej vetëm e vetëm për t'Amerikanizuar të huajt e ardhur

këtu, duke u mësuar gjuhën Anglisht dhe duke ngjallur tek këta simpathin për Demokracin Amerikane.

Në 7 Prillin e 1939-ës, kam qenë n'Universitet, për këtë Shqiptarët e Amerikës, në përgjithësi, u piklluan, me përjashtim të nji pjese të vogël dhe Faik Konitzës, i cili me gjithë që në fillim foli kundra invazionit fashist në Shqipni, më vonë, më 28 Nandorin e 1939-ës, foli në favor të këtij invazioni, duke cituar këto fjalë: "Sot flamuri Shqiptar po valon me krenari krah për krah me flamurin e Perandoris Italiane dhe Shqiptarët e festojnë këtë ditë me një madhështi që s'ësht parë kurrë". Ky u dorzoj italianve Legatën Shqiptare me gjithë dosjet dhe shkresorinat e saja. Edhe Hito Sadiku ka bërë nji broshurë në gjuhën Inglisht, me titullin: "An Albanian Letter", në favor t'invazionit fashist në Shqipni. Parathënjen e kësaj broshure ja ka bërë Faik Konitza. Në këtë kohë Hito Sadiku, ka qenë sekretar'i Legatës dhe vazhdoj t'ishte edhe kur u muarr në dorzim nga Italianët. Në kohën kur Italija hyri në luftë me Anglo-Amerikanët, Hito Sadiku, bashkë me italianët, shkoj n'Itali. Këtu fliste në radio Roma çdo të mërkurë, duke u bërë thirrje Shqiptarve t'Amerikës në favor të fashizmit që sundonte në Shqipni.

Shtypi amerikan shkoj shum pak për invazionin e Shqipnis nga ana e fashizmit Italian; përmendi vetëm qëndresën e Shqiptarve me armë në breg-detin Adriatik kundra Italianvet.

Në fillim të vjetit 1942 më lajmëroj Çekrezi nga Bostoni, se isha zgjedhur, nga Kongresi Pan-Shqiptarë, q'u mbajt me 25 Dhjetor 1941, si drejtor'i gazetës së Shoqërisë "Shqipërija e Lirë" – "Lirija". Me 5 Janar 1942 fillova nga puna dhe vazhdova gjer në Qershorin e 1943-së. Gjatë kësaj kohe isha njikohësisht dhe sekretar'i shoqërisë "Shqipërija e Lirë", si kryetar'i shoqërisë ka qenë Çekrezi. Ndërmjet Shoqërisë "Shqipërija e Lirë" dhe "Vatrës" bëhej nji luftë e ashpër, arsyeja e së cilës ishte vetëm kush të merrte kryesin nga Shqiptarët.

Fan Noli përkrahte formimin e nji qeverije n'emigracion, duke patur për mbret Zogun, ndërsa Çekrezi kundërshtonte vetëm pse donte të kryesonte ky vetë.

Po në këtë kohë bisedohej, ndërmjet Shqiptarve, për formimin e "Frontit Shenjtë". Ky sygjerim bëhej nga Fan Noli, mbasi hyri në lidhje me Zogun dhe me miqt e këtij të fundit, Englezë: Lord Cecil, Eduard Boyle, Hoxhson, ish ministër englez në Tiranë dhe Miss Durham. Po të këtij mendimi kan qenë edhe Shqiptarët e Londrës: Dervish Duma, Logoreci, Zavalani dhe Perlat Bogdo, tash oficer n'ushtrin Engleze (këta tre të fundit nuk e pranonin Zogun si mbret, por vetëm si shqiptar të thjshtë).

Shqiptarët e Kairos me Abdyl Sulën, ishin të nji mendimi me Zogun e Fan Nolin, po ashtu dhe shqiptarët e Stambollit. Edhe Amerikanët u përpoqën për formimin e "Frontit Shenjtë", por pa frut se grindjet nuk mund të ndërpriteshin ndërmjet shqiptarvet.

Kont Von Redlich, i cili ka qenë konsull nderi i Zogut në Kanada, erdhi n'Amerikë nga Korriku i 1943-së dhee propagandonte në favor të Zogut në shqiptarët e atjeshëm.

Charles Hart, ka qenë Ministri i Amerikës në Tiranë dhe kryetar'i Organizatës "Miqtë Amerikanë të Shqipërisë", në Ëashington, ka folur mjaft për bashkimin e shqiptarve n'Amerikë dhe luftonte mjaft kërkesat greke. Ky nuk përmendëte asgjë për Zogun.

Personalitete të larta amerikane interesoheshin mjaftë që Shqipërija të përfaqsohej në botën e jashtme nga nji Qeveri n'emigracion e përbërë me elementa pro-Amerikanë.

Kur kam qenë në Bari në 12 gushtin e 1944-rës, më ka njoftuar, Fultzi se n'Amerikë ishte krijuar nji Komiteti Shqiptaro-Amerikan i cili do të punonte në marëdhënje harmonioze me Departamentin e Shtetit dhe degë të tjera të Qeverisë (Amerikane). Këtë ja lajmëronte Fultzit, me anën e nji letrës, Zoti Adams i cili i thoshte: "Konventet e Shqipërisë së Lirë dhe Vatras vendosën të formojnë nji Komitet të tillë me 22 Korrik 1944, me Qerim Pabaritin që përfaqsonte Vatrën dhe Çekrezin që përfaqsonte Shqipërin e Lirë, u thirrën në Departamentin e Shtetit dhe paraqitën aty nji marëveshje të nën-shkruar". Ky lajm u hap me anën e radios.

Nga shqiptarët që punonin simbas direktivave të Qeverisë Amerikane kan qenë: Çekrezi, Dr. Rifat Tirana, i cili më vonë hyri antar'i Kshillit Kontrollues Aleat të Mesdheut, Petraq Kolonja, i cili përfaqsonte Zogun n'Amerikë, Avokat Koteli, Arthur Tashko, Nelo Drizari dhe Petraq Tiko. Këta dy të fundit punonin në zyrën e propagandës Amerikane dhe flisnin në radion Amerikane "Zëri i Amerikës". Kontakte të dendura ka patur dhe Fan Noli me personalitete të ndryshëm të Qeverisë Amerikane.

Në këtë kohë, n'Amerikë, bëhej nji propagandë në stil të gjerë nga grekërit, përsa u përket rivendikimeve mbi Shqipërinë. Elementat që drejtonin këtë propagandë kan qenë: Mihallopullos, ministër i propagandës në qeverin greke në mërgim, Diamantopullos, ambasador grek në Ëashington, Cideros, kryeministër i qeverisë në mërgim dhe të tjerë.

Mjaft gazeta të shtypit amerikan, kan përkrahur rivendikimet greke, p.sh. gazetat e Hurstit.

Me grekërit bashkëpunonte ngushtë organizataa e Vorio-Epirotve, ndër këta dalloheshin: Mullas, Demas dhe Bafkas, që të tre nga Gjirokastra, të cilët drejtojnë degët e organizatës Vorio-Epirote. Edhe kryepeshkopi i Kishës Greke n'Amerikën e Jugut dhe të Veriut, Athinagoras, shqiptar nga Delvina punonte mjaftë duke propaganduar për rivendikimet greke në Shqipëri.

Shtypi amerikan për Lëvizjen e Popullit Shqiptar shkruante fare pak, me gjithë që informohej me anën e Englezve mbi realitetin e këtushëm, për këtë arsye shqiptarët e atjeshëm ishin të errët mbi gjendjen në Shqipëri dhe kjo shkaktonte që këta të mos ishin në gjendje të caktonin rrugën që duhet të ndiqnin.

Edhe për lëvizjen e popullit jugosllav nuk shkruhej shumë nga shtypi amerikan, nji propagandë e fortë zhvillohej n'Amerikë në favor të Mihailoviçit, bile nxuarrën dhe nji film me titullin "Drazha Mihailoviçi".

Në Qershorin e 1943-së më ftoj Francis Kallney, i cili bënte pjesë n'organizatën O.S.S. (Zyra e Shërbimeve Strategjike) e cila mvarej nga komanda e lartë ushtarake Amerikane, që të takohesha me të. U takova me këtë dhe mbas disa bisedimesh të rëndomta më propozoj: "A pranon të shkosh e të luftosh në Shqipëri së bashku me shqiptarë të tjerë, mënyrën e ikjes do t'a marrish vesht më vonë". Unë pranova

propozimin e tij me gjithë qejf dhe simbas kërkesës tij i prezantova dy shqiptarë të tjerë: Spiro Thanasin dhe Dhimitër Trebickën, që të dy nga Korça.

Kallney m'u paraqit si nji i dërguar i Qeverisë Amerikane, i cili donte të pregatiste disa shqiptarë për t'i dërguar në Shqipëri që të organizonin rezistencën kundra okupatorit. E pyeta se për ç'qëllim e bënte këtë gjë Amerika dhe ay m'u përgjegj: Se, ne, ashtu si për gjithë shtetet e tjera edhe për Shqipërinë interesohemi që t'a ndihmojnë të ngrihet në luftë dhe të fitoj Indipendencën e saja. Më tha, do t'u stërvitim juve në kurse të veçanta, për ttë mësuar mënyrën e sabotimit e pastaj do t'u çojmë në Shqipëri. Me anën t'uaj do të furnizojmë grupe të rezistencës me materjal luftarak.

Mbasi kaluan dy-tre ditë, Kallney, na dërgoj disa aplikata për t'i mbush. Këto përmbanin: Emërin, mbiemrin, mëmësija, atësija, dt.lindja, vend-lindja, vend-banimi, kombësija, profesioni, gjendja familjare, gjendja politike, dipendentët e familjes dhe gjendja ekonomike. Nga ana tjetër na kërkuan edhe nga pes emëra të personave që na njifnin neve të treve.

Amerikanët kishin si objektiv luftën kundra fashizmit dhe e dyta të ngjallnin kudo influencën për Amerikën dhe të bënin që mbas luftës në ç'do shtet të ngriheshin qeveri demokratike të tipit amerikan. E për t'arrijtur objektivin e dytë që thash, Amerikanët kishin ngritur organet e tyre:

1) O.S.S. (Zyra e Shërbimeve Strategjike), e cila kish dy seksjone: a) Seksjoni Informativ dhe b) Seksjoni Operacioneve.

2) O.Ë.I. (Zyra e informata të Luftës).

Në mbarim të Qershorit 1943, më lajmëroj në telefon, Francis Kallney, nga Washingtoni, që të nisesha me urgjencë, duke më thënë të prezantohesha tek Dr. Coon. Arrita në Ëashington dhe u takova me Dr. Coon-in. Ky më pyeti se, a do të luftosh për kauzën e përbashkët dhe energjija tënda t'i derdhet drejtë për drejtë Shqipërisë. Ne jemi nji grup, tha Coon-i, që do të shkojmë për në Shqipëri ku t'organizojmë Rezistencën dhe të sabotojmë armikun e përbashkët. Coon-i e njifte pak Shqipërinë e Veriut, pse më 1933 kishte ardhur për të bërë studime antropologjike. Ishte profesor n'Universitetin e Harvard-it. Para se të niseshim për në Shqipëri duhej të bënim disa pregatitje ushtarake dhe të forcoheshim fizikisht, këto do t'i bënim në disa kampe jasht Ëashingtonit. Por në të vërtetë qëllimi kryesor nuk ishte ky, këta donin të na pregatitnin, në mënyrë që të mësonim se si të mblidhnim informata rreth gjendjes të vendit ku do të shonim.

Dr. Coon-i më shpuri në kampin A., jasht Washingtonit, ku ishte nji vilë me të gjitha komoditetet. Këtu kishte italianë, grekër, jugosllavë dhe nga ç'do kombësi tjetër. Ndaloheshim të tregonim kombësin dhe emërin e plotë, për këtë arsye unë kisha vënë emërin Lary. Hyrja në kamp ishte njikohësisht dhe hyrja në O.S.S. Gjatë dy javëve që qëndruam këtu, personat që drejtonin kursin përpiqeshin të mblidhnin informata të sakta për secilin nga ne që bënte pjesë atje. Në këtë kamp ishin më tepër se 100 veta që merrnin pjesë në kurs. Mbasi kaloj nji javë erdhi në Dr. Coon-i bashkë me nji kapiten të cilin ma prezantoj me emërin Hans Taft, danez, duke më thënë se dhe ky do të vinte me neve në Shqipëri.

Si mbarova dy javë në kampin A., më dërguan në kampin B., ku ishin, po-thuaj, 40 veta, nga kombësi të ndryshme. Në kampin B., që ishte afër Washingtonit, erdhi dhe Francis Kallney. Urdhërat për të mbajtur të fshehtë emrat e vërtetë t'onët, kombësit, edukatën, profesjonin ishin shumë më të rrepta në këtë kamp. Rezervimin midis njëri tjetrit ishte më i madh dhe i detyrueshëm. Edhe këtu na u rekomandua që të zgjidhnim nji emër tjetër, unë vazhdova të mbanja përsëri emërin Lary. Komandanti i kapit ishte kapiteni Allen. Këtu qëndrova dy javë, kishim nga 12 orë mësime në ditë, të cilat ishin:

1) Propagandë, me togerin Ezra Shine, me origjinë polake, i rritur dhe i edukuar n'Angli, dhe ardhur n'Amerikë.

2) Shifër, me togerin Ezra Shine dhe me nji spanjoll, që s'ja mbaj mend emërin.

3) Topografi, me profesorin Forest, emrin e parë nuk ja mbaj mend.

4) Qitje me armë, mbrojtje me thika dhe kapje trup për trup me profesor major Fairban, englez; ky kishte qenë në policin engleze në Changai, në zonën Internacionale.

5) Eksplozivë, me profesorin kapiten Allen.

6) Shtypshkronjë, me nji person që s'më kujtohet emëri.

7) Kodin Mors, me nji person që s'ja mbaj mend emërin.

8) Dallimi i aeroplanave, për këtë nuk kishim profesor, por në sallën e bukës kishin varur aeroplanë të ndryshëm, nga të gjith tipat e shteteve, bombardierë, trasportues, ndjekës dhe të tjerë. Mbaj mend se kish aeroplanë të tipit italian, gjerman, japonez, francez, amerikan, englez, rus dhe të tjerë.

Mbasi mbaruam kursin shkuan në Ëashington, ku unë ndejta vetëm pesë ditë, pse më dërguan në nji fermë jasht qytetit, që të mos vinja në kontakt me njeri, për arsye se dyshonin që mos dekonspironja punën që bëhej mbrenda në kurs. Në këtë fermë qëndrova gati dy javë deri sa u bënë pregatitjet për t'u nisur. Edhe këtu mbanim të mësheftë ç'do gjë. Mësuam se si të hartonim trakte, të njifnim gradat dhe uniformat e ushtrive botnore. Përsa kohë ndejtëm në fermë, shkonja dendur në Ëashington dhe takohesha me Dr. Coon-in dhe Hans Taft, të cilët më shpjegonin herë pas here kjartë qëllimet e ndërmarrjes t'onë. Këta më kishin shpjeguar se, ne do të ndaheshim në grup të vegjël dhe do të hidheshim në Shqipëri. Në kurset që bëmë ne, u pregatitmë për në rrjetin e spiunazhit dhe kondra spiunazhit në favor t'Amerikës. Më vonë e kuptuam mirë se ne po bëheshim vegla të verbëra t'interesave t'imperjalizmit amerikan, me punën që po kryenim. Neve, si elementa të rrjetit të spiunazhit dhe kunra-spiunazhit, na ishin ngarkuar këto detyra: Kur t'arrijmë në Shqipëri do të binim në kontakt me elementa të ndryshëm, që t'organizonim rezistencën dhe ajo më kryesorja ishte të ngrinim rrjetin e spiunazhit me elementa të përshtaatshëm. Me punën t'onë dhe t'elementave që do të gjenim këtu në Shqipëri do të mblidhnim informata rreth forcavet t'okupatorit, gjithashtu dhe rreth forcave të Rezistencës, mbi atitudën politike të tyre, qëndrimin dhe të tjera informata politike.

Dr. Coon-i, në këtë kohë, duke biseduar m'ka folur edhe për organizimin e O.S.S.,

i cili më ka thënë se mbrenda kësaj ka dy degë:

1) S.I. (Sppecial Inteligence)
2) S.O. (Special Operation)

E para merrej me mbledhjen e informatave në vende të ndryshme, ku ekziston O.S.S. dhe e dyta merret me operacionet që informohet nga e para.

Prej fermës na dërguan në nji kamp afër Baltimorës, këtu ndejtëm pesë ditë dhe pamë të gjitha armët bonore, tankse, topa etj. Gjithashtu mësuam dhe përdorimin e armëve moderne. Pastaj shkuam në Washington ku prisnim mbarimin e pasaportave dhe plotësimin e sendeve që do të merrnim me vehte. Në këtë kohë erdhën në Washington kapiteni Hans Staft, me të cilin isha prezantuar më parë, kapterri George, reshteri Joe dhe nji radio-telegrafist Angelo Mitro, me origjinë nga Treska e Korçës. Me këta do shkonim sëbashku për në Kairo. Pas dy ditësh më thirrën në qendër dhe pasi u prezantova te përgjegjsi na udhëzuan se do të niseshim për në Kairo. Më parë u nis Dr. Coon-i dhe kapiteni Taft, pastaj u nis Angelo Mitro dhe Joe me vaporr. Më vonë u nisa unë me aeroplanë, duke ndjekur rrugën drejt Washingtoni në Scotlandë dhe q'aty në Kairo, ku qëndrova tri javë në O.S.S. për zonat e Mezdheut, tek përgjegjsi për Shqipërinë. Në Kairo ishte qendra e O.S.S. për zonat e Mezdheut, duke patur për komandant Kolonel Tullman, me profesion avokati. Përgjegjës për Shqipërinë ishte Wells, me gradën toger, i biri Sumer Wells-it. Më vonë komanda e O.S.S., për Mezdheun, u transferua prej Kairos në Cazerta. Kur u nisëm prej Amerike sejcili prej nesh mori nji çantë, mbrenda në të cilat kishim nga dy rrevolverë, nji automatik, nji dylbi dhe nji radio-dhënëse e marrëse "W.T."

Në Kairo nuk takova as Dr. Coon-in as kapitenin Hans Taft, mbasi i pari kishte shkuar në Corsikë, ku merrte pjesë në sabotime dhe i dyti në Palestinë ku stërvitej në parashyt. Këtu u njofta me Majorin McAdoo, i cili ishte përgjegjsi i S.I. për Shqipërinë.

Në Kairo desha të takohesha me shqiptarët e atjeshëm (me Qemal Butkën dhe Dalip Zavalanin), por më ndaluan, duke vënë si pretekst çështjen e dekonspirimit dhe nga ana tjetër dhe pse ishim në rrugë e sipër.

Pasi u kthye Dr. Coon-i dhe kapiteni Taft, me gjithë që urdhëri i mëparshëm ishtee se do të shkonim drejtë në Shqipëri, u nismë për në Bari për të ngritur zyrën e S.B.S. U nismë për në Bari duke ndjekur këtë rrugë: Kairo – Tunis – Algjeri ku ndejtëm pesë ditë. Këtu takuam nji Kolonel Çetnik i cili kishte ardhur pranë O.S.S., në degën për Algjerin që të kërkonte ndihma. Që këtu vajtëm në Bari, ku gjetëm majorin McBain, i cili kishte shkuar më parë dhe ishte përgjegjës i S.I. për Ballkanin.

Dr. Coon-i u bë komandant i S.B.S. dhe filloj nga puna me-nji-herë duke na e ndarë neve punën në këtë mënyrë: Majori McBain u ngarkua që të gjente lokalin e qëndrimit t'onë dhe na e gjeti në Via Melo, kapiteni polak i cili ishte i aviacionit dhe që e kishte marrë MCBain-i për ndihmë kishte gjetur "Vila Azone" dhe banonte me dy-tre çetnikë, këtë e muarrëm neve më vonë. Unë bashkë me kapitenin Taft mora përsipër të binja në kontakt me shqiptarët që ndodheshin në Bari, me të cillët u takova qysh të nesërmen.

Në Bari ngritmë zyrën e S.B.S., që më parë thirrej Strategjik Balkan Service. Kjo ishte nji degë e O.S.S., por mbante këtë firmë për të maskuar të vërtetën. Mbasi kjo i afrohej shumë emërit të vërtetë t'organizatës O.S.S., u vendos që kjo të thirrej Special Ballcan Service, mënyrë që të fshihej më tepër dhe të mos binte në sy e vërteta. Këto ishin zyrat qendrore të spiunazhit dhe kondra-spiunazhit, prej të cilave do t'udhëzoheshin gjithë elementat e rrjetit mbi mënyrën e punimit në vendin e caktuar.

Shefi për Seksjonin e Jugosllavisë ishte Majori Arnold-i, me profesionin inxhinjer, kishte si ndihmësa kapitenin Popoviç dhe togerin Vujnoviç (këta të dy ishin jugosllavë, lndur n'Amerikë).

Përgjegjësi i Seksjonit për Greqinë ishte Majori Oliver, i cili ka qenë për mjaft kohë profesor në Greqi.

Për herën e parë që kam rënë në kontakt me shqiptarë, ishte tregtari Zoga, i cili më dha listën e disa shqiptarve të tjerë, ndërmjet tyre më kujtohen disa me mbiemrin Sharra. Në nji restaurant italian hëngrëm darkë bashkë me këta. Sharra më tha se në Brindisi ishin disa shqiptarë, një i quajtur Stavri (i vdekur) dhe një i quajtur Kalaja. Më vonë më thanë se kishte disa shqiptarë të tjerë në Displacet Persons Bureau (Zyra e Njerëzve të Ç'vendësuar), e cila kishte për shef Brigadier-Gjeneral Vanebells.

Në këtë mbrëmje i raportoj Dr. Coon-it se, u takova me disa shqiptarë dhe i tregova se në kamp ka mjaft shqiptarë gjithashtu edhe në burg. Ndërsa Dr. Coon-i merrej vesht për të vajtur në burg, unë dhe Taft-i deshëm të merrnin leje për të shkuar në kamp, tek Gjenerali, bashkë me McBain i cili pasi u prezantua, kërkoj të më autorizonon mua që të vinja të takohesha me shqiptarët. Gjenerali më tha se të jap leje me gjith qejf veçse të mos ngjasë gjë, gjithashtu të mos bëhen biseda politike.

U nismë bashkë me McBain-in dhe vajtëm në kamp, ku njoha menjiherë Kol Berishën dhe Ismail Karapicin. Sa erdhëm në kontakt me shqiptarët, McBain-i hiku, ndërsa unë qëndrova aty dhe u-takova me Wrighte (neozelandez), i cili ishte kujdestar i shqiptarve, duke mbajtu me vehte dhe Adem Derhemin, pse ky dinte pak anglisht. Komandanti i kampit ishte Purvis (neozelandez). Njerzit e kampit ishin të pregatitur që më parë për këtë takim dhe si duket kanë qenë lajmëruar me anën e telefonit para se të vinja unë atje. I pyeta të gjithë shqiptarët mbi arsyen që kishin ardhur këtu dhe pastaj i thash Kol Berishës të formonte nji listë ku të shënonte për sejcilin: emërin, mbiemërin, moshën, datën e arrestimit, me sa vjet ishin dënuar dhe edukatën e sejcilit.

Listën që mora prej Kol Berishës ja paraqita Majorit Dr. Coon. Qëllimi i Dr. Coon-it ishte të formonte nji njisi shqiptare, elementat e së cilës do të përdoreshin për t'i dërguer me misionet amerikane në Shqipëri ku do të binin në kontakt me forcat luftonjëse (kështu thojshin amerikanët). Qëllimi kryesor, në të vërtetë, ka qenë se, Amerikanët donin t'i përdornin për interesat e tyre, duke i patur këtaa si informatorë për në ç'do drejtim. Dr. Coon-i më tha se, herën e parë le të marrim ndonji shofer dhe ndonji kuzhinier për të cilin kemi nevojë.

Mbasi mora nji autorizim nga zyra, mora pesë persona nga shqiptarët të cilët janë: Kol Berisha, Merushe Topulli, Adem Derhemi, Qazim Hoxha dhe Riza Leka. Kur vajta në kamp për këtë punë i pyeta nëse donin të shkonin në Shqipëri për të luftuar dhe se do t'i dërgonim në grupe grupe. Këta persona ishin në kampin nr. 1, në Bari i cili ka qenë nën-kontrollin e Zyrës D.P.B. (Zyra e Njerzve të ç'vendësuar).

Amerikanët kishin vënë gjith forcat për grumbullimin e nënshtetasve të huaj n'Itali, po në këtë drejtim vepronin dhe Englezët. Amerikanët donin të tregoheshin karshi botës si flamurtarët për shlirimin e shteteve të vegjël dhe se në këtë mënyrë do të mundnin të shtrinin influencën e tyre kudo. Objektivi i tyre ka qenë që, t'arrinin në krijimin e organizatave pro-Amerikane në çdo shtet dhe që këto, në të nesërmen, të merrnin në dorë forcat e shtetit. Për t'arrijtur këto objektivë përdorën ç'do taktikë: Grumbullonin gjithë elementët refugjatë ndër kampe, i vishnin mirë, i ushqenin, u paguanin nga nji sasi të hollash dhe u bënin gjithë lehtësit për nji jetë të kënaqëshme.

Përveç grupit që muarrëm neve nga kampi nr. 1, kishin marrë dhe englezët nji grup i cili përbëhej prej xhandarësh dhe nji hoxhë, i cili ishte si kryetar i grupit, këtyre u thanë se do t'i dërgonin n'Afrikë, por ata i shpunë afër Lecces, në nji kamp dhe nuk dij nëse i dërguan n'Afrikë, por flitej se i dërguan.

Unë kur vajta në kamp nr. 1, djemt m'u paraqitnë të bashkuar të gjithë, por kur mora këta të pestë, më vjen hoxha dhe një me mbiemrin Spahiu dhe një Hito Lame, në Miramar, të cillët mbani nuk i linin të hynin mbrenda dolla i takova jasht. Këta më thanë se në kamp ishin paraqitur të bashkuar, por e vërteta nuk ishte ashtu, pse ishin të ndarë në komunista dhe nacionalista, dhe propozuan që ne të merrnim vetëm nacionalista në vilë. Majorit Dr. Coon i them se, në kamp ka komunista dhe nacionalista, por ay nuk foli gjë rreth kësaj çështjeje. Një mbrëmje, të pes personat që muarrëm nga kampi nr. 1, i shpumë më Vila "Azone", në rrugën Via Re David. Bashkë me këta vajtëm, unë, McBain dhe Coon-i. McBaini u foli dhe më në fund i pyeti se ç'ishte ay ylli i kuq që mbani dhe njikohësisht i njoftoj se nuk mbahet ylli n'uniformën Amerikane, prandaj duhet t'a hiqni. Kol Berisha vazhdonte gjithmonë t'më jepte lista emërash dhe vendet ku ndodheshin shqiptarë.

Pak më vonë, nga mezi i Nëndorit 1943 shkuam bashkë me McBain-in në Napoli, ku vizituam burgjet, por nuk gjetëm asnji të burgosur, mbasi simbas deklaratave të nji N/Koloneli, Drejtor' i Burgut, i kishte liruar populli. Pastaj vajtëm në Displacet Persons Bureau Engleze dhe pyetëm se ku kishte shqiptarë. Këtu na thanë se kishte në kampin nr. 2, në Ressina. Në kampin nr. 2, takuam pes xhandarë që kishin ikur nga lufta italo-greke. Më vonë u kthyem prap në Bari. Pas nji jave shkuam në Brindisi, unë, Major Coon dhe nji Major neozelandez. Në burgun e atyshëm gjetëm 17 shqiptarë, midis tyre dhe nji grua që quhej Aleksandra, ishte nji grup grekërish dhe nji grup jugosllavë, të gjithë partizanë. Nga shqiptarët njoha vetëm Vani Furrxhiun. Midis këtyre 17 shqiptarve kan qenë Galip Hatibi, Irfan Hasanaj, Aleks Peleshi dhe të tjerë. Më vonë shkuam në Lecce ku pyetëm guvernatorin ushtarak majo Cox, i cili na tha se ishin dy-tre veta shqiptarë. Prej andej shkuam në Otranto, por aty nuk kishte shqiptarë.

Shqiptarët që ishin në Brindisi i muarrëm dhe i shpuam në kampin nr. 1. Në këtë kohë qeverija greke kishte dërguar nji përfaqsues, i cili propagandonte kundra shqiptarvet. Ai kishte vajtur në të gjitha kampet dhe gënjente njërin dhe tjetrin për t'i bërë më vehte, të gjitha këto bëheshin me dijenin e Englezvet. Personat që regjistronte greku, mbasi u jepte nji sasi të hollash i dërgonte n'Afrikë, në Kairo.

Mbas pak kohe marrim dhe nji grup tjetër nga kampi nr. 1, listën m'a dha Spiro Ruço. Në këtë grup ishte Galip Hatibi, Vani Furrxhiu, Aleks Peleshi dhe të tjerë.

Mbas ardhjes së grupit të dytë në Vila "Azone", grupi i shqiptarvet arrijti afro 38-40 veta. Tani midis këtij grupi u fillua të bëhej nji jetë kampi. Aty shkonte herë pas here kapterr Vangjel Kirias dhe të tjerë që u bënin propagandë pro-Amerikane. Më vonë vjen aty edhe grupi i Hasan Reçit, i dërguar me aeroplan, nga Palermoja, prej kapiten Corvei (Amerikan), në këtë kohë ishte mbarimi i Nëndorit 1943-së.

Nga fundi i Nëndorit 1943, erdhi n'Itali Fultzi nga Stambolli, i cili mori përgjegjsin e S.B.S. për Shqipërinë dega S.I.

Fultzi ishte dërguar nga Zyra e Propagandës së Lindjes së Mesme, me qëllim që të binte në kontakt me exponentat shqiptarë që ishin atje. Kur u kthye prej Stambolli bëri nji raport rreth bisedimit që kishte patur me Hasaf Xhaxhulin, Musa Jukën, Lal Krosin, Asim Jakovën, Stavri Skëndon dhe shqiptarë të tjerë. Ky i pat kshilluar ata që të formonin nji qeveri në mërgim, duke u marr vesht me të gjitha kolonit shqiptare. Kishte shtuar që në këtë qeveri të futshin dhe elementa të rinj qoftë dhe për formë gjersa të mblidheshin të gjitha kolonitë e të merrnin njohjen nga Aleatët dhe të futeshin në radhët e Kombeve të Bashkuara. Ky i pat sygjeruar se po të ngjiste kjo, në Shqipëri do të konkretizohej pa tjetër nji organizatë e gjerë e bazuar ne kjo qeveri dhe në përfundim do të merrnin dhe ndihma nga Aleatët. Personat që përmendëm më lart i patën shfaqur Fultzit mërzitjen e tyre pse nuk dinin si t'ja bënin Zogut që nji pjesë e shqiptarve t'Amerikës nuk e donin. Fultzi, i pat këshilluar se këtë çështje mund t'a bënin kondicionale sa për kohën e luftës, d.m.th. të pranohej Zogu sa të mbaronte lufta dhe pastaj mund të bëhej një plebishit.

Në këtë kohë Dr. Coon-i u transferua dhe vendin e tij e zuri Major Koch. Po ashtu dhe Majori McBain ishte transferuar për në Pacifik dhe që më vonë u gradua N/Kolonel. Shtoj se ky kishte ardhur vetëm sa për t'organizuar S.B.S. n'Itali. Në këtë kohë shqiptarët që kishin mbetur në kampin e Aleatve të D.P.B., që ishte ndën-kontrollin e Englezve, deshnë t'iknin që aty, mbasi Englezët po transferonin nji pjesë prej këtyre për në Afrikën e Veriut për qëllimet e tyre politike. Elementat që këta kishin hequr ishin xhandarë me tendenca zogiste. Në këtë kamp ata që çfaqeshin me tendenca pro-Lëvizjes Nacional Çlirimtare shiheshin me sy të keq nga Englezët dhe për këtë arsye edhe mund të deportoheshin që aty. Për këtë shkak unë i them Fultzit se, disa shqiptarë, që janë nëpër kampet, kërkojnë të vijnë në Vilë. Përsëri i them Fultzit se, Majori McBain edhe Coon-i kishin premtuar që t'i merrnin në Vilë. Mbas pak kohe Koch bisedoj me Fultzin dhe ranë dakord që t'i merrnin në Vilë edhe këta. Për këtë arsye zunë nji tjetër Vilë "Vila Rossa", në Karbunar, karshi stacionit të radios S.B.S. Këtu vajtën të gjithë shqiptarët që po vinin rishtas të cillët ishin nën-kujdesin e Spiro Ruços.

Në këtë kohë në Vilë, Fultzi me shokë, po pregatiste të bënte nji kurs. Qëllimi i kursit ishte që të pregatiste elementa teknikisht në degë të ndryshme si radio-telegrafistë, në degën e inteligjencës dhe në eksplozivë, për t'i përdorur kur të kishin nevojë dhe ku të kishin nevojë. Këta i deshën që t'u bindeshin verbërisht dhe t'i përdornin si pas urdhërave të tyre kundra armikut dhe mikut mbi çështje informative. Kjo punë që bënin ata kishte si qëllim që të pregatitnin elementa n'atë kohë dhe për t'ardhmen për t'arrjtur objektivat e tyre, t'i përdornin njikohësisht dhe si informatorë. Elementi më i preferuar për punën e tyre ishin ata që ishin sa më shumë kundra Lëvizjes Nacional-Çlirimtare. Shkurt përfundimi i këtyre kurseve ishte që t'u shërbenin Amerikanve për realizimin e planeve të tyre në të ardhmen.

Për të pregatitur këta kurse, Fultëzi kërkoj, më parë biografit e elementave që kishim në Vilë. Këto pasi i studjoj mirë dhe si pa tendencat e tyre, vendosi që t'i ndante në grupe të ndryshëm. Para se t'i ndante në grupe të ndryshëm, u konsultuan dhe vendosën që të bëheshin tre kurse: në Inteligjencë, n'Eksplozivë dhe në Radio-telegrafi. Këto kurse bëheshin në të dyja Vilat, si "n'Azzone" ashtu dhe në Vila "Rossa".

Mësimet që bëheshin në kursin e Inteligjencës ishin këto:

1) Shifër (me profesor mua, Lary, dhe Nick Cooky).
2) Karta gjeografike (topografi, me profesor Fultzin dhe përkthys isha unë dhe nmungesë t'ime Kiriazi).
3) Observim (me profesor Fultzin dhe përkthyes unë).
4) Reportazh (me profesor mua dhe Fultzin).
5) Mjetet e orientimit (me profesor Fultzin dhe Nick Cooky).
6) Propagandë (këtë e bënja unë).

Kursi i radio-telegrafistëve kishte këto mësime:

1) Shifër (me profesor mua dhe Nick Cooky).
2) Alfabetin Mors.
3) Kodin e radios.
4) Bënin dhe shumë lëndë që bëheshin në kursin e Inteligjencës.

Shtoj se nji pjesë nga kursistët që ndiqnin radio-telegrafinë, merrnin mësime dhe n'Inteligjencë. Në radio jepte mësime reshter Joe, Angelo Mitro (shqiptaro-amerikan) dhe Nick Cooky. Drejtor'i radios ka qenë Huston, i cili jepte mësim në radio. Në fund për nji kohë jepte mësim dhe Spiro Dhima, mbasi ky mësoj shpejt.

Në kursin e Eksplozivave jepeshin këto mësime:

1) Lëndë eksplozive të të gjithë llojeve.
2) Të gjithë llojët e fitilave.
3) Mënyra e përdorimit të tyre.

Në fund të kursit i mblodhi të gjithë elementat që merrnin pjesë, Majori Oliver, i cili u bëri disa orë mësime Intelizhence në gjuhën italisht.

Në përgjithësi të gjithë djemtë duallën mirë në kurs.

Elementat që merrnin pjesë në këto kurse ishin të ndarë kështu:

Grupi i Inteligjencës:

1) Kol Berisha, me pseudonimin “Lec”.
2) Adem Derhemi, me pseudonimin “Demi”.
3) Qazim Hoxha, me pseudonimin “Zim”.
4) Ali Alija, me pseudonimin “Shami”.
5) Hasan Reçi, me pseudonimin “Koçi”.
6) Niko Kovaçi, me pseudonimin “Jozi”.
7) Foto Vesha, me pseudonimin “Al”.
8) Aleks Peleshi, me pseudonimin “Ken”.
9) Ndue Gega, me pseudonimin “Lin”.
10) Galip Hatibi, me pseudonimin “Gjak” pse “Jack”.
11) Haki Harvati, me pseudonimin “Bobi”.
12) Spiro Ruço, me pseudonimin “Çiang”.
13) Qani Katroshi, me pseudonimin “Igli”.
14) Koço Gjika, me pseudonimin “Nino”.
15) Fadil Kërtusha, me pseudonimin “Harry”.
16) Stamati Stamatiani, me pseudonimin “Stamo (?)”.
17) Vasil Lazari, me pseudonimin “Sili”.
18) Një djal i vogël shok i Galipit me pseudonimin “Smith”.

Grupi radio-telegrafist:

1) Sinan Gjoni me pseudonim “Nano”.
2) Spiro Dhima me pseudonim “Pipi”.
3) Osman Shehi me pseudonim “Man”.
4) Shefqet Kavaja me pseudonim “Vaja”.
5) Faik Mane me pseudonim “Toni”.
6) Sali Doda me pseudonim “Salvatore”.
7) Alush Sejko me pseudonim “Zhon” ose “John”.

Grupi i demolicionit (eksploziva):

1) Shate Dulla nga Kuçi me pseudonimin “Dulla”.
2) Hamit Gryksi me pseudonimin “Miti”.
3) Preng Shkoreti me pseudonimun “Niti”.
4) Ramazan Metalla me pseudonimin “ ? “.
5) Etëhem Beluli me pseudonimin “Gary”.
6) Shahin Pertef me pseudonimin “Jerry”.
7) Qamil me pseudonimin “Mili”.
8) Haxhi Braja me pseudonimin “Xhi”.
9) Osman Alla me pseudonimin “Alla” (?).
10) Nikolla Bruka me pseudonimin “Nik”.
11) Ndue Nikolla me pseudonimin “Mujo”.

12) Riza Leka me pseudonimin “Leka”.
13) Nji italian i rritur në Shqipëri me pseudonimin “Thomo”.

Kurset mbaruan në Marsin e 1944-rës. Mbas këtij u futëm në kursin e infermeris me instruktor një kapter nga spitali Amerikan, në të cilin vazhduam gati një muaj. Mbasi mbaruan kursin kursistat donin të niseshin, por Fultzi dhe unë u nxirrnim shkaqe të ndryshme vonese, për arsye se duhesh t’i bënim këta besnikë t’onë në mënyrë që t’i përdornim për punë informative. Me arsye të ndryshme ne po e zgjatnim kohën dhe njikohësisht po mundoheshim t’i vononim sa do që kishte mundësi t’i nisnim. Si përfundim i gjithë punës t’onë ishte që këta elementa të bëheshin informatorë t’Amerikanve në ç’do situatë dhe kjo u arrit pjesërisht me elementa të ndryshëm.

Nga ana politike qëllimi i ynë ishte që Shqipërija të futej ndën sferën e influencës Amerikane. Me punën që bënim ne, duhej të ngjallnim simpathin për Amerikën, në mënyrë që t’ishte e hazërt në të nesërmen fusha për qëllimet e tyre politike. Ky ishte qëllimi i tyre që bënin gjithë ato shpenzime. Për këtë si fakt sjell fjalët e hapura dhe propagandën që bënte Vangjel Kiriaz me shokë dhe për këtë punë kishin pregatitur dhe kopsa me flamurin shqiptar dhe Amerikën në mes.

Nga ana tjetër edhe Englezët të njëjtin veprim bënin për t’ja arrijtur qëllimit në favor të tyre.

Në formulën “ç’do gjë për interesë t’Amerikës”, ne filluam veprimtarin t’onë.

Me t’u ngritur S.B.S., degë e O.S.S. n’Itali filluan dhe propagandën në favor t’Amerikës dhe kondra Lëvizjes Nacjonal-Çlirimtare, mbasi informatat që kishim marrë ishun kundra kësaj të cillën e quanim nji lëvizje krejt të “majt”, ku dominonin Komunistët. Kjo lëvizje ishte për ne në kundërshtim me punën t’onë që do të bënim dhe nuk linte asnji shkak ose shpresë që ne të bënim Shqipërinë që të hidhej ndën influencën amerikane, pse ndalonte ç’do fushë veprimi për ne.

Informatat e para të marra nga Fultzi prej Stavro Skëndit dhe Asim Jakovës dhe së shoqes së tij në Stamboll, që sot janë në shërbim t’Englezvet dhe që marrin nji rrogë 600 dollar në muaj sejcili, ishun kundra Lëvizjes Nacional-Çlirimtare dhe pro-Ballit Kombëtar dhe simbas pretendimeve të këtyre të dyve, këta ishin përfaqsuesit e Ballit Kombëtar në botën e jashtme.

Fultzi, si njeri me pozitë në O.S.S. dhe me influencë në Washington qarkulloj raportet e tija edhe në zyrat ku ndodheshim ne (S.B.S.). Pra informatat e para që muarrëm ne, kan qenë kundra Lëvizjes. Të bazuar në këto informata, filluam propagandën anti-Lëvizjes.

Në Washington, kur po niseshim për Shqipëri, na ranë në dorë disa informata ku flitej për Shqipërinë dhe mbi gjendjen e saja politike, gjithashtu shënoheshin dhe disa emëra udhëheqësish të rezistencës në Shqipëri. Këto ishin shkrojtur në dy fletë dhe na u dhanë neve me qëllim që të orientoheshim rreth Lëvizjes dhe krejt gjendjes në Shqipëri.

Nga emërat e udhëheqsave më bijen ndërmend këta: Muharrem Bajraktari, për të cilin kishte shënim si nacionalist, Mehmet Shehu, për të cilin kishte shënim si

komunist, Abaz Kupi, Bilal Nivica, Dine Hoxha (që ka 15 vjet që ka vdekur) dhe të tjerë elementa të vdekur.

Materjal tjetër informativ përmbi Shqipërinë, në kohën kur u nismë prej këtej nga Kairo-ja, në zyrat e O.S.S. më dhanë disa koleksione të gazetave Tomori dhe Roja Kombëtare. Këto i dërgoheshin togerit Welles nga nji zyrë Engleze për të bërë disa përkthime rreth gjendjes ekonomike dhe politike të Shqipërisë. Wellesi këto gazeta m'i dha mua dhe mbasi i studjova bëra nji raport mbi gjendjen ekonomike dhe atë politike të Shqipërisë e cila ju dërgua zonjës Hasluck.

Në këtë kohë, në Kairo, jam takuar dhe me Fultzin, i cili porsa ishte kthyer nga Stambolli, ku kishte ndenjur për mjaft kohë në kontakt me Stavro Skëndon dhe Asim Jakovën. Këtu me Fultzin kemi biseduar mbi shqiptarët e Amerikës, tentativat e tyre për të formuar nji qeveri shqiptare në mërgim dhe mbi tendencat e ndryshme që ekzistonin në Shqipëri, si Balli, Lëvizja Nacional-Çlirimtare dhe Legaliteti.

Në bisedimet që kemi bërë me Fultzin këtë kohë, ky përkrahte shumë Ballin Kombëtar dhe kishte merak të madh se Mehmet Shehu mos ishte komunist. Harry Fultz fliste me urrejtje të madhe për Lëvizjen Nacional-Çlirimtare, duke thënë se ajo është komuniste, e kritikonte dhe e urrente haptas. Fultzi ka dashur gjithmonë që në Shqipëri të kishte nji qeveri në favor t'Amerikës; për këtë arsye, ky bashkë me shokët e tij interesoheshin që të dinin se, kush ishte komunist dhe kush jo. Kjo ishte detyrë krysore që u ngarkohej elementave të ndryshëm të O.S.S.

Fultzi mbante me vehte librin "Basic Hant Book on Albania", e cila përmbante informata ekonomike, kulturale, llojët dhe sasit e prodhimit në Shqipëri, mbi fetë që ndodhen këtu, klimën, portet e Shqipërisë, rrugët, urat, eksport e import, pak histori, ethnografi, pozitat ndërkombëtare të Shqipërisë dhe regjimet që kan qenë në Shqipëri. Gjithashtu kishte nji seri fotografish, prej të cilave më kujtohet zbarkimi i italianve në Durrës, Shëngjin, Vlorë, Sarandë.

Fultzi, shqiptarëve që ishin në kurs, ja u paraqiste gjendjen e Shqipërisë kaotike, ja u mëshifte realitetin.

Në S.B.S., kam kënduar një seri raportesh informativë, rreth gjendjes në Shqipëri, prej të cilëve më kujtohen këta:

1) Nji raport nga Asim Jakova, i cili e përshkruante gjendjen kaotike në Shqipëri. Ky fliste gjithmonë për Ballin Kombëtar dhe e ngrinte lart, duke i qojtur udhëheqsit e këtij si patriotë të provuar, njerëz me edukatë, të cillët nuk kishin tjetër ambicje veç mirëqenien e Atdheut. Balli Kombëtar, thoshte ay, është gati të hyj në relacioni të ngushta me aleatët perendimorë dhe ka forca të shumta luftarake, që mund të kryejn veprime të rëndësishme sikur të përkrahen nga Aleatët. Që të veprohej nji veprim i gjerë ushtarak duhej më parë të bëhej një marëveshtje me Aleatët dhe të siguroheshin prej këtyre kufijt ethnike të Shqipërisë. Ky e minimonte Lëvizjen Nc.Çl., në çeta terroriste t'udhëhequr nga persona që refuzonin ç'do bashkpunim me grupe të tjerë, por që kërkojnë që ç'do gjë të bëhej si pas planit të tyre komunist. Kjo Lëvizje thoshte ay, është organizuar dhe tërhiqet prej hunde nga Jugosllavët internacionalistë, si Dushani dhe Meladini.

2) Një raport nga zonja Jakova, e cila paraqitej si moderate. Kjo tregonte se si ishte takuar me Lumo Skëndon, para se të nisej për në Stamboll dhe se si e kishte gjetur tepër të shqetësuar për shkak të vëlla-vrasjes që kishte filluar. Lumoja i akuzonte komunistat si shkaktarë të vlla-vrasjes ddhe se ay vetë po përpiqej me ç'do mënyrë që të vinte në marëveshtje, por ishte e pa-mundur. Ky kërkonte që të ndërhynin anglo-amerikanët dhe të pajtonin këto tendenca që po e shkatrronin fare Shqipërinë, pëmendëte djegëjet e shtëpive që bënin komunistët, duke ndjekur ballistat. Edhe në këtë raportë kërkoj nji marëveshtje me Aleatët. Zonja Jakova përmendëte në raport dhe nji bashk-fjalim që kishte patur me Gjinishin, të cilin e quante "komunist t'arsyeshëm", trim dhe të pa lodhshëm mbrenda në qytet për organizimin kondra okupatorit. Kjo nuk u a mohonte luftën Nacional-Çlirimtarve, por i quante luftimet si premature dhe se sakrificat ishin shumë më të mëdha se fitimet, me qenë se okupatori bënte raprezalje të mëdha. Udhëheqsit i quante njerëz pa eksperiencë. Në pikëpamje luftarake thosh se nacional-çlirimtarët janë të rinj dhe kokë krisur dhe prandaj lufta e tyre është më e dukëshme se ajo e Ballit.

3) Nji raport që vinte në O.S.S. prej Tajar Zavalanit. Ky ishte nji raport i gjatë, që fillonte me rezistencën në Shqipëri qysh më 7 Prill 1939. Ky e fillonte që me demostratat e ditëve të 7 Prillit, ku tregonte se si rinija ishtre gati të luftonte, por nuk kishte me se, flite mbi rezistencën në Durrës dhe kalonte pastaaj në demostratat e tjera para se të fillonte luftimi me çeta. Pasi fillonte me tendencat politike në Shqipëri, pëshkruante Konferencën e Pezës dhe të tjerat, përpjekjet për bashkim midis Ballit Kombëtar dhe Lëvizjes Nacional-Çlirimtare. E quante nji fatkeqësi që nuk mund t'arrihej nji marëveshtje. Ky ja atribuonte falimentimin për bashkim Partisë Komuniste, e cila refuzonte të bënte konçesione, duke vazhduar vijën e saja politike "jo-kompromis". Pasi thoshte se, në Ballin Kombëtar, ka elementa patriotë me rëndësi si Lumo Skëndua, Butka e të tjerë, që gëzojnë simpathi kudo; ç'faqte mendimin e tij që, komunistët duhet të harronin vijën e tyre politike, t'i zhytnin divergjencat të dy palët dhe të mendonin vetëm për problemin imediat: "Çlirimi i vendit". Në këtë mënyrë, thoshte ay, do të kishin edhe përkrahjen e Aleatve, kur t'i shifnin të bashkuar.

4) Nji broshurë të Tajarit, në gjuhën anglisht, nji kopje të së cilës ja dhash Frederik Nosit kur erdhi n'Itali, përmbante lëndën e sipërme pjesërisht, njikohësisht ishin shtuar dhe veprime ushtarake nga Lëvizja Nacjonal-Çlirimtare dhe Balli Kombëtar. Në nji vend bënte hero Skënder Muçon dhe mburrtee Lumo Skëndon. S'ka dyshim që ky këto informata do t'i ketë marrë nga Englezët.

5) Nji raport me nji far organizate tepër të mësheftë që ekzistonte me qendër në Tiranë dhe me dega në të gjithë anët e Shqipërisë, e cila quhej "Klika". Ky raport vinte nga burim Englez, por nuk mbante emër. Antarët e kësaj organizate i quante si njerëz me eksperiencë politike dhe me influencë, por që nuk mund të vepronin ushtarakisht pa ardhur rasti oportun. Këta vetëm mundoheshin që t'a mbanin Shqipërinë të bashkuar, të ruheshin nga raprezaljet dhe të vepronin vetëm kur të merrnin senjalin.

6) Nji raport tjetër, që nuk e dij burimin se nuk e lexova mirë, për arsye se nuk m'a lanë, kishte nji shënim që ruhej nga mua e shënuar prej Fultzit. Pashë vetëm nji paragraf, kurse sugjerohej se, duhej vendosur sa më shpejt që të bëhej nji deklaratë zyrtare në favor të Ballit Kombëtar. Dhe Aleatët duhej të favorizonin Ballin Kombëtar me anën e radios.

7) Në nji raport nga R.A. i S.B.S. (kërkime dhe analizë të S.B.S.) i pari që pata parë, i kompiluar nga togeri Madison. Ky raport ishte nji studim i gjithë trakteve, gazetave dhe informatave që ishin mbledhur gjer atëhere. Ky bënte fjalë mbi organizatën ose tendencat politike të ndryshme në Shqipëri. Përshkruente Lëvizjen Nac.Çl. si nji Front Komunist në Shqipëri, por që lëftonte më shumë nga të tjerët dhe e lidhte me Lëvizjen Nac.Çl. të Ballkanit, rreth Titos për nji Front Ballkanik në lidhje tepër miqësore me Bashkimin Sovjetik. Ky thoshte se qëllimi kryesorë i këtyre lëvizjeve ishte krijimi i këtij Fronti Ballkanik, pë t'i rrëmbyer fuqit shtetnore me t'u zhdukur okupatori. Përmendëte emërin e Enver Hoxhës si udhëheqës, organizimin e mirë që kishin dhe jepte nji numur forcash, që më duket se ishte 10.000. Përshkruante Legalitetin si organizatë që donte të binte në fuqi prapë Zogun dhe se kjo simpathizohesh më shumë në Veri, kurse Lëvizja Nac.Çl. në Jugë. Përmendëte udhëheqësin e Legalitetit Abaz Kupi i cili ishte tërhequr nga Lëvizja Nacional-Çlirimtare. Përshkruante dhe Ballin Kombëtar si nji organizatë moderate e udhëhequr nga intelektualë të zgjedhur, por që u mungonte zotsija e organizimit. Këta i quante si anti-Legalistë, por më shumë anti-Komunistë. Shtonte se këta të Ballit kishin patur forca të mëdha, por po perëndonin që kurse kishte filluar vlla-vrasja. Si konkluzion ky nxirrte këtë: Si kudo gjetkë, edhe në Shqipëri, po harxhoheshin energjitë më të mëdha në vlla-vrasje, duke e kënaqur okupatorin në këtë mënyrë dhe se kjo vlla-vrasje mund të rezultonte në masakra në mbarim të luftës, për të fituar fuqin politike. Vetëm nji ndërhyrje nga ana e Aleatvet që n'atë kohë, për t'i pajtuar këto rryma mund të zhdukte rrezikun e masakrave.

8) Who's Who among Albanian Fighting Forces (kush ësht kush midis forcavet shqiptare, e kompiluar në O.S.S., Washington, në bazë t'informatave të ndryshme që kishin patur. Këtë e kam parë në kohën ma të fundit që u ndodha në S.B.S., d.m.th. andej nga shtatori i 1994-rës. Ky raport në formë broshure kishte emëra udhëheqësish që luftonin në çeta të vogla dhe mundësit e këtyre që kishin në ngritje forcash, sikur të kishin armë lokali ku vepronin dhe tendencat politike. Ishte krejt absurde se në shumë raste njerëz të Ballit Kombëtar shënoheshin si Nacional-Çlirimtarë ose komunsta dhe viçe – versa. Figuronin emëra udhëheqsish që nuk ekzistonin fare ose që kishin vdekur nja 10 vjet më parë.

Qëllimi imediat në lidhje me grumbullimin e shqiptarvet ishte që ne t'i stërvitnim de t'i dërgonim në grupe të vegjël në Shqipëri që të vinin në lidhje me personat e ndryshëm të rezistencës; mirpo mbasi filluan stërvitjet u kuptua kjartë se këto bëheshin vetëm për t'i shërbyer kauzës amerikane përgjithnji në ç'do situatë.

Shqiptarve të grumbulluar në Vila "Azzone" dhe "Rossa" nuk u shpjegohej fare gjendja e vërtetë në Shqipëri dhe as që ju jepej akoma dhe një trakt. Në vija të

përgjithëshme edukata që bëhej këtu ishte që ky element të rritej në frymën e tyre dhe t'a kishin rezervë për të nesërmen. Nji nga veprat që bëmë ne kundra frymës nacional-çlirimtare, që mbizotronte mbi këta shqiptarë të grumbulluar, ishte dhe çështja e heqjes së yllit. Qysh kur bëmë takimin e parë me shqiptarët, unë dhe McBain, ky i fundit u tha se ylli nuk mbahet n'uniformën amerikanem me gjithë se këta ishin partizanët shqiptarë. Mbasi kaloj nji kohë, vjen nji urdhër nga komanda më e lartë, ku urdhërohej se, ylli i kuq nuk duhet mbajtur dhe se për këtë ata duhej t'a hiqnin. Shpjegimi i këtij urdhëri u bë nga Harry Fultz, i cili justifikoj këtë urdhër, duke thënë se na ekspozoni përjashta dhe njëmijë pallavra të ndryshme dhe lloj lloj shpifje. Por e vërteta nuk ishte kjo. Ata nuk dojshin që të shikojshin njeri me sy që mbante yllë, pse u vriteshin ytë. E njejta gjë ngjau dhe tek partizanët jugosllavë.

Midis djemve që merrnin pjesë në kurs kishin futur Vangjel Kiriazin i S.I., që bënte propagandë kundra Lëvizjes dhe Komunistave, që t'i ndante këta në individë edhe kështu të plotsoheshin qëllimet e tyre. Vangjel Kiriazi kishte lidhje shumë të ngushta me Fultzin dhe ishte njeriu më konfident i tij.

Nga dhjetori i 1943-së, ka ardhur n'Itali Asim Jakova me të shoqen nga Stambolli të cilët u futën në shërbim t'englezvet, në zyrën e propagandës ku ishte si kryetar majori Barbrook (ish organizatori i Gjindarmarisë në Durrës), secili nga këta paguhej nga 600 dollar në muaj. Asimi me të shoqen qysh në Stamboll ka qenë në shërbim në zyrën e Propagandës të Lindjes së Mesme. Ky i ka thanë vetë Spiro Ruços se ka qenë përfaqsonjës i Ballit Kombëtar, këtë gjë e dinim edhe ne nga burime të tjera. Asim Jakova qendrën e veprimtaris së tij e kishte në dyqanin e Hysni Sharrës, duke dijtur se Hysni Sharra me shokët e tjerë kan qenë kundra Lëvzjes Nacional-Çlirimtare.

Në këtë kohë Asim Jakova në bashkëpunim me Xhemal Farkën dhe me majorin Barbrook, punonin në zyrën e propagandës Engleze dhe nxirrnin gazetën "Mundimi". Pranë tyre qëndronte dhe Irfan Hasanai, i cili punonte po në këto zyra. Që të katër këta flisnin shum keq kundra Lëvisjes dhe propagandonin kundër saj. Majori Barbrook ishte anti-shqiptar i t'mershëm.

Këta këtë propagandë e bënin në bashkëpunim me Englezët dhe në konsultim me Fultzin. Rrogën mujore e merrnin nga Amerikanët dhe teknikisht ishin të varur nga këta (O.W.I.) ndërsa raportet e punës që kryenin i jepnin tek Englezët.

Asim Jakova, Xhemal Farka, Hysni Sharra, Alfred Andoni, Mahmud Cungu, Llambi Tavanxhiu, dhe të tjerë tregtarë në Bari, filluan nji propagandë të gjerë kundra Lëvizjes Nc.Çl. Për këtë veprim ishin në dijeni Anglo-Amerikanët dhe antarët e S.B.S., të cilët jepnin ndihma morale dhe materjale për t'u ushtruar kjo propagandë.

Kur e panë Anglo-Amerikanët se punët nuk do të vinin ashtu siç dëshironin ata në Shqipëri, d.m.th. që s'kishin mundësi për të krijuar nji rezistencë krejt miqësore ndaj tyre dhe që të vepronte simbas direktivave që t'i jepnin ata, gjë që kishte për të lënë fushë të lirë për politikën e tyre në t'ardhmen, atëhere këta vazhduan të mohojnë luftën Nacjonal-Çlirimtare dhe i a nisnë punës më me zellë për të krijuar nji bashkim midis shqiptarve të mërguar, që kështu të dilte nji autoritet përfaqsues për Shqipërinë në botën e jashtme. Pa dyshim ky do të ishte kukulla e tyre.

Kur filloj të merrej vesht se Lëvizja Nc.Çl. po korrte suksese, Asim Jakova, Xhemal Farka, Hysni Sharra dhe nji sërë shqiptarë të tjerë, të shtyrë nga Amerikanët, nëpërmjet Fultzit, formuan nji organizatë, në të vërtetë politike, por për t'a maskuar i vuen emërin "Shoqërija mirëbërëse". Në këtë bënin pjesë disa antarë aktivë të S.B.S. si p.sh. Stevens, Irakli Lesho, Ahmet Kuçi, Vangjel Prifti, Vangjel Kiriazi dhe Kamber Elmazi me pseudonimin Ali Jashari, i cili ishte nji nga organizatorët kryesorë dhe që sillte këtu direktivat e marra prej Fultzit.

Kryetari i kësaj shoqërije ishte Asim Jakova, arkëtar Hysni Sharra dhe antarë Llambi Tavanxhiu, Xhemal Farka dhe të tjerë. Këta mundoheshin me ç'do mënyrë të shtonin antarët dhe njikohësisht përpiqeshin që shoqërija e tyre të njihej zyrtarisht nga Anglo-Amerikanët si nji organizatë politike, me qëllim që mbas lufte të merrnin drejtimin e qeverisë në dorë. Bënë tentativa të vazhdueshme për t'ardhur në lidhje me gjithë kolonit shqiptare që ishin nëpër shtetet e ndryshëm, për këtë arsye dërguan dhe Mahmud Cungun në Kairo.

Në fillim të muajit shkurt 1944, erdhi në Napoli, Dr. Rifat Tirana i cili ishte antar'i Kshillit Kontroll Aleat në Mezdhe. Ky ishte i dërguar apostafat, prej Ministrisë Jashtëme Amerikane, për të studjuar çështjen shqiptare me Anglo-Amerikanët që ishin këtu. Për këtë arsye më vonë erdhi në Bari dhe mbasi bisedoj për nji kohë të gjatë me Asim Jakovën, u takua me Fultzin.

Në dyqanin e Sharrës, ku ishte qendra e kësaj shoqërije, delte lëndë propagandistike balliste dhe kjo u ndahej gjithë ballistave pë t'a lexuar. Ç'do ballist që vinte në Bari futej në këtë shoqëri, si p.sh. sh. Xhelil Çela nga Dukati, i cili isht korieri i Englezvet. Ky shpinte postën e këtyre të fundit nga Spileja në Bari, gjithashtu mbante lidhjet midis misionit Englez dhe atij Amerikan nga njëra anë dhe nga ana tjetër Ballit Kombëtar (me Skënder Muçon, Lumo Skëndon dhe të tjerë). Xhelili ishte antar i S.B.S. dhe kryente edhe shërbimin potier të kësaj.

Mbaj mend se më ka ardhur Antony Stevens dhe më ka kërkuar 500 lireta si ndihmë për shoqërinë "Mirë-bërëse". Më vonë, kam qenë i dërguar prej Fultzit, te Sharra për t'asistuar kur bisedonin rreth organizimit të të gjithë shqiptarve në Itali dhe gjetkë, që kështu të delte nji autoritet përfaqsonjës pranë aleatve. Këto mbledhje organizoheshin nga Ali Jashari (Kamber Elmazi) antar i S.B.S., Asim Jakova, Mahmud Cungu, Hysni Sharra, Alfred Andoni, dhe Xhemal Farka. Kisha parë që në këto mbledhje vinin: Adem Derhemi, Ali Alija, Irfan Hasanaj, Riza Leka dhe Qazim Hoxha.

Kam parë që, udhëheqsat e shoqërisë "Mirë-bërëse" të vinin dendur në shtëpin e Kol Berishës.

Fultzi së bashku me Kiriazin dhe Stevens ka shkuar tek Asim Jakova për t'i ndihmuar n'organizimin e kësaj shoqërije. Kur u formua organizata "Mirë-bërëse", Fultzi ka marrë pjesë në dyqanin e Sharrës dhe i këshillonte që të bashkoheshin të gjithë shqiptarët se, vetëm me këtë mënyrë do të shifeshin me sy të mirë nga Aleatët dhe do të ndihmoheshin. Ky u a paraqitëte gjendjen në Shqipëri krejt të ngatrruar, dhe pa shpresa për nji organizim të mbrendshëm, prandaj shqiptarët e mërguar, thoshte, duhet të bëjnë dishka konkrete, në vend që të vërtiten rrotull vetëm duke

folur. Fultzi e mori përsipër se do të ndërhynte pranë autoriteteve Aleate në Bari, që t'u jepnin ç'do lehtësi morale dhe materjale në rast se do të paraqiteshin si nji grup; në rast të kundërt, tha ay, s'kishte për të humbur kohë me lojna. Përfundojë duke thënë se, tash është koha që duhet të lini ideollogjit me njanë dhe të veproni si shqiptarë. Përkthyes ishte Asim Jakova. Në këtë nmbledhje kam qenë dhe unë prezent.

Në zyrën e Fultzit vinin dendur Asim Jakova me të shoqen, Alfred Andoni, Mahmud Cungu dhe Ymer Sharra. Mahmud Cungu mbante dhe disa letra të mbështjella në doë. Kjo shoqëri vazhdoj punën e saj gjersa erdhi misioni shqiptar në Bari. Si erdhi misioni shqiptar, Asim Jakova, shkoj tek Kadri Hoxha që rrinte në shtëpin e Kol Berishës, për t'i dorëzuar të hollat e kësaj shoqërije mbasi u shpërnda, por nuk dij nëse Kadriu i pranoj këto të holla a po jo.

Kah mezi i muajit mars 1944-ës, kursi mbaroj dhe shqiptarët kërkuan me këmbëngulje të niseshin për në Shqipëri, mirpo pengoheshin nga Amerikanët, pse këta donin t'i bënin krejtë për vehte dhe t'i përdornin si individa dhe jo si grupe, për këtë arsye u nxirrnin përpara si pengesë mungesën e mjeteve të transportit, veç kësaj dhe ndalesën e Englezve për të kaluar n'Adriatik. Po në këtë kohë në vilën Jugosllave bëheshin stërvitje parashutiste, për këtë gjë Fultzi propozoj që të merrnin pjesë edhe shqiptarët në kursin e parashutistëve, kjo bëhej vetëm për qëllim vonimi. Në fillim shqiptarët pranuan të mirrnin pjesë në kurs, por më vonë mbasi u lindi dyshimi se mund t'u delnin pengesa të tjera, jo vetëm që nuk pranuan të venë në kurs, por i dhanë dhe nji ultimatum Fultzit që, në qoftë se nuk do t'i nisnin me 5 Prill, do të gjenin vetë mënyra për t'ikur. Nga fundi i Marsit, unë edhe Fultzi shkuam tek komandanti Edward Green (major ekuivalent, pse ishte në marinë) dhe i parashtruam kërkesën që kishin bërë djemt e vilës. Komandanti tha se, ne nuk kemi asnji kundërshtim për nisjen e tyne, por tash për tash për pengesa të ndryshme që na paraqiten, nuk mund t'i dërgojmë të gjithë përnjiherë, vetëm se në grupe grupe. Këtë gjë e pranoj dhe Fultzi. Më në fund majori Green tha se, djemtë, mund të merrnin nga plaçkat që kishin ç'të donin, gjithashtu edhe armët, bile mund t'u epnin edhe pare po të donin.

Në të vërtetë, Amerikanët kishin të gjitha mundësitë që t'i dërgonin djemtë në Shqipëri me anën e Adriatikut, por për t'arrijtur qellimet e tyre donin t'i nisnin në tjetër rrugë për t'arrijtur në Shqipërin e Veriut.

Ne dinim se Lëvizja Nac.Çl. ishte përhapur në krejt Shqipërin e Jugut, ndërsa n'atë të Veriut, gjer në këtë kohë, nuk kish mundur të hidhte baza, për këta arsye Fultzi mendoj që djemt e vilës të shkonin në Veri, mbasi këtu politika amerikane do të gjente fushë të lirë veprimi për të realizuar qëllimet e saj. Fultzi vendimin e tij që t'i niste shqiptarët nga ana e Jugosllavis për në Shqipërin e Veriut ja tha Spiro Ruços, i cili përfaqsonte grupin e tërë dhe u vendos që të bëj nji marëveshtje me misionin jugosllav për të bërë këtë udhtim. Bisedimet me Misinin Jugosllav i bëri Spiro Ruçua me Vasil Lazarin, pastaj u vuen në dijeni edhe Galip Hatibi, Spiro Dhima dhe Sinan Gjoni. Këta do të niseshin si partizanë shqiptarë dhe si të hynin në Shqipëri do të binin në kontakt me misionet amerikane, që ishin në Shqipërinë e Jugut, prej të cilëvet do të furnizoheshin me radio edhe materjalin që u-nevojitej edhe mbasi të merrnin

pëlqimin e Shtabit të Përgjithshëm të Lëvizjes Nacjonal-Çlirimtare, do të fillonin nga puna që u-ishte ngarkuar, dhe do t'na mbanin në korent të ngjarjeve në Shqipëri.

Fultzi e kishte biseduar këtë çështje, më parë me superiorët e tij në S.B.S. dhe pat marrë pëlqimin e tyre.

Kur do të niseshin djelmët për në Shqipëri nga ana e Jugosllavis Fultzi u mbajti një fjalim përcjellës, duke u thënë se ky udhtim ishte krejt me vetë-dashje dhe se ata që s'donin të niseshin tani, do të çoheshin prapë në kampin nr. 1 të refugjatëve. Pastaj shtoj se, amerikanët kan qenë miqt e Shqipërisë dhe shpresojnë të bëhen akoma më të fortë; kjo dipendonte në shqiptarët e vilës që i patën njohur mirë dhe në punën që ata do të bënin në Shqipëri për të përforcuar këtë miqësi. Shqipërija, tha, do të shlirohet dhe do të lihet e lirë të vet-vendosë fatin e saj, në bazë të Kartës Atllantikut. Por, vazhdoj të thotë Fultzi, mos harroni se, stabilizimi i paqës nuk ësht fort i thjeshtë dhe mua më duket se Shqipërija ka për të patur nevojë për miqë në Konferencën e Paqës. Ne do të qëndrojmë miqt e Shqipërisë, po të na konsideroni si miq dhe po të keni relacione të mira me ne. Juve, tha që po nisi tani mund të bëni shumë për të përforcuar miqësinë midis amerikanve dhe vendit t'uaj.

Përgjigjen n'emër të grupit ja dha Sinan Gjoni, duke e siguruar Fultzin se, ata do të bëjnë ç'ësht e mundur për të përforcuar miqësin midis Shqipërisë dhe Amerikës dhe mësimet që ishin marrë në vilë nuk do të shkonin kot. Pastaj e falenderoi Fultzin për mirëmbajtjen e tyre nëpër vila, gjë që e konsideronin si një gjest bujar t'Amerikanve ndaj Shqiprisë.

U nisnë për në Shqipëri 22 veta dhe mbetën këtu 11-të, të cillët ishin: Kol Berisha, Merushe Topulli, Adem Derhemi, Qazim Hoxha, Riza Leka, Sotir Kuneshka, Osman Shehu, Ali Alija, Haxhi Braja, Haki Harvati, Koço Gjika, Vasil Llazari (këtë e lanë përfaqsonjës ata që ikën), Et-hem Beluli dhe Preng Shkoreti. Veç këtyre u kthyen në Bari nga ata që u nisnë: Qani Katroshi dhe Fadil Kartusha. Këta që mbetën i çova unë prap në kamp, por më vonë iknë përsëri dhe zun punë në vende të ndryshme në Bari. Vangjel Kiriazi propozoj që këta të mbaheshin akoma në vilë, por në këtë kohë vila u mbyll.

Personat që u nisnë nuk muarrën të holla me vehte, që të mos binin në sy të jugosllavëve dhe të mos ekspozoheshin si të dërguar nga Amerikanët.

Mbasi arritën në ishullin "Vis" kishin nevojë për të holla dhe ushqime të tjera, veç atyre që merrnin nga jugosllavët, por dega e S.B.S. që ishte këtu s'kishte dijeni fare se ç'po bëhej dhe për këtë arsye s'mund t'i ndihmonte.

Pas nja dy javësh u kthye Galip Hatipi në Bari, i cili u takua me disa nga djemtë që kishin mbetur aty, si Adem Derhemi, Et-hem Beluli, Ali Alija, Vasil Lazari etj. Mua më takoj n'apartamentin tim ku më kërkoj dhe disa tesha për t'u veshur, si mori teshat kërkoj të takohet me Fultzin dhe unë e drejtova në zyrën e këtij të fundit. Mbasi bisedoj me Fultzin mori nga 500 lireta për shok dhe nji rekomandim për S.B.S. e ishullit "Vis", prej të cilit mund të furnizoheshin me sendet që kishin nevojë. Nga ana tjetër Fultzi lajmëroj në "Vis" për të vërtetuar rekomandimin dhe se kjo çështje duhej të mbahej sekrete.

Nji javë pas këtij udhtimi Galipi u kthye përsëri në Bari, për të marrë instruksione se ku mund të takoheshin me misionet amerikane në Shqipëri mbasi po bëheshin gati të niseshin menjiherë. Këtij i tha Fultzi se, po të kishte ndonji element që donte të ndahej nga grupi për arsye të ndryshme, mos e lini posht e lart por t'a ktheni në Bari. Kjo masë duhej të merrej për të mos u dekonspiruar puna që i ishte ngarkuar grupit që po vinte në Shqipëri.

Fadil Kërtusha dhe Qani Katroshi, mbasi shfaqën arsye shëndetsore për mos mundjen e vazhdimit t'udhtimit, i kthyen përsëri në Bari. Këta të dy na thanë se edhe Galipi pat qenë i sëmurë por prap rezistonte. Gjithashtu na thanë se ishin vrarë disa në nji përpjekje me gjermanët, por nuk dinin se cilët ishin ata që u vranë.

Arritjen e grupit në Shqipëri na e lajmëroj Thoma Stefani, kryetar'i Misionit Amerikan në Shqipëri. Ky lajmëroi se kishin arrijtur nji grup, por nuk dinte cillët ishin dhe sa ishin. Më vonë lajmëroj përsëri se kishin arrijtur 16 persona, katër ishin vrarë rrugës dhe dy ishin kthyer përsëri në Bari.

Mbas nja dy javësh Thoma Stefani na lajmëroj se kishte takuar n'Odriçon Sinan Gjonin dhe Galipin ose Spiro Ruçon (s'e mbaj mend mirë) dhe se këta i kishin raportuar mbi udhtimin dhe se cillët ishin vrarë. Njikohësisht ky thoshte se grupi ishte shpërndarë nëpër brigata të ndryshme, kështu që plani i mëparshëm, që Toni do t'i organizonte në grupe të vegjël dhe do t'i furnizonte me radio, falimentoj.

Djemt që kishin mbetur në Bari vinin dendur në zyrën e Fultzit, sidomo Adem Derhemi, i cili mbante lidhje me vetë Fultzin dhe Qazim Hoxha e Riza Leka takoheshin me Stevens. Të gjithë këta që mbetën në Bari u mblidhnin gjithmonë në shtëpinë e Kol Berishhës, i cili bënte nji jetë modeste. Se nga i kishte këto të ardhura nuk e dij, por dij se Asim Jakova me Kol Berishën dhe Merushe Topullin kishn miqësi të ngushtë dhe flitej se ky u jepte të holla. Nga ana tjetër dhe Xhemal Farka vinte gjithmonë në shtëpin e Kol Berishës.

Nuk shkoj shum kohë dhe Englezët muarrën në shërbimin e tyre Adem Derhemin dhe Osman Shehin, k,urse Haxhi Brahja iku me englezët për n'Afrikë. Dij gjithashtu se Kamber Elmazi (Ali Jashari) dhe Stevens kan qenë gjithmonë në kontakt me djemtë. Nja dy javë pasi u lirua Roma, Fultzi më ngarkoj të shkonja për në Romë dhe të shikonja se kush ishte nga shqiptarët aty, njikohësisht të shkonja në Ministrin e Jashtme Italiane, për të parë nëse kishte dokumenta rreth Shqipërisë, do të kërkonja libra dhe dokumenta të tjera nëpër entet turistike etj.

Në Romë u prezantova në zyrat e O.S.S., që sa po kishin zën vend në Legatën Kroate. Komandant ishte N/Koloneli Koch, i cili ishte transferuar nga Bari. Këtu takova dhe McAdoo, i cili tani punonte në seksjonin për Italin S.I.

Pasi më dhan nji automobil në O.S.S. dhe nji shofer roman, unë fillova ttakonj shqiptarët. Të parin që takova ishte Mehmet Konica, i cili banonte në nji apartament në Via Colina bashkë me Dr. Qmal Jusufatin dhe të shoqen e këtij.

Para se të nisesha për në Romë, porosit konkrete që më dha Fultzi ishin këto: Të shifnja se kush nga shqiptarët ishte në Romë, pse ishin dhe çfar mendonin për Shqipërin, nga ana tjetër ç'mendonin këta të bënin; mbaj mend që më tha: Të mos

zgjerohesh në bisedime, por të gjejsh Mehmet Konitzën dhe t'i tregosh në fraza të përgjithëshme tentativat që ishin bërë përjashta Shqipëris, për t'i bashkuar gjith Shqiptarët në nji front politik me qëllim që të delte një përfaqësi në botën e jashtme dhe se kjo gjë përkrahej nga Amerikanët. Do t'i thosha gjithashtu se gjendja në Shqipëri ishte e vajtuarëshme, me qenë se ekzistonte vlla-vrasëja dhe tentativat e Anglo-Amerikanve për t'i bashkuar, nuk kishin dhënë ndonji frut, për arsye se gjakërat ishin të ndezura dhe se, për t'a neutralizuar këtë gjendje anormale, mund të ndihmonin shqiptarët e mërguar, duke u paraqitur si të bashkuar pranë Aleatve, prej të cillëve do të merrnin këshilla se si duhej vepruar.

Unë i bisedova këto sende vetëm ne Konitzën dhe ay më tha se, kish ndërmend të vinte në Bari që të bisedonte me autoritetet anglo-amerikane personalisht.

Kur i thashë se vinja nga Amerika, Mehmeti menjiherë më pyeti rreth vdekjes së të vllait, Faikut. Ky më tha gjatë bisedimeve se, Mehdi Frashëri, në fillim, qëndronte shumë mirë dhe i këshillonte të rinjt shqiptarë, që të vinin në Shqipëri dhe të luftonin; por më vonë erdhi i biri Vehbiu, në Romë dhe që prej asaj kohe e ndrroj pllakën duke thënë se, Shqipnija nuk mund të bëhej me llustraxhit. Bashkë me të birin filluan të frekuentojnë legatën gjermane në Romë dhe më në fund u nis për në Shqipni, ku formoj dhe regjencën e mir-njohur. Konitza filloj të shpjegoj mbi çmendësin e Mehdi Frashërit, duke thënë se ay ka qenë në çmendinën e Stambollit nja dy herë. Të njëjtën gjë pata ndigjuar dhe nga i vllai, Faiku.

Kur e pyeta Mehmet Konitzën se ç'mendonte ay për luftën që bëhej në Shqipni, më tha se ishte nji gjë shumë e mirë, mbasi nji popull që s'lufton për Indipendencë, nuk ësht i denjë të ketë indipendencë, porse nuk i pëlqenin përçarjet që ekzistonin në Shqipëri. Ay ishte i mendimit se, Mehdi Frashëri kontribuojë edhe më shumë në luftën vlla-vrasëse, duke mashtruar që t'a pasonin nji pjesë e shqiptarvet, që kujtonin se Mehdiu ishte me të vërtetë patriot i sinqert.

Në bisedimet rreth kërkesavet greke mbi Shqipërinë e Jugut, ay filloj t'i shajë grekërit, por shfaqi shpresa se mund të frenoheshin nga Englezët dhe Amerikanët, po t'a kishin punën mirë këta. Në këtë bisedim e sipër ay më dha edhe disa dokumenta rreth kërkesave absolute greke, në gjuhën Italisht të shkrojtura nga nji grek.

Qemal Jusufati u shpreh haptas kundra Lëvizjes Nacional-Çlirimtare e s'pushoj gjersa i hoqi vrejtjen Mehmti duke i thënë: "Filloj ciceroni".

Pastaj e pyeta për Zef Seregjin, i cili më tha se atij i ishte shfaqur si anti-Zogist, porse nuk përzihej me shqiptarët dhe as që dilte përjashta, me qenë se ishte kompromet uar shumë si me Ittaliaanët ashtu dhe me Gjermanët, me të cillët kishte miqësi të ngushtë – e shoqja bënte gostira për Gjermanët mbasi ishte Austriake.

Për Ernest Koliqin më tha se kishte shkuar në Veri t'Italis me Gjermanët; po ashtu edhe i biri i Vërlacit me gjithë që nuk ish përzier në politikë.

Po atë ditë e takova edhe Zef Seregjin, të cilin e pashë se u trondit kur i thashë se isha zyrtar Amerikan dhe më priti me nji nervozitet të dukshëm. Kur e pyta këte se ç'mendonte për çështjen e Shqipëris, ay m'u përgjegj automatikisht: "Shqipërin vetëm Zogu mund t'a shpëtoj".

Në këtë kohë erdhi Kiço Karajani, i cili më kërkoj shpjegime, se ç'qëndrim mbanin Aleatët kundrejt Lëvizjes Nacional-Çlirimtare. Unë ju përgjegja thjeshtë dhe sikundër na kishin instruktuar në zyrë, se Aleatët përkrahnin ata që luftojnë. Karajani m'informoj se, në Romë, shqiptarë kishin formuar nji far Fronti, në të cilin përmblidheshin të gjithë shqiptarët dhe se Mehmet Konitza ishte zgjedhur kryetar. Për t'a zgjeruar organizimin e këtij fronti ishte nisur për në Bari Petro Marko dhe Ymer Sharra. Qëllimi kryesor i Frontit ishte që të grumbulloheshin sa më tepër shqiptarë dhe pastaj të paraqiteshin përpara Aleatëve si nji grup i organizuar në mënyrë që të përfitonin prej tyre ndihma materiale dhe më vonë të ndihmoheshin politikisht. Në këtë Front bënin pjesë si nji pjesë e madhe fashistash të falimentuar si p.sh. Xhemil Dino, dhe elementa të tjerë të këtij kalibri.

Në fund Karajani më pyeti nëse ishte e mundur të ndërhynja pranë Autoritetevet Aleate, në Romë, që t'u jipnin shqiptarëve të Romës ushqim dhe ndihma të tjera. Unë i dhashë drejtimin e D.P.B., ku mund të paraqiteshin si organizatë që ishin. Po prej Kiços mora dhe adresën e Dhimitër Beratit.

Dhimitër Beratin e takova në shtëpin e tij; kur po bëhej gati të shkonte për në bankë. Pasi u prezantova, më ftoj që të vinim bashkë në bankë ku, tha ay, po e prisnin Shqiptarët, që t'u jepte ca para. Më shpjegoi se si ky përpiqej të ndihmonte shqiptarët që kishin mbetur udhëve. Ky u jepte nga 200-300 lireta herë mbas here. Kur e pyeta mbi burimin e këtij fondi, ay m'u përgjegj se, Qeverija Shqiptare, pat dërguar nji mision financiar në Romë, i përbërë prej tij, si kryetar, antarë: Ymer Fortuzi dhe Dr. Gjini. Kur pyeta disa shqiptarë se si ishte historija e këtyre pareve, një djal i ri më tha se, kur i shpërndante këto pare në kohën e gjermanve, Dhimitë Berati, u thosh që vinin nga bujarija dhe shpirt-mirësija gjermane dhe prandaj duhet t'u jemi mirnjohtës atyre.

Pas dreke shkova dhe tek Ymer Fortuzi, por nuk e gjeta. Prej këtu vajta në Albergo de Gasperi, ku më priste Kiço Karajani dhe Hito Sadiku. Ky i fundit kërkoj të bisedonte me mua, por unë mbasi e njifnja mirë se kush ishte prej veprave të tija fashiste që ka bërë gjatë kohës që ka qenë n'Amerikë, i thashë se s'kisha kohë. Hito Sadiku pat tentuar të hynte në kontakt me Anglo-Amerikanët dhe në këtë pikë kishte patur sukses pse qëndrimi i tij në hotel de Gaspari, ku banonin dhe Amerikanët, tregonte haptë se ky ishte nji vegël e tyre dhe kjo provohet, pse në këtë hotel me përjashtim t'Amerikanvert nuk mund të banonte asnji i huaj. Në hotel Hitua kishte edhe nji zyrë, mbasi ky ishte ndërlidhësi i grupit të shqiptarvet me Anglo-Amerikanët. Këtu takova dhe Ferid Dervishin ish deputet i Zogut, i cili foli me sinqeritet dhe pa dredhi duke thënë: "Unë kam qenë Zogist dhe qëndroj Zogist".

Të nesërmen në mëngjes vajta në Ministrin e Jashtme Italiane dhe u drejtova në Zyrën për punët e Shqipnis. Këtu gjeta nji oficer Englez dhe Asim Jakovën, të cillët po mblidhnin të gjitha aktet rreth punëve të Shqipnis. Oficeri Inglez më tha se duhet të merrnja leje më parë nga Ministri i Jashtëm, pastaj të hynja n'atë Zyrë. Unë vajta menjiherë te zëvendës Ministri, Conte Vidò dhe i kërkova nji autorizim për të parë aktet e zyrës për Shqipnin, por ay më tha se kjo gjë i dukej e tepërt, mbasi ay pat

autorizuar disa persona t'Aleatvet për të shkuar n'atë Zyrë. Prej insistimit t'im, m'a dha autorizimin, por kur vajta unë në Zyrë, Asim Jakova dhe oficeri Inglez, kishin marrë ç'do dokument, kështu që nuk mora asgjë. Si kujdestar i kësaj Zyre ishte akoma një shqiptar, i quajturi Ludovik Jakova.

Kur u ktheva prapë në zyrat e O.S.S. të Romës, më lajmëroj nji zyrtar se në Romë gjendej një n/kolonel italian, Tomasso Gilardi, i cili kishte njohtuni të shumta mbi Shqipnin. Ky amerikani më çoj tek Giraldi dhe pasi më prezantoj, Gilardi më tha se kishte qenë në Shqipni për herë të parë më 1924 dhe pas kësaj kohe ka qenë dhe shum herë të tjera. Kur u emërua Gjeneral Pariani si mëkëmbës, ky kishte qenë sekretar partikular i tij. Nga bisedimi që pata me këtë person, kuptova se ky e njifte mirë Shqipnin dhe veçanërisht Tiranën. Më tha se i pat vajtur edhe Asim Jakova nji ditë më parë, porse ky nuk e kishte pranuar. Për Asimin më tha se është tepër i zgjuar dhe din t'a lozë mirë rrolin e tij, gjer dje, tha, punonte për ne dhe tani punon pë Inglezët. Pataj më foli për Koliqin dhe shumë zyrtarë të naltë, që kishin qenë të paguar nga Italianët. Më tha si subvencionin gazetat e Tiranës, për të shkrojtur në favorin e fashizmit Italian etj. Gjithashtu më tha se, edhe Çekrezi pat marrë pare nga 'ta, por tek ky s'kishin besim se shkruante nji artikull në favorin e tyre dhe pastaj u a kthente kundra; është njeri i pa qëndrueshëm më tha. Më foli për kryengritjen e Totos, e cila ishte e inspiruar dhe e furnizuar në të holla nga Italianët, po të njëjtën gjë më tha dhe për Lëvizjen e Fierit.

Në lëvizjen e Fierit, tha, kishim gisht edhe neve me disa persona, por sidoqoftë, vazhdoj të thotë, çdo kryengritje ishte në favorin t'onë, mbasi ne donim shkak që të plotsonim konditat e traktatit të Tiranës, të cilat na detyronin të hynim në Shjqipni, po t'a shifnin të nevojshëme për të stabilizuar rregull dhe qetësi. Ay tha që motoskafin që shpëtuen udhëheqsit e kryengritjes së Fierit e patën dërguar këta vetë në bregdetin Shqiptar dhe më vonë kur u burgosën në Bari Çekrezi me shokë, dha urdhër Pariani që të lirohen me konditë që të largohen nga Italija.

Për Fortuzin, ky foli shum keq, e quajti hajdut me çizme dhe pastaj më informoj se bashkë me misionin financiar të Dhimitër Beratit, në Romë pat ardhur dhe nji agjent i Gestapos, Gjerman, i cili fleti dy net n'apartamentin e Fortuzit. Gilardin e pashë edhe njiherë tjetër, i cili më premtoj se do të më çonte tek Gjeneral Azzi, i cili posa kish dalë nga Shqipnija, por nuk e takova për arsye se unë isha i zënë me punë të tjera.

Të nesërmen vajta në zyrën e Sigurimit dhe të kundër-spiunazhit Amerikan në Romë, që kryesohej nga nji Major dhe i dhashë disa emëra kuislingësh, për t'i arrestuar, si dhe Dhimitër Beratin, Zef Seregjin, Ymer Fortuzin, Dr. Gjinin dhe Xhemil Dinon, por mora vesht në Bari se nuk ishte arrestuar asnji nga këta. Pastaj vajta në Zyrën turistike për Shqipnin, por s'gjeta asnji shenjë zyre, këtu kish hyrë nji familje Italiane për banim. Nëpër librarit gjeta mjaft libra mbi Shqipnin si dhe rivistën "Albania", për të gjitha pagova 1000 lireta.

Pas pes gjasht ditve u ktheva në Bari dhe bisedova me Fultzin mbi të gjitha këto, i cili më tha të shkruanja nji raport. Këtë e bëra dhe ja dorzova Fultzit.

Nuk shkuan tri ditë, mbasi u ktheva unë në Bari, kur shof Mehmet Konitzën, që hyri më parë ne Inglezët dhe pastaj u kthye ne Fultzi, me të cilin bisedoj mjaft. Ky pat ardhur me aeroplan Inglez, me gjithë që për civilat jo me punë zyrtare ishte e ndaluar të udhtonin me aeroplan. Inglezët i patën angazhuar një apartament në Bari, ku përkujdesej një shërbëtore italiane. Mua më shpuri tek Konitza Petro Markua, ku gjetëm mjaft shqiptarë, midis të cilëve mbaj mend Kol Berishën, Merushe Topullin dhe Xhemal Farkën. Ndenja fare pak dhe dola. Pas disa ditësh Mehmeti shkoj prap për në Romë.

Petro Markua me Ymer Sharrën me t'ardhur nga Roma në Bari, filluan t'organizojnë Frontin, duke përmbledhur të gjithë elementat që ndodheshin aty dhe u patën dërguar lutje Anglo-Amerikanvet, që t'u jepnin vesh-mbathje ushtarake, për ata që dëshëronin të luftonin, ushqime për të gjithë, lehtësira për stërvitje ushtarake, lehtësira që të ktheheshin në Shqipëri dhe zyra në Bari dhe gjetkë, ku kishte shqiptarë, që kështu të grumbulloheshin të gjithë. Në këtë kohë erdhi në Bari Misioni i parë Shqiptar, nën kryesin e Bedri Spahiut dhe të gjithë format e tjera organizative muarrën fund dhe filloj Bedriu vetë t'i udhëzoj se si duhej vepruar, duke u shpjeguar edhe gjendjen reale në Shqipëri. Delegacioni Shqiptar, që erdhi në Bari për të bërë një marëveshtje ushtarake me Komandën e Mesdheut, u strehua n'Albergo Imperiale. Këtu banonte dhe N/Koloneli Palmer, kapiteni Thoma Stefani dhe Majori Oliver, i cili kish nën-kujdes antarët e Misionit. Në koridorin para dhomave ku banonin antarët e Delegacionit Shqiptar, qëndronin dy policë ushtarakë Inglezë, të cilët ndalonin çdo person që donte të kalonte asaj ane. Në rastë se nji person donte të takohesh me ndonji nga antarët e Misionit, do të regjistrohej në rregjistrin e dy policave, të cilët do të lajmëronin majorin Oliver. Mvarej tek ky nëse mund të takohej njeri me Misionin. Me sa dij unë, Amerikanët s'kishin të bënin fare me kujdestarin e Misionit. Unë u takova me Misionin dy ditë pasi erdhi në Bari. Për këtë gjë mora leje nga Fultzi. Nuk e dij si do të sillej Oliveri me mua, mbasi me të hyrë unë në koridor dhe po më pysnin policët, dolli Baca (Ramadan Çitaku), i cili më njohu menjiherë dhe më mori mbrenda. Gjer në këto kohë Misioni s'kish patur mundësi të takohej me ndonji shqiptar dhe as që ishte lejuar të delte jasht fare. D.m.th. se n'emër të "Sigurimit" ata pengoheshin të takoheshin me Shqiptarët.

Herën e dytë që u takova, më pyeti Baca nëse kish shqiptarë në Bari dhe kush ishte. Unë i them se mund t'a vinja unë në kontakt me shqiptarët, po të mos thoshte gjë Oliveri. Baca m'u përgjegj "po, pse a jemi të burgosur neve? Ec mor dalim". Dhe duallëm në mbrëmje bashkë me Bacën dhe shkuan në shtëpin e Kol Berishës. Oliveri s'kish dijeni se ç'ngjau, por pas pak vjen nji ushtar Inglez atje ku ishim dhe thotë se ishte urdhëri i Oliverit që të ktheheshim në hotel. Si e gjeti shtëpin ushtari nuk e dij, por besoj se mund të ketë lajmëruar Kol Berisha me ndonji mënyrë. Bashkë me Bacën u kthyem në hotel. Seç-ngjau më vonë me Oliverin nuk e dij. Mua më hoqën vrejtjen me anën e Zyrës s'onë, që e nxorra Bacën jasht pa lejen e Oliverit.

Pas nja dy javësh delegacionin shqiptar e lanë të lirë, por kurdoherë që delnin jasht ishin të shoqëruar nga Oliveri vetë ose nga nji kapiten Inglez emëri i të cilit nuk mbjen ndërmend.

Si iku Delegacioni Shqiptar, erdhi Kadri Hoxha, të cilin Englezët e shpunë në një vilë larg fare, me qëllim që të mos takohej me shqiptarët dhe i suellën shumë pengesa të tjera për punën e radios, bile, Ëaterous-i i kërkonte dhe shifrën.

I pari Mision Amerikan që ka ardhur në Shqipëri ka qenë ai i McAdoois dhe që kishte si pjestarë Ismail Karapicin dhe nji radio-telegrafist Fraser, i cili me qenë se u sëmur iku dhe në vend të tij vajti Nick Cooky.

McAdoo-i kishte urdhër që të shkonte për në Martanesh si ndërlidhës Amerikan, ku ishte dhe Gjeneral Davies, por ky me kokë të vet, ndenji në qarkun e Vlorës, me bazë në Spile, ku qëndronte nji ndërlidhës naval Inglez. Kjo bazë ishte si port hyrje për në Shqipni. U diktua nga gjermanët dhe u sulmua nja dy herë, gjë që rezultonte në ndrrimin e saj, por gjithmon aty afër. Nga fundi i Nëndorit, kohë kur hyri ky mision i parë Amerikan në Shqipni, McAdoo-i filloj të hyj në kontakt, me anmë të Ismail Karapicit që shoqnonte që nga Bari, me element ballistë dhe me ndihmën e Xhelil Çelës nga Dukati, nji nxënës i teknikës, familja e të cilit ishte bërë si bazë për Anglo-Amerikanët dhe shpesh herë dhe për gjermanët, pse kishte qilluar shum herë që në nji dhomë rrinin Anglo-Amerikanë dhe në nji dhomë tjetër Gjermanët. Xhelil Çela e vuri McAdoo-in në kontakt me Skënder Muçon, përfaqsues i Lumo Skëndos, me të cilin vazhdoj bisedime të gjata rreth gjendjes së Shqipnis. Njikohësisht ndihmohesh edhe nga Hodo Metua, nji teknikas tjetër, i cili pat zgjeruar edhe më tepër kontaktet e McAdoo-it mbrenda në Vlorë dhe në rrethet.

Kur lajmëron McAdoo-i në S.B.S. se po qëndronte në Spile, me qenë se aty kishte mundësi të mblidhnin informata të vlefëshme rreth gjendjes së Shqipnis dhe rreth forcave gjermane t'okupacionit, major Coon i hoqi vrejtjen dhe e urdhëroj përsëdyti që të vepronte simbas direktivave, d.m.th. të nisej për në Martanesh, ku mungonte ndërlidhja Amerikane. McAdoo-i pëgjigjet se, një mejtim i tillë, ishte i pamundur për shkak të dimërit të madh që e bënte të pa-mundur kalimin e lumenjve dhe të maleve. Por e vërteta u kuptua më vonë: Ay ish këshilluar nga Skënder Muçua dhe shokët e këtij të fundit, që të rrinte aty. Këta kishin zënë një miqësi të ngushtë ndërmjet tyre dhe merreshin vesht mirë pse që të dy kishin bërë studimet e larta n'Itali.

Në këtë kohë, aty nga fillimi i Dhjetorit, kishte ardhur dhe Fultzi në Bari i cili pat marrë kryesin e zyrës S.B.S., për Shqipnin si të S.O. ashtu edhe të S.I., me qenë se majori Coon u sëmur dhe u dërgua në Ëashington. Edhe Fultzi e urdhëroj McAdoo-in që të nisej për në Martanesh, por mori të njëjtën përgjigje që kishte marrë edhe majori Coon.

Fultzi u qetësua pak, kur erdhi posta e parë e McAdoo-it. Ky kishte mbledhur me ndihmën e Xhelil Çelës, Ismail Karapicit, Hodo Metos dhe tjerëve, shumë informata të vlefëshme rreth pozitave dhe forcave gjermane, gjithashtu dhe rreth gjendjes në Shqipni, të cilin ja pat spjeguar Skënder Muçua. Pat dërguar nji plan të qytetit dhe rretheve të Vlorës, të cilën japat dhënë nji Ing. i Botores së Vlorës, me të gjitha pozitat ushtarake gjermane, nji numur traktesh dhe gazetash të ndryshme, urdhënesa të Komandaturës Gjermane e tjera. Gjithashtu edhe nji letër nga Skënder Muçua që i drejtohej Komandës Amerikane në Bari. Skënder Muçua kërkonte njohje zyrtare

për Ballin, të cilën e quante nji organizatë moderate dhe që përfshinte shumicën e popullit Shqiptarë, nji organizatë që ishte gati të hynte në marëdhënje të ngushta me Anglo-Amerikanët dhe të vepronte si të këshillohej nga këta. Kërkonte ndihma ushtarake dhe të lejohej nji delegacion Ballist që të dilte në Bari për nji marëveshtje me Anglo-Amerikanët. Ay thosh se ata po luftonin kundra okupatorit, porse pengoheshin nga forcat Komuniste të cilët po përpiqeshin të siguronin më tepër fuqin politike për t'ardhëmen.

Me qenë se radio-telegrafisti që kish marrë kish marrë me vehte McAdoo-i u sëmur, erdhi në Bari dhe në vendin e këtij u dërgua Nick Cooky.

Nga fundi i Dhjetorit 1943, Fultzi vendosi të dërgoj me mision në Shqipni Hasan Reçin, Foto Veshon dhe Niko Kavaçin, të cillët do t'a udhëhiqnin McAdoo-in për në Martanesh. Hasani ishte i sigurt se mund t'udhtohej në këtë drejtim, mbasi ishte marrë vesht me disa udhëheqës të Lëvizjes Nacional-Çlirimtare në qarkun e Vlorës. Hasani me shokë erdhi në Shqipni me 1 Janar 1944. McAdoo-i e kundërshtoj Hasanin që të niseshin për në Martanesh, kështu që ky u nis vetëm me dy shokët e tij. Gjat kohës që ndejti në qarkun e Vlorës Hasani dërgoj shumë trakte të Lëvizjes Nacional-Çlirimtare dhe dy raporte mbi gjendjen e mbrendëshme të Shqipnis.

Pas nja dy muajsh, McAdoo-i u kthye në Bari për konsultim. Ky i shpjegoj Fultzit dhe autoriteteve më të larta arsyen që ish shtrënguar të qëndronte në Spile, arsyeja e parë ishte dimër i madh dhe e dyta se këtu ishte nji bazë e mirë për të mbledhur të gjitha informatat e nevojshme për Shqipnin. Me gjithë që komanda Amerikane, në fillim i hoqi vrejtjen për shkeljen e urdhërit, pastaj Fultzi me superiorët e tij u bindën se McAdoo-i u kish sjellë shërbime të mëdha informative dhe ndërlidhjeje, për këtë arsye vendosën që ky të këthehej prap në Spile për të filluar nga aktiviteti i tij. U vendos që në Martanesh të dërgohej një mision tjetër me të gjetur personelin e përshtatshëm. McAdoo-i, u nis për në Shqipni, por u sëmur në vapor dhe u kthye. Pas nji pushimi të gjatë në Kairo, u kthye n'Itali por nuk ishte më në zyrën për punët shqiptare; hyri në zyrën për Italin, në Romë, në degën S.I. Kështu që për nji kohë mbeti Nick Cooky vetë gjersa u dërgua kapiteni Hudson, i cili bënte udhtime të shpeshta midis Spiles dhe Barit, bashkë me Xhelil Çelën. Kur erdhi McAdoo-i në Bari, ay filloj të flasë kundra Lëvizjes Nacional-Çlirimtare dhe në favor të Ballit Kombëtar, dyke shfaqur një simpathi të madhe për Skënder Muçon. McAdoo-i thoshte se, Amerikanët duhej të përkrahnin Ballin, me qenë se këta ishin me të vërtetë pro-Amerikanë dhe gati të lidhnin nji miqësi zyrtare, e cila do të vazhdonte edhe në t'ardhëmen. Ay ish i mendimit që të mos i jepej asnji ndihmë Lëvizjes Nc.Çl., me qenë se ishte nji front krejt Komunist, në favor të Bashkimit Sovjetik dhe aspak pro-Amerikan dhe se ata po manovronin vetëm për të pushtuar fuqin politike në t'ardhmen.

McAdoo-i kishte konstatuar, përsë-afërmi se Balli Kombëtar ishte në bashkëpunim me Gjermanët, por këte e justifikonte duke thënë se ishte e nevojshëme për këtë bashkëpunim për ca kohë dhe se fundja gjermanët do të hiknin nga Shqipnija dhe kështu do të mbeteshin ballistat në pozitat kyç. Ata janë kundra gjermanve, thosh ay, i luftojnë me ç'do mënyrë kur gjejnë rast, por njikohësisht dijnë të qëndrojnë

edhe midis tyre. Këte ay e quante nji zotësi dhe sukses politik për Ballin. Me këtë mënyrë thosh ay, ne jemi në pozita t'informohemi fare mirë rreth gjermanve me anë të miqve ballista. Me këtë mënyrë, shtonte ay, ne jemi në midis t'armikut, i dimë të gjitha lëvizjet e tij dhe njikohësisht kemi dhe miqtë për t'ardhëmen. Këtë opinion ay e paraqiti edhe në Ëashington me anë të zyrave përkatëse.

Në Shkurtin e 1944-rës arrijti në Bari Thoma Stefani. Më parë ky ka qenë në G-2 (Inteligjenca e Ushtrisë Amerikane) dhe pastaj u muar në shërbim nga O.S.S. për në Shqipni.

Ky do të dërgohej në Shqipni, si ndërlidhës pranë Shtabit të Lëvizjes Nacional-Çlirimtare, po s'kishim radio-telegrafist. Nuk mbaj mend personin, i cili sugjeroj se dega O.S.S. në Napoli, kishte në dispozicion nji radio-telegrafist shqiptar dhe se mund t'a merrnim neve. Fultzi më dërgoj mua në Napoli për këtë punë, ku si radio-telegrafist më prezantuan Sali Dodën, por unë kuptova se ay nuk kishte dijeni fare mbi radio-telegrafin dhe uktheva bosh. Më vonë Sali Doda u dërgua në Bari dhe e mbajti Fultzi, të cilin dhe e stërvitnë ssi radio-telegrafist.

U vendos që Thoma Stefani do të merrte si radio-telegrafist Angelo Mitron, i cili jepte mësime në shkollën e Radios dhe pasi iku ky gjatë ofensivës së Verës, mori Nick Cookyn.

Thoma Stefani erdhi në Shqipëri vetëm si ndërlidhës, për të mbledhur informata rreth forcave gjermane dhe për të studjuar Lëvizjen Nc.Çl. Ndihma materjale mund t'i jepnin vetëm Inglezët, kur të kishin vendosur këta në konsultim edhe me Amerikanët.

Thoma Stefani (u shuan dy fjalë), veç mesazheve që dërgonte me anë të radios, dhe që unë z'dij se ç'përmbanin, se s'pashë asnjë prej tyre, dërgonte shpesh trakte, gazeta, broshura rreth të gjitha rrymave politike në Shqipni. Ay mori pjesë në Kongresin e Përmetit dhe dolli në Bari disa herë, për konsultim me Fultzin dhe autoritetet tjera.

Se çka raportonin këto misione, kuptohet nga dy raportet e Fultzit, që kam mundur t'i shoh, të cilat drejtoheshin për Washington.

Nga muaji Shkurt i 1944-ës kam parë nji raport konkluzion mbi gjendjen në Shqipni tepër kaotike, duke thënë se Lëvizja Nacional-Çlirimtare përpiqej më shumë për të siguruar t'ardhëmen se sa të luftonte okupatorin, duke i vënë nacionalistat në nji pozitë midis dy zjarresh, të cilët për të mos u likujduar shpesh herë shtërngoheshin të bashkoheshin me Gjermanët. Lëvizja Nc.Çl. thoshte Fultzi, ishte nji front Komunist me pasonjës të dehur nga premtime të shumta dhe të frymzuar me shpirtin internacionalist, që na shikojnë neve si miq vetëm për interesin e luftës dhe të tyren. Ay raportonte se të gjitha energjitë këtu po shkojnë kot, për shkak të Komunistave dhe do të jetë tepër vonë sikur të mos merret nji vendim që ose të pajtojmë të gjitha rrymat politike dhe t'i mbajmë në vij ose të përkrahim kundërshtarët e Komunistave. Kjo e fundit ka për të ndarë Lëvizjen Nac. Çl. në komunista të thjeshtë dhe n'ata që janë bashkuar si të dehur. Pjesa e dytë do të lidhet këtej duke parë se kanë përkrahjen t'onë. Kështu përfundonte në këte raport Fultzi.

Me rastin e Kongresit të Përmetit, Fultzi në nji raport shkruante kështu: Vonesa e jonë në vendime të prera i nxorri me sukses Komunistat. Këta formuan nji lloj Komiteti anti-fashist, që mund të quhet si Qeveri, me elementa Komunista në përgjithësi. Këta sigurisht dirizhohen nga Titua, duke parë se ç'simpathi tregojnë për këtë njeri. U konstatua nga misioni i ynë në Kongres se fryma e vërteta dirizhonjëse ishte prapa-perdes, ku fshihen organizatorët Jugosllavë t'Internacionales. Këta, tani, sigurisht, do të fillojnë të kërkojnë njohjen t'onë, duke na quajtur miq dhe Aleatë; por e vërteta është se, ata, janë armiq të t'onë dhe në rast se nxitohemi t'i njohim, atëhere do t'i sjellim dobi vetëm Stalinit. Ne duhet të tregohemi si miq dhe t'a shtyjmë njohjen sa të jetë e mundur, gjersa të skjarohet mirë çështja mbrenda në Shqipni.

Në Qershor ose Korrik 1944-tër, u dërgua në Shqipëri me mision edhe Kamber Elmazi, por ky s'u pranua nga Shtabi i Lëvizjes Nacional-Çlirimtare dhe u kthye në Bari. Po në këtë kohë u lëshua me parashut edhe Sali Doda me Vangjel Kiriazin. Saliu s'u pranua nga Shtabi i Lëvizjes Nacional-Çlirimtare, kurse Kiriazi ndenji gjersa u çlirua Tirana, ku kishte dhe t'emën.

Nga mesi i marsit 1944-tër, u nis edhe nji mision tjetër për në Shqipni, me qëllim që të kalonte në zonat e Lëvizjes Nacional-Çlirimtare, por dështoj. Ky mision, me kryetar Sinan Gjonin dhe pjestarë Haki Harvati, Haxhi Brahëja, Shate Dulla dhe Nikolla Bruka, zbarkoj në Spile, por u ndalua nga Ballistat që të kalonte në zonat e Lëvizjes Nacional-Çlirimtare, me gjithë ndërhyrjen e Misionit Amerikan duke i paraqitur këta si Shqiptarë në shërbimin Amerikan. Këtu mbetën edhe nji sasi materjali radiosh dhe teshat që kishin marrë ata me vehte. Shkaku që s'i lejuan të kalojnë në zonat e Lëvizjes Nac.Çl. ishte se një hoxhë nga Tragjasi, e njojti Sinan Gjonin dhe dha alarmin se Komunisti Sinan Gjoni ishte kthyer me disa shokë të tij. Këta u kthyen prap në Bari dhe po studjoheshin mënyra të tjera për të hyrë në Shqipëri.

Kur erdhi misioni i parë Shqiptar në Bari, si Amerikanët ashtu edhe Inglezët, filluan të tregojnë simpathi për Lëvizjen Nac.Çl. dhe këshilloheshin të gjithë zyrtarët e tyre që të shfaqnin simpathi për këtë Lëvizje. Këtë e bënin më tepër për të fituar besim përkundrejt Lëvizjes që të mund të penetronin mbrenda saj lirisht dhe kështu shpresonin të hidhnin renjë në 'te. Unë pata shfaqur simpathi për luftën Nacional-Çlirimtare që më parë dhe i para shkrojtur nga dy herë Mehmet Shehut, Mustafa Gjinishit dhe Myslim Pezës me gjithë që nuk e njifnja, të cilit i pata dërguar me Hasann Reçin një revole Colt dhe një letër. Mehmet Shehu dhe Mustafa Gjinishi më kthyen përgjigje, por mua s'më ranë në dorë.

Për delegacionin shqiptarë, i përbërë nga Bedri Spahiu dhe dy shokë të tij, Amerikanët u përkujdesuan mjaft, duke i furnizuar me vesh-mbathje dhe sende të tjera që u duheshin.

Kur erdhi Misioni Ushtarak permanent, Fultzi tregonte nji interesim mbi veprimtarin e tij dhe ishte gati që t'a ndihmonte. Kadri Hoxha e takonte Fultzin shpesh dhe para se të stabilizonte kontakt me Shtabin e Lëvizjes Nacional-Çlirimtare

me anë të radios tij, komunikonte me radion e S.B.S. me ndërmjetsin e Fultzit. Kur kishte nevojë për mjete transporti, Kadriu i kërkonte Fultzit dhe ky i jepte. Edhe oficerat e këtij misioni, Fultzi i furnizoj me vesh-mbathje oficerash dhe me sende të tjera personale.

Në Misionin Shqiptar në Bari rrinin shpesh herë këta persona: Irakli Leço, shqiptaro-amerikan, i S.B.S., Zogist i njohur mirë n'Amerikë, por që tani tregonte miqësi ndaj Lëvizjes Nc.Çl., se donte të vinte në Shqipni me mision dhe kur të stabilizohej paqa, të bënte tregti midis Amerikës dhe Shqipnis. Për çështjen e tregtisë më ka shkrojtur dy herë me anë të Misionit Shqiptar dhe i kam marrë letrat në Shtabin e Përgjithshëm. Ky u jepte sende të ndryshme si këmisha edhe të tjera gjëra vesh-mbathjeje antarve të Misionit që të fitonte simpathi kundrejt tyre.

Ahmet Kuçi, Shqiptaro-Amerikan, antar i S.B.S., edhe ky Zogist, bënte të njëjtën lojë se donte të vinte këtu me mision dhe më në fund të stabilizohej në Shqipni, mbasi të shoqen e ka këtu dhe pasurin n'Amerikë e kish shitur. Edhe ky u jepte sende të vogla, këmisha e të tjera gjëra antarve të misionit.

Sali Doda antar i S.B.S. mbasi u kthye nga Shqipnija, ku nuk e pranuan me mision, donte të vinte këtu si shqiptar i thjeshtë, filloj të vinte në mision për të rregulluar ardhjen. Ky e ka Kadriun kushuri.

Adem Derhemi, u stabilizua në Mision, mbasi e la punën që kish në zyrën e propagandës, dhe rrinte si roje-pritës, me qenë se dinte pak Inglisht, për të pritur vizitorët Englezë që vinin dendur këtu.

Xhemal Farka rrinte në mision dhe e para parë që ndihmonte Kadriun në punët e misionit. Kishte miqësi të ngushtë me Kadrin dhe më pat thënë se kishte aderuar në Frontin. Togeri i marinës, Jani Papajani, antar i S.B.S., e pashë të vinte në mision vetëm nji herë. ky ish kundra Lëvizjes Nacjonal-Çlirimtare.

Lush Pogu, që ishte Dr. i misionit, kishte miqësi edhe me Fultzin, kjo rridhte qysh në kohët e vjetra, që kur punonte për Rocke Feller Fondation n'Elbasan.

Kol Berisha, qëndronte vazhdimisht në mision, të cilit i kishte dhënë nji funksion zyrtar Kadri Hoxha.

Të gjithë këta mblidheshin shpesh mbrëmjeve në mision dhe bënin muhabet, duke pirë verë, duke kënduar dhe duke treguar eksperiencat e tyre. Këtu vinin edhe Njazi Bimi me Vait Maçin, Riza Leka, Irfan Hasanaj, Llambi Tavanxhiu me Hysni Sharrën, Xhelil Çela, Ali Alija i cili banonte aty dhe Sotir Kuneshka.

Unë kam qenë disa herë në mision kur rregullonin zyrat. Kam biseduar me Halim Budon, Kadri Hoxhën dhe elementa të tjerë të misionit. Njiherë i kam bërë një kërkesë Inglisht Kadri Hoxhës, që i drejtohej zyrës Ingleze, për automjete.

Relacjonet midis Amerikanve dhe Englezve me sa dij unë, kan qenë të mira, përsa u përkiste interesave të përbashkëta në luftë, por ka patur dhe divergjenca karakteri dhe kur vinte puna në interesat kombëtare respektive Inglezët silleshin pak si arrogantë kundrejt Amerikanve, duke i akuzuar se vepronin pa i studjuar punët mirë, kurse ata ishin në dijeni të plotë dhe të gjerë mbi gjendjen n'Jugosllavi ashtu edhe në Greqi dhe Shqipëri. Kjo gjë u konkretizua kur majori i S.B.S. Huct çoi

ndihmat e para n'Jugosllavi për partizanët, të cilin Inglezët e akuzuan për vjedhje dhe mos bashkëpunim.

Inglezët, me qëndrimin e tyre karshi Amerikanve, bën që Amerikanët të kujtojnë se ishin bishtrat e tyre. Më ka takuar rasti të takonj një oficer Amerikan që kishte qenë me mision në Greqi dhe ky ankohej se Inglezët ishin arrogantë, s'bashkpunonin dhe duke futur hundët shumë në punët e mbrendëshme të Greqisë, kishin shkaktuar vlla-vrasje. Në Shqipni, Inglezët preferonin më shumë Legalitetin dhe ndërhynin në punën organizative dhe i inkurajonin për aktivitet. Amerikanët e kishin synë tek Ballistat, gjersa u konstatua supremacija L.N.O. pastaj duhej me doemos të shfaqnin dëshirë bashkëpunimi me kta. Këtë mund t'a faktoj, se kur isha në Kairo më ra në dorë nji shenim i Stavro Skendit për Qemal Butkën. Ky thoshte: "Ju lutem të kini të bëni me Amerikanët më shumë, mbasi këta janë më të sinqert se sa Englezët".

Përsa u përket personave të ndryshëm që kishin të bënin me S.B.S., unë dij këta: Pavli Margariti, tani oficer, bënte pjesë në grupin partizan, por nuk ndenji në Vilë me qenë se vuente nga mushkëritë dhe Spiro Ruçua më tha se e kishte çuar në nji spital Italian, duke e marrë që nga kampi, mbassi u zotova unë se mund të paguanja 500 lireta në muaj për ushqime extra. Paret dhe konservat i merrnja unë në Vilë dhe ia jepnja Spiro Ruços t'ja dorzonte Pavlit. Edhe si iku në malt për klimë, unë e Spiro Ruçua i dërgonim nga koha në kohë racione ushqimi amerikan me anë të Misionit Jugosllav.

Sotir Kuneshka, ka ngrënë vetëm nja tre ditë në Vilë, e sillte Spiro Ruçua këtu, ashtu si kish sjellur dhe shumicën e djemve në Vilë.

Kuneshka banonte jashtë dhe mbante lidhje me Spiro Ruçon. Ky kishte miqësi me Stefan Treskën, me të cilin njifej përpara luftës dhe më duket se kan qenë kolegë si profesorë. Ky nuk pranoj të shkonte nga ana e Jugosllavisë.

Vait Maçi, nuk ka qenë në Vilë, por ishte në marëveshtje me Spiro Ruçon se donte të shkonte edhe ay me 'ta. Ky ka qenë n'ushtrin Italjane si oficer. Kur rrinte në Bari banonte në shtëpin e Kol Berishës.

Njazi Bimin e kam bashkuar në shtëpin e Kol Berishës, ku kam ndenjtur ca kohë. Kola m'a paraqiti si jo fort burrë të mirë. Për ardhjen e tij këtu, Bimi pat biseduar vetë me Bedri Spahiun.

Koço Gjika, ka qenë në Vilë ku ka marrë edhe mësime, por më në fund u qit nga Vila dhe u shpue në nji tjetër ku rrinin vetëm ushtarë Amerikanë, me kërkesë të Sinan Gjonit, Spiro Ruços, Galip Hatibit dhe Spiro Dhimës, këta insistuaan para Fultzit që ky element nuk mund të qëndronte në Vilë, midis shokëve, me qenë se kishte relacione me Ludovik Jakovën, i cili ishte dënuar me vdekje nga Lëvizja Nac. Çl. për tradhti. Fultzi nuk donte t'a nxirrte, por më në fund e hoqi, pasi më duket, se e investiguan edhe nga ana e tyre çështjen e Ludovikut.

Qefsere Begeja, e kam parë nja dy herë në kampin e refugjatve në Bari. Kjo kishte të bënte me Asim Jakovën, Xhemal Farkën dhe Irfan Hasanain. Këtë gjë m'a kan thënë disa nga djemt që ishin në Vilë.

Irfan Hasanain e kam liruar unë nga burgu i Brindisit bashkë me 16 shqiptarë të tjerë. Nuk e muarrëm në Vilë, me gjithë që ay dëshironte se pat thënë Galip Hatibi

dhe Spiro Ruçua, që ay ishte kundra Lëvizjes Nacional-Çlirimtare. Irfani punonte në Radio-Bari me Asim Jakovën dhe Xhemal Farkën.

Sali Doda, ka shyrbyer në zyrën e S.B.S., ku ndihmonte në punimin e kartave gjeografike dhe njikohësisht merrte dhe mësime në radio-telegrafi. Ky ka qenë në O.S.S. në Napoli dhe më duket se ka kaluar njiherë vijat gjermane me mision. Ësht i edukuar mirë dhe i zgjuar. Në zyrën e S.B.S. e mbajti n/kolonel Ëeile dhe Fultzi. Nuk e çuam në Vila "Azzone" se djemt e atjeshëm e njifnin si zogist dhe nuk e donin.

Spiro Ruçua si në kampin e refugjatve ashtu edhe në vilë, ka qenë si kryetar i të gjith djemve shqiptarë. Bisedimet më të shumta un i kam bërë me këte dhe ky vetë zgjodhi gjithë elementat që do të vinin në vilë.

Kur erdhi Hasan Reçi në vilë, i a dhanë këtij kryesin për pak kohë, vetë djemtë, gjersa u nis për në Shqipni, por pastaj përsëri e mori Spiro Ruçua. Ky kishte si kshilltar Galip Hatibin, Kol Berishën, Sinan Gjonin, Spiro Dhimën dhe Vasil Lazarin; por në bisedimet me Fultzin Vasil Lazari nuk vinte. Për ç'do kërkesë të vogël nga ana e djemve, fliste n'emër të të gjithëve, Spiro Ruçua. Kur ishte ndonji çeshtje me rëndësi, si mënyrat e hyrjes në Shqipni, stërvitja e djemve në vilë, mblidheshin me Fultzin "Shtabi" nën-kryesin e Spiro Ruços, me antarë Galip Hatibin, Kol Berishën, Sinan Gjonin dhe Spiro Dhiman; nuk e dij arsyen pse nuk e merrnin Vasil Lazarin, të cilin e konsideronin si udhëheqës dhe që në mbledhjet e tyre private këshilloheshin edhe me 'të.

Edukimin politik dhe disiplinën e të gjithë djemve e kishin krerët e përmendur më sipër. Bënin mbledhje të përgjithëshme shpesh.

Unë kam patur bisedime konfindenciale me të lart-përmendurit, por jo me të gjithë. Shpesh herë u kisha treguar sende që unë dinja mbi çeshtjen e Shqipnis dhe që isha i ndaluar nga ana e Zyrës, të flisnja. Sinan Gjonit i kam treguar edhe raporte sekrete, ndërsa Galipit dhe Ruços u kisha dhënë trakte të Lëvizjes për t'i lexuar në dhomën t'ime, me gjithë që ishte ndaluar nga Fultzi që, ata, të shifnin trakte të rrymave politike në Shqipni. Fultzi thoshte se, në qoftë se djemtë kërkojnë skjarime rreth gjendjes politike në Shqipni, u jap unë. Kur djemtë çfaqnë dëshirën që të kishin nji shaptilograf, unë thash të gjenin një dhe mbasi e gjetnë u a bleva unë me parat e mija; pagova 5000 lireta për shaptilografin dhe 3000 lireta për kartë dhe bojë, me konditë që të mos merrnin vesht në zyrë se ku e gjetën. Shaptilografi nuk u vue në veprim dhe as që dij se çu bë.

Kur kishim nevojë për zyrë, për shpjegime specifike, politike ose ushtarake, thërrisnim elementat që përbënin kryesin dhe i pyeste Fultzi. Mbaj mend se, Sinan Gjoni ka dhënë shpjegime rreth planit të Vlorës, që na ish dërguar nga Shqipnija, ku shënoheshin pozitat ushtarake gjermane. Hasan Reçi i dha Fultzit shpjegime rreth udhëheqsave të çetave në Shqipni dhe relacionet që kishin këta ndër-mjet njeni tjetrit.

Kol Berisha kishte dijeni të gjerë mbi personalitetet në Shqipni dhe aktivitetin e tyre politiko-ushtarak, të cilat ja thoshte Fultzit mbasi pyetej prej tij. Ky përkthente artikuj dhe raporte të lëshuara nga Italianët që delnin nga Shqipnija dhe ja dorzonte Fultzit. Galipin e simpatizonte Fultzi shumë se ishte i zgjuar, i zellshëm dhe kishte

mësuar edhe mjaft Inglisht. Edhe këtë e pyeste shpesh herë rreth Lëvizjes Nacional-Çlirimtare dhe udhëheqsave të saj.

Foto Vesha konsiderohej si nji nga udhëheqsat në vilë, përsa kohë qëndroj aty, ky konsultohej shpesh me Hasan Reçin dhe Galip Hatibin. Ishte nji djal i zoti dhe gati për ç'do shërbim, prandaj u zgjodh nga Fultzi që të shkonte me mision në Shqipni. Foto Vesha, Hasan Reçi dhe Niko Kovaçi, kur u nisnë për në Shqipni, u dha nji sasi floriri Fultzi.

Shtabi i djemve në Vilë, lexuan dhe studjuan mirë edhe raportet që dërgoj në Bari Hasan Reçi. Këta e njihnin gjendjen e Shqipnis mirë dhe sidomos pasi takuan mjaftë shqiptarë që duallën nga Shqipnija për këtë informoheshin edhe nga Misioni Ushtarak Jugosllav që ishte në Bari.

Stevens, gjatë kohës që qëndroj në vilë, takohesh shpesh dhe bënte muhabet me këta djem: Ndue Gega, Ndue Nikolla, Nikoll Bruka, Preng Shkoreti, Koço Gjika, Faik Mani dhe Vasil Lazari. Me Kiriazin kishin miqësi Adem Derhemi, Riza Leka, Qazim Hoxha, Rexhep Metalla, Haxhi Brahja, Fadil Kërtusha, Qaani Katroshi, Osman Shehi, Osman Alla dhe nji djalë i vogël që s'ja mbaj mend emërin, me pseudonim Smith.

Me Çekanin, reshter Shqiptaro-Amerikan, kishin miqësi Hamit Gryksi, Ali Alija, Etëhem Beluli. Disa nga këta djem kan bërë edhe roje në kuartjerin e S.B.S.

Mbaj mend se mbrenda në zyrat, natën, ka bërë roje Galip Hatibi, Fadil Kërtusha dhe Qani Katroshi. Ne porta përjashta kan bërë roje Ndue Gega, Ndue Nikolla, Nikolla Bruka etj.

Kur u arrestua nji oficer grek, antar'i S.B.S., për arsye se kish nxjerrë informata sekrete përjashta, në pije e sipër, i është lënë ndën-kujdes Spiro Ruços, në Vila "Rossa", ku u mbajt për disa ditë gjersa u çua në nji vend tjetër. Spiro Ruçua caktonte rojet dhe i ndërronte bashkë me nji kapiten të S.B.S., oficer'i Sigurimit.

Pasi iknë djemt dhe u mbyll Vila, Vasil Lazari vinte në zyrën t'ime shpesh dhe kopjonte trakte të Lëvizjes Nacional-Çlirimtare, për t'i organizuar në nji formë broshure, thosh ay, të cilën do t'a shtypte në Bari. Ky u kthye në Shqipni me Bedri Spahin.

Fultzi, Galip Hatibin e mbante gjithmonë afër, e thërriste në zyrë dhe i kërkonte shpjegime mbi Tiranën, p.sh. mbi pozitat e Tiranës, si Dajti dhe rrethe të tjera të saj, d.m.th. bënte po atë punë që bënte dhe Sinan Gjoni për Vlorën. Galipi delte sa herë donte jasht në qytet, kurse për të tjerët ishte e ndaluar, vetëm shum radhë. Galipi si gjithë djemt e tjerë të vilës merrte 3500 lireta në muaj. Këto të holla sejcili nga djemt i merrte individualisht, pse kështu ishte urdhëri nga nalt.

Rroga e ime mujore gjatë kohës që kam qëndruar n'Itali ishte 300 dollarë Amerikanë bazë dhe 7 dollarë në ditë shpenzime, të cilat i merrnja nga arka e S.B.S.

Kryetarët e zyrave të S.B.S. më kan ngarkuar të kryenja shumë shërbime të ndryshme. Me urdhërin e këtyre kam bërë arrestime dhe rekuizime automjetesh, ndërtesash etj.

Në zyrat e S.B.S. unë kam qenë këshilltar'i tyre për punët e Shqipnis. Kur jam nisur nga Amerika bënja pjesë në degën e S.O., mirpo gjatë qëndrimit t'im n'Itali, kam kryer shërbimet e degës S.I.

Destinimi i im nuk ishte që të rinja në Bari, por do të vinja nga Amerika drejt në Martanesh me Misionin e parë Amerikan në Shqipni, pranë të cilit do të jesha si këshilltar, njikohësiht do t'isha agjent i Amerikanve, të cillët do të informonja mbi gjendjen e Shqipnis. Kjo ka qenë marëveshtja që pata bërë në Washington me majorin Coon. Përsa kohë ndejta në Bari, kam kërkur shpesh herë të nisesha për në Shqipni, mirpo autoritetet e S.B.S. duke menduar punën që unë kryenja atje, refuzuan ardhjen t'ime në Shqipni. Rreth dëshirës t'ime për ardhje në Shqipni dhe pengesave që m'paraqiteshin nga ana e zyrës së S.B.S. përsshkruhen në letrën që Fultzi i drejton Komandantit Green, dt. 1 Prill 1944.

Kur erdhi Bedri Spahiu në Bari me mision, unë bisedova gjatë e gjerë me Ramadann Çitakun, me të cilin kam qenë në shkollën teknike për shtatë vjet rrjesht, rreth pozitës s'ime. Ay më pyeti nëse dëshironja të nisesha bashkë me 'te për në Shqipni, por unë i thash që nuk ishte aq kollaj të shkëputesha nga S.B.S. Shtova se, nën-shtetsin Amerikane e kisha fituar, duke shyrbyer n'Ushtrin Amerikane, simbas ligjit ç'do i huaj që shërben n'Ushtrin Amerikane, mbrenda gjasht muajve bëhet automatikisht nën-shtetas Amerikan. Mirpo, kur kërkova që të kthehesha n'Amerikë për të skjaruar pozitën t'ime, më vjen një letër nga O.S.S. (Zyra e Shërbimeve Strategjike Qëndrore në Washington), ku thuhej se, Ministrija e Jashtme Amerikane, nuk më lejonte të hynja n'Amerik. Në insistimin t'im, ata më thanë se mund të vinja në Washington vetëm për konsultim, por komandanti në Bari m'a refuzoj edhe këte. Kur erdhi Kadri Hoxha në Bari, kam biseduar me 'te disa herë rreth kësaj çështjeje dhe vendosmë që unë të shkëputesha nga Amerikanët, por me kujdes që të mos krijohej nji armiqësi. Unë i thash se do të tentonja por duhej të më vinte në ndihmë, në rast se ngjiste gjë, mbasi kishte patur preçedenca kur ata i zhduknin personat që nuk u bindeshin atyre. Në këto kohë pata bërë dhe aderimin me frontin.

Fultzi pat kërkuar, nja dy herë, nga Shtabi i Lëvizjees Nac.Çl. sikundër më tha ay, që unë të vinja në Shqipni me mision, por përgjigja ishte negative, dhe se po të donja mund të vinja vetëm si shqiptar i thjesht.

Në zyrat e O.S.S., në Washington, kam bërë kontraton e shërbimit për deri në mbarim të luftë, mbas realizimit të paqës, do të qëndronja pran tyre. Për 10 vjet rrjesht isha i ndaluar të nxirrnja informata rreth organizimit dhe detyrave të O.S.S., në të kundërtën zhdukesha.

Nga fundi i Tetorit 1944-rës, paraqita dorheqjen, duke theksuar faktin se unë s'kisha ç'të bënja më në S.B.S., mbasi Shqipnija ishte në lirim e sipër. Kërkova prej tyre që lutja të më pranohej në Bari, se si pas rregullit, unë s'mund të jepnja dorëheqjen në Bari, me qenë se isha marrë në shërbim në Washington dhe jo në Bari. Për këtë çështtje Fultzi bisedoj me komandantin Green dhe me syperiorë të tjerë dhe mbas këtij bisedimi më tha se, nuk ishte aq kollaj të shkëputesha nga O.S.S. dhe se dorheqja do t'më pranohej vetëm sa për formë, kur të shkonja në Shqipni, pa mision të caktuar, duhet të ndihmoja Tomin, duke e këshilluar mbi punët politike kur të çfaqej nevoja.

Unë pranova detyrën që m'u ngarkua dhe mora pranimin e dorheqjes me shkrim, të nën-shkruar nga Edward Green. (u shuan dy fjalë) Fultzi, më kujtoj se z'duhej të harronja, që unë kisha nën-shkruar nji deklaratë në Ëashington, që për 10 vjet s'kisha për të nxjerr asnji informatë rreth O.S.S. dhe aktiviteteve të saj.

Teksti i pranimit të dorheqjes përmbante këto: "Pam dorheqjen tënde që çfaq si arsye, se ke mbetur pa punë. Ke hak. Ne pranojmë dorheqjen tënde menjiherë, duke të falenderuar n'emër të Komandës s'onë, për shërbimin që u ke bërë Shteteve të Bashkuar dhe kauzës së përbashkët. T'urojmë udhën e mbarë dhe të kesh sukses në vendin tënd".

Këtë ja tregova edhe Kadri Hoxhës kur erdhi në zyrën t'ime, për të parë si vajti puna.

Mblodha teshat e mija që atë ditë dhe pasi skjarova punën me financën e S.B.S., shkova në Misionin Shqiptar.

Në mbrëmje vajta ne Fultzi, për të marrë disa sende dhe kur po ndaheshim më dha një zarf të madh për Tomin dhe më këshilloj përsëri që t'a ndihmoja, por të kisha kujdes që të mos e shifnja shpesh. Prej kësaj nën-kuptohet që marëdhënjet ndërmjet meje dhe Tomit të mos diktoheshin nga organet e qeveris shqiptare. Më në fund tha: "Shpresojmë që punët do të venë mirë dhe do të kemi relacione të mira me Shqipërinë duke u njohur të dy popujt më mirë".

Për ardhjen t'ime në Shqipni, Kadri Hoxha ësht përpjekur mjaft pranë autoriteteve shqiptare që të më jepej leja e hyrjes në Shqipni.

Atë ditë që u nisa unë për në Shqipni, erdhi dhe delegacioni i Gruas Anti-Fashiste Jugosllave, që vinte të merrte pjesë në Kongresin e Gruas Anti-Fashiste Shqiptare, Liri Belihova, Adem Derhemi, Ali Alija, Haki Qatja, Sotir Kuneshka, Vait Maçi, Koço Gjika, Njazi Bimi, disa partizanë që ishin shëruar nga plagët dhe Myfit Dudushi i cili ishte përgjegjës i grupit.

Më 28 Tetor 1944-ër, kemi hyrë në vapor, në Brindisi dhe zbarkuam në Kakome, ku na futën Inglezët në nji motoskaf dhe na çuan në Sarandë. Kemi arrijtur në Sarandë pas dreke dhe na shpërndanë nëpër shtëpi të ndryshme për të kaluar atë natë.

Të nesërmen në mëngjez u nismë për Delvinë, ku ishte organizuar një pritje madhështore për delegacionin e Gruas Anti-Fashiste Jugosllave. Këtu unë dhe Kuneshka u ftuam për të marrë pjesë në gostinë që u shtrua për nderin e delegacionit të Gruas Jugosllave.

Ditën tjetër, në mëngjez, u nismë për në Gjirokastër me anë të malit. Në Delvinë, Myfit Dudushi, la sipas direktivave që kishte, Adem Derhemin, Ali Alin, Haki Qaten dhe disa partizanë të tjerë. Këtu unë i fala Brigadës së XIX-të dy batanijet e mija.

Në Gjirokatër arrijtëm natën dhe na shpërndanë nëpër shtëpit e ndryshme. Edhe unë këtu isha në nji shtëpi me Sotir Kuneshkën.

Të nesërmen festohej në Gjirokastër shpallja e Komitetit Anti-Fashist në Qeveri Provizore. Me këtë rast foli dhe nji oficer Inglez i ndërlidhjes, në gostin që u dha, përkthente Pupo Shyti.

Nga Gjirokastra arrijtëm në Berat, ku ishte stabilizuar Qeverija. Këtu për herën e parë takova Hasan Reçin, Isuf Kambën dhe shumë të tjerë të njohur. Hasani

më shpuri tek Myslim Peza, ku ishte dhe Haxhi Lleshi. Ndejtëm mjaft duke bërë muhabet dhe duke folur rreth luftës.

Të nesërmen kam vajtur në Misionin Amerikan, bashkë me Frederik Nosin, ku gjetëm Selahudin Toton dhe nji teknikas tjetër, që po pinin me Tomin. Unë i dhashë postën Tomit, i cili më tha se do të shifemi prap nesër dhe ika. Në mëngjezin e ditës tjetër u takova me Tomin në kafe Kolombo dhe më tha se e kish parë postën e Fultzit, ku i thoshte se, unë, do t'a ndihmonja rreth gjendjes politike, pasi të isha adoptuar mirë në gjendjen e re. Në të vërtetë unë e gjenja vehten krejt të konfonduar, mbasi ishte bërë një ndryshim i madh gjatë këtyre vjetve që kisha munguar nga Shqipnija. Tomi filloi të më shpjegonte shumë gjëra rreth gjendjes dhe më ftoj të vinja të nesërmen në mision.

Unë pyeta në Berat Bacën dhe Frederikun, nëse mund të vinja në Misionin Amerikan dhe ata më thanë: "Pse të mos vesh, ne Aleatë i kemi".

Kur e takova Tomin herën tjetër ay më tha: "Si me shaka, këta e fituan. Kur hynë këtu në Berat vumë re se vunë drapër dhe çekanë nëpër muret, por tani që po vijnë përfaqsues të ndryshmë Aleat, i kanë fshirë këto shenja, për të mos u dhënë përshtypjen Aleatve se ç'rrugë kanë zgjedhur, gjersa të marrin njohjen. Jam kurioz të dij se si do të sillet populli kundrejt këtyre, kur të jetë çliruar gjithë Shqipnija dhe si do të sillen këta, ndër qytete, se në mal ishte ndryshe".

Tomi më tha se për ca kohë unë s'kisha për të biseduar gjë me 'te, mbasi z'dihej se si do të mirrte fund puna me çlirimin e Tiranës dhe të Shqipnis së Veriut, përveç këtyre të shihnim se ku do të caktohesha unë me shërbim nga Shtabi dhe nga ana tjetër, tha, ti s'e ke njohur gjendjen mirë akoma.

Në këto ditë unë u thirra n'audiencë nga Komandanti, Gjeneral-Kolonel Enver Hoxha, mbi të cilin bisedova gati nji orë rreth pozitës së Shqipnis në relacione ndërkombëtare. Pastaj më thirrën në zyrën politike ku dhash nji raport para Pandi Kristos dhe Theodhor Hebës, rreth shërbimit që pata patur me Amerikanët. Rreth aktivitetit t'im n'Itali dhe rreth shqiptarve që kisha bashkuar në vendet që kisha vizituar. Këtu dhash mjaft fakte për ç'do gjë që më pyetën.

Më vonë më thirri Spiro Moisiu dhe më pyeti se ç'shërbim donja të më caktohesh. Unë i thash se, kam qen gazetar dhe dij Inglisht mirë, në bazë të këtyre mund të më caktoni. Kaq më pyeti dhe më tha se do t'më lajmëronin ku do të caktohesha.

Në Berat pata bisedime mjaft me Dr. Dishnicën dhe Sejfulla Malishovën, rreth shqiptarve t'Amerikës, rreth qëndrimit të Fan Nolit dhe se ç'mendonin Aleatët për Shqipnin. Malishovës i dhash edhe tekstin e Kartës së Atlantikut në gjuhën Inglisht dhe shqip, të cilën e pata përkthyer unë.

Tomin e pash edhe njiherë vetëm për pak minuta në rrugë dhe i thashë se Qeverija Provizore shpresoj të njihej më parë nga Amerikanët, mesa kuptoj unë. Këtë ay e dinte se m'a pat përmendur vetë mëparë.

Për çeshtjen e djemvet që kishin qenë në vilë, nuk më përmendi gjë tjetër veçse më tha se janë shpërndarë andej këtej me shërbime të ndryshme dhe se Vasil Lazari ishte në Berat dhe e pat takuar disa herë. Për Hasan Reçin më tha se, ky, nuk

i afrohej atij; siç duket, tha, ka frikë. Gjë tjetër s'më tha. E pashë njiherë, prej sëlargu, që po shëtitëte me Njazi Bimin nga rruga që të shpie nga aeroporti dhe njiherë tjetër e pashë që rrinte në kafe me Vait Maçin.

Në këtë kohë mora urdhër që të nisem për në Shrabin e Korpo-armatës I-rë në qarkun e Tiranës. Me gjithë që ishja i sëmurë u nisa me Njazi Bimin dhe bashkë me ne edhe nja dy partizan. Nga Berati shkuam në Lushnje dhe që këtej në Peqin, i cili ishte i liruar atë ditë. Prej këtej shkuam në Kavajë, ku po festohej çlirimi i këtij qyteti dhe që këtej muarëm drejtimin e Durrsit, bashkë me Islam Radovickën. Për të shkuar në Tiranë muarëm rrugën e Ndroqit dhe arritëm në Vaqarr, dy ditë para se të lirohesh Tirana. Që nga Selita dukej fare mirë Tirana ku po bëhej nji luftë e rreptë. Njazi Bimi më la mua vetëm në Vaqarr natën e dytë dhe ay hyri në Tiranë ku kish dhe familjen. Të nesërmen hyra dhe unë në Tiranë me disa katundarë.

Në Tiranë u prezantova tek Mehmet Shehu, i cili më fjalosi mjaft rreth luftës. Ky më dërgoj tek Dali Ndreu, i cili më tha se s'kish marrë ndonji urdhër nga Shtabi i Përgjithshëm, prandaj duhej të prisnja gjer sa të lajmërohesha.

Më 28-29 Nëndor, isha akoma në Tiranë. Me 29 Nëndor e pash pak Tomin me Nick Cooky-n në bulevard. Atyre u kishte bërë përshtypje pritja madhështore që i u bë Qeverisë, por donin të dinin nëse kjo pritje ishte e përzemërt apo sa për formë, nga frika. Për amnistinë thanë se ishte nji gja e mirë, porse-kuptonin a do të vihej në veprim, a po ishte bërë sa për propagandë që të pajtonin popullin e tërë. Këta po studjonin me kujdes urdhënesat për të normalizuar gjendjen dhe nëse Qeverija do t'ishte e zonja t'a normalizonte gjendjen. Tomi tha se opozita do të kishte qëndruar në Veri dhe çfaqi dëshirën që të vinte ay në Shkodër, ose të dërgonte ndonji oficer tjetër. Njikokësisht donte të hynte në kontakt me personalitete që kishin qenë në Tiranë gjatë luftës, për të marrë vesht se ç'kishte ngjarë në Tiranë dhe se ç'mendonin ata mbi gjendjen e re.

Më 30 Nëndor lajmërohem që të paraqitem në Shtabin e Divizjonit të IV-tër, tek Asaf Dragoti, këtu më thanë se duhej të nisesha për në Brigadën e IV-tër, që ndodhej diku në Veri. Asafi më tha se do të vinja si agit-propi i Brigadës dhe u nisa me nëndë partizanë. Pas nja tetë ditë udhtimi të zorshëm arrijtëm në Pukë, ku ishte Shtabi i Brigadës. Këtu më tha Irakli Vakëflliu, komisar i brigadës, që unë isha dërguar si partizan i thjesht. Këtu u sëmura dhe u ktheva për Tiranë pas dy javësh, me nji infermier, ndërsa Brigada u kthye në Durrës.

Pas nja dhjetë dit, kur isha në shtrat, lajmërohem se isha vënë në dispozicion të Ministrisë së Kulturës. Në këto kohë unë bëra tre artikuj për gazetën Bashkimi, dy ja dhashë Musa Rait dhe nji Petro Markos, por s'u botua asnjë me gjithë që më thanë se ishin të mirë.

Në fund të Dhjetorit e kam takuar Tomin dhe Nick Cooky-n në kafe Berlin. Këta më thanë se e dinin që kishja qenë në Veri dhe më pyetën si kishte ngjarë puna që u ktheva, unë u thash se u sëmura dhe për këtë arsye u ktheva.

Unë në këto kohë kisha arrijtur në kulmin e dëshpërimit se e shifnja që isha vënë në nji pozitë tepër të vështirë dhe nuk dinja nga t'ja mbanja. Fillova të pij

alkol pa masë dhe e vazhdova gjer në fund. Këte dëshpërim e shifnin të gjithë ata që shoqëroheshin me mua. Donja t'iknja nga Shqipnija pa tjetër, mbasi këtu nuk kishte vend për mua, dhe nga ana tjetër nuk gjenim dot fushë të lirë veprimi. Këtë gjë ja kam thënë dhe Kadri Hoxhës, kur erdhi këtu me rastin e Krisht-lindjeve dhe i u luta që të ndërhynte pranë autoriteteve përkatëse, që t'më lejonin të dilnja jasht Shqipnis. Ky m'u zotua se do t'ma bënte këtë gjë, mbasi ishte ay shkaktar'i ardhjes t'ime këtu. Prita ndonji përgjigje, por s'më erdhi gjë. Këtë lutje ia paraqita disa herë Kadriut kur vinte këtu; ay më zotohej, por nuk shifnja rezultate konkrete.

Në këtë kohë më vjen në shtëpi, nji ushtar shqiptaro-amerikan, Spiro Thanasi, për të më lënë lamtumirën, se po transferonja n'Amerikë. Pas nji çerek ore më kërkuan përjashta, ku po priste nji civil me syze, i cili më foli në këtë mënyrë, në prezencën e atij ushtarit: "A e dini se u arrestoj?" bashkë me 'te ishte dhe nji tjetër. Unë i them se nuk ishte nevoja aspak dhe se po vinja vetë n'autoritetet përkatëse. Vajta në Shtabin e Brigadës së I-rë të Mbrojtjes Popullit dhe ia referova komisarit këtë gjë, Llaqi Ziçishtit. Ky filloj t'a shqyrtoj këtë incident dhe më tha se do të jetë ndonji provokacion. Prej këtu un vajta te Sejfulla Malshova dhe ia referova edhe atij. Sejfullahu më tha se sigurisht do të jetë ndonji provokacion, mbasi s'ka asnji arsye arrestimi; ne, tha, i kemi Aleatë, por natyrisht duhet të kemi edhe kujdes se ja po e shohim se ç'po ngjet në Greqi.

Tomit ja pat përmendur këtë gjë Spiro Thanasi, dhe kur vajta unë në Misionin Amerikan, për të parën herë, ay më tha se ç'kishte ngjarë para disa ditësh. Unë ja shpjegova çeshtjen dhe i thash se s'më pëlqente fare kjo punë edhe se s'ishte çudi që t'arrestohesha me të vërtetë po të takohesha prapë me antarë të misionit. Këtu biseduam dhe vendosëm që unë t'iknja dhe ay m'u zotua se do t'më nxirrte jasht Shqipnis me aeroplan brenda pak ditëve. Ishte prezent edhe Nick Cooky.

Tomi tha se kishte patur edhe preçedenca të tjera të këtoj lloji dhe habitej si bëheshin këto vëzhgime kaq të hapura, në nji kohë kur Qeverija ishte në relacione të mira me Aleatët dhe priste njohjen nga këta. Pastaj ay më tha se informohej mirë rreth gjendjes politike të mbrendëshme, nga persona miq t'Amerikës, nga miqt e Fultzit, por nuk më përmendi emëra. Më pyeti nëse kisha takuar ndonji nga djemt e Vilës në Veri të Shqipnis dhe unë i thashë se pata takuar Nikolla Brukon, Faik Manen dhe Osman Allën, të cilët kishin përgjegjësira në brigadën e Shkodrës, porse s'pata patur kohë të bisedonja me 'ta. Më pyeti se ku ishte Njazi Bimi dhe Sali Doda, por unë z'dinja se ku ishin. Nick Cooky më pyeti pë Jackun (Galipin) se ku ishte, me qenë se kishin patur miqësi që në Bari me 'të. Në këtë kohë vjen Dino Shani në mision me të cilin më prezantoj si nji ish oficer dhe nxanë i Fultzit. Unë hika menjiherë dhe i thashë se do të kthehesha pas disa ditësh për të marrë përgjegjen e ikjes.

Vajta pas tri ditë prap në mision dhe e pyeta Tomin se si u bë çeshtja për t'ikur. Ay më tha se hë për hë s'kishte mundësi, mbasi aeroporti ruhej shumë, që kurse kishin nxjerrë Inglezët Meri Çelën. Ky më tha mos kij frikë se nuk t'arrestojnë se ata e dijnë se ti ke qenë me ne dhe se s'ke qenë ndonji bashkëpuntor i fashizmit.

I thashë se pata kërkuar leje për të dalë jashtë Shqipnis, me anë të Kadri Hoxhës dhe se po prisnja përgjigjen. Pastaj ay sugjeroj që t'i jepte disa suhare në mision për miqt e misionit dhe kështu të shtonte edhe miq të tjerë. Njoftoj të vinja aty të shtunën e ardhëme se do të kishte mjaft miq, që do t'i çonte Loni Adami. Unë Lonin e njihnja dhe e dinja që kishte miqësi me misionin. Tomi, John O'Keefe dhe Nick Cooky vinin shpesh në shtëpinë e Adamit.

Në këtë mbrëmje kan qenë prezent: Unë, Loni Adami familisht, djali dhe vajza e Ing. Adamit, dy vajzat e Priftit, Lirija dhe Yllka, një himariot me të motrën, që banojnë karshi shtëpis së priftit, dhe nga të misionit ishin oficerët dhe nën-oficerat. Bisedime politike nuk u bënë, me sa dij unë; kishte ballo dhe pije plot. Tomi hiqej më nj'anë dhe bisedonte me personat e sipërm një nga një, sigurisht rreth gjendjes së Shqipnis.

Në mision më ka prezantuar Tomi me Tika Tezhën dhe Lik Toptanin; si shok të ngusht të tij. Tomi kishte me të vërtet miqësi të ngushtë me këta dhe vinte shpesh herë në shtëpit e tyne, ku u mblidhshin shumë njerëz. Këtë m'a pat thënë vetë Tomi. Për këta të dy më kish treguar se ishin të vlefshëm për interesat amerikane dhe se kishin miqësi me persona të Drejtoris së Mbrojtjes, prej të cilëve mund të merrnin informata të sigurta rreth punëve të kësaj Qeverije.

Aty nga muaji i Janarit 1945, Tomi sugjeroj se donte të takohej, me disa nga djemt që kishin qenë në Vilë, prej të cilëve donte të kuptonte nëse këta mund t'ishin në gjendje që t'i sillnin këtij ndonji shërbim informativ.

Nuk kaloj dy-tre diitë, unë takova Adem Derhemin në kafe Bar Sahat, të cillit i thash të vinte në Misionin Amerikan, të nesërmen mbrëma se e kërkonte Tomi dhe po të gjente dhe shokë të tjerë t'i sillte edhe ato atje.

Të nesërmen mbrëma kur po rrinim në mision, vjen Adem Derhemi, Vait Maçi, Ali Alija dhe Haki Qatja. Vait Maçi dhe Haki Qatja s'kan qenë në Vilë dhe unë për herë të parë i kam njoftun n'Itali.

Herën e parë filloj t'u flas Tomi, duke u thënë se, ju që keni qenë në Vilë e keni kuptuar se ne jemi miqt e vërtetë të Shqipnis, por të nji Shqipnije mike t'Amerikës. Juve, tha, ai, sigurisht që nuk e pëlqeni këtë gjendjen e sotme, por mos kini merak se nuk do të qëndroj kështu. Ne nuk e bëmë luftën që të na shkoj kot, por që të ndryshohet kjo gjendje ne kemi nevojë për informata. Këto duhet të na vijnë nga juve, pse në këtë mënyrë ju ndihmoni vehten t'uaj. Pastaj Tomi tha t'u flisnja unë, me qenë se i njifnja. Fillova t'u flas duke u bërë agjitacjon për Demokracin Amerikane. Këta u shfaqnë të gatshëm për shërbim, mjafton t'u jepshin direktivat.

Të nalt-përmendurve Tomi u tha këto direktiva:

1) Ne na vlen ç'do informatë, që të mblidhni ju si ushtarak që jeni. Mund t'na jepni informata rreth ushtrisë, si ësht organizuar kjo, përse ësht organizuar, si mbahet dhe si edukohet, ç'materjal ushtarak mban dhe nga vjen ky, nëse ka organizatorë të huaj n'ushtri, Rusë ose Jugosllavë dhe vendet e përqëndrimit të forcave ushtarake.

2) Tomi ju drejtua Vait Maçit dhe i tha: "Ti ke punuar pas urave, dhe rreth këtyre na vlejnë informata, si p.sh. çfar lloj urash janë bërë dhe ku ndërtohen këto". Mbasi

Vait Maçi ishte oficer akademist, Tomi, kishte shpresa të mëdhaja tek ky, pse do të ishte në gjendje t'i jepte ndihmë në punë informative.

3) Po të takoni elementa të tjerë të Vilës, që e dini që këta kanë simpathi për Amerikanët, t'i dërgoni menjiherë këtu.

4) Po të gjeni elementë të tjerë të rinjë të gatshëm për punë dhe që kan simpathi për Amerikanët, t'i rekrutoni dhe t'i dërgoni në mision të flasin me Tomin.

5) I këshilloj të ruheshin, mos rrinin bashkë dhe kur të vinin në mision, të vinin në kohën e mbrëmjes dhe një nga një.

6) Më në fund u tha se po të kishin nevojë për para, ishte gati t'i ndihmonte.

Në mbarim të këshillave që u dha Tomi iknë që të gjithë një nga një.

Unë vinja rrallë në mision, nganjëherë takonte që rrinja pa vajtur tri javë ose një muaj.

Me Tomin shifesha përjashta, nëpër kafet, por këtu nuk bisedonim gjë tjetër, veçse punë qejfi.

Gjatë kësaj kohe, Qeverija Shqiptare kërkonte njohjen nga Aleatët dhe tregonte miqësi ndaj 'ta, por nuk fshiheshin demostracionet drejt nji politike të jashtme unilaterale, në drejtim të Moskës. Për këtë Tomi ish i sigurt, porse me kë bisedonte përjashta, unë nuk e dij. Dij vetëm që, ay, bisedonte shpesh me Loni Adamin dhe Kol Kuqalin dhe se këta të dy takoheshin shpesh me Dr. Nishanin.

Politika e mbrendëshme e Shqipnis, na dukej tepër e ngatrruar. Kishin filluar taksat e tatim fitimit, të cillat konsideroheshin si të tepruara, asnji nuk e besonte të kishte patur aq fitime këtu; prandaj e quanim, më tepër, si nji masë çpronësimi. Kjo kishte për të shkaktuar, padyshim, kaos n'ekonomi dhe pakënaqësira nga të prekunit.

Në këtë kohë, Tomi kishte marrë vesht nga Englezët se, në Shkodër kishte ngjarë nji far kryengritje, por z'dihen shumë hollësira rreth kësaj kryengritjeje, me qenë se Misioni Inglez që ishte ndodhur atje, ishte përzënë. Më vonë kjo u kuptua kjartë se ishte vetëm nji çrregullim i guximshëm, nga nji grumbull i pa-organizuar.

Ishte koha kur do të bëhej gjygji special. Tomi gjatë zhvillimit të këtij gjygji, dërgonte si ndigjues Stefan Treskën, përfundimin e të cilit e priste me pa-durim, pse këtu do të kuptohej vendosmënija e Qeveris kundrejt opozitës. Unë isha i mendimit, mbasi ndigjova disa nga proçeset me plot fakte konkrete, se shumica ishte fajtore dhe se do të dënohej me vdekje. Tomi thosh se nuk do të tregohen t'ashpër shumë, për arsye se presin njohjen e tyne dhe nuk duan të krijojnë nji opinion të keq, sidomos n'Angli dhe n'Amerikë.

Pasi filloj gjygji, atyre u dukshin metodat e gjygjit si krejt të huaja, duke u bazuar me sistemin Amerikan. Ashpërsija e jashtëzakonshme e prokurorit, ndalimi i ndërhyrjes dhe i ekzaminimit në t'akuzuarit nga ana e mbrojtjes, gjykohej se gjygji bëhej më shumë, për të demaskuar organizatat e opozitës dhe se vendimi do t'ishte marrë që më parë.

Mbasi u muar vendimi, Tomi më pyeti se si m'ishte dukur mua. Unë i thash se, me sa dij unë, vendimi qe i drejtë. Ay e gjente këtë vendim shumë t'ashpër

dhe guximtar dhe thosh: "Si guxuan të prishin Bahri Omarin dhe Kol Tromarën, dy patriotë të vjetër, të cillët njihen edhe n'Amerikë, ku kanë qenë që të dy". Ky nuk i quante dhe aqë të fajshëm këta, por mbasi kishin qenë exponenta të Ballit, u dënuan me vdekje. Ky, si dhe shumë amerikanë të tjerë, nuk i konsideronin si fajtorë koshientë udhëheqësit e Ballit, por vetëm si viktima të rrethanave të luftës. Legalitetin e quan si nji pjellë t'Englezve, e cila mund të kishte patur sukses po t'ishte formuar më parë.

Në Majin e 1945, erdhi Fultzi këtu dhe unë shkova për t'a takuar. Ay më pyeti se si më dukej gjendja e këtushme, ç'bënin ish studentat e tij, që kisha takuar unë dhe profesorët e teknikes. Më foli për pozitën t'ime të vështirë, që ndiqesha nga kjo Qeveri dhe habitej pse të dyshohesha, kurse unë pata qenë me Aleatët anti-fashistë dhe se kisha ndihmuar në kauzën e përbashkët të luftës. Më këshilloj të ruhesha, gjersa të normalizohej gjendja dhe tha se do të përkujdesej, që unë të shkonja prap n'Amerikë.

Fultzi më pyeti nëse ishte konstatuar ndonji opozitë e organizuar, por unë i thashë se jo. Ay kërkoj që t'ja bënja të njohur, po të konstatonja gjë.

Mbas disa ditësh, gjej të mbledhur në Mision këta persona: Xhemal Farkën, Adem Derhemin, Ali Alija, Haki Qatja, Sul Dizdari, Vait Maçi dhe Sejfo, të cilin nuk e njoh. Në këtë mbledhje ishte Fultzi dhe Stevens nga të misionit.

Në fillim, Fultzi, po i pyeste se si shkonin dhe nëse u pëlqente gjendja e re. Ata të gjithë thanë: se jo, dhe Fultzi pyeti se, a kishte shumë të tjerë që mendonin si ata; ata thanë se po. Atëhere ay tha se ç'bëjnë këta njerëz? Filloj t'u flasë mbi Demokracinë Amerikane, mbi lirin personale dhe atë të partive politike. Përmendi dhe Kartën e Atllantikut, me anë të së cilës u siguroj popujve të çliruar, lirija e fjalës, lirija e mbledhjes, e shtypit, lirija nga nevojat dhe lirija nga frika. Këtu, tha ay, s'janë vënë në veprim këto; këtu unë s'kam parë gazeta të tjera veç atyre zyrtare. Këtu njerzija rrojnë me frikë. Ju që doni nji Demokraci si ajo e Amerikës, duhet të punoni dhe të na ndihmoni edhe neve, duke na informuar mbi gjendjen që kemi ardhur të studjojmë. Në fund u dha këto udhëzime:

1) Të punoni individualisht.

2) Të shtoni shokët, por të punoni dy nga dy, që të mos njihi me gjithë të tjerët.

3) Të mos vini shpesh në mision, po t'ini në kontakt të vazhdueshëm me Stevens, ose me pjestarë të tjerë të Misionit.

Xhemal Farkës i tha të vinte në kontakt me personalitete të Pushtetit dhe të mblidhte informata politike prej këtyre.

Si objektiv, ay kërkoj informata nga të gjithë.

Në të mbaruar të mbledhjes, Stevens u tha, më nj'anë, se në rast se kishin nevoj ata, ishin gati t'i ndihmonin financjarisht.

Unë edhe Fultzi biseduam më vonë rreth gjendjes së këtushme. Herën e parë i fola Fultzit mbi përbërjen e Qeverisë, simbas mendimit t'im dhe me sa kam marrë vesht, i thash, një pjesë e qeverisë nuk janë komunistë, p.sh. Dr. Nishani. Dr. Medar Shtylla, Ing. Koleka dhe Haxhi Lleshi, porse Fronti dukej që ishte kompakt dhe funksjononte n'armoni të plotë.

I thash se Qeverija e kishte mbështetjen kryesore në masat e gjera të popullit dhe në rinin e organizuar, në nji pjesë të fshatarsis e cila po shkëputej nga dominioni feudal i së kaluarës. Fultzi qe i mendimit se masat e gjera të Shqipnis nuk ishin n'atë gjendjen zhvillimi, sa të kuptonin problemet e sotme.

Më pyeti për në Veri, ku popullsija ishte e lidhur pas bajraqeve dhe ku jeta ishte patriarkale. I thash se populli i Veriut nuk ësht i lidhur me Lëvizjen Nac.Çl., edhe nji pjesë e tij që tregohet si pro-Lëvizjes këtë e bën prej presionit të forcave partizane që janë n'ato vende. Urrejtjen kundrejt kësaj Qeverije, nji pjesë e popullit të Veriut e ka demostruar, si p.sh. lëvizja e Malsis së Shkodrës që u bë në Dhjetorin e 1944-rës.

Kur më pyeti nëse ka exponenta, të cilët të mund t'organizojnë dhe të mund t'udhëheqin një opozitë, unë i thash se s'kish dyshim që do të kishte, duke marrë parasysh, se këtu ekzistonin organizata kundërshtare gjatë luftës, porse unë s'kisha kontatuar ndonji manifestacion dhe as që shpresohej që do të kishte me qenë, se udhëheqsit e tyne ishin kompromet uar keq gjatë luftës dhe këtë e provoj gjygji special me fakte konkrete. Siqodoftë, i thash, opinioni publik s'mund të matet hë për hë, me qenë se rregullorja e shtypit s'kish dalë akoma dhe s'kishte shtyp privat. Shtova se kjo kishte për t'u kuptuar në rastin e ndonji votimi a po të ndnji plebishiti.

Për sa i përket prestigjit amerikan këtu, i thashë se mund t'ishte më i mirë se ay i Englezve, të cilët urrehen për shum arsye: Për ndihmat që s'kan dhënë gjatë luftës, për progandën vage, që bënin gjatë luftës dhe për ndërhyrjen e tyre në punët e mbrendëshme të Shqipnis.

Me Jugosllavin, i thash, sikundër dihej më parë, janë në relacione kordiale, me qenë se kan bërë një luftë të njajtë edhe sëbashku. Bashkimi Sovjetik simpathizohet për luftën e madhe që bëri dhe për sistemin qeveritar, që tërheq puntorin dhe fshatarsin. Por se si do të vinin punët kishte për t'a provuar koha dhe masat që mund të merrte pushteti në punët e mbrendëshme.

Gjer më këto kohë unë s'kisha rënë në kontakt me ndonjë opozitë dhe as që kisha ide se kush mund të formonte opozitë, mbasi mua më dukej, ata që s'ishin bashkuar me Frontin, ishin kompromet uar keq dhe kishin hikur përjashta.

Rreth ushtrisë nuk jam interesuar ndonji herë t'informohem rreth sajë dhe as që biseduam gjë me Fultzin. Këto biseda i kemi bërë me Fultzin aty nga fundi i muajit Maj 1945.

Fultzi më përmendi pritjen që ju bë nga populli i Tiranës, të cilën unë s'e pashë, dhe ishte i mendimit se turmat s'kan kuptim, mbasi aty mund t'ishin njerëz që dëshëronin të shifnin nji gjendje tjetër këtu dhe nga ata që kërkonin njohjen e Qeverisë. U zgjatëm rreth psikologjis së turmës dhe se si në botën Anglo-Saksone nuk u jepet rëndësi demostratave në përgjithësi. Ay çfaqi dyshim nëse Qeverija kërkonte me të vërtetë njohje nga Anglo-Amerikanët, por nuk u shpjegua më tutje. Ay tregonte nji interesim të madh rreth përpjestimit të komunistave të bindur në Qeveri.

Pastaj më pyeti përsëri mbi teknikasit që mund të kisha parë unë dhee më tha se disa prej tyre e kishin vizituar, por s'përmendi emëra. Unë i thash që kisha parë Beqir Haçin, që shiste zarzavate në pazar, për Ihsan Qereshnikun që punonte

si radio-teknik. Më pyeti për Xuf Koliakën, por unë i thash se z'dinja se ç'bënte. Gjithashtu më pyeti edhe për Kostaq Stefën, Hil Berishën, Pasko Brahimaj, të cilët unë s'i kisha parë.

U interesua mjaf edhe për djemtë që kishin qenë në Vilë, por unë i përmenda vetëm ata që kisha parë.

Tregoj nji interesim të veçantë për Galipin, për të cilin kish dijeni nga Tomi dhe Cooky dhe se kish dëshirë t'a shifte. Gjithashtu kërkoj të takoj edhe me Hasan Reçin. Amerikanët e quanin exponent, politikan të vjetër, me eksperiencë, me influencë të gjerë në popullin shqiptar dhe për këto veçanti të tij kishin shpresa të mëdhaja tek ky.

Rreth djemve të Vilës "Azzone", që kishin ardhur këtu dhe për ata që kan mbetur n'Itali, unë dij këto:

Vasil Llazari, si erdhi nga Italija në Shqipni, pat hyrë në kontakt me Thoma Stefanin, që në Odriçan, në Gushtin e 1944-rës, këtu takohej me Stevens dhe me të tjerë. Unë e kam parë, Vasilin nja dy herë, këtu në Tiranë, me të cilin kam biseduar pak. Nji herë e pyeta se ku punonte dhe ay më tha se ishte në zyrën e përkthimeve. Kur i shfaqa dhe unë dëshirën që të hynja n'atë zyrë, ay më tha se kishte për të qenë pak si zorr dhe jo punë e lezetëshme. Vasili edhe këtu në Tiranë ka mbajtur vazhdimisht kontakt me Tomin dhe me elementa të tjerë të Misionit Amerikan.

Hasan Reçin e kam takuar nja tre herë dhe në këto takime m'ësht treguar fort i pakënaqur. Kur e kam takuar në Berat, më tha që të mos shkonja dendur në Misionin Amerikan, pse ky nuk shikohej me sy të mirë nga qeverija e sotme. Në nji takim që kemi bërë me 'te në Kafe Berlin, më çfaqi dëshirën të takohej me Fultzin, por kishte frikë. Pastaj mora vesht nga Stevens se, Hasani, Sinan Gjoni dhe Foto Vesha ishin takuar me Fultzin dhe me Stevens, nuk më kujtohet o në shtëpin e Stevensit o të Merushe Topullit.

Sinan Gjonin e kam takuar nji herë në komandën e qendrës, nji ditë pasi u çlirua Tirana, kur vajta të takohesha me Mehmet Shehun, nja dy herë të tjera e kam takuar në shtypshkronjën Bashkimi, në Dhjetorin e 1944-rës. Në këto takime nuk kemi biseduar çështje politike.

Foto Vashën e kam parë vetëm një herë në Ministrin e Ekonomis dhe tjetër herë nuk e kam takuar. Këtë herë më pyeti për Fultzin dhe antarët e tjerë të misionit si ishin.

Nikolla Brukon e kam takuar në Pukë, kur isha në Brigadën e IV, nji ditë para se të nisesha për Tiranë. Më tregoj mbi udhtimin e tij që kish bërë nga Italija këtu. Gjithashtu më tregoj dhe se si e kishin kapur Llazar Fundon dhe e kishin pushkatuar, me qenë se ishte dënuar me vdekje nga Partija. Që ishte i dënuar Fundua me vdekje, ne e dinim që n'Itali se na pat thënë Galipi. Që atëhere nuk e kam parë më.

Në Pukë, takova edhe Osman Allën, por nuk bisedova me 'te, vetëm se u salutuam.

Edhe Faik Manen e takova në Pukë. Ky filloj të më tregoj mbi jetën e keqe që bënin në Brigadë, duke e barazuar me "parajsën" e Barit, dhe më kërkoj një palë këpucë, por unë s'kisha të t'i jepnja. Unë nuk e kam parë më, por e dij që ishte takuar me Stevens dhe vinte në shtëpin e Kuqalit.

Shefqet Kavajën nuk e kam parë fare, por më duhet se, më tha Stevens që, ky punonte bashkë me Faik Manon.

Preng Shkoretin nuk e kam takuar fare. Ky u takua me Tomin në Berat. Ishte nji element i zgjuar dhe tregonte miqësi të madhe ndaj amerikanvet. Më duket se është nga Laçi i Milotit.

Ali Alinë e kam parë nja dy herë, në post-bllokun e Tiranës, kur unë u kthenja nga Durrësi në Tiranë. Me këte nuk kam biseduar.

Haki Qaten e kam parë vetëm një herë, pranë xhamis së vjetër. Ky filloj t'ankohej se nuk ja linte misioni shqiptar në Bari të shoqen që të vintee këtu, me qenë se ishte italiane. Unë e këshillova që të vinte tek Bedri Spahiu për këtë çështje.

Me Spiro Ruçon kam bërë dy takime të shkurtën dhe s'kemi biseduar. Herën e dytë aty nga Nëntori i 1945-sës, e kam takuar në Bulevard Musolini, më pyeti ç'bënja në Durrës dhe më tha vetëm, se ishte takuar me Fultzin. Për Spiro Ruçon më ka thëmë Fultzi se, ishte takuar dhe kishte biseduar me 'te rreth Reformës Agrare. Spiro Ruçua i pat thënë se, Reforma Agrare nuk kishte për të patur sukses, me qenë se Qeverija nuk kishte mundësi t'i furnizonte bujqit me mjete bujqësije. Kishte thënë gjithashtu se reforma agrare, ishte më tepër një masë politike, për të fituar simpathi, porse kjo do të dështonte. Fultzi tha se Spirua ësht inteligjent, ka zotësi të madhe, por ësht tepër nevrik. Sidoqoftë, tha Fultzi, ky mun t'na ndihmoj shumë.

Spiro Dhimën e kam takuar nja dy herë, një herë më ka ftuar të shkonja dhe në shtëpin e tija. Herën e fundit që e pashë, ka qenë aty nga Tetori i 1945-sës dhe më tha se po shkonte për në Moskë, për studime. Nuk e zgjata se isha me një oficer të Unrra-s. Dij që Spiro Dhima kishte kontakte me Fultzin, Stevens, Tomin dhe Tolin.

Stamat Stamatiadhin e kam takuar vetëm njëherë në rrugën 28 Nëndor, nuk biseduam gjë vetëm sa u-salutuam. Ky ka patur takime me Stevens, Tolin dhe ushtarë të tjerë të misionit, më duket se edhe me George Rudson.

Haki Arvetin e kam parë vetëm një herë, në Maj ose Qershor të 1945-sës, karshi Bar Sahatit, porsa kishte dalë nga burgu, ishte krejt anormal dhe për këtë arsye as që bisedova fare me 'te.

Me Shain Pertefin jam takuar vetëm nji herë në Majin e 1945-sës. Ky më duket se ka patur hyrë në kontakt me Stevens.

Shate Dullën e kam parë nja dy herë, në Prill dhe në Maj të 1945-sës dhe më kërkoj ca fishek për një kobure amerikane. Ky më kish kërkuar mua një herë në shtëpi por s'më gjeti. Dij se kishte relacion mee Stevensin dhe Tolin.

Sali Dodën nuk e kam parë asnjiherë. Por dij se ky kishte kontakte me Tomin dhe Fultzin. Po nji gjë të këtillë bënte dhe Njiazi Bimi.

Koço Gjikën e kam takuar dy herë Nëntorin ose Dhjetorin e 1944-rës, kur punonte në çensurë. Nji herë më solli disa letra, që kishin ardhur me anë të misionit shqiptar në Bari, dhe nji herë më tha se më kishin ardhur edhe disa letra të tjera, por duhej të vinja t'i merrnja vehtë. Ky ishte penduar që kishte ardhur këtu. Kishte kontakte me Tolin dhe Nick Cooky-n.

Alush Sejkon dhe Rexhep Methallën nuk i kam parë fare.

Aleks Peleshin e pash nji herë këtu të sëmurë, kur po nisej për në Korçë.

Ndue Gegën (Lin) e kam takuar nji herë këtu në Tiranë, kur ishte student në

shkollën e kadetve. Q'atëhere nuk e kam parë më. Ky ka patur miqësi të ngushtë me Stevens.

Ndue Nikollën (Mujo) s'e kam parë fare.

Qani Katroshin dhe Fadil Kërtusha parën hyrë në kontakt me Stevens, në Durrës.

Unë me këta jam takuar nji herë në Durrës dhe më thanë se ishin takuar me Stevens, të cilit i kishin thënë se malli i Unrras po shkonte për në Jugosllavi.

Nga fundi i Dhjetorit 1944, jam takuar, këtu në Tiranë, me Galip Hatibin, me të cilin kam biseduar rreth udhëtimit të tij, kur u nis nga Italija për në Shqipni dhe rreth disa përkthimeve që po bënja unë. U habit që nuk isha caktuar me ndonji shërbim të përshtatshëm, si në kulturë, ose në zyrën e përkthimeve.

Unë i thashë se po pregatitesha të kthehesha prapë n'Amerikë, se e shifnja që s'mund të bënja gjë këtu. Ay më tha të kisha durim, se do të rregulloheshin punët. Pastaj çfaqi pakënaqësira dhe tha se kishte mbetur keq financjarisht, me gjithë që kishin pasuri në Kairo. Unë i thashë se, po të donte, mund të merrej veht me Kairon me anë të Misionit Amerikan.

Unë i pata përmendur Tomit dhe Nick Cookyt, që e kisha parë Galipin dhe se ay donte të takohesh me këta.

Nick Cooky m'u përgjegj se e kishte takuar dhe i ish dukur jo fort i kënaqur kundrejt kësaj Qeverije dhe se punonte në Drejtorin e Mbrojtjes.

Në fillim të Janarit 1945-së, e takova prap Galipin, në rrugën e Barrikadave dhe filloj të më flas ay vetë, siç duket kishte rënë në marëveshtje me Cooky-n dhe kishte biseduar shumë gjëra me 'te. Më tha se punonte për Drejtorin e Mbrojtjes, më foli mbi arrestimet e shumta që po bëheshin dhe mbi torturat e pa-shembullta që përdoreshin kundrejt tyre. Më tha se direktivat për këto vinin drejtë nga Koçi. Ai më tha se nuk i jepej rëndësi korrektimit dhe riabilitimit të burgosurve politikan, me përjashtim të ndonji të riu.

Për Koçi Xoxen më tha se ishte shumë i zgjuar. Kur e pyeta nëse studjonte Koçi, ai më tha se po dhe se këshillohej shpesh me antarë të Misionit Rus, por më tepër me Ivanovin. Kur e pyeta nëse dinte Koçi rusisht, ay më tha se merresh vesht me anë të nji përkthyesi.

Galipi rrinte larg meje, se ay e dinte dhe më pat thënë edhe mua, që unë vëzhgohesha shumë. Për këtë arsye ay takohej me Cooky-n, me Tomin, të cilëve u jepte informata.

Nick Cooky më pat thënë se, "Jacku" u pat dhënë informata të vlefëshme. Ky me mua bisedonte gjëra të vogla, por kur takohej me 'ta, bisedonte gjatë e gjerë.

Galipi u pat thënë antarve të Misionit Amerikan se, Misioni i tyre vëzhgohej dhe mbaheshin shënim kush hynte edhe kush dilte dhe sa kohë qëndronin mbrenda, por nuk mirreshin masa imediate, me qenë se pritej njohja e Qeverisë nga ana e Aleatve.

Galipi më pat thënë mua se, në çdo lagje, kishte skuadra informative që raportonin në Seksjonin e Mbrojtjes. Më ka njoftuar se Nesti Kerenxhi, Nesti Zoto dhe Stefo Grabocka ishin besnikë të Koçit. Më ka thënë se edhe nëpër kafenet, shumica e klientave ishin informatorë të Drejtorisë. Gjithashtu më ka thënë se

brigadat e Mbrojtjes përbëheshin nga elementat më të vendosur. Këto gjëra ay i pat biseduar edhe me Cooky-n.

Herën e tretë e kam takuar tek Misto Terpo. Këtu më ka folur rreth gjendjes së mbrendëshme, të cilën m'a paraqiti kaotike, biseduam rreth plebishitit që mund të bëhej këtu, si pas Kartës së Atlantikut dhe sipas dëshirave të shpallura t'Anglo-Amerikanvet. Ay ish i mendimit se nji plebishit i tillë s'kishte për t'u pranuar këtu, kurrë nga këta që e kishin fuqinë, për arsye se do të dilte 80% opozitë, duke marrë parasysh moskënaqësin që ekziston, në çdo shtresë të popullit nga vështirësit ekonomike, nga ashpërsija e regjimit, nga pa eksperienca e sistemit.

Pastaj më kërkoj rivista Inglisht, që të praktikonte Inglishten dhe unë i thash që s'kisha, por t'i kërkonte Cooky-t.

Takimin tjetër e kemi bërë dyke dalë nga gjygji special i kriminelave të luftës. Ay më tha se t'akuzuarit mundoheshin më kot të mproheshin, se puna e tyre kishte marrë fund me kohë, mbasi dënimet e tyre ishin caktuar nga Drejtorija dhe se në krye të gjygjit ishte ustai vetë. Përsa i përket qëllimit të gjygjit, ay tha se bëhej për të demaskuar organizatat kundërshtare dhe për të fshehur vendimin e marrë para-gjykimit. Më tha se ay ishte i mendimit që do të dënoheshin shumë me vdekje, dhe veçanërisht exponentat e Ballit Kombëtar. Për Bahri Omarin, i cili ishte i kunati i Enverit, më tha se ky do të dënohej pa tjetër me vdekje mbasi dënimin e tij do t'a përdorin si shenjë drejtësije edhe sikur të mos ishte aq i fajshëm. Përsa i takon prokurorit, ay më tha se, Bedriu, ishte "dhelpër" dhe njeri me shumë rëndësi në Pushtet.

Përsa i përket Partisë, ay më ka thënë vetëm se, Koçi, ishte Sekretar Organizativ, kurse Sejfullai ishte ideollogu i Partisë. Tha se Partija funksjononte në celula të mëshefta, sikurse edhe më parë. Gjithashtu më ka thënë se që t'ishe një nëpunës me përgjegjësi, duhet të ishe pa tjetër antar'i partisë; po kështu edhe oficerat. Ajka e rinis, tha, rekrutohet në Parti.

Galipi më ka njoftuar se në Qeveri kishin influencë më shumë Koçi Xoxe, Sejfulla Malishova dhe Bedri Spahiu. Më ka thënë gjithashtu se Lëvizja Nacional-Çlirimtare donte t'i jepte përshtypjen se këtu ishte Fronti dhe jo Partia, gjersa të fitonin njohjen e Qeverisë nga Aleatët.

Pas Kongresit të I-rë të Rinis, takova prap Galipin, në bulevard dhe shkuam nga rrugica e kishës katolike. Këtej biseduam rreth vendimit të gjygjit dhe më tha: "E pe si duallën fjalët e mija?". Ay më vuri në dukje se ekzekutimi i tyre ka bërë shumë përshtypje. Kur i thashë se kishte për të bërë përshtypje shumë n'Angli dhe Amerikë, ay më tha se këta s'kan gajle. Për Kongresin e Rinis më tha se i kishin vënë rëndësi të madhe edukimit të masave dhe se rinija do t'a merrte përsipër këtë. Për Nako Spiron më tha se ishte tepër i zgjuar, por ambicioz dhe se ky do t'arrinte në pozita të larta; shtoj se Nakua ishte në relacione të ngushta me Koçin.

Këto kan qenë bisedimet kazuale, që kam patur me Galipin. Galipi këto bisedime i pat zhvilluar edhe me Cooky-n, si pas indikacioneve që më kish dhën mua ky i fundit. Më pat thënë Cooky se u kish dhënë sende me vleftë, porse ç'ishin ato as që isha interesuar t'i dinja dhe as që m'i kishin treguar. Tomi më pat thënë se rroga e

këtyre ishte në bazë të asaj që u jepnim n'Itali; tha se ja u kish caktuar 2000 franga veç shpërblimeve të tjera.

Mbasi erdhi Fultzi, më ka thënë Stevens se, "Jacku" (Galipi) ishte takuar me Fultzin dhe kish biseduar gjer e gjatë me 'të dhe se kishte për të patur relacione të përherëshme me 'të. Unë Galipin nuk e kam parë më, me përjashtim të nja dy herëve që jam salutuar në rrugë, kur ka qenë bashkë me të shoqen.

Loni Adami ka qenë nëpunës i legatës amerikane, para luftës dhe do të merrej prap po n'atë shërbim, si pas të thënave të Tomit. Tomi kshillohej me Loni Adamin dhe më duket se ka qenë edhe gjatë luftës në shërbim të nji pjese të misionit amerikan, prej të cilëve paguhej.

Tek Kol Kuqali kam qenë vetëm një herë, kur erdha në Tiranë, pas çlirimit. Këtë e njifnja që më parë familjarisht dhe vajta t'aa ngushullonj për humbjen e djalit. Me të kam biseduar rreth Tomit dhe ay më tha se ishte gjynah që Amerika të përfaqsohej nga nji njeri jo serioz, sikur se ishte Tomi. Më pyeti për amerikanë të tjerë, të cilët i njifte qëkurse ishte nëpunës në legatë, gjithashtu më pyeti dhe për Fultzin. Unë i thash se Fultzi mund të vinte këtu ose si ministër ose si drejtor'i Unrras, sikurse flitej n'ato kohë.

Tomi vinte shpesh ne Kuqali, por më kishte thënë se ishte besnik i Lëvizjes Nac. Çl. Sidoqoftë ay vazhdonte të vinte tek ay dhe bënte biseda politike.

Fultzi erdhi në Tiranë filloj të takohej me Kuqalin, me të cilin këshillohej vazhdimisht. Ishte koha kur këtij të fundit po i prekeshin interesat private nga reformat e Pushtetit në fuqi dhe kish filluar të devijonte nga Fronti.

Selahudin Totua ka qenë në relacione të mira me Tomin që në Berat, me gjithë që nuk e quante Tomin fort serioz. Kur erdhi Fultzi ky filloj t'a vizitonte dhe bisedonte me këtë rreth gjendjes në Shqipni. Toton unë e kam parë nja dy herë në Tiranë, por nuk kemi biseduar gjë me rëndësi, që të m'kujtohet, më tepër kemi bërë bisedime akademike, si mbi çështje fizike, literatyrë dhe filozofi. Mua m'u duk jo fort i kënaqur Totua dhe më kish shfaqur dëshirën që të shkonte n'Amerikë.

Ali Cungu ka patur lidhje të vazhdueshme me Tomin, këtë m'a ka thënë vetë Tomi. Ky i fliste shumë keq mbi gjendjen e Shqipërisë Tomit.

Beltoja, ish profesor në shkollën teknike, shkonte dentur tek Fultzi, nja dy a tri herë e kam gjetur dhe unë tek Fultzi. Sigurisht që Fultzi e ndihmonte financjarisht, për ndihmat që i nepte në pikpamje informative.

Beqir Haçin unë nuk e kam parë në mision dhe as që kam folur me 'të. Por Fultzi më pat përmendur se e kishte takuar dhe që vuante ekonomikisht si shumë të tjerë. Haçi i pat folur rreth luftës dhe rreth qëndrimit të tij si ballist. I kish përmendur se si ata prisnin që të zbarkonin Anglo-Amerikanët në Shqipni. Beqiri ka qenë profesor në teknike dhe nji simpatizant i Fultzit dhe i Amerikës.

Dino Shani ka patur miqësi të ngushtë me Tomin dhe sigurisht i jepte informata. Unë s'kam biseduar ndonji herë me 'te, por e kam parë në mision mjaft herë. Tomi më pat thënë se ky ishte i vlefshëm, mik i Amerikës dhe se e ndihmonte financjarisht.

Fultzin e vizitonin shpesh ish nxanësat e tij dhe bisedonin me 'te rreth gjendjes në Shqipni. Këta kan patur nji respekt të madh për Fultzin dhe i pranonin këshillat e

tij. Unë s'kam qenë asnji herë prezent në të tilla bisedime dhe se s'dij se ç'u-thoshte. Dij vetëm që këta persona e patën vizituar: Beltoja, ish profesor në teknike, Beqir Haçi, Xhuf Koliaka, Pasko Brahimaj, Hil Berisha, Ihsan Qereshniku, Vangjel Morcka, Beqir Çela, Abedin Çiçi, Anthim Konomi, Dhimosten Malo dhe Myfit Borshi.

Me Tomin ka patur miqësi edhe Petro Markua. Këtë të fundit unë e kam gjetur nji herë që hante drekë në mision. Këtë herë ishte dhe Tika Tezha dhe të gjithë së bashku kemi shkuar në Durrës, për të parë arritjen e vaporrit të parë t'Unrras.

Tika Tezha dhe Lik Toptani vinin shpesh në mision dhe kishin miqësi të ngushtë me Tomin. Por më vonë, nuk e dij për ç'arsye, këta u ndanë nga Tomi dhe kishin miqësi të ngushtë me Misionin Englez; me të cilin shkëmbenin vizita të shpeshta.

Me Lik Toptanin kemi qenë nji mbrëmje, në Korrikun e 1945-sës, në Valbonë, ku takuam dhe Majorin Smith, gjysmë të dehur. Pas pak piva dhe unë mjaft konjak. Prej këtu shkuam në shtëpin e Likës, ishte e para herë për mua, edhe këtu ja vazhduan të pirit. Smithi i shpjegonte dishka Likës në gjuhën frengjisht, mbi funksjonimin e Demokracis Britanike. Unë përkëthenja nga ndonji herë kur s'kuptonte Lika nga frengjishtja. Pas pak mua më zuri pija dhe dolla n'oborr. Këtu dishka ngjau se dikush kërceu mbrenda mureve dhe filluan shërbëtorët të bërtasin; personi që pat hyrë n'oborr u hodh prap përjashta. Më vonë mua më çoj Lika në nji shtrat, ndërsa Smithi po bëhej gati t'ikte.

Në Majin e 1945-sës, ishte organizuar nji piknik në malin Dajt, nga nji grup shqiptarësh në lidhje me Misionin Amerikan, të cilët furnizuan transportin. Mua më lajmëroj Loni Adami dhe erdh më muar kur u nisnë.

Këtu ishun prezent personeli i misionit ushtarak amerikan, vajzat e misionit diplomatik dhe disa nga të M.L.-it. Nga shqiptarët ishin: Loni Adami familisht, Irfan Majuni familisht, Malo Frashëri familisht, Ing. Adami familisht, Petro Afezolli dhe Sofokli Afezolli, Koço Xhori, Tika Tezha me të motrat, Lik Toptani, nja dy vajza toptanase, nja dy vajza të Koliakës, Polivaq Strati, dy vajzat e priftit, Koço Nini me zonjën dhe Dr. Dhimitër Lito. Pjesën më të madhe të pijeve e furnizoj Tika Tezha. Në mbrëmje erdhi me automobil dhe Hasaf Dragoti, mbasi na pat parë me dylbi që nga Tirana.

Përsa i përket veprimtaris informative që bëhej, kapiten Thoma Stefani më pat thënë se, shpesh herë, gjente zarfe me informata në Jeep, kur e qëndronte para pijetoreve, ose rojtores së zakonëshme, në rrugën e barrikadave. Ay më thoshte se këto informata s'kishin vleftë mbasi nuk firmoheshin, që kështu të vleftësoheshin informatat e shkrojtura.

Me sa dij unë, Thoma Stefani ka patur këto kontakte me femëra: me të mbesën e Sulltan Hamitit, e cila ikur për në Kairo me ndihmën e Gerson-it, Zyra e Njerzëve të Çvendësuar pranë Unrras, nga e cila Tomi thosh se merrte mësime frengjisht. Me nji italiane e cila më dukej se ishte e bija ose e mbesa e Mazzarinit. Me dy motrat Popa, që vinin shpesh tek Tomi dhe që kishte miqësi familjare me këto.

Kisha parë në mision dhe më pat prezantuar Tomi me Kaliroj Simon dhe Ksanthi Pidilo. Por nuk dij se çfar relacione kishin.

Qysh në fillim, kur erdhi Fultzi më pat këshilluar që, po të konstatonja ndonji

opozitë t'organizuar, unë të hynja mbrenda dhe t'a informonja se ç'elementa kishte, cili ishte programi i tyre, e të tjera. Unë i thash se s'kisha dëshirë të identifikohesha me ndonji grup politik, me qenë se donja t'iknja së shpejti n'Amerikë. Më në fund, mbas bisedimeve që bëra me Fultzin, fillova nga ky veprim.

Në fund të Majit 1945-së, ose në fillim të Qershorit po të këtij viti, m'erdhën në shtëpi Abdulla Muça dhe Reis Hasho. Këtë të fundit e njifnja, që kur ndenja në shtëpin e Tomor Frashërit për disa ditë dhe na pat diftuar i ati, i cili banonte po n'atë shtëpi, të gjithëve për muhabet nji mbas-darke. Ky më prezantoj me Ing. Muçon dhe filluam muhabet, duke më pyetur mua nëse do të rrinja këtu a po do të kthehesha përsëri n'Amerikë. Unë u thash se do të kthehesha përsëri, mbasi s'kisha se ç'banj këtu; shtova se mërgimi prej disa vjetësh më pat ndarë shumë nga zhvillimet që ishin bërë këtu. Ata më thanë se duhej të qëndronja këtu se vendi kishte nevojë pë mua, e të tjera dhe më njoftuan se këtu ishte formuar një organizatë, që ishte në favor të demokracive perëndimore, dhe se ftohesha edhe unë të merrnja pjesë dhe t'i vinja në kontakt me Anglo-Amerikanët. Unë i pyeta nëse kishin të bëjnë me kuislinga dhe ata më thanë se jo. Kur u kërkova shpjegime më të gjëra, ata më thanë se këto do t'mi jepte nji person tjetër, me të cilin do të më vinin në kontakt.

Të nesërmen, ose pas nja dy dit më takon Reis Hashua në rrugë dhe më lutet të vinja me 'të, mbasi do të më prezantonte me një nga njerëzit e tyre. Ky më shpuri n'apartamentin e Dr. Kiço Xhongos. Ky i fundit më foli më gjerë për organizatën, duke më thënë se përmblidhte shumë dega nëpër qytete të ndryshëm dhe se përkraheshe nga shumica e popullit. Shtoj se këta donin t'ishin në lidhje me Aleatët dhe se prisnin këshilla nga 'ta se si duhej të vepronin dhe se ishin në pozita t'a përmbysnin gjendjen me forcë, në rastë se u mohohej e drejta legale, që të shpreheshin dhe të formonin nji qeveri koalicioni. Këtë tha ay, d.m.th. të drejtën legale nuk e prisnim.

Në fund më lexoj disa pjesë të programit, ku përmendeshin, se ata dëshironin nji Demokraci të bazuar në parime të Demokracive Perëndimore dhe veçanërisht n'atë t'Amerikës. Më tha se ishin në favor të reformës agrare, në favor të krijimit të sindikatave dhe se donin nji Shqipni Ethnike. Sa për politikë të jashtëme ata do të deklaronin neutralitet permanent.

Kur e pyeta nëse kishin të bënin me t'arratisur, ay më tha se po, me Muharrem Bajraktarin, ku ishin grumbulluar mjaftë elementa që s'mund të rrinin nëpër qytete. E pyeta nëse ky ishte kriminel lufte, por ay më tha se jo dhe shtoj se ky ka luftuar kundra okupatorit. Xhonga ishte i mendimit se relacionet duhej të stabilizoheshin me Inglezët, mbasi këta interesoheshin pë Ballkanin.

Mbas disa ditësh vajta tek Fultzi dhe i a raportova këtë kontakt. Ky u enthuziasmua kur ndigjoj këte, se këtu kishte përkrahës t'organizuar të Demokracis së tyre dhe më prezantoj me nji herë me Jacobs.

Në prezencën e Jacobsit, më pyeti sa e madhe ishte organizata dhe se kush e dirizhonte, por unë s'e dinja: përmenda vetëm tre persona që kisha njohur unë, shtova se kjo organizatë kishte lidhje dhe me Muharrem Bajraktarin. Këta donin të dinin dhe

sasin e forcave që kish Muharrem Bajraktari, por unë s'dinja gjë për këtë pikë. Kur më pyetnë rreth programit, unë përmenda ato që më pat lexuar Kiço Xhongua. Atëhere ndërhyri Jacobs, kur përmenda politikën e jashtme dhe tha: "Tani është pak si zorr të mbahet neutraliteti". Pyeti nëse kishte intelektualë, a kishin lidhje ose jo me fshatarsin, sende këto që unë nuk i dinja, duke vënë në dukje se këtu fshatarsija është e varfër dhe mund të kishte shpresa në programin e Qeverisë në fuqi. Në idenë se mund të përdorej edhe forca, në rastë se nuk zgjidhej çeshtja legalisht, ay tha se mund të ndërhynte Jugosllavija dhe kështu kishin për të dalë konplikacione ndërkombëtare. I thashë se ata donin të bënin nji marëveshtje me Anglo-Amerikanët që në rastë se përdorej forca të përkraheshin nga këta të fundit. Në këtë kohë Fultzi tha: "Referouaju Englezëve këtë, se ata interesohen më shumë për këto punë; ne do të vazhdojmë të rrijmë lark. I thashë se kjo ishte edhe dëshira e atyre që më thanë këto.

Të nesërmen vajta ne Inglezët dhe kërkova të flas me Palmerin, me qenë se këtë e njifnja që n'Italí. Këta nuk e dinin që unë pata informuar Amerikanët mbi këtë gjë dhe as që u thashë se ç'biseduam me këta të fundit. Edhe me Palmerin bëra të njëjtin bisedim, por përgjigjësija e tyre ishte: "Do t'ja referojmë Shtabit të Mezdheut". Pastaj shtoj se Palmeri se ata s'kishin për të përkrahur asnji opozitë po të kishin lidhje me kuislinga.

Kur ja njoftova Xhongos ndërlidhjen që pata bërë, ay nuk më besonte dhe për këtë arsye kërkoj mbas disa kohe, që të takohej vetë me Palmerin ose me Smithin.

Nji ditë të muaajit Qershor 1945-së, kur e takova Palmerin në kafe sahati, i thashë se një nga t'organizatës donte të takohej me 'te. Ay e pranoj dhe pasi e lajmërova Xhongon, u bë pikëpjekja në Valbona. Unë, Palmeri dhe Smithi po pinim në barë të Valbonës, kur erdhi Kiço Xhongua. I prezantova me Xhongon dhe Palmeri foli pak më nj'anë me 'të në gjuhën frëngjisht. Kiço Xhonga iku dhe pas pak ditësh dhe pas pak ikën edhe ata të dy.

Kohë pas kohe më pyetë Kiço Xhongo nëse kisha marrë ndonji përgjigje dhe kur i thashë se jo, atëhere ay kërkoj që Palmeri ose Smithi të mirrnin pjesë në nji mbledhje me disa nga antarët e organizatës. Xhonga sugjeroj se do të bëhej në shtëpin e Abdulla Muçës dhe me qenë se nuk e dinjaa unë shtëpinë, më këshillonj që t'i udhëhiqnja gjer ne qoshja e udhës së Zajmit, ku del në rrugën e Dibrës.

Palmerin e takova në kafe Bar Sahat dhe e lajmërova përsa më tha Xhonga dhe ky e pranoj. Nji mbrëmje aty nga fundi i Qershorit 1945, Palmeri me Smithin erdhën në këmbë gjer ne qoshja e caktuar dhe atje i mori Kiço Xhonga dhe Abdulla Muça dhe shkuan. Pas pak më thërresin edhe mua, erdhi vetë Abdulla Muça më mori. Aty gjeta veç Kiço Xhongas edhe Qenan Dibrën, të cilin nuk e njihnja mëparë. Këta biseduan në gjuhën frengjisht më nj'anë, ndërsa unë e Smithi po pinim. Këtu nuk e dij se ç'u bisedua, pasi si thashë ata biseduan në gjuhën frengjishte dhe unë s'mora pjesë në bisedimet e tyre. Kur më përcolli mua Muça, ay më tha se kishin biseduar gjerë e gjatë rreth programit dhe Palmeri kish mbetur i kënaqur.

Nuk mbanj mend nëse ma dhanë këtu programin për t'a përkthyer, por dinj se e mbajta në xhep ndonji ditë e gjysmë dhe i a ktheva përsëri Abdulla Muças pa

e lexuar dhe pa e përkthyer; i thashë që unë s'kisha mundësi t'a përkthenja. Këtë e bëra më tepër nga përtesa. Atëhere ay më tha që të vinja pak në mulli të tij, në rrugën e Dibrës dhe më futi në nji dhomë, ku po përkthente Emin Bakalli. Ky i fundit më pyeti për disa fjalë që s'i dinte.

Këto unë ja njoftova Fultzitt, por ay më duket se kishte dijeni, mbasi gjatë tregimit t'im nuk interesohej edhe aqë shumë. Veçse më pyeti se ç'premtime u kishin dhënë Inglezët. Unë i thashë se s'kishin marrë gjë gjer atëhere, me qenë se çeshtja i ishte referuar Shtabit të Mezdheut. Me këtë rast i them se Muharrem Bajraktari kishte 2000 veta, simbas të dhënave t'Abdulla Muçës.

Në muajin korrik, kur po shkonte Palmeri për n'Itali, ju dorzua Palmerit dhe Smithit programi në të dalë të Valbonës.

Para se t'u dorzohej Englezve programi, me qenë se Emin Bakalli nuk e kish mbaruar edhe me makinë, më çoj mua Abdulla Muça, në shtëpin e Bakallit për t'a ndihmuar. Këtu unë i lexova nja dy o tri faqe Bakallit dhe ay shtypte në makinë. Pas pak unë ika për në Valbonë dhe u takova me Palmerin dhe me Smithin, të cilët muarën në dorzim programin jasht derës së Valbonës.

Pak kohë para se çpallej Ligji Elektoral, më pyeti Palmeri se çka do të kërkonte organizata nga Englezët, në rastë se bëheshin zgjedhjet për së shpejti. Mbasi pyeta Xhongon ase Abdulla Muçën, unë i thash Palmerit se donin liri propagande, dhe aleatët të dërgonin mbikqyrës ditën e zgjedhjeve.

Mbasi u shpall Ligji Elektoral, të dy misionet, Amerikanë dhe Inglezë, ishin të mendimit që organizata të (u shua nji fjalë) dilte sheshit, por ajo kërkonte sigurime nga këta që të mos persekutoheshin antarët e saj. Njikohësisht prisnin të delte ndonji gazetë por dhe kjo s'u bë.

Në këtë kohë unë vendosa të hyej në Unrra, me qenë se u mërzita, duke ndenjur kafeneve. Për këtë ju luta Fultzit të fliste me Hillin, duke i thënë se unë ishja në rrezik t'arrestohesha, duke ndenjur pa punë në Tiranë dhe në kontakt me njerëz që vepronin ilegalisht. Fultzi foli me Hillin, por unë s'mora ndonji përgjigje, gjersa aty nga fundi i gushtit, vajta vetë tek Hilli dhe ay më tha se ishte nji vend bosh në Durrës dhe mund të hynja.

Në fund të gushtit shkova në Durrës dhe i preva kontaktet me organizatën për nji kohë të gjatë. Në Unrra isha si ndihmës sekretari dhe mbanja llogarit e përditëshme të shkarkimit të mallrave.

Me anë të disa miqëve që zura në Unrra, po mundohesha të rregullonja kthimin t'im n'Amerikë, me qenë se po shifnja që Fultzi s'po përkujdesej dhe aqë shumë. Nji nëpunës amerikan n'UNRRA e mori përsipër që t'më ndihmonte, duke më thënë se kishte miqë me influencë në Ëashington dhe më kërkoj nji biografi të shkurtër për t'a përdorur si referencë.

Unë i dhashë nji relacion në të cilën pështkruanja mbi punën t'ime që pata bërë në S.B.S., ardhjen t'ime në Shqipëri, ç'faqnja pakënaqësit kundrejt Pushtetit në fuqi dhe më në fund për pamundësi qëndrimi në Shqipëri, çfaqnja dëshirën për kthimin t'im n'Amerikë.

Mbas nji kohe shkëputjeje nga organizata anti-pushtetit, nga fundi i Tetorit 1945-së, një të djelë, kur unë po kalonja para kafe Kursalit më ndaloj Reis Hashua dhe më prezantoj me disa njerëz që ishin ulur sëbashku. Më prezantoj me Sami Qeribashin, si vokat, Ali Kavajën dhe një tjetër që s'ja mbaj mend emërin, por që më duket se ishte Mëniku. Unë i u thasshë se s'mund të qëndronja me qenë e kisha miq në shtëpi, ku do të celebronja martesën dhe mbasi më uruan hika.

Ndonji javë para zgjedhjeve e gjej Reis Hashon në rrugë dhe më njofton se kishin bërë një lutje pranë Aleatve, për t'i shtyrë zgjedhjet dhe se ay pat vënë edhe firmën t'ime. Unë i thashë mirë për këtë gjë.

Ditën e zgjedhjeve e takova pak Reis Hashon, në rrugë dhe vendosmë që të rrinim rehat mbas zgjdhjeve.

Mbas 2 Dhjetorit unë s'pata asnji kontakt me organizatën. U vendosa në Durrës familisht, rrinja i vetmuar dhe i isha vënë punës që t'iknja sa më shpejt sëbashku me gruan. N'ato kohë dukej se po stabilizohej dhe shërbimi konsullor në Tiranë, gjë që do t'më lehtësonte emigracionin.

Mbasi u bënë arrestimet e para në janar, pata ardhur në Tiranë me postën e UNRRA-s dhe takova dhe Fultzin. Ay kish marrë vesht për arrestimet dhe më pyeti: "Akoma i lirë qenke?". I thashë se ashtu _____ dhe ay më tha që t'iknja menjiherë me ndonji vaporr t'UNRRA-s. Unë donja t'iknja por s'pata mundësi dhe me 23 janar 1946 u arrestova.

Në marsin e 1945-sës më kan ardhur nga Italija prej zyrës S.B.S. 2000 dollarë amerikanë t'okupacionit, këto rrithnin nga pagesat e prapambetura.

AIDSSH, N= 1081-A. VITI 1961, D. 3.

BIOGRAFIJA E LARY POST (Lazar Apostoli). – Është lindur në Ziçisht të Korçës dhe që i vogël u largua nga Shqipërija për në Amerikë. Dhe se ësht kthyer me Misionin e parë Amerikan në Shqipëri. Arsyet përse ësht larguar nga Misjoni Amerikan nuk dihen. Tani shihet civil. Me gjithë që ësht larguar nga Misjoni Amerikan, prap se prap shihet të bisedojë gjatë si me Thoma Stefanin, Smithin e tjerë. Rrethi shoqëror i tija ësht: Solomon Gatagna Çifut Jugosllav, i cili para disa ditësh u arrestua nga S.E.M.P. por prap u lirua për mungesë faktesh. Ilia Polloshi nënpunës pranë Ministris së Ekonomis, Aleksandër Koçi, prej Pogradeci, nënpunës i Ministris Asistencës Socjale, Komisjoni i Strehimeve, prej Koço Ninit dhe së shoqes së tij Violeta Xhaçka (pa punë) e prej një Izrailiti tjetër Jugosllav. Të gjithë shihen shpesh herë së bashku duke biseduar me orë të tëra.

AIDSSH, N= 1081-A. VITI 1961, D. 3.

SEKSIONI I MBROJTJES SË POPULLIT — Durrës, më 19.X.1945
P Ë R D U R R Ë S
Nr. 1215/1 Prot.

DREJTORIS MBROJTJES POPULLIT
SEKSIONIT II-të

T I R A N Ë

LAZAR POST. – Kombësi Shqiptare, i larguar nga Shqipërija për n'Amerikë për nji kohë të gjatë, dhe i rikëthye pak para shlirimit të Shqipërisë, punon në U.N.R.R.A.

I përmenduri me biseda që ka pasë me njerz intim të tijë, është mundue të paraqitet njeri i Frontit. Ka thënë se ka pasë shërbye në dipartimentin e punëve të Jashtëme të Shteteve të Bashkuara si Shef'i nji Seksioni dhe pikërisht për punët e Shqipërisë. Pagohesh për këtë detyrë 20000 Fr. Shq. (njizet mijë) në muej, dhe qëndronte para se të këthehesh këtu, në Bari (Itali).

Pretendon të jetë thirrur në Shqipëri nga njerz udhëheqësa të L.N.Çl., si Bedri Spahiu, Mehmet Shehu e tjerë, me premtim se do të jepesh nji detyrë me randësi në Ministrinë e Jashtëme.

Qëndrimi i tijë në U.N.R.R.A. e konsideron si nji humbje për vehten e tijë, mbassi aty pagohet vetëm 2000 Fr. Shq. (dymijë) në muej; dhe se këtë humbje e paska nga largimi i detyrës së tijë në Bari. Mundohet të paraqitet se i urren Anglo-Amerikanët, dhe se edhe nëpunsit e huej të Unrras e u-rrejnë këtë.

Punon në zyrën e Kolonelit Englez, bashkë me nji grue tjetër Engleze. Është njeri mjaftt i zgjuet, tregohet mjaft i kufizuar në biseda të ndryeshme.

Takohet me Hamid Tabakun, Vangjel Manushin dhe Fonci Dovanën.

Shef'i Seksionit
(Vilson Pecani)

AIDSSH, N= 1081-A. D. 3.

REPUBLIKA POPULLORE E SHQIPËRISË — VDEKJE FASHIZMIT
PROKURORIJA E GJYKATËS USHTARAKE — LIRI POPULLIT
TË NALTË
Nr. 5 Regj. Them.

A K T - A K U Z Ë
(KOMUNIKATË)
GJYKATËS USHTARAKE

Sikurse do të konstatohet dhe nga proces-verbalet e mbajtura prej Seksioni M.P. Tiranë, që bashkangjitur paraqiten, i pandehuri Haki Karahoxha, i biri Rizait dhe i Qehaja, vjeç 34, nga Elbasani, me profesion puntor, i rreshtuar më datën 21-I-1946 akuzohet se i pandehuri Haki Karahoxha gjat okupacionit fashistë-nazistë ka shërbyer si besnik i tradhtarit Shefqet Vërlacit.

2) Ka qenë ndërlidhës i kriminelave të luftës si A. Leshanakun me Zonjën e Shefqet Vërlacit e cila i ka dhanë dhe para.

3) I pandehuri ka bërë pjesë në grupin terorist të rezistencës dhe ka vënë në lidhje me kriminelat e luftës A. Leshanakun për të kordinuar veprimet kundra pushtetit të popullit.

4) Ka bashkë punuar dhe me grupin fashist monarkistë dhe ka vënë në lidhje me kriminelat e njohu A. Leshanakun.

5) Ka punuar me gjith organizatat trathtare kundra pushtetit popullor për ta rëzuar me violencë, ka punuar gjith veprimtarin trathtare të grupit fashist.

Mbasi faji i tij parashikohet i ndëshkushëm prej Neneve nr. 1 të Ligjës Nr. 21 dt. 15.XII.44 dhe 15 II të Ligjit Nr. 41 dt. 15/1/1945, është parë e nevojshëme që ky të gjykohet.

P r a n d a j:

Kërkoj gjykimin e tij nga ana e asaj Gjykate dhe mbasi t'i faktohet faji që akuzohet, në përfundim të vendoset ndëshkimi i tij në bazë të Nenit 18 Ligjit Nr. 41 dt. 14.Janar.45 mbi organizimin e funksionimin e Gjykatave Usht.

Tiranë më 10.VI.1946. P R O K U R O R I :
(Kap.I-rë: Nevzat Haznedari)

AIDSSH, N= 1081-A. D. 3.

REPUBLIKA POPULLORE E SHQIPËRISË
GJYKATA USHTARAKE E NALTË
Nr. 5. Regj. Them.

VDEKJE FASHIZMIT
LIRI POPULLIT
Tiranë më 8.VIII.1946

Drejtoris së Burgut TË RI

T I R A N Ë

Ju njoftojmë se kjo Gjykatë me vendimin e saj Nr. 5 Regj. Dat. 2.VII. 1946 ka vendosun ndëshkimin e HAKI RIZA KARAHOXHËS nga Elbasani, me 10 VJET BURGIM, humbjen e të drejtave qytetare e politike, si dhe konfiskimin e pasuris.

Ky vendim ka marë formën e preme.

Ndëshkimi i fillon më datën 23 / I / 1946 dhe i mbaron më Dat. 23 / I / 1956.
Për KRYETAR' I GJYKATËS USHTARAKE
(Major Frederik Nosi)

AIDSSH, N= 1081-A. D. 3.

REPUBLIKA POPULLORE E SHQIPËRISË — VDEKJE FASHIZMIT
PROKURORIJA E GJYKATËS USHTARAKE — LIRI POPULLIT
TË NALTË
Nr. 5 Regj. Them.

A K T - A K U Z Ë
(KOMUNIKATË)
GJYKATËS USHTARAKE
K Ë T U

Sikurse do të konstatohet dhe nga proces-verbalet e mbajtura prej Seksionit të M.P. të Tiranës, që bashkangjitur paraqiten, i pandehuri MYRTEZA BELI, i biri HAKI dhe i ZYRHA, vjeç 44 nga KORÇË, me profesion Nëpunës, i rreshtuar më datën 10 Janar 1946, akuzohet se i pandehuri Myrteza Beli inisiator dhe organizator i grupit tradhëtar dhe terorist të Korçës, i lidhur ngushtë me grupin terorist të Rezistencës në Tiranë për të rëzuar me violencë pushtetin e popullit.

2) Ka marë pjesë në mbledhjet e mshehta që janë bërë në Tiranë dhe në Korçë.

3) Ka mbajtur lidhje të ngushta me kriminelat e luftës t'aratisur brenda dhe jashtë shtetit.

4) Është munduar që të mbahen lidhje me reaksionin e jashtëm e sidomos me reaksionin Grek dhe në bashkëpunim me këtë dhe me kriminelët e luftës, të luftojë pushtetin demokratik me armë për t'a rëzuar.

5) Ka pranuar me kënaqësi më të madhe gjith veprimtarinë tradhëtare të Grupit të Rezistencës.

Mbasi faji i tij parashikohet i ndëshkushëm prej Nenit 1 të Ligjit Nr. 21, dat.15.12.44 dhe 15 II. Ligjit Nr. 41, dat.14.I.945, është parë e nevojshëme që ky të gjykohet.

P r a n d a j:

Kërkoj gjykimin e tij nga ana e asaj Gjykate dhe mbasi t'i faktohet faji që akuzohet, në përfundim të vendoset ndëshkimi i tij në bazë të Nenit 18, të Ligjit Nr. 41, dat. 14 Janar 1945, mbi organizimin e funksionimin e Gjy.Usht.

Tiranë më 10.VI.1946. — P R O K U R O R I:
(Kapiten i I-rë NEVZAT HAZNEDARI)

AIDSSH, N= 1081-A. D. 3.

REPUBLIKA POPULLORE E SHQIPËRISË
GJYKATA USHTARAKE E NALTË
Nr. 5 Regj. Them.

VDEKJE FASHIZMIT
LIRI POPULLIT
Tiranë më 8.VII.1946

Drejtoris së Burgut TË RI.

T I R A N Ë

Ju njoftojmë se kjo Gjykatë me vendimin e saj Nr. 5 Regj. Dat. 2.VII.1946 ka vendosun ndëshkimin e MYRTEZA BELIT nga Korça me 25 VJET BURGIM, humbjen e të drejtave qytetare e politike, si dhe konfiskimin e pasuris.

Ky vendim ka marë formën e preme.

Ndëshkimi i fillon më datën 10 / I / 1946 dhe i mbaron më Dat. 10 / I / 1971.

Për KRYETAR' I GJYKATËS USHTARAKE

(Major Frederik Nosi)

AIDSSH, N= 1081-A. D. 3.

REPUBLIKA POPULLORE E SHQIPËRISË
P R O K U R O R I J A E
GJYKATËS USHTARAKE E NALTË
Nr. 25 i R. P.

Vdekje Fashizmit – Liri Popullit

L e t ë r - R r e sh t i m

K o n d r a :

Myrteza Beli, bir' i Hakiut dhe i Zyhras, vjeç 44 nga Korça, me profesion nënpunës

A k u z o h e t

Si sabotatorë të luftës dhe të pushtetit popullor dhe armiq të popullit.

Me qenë se faji i tij parashikohet prej Nenevet 1 të Ligjës Nr. 21 datë 15.XII.1944 dhe 15 parag. II të Ligjit Nr. 41 datë 14.I.1945

Ne Prokuror' i Gjykatës Ushtarake në bazë të Nenit 20 Parag. III të Ligj. Nr. 41,

U r d h ë r o j m ë :

Rreshtimin e tij për një kohë të pa caktuar në burgun e Tiranës.

Organet e M. P. Policis dhe çdo fuqi e armatosur ngarkohet me zbatimin e këtij letër-rreshtimi.

P R O K U R O R I

Kap. I-rë Nevzat Haznedari

KRYETARI

Tiranë më 10.V.1946

Vdekje Fashizmit Liri Popullit

Dekllaratë

I nënëshkruari Myrteza Beli nga Korça me anën e kësaj dekllaroj se: Vepra e krijuar nga Sami Çeribashi me shokë e lidhun me elementa fashistë dhe kriminela t'aratisun për kondra Pushtetit Demokratik të sotçëm, ka qënë një vepër tradhëtare dhe fashiste e cila mund të shkakëtonte gjak derdhje e vëlla-vrasje të kotë në dëm të interesave t'atdheut mundet dhe në copëtimin e Shqipërisë dhe si të tillë unë e dënoj dhe pendohem për gabimin që kam pas bërë për sa që kam vepëruar në të simbas dekllarimeve në hetuesi dhe që është i pari gabim në jetën t'ime ku kam vepëruar me krejt inkoshiencë.

Pra lëshoj këtë dekllaratë me vullnetin t'im të lirë dhe pa u detyruar prej askujt dhe premtoj e siguroj me jetën t'ime se që sot e tutje kam për të qënë ushtari më i bindur e besnik i Lëvizjes N. Çlirimtare për mbrojtjen e Pushtetit Demokratik të sotçëm.

Tiranë më 6 Shkurt 1946

Dekllaruësi:
Myrteza Beli

AIDSSH, N= 1081-A. VITI 1961, D. 3.

SEKSIONI MBROJTJES POPULLIT
PËR TIRANËN
Nr. 58 Prot. Rez.

VDEKJE FASHIZMIT
LIRI POPULLIT
Tiranë, me 9 Shkurt 1945

DREJTORIS MBROJTJES POPULLIT
T I R A N Ë

Këtu poshtë ju përshkruajmë nji bisedim që ka pasur nji shoku i jonë me të qojturin Lari Post (Llazar Apostoli) i ardhur prej Amerike si vullnetar dhe që banon në shtëpin e Vasil Xhaçkës. I naltpërmenduri ka lidhje me Misionin Amerikan të këtushmë. Duket se di dhe opinionin e Misionit Englez.

Ai ka thënë se misionet e Aleatve, sidomos ai Englez, ruajnë dhe përgjojnë shumë opinionin shqiptar dhe përpiqen të vinë në kontakt direkt me popullin. Inglitera është më e interesuar për fatin e Europës Jug-Lindore. Kësaj i është njohur, shton Lari, e drejta në Ballkan me përjashtim të Jugosllavisë. Kjo e drejtë shton i është njohur në Konferencat e Moskës dhe të Teheranit. Këta përpiqen të ngrenë

reaksionin këtu, pse kështu do të mundin të ruajnë më mirë interesat e tyre. Balli dhe Legaliteti, shton Lari, subvencionoheshin nga Inglezët. Këta i kishin dhënë premtim; jo zyrtar, Mbretit Zog për kthimin e tij në Shqipëri. Kjo u vu re, shton, nga ndihma që i dhanë Bazit nga misioni që rrinte pranë tij. Shton, se Radio Bari drejtohet nga reaksioni Englez. Ata oficera që kanë ndihmuar lëvizjet Nac.Çl. shtoi, janë transferuar në Kinë dhe në vende të tjera të largëta për dënim.

Përsa i përket mitingut të pardjeshëm, misioni Engles e pandehu si një akt kundra tyre dhe pandehu se mos populli ishte revoltuar kundra tyre. Prandaj u fshenë kur populli ishte para tyre.

Ai thotë se Englezët ndalojnë njerës rrugës dhe i pyesin në se janë të kënaqur nga gjendje e re.

Gjith'ashtu këtu poshtë ju përshkruajmë nji bisedim i Loni Adamit me nji nga zbulusat t'anë:

Simbas pyetjesh Loni përgjigjej. Mbledhja midis Stalin-Roosevelt-Churchill, nuk do të sjellë përfundime të mira në përgjithësi, e sidomos Qeverinë t'onë nuk mund t'a njohin se këta nuk e mbajnë Demokracinë, si shëmbëll: Nuk lejojnë asnji Parti tjetër ase gazetë të dalë prej elementash demokratë, shumë shok të lëvizjes kanë bërë shumë artikuj për t'i shtypur në gazetën "BASHKIMI", por nuk ja kanë botuar se ka diktaturë. Mua më pëlqen, vazhdoi, Demokracija Amerikane dhe jo Engleze, se populli dhe Qeverija Amerikane janë lidhur shumë ngushtë me Bashkimin Sovjetik, dhe U.R.S.S.-i i ka kërkuar Qeveris Amerikane 60 miliarda dollarë për rimëkëmbjen e saj; ndërsa këtu në Shqipëri ndjekin tjetër rrugë. Si shembull: kam pasur nji takim me Shokun Nako Spiru – thotë Loni – dhe më ka thënë se Amerika është më e keqe në politikë se Anglija.

SHEF' I SEKSIONIT
(Stefo Grabocka)

Gjësendi për të thënë të thërresish kolonelin (Nestin) ose Gjeneralin (Koçin), por unë mbassi nuk kisha se ç'far të thoshja nuk kam thënë kurgjë dhe nga kjo ata përdornin tortura të tmerrshme duke më sakatepsur sa së fundi shkova në spitalë për t'u mjekuar dhe prapë jam gjysmë njeriu pse kam humbur zërin nga që më është shkatrruar gërrmazi. Nji ditë kur unë jesha këtu në burg ndigjova se po flitte autoparlanti mbi Kongresin e Partisë dhe që atëhere mejtova se e drejta e ime do të dilte në shesh.

Dt: 15.II.1949. DEKLARUESI:
(Llazar Papapostoli)

AIDSSH, N= 1081-A. VITI 1961, D. 3.

SEKSIONI V-të Tiranë, me 3.X.1947

ELEMENTI NË LIDHJE ME ENGLEZ

1) – FUAT ASLLANI. – Ish antar dhe kryetar i "Bashkimi" në kohë të Fan Nolit, emigrant politik, i kthyem në kohë të Zogut, dhe Ministër i Punëvet të Jashtme. Ma vonë ambasador i Shqipëris në Londër. Intelektual me nji farë influence ndër rrethet intelektuale. Në kohë të italianëvet, në Këshillin e Shtetit. Grueja e tijë "Zonjë nderi" e Jakomonit. Ka përfitue nga pozita e gruas tijë dhe muejti të marri leje që të bënte tregëti etj. Të Misionit Englez kanë shkuar në shtëpi të tijë. Asht Anglo-fil i njojtur. E gjithë familja e tijë ka studjuar ndër shkolla Engleze.

2) SUAT ASLLANI. – Avokat, internuar politik nga italjanët. Ka shumë influencë ndër rrethet intelektuale.

3) RESHAT ASLLANI. – Ka studjuar nër shkolla Engleze. Profesor në shkollën Amerikane të Kavajës.

4) RESHAT JELLA. – Ka qenë Prefekt në kohë të Zogut. I pa kompromentuar me Italianët dhe Gjermanët. I lidhur që me kohë me Englezët.

5) LONI KRISTO. – Profesor, i internuar në Ventotene.

6) ALI CUNGU. – Profesor në shkollën Teknike, agjent i sigurt i Englezëvet, flet kondra nesh. Nji letër e tijë që asht zzënë, drejtue Fultz-it, ku i thotë se vehet në shërbim të Amerikanëvet për rindërtimin e vendit. Nënvleftëson luftën t'onë.

7) LARI POST. – I ardhur nga Bari. Person inteligjent. Punon mëçeftas për të krijue nji organizatë demokratike, indipendente, kundra Frontit. I lidhur shumë ngushtë me Amerikanët.

Elementa të tjerë të nji randësije të dytë

8) ABEDIN ÇIÇI. – nxanës i shkollës Teknike, antar i Këshillit Nacional Çlirimtar të Shqipëris. Simpatizon Fultz-in dhe Amerikanët.

9) LONI ADAM. – Ish nëpunës i Legatës Amerikane. Në kontakt me Englez dhe Amerikan. Hyjnë e dalin në shtëpi të tijë. Shumë i afërt me Englez. Përpiqet të mbulojë këtë aktivitet. I lidhur shum ngushtë me interesin e tijë.

10) HASAN JERO. – Dentist, kunat i Fuat Asllanit. Ka lidhje me Englez.

11) KOÇO SEMINI. – Ish nxanës i shkollës teknike.

12) KOSTAQ STEFA. – Ish nxanës i shkollës teknike.

Të tjerë elementa shqiptarë të ardhur nga Bari, të nji randësije të dorës së ddytë, punojnë që të ngjallin pakënaqësira.

Shumë nxanës të ish shkollës teknike amerikane bajnë lëvizje dhe përhapin parulla kundra lëvizjes dhe në favor të Anglo-Amerikanëvet (si kundra nesh).

Të gjitha këto informata nuk janë pasqyra e vërtetë e këtij problemi (mbasi kjo është nji problem i vërtetë). Punohet me gjallëri nga ana e Misionit Anglo-Amerikan për të krijue nji rjetë spiunazhi dhe organizatash politike në dam t'onë. Shërbimet

t'ona nuk janë akoma në gjendje që të japin nji ide të kjartë dhe të kontrollojnë gjendjen. Reaksionarët e lidhur direkt dhe indirekt me gjermanët janë që të gjithë rezervë të këtyre misjonevet.

Kapitalistët janë në lëvizje pë t'u lidhur me 'ta, dhe këta interesohen shumë për punë tregëtare dhe për të gjithë jetën ekonomike të vendit.

Në lidhje me Kosovarët banues në Tiranë, nuk kemi informata të sakta, nuk dihet mirë se ç'bajnë këta dhe ç'ka kërkojnë. Kemi ngarkuar disa shokë për të mbledhur informata të sakta për këtë çështje. Dihet që në Tiranë nuk ka elementa reaksjonare kosovare, të zot për të krijue nji lëvizje kosovarësh. Ata që qenë të zot kanë ikur. Ata që ndodhen këtu janë elementa pasivë; me këtë nuk duem të themi që ata pranojnë të zgjidhin problemin kosovar ashtu siç e mendojmë neve.

Mbledhja e kosovarëvet ka qenë e provokume nga neve para nji viti për t'i përdorur kundra propagandës së armikut. Në kohët e fundit neve kemi urdhëruar organizatave t'ona që të organizojnë kosovarët simbas lagjevet të qytetit, së bashku me banorët e tjerë të qytetit por jo të organizohen veçmas.

Nga informatat që na kanë ardhur mbi atë që ndodh në Greqi, kemi mësuar që disa elementa reaksionar, të së djathtës, hapnin parrulla se ajo që ndodh nnë Greqi, për Partin Komuniste të Greqis, do t'i ndodhi gjithë Partive Komunist në Ballkan, e që Englezët për të kryem këtë gja kanë zbarkuar në Greqi 500.000 ushtar. Kuptohet që çështja e Greqis ka inkurajue elementet e së djathtës.

AIDSSH, N= 1081-A. D. 3.

REPUBLIKA POPULLORE E SHQIPËRISË
GJYKATA USHTARAKE E NALTË
Nr. 5 Regj. Them.

VDEKJE FASHIZMIT
LIRI POPULLIT
Tiranë më 8.VII.1946

Drejtoris së Burgut TË RI.

T I R A N Ë

Ju njoftojmë se kjo Gjykatë me vendimin e saj Nr. 5 Regj. Dat 2.VII.946 ka vendosun ndështkimin e KOL RODHES, nga KORÇA me 30 VJET BURGIM, HUMBJEN E TË DREJTAVE QYTETARE E POLITIKE, SI DHE KONFISKIMIN E PASURIS.

Ky vendim ka marë formën e preme.

Ndështkimi i fillon më datën 25 / I / 1946 dhe i mbaron më Dat. 25 / I / 1976.

Për KRYETAR' I GJYKATËS USHTARAKE
(Major Frederik Nosi)

AIDSSH, N= 1081-A. VITI 1961, D. 3.

REPUBLIKA POPULLORE E SHQIPËRISË VDEKJE FASHIZMIT
PROKURORIJA E GJYKATËS USHTARAKE LIRI POPULLIT
TË NALTË
Nr. 5 Regj. Them.

A K T - A K U Z Ë
(KOMUNIKATË)
GJYKATËS USHTARAKE

Sikurse do të konstatohet dhe nga proces-verbalet e mbajtura prej Seksionit M.P. Tiranë që bashkangjitur paraqiten, i pandehuri Lluka Bibi, i biri Kostandinit dhe i Athinasë, vjeç 45 nga Përmeti me profesion Noter, i rreshtuar më datën 10 Kallnor 1946 akuzohet se i pandehuri Lluka Bibi gjatë kohës së okupacionit fashistë ka qenë Federal i P.F.Italiane, ka qënë anëtar'i Komitetit Qarkor të Ballit dhe anëtar'i Komisionit Internimeve.

2) Ka penguar luftën e popullit shqiptar me axhitasionin e t'ij helmatues pro-Fashistë.

3) Është nji ndër antarët më aktiv të grupit fashist të Korçës të lidhur ngushtë me grupin teroristë të rezistencës në Tiranë për të luftuar pushtetin e popullit me armë.

4) Ka marrë pjesë në mbledhjet e mshefta qi ka bërë grupi në Korçë.

5) Ka pranuar e bashkë punuar për të formuar lidhjet me kriminelatë e luftës mbrenda e jashtë shtetit si dhe me reaksionin e jashtëm kundra Pushtetit.

6) Ka qenë ndërlidhës ndërmjet grupit të vetë me grupin tradhtar të Soçial-Demokratëve dhe axhitator i fortë kundra pushtetit për të shtuar radhët e grupit trathtar.

Mbasi faji i tij parashikohet i ndëshkushëm prej Neneve 1 të Ligjës Nr. 21 dt.15. Dhjetor.44 dhe 15 II të Ligjit Nr. 41 dt.14.1.45. është parë e nevojshëme që ky të gjykohet.

P r a n d a j:

Kërkoj gjykimin e tij nga ana e asaj Gjykate dhe mbasi t'i faktohet faji që akuzohet, në përfundim të vendoset ndëshkimi i tij në bazë të nenit 18 Ligjit Nr. 41 dt.14. Janar.45 mbi organizimin e funksionimin e Gjykatave Usht.

Tiranë më 10.VI.1946. P R O K U R O R I :
(Kap.I-rë Nevzat Haznedari)

AIDSSH, N= 1081-A. VITI 1961, D. 3.

REPUBLIKA POPULLORE E SHQIPËRISË
GJYKATA USHTARAKE E NALTË
Nr. 5 Regj. Them.

VDEKJE FASHIZMIT
LIRI POPULLIT
Tiranë më 8.VII.1946

Drejtoris së Burgut TË RI

T I R A N Ë

Ju njoftojmë se kjo Gjykatë me vendimin e saj Nr. 5 Regj. Dat 2.VII.1946 ka vendosun ndëshkimin e LLUKA BIBIT nga PËRMETI me BURGIM TË PËRJETSHËM, HUMBJEN E TË DREJTAVE QYTETARE E POLITIKE, SI DHE KONFISKIMIN E PASURIS.

Ky vendim ka marë formën e preme.

Për KRYETAR'I GJYKATËS USHTARAKE

(Major Frederik Nosi)

AIDSSH, N= 1081-A. VITI 1961, D. 3.

REPUBLIKA POPULLORE E SHQIPËRISË
PROKURORIJA E GJYKATËS USHTARAKE
TË NALTË
Nr. 5 Regj. Them.

VDEKJE FASHIZMIT
LIRI POPULLIT

A K T - A K U Z Ë
(KOMUNIKATË)
GJYKATËS USHTARAKE

Sikurse do të konstatohet dhe nga proces-verbalet e mbajtura prej Seksioni M.P. Tiranë që bashkangjitur paraqiten, i pandehuri Vahid Verdova, i biri Isait dhe i Shakos, vjeç 65, nga Vërdolla (Korçë), me profesion Bujk, i rreshtuar më datën 5.I.1946 akuzohet se ka strehuar t'aratisurit kriminela lufte Jaup Çezmën dhe në bashkëpunim me të ka rënë në kontakt me të tjerë duke i vënë në lidhje me Fiqiri Dinen, Hysni Demën e gjithë këta më t'aratisurit kriminela lufte që ndodhen në Greqi.

2) Ka bashkëpunuar me Tefik Verdovën, Kol Rodhen, Pal Terovën etjerë, për të mobilizuar të gjitha mbeturinat e Ballit Kombëtar kundra pushtetit dhe qeveris së sotëshme.

3) Ka bërë një memorandum së bashku me Kol Rodhen e shokë.

4) Ka mbledhur ndihma në të holla e material tjetër për të furnizuar t'aratisurit.

5) Ka ndihmuar dhe ka drejtuar t'aratisurit kriminela lufte që të kapërzejnë kufirin nga të katër anët dhe me këto mënyra e të tjera ka vepruar, duke synuar përmbysjen

e pushtetit popullor duke shpresuar në një ndërhyrje të reaksionit të jashtëm.

Mbasi faji i tij parashikohet i ndëshkushëm prej Nenevet 1, të Ligjit Nr. 21, datë 15.12.944 dhe 15 II. të Ligjit Nr. 41 datë 14.I.945, është parë e nevojshëme që ky të gjykohet.

P r a n d a j:

Kërkoj gjykimin e tij nga ana e asaj Gjykate dhe mbasi t'i faktohet faji që akuzohet, në përfundim të vendoset ndëshkimi i tij në bazë të nenit 18, të Ligjit Nr. 41, datë 14 Janar 945, mbi organizimin e funksionin e Gjyka.Ushtara.

Tiranë, më 10.V.1946. P R O K U R O R I:

(KAPITEN i I-rë NEVZAT HAZNEDARI)

AIDSSH, N= 1081-A. VITI 1961, D. 3.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA USHTARAKE E NALTË
Nr. 5 Regj. Them.
Drejtoris së Burgut TË RI.

VDEKJE FASHIZMIT
LIRI POPULLIT
Tiranë më 8.VII.1946

T I R A N Ë

Ju njoftojmë se kjo Gjykatë me vendimin e saj Nr. 5 Regj. Dat 2.VII.1946 ka vendosun ndëshkimin e VAHID VERDOVËS, nga Vërdovë, Korçë, me 20 VJET BURGIM, humbjen e të drejtave qytetare e politike, si dhe konfiskimin e pasuris.

Ky vendim ka marë formën e preme.

Ndëshkimi i fillon më datën 5.I.1946 dhe i mbaron më dat. 5.I.1966.

Për KRYETAR'I GJYKATËS USHTARAKE

(Major Frederik Nosi)

AIDSSH, N= 1081-A. VITI 1961, D. 3.

REPUBLIKA POPULLORE E SHQIPËRISË
GJYKATA USHTARAKE E NALTË
Nr. 5 Regj. Them.

VDEKJE FASHIZMIT
LIRI POPULLIT
Tiranë më 8.VII.1946

Drejtoris së Burgut TË RI.

T I R A N Ë

Ju njoftojmë se kjo Gjykatë me vendimin e saj Nr. 5 Regj. Dat 2.VII.1946, ka vendosun ndëshkimin e PALI LLAZAR TËROVA, nga Tërovë, Korçë, me 10 VJET BURGIM, humbjen e të drejtave qytetare e politike, si dhe konfiskimin e pasuris.

Ky vendim ka marë formën e preme.
Ndëshkimi i fillon më datën 27 / I / 1946 dhe i mbaron më dat. 27 / I / 1956.
Për KRYETAR'I GJYKATËS USHTARAKE

(Major Frederik Nosi)

AIDSSH, N= 1081-A. VITI 1961, D. 3.

REPUBLIKA POPULLORE E SHQIPËRISË
PROKURORIJA E GJYKATËS USHTARAKE
TË NALTË
Nr. 5 Regj. Them.

VDEKJE FASHIZMIT
LIRI POPULLIT

A K T - A K U Z Ë
(KOMUNIKATË)
GJYKATËS USHTARAKE

Sikurse do të konstatohet dhe nga proces-verbalet e mbajtura prej Seksionit M.P. Tiranë që bashkangjitur paraqiten, i pandehuri Pali Tërova, i biri Llazo dhe i Aleksandrës, vjeç 37, nga Tërova, me profesion ish Nënpunës, i rreshtuar më datën 27.Janar.1946, akuzohet se Pali Tërova ka qenë antar' i Partisë Fashiste Shqiptare dhe nënpunës i Bankës Napulit deri në çlirimin e Shqiprisë.

2) Ka bashkëpunuar me Halit Vërdovën, Vait Vërdovën, Kolë Rodhen, Shahsivar Selamin, Zhani Gurguzin, Riza Shtyllën kundra Pushtetit Populllor.

3) Në bashkpunim me të sipërmit dhe me t'aratisurit kriminela lufte Jaup Çizma, Mark Gjon Markun, Fiqiri Dinen, Hysni Demën e tjerë, ma dashë të përmbysë pushtetin e sotmë duke u lidhur edhe me reaksionin grek e duke shpresuar në nji ndërhyrje të huaj.

Mbasi faji i tij parashikohet i ndëshkushëm prej Neneve 1 të Ligjit Nr. 21 dt.15. XII.44 të Ligjit dhe 15 £ II Nr. 41 dt.14.I.1946; është parë e nevojshëme që ky të gjykohet.

P r a n d a j:

Kërkoj gjykimin e tij nga ana e asaj Gjykate dhe mbasi t'i faktohet faji që akuzohet, në përfundim të vendoset ndëshkimi i tij në bazë të Nen. 18 të Ligjit Nr 41 dt.14. Janar.45, mbi organizimin e funksionimin e Gjykatave Usht.

Tiranë më 10.VI.1946

P R O K U R O R I:
(Kap.I-rë Nevzat Haznedari)

AIDSSH, N= 1081-A. VITI 1961, D. 3.

Vdekje Fashizmit Liri Popullit

" D E K L L A R A T Ë "

I nënëshkruari Kosta J. Bezhani banuhes në Korçë me profesjon pastiçer, dekllaroj sa vijon:

Me të qojturin Pali Llazo Tërova se kam pasur një miqësi dhe si klient në lokalin tem Kristal në bizedimet që kam pasur nuk e kam kuptuar të meret me politikë por kur do erë ka shprehur në favor të lëvizjes Nacional Çlirimtare.

Korçë më 17/VI/1946 Me nderime.
Kosta L. Bezhani

AIDSSH, N= 1081-A. VITI 1961, D. 3.

Vdekje Fashizmit Liri Popullit

" DEKLLARATË "

I nënëshkruari Lefter Ligor Fundo banues në Korçë në sek. N. 2, dekllaroj se të quajturin Pali Llazo Tërovë e kam patur shok dhe gjatë shoqërisë që kam pasur nuk e kam kuptuar që të jetë kondra Lëvizjes Nacional Çlirimtare por për kundrazi në favor;

Korçë më 17/VI/1946 Me nderime
Lefter Fundo

AIDSSH, N= 1081-A. VITI 1961, D. 3.

VDEKJE FASHIZMIT LIRI POPULLIT

D E K L L A R A T Ë

I nënëshkruari Mihal Qano benues në Korçë me profesjon mikanik, dekllaroj se i qojturi Pali Llazo Tërova gjatë shoqënimit që kisha nga bisedat të bëra me të ka qenë gjith monë në favor të lëvizjes Nacional Çlirimtare dhe e ka ndihmuar me sa jeshte mundur, dhe as ndonjerë s'ka qenë kundërshtar.

Korçë më 17/VI/1946 Me nderime
Mihal Qano

AIDSSH, N= 1081-A. VITI 1961, D. 3.

Dekllaratë

I nënëshkruari Petro Kotoko dekllaronj se në kohën e Ilegalitetit dhe pas kapitullimit t'Italisë, si furnizues në material dhe në të holla i Lëvizjes Nacional Çlirimtare të Qarkut Korçës, dyke patur mbesim të plotë dhe dyke bazuar në ndjenjat e tija për Lëvizjen Nacional Çlirimtare, kam marë me ndërmjetësimin e Z. Pavlo Tërova prej Bankës di Napoli (Dega e Korçës) si ndihmë për Lëvizjen Nac. Çlirimtare sumën prej fr.shq. njëzetepesë mijë (25.000), dyke lëshuar për Bankën në fjalë dëftesën përkatëse të Lëvizjes Nac. Çlirimtare dhe të cilën sumë, po që atë ditë të marjes ja kam dorëzuar Këshillit Nac. Çlirimtar të Qytetit Korçës. Për veç këtyre shtoj se ditën që më dorëzovi të hollat në fjalë më ka dekllaruar që dëshiron dhe është gati kur do herë t'i shërbejë Lëvizjes Nac. Çlirimtare me sa kishte mundësi.

V F L P — Korçë me 18 Qershor 1946

Dëshmimtarët. — Dekllaruësi

Vasil G. Ziçishti — Petro Kotoko

AIDSSH, N= 1081-A. VITI 1961, D. 3.

REPUBLIKA POPULLORE E SHQIPËRISË — Vdekje Fashizmit – Liri Popullit

P R O K U R O R I J A E

GJYKATËS USHTARAKE e Naltë

Nr. 12 i R. P.

L e t ë r - r r e s h t i m

K o n d r a :

NIKO BEÇA bir' i ANTONIT dhe i EVANTHI, vjeç 33, nga TIRANA, me profesion TREGËTAR,

A k u z o h e t

Si sabotator' i Pushtetit dhe Armik' i Popullit.

Me qenë se faji i tij parashikohet prej Nenevet 1; të Ligjës Nr. 21, dat.15.XI.1944 dhe 15. paragraf II. të Ligjës Nr. 41 dat.14.I.946.

Ne Prokuror' i Gjykatës Ushtarake në bazë të Nenit 20, Para.III. Ligjit Nr. 41.

U r d h ë r o j më :

Rreshtimin e tij për një kohë të pa caktuar në burgun e Tiranës.

Organet e M. P. Policis dhe çdo fuqi e armatosur ngarkohet me zbatimin e këtij letër-rreshtimi.

P R O K U R O R I

(KAPITEN i I-rë NEVZAT HAZNEDARI)

KRYETARI

(Major Frederik Nosi)

Tiranë më 10/V/1946

AIDSSH, N= 1081-A. VITI 1961, D. 3.

REPUBLIKA POPULLORE E SHQIPËRISË — VDEKJE FASHIZMIT
PROKURORIJA E GJYKATËS USHTARAKE — LIRI POPULLIT
TË NALTË
Nr. 5 Regj. Them.

A K T - A K U Z Ë
(KOMUNIKATË)
GJYKATËS USHTARAKE
K Ë T U

Sikurse do të konstatohet dhe nga proces-verbalet e mbajtura prej Seksionit të M.P. të Tiranës, që bashkangjitur paraqiten, i pandehuri NIKOLLAQ BEÇA, i biri ANTONIT dhe i EVANTHI, vjeç 33, nga Tirana, me profesion TREGËTAR, i rreshtuar më datën 26 Janar 1946, akuzet se:

1) Ka qenë Antar i Grupit terorist të Rezistencës në Tiranë,

2) Ka bërë mbledhje të fshehta në shtëpinë e tij.

3) Ka qenë në lidhje me t'aratisurit kriminela lufte.

4) Ka qenë në lidhje dhe ka koresponduar me kriminelin e aratisur Shefqet Vërlacin.

5) Në lidhje me t'aratisurit dhe reaksionin e jashtëm ka dashur të përmbysin Pushtetin e Popullit me armë.

Mbasi faji i tij parashikohet i ndëshkushëm prej Nen. 1, të Ligjës Nr. 21 Dt.15.12.944 dhe 15 Para.II, të Ligjës Nr. 41 Dt. 14.I.945.

P r a n d a j:

Kërkoj gjykimin e tij nga ana e asaj Gjykate mbasi t'i faktohet faji që akuzohet, në përfundim të vendoset ndëshkimi i tij në bazë të Nen. 18, të Ligjës Nr. 41, dat 14.I.945 mbi organizimin e funksionimin e Gjy.usht.

Tiranë, më 10.VI.1946. — P R O K U R O R I:
(KAPITEN i I-rë NEVZAT HAZNEDARI)

AIDSSH, N= 1081-A. VITI 1961, D. 3.

REPUBLIKA POPULLORE E SHQIPËRISË — VDEKJE FASHIZMIT
GJYKATA USHTARAKE E NALTË — LIRI POPULLIT
Nr. 5 Regj. Them. — Tiranë më 8.VII.1946

Drejtoris së Burgut TË RI.

T I R A N Ë

Ju njoftojmë se kjo Gjykatë me vendimin e saj Nr. 5 Regj. Dat. 2.VII.1946 ka

vendosun ndëshkimin e NIKO ANTON BEÇA, ng Elbasani, me 10 VJET BURGIM, humbjen e të drejtave qytetare e politike, si dhe konfiskimin e pasuris.

Ky vendim ka marë formën e preme.

Ndëshkimi i fillon më datën 16 / I / 1946 dhe i mbaron më dat 26 / I / 1956.

Për KRYETAR' I GJYKATËS USHTARAKE

(Major Frederik Nosi)

Shtojcë Procestë Verbali i Nikolla Beçës.

Mbasi u pa nevojë u muar prapë në pyetje Niko Beça, i cili deklaron:

Një herë kam bisedur me Qemal Biçakun i cili më ka thënë se është takuar me një katund me Alush Leshanakun. Qemal Biçaku më ka folur me simpathi të madhe për Alushin dhe thoshte se ky është gati për të luftuar kundra Qeverisë. Qemali më ka folur herë-pas here kundra kësaj gjendijeje që është krijuar në vendin t'onë.

Këto jan të vërteta dhe i firmoj me vullnetin tem, pa as një kundërshtim prej kujt.

I-akuzuari
(Nikolla Beça)

AIDSSH, N= 1081-A. Viti 1961, D. 3.

REPUBLIKA POPULLORE E SHQIPËRISË Vdekje Fashizmit – Liri Popullit
P R O K U R O R I J A E
GJYKATËS USHTARAKE E NALTË
Nr. 13 i R. P.

L e t ë r - r r e s h t i m

K o n d r a :

Talat Drini, bir'i Asllan dhe i Hamides, vjeç 25 nga Dibra, me profesion Nënpunës
A k u z o h e t

Si sabotator i Pushtetit dhe armik i Popullit

Me qenë se faji i tij parashikohet prej nenevet 1 të Ligjit Nr. 21 dat.15.XII.44 dhe 15.Parag.II të Ligjës Nr. 41 Dt.14.I.1945.

Ne Prokuror' i Gjykatës Ushtarake në bazë të Nenit 20 Parag.III Ligj. Nr.41.

U r d h ë r o j m ë :

Rreshtimin e tij për një kohë të pa caktuar në burgun e Tiranës.

Organet e M. P. Policis dhe çdo fuqi e armatosur ngarkohet me zbatimin e këtij letër-rreshtimi.

P R O K U R O R I
(Kap.I-rë Nevzat Haznedari)

KRYETARI OSE ANTARI
(Major Frederik Nosi)

AIDSSH, N= 1081-A. Viti 1961, D. 3.

Tiranë, më 10.V.1946

P R O C E S - V E R B A L

Sot më datën 13.V.1946 meret në pyetje prej meje Prokuror i Gjykatës Naltë Ushtarake Kapiten I-rë Nevzat Haznedari dhe me asistencën e Sekretarit Aspirant Thoma Rinos i quajturi Talat Drini bir' i të ndyerit Asllan dhe i Hamides, lindur në Dibër 1911, me banim në Tiranë, me profesion nënpunës, me arsim filluer, i pa martuar, i pa dënuar, i cili pasi u pyet dekllaroj:

Unë gjat regjimit të Zogut kam qënë nënpunës dhe si i ri Zogun e kam parë me sy të keq, ndërsa rrethi i im domethënë vëllaj i im Amza Drini ka qënë i lidhur ngushtë me Zogun. Kur u largua Zogu prej Shqipërije unë së bashku me disa shokë u larguam prej Tirane dhe u kthyem përsëri mbas dy ditë, ndërsa vëllaj u aratis në Jugosllavi u kthye përpara kapitullimit t'Italisë. Gjat okupasionit Fashist unë kam qënë nënpunës, sikuse në kohën e Zogut dhe kur lindi Lëvizja Nacional Çlirimtare, sidomos Konferencën e Pezës e kam parë me simpathi të madhe, mbasi ajo, si mora vesh do ta lëftonte okupatorin, si e lëftoj me të vërtet. Unë në Partinë Fashiste jam regjistruar shumë von kur nuk kish mundësi t'i shpëtonja. Kur lindi organizata e Ballit Kombëtar unë jam ndodhur në Tiranë, dhe këtë organizatë e kam urejtur për kompromizin që kishte bërë me okupatorin.

Pushtetin Demokratik në Shqipëri në fillim e kam simpathizuar dhe e kam parë me vend, ndërsa më von kam filluar ta kritikoj në rethet e mij. E kam kritikuar Pushtetin për shkak se kompetencat ju jepeshin njerëzëve që nuk kishin zotsi teknike; e kam kritikuar gjith ashtu pse Qeverija e kishte lënë më njanë çështjen e Kosovës që i takon Shqipërisë, lënjen më njanë t'Oficerave të kohës së parë, aleancën e ngushtë të Qeverisë Shqiptare me Bashkimin Sovjetik, Jugosllavinë, Bullgarinë etj kritika. Unë kam dëshëruar që aleanca e Shqipërisë t'ishte më e ngushtë e më e fortë me Anglin e me Ameriknë, si shtete më të pasur. Me një fjalë Pushtetin e sotme kam parë me sy të keq për arsye si thashë më lart dhe bashkë me shokë të tjerë si me Qemal Kallullin, me Sabri Hoxha, Mehmet Ali Beshirin, Ali Ndroqin, me Tut Mënikun, me Alie Sulën, Musa Ruçin që është daja i Alie Sulës me Maria Kola, Kajmak Xhanin me Sali Pullumbin me të nipin e Beqir Valterit Rexhepin, Xhavit Kokën, nefail Bexhetin, Stefan Bumçin, Muherem Bejlerin, me pronarët e Kinema Tomorit Nurinë dhe me Hamitin, Seit Çelën, Qenam Dibrën, Reiz Golja, Aqif Dibrën, Riza Selmanin, Rexhep Fetahun, Abdyl Kokoshin, Manol Kumen, Reshat Beqirin dhe profesor Vasil Progrin, me Qemal Biçakçinë, Zef Nikaj, Nefail Skikulin, Muharem Bejleri e ndonjë tjetër që nuk më bie ndërmend, kemi vepruar për përmbysjen e puhtetit të sotmë me violencë. Kur jam kthyer prej Gjermanije kam kaluar për në Itali dhe jam takuar me vëllanë tem t'aratisur Anza Drinin dhe me t'aratisurin Masar Pustinën. Nuk është e vërtetë që me vëllanë tem dhe me t'aratisurit e tjerë n'Itali të kem biseduar për

çështje politike dhe të jem ngarkuar prej tyre për një veprimtari kondra Pushtetit të sotmë në Shqipëri. Aktivitetin tem kondra Pushtetit të sotmë e kam filluar në lidhje me Qemal Kallullin nga fundi i Gushtit të vitit 1945, i cili më foli për krijimin e nji grupi të legalitetit, veprimet t'ona i bënim të fshehura. Bashk me Qamilin kemi shkuar në Sali Pullumbi për t'u marë vesh edhe me njerës të tjer që do të punonin drejt qëllimit t'onë. Sali Pullumbi, i lidhur me neve na njoftoj se kishin me vehte edhe Tut Mënikun, Mehmet Ali Beshirin dhe Ali Ndroqin. Me Mehmet Beshirin, Tut Mënikun, Ali Ndroqin, Qenam Dibrën kemi biseduar për formimin e një komiteti të Legalitetit, dhe me këtë komitet do t'ishte si kryetar (prishen dy fjalë) edhe Qenam Dibra. Një ndër pikat kryesore të programit të grupit t'onë ka qenë që të vendosim regjimin monarkist dhe të sillnim në Shqipëri Mbretin Zog.

Kur kam qënë nënpunës Banke, kam njohur atje një nënpunse Alije Sula dhe i kam folur asaj për krijimin e Legalitetit. Nga Alie Sula kam kërkuar dhe kam njohur Dainë e saj Musa Ruçin me të cilin kur jam takuar i kam paraqitur qëllimet e mija dhe ay dyke i aprovuar të gjitha më ka thënë se edhe në Burel po veprojet drejt këtij programi. Mbas pak kohe me anën e një letre që dërgonte Musa Ruçi më rekomandonte nipin e Beqir Valterit Rexhepin. Rexhepin e takova dhe ai kërkonte gjith monë prej meje që ta ngarkonja me shërbime t'organizatës. Unë kur vendosëm të bënim një demostratë më 28 Nandor lajmërova Rexhepin t'ishte gati të merte pjesë dhe ai të lajmëronte shokë të tjerë që mund të kishte me veht. Për pjesmarjen në demostratë i kam lajmëruar të gjithë personat që i kam përmëndur ma sipër, për veç Ali Ndroqit. Pregatitjen e demostratës ma ka thënë Sali Pullumbi dhe kjo do të bëhet prej të rinjve dhe për një fjalim që do të mbahej më tha Riza Selmani. Këtë fjalim do artonin dy studenta universitarë që i njihte ai vetë. Fjalimin e kam parë t'artuar dhe e kam kënduar në zyrën e Qenam Dibrës në të cilën po e korigjonin Reizi, Xhahit Koka dhe Qenami. Në fjalimin e pregatitur që do të mbahej në demostratë përmëndej, ndër të të tjera terori që bënte qeverija, vrasje nga Gjyqet; përmëndej Kosovën që u shit Jugosllavisë, kërkohej shtytja e zgjedhjeve etj që nuk më bien ndërmend. Demostrata nuk u krye pse nuk u pregatit si duhej. Në shtëpi të Alije Sulës kemi bërë dy mbledhje; mbledhjen e parë më datën 30 Nandor 1945 dhe mbledhjen e dytë më datën 6 Janar 1946. Në mbledhjen e parë mernin pjesë Rexhep Fetahu, Ali Ndroqi, Qemal Kallulli, Riza Selmani, Reshat Beqiri, Manol Kumja, Abdul Kokoshi dhe Profesor Vasil Progri dhe unë Talati dhe një gazetar Engles. Gazetarin Engles nuk mbaj mënd se kush e kish lajmëruar të vinte por e di që shkoj e mori Qemal Kollulli. Këtu i referuan gazetarit disa mungesa në lidhje me veprimet e pushtetit të sotmë. Nuk e di se çfarë u bisedua me gazetarin dhe ndërmjet tyre, mbasi unë si mbas kërkimit të shokve dolla për të kërkuar Qenam Dibrën, të cilin nuk e gjeta dhe u ktheva përsëri në mbledhje. Kur hyra unë mbrenda gazetari engles u largua dhe ne ja filluam përsëri mënyrës se si duhet të vepronim duke shfaqur se cili mendimin e vet e dyke i bërë kritika njëri tjetrit. Mbledhjen e dytë mernin pjesë Xhahit Koka, Qenam Dibra, Reis Golja, Mehmet Ali Beshiri, Tut Mëniku, Ali Ndroqi, Qemal Biçaku dhe unë Talati dhe Alije Sula qëndroj pak minuta.

Këtu u kërkua që të formohej sa më parë një Komitet, dhe në këtë mënyrë t'ja fillonim veprimit t'onë të gjerë. Qenam Dibra e tregoj të pa mundur krijimin e nji komiteti për shka se, si tha ay në Tiranë ekzistonin edhe grupe të tjera dhe nuk mund merej inisjativa nga ana e grupit të Legalitetit. Me kërkesën e shumicës të pjestarve të mbledhjes u vendos që të formoshin një kongres ku të mernin pjesë edhe delegatë nga t'aratisurit. Të gjithë unanimisht pranuam formimin e kongresit me përjashtim të Ali Ndroqit i cili vetëm dëgjonte. Këtu u bë kjo ndarje pune: unë do të lajmëronja me anën e njerzëve që kisha në Burel çetat e aratisura të Matit të Bilal Kolës; Tut Mëniku u ngarkua të lajmërojë për të marë pjesë në kongres t'aratisurit e Dibrës dhe dekllaroj se e merte vetë për sipër; Qemal Biçaku mori përsipër dhe u ngarkua të lajmëronte t'aratisurit e Elbasanit dhe Zef Nikaj, që edhe ky merte pjesë në mbledhje mori përsipër të lajmëronte t'aratisurit e Shkodrës. Kur të ishin të lajmëruar të gjithë t'aratisurit dhe t'ish marë pëlqimi i tyre do të caktohej vendi se ku do të bëhej ky kongres. Unë për punën që mora përsipër dhe që m'u ngarkua nga shokët që mernin pjesë në mbledhje lajmërova Seit Çelën që ndodhej në Tiranë, po ky nuk ma siguroj që ta kryente punën teme.

Ndihmat t'ona për nevojar që do të na paraqitshin do t'i mblidhnin nga tregtarët, dhe Qemal Kollulli nga ndihmat që kishte mbledhur nga tregtarët e Durësit më dha mua 1000 (njëmijë) franga, të cilat si mbas fjalës së Ali Pullumbit do t'i përdorte Mehmet Beshiri për një mision që ishte ngarkuar të kryente, i cili më duket si mora vesh do të shkonte nga ana e Jugut. Në këtë rast kam njohur dhe Nefail Skikulin, i cili mora vesh se ishte ngarkuar me grumbullimin e ndihmave.

Mbaj mënd se Riza Selmani më ka kërkuar dy tri palë roba partizane për t'i veshur ditën e zgjedhjeve, pa e ditur mirë: këtë ditë ose ndonjë ditë tjetër dhe kto roba si mbas fjalës së Rizajt do t'i vishnin tre shokë për të çuar një letër zyrtare, bashk me një Engles në një nga zyrat qeveritare të Qeverisë. Unë nuk e di përse Rizaj do t'i vishte njerzit tanë me roba ushtari, dhe ndoshta unë nuk e di përse (prishen pesë fjalë) Rizaj ka menduar të veprojë në këtë mënyrë që të mos bjerë në sy forcave të sigurimit publik, të cilat nuk do të dyshonin kur të shikonin hipur n'automobil partizanët. Edhe otomobilin Rizaj e kërkoj që t'ja gjenja unë. Nuk është e vërtetë që Riza Selmani të ketë dashur, sikurse e shënuam në proves-verbalin e mbajtur kondra meje më datën 25 shkurt 1946 dhe nënshkruar prej meje se neve të kemi dashur të veshim njerzit tanë ushtarë e me një shkresë fallco, t'imituar atë të Gjykatës Ushtarake të shkonim e të nxirnim nga burgu Patër Antonin, Lef Nosin dhe Maliq Bushatin. Gjith ashtu nuk e di në se Qemal Kollulli do të kryente punët e shoferit. Këtë mendim d.m.th. për të gënjyer rojet e burgut mund ta kenë pasur dhe vendosur Riza Selmani me shokë dhe me të vërtetë edhe unë më von mora vesh se ata kështu kanë menduar të veprojnë, d.m.th.në të veshin tre njerës si partizanë, t'ua apin urdhënesën fallco nga ana e Gjykatës Ushtarake dhe dyke gënjyer Drejtorin e Burgut të vithnin Lef Nosin, Patër Anton Arapin dhe Maliq Bushatin. Unë këtë më von e mora vesh nga Xhelal Ndreu.

Nuk është e vërtetë që unë të kem biseduar ashtu si kur se thotë Alije Sula në procesin e saj.

Veprimin tem e quhaj të gabuar pse e kuptoj që shumica e popullit shqiptar nuk mendon ashtu si mendonim meve; d.m.th.në populli shqiptar nuk don që edhe një herë të vendoset regjimi i Zogut, sikurse donim të vendosnim ne, dhe kjo provohet nga fakti që duall përpara.

E këndova për sa u shkruan ma lart dhe e nënshkruaj me vullnet dhe pa ndo një shtrëgicë.

I PANDEHURI: SEKRETARI P R O K U R O R I:
(Kap. Nevzat Haznedari)

AIDSSH, N= 1081-A. Viti 1961, D. 3.

Me Apstenue më 2 Dhjetor d.m.th. me qenë besnik i popullit shqiptar
Rr. Shqipëria Nacionaliste.

V Ë L L A Z Ë R S H Q I P T A R Ë. 28 NANDUR 1945.

Sot në këtë ditë të shëjtë ka ardh koha që të gjithë të bashkohemi dhe t'ju heqim maskën armiqve të kombit, që na kanë pushtue vatrat t'ona, dhe po na çojnë në greminë.

Partija Komuniste që sot është në fuqi me terror siç e dini të gjithë nuk është gjë tjetër përveç se nji vegël e verbër e Imperjalizmit Sllav. Këjo parti që mbretënon sot në Shqipni, sikundër e shiti Kosovën, ka me ja dorzu Titos shumë shpejt dhe krejt Shqipnin.

Na përket ne popullit dhe patriotëve të vërtetë që e dashurojnë këtë vëndë me sinqeritet të duhur, që t'a shpëtojmë Atdheun nga këjo fatkeqsi e madhe që ka qënë sot.

Me qenë se këtu po trumbetohet se gjoja ka shum kohë se ka liri fjale dhe propagande, ju njoftojm që të gjithë së bashku të drejtohemi në misionet Aleatë dhe të kërkojm prej tyre ndërhymjen për shtymjen e zgjedhjeve, për me i tregue botës mbarë se këtu ka një Opozit të fortë që është në gjëndje të përmbledhë reth saj shumicën dërmuse të popullit shqiptar, dhe ka formue për këtë qëllim Koalicionin e partive me tendenca demokratike. (Partia Monarkiste, Social Demokrate dhe ajo e Resistencës).

AIDSSH, N= 1081-A. Viti 1961, D. 3.

A R M I Q T E P O P U L L I T PARA GJYQIT
(GRUPI I 37 ANMIQËVE TË POPULLIT ME NË KRYE SAMI ÇERIBASHIN)

TIRANË, QERSHOR 1946.

Këtu janë lidhë proceset orgjinale të grupit fashist terrorist i përbamë prej 37 personave me në krye Sami Çeribashin, kryetar i Grupit të Rezistencës, Qenan Dibrën etj. përfaqësues i Grupit Monarkist dhe Musine Kokalarin kryetare e Grupit Social Demokrat, që të tre këto grupe së bashku kanë formue organizatën Bashkimi Demokratik me në krye një komitet qendror të përkohëshmë, i ashtu-quajtur "Komiteti Nacional".

Në Tiranë ditën e Hanë n'ora 8.30 të datës 17 Qershor 1946 filloi gjyqi kundër 37 antarve të grupit t'armiqëve të popullit në lokalin e Kinema Nacionalit.

Në këtë gjyqë që zgjati 15 ditë kanë asistue mijëra njerëz nga kryeqyteti dhe krahina të tjera dhe nëpër mes radios e shtypit ashtë ndigjue në çdo skaj të Shqipëris me vrejtje dhe habi të madhe se pse dolli në shesh veprimtarija kriminale e t'akuzuarve kundra ë cilëve populli anë e mbanë Shqipnis shpreu urrejtjen e tijë të madhe për këto mbeturina të fashizmit dhe çfaqi njikohësisht dashurin dhe mirënjoftjen e tijë të thellë për pushtetin e Ushtërinë e tijë.

Grupi i t'akuzuarve kriminela u gjykue nga Gjyqi i Naltë Ushtarakë i formuarë prej: Major Frederik Nosit, Kryetar dhe antarë Kapitenat e Parë Veledin Zeneli e Nexhat Hyseni, Sekretar Thoma Rino.

Akuza u ngrit nga Prokurori Ushtarak Kapiten i Irë Nevzat Haznedari. N'akt-akuzën që u lexue nga Prokurori u zbulue gjithë tradhëtija e këtyre armiqëve të popullit, organizimi, programi dhe aktiviteti i tyre kriminal.

Këta tradhëtarë jo vetëm që në kohën e okupasionit nuk luejtën vendit e u hodhën në prehën t'okupasionit bashkë me Ballin e Legalitetin e në të gjitha organizatat tradhëtare e mercenare por edhe mbas çlirimit të Shqipëris në nji kohë kur populli i ashtë përveshur punës së rindërtimit me të gjitha forcat e tija këta armiq të betuem të demokracis dhe të Pushtetit Popullor, ish oficera të vjetër të kohës së Zogollit, njerzë të privilegjuarë prej regjimeve të kalueme, tregtarë spekullatorë dhe të goditur nga reformat, shërbëtorë e vegla qorre të feudalëve pseudo-demokratë e pseudo-intelektualë që futënë në Frontin Demkratik për t'a minuarë ma mirë nga mbrenda, u mblodhën poshtë e lartë e të gjithë së bashku tue kujtue se populli do të mos i vëzhgonte, ju përvehshën punës së tyre tradhëtare e kriminale dhe me fshehtësin ma të madhe po i pregatitnin nji tragjedi tjetër popullit shqiptarë, për t'i përmbysur me forcë dhe me terror pushtetin e tijë dhe për t'i rrëmbyer nga duartë lirinë dhe indipendencën e fitueme me gjakun që derdhën bijt e tij ma të zgjedhur.

O R G A N I Z I M I

Të gjithë këta persona pasardhës besnikë dhe të betuem për të ndjekë gjurmat e atyre që bashkëpunuan ngushtë me okupatorët dhe qeverit kuislinge, me çlirimin

e Shqipëris u organizuen në rrethe kundërshtare të frymëzueme dhe të nxitun nga reaksioni i jashtëm dhe të shtytur nga interesat e tyre personale meskine dhe nga shpirti i tyne antipopullor, reaksionar, fashist, tue qenë në fillim të veçuem, arritën të shkrihen në një grup të përbashkët në të cilin përfaqësoheshin krerë e këtyre tre grupeve të ndryshme.

Në lidhje me kriminelët e luftës t'aratisur mbrenda e jasht Shqipëris dhe me reaksionin e jashtëm u aktivizuan për të rëzue me violencë pushtetin popullor, për të shkaktue një ndërhyrje të imperialistëve të jashtëm, që për pasojë do të kishte vëllavrasjen, për të bamë atentate kundër udhëheqësave të Pushtetit Popullor për të prishun vëllazërimin e popullit shqiptar me popujt Jugosllavë e me gjithë popujt e tjerë liridashës. Këto u lidhën ngusht sepse ishin për nji rrugë edhe me reaksionin e klerit katolik "Bashkimi Shqiptarë".

Të lidhun me gjithë këto grupe e individë reaksionarë këto rrethe kundërshtare në fillim dhe me propagandën më të gjanë kundër masave ddhe reformave të mëdha shoqnore filluan të veprojnë në grupe të vogla klandestine tue krijue më vonë komitete e nën-komitete të cilat u lidhën dhe bashkërisht me grupet fashiste terroriste të Shkodrës, formuen një komitet qendror të përkohëshmë t'ashtu-quajtur "Komiteti Nacional".

PROGRAMI DHE AKTIVITETI I TYRE KRIMINAL

Programi i tyre kryesisht ishte të rëzojnë pushtetin popullor me violencë dhe me terror. Këti qëllimi do të i a arrijshin me këto mjete: me atentate, sabotime, aksione të ndryshme me kriminelat e aratisur, goditje deposh ushtarake dhe grabitje armësh e municioni, sulme nga ana e kriminelëve t'aratisur dhe me ndërhymjen nga jashtë me armë.

1) Për këtë punë krijuan lidhje të rregullta me kriminelat e aratisur mbrenda Shqipëris të cilët i kanë fornizue me të holla, ushqime, municion, vesh-mbathje dhe informata. Gjith'ashtu i kanë ftue të dërgojnë njerzit e tyre për të marë pjesë në Kongres.

2) Kanë dërgue njerëz në Greqi për t'u lidhur me reaksionin grek, në këtë mënyrë tue veprue kundër interesave të nalta t'Atdheut kundër integritetit tokësor dhe indipendencës së Shqipëris. Kështu këta kanë pranue rivendikimet krejt të pa drejta mbi Shqipërinë e Jugut. Kjo është tradhëtija ma e naltë që mund t'i bahet Atdheut t'onë dhe popullit shqiptar.

3) U lidhën ngushtë me organizatën tradhëtare "Vorio-Epir" me anën e Lluka Bibit i cili shkoi në Përmet e Gjinokastër dhe me organizatat teroriste të Shkodrës nëpërmes të Frano Mirakajt, Anton Dukagjinit, Pjetër Gilajt etj.

4) Janë përpjekur me çdo kusht të shtrembërojnë realitetin tue e paraqitur gjendjen në Shqipëri të trubulltë e pa siguri. Këta renegatë e tradhëtarë të popullit tue dashun të shkaktojnë nji ndërhyrje të reaksionit të jashtëm, kanë vue në rezik indipendencën dhe integritetin toksor të Shqipëris. Kanë dashur të përsërisin edhe nji herë tragjedin e 7 Prillit 1939. Kanë përhapur me çdo mënyrë shpifje e mashtrime të çdo lloi në bisedime me gazetar të huaj, tue e paraqitë situatën e Shqipëris t'errët e kaotike.

5) Kanë dashur të sabotojnë zgjedhjet tue prishur rendin për zhvillimin e qetë të votimeve në mënyrë që populli të mos shprehte vullnetin e tijë sovran mbi regjimin e shtetit dhe mbi zgjedhjen e përfaqësonjësve të popullit.

6) Kanë mbledhur informata të ndryshme me karakter ekonomik ushtarak dhe u a kanë dërgue të huajve.

7) Kanë mbledhur ndihma të ndryshme nga tregtarët spekullatorë, nga armiqt e popullit, nga familjet e kriminelëve të luftës, të cilat kanë qenë mbështetja e tyre kryesore dhe u a kanë dërgue t'aratisurve kriminela Hysni Demës me shokë.

8) Kanë pasë në program të vrasin njerzëz të lëvizjes dhe udhëheqsat kryesorë të pushtetit popullor.

Antarët e këtyre veprave kriminale janë personat që përmenden ma poshtë:

1) SAMI ÇERIBASHI, i biri i Kasemit dhe i Gjyzes, lindur më 1887 në Gjinokastër e banues në Tiranë, i martuarë me pesë fëmijë, me arësim të mesëm e me profesion tregëtar.

Ka qenë kryetar i grupit rezistencës dhe elementë ma aktiv i gjithë t'akuzuarve. Ka organizue dhe kryesue mbledhje me Gjergj Kokoshin, Profi Çokën e Shaban Ballën etj. Ka pasë takime me antarë të UNRRA-s dhe të misionit Englez në Shqipëri. Me shoqnin UNRRA ka pasur marëdhënje tregtare dhe me anën e kësaj ka dërgue në Greqi dy maqina me mallë. Ka pasë lidhje me t'aratisur mbrenda shtetit. U dënue me vdekje dhe u ekzekutue.

2) SHABAN BALLA, i biri i Qamilit dhe i Havas, lindur në Tiranë më 1908 dhe banues po atje, me profesion gjometër, i martuarë me dy fëmijë, ka mbaruarë shkollën teknike në kohën kur ish Drejtor Fulzi.

Gjat okupasionit italian ishte në radhët e fashizmit ku kishte marrë dhe teserën e partis fashiste. Me ardhjen e UNRRAS u fut në punë si përkthyes mbassi dinte mirë Inglishte dhe u bë agjent i tyre në dëm të pushtetit të popullit. Ky ka qenë elementi që lidhte grupin me Englezët. Për aktivitet të gjerë që ka dëftuar kundra pushtetit u dënua nga Gjyqi i Naltë Ushtarak më 3-7-1946 me vdekje dhe u ekzekutua.

3) MEHMET BESHIRI, i biri i Sartit dhe i Nailes, lindur në Tiranë më 1904 dhe banues po këtu, me profesion nëpunës, i martuarë me dy fëmijë.

Gjat okupasionit gjerman, ka qenë i lidhur ngushtë me Kolonelin gjerman të Geestapos (emrin nuk i dihet) dhe ishte si përkthyes i tij. Ka qenë i lidhur ngushtë edhe me Legalitetin duke sharë lëvizjen N.ÇL. ka patur lidhje direkte me Shtabin e Abas Kupit. Tue qenë organizator kryesor i këtij grupi u dënua nga Gjyqi me vdekje më datën 3-7-1946 dhe u ekzekutue.

4) TALAT DRINI, i biri i Asllanit dhe i Hamides, lindur në Dibër më 1911, banues në Tiranë, me profesion nëpunës, me shkollë plotore, i pa martuar.

Ishte i ngarkuarë të rekrutonte elementë të pa kënaqur nga pushteti i jonë dhe t'i futë në grupin e tyre. Ky ka qenë inisiator që në 28 Nëndor 1945 të grumbullonte elementat e pa kënaqur, për të demostruarë në Tiranë dhe të kërkonin nga Anglo-Amerikanët shtytjen e afatit të zgjedhjeve. Akuzohet për mbledhjet që ka bërë dhe si organizator i njësive për të sabotuarë zgjedhjet e 2 Dhjetorit. Ka bërë shumë

lëvizje nëpër qytetet e Shqipëris për të organizuarë grupin. U dënua me vdekje nga Gjyqi i Naltë më 3-7-1946 dhe u ekzekutue.

5) QENAN DIBRA, i biri i Abdurahmanit dhe i Adiles, lindur në Dibër më 1912 dhe banues në Tiranë, me profesion avokat, ka mbaruarë universitetin e Drejtësis në Francë. Element kryesor i grupit. Ka qenë në të gjitha mbledhjet që janë bërë kundra regjimit të sotëshmë në bashkëpunim me Kiço Xhongën dhe me Palmerin (Englez). U dënue me vdekje nga Gjyqi Ushtarakë më datën 3-7-1946 dhe u ekzekutue.

6) XHAVIT KOKA, i biri i Mustafait dhe i Sembries, lindur më 1909 në Leskovik, i pa martuarë me profesion ish nëpunës, ka mbaruar në Bukuresht Shkencat Ekonomike. Element kryesor i Grupit. Ka marë pjesë në të gjitha mbledhjet në mes të Kiço Xhongës dhe Palmerit. U dënua me vdekje nga Gjyqi i Naltë Ushtarakë më datën 3-7-1946 dhe u ekzekutua.

7) ALI KAVAJA (JONUZI) i biri i Jonuzit dhe i Sulltanes, lindur në Kavajë më 1912 dhe banues në Tiranë, me profesion tregëtar, ka mbaruarë shkollën teknike. Gjat okupasionit gjerman ishte antar besnik i Legalitetit dhe ka propaganduarë kundra L.N.ÇL. Mbas çlirimit vazhdon të qëndrojë po ashtu dhe më vonë u lidhë me grupin e Sami Çeribashit, ku u bë elementi më aktiv i grupit. Ka marrë pjesë në mbledhjet e grupit dhe ka qenë korier i tyre. Ka shkuarë nëpër vende të ndryshme për të organizuarë elementa kundra Pushtetit. U dënua me vdekje nga Gjyqi i Naltë Ushtarak më datën 3-7-1946 dhe u ekzekutua.

8) MAHMUT (TUT) MËNIKU, i biri i Mahmutit dhe i Zyhrasë, lindur në Tiranë më 1907 dhe banues në Tiranë, me profesion tregëtar, i martuarë me pesë fëmijë, ka mbaruarë shkollën qytetëse. Është një nga ata që kanë pregatiturë terenin për ardhjen e Italisë këtu.

Gjat okupasionit gjerman është munduarë të sabotojë luftën. Mbas çlirimit është shoqëruarë me elementa reaksionarë si Mehmet Beshirin etj. dhe më vonë u fut në grup dhe u bë elementi nga më aktivët e grupit.

U dënua me vdekje nga Gjyqi i Naaltë Ushtarakë më datën 3-7-1946 dhe u ekzekutua.

9) IVZI GOLJA, i biri i Hysenit dhe i Hamdijes, lindur më 1895 në Dibër të Madhe dhe banues në Tiranë, me profesion tregëtarë, i martuarë me nji fëmijë.

Ka qenë antar i Legalitetit dhe armik i betuarë i L.N.ÇL. Ka propaganduarë kundra L.N.ÇL. Mbas çlirimit u bashkua me elementa reaksionarë për të përmbyur pushtetin popullor. Ka qenë një nga më aktivët e grupit dhe ka bërë mbledhje me karakter anti-popullor. Ka favorizuarë ushtarët dezertorë për të hedhur në Greqi. U dënua nga Gjyqi i Naltë Ushtarakë më datën 3-7-1946 me vdekje dhe u ekzekutua.

10) ABDULLA MUÇA, i biri i Shabanit dhe i Aishes, lindur më 1916 në Tiranë dhe banues në Tiranë, me profesion Inxhinjier.

Nji ndër pjestarët aktivë të grupit rezistencës, prezent në të gjitha mbledhjet e aktivit të këtij grupi, që janë bërë disa herë në mullirin e tij; delegat i caktuar në mbledhjen qi kanë pasur me Palmerin e Smithin, të cilëve u parashtruan platformën e organizatës së tyre tradhëtare. U dënua me burgim të përjetëshëm dhe me punë të detyrueshme.

11) ANDON DUKAGJINI, i biri i Markut dhe i Prengës, lindur më 1891 në Shkodër dhe banues në Tiranë, me profesion profesor.

Ka qenë një nga më aktivët e grupit Bashkimi Demokratik. Ka marë pjesë në mbledhje që ka bërë grupi i rezistencës për rëzimin e Pushtetit Popullor. Ka marrë përsipër që të bëjë lidhje midis t'aratisurve të Shkodrës dhe organizatës së tyre. U dënua nga Gjyqi Ushtarak me datën 3-7-1946 me burgim të përjetëshmë dhe me punë të detyrueshme.

12) ENVER HASA, i biri i Beqirit dhe i Ulfetit, lindur në Dibër më 1919 dhe banues në Tiranë, me profesion ish Oficer.

Ky ka marë pjesë aktive në grupin e rezistencës dhe këtë e ka kërkuarë vetë. I ngarkuar nga grupi i tij, ka përpiluarë një listë të të gjithë Oficerave të vjetër dhe të një pjese t'intelektualëve dhe këtë organizata me anën e Nafail Skikulit ja kamë dërguarë Englezëve, të cilët e kërkonin. Ka marë pjesë në mbledhje dhe ka qenë një nga më aktivët.

I dënuarë me 101 vjet burgim dhe me punë të detyrueshme.

13) LLUKA BIBI, i biri i Kostandinit dhe i Athinas, lindur më 1903, në Përmet dhe banues në Korçë, me profesion ish nëpunës.

Ka qenë federal i fashizmit dhe ka dhënë çdo ndihmë etj. Ka marë pjesë në grupin e Kol Rodhes dhe ka qenë një nga më aktivët e këtij grupi. Ka propaganduarë dhe ka dashur të helmatosë popullin e Përmetit ku ka shkuarë për qëllime propagandistike. Është përpjekur të vijë në lidhje me reaksionarët Grekë e tjera.

U dënua nga Gjyqi i Naltë Ushtarak me datën 3-7-1946 me 101 vjet burgim dhe me punë të detyrueshme.

14) PROFI ÇOKA, i biri i Jorgjit dhe i Kostandinës, lindur më 1910 në Belit të Strugës (Jugosllavi) dhe banues në Tiranë, me profesion tregëtar. Ky ka qenë një nga më aktivët e grupit të rezistencës. Në shtëpin e tij janë bërë mbledhje të ndryshme ku kanëmarrë pjesë dhe antarë të misioneve anglo-amerikane. Ka dhënë informata mbi gjendjen ushtarake, politike dhe ekonomike të vendit t'onë Shaban Ballës dhe ky ja çonte Anglo-Amerikanëve.

U dënua nga Gjyqi mee burgim të përjetëshmë dhe punë të detyrueshme.

15) GJERGJ KOKOSHI, i biri i Jacimit dhe i Viktores, lindur më 1914 në Shkodër dhe banues në Tiranë, me profesion profesor, i pa martuarë, ka marë doktoratën në Letrat e Bukura.

Ish Antar i Këshillit P.N.ÇL. dhe më vonë Ministër i Arësimit. Për aktivitet antipopullor u përjashtua nga puna ashtu dhe nga K.N.Çl. Në zgjedhjet e 2 Dhjetorit vuri kandidaturë por më vonë e tërhoqi. Është inisiator i grupit bashkë me Sami Çeribashin. Ky bashkë me shokët e tjerë u ka dorëzuarë Englezëve një memorandum ku protestohej për njohjen e Qeveris.

U dënua nga Gjyqi i Naltë Ushtarak me datën 3-7-1946 me 30 vjet burgim dhe punë të detyrueshme.

16) KOL RODHE, i biri i Pandeliut dhe i Sofies, lindur më 1884 në Korçë dhe banues po atje, me profesion ish nëpunës. Ka dashur që të formojë një parti kundërshtare

e cila të ishte në lidhje me rezistencën. Ka bërë mbledhje për këtë qëllim dhe është përpjekur me çdo mënyrë që të formojë çeta kundërshtare në Kolonjë.

U dënua nga Gjyqi i Naltë Ushtarakë me datën 3-7-1946 me 30 vjet burgim.

17) NAFAIL SKIKULI, i biri i Jusufit dhe i Uries, lindur në Dibër më 1916 dhe banue në Tiranë, me profesion ish Oficer. Ka qenë një nga më aktivët e grupit të rezistencës. Ka marë pjesë në të gjitha mbledhjet që ka bërë ky grup dhe në bashkëpunim të ngusht me Enver Hasan kanë pregatitur një listë t'oficerave të vjetër dhe ja kanë dhanë Misionit Englez që e kërkonte.

Ky ka pasur dijeni të plotë mbi lidhjet që ka pasur grupi i tij me t'aratisurit si Fiqiri Dinia e shokë dhe me Anglo-Amerikanët. Kanë pasur korespondencën me Fulzin e tjerë Englezë dhe Amerikanë.

Ashtë dënuarë nga Gjykata e Naltë Ushtyarake me 30 vjet burgim dhe me punë të detyrueshme.

18) REIS HASHO, i biri i Aliut dhe i Sadikas, lindur më 1924 në Gjinokastër dhe banues në Tiranë, student universitari pa martuarë. Ka qenë një nga më aktivët e grupit të rezistencës. Ka marë pjesë në mbledhje ku kanë qenë dhe Englezë dhe Amerikanë. Ka pregatiturë me shokët e tij memorandumin që ju ashtë dhënë Englezëve në lidhje me zgjedhjet dhe këtë e ka shpurë dhe vetë Reizi. Ka bërë propagandë dhe takime të shpeshta me Musinenë, Samiun dhe Shabanin. Ka marë pjesë në një mbledhje ku është biseduarë për ndihmat që do të kërkonin nga Anglo-Anerikanët etj. Dënuarë nga Gjykata e Naltë Ushtarake me datën 3-7-1946 me 30 vjet burgim dhe punë të detyrueshme.

19) QEMAL BIÇAKU, i biri i Hasanit dhe i Elmies, lindur në Elbasan më 1920, banues në Tiranë, me punë private, i martuarë me vajzën e tradhëtarit Shefqet Vërlaci. Ka marë pjesë në mbledhjet e ndryshme që ka bërë grupi i rezisteencës. Ka pasur korespondencë me t'aratisurin Alush Leshanaku, dhe ka bërë takime me 'të. Ky do të ishte ndërlidhës i Alushit me grupin e rezistencës etjera.

U dënua nga Gjykata e Lartë Ushtarake me 30 vjet burgim dhe me punë të detyrueshme.

20) MYRTEZA BELI, i biri i Hakiut dhe i Zyrasë, lindur më 1903 në Korçë dhe banues në Korçë, me profesion tregëtar. Ka marë pjesë në mbledhjet që ka bërë grupi i rezistencës dhe ka qenë në bashkëpunim me Lluka Bibin etj. Ky ka bërë pjesë më shumë në grupin e Korçës që kryesohej nga Kol Rodhia. Ka qenë një nga më aktivët dhe ka propaganduarë kundër Pushtetit popullor. Është përpjekur të vijë në lidhje me t'aratisurit e Greqis etjera.

U dënua nga Gjykata e Naktë Ushtarake me 25 vjer burgim dhe me punë të detyrueshme.

21) NESTI OROLLOGAI, i biri i Vangjelit dhe i Poliksenit, me dat-lindje 1899, lindur e banues në Korçë, me profesion tregëtar. Ka qenë një nga më aktivët e grupit të Korçës dhe si i tillë mbante lidhje të shpeshta me grupin e Tiranës, i cili vinte shpeshë herë këtu. Ka marë pjesë në shumë mbledhje që janë bërë dhe që ky ka aprovuarë plotëiht politikën që do të ndiqte ky grup kundër Pushtetit Popullor. Ka

propaganduarë kundër gjendjes në hqipëri dhe ka dashur që grupi ku bënte pjesë të binte në lidhje me t'aratisurit e Greqis etj.

U dënua nga Gjykata e Naltë Ushtarake me datën 3-7-1946 me 25 vjet burgim dhe me punë të detyrueshme.

22) HAKI GJINISHI, i biri i Tahsinit dhe i Hajrijes, lindur më 1891 në Peqin dhe banues atje. Ka mbaruarë gjymnazin turkë, me profesion privat. Ka marë pjesë në mbledhjet që bënte grupi i rezistencës për rëzimin e Pushtetit popullor. Ka qenë në një mbledhje që është folur për atentate kundër udhëheqësave të Pushtetit popullor. Me anën e Haki Karahoxhës është përpjekur të bjerë në lidhje me t'aratisurit e qarkut Elbasanit.

U dënua nga Gjykata e Naltë Ushtarake, me 3-7-1946 me 20 vjet burgim dhe punë të detyrueshme.

23) HASAN KALAJA, i biri i Haxhiut dhe i Dudes, vjeç 41, lindur në Krujë e banues në Tiranë, me profesion nëpunës. Ka krye gjysmën e shkollës së mesme. Ka aderuarë në grupin e rezistencës dhe ka marë pjesë në mbledhje të ndryshme. Ka shtypur trakte dhe ka bërë propagandë kundër Pushtetit.

Dënuarë nga Gjykata e Naltë Ushtarake me 20 vjet burgim dhe me punë të detyrueshme.

24) MUSINE KOLALARI, e bija e Reshatit dhe e Anushes, me dat-lindje 1917, lindur në Turqi dhe banuese në Tiranë, me profesion libra-shitëse. Ka mbaruarë Gjymnazin dhe ka ndjekur universitet. Kjo ka qenë një nga më aktivet e grupit të rezistencës dhe që e quante vetëhen Social-Demokratike. Ka marë pjesë në mbledhje të ndryshme dhe ka qenë në përpilimin e programit të grupit tradhëtar ku kjo bënte pjesë. Kjo në mbledhjet që bëheshin përfaqësonte grupin Social-Demokrat. Memorandumi që i ashtë drejtuarë aleatëve anglo-amerikanë është nënëshkruarë dhe prej saj.

25) VAHIT ISA VERDOVA, i biri i Isajt dhe i Shakos, lindur e banues në katundin Verdovë të Korçës, me profesion bujk. Ky ka pasur lidhje me grupin e Korçës dhe ka strehuarë dhe udhhequr kriminela lufte t'aratisur. Ka qenë në lidhje me Kol Rodhen me shokë etj.

U dënua nga Gjykata e Naltë Ushtarake me 20 vjet burgim dhe me punë të detyrueshme.

26) STEFAN BUMÇI, i biri i Pjetrit dhe i Emilias, lindur më 16-I-1913, në Shkodër dhe banues në Tiranë, me profesion ish Oficer. Ka qenë fashist i orës së parë. Kur ishte me ushtërin italiane nga që nuk donte të tregohej se ashtë shqiptarë lente mjekër. Ka bërë pjesë në grupin e rezistencës dhe ka marë pjesë në shumë mbledhje. Ka propaganduarë dhe bashkë me shokët e tij të grupit ka dashur të organizojë një demostratë me datën 28 Nëndor 1945 kundër Qeveris. Ka bërë takime me gazetarin Englez Clear dhe këtij i kanë dhënë informata të reme e tjera.

U dënua nga Gjykata Ushtarake e Naltë me datën 3-7-1946 me 20 vjet burgim dhe me punë të detyrueshme.

27) SUAT ASLLANI, i biri i Mazarit dhe i Fatimes, i dat-lindjes 1902, lindur në katundin Nepravisht të Gjinokastrës dhe banues në Tiranë, me profesion avukat. Ka biseduarë

me Musine Kokalarin për formimin e një partije opozite dhe për këtë ky do të jepte çdo ndihmë. Ky ka qenë fashist, nga procesi i tij del se ka qenë spiun i fashizmit.

U dënua nga Gjykata e Naltë Ushtarake me datën 3-7-1946 me 15 vjet burgim dhe me punë të detyrueshme.

28) HAKI KARAHOXHA, i biri i Rizait dhe i Sabries, lindur më 1912 në Elbasan dhe banues atje, me profesion punëtor. Ka bërë pjesë në grupin e rezistencës dhe ky ka qenë ndërlidhësi midis grupit dhe t'aratisurve të Elbasanit. Ka marë pjesë në mbledhje dhe ka shpurë Ali Kavajën dhe Haki Gjinishin për t'u takuarë me Alush Leshanakun, gjë që kanë bërë.

Dënuarë nga Gjykata e Naltë Ushtarake me datë 3-7-1946 me 10 vjet burgim dhe punë të detyrueshme.

29) MUSA DIZDARI, i biri i Dashit dhe i Gjyles, lindur në Pukë më 1913 dhe banues në Tiranë, me profesion profesor. Ka marë pjesë në mbledhje që ka bërë grupi i rezistencës. Ka qenë një nga nxitësit për dërgimin e një proteste kundër pushtetit popullor anglo-amerikanëve dhe ky ka firmuarë në 'të. Ka qenë kundër zgjedhjeve dhe bash për këtë ka firmuarë protestën. Ka qenë një nga më të afërmit e Musine Kokalarit etjera.

U dënua nga Gjykata e Naltë Ushtarake me 10 vjet burgim dhe me punë të detyrueshme.

30) NIKO BEÇA, i biri i Andonit dhe i Evanthis, lindur më 1913 në Elbasan dhe banues në Tiranë, me 4 vjet Universitet. Ka pasur lidhje me Shaban Ballën dhe këtij i jepte informata që ja u dërgonte Engleëve dhe Amerikanëve. Ky thotë mbi takimet që kanë bërë t'aratisurit me Englezët dhe këto ja kish thënë Shabani. Ka marë pjesë në të gjitha mbledhjet që ka bërë Grupi i Rezistencës dhe ka qenë nga më aktivët. Ka marë pjesë në një mbledhje që ka qenë një major englez dhe që këta këtij i kërkuanë ndihma etj.

U dënua nga Gjykata e Naltë Ushtarake me 3-7-1946 me 10 vjet burgim.

31) PALI LLAZI TRESOVA, i biri i Llazit dhe i Aleksandrës, lindur në Tresovë më 1906, banues në Korçë, me profesion ish nëpunës i bankës së Napolit. Ky ka marë pjesë në grupin e rezistencës që ishte formuarë në Korçë dhe që ishte në lidhje me grupin e rezistencës në Tiranë. Ka marë pjesë në mbledhjet që bënte grupi i tij dhe ka dashur që të formonin çeta kriminale në krahinën e Kolonjës me anën e kriminelit t'aratisur Jaup Çezmës. Ka propaganduarë dhe folur kundër pushtetit etj.

U dënua nga Gjykata e naltë Ushtarake me datën 3-7-1946 me 10 vjet burgim dhe me punë të detyrueshme.

32) LLAZAR PAPAPOSTOLI, lindur në katundin Ziçisht të Bilishtit më 1915, i biri i Dhimitrit dhe i Fotinis, me profesion nëpunës i UNRRA-s në Durrës. Ky ka qenë ai që bënte ndërlidhjen midis grupit të rezistencës dhe anglo-amerikanëve. Ka marë pjesë në mbledhje dhe ka bërë përkthime të memorandumeve të ndryshme që u janë dërguarë nga grupi tradhëtar anglo-amerikanëve.

U dënua nga Gjykata e Naltë Ushtarake me datën 3-7-1946 me 10 vjet burgim.

33) SENIAZ VËRLACI, lindur në Berat, vjeçe 64 dhe banuese në Elbasan me

profesion shtëpijake. E shoqe e tradhëtarit të popullit Shefqet Vërlacit. Kjo ka ndihmuarë me të holla për forcimin e organizatës tradhëtare të rezistencës. Me anën e Haki Karahoxhës ka pasur lidhje me Alush Leshanakun. Ka pasur lidhje me burin e saj Shefqetin, i cili ashtë i aratisur në Itali etj.

U dënua nga Gjykata e Naltë Ushtarake me datën 3-7-1946 me 5 vjet burgim dhe me punë të detyrueshme.

34) NESIM BELI (STAROVA), i biri i Hajdarit dhe i Qerimes, lindur në Starovë më 1906 dhe banues në Tiranë, me profesion nëpunës. Ka marë pjesë aktive në mbledhjet që ka bërë grupi i rezistencës ku ka biseduarë dhe për të kryer atentate kundër udhëheqësave të pushtetit popullor.

Kanë bisedurë që të vinin në lidhje me t'aratisurit dhe për të bërë një demostratë me rastin e 28 Nëndorit etj. Veprimtarija e tija nuk ashtë dhe aqë e madhe dhe për këtë është dënuarë nga Gjykata e Naltë Ushtarake me datën 3-7-1946 me 2 vjet burgim.

35) PJERIN SHALA, i biri i Nocit dhe i Maries, lindur në Shkodër më 1920 dhe banues në Tiranë. Ka marë pjesë në grupin e rezistencës mirëpo veprimtarija e tij ka qenë shumë e kufizuar. Kur ka marë vesh se janë arestuarë elementa që ai ishte në lidhje është aratis për disa ditë por prapë u këthye.

Gjykata e Naltë Ushtarake e dënoi me datën 3-7-1946 me 1 vjet burgim kondicional.

36) TAQO RUÇO, i biri i Rafailit dhe i Anastasis, lindur më 1904 në Shalës të Kolonjës dhe banues në Tiranë, me profesion ish Oficer. Aktiviteti i tij nuk ka qenë i shumtë vetëm është kufizuarë në disa biseda që ky ka bërë me Niko Beçan etj.

Gjykata e Naltë Ushtarake me datën 3-7-1946 e nxori të pa fajëshmë dhe u lirua nga burgu.

37) XHEVAT MILUKA, i biri i Faslliut dhe i Lahes, lindur në Dibër, vjeç 38, banues në Tiranë, me profesion ish oficer me gradë Toger intendencier. Ka krye gjysëm shkolle të mesme dhe një kurs t'intendencës. Ka pasë kontakte të shpejta me pjestarë të këtij grupi si me Niko Beçën etj. Ka lëshue dhe përhapë parulla kundër gjendjes në Shqipëri dhe ka favorizue moralisht t'aratisurit kriminel. Tue qenë se nuk ka zhvilluar aktivitet në dam të Pushtetit popullor mori pafajësin dhe u lirue nga burgu.

Shtojcë Proçes – Verbali.

Sot më datën tetëmbëdhjet i treti njëmijenëndëqind e dyzet e gjashtë, u rimuar përsëri në pyetje Sami Çeribashi, i cili mbasi u piet, dekllaroj si më poshtë:

Ka qënë fund'i Gushtit ose fillimi Shtatorit 1945 që unë kthehesha nga Vlora për Tiranë. Ndërmjet rrugës Mifol-Fier del një person ndal veturën dhe hipën sipër, me të cilin gjat rrugës u prezantuam me njeri tjetrin, të cilin e quajnë Xhemal Gërgali emigrant Kosovar. Si zakonisht filluan bisedimin e udhtimit, u ankua shumë për dëmet që kishte patur në Kosovë tue humbur me mijra napolona si nga tregëtija ashtu dhe nga të dhetat. Gjith'ashtu u tregua i pa kënaqur dhe nga populsija e

qarkut të Fierit, e cila nuk po i shikonte me sy të mirë emigrantët Kosovar e me një fjalë tregohej mjaft i dëshpëruar.

Përmbi këtë edhe unë e pyeta se sikur t'u vinte gjë në dorë ç'mund do të bënit? M'u përgjegj se "po të vijë rasti bëhemi me qindra Kosovar që jemi gati të vdesim me nder, për këtë të jeni të sigurtë më tha"; mbasandaj gjat rrugës biseduam dhe u fjalosëm kot gjersa arritëm në Tiranë ku u ndam duke shkuar seicili në punën e vet.

Herën e dytë kur u ktheva prapë për në Vlorë u-takova në Fier me Fejzi Selfon me të cilin kisha biseduar dhe herë të tjera dhe dhe e dija që ishte i pa kënaqur nga ky regjim. E pyeta në se ishin të vërteta mbi sa kisha biseduar me Xhemal Gërgalin, por ay m'u përgjegj se përsa u takon Kosovarve të Fierit mund të meresh vesh se ... ., dhëndër i Idriz Bylos, të cilin për meritat që ka e nderojnë dhe e dëgjojnë të gjithë emigrantët Kosovar. Përmbi këtë rekomandim shkova në dyqanin e Idriz Bylos, i cili më prezantojë me të, dhëndërin e vet që po shifnja për herë të parë. Idriz Byloja mirej me shitje malli, kurse neve të dy ishim mbrapa si t'izoluar në mënyrë që bisedimi jonë nuk dëgjohej fare prej Idrizit. Mbas bisedimesh të tjera të kota e solla fjalën rreth bisedimit që kisha patur me Xhemal Gërgalin, d.m.th. a është e vërtetë se me qindra Kosovar emigrandë ishin gati të vdisnin gati me armë në dorë; m'u përgjegj në mënyrë kategorike se "nuk është e vërtetë, pse jo vetëm që Kosovarët kanë mbetur të paktë, por tashti mbasi i janë vënë punës nuk duan të dinë për kur gjë tjetër, prandaj nuk duhet t'u zihet besë fjalëve të kota të Xhemalit më tha". Me kaq përfunduam dhe u ndam.

Një herë tjetër kur kthehesha nga Vlora për Fier, u takova në Fier me Tafil Buletinin, bëmë një shëtitje për disa minuta përpara hotelit dhe mbas një bisedimi të shkurtër këtë pyetje ja vura parasysh dhe këtij, por edhe ky m'u përgjegj si edhe i pari. Kosovarët që kanë mbetur në Fier janë ata më të vdekurit, këta veç punës nuk dinj gjë tjetër, prandaj as sot as motë nuk kanë niset të vdesin. Kështu që edhe ky me një mënyrë të preme i përgënjeshtrojë gjithë sa kishte folë Xhemal Gërgali gjat udhtimit Vlorë Tiranë, për të cilën unë u bëra kurjoz dhe desha të mirja vesh të vërtetën. Mbasi po ngrizen dhe Tafili do të shkonte në katund e mbyllëm bisedën dhe u ndam.

Thëniet që deponova sa sipër janë të vërteta dhe mbasi i këndova i nënshkruaj.

I pyeturi :

(Sami Çeribashi)

Shtojcë proçes – verbali.

Pasi u muar në pyetje Mehmet Ali Beshiri, deklarojë sa më posht vijon:

Në mbledhjen e bërë me Gjergjin në shtëpin e Shaban Ballës, na deklaruan grupet që përfaqsonin dhe Samiu deklarojë se grupi i rezistencës që ishte në lidhje me t'aratisurit Muharem Bajraktarin, Fiqri Dinen, Hysni Demën etj. me të cilët do të bënte maft punë.

Në mbledhje në shtëpin e Ali Kavajës kur Samiu tha që grupi i tij i rezistencës kishte lidhje dhe përfaqsonte t'aratisurit, atëhere Qenani dhe Xhahiti i thanë se sa

do që ti pretendon ashtu, por të shikohen mirë punët, në të vërtetë t'aratisurit i përfaqsojmë ne.

Mbas bisedimit u proçedua verbalisht në zgjedhjen e një komitetit të përbashkët të përbërë prej Qenan Dibrës, Sami Çeribashit dhe Musine Kokalarit. Ky komitet i përbashkët do të drejtonte punën e të tre grupeve.

Sa deklarova ma sipër, mbasi m'u kënduan i nënshkroj.

Tiranë më 9.III.945. I pyeturi :
(Ali Beshiri)

P R O C E S - V E R B A L

Sot me datën 3/ Prill /1946 u muar përsëri në pyetje i pandehuri Mahmut (Tut) Mëniku, i cili mbasi u pyet dekllaroj: Në muajin Qershor të vjetit 1945 tue qenë në Kafe Bar-Sahati Abdullah Muça më ka prezantuar me Kiço Zhongën dhe Reis Hashon, mbas këtij prezantimi fillojti biseda mbi punën e programit që grupi monarkist kishte hartuar dhe të tre këta me radhë njëri pas tjetrit filluan të më shpjegonin në vija të përgjithëshme qëllimin e këtij programi i cili ishte: 1) një parti kundra Pushtetit Demokratik e cila do të kishte lidhje me të gjithë të aratisurit që ndodheshin në mal, me njerzit e pa kënaqur nga Pushteti dhe atyre që u janë vrarë njerzit. Në këtë mbledhje nuk u bisedua gjatë dhe mbetëm dakord që të bëjshim një mbledhje tjetër.

Mbas kësaj na kanë thirë në dyqanin e Qenan Dibrës për të bërë mbledhjen në të cilën mernin pjesë: Qenan Dibra, Xhahit Koka, Reis Hashua, Fiqri Sulua, Mehmet Beshiri, Kiiço Zhinga, Abdullah Muça dhe unë. Në këtë mbledhje fjalën e mori Fiqri Sulua i cili tha: Për të bërë organizimin e kësaj Partije duhet që të formohen çelule nëpër lagje dhe gjithsejcili prej nesh duhet t'i dali zot lagjes së vet, prej çeluleve të lagjeve do të dilte Komiteti, ky Komitet ddo të bënte një Kongres në të cilin do të mernin pjesë delegatë nga të gjitha anët e Shqipëris. Gjithashtu Fiqriu shtoj se duhet të formohesh dhe një Shtab i cili do të drejtonte forcat operative, por me qënë se aty ishte rezik se mos vinte ndonjë njeri filluan të shpërndaheshim. Për këtë punë unë thashë se kjo mbledhje nuk ka asnjë rëndësi mbasi nuk ka ardhur asnjë përgjigje nga Programi i cili i është dhënë Misionit Englez e N/Kolonelit Palmer.

Mbas kësaj jemi takuar edhe një herë në Bahçen e Kursalit ku ndodheshin: Reis Hashua, Qenan Dibra, Xhahit Koka, Sami Çeribashi, Mehmet Beshiri, dhe unë. Në këtë mbledhje fola unë për mungesën e benzinës dhe për shtrënjtësitë. Këtu thashë se benzina në vend që të harxhohet për nevojat ekonomike të vëndit t'onë i dërgohet Jugosllavis. Për këtë arësye unë shkova në kooperatiiv të kërkoja benzinë dhe ata ka dy javë resht e po na sjellin vërdallë tue më thënë hajde sot e hajde nesër. Unë fola për shtrënjtësinë e bukës dhe të sendeve të tjera dhe që kjo qeveri nuk po mer as ndonjë masë. Mbas shumë bisedimeve të tjera që u bënë dhe që nuk më kujtohen u ndamë.

Rreth muajit Korrik ose fillimi i Gushtit kemi bërë një mbledhje në shtëpinë e Enver Hasës ku mernin pjesë: Qenan Dibra, Nefail Skikuli, Ali Ndroqi, Enver Hasa,

Nikolla Kota dhe unë si dhe Mehmet Beshiri. Në këtë mbledhje filluan të këndohesh një letër e ardhur nga Dibra që dërgohesh prej Shemshi Hatibit në të cilin përshkruhesh: Neve kemi filluar aktivitetin t'onë politik me formimin e Këshillavet të cilat janë si organe për të pregatit popullin për një luftë kundra Qeveris; gjithashtu shtonte se me anën e këtij personi ju është sjellë nga Hysni Dema një letër që i drejtohesh Fultzit dhe një tjetër që i drejtohesh Komitetit Qenddror Nacionalist. Për të mundur që aktiviteti t'onë politik të ketë sukses kërkojmë nga juve të kemi përkrahje me ndihma të hollash, gjithashtu kërkojmë vesh-mbathje për çetat t'ona të cilat janë zbathur dhe zveshur. Kërkojshin prej kësaj organizate landë propagandistike, proklamata, trakte e të tjera. Gjithashtu kërkojshin dhe një kalë. Në muajin Korrik të vjetit 1945 Abdullah Muça së bashku me Reis Hashon në një takim që pata me ta mbas Bashkis ku është Pastiçerija Shpati më dhanë një kopje të Programit që i ishte dorëzuar N/Kolonelit Palmer me qëllim që këtë t'ua dërgojsha t'aratisurvet të Dibrës. Para dy ditëvet prej Dibre kishte ardhur një malsor i dërguar prej Ramadan Hoxhës me drejtim për tek unë dhe ky kishte një letër e cila ishte për familjen e Hysni Demës pranë Shaqir Muços, në këtë kohë unë mora biçikletën dhe shkova në shtëpinë e Shaqir Muços ku dorëzova letrën tek Zonja e Hysni Demës që banon atje, ajo më pyeti se kush isha unë dhe ku rij, unë ju përgjigja se isha Mahmut Mëniku dhe rija në Hotelin Ballkan. Në bisedimet që pata me malsorin që pruri letrën më tha se aay do t'ikte nga Tirana mbas dy ditësh mbasi kishte dhe punë të tjera dhe kështu mbemë dakord që të takoheshim para se të shkonte për Dibër. Atë ditë që katundari do të largohesh për Dibër unë i dorëzova atij një pako e cila mund të kishte një peshë prej 3 kilogramësh, por çfarë kishte mbrënda nuk e dij dhe Programin me qëllim që këto t'ja dorëzonte Ramadan Hoxhës dhe prej andej t'i përcilleshin Hysni Demës dhe Fiqri Dines. Emërin e malsoriit nuk e mbaj mënd. Nuk di që të jenë dërguar të holla.

Në mbledhjen e shtëpis së Enver Hasës ka ardhur një zarf i mbyllur në drejtim të Nefail Skikulit dhe që mbrënda këtij zarfi ndodheshin tre letra me tre drejtime, e para i drejtohesh Komitetit Nacionalist Shqiptar në Tiranë, e dyta i drejtohesh Nefail Skikulit dhe e treta i drejtohesh Kryetarit të Misionit Amerikan Hery Fultz. Letra që i drejtohesh Nefail Skikulit përmbante ato që kam përmëndur më lart. Letra tjetër që i drejtohesh Komitetit Nacional shkruante. Rrefuzoj të përgjigjem pyetjes se çka përmante kjo letër. Vrejtje nga Prokurori, din dhe s'do të përgjigjet.

Për sa i përket letrës së Fultzit unë nuk kam dijeni se cila qe përmbajtja e saj, por vetëm mora vesh nga goja e Nefailit se ishte dhe një letër e cila i drejtohesh Misionit Amerikan d.m.th. Fultzit nga ana e Hysni Demës.

Në këtë mbledhje, u vendos që t'u shkruhesh t'arratisurvet, se mbledhja e ndihmavet dor për dor ishte e zorshme, prandaj kjo do të lihej në heshtje, prandaj dhe mbledhja me kaq mori fund.

Mbas kësaj mbledhje jemi thirrur prej Nefail Skikulit dhe Enver Hasës që po rrijshin në baçen e kafe Kursalit, këtu shkova unë, ku gjeta përveç këtyre dhe Mehmet Beshiri. Fjalën e mori Nefail Skikuli, i cili më tha në prezencën e tjervet, se

Enver Hasa ka gjetur një njeri që paguan dhjet milion për formimin e një organizate serioze. Mbasi e pyeta se kush ishte ky person që paguante këto të holla, ay m'u përgjegj se ishte një i huaj. Unë i thash se duhet të largohemi prej të huajvet.

Mbas kësaj mbledhje, kemi bër një mbledhje tjetër më datën 6 Kallnor në shtëpinë e të fejuemes të Talat Drinit, që ndodhet në rrugën e Pishës, dhe në këtë mbledhje merrnin pjesë: Qenan Dibra, Reis Hasho, Xhahit Koka, Mehmet Beshiri, Ali Ndroqi, Zef Nika, Qemal Biçaku, një shofer, që ishte miku i Talat Drinit dhe që quhej, Ismail ose Qemal Kallulli, një vajzë nga familja e Golëvet që ishte e fejuara e Talat Drinit, mbasi kështu na i prezantoj Talati dhe unë Tuti.

Mbledhjen e hapi Qenani, i cili tha: qëllimi i kësaj mbledhje është për me ju bër një thirrje të gjith intelektualëvet, që të marrin pjes për të bër një kongres, mbas tij fjalën e mori Zef Nikaj i cili e zhvillojti këtë duke thënë se për të pasur një sukses neve duhet të formojmë një kongres, nga i cili do të dali një komitet për të dirixhuar të gjith punët, me qënë se ngjarjet po rrukullisen nga dita në ditë, për këtë duhet të thërrasim dhe t'arratisurvet për të dijtur se çfarë tendencash kanë. Për të gjitha këto duhet gjith se i cili të marri përsipër nga një krahinë dhe unë po marr përsipër Shkodrën, Talati Krujë e Mat, Mehmeti tha unë po marr Vlorën dhe Tuti të marri Dibrën, kur se unë e kundërshtova. Mbas kësaj fjalën e mori Xhahit Koka dhe pyeti ç'kupëtoni mbi situatën që është krijue në mes të Shqipëris e Greqis për çështjen e Korçës dhe të Gjirokastrës. Këtij ju përgjegj Zef Nikaj i cili tha se reaksioni i jashtëm shqiptar, si p.sh, Zogu, Ali Këlcyra etjerë, të ndihmuar prej reaksioni Anglo-Amerikan dhe grekëvet, kërkojnë t'i japn Korçën dhe Gjirokastrën Greqis për të marrë pushtetin e Shqipëris në dorë.

Si të lajmëroheshin t'aratisurit do të mblidheshim në një Kongres të përbashkët dhe të rëzonim pushtetin popullor të sotëm dhe të vendosnim një pushtet të ri ashtu sikundër këshillohet prej Anglo-Amerikanëvet me anën e Radio Londrës. Tjetër gjë nga kjo mbledhje nuk më kujtohet të jetë biseduar.

Një ditë në muajin Nëndor të vjetit 1945, kur isha duke ndejt në Kafe Kursal më ka ardhë Qemal Biçaku së bashku me Haki Gjinishin, i cili më ka thënë se jam dërguar prej Reis Hashos ose Xhahit Kokës për të ardhë tek ty mbasi ke lidhje me t'aratisurit e Dibrës si Fiqri Dinen ddhe Hysni Demën, siç më ka thënë, dhe prandaj unë dua të dërgoj Alush Leshanakun për t'u takuar me Fiqrinë dhe me Hysninë, mbasi ashtu kam një punë dhe kjo punë ishte që të bëhesh lidhja midis Alush Leshanakut dhe Fiqri Dines e Hysni Demës, d.m.th. t'aratisurvet t'Elbasanit me të Dibrës. Refuzoj të përgjigjem mbi pyetjen që më bëhet për takimin dhe lidhjet që t'u kem bërë të sipërmëvet me Dibrën dhe as që kam pasur lidhje me t'aratisurit e Dibrës. Vrejtje Prokurorit; ka djeni për t'aratisurit e Dibrës mbasi ka marë dhe ka dërguar shkresa, p.sh. Programin.

Në Kafe Kursal jam takuar me Mehmet Beshirin dhe Qemal Biçakun të cilët më propozuan të shkojmë e të takoheshim me Alush Leshanakun që ndodhet i aratisur kriminel lufte, mbasi këtë e njifte edhe Mehmet Beshiri, dhe kështu të gjithë së bashku me një veturë që kishte një figurë Kaprolli u nisëm për në Çiflikun e Qemal

Biçakut që ndodhet në Qaf-Krabë. Së bashku me neve ishte dhe Sekretari Qemal Biçakut Haki Karahoxha. Mbasi mbrijtëm në vëndin e caktuar ndalëm veturën dhe në këmbë shkuam në katundin Bizhutë që ndodhet një orë larg nga rruga ku lamë veturën, nja 10 minuta jashtë katundit u takuam me Alushin. Mua me Alushin më prezantoji Mehmet Beshiri dhe Qemal Biçaku mbasi nuk u njifsha. Këtu fjalën e mori Mehmet Beshiri: kishim marë vesh për ty se jeshe vdekur; mbasi Alushi i bëri një histori mbi të kaluarën e tij dhe mbi plagën që kishte marë si dhe mbi kthimin e tij që nga Kosova e deri n'Elbasan ku kishte kaluar rrugës tue patur me vete disa dele si bari, biseda ndërmjet këtyre mbarojti dhe mandej fjalën e mora unë duke filluar t'i kallzoj Alushit për Programin që ishte përpilluar nga ana e Partis t'onë dhe që këtë unë ja kisha dërguar dhe t'aratisurvet të Dibrës. Alushi më pyeti për programin që unë shpjegojsha nëse ky është pranuar prej englezëve ose jo; unë ju përgjigja se s'kemi marë hala ndonjë përgjigje prej tyre dhe me qenë se ka një kohë të gjatë çështja e programit që u është dërguar atyre afati skadoj. Alushi m'u përgjegj se neve duhet të bëjmë një Kongres i cili do të kishte qëllimin që përmëndëm më parë, dhe për këtë ay kërkonte që të takohesh me t'aratisurit e Dibrës, Hysni Demën, Fiqri Dinen dhe për këtë ay kërkonte se si do të gjente mundësinë për t'u takuar mbasi nuk njifte njeri në Rajonin e Dibrës, unë ju përgjegja se njof nja dy miq me anën e Ramadan Hoxhës dhe kështu mund të shkosh vetë për t'u takuar me ta, d.m.th. me Fiqri Dinen dhe Hysni Demën. Në pyetjen që i bëri Mehmet Beshiri se çfarë forcash dispononte Alushi, ay ju përgjegj se të gjitha këto katundet që janë nën influencën e Shefqet Beut janë me mua, në këtë kohë Qemal Biçaku shtoj se prezenca e Alushit në këto vënde është njsoj sikur të ishte dhe vetë Beu. Kur u bisedua për çështjen e armatimit dhe të aksioneve që do të bëheshin nga ana e t'aratisurvet Alushi u përgjegj se përsa i përket armatimit edhe këtë mund ta bëjmë shumë lehtë me një sulm mbi depot e Librazhdit ku do t'armatosemi dhe pjesës tjetër i vëmë zjarrin, gjithashtu ay na u përgjegj se përsa i përket rrugës s'Elbasanit që prej Qaf-Krabës e deri në Pogradec, prej aksioneve të shumta kjo do të dali jashtë përdorimit. Ay më tha gjithashtu se po të bëhej një Kongres dhe po të ketë nevojë të shkojë ndonjëri për të shkuar jashtë me ba lidhje, shkoj unë. Alushi më tha gjithashtu se kishte marë haber nga Misioni englez të cilët më kanë lajmëruar që të pres deri sa të më thonë ata. Kur ishim duke ikur Alushi na tha se po dëshironi Bizhutin dhe rethet e tij mund t'i bëjmë si Peza. Me kaq u ndamë dhe muarmë maqinën e erdhëm në Tiranë, të hollat e maqinës i pagoj Qemal Biçaku.

Me Giovani Girron jam njojtur në vjetin 1938 dhe me këtë më ka prezantuar Selman Stërmasi në baçen e Kafes Kursal. Në këtë takim Girrua na ka folur mbi organizimin e djelmënis shqiptare dhe mbi premtimet që i kishte dhënë Zogu se si do mund t'organizonte djelmëninë. Girrua ka ardhë shpesh herë në Kafe Ballkan dhe në bisedat që kam pasur me të, mbasi ay më shifte si një element anyi-zogist, shprehesh lirisht tue folur me urejtje dhe përbuzje kundër Qeveris të ish Zogut, mbi injorancën e popullit shqiptar që dhe kjo ishte si pasojë e Qeveris. Ay fliste gjithashtu mbi fashizmin dhe mënyrën se si t'organizohesh djelmënija shqiptare

nën fashizmin e tjera. Në një bisedë që ka pasur me Girron më ka thënë se për organizimin e djelmënis shqiptare janë paraqit dy Programe, një nga unë dhe një nga Ismet Totua. I Ismet Totos ishte kopjuar nga organizimi që kishin gjermanët, ndërsa Programi i Girros ishte ay që kishte fashizmi italian. Këto të dyja Programe i janë paraqitur Zogut dhe shpresojmë që të vihen në zbatim.

Me Girron kemi bërë dhe shumë biseda të tjera, por mua nuk më kujtohet se çfarë biseda politike kemi bërë. Qëllimi i ardhjes së Girros në Kafen t'onë ishte me qënë se më njifte mua dhe mbasi në Kafe mblidheshin elementa të ndryshëm tregëtarë e të tjerë, që kështu të mund të zhvillonte ndonjë farë axhitasioni për interesin e fashizmit. Një nga miqtë më të afërtë të Girros dhe që i shkonte gjithmonë mbrapa ishte Nexhmedin Qoraliu, Jak Koçi. Jani Koçi është nga Shkodra dhe Nexhmedin Qoraliu nga Tirana.

Tjetër gjë nuk kam për të thënë, thënjet e mia mbasi m'u kënduan dhe janë konform i vërtetoj me nënshkrimin t'im me vullnet të lirë dhe pa ndonjë shtërngim.

Tiranë, më 3/IV/1946.

I pandehuri: Sekretari: Prokurori:

Mahmut Mëniku

AIDSSH, N= 1081-A. Viti 1961, D. 3.

REPUBLIKA POPULLORE E SHQIPËRISË
GJYKATA USHTARAKE E NALTË
Tiranë, më 8.VII. 1946

Drejtoris së Burgut të Ri Tiranë

Ju njoftojmë se kjo Gjykatë e vendimin e saj Nr. 5 regj. Dat. 2.VII.1946 ka vendosur ndëshkimin e MUSINE KOKALARI nga Tirana me 20 VJET BURGIM, humbjen e të drejtave qytetare e politike, si dhe konfiskimin e pasuris.

Ndëshkimi fillon më datën 23/1/1946 dhe i mbaron më 23/1/1966.

Për KRYETAR I GJYKATËS USHTARAKE
(Major Frederik Nosi)

AIDSSH, N= 1081-A. Viti 1961, D. 3.

REPUBLIKA POPULLORE E SHQIPËRISË
PROKURORIA E GJYKATËS USHTARAKE TE NALTË

AKT-AKUZË
(KOMUNIKATË)
GJYKATËS USHTARAKE

Këtu

Sikurse do të konstatohet dhe nga process-verbalet e mbajtuna prej Seksionit te M.P. të Tiranës, që bashkangjitur paraqiten, I pandehuri MUSINE KOKALARI e bija e RESHATIT dhe ANUSHES vjeç 28, nga TIRANA, me profesion efektiv LIBRA-SHITËSE, e rreshtuar më datën 23 Janar 1946.

Akuzohet se Musine Kokalari gjat okupacionit Fashist-Nazist, ka bashkëpunuar me kreret e Ballit Kombëtar dhe Legalitetit, si: Mitat Frashëri, Gaqo Gogo, Xhelal Staravecka etje.

2) – Mbas çlirimit të Shqipërisë ka zabotuar pushtetin duke bashkëpunuar me Suat Asllanin, Qenan Dibrën, Sami Çeribashin e tjerë.

3) – Ka marrë pjesë në të gjitha mbledhjet e fshehta që ka bërë Grupi Monarkist, Grupi i Rezistencës dhe i Social-Demokrates, duke zgjedhur një; Komitet të përbashkët, e cila në bashkëpunim me t'aratisurit, si Fiqiri Dineja dhe Muharem Bajraktari etj, kishin për qëllim përmbysjen e pushtetit të sotmë me violencë.

4) – Bashkarisht me krerët e Grupeve të tjera tradhëtare kanë përpiluar nota e programe për aleatët, të cilëvet ja u kanë paraqitur të turbullt gjendjen në shqipëri, dhe me këtë mënyrë, duke i gënjyer, kanë kërkuar ndërhyrjen e tyre.

Mbasi faji i tij parashikohet i ndëshkueshëm prej Nen. 1, të Ligjës Nr. 21, datë 15.12.1944 dhe 15 & II, të Ligjës Nr. 41 datë 14.I. 1945 është parë e nevojshme që ky të gjykohet.

Prandaj:

Kërkoj gjykimin e tij nga ana e asaj Gjykate mbasi t'i faktohet faji që akuzohet, në përfundim të vendoset ndëshkimi në bazë të nen. 18, të Ligjës Nr. 41, datë 14. I. 1945 mbi organizimin e funksionimin e Gjykatave Ushtarake.

Tiranë, më 10.VI. 1946

Fl. 214-215
Tiranë, më 30/III/1946

U muar në pyetje e pandehura Musine Kokalari, e bija e Reshatit dhe e Anushes, vjeç 28, lindur në Turqi e banuese në Tiranë, libra-shitëse, e pamartuar, me arsim të lartë, studime universitare, e padënuar, e arestuar më datën 23/Janar/1946 e mbasi

u pyet dekllaroj: Organizatën e Ballit Kombëtar, mbi këtë nuk mund të përgjigjem, pse nuk jam përgjegjëse për veprat e Ballit. Në Ballin Kombëtar kam marrë pjesë si Social-Demokrate. Aproksimativisht një muaj para se të njifej Qeverija më ka ardhur Shaban Ballan në Mesagjeri afër Bar-Sahatit, i cili më tha se duhet të fillojmë nga aktiviteti politik, unë ju përgjigja se nuk e shof të nevojëshme që të punohet se kur të vijë koha kjo punë është e lehtë dhe do të bëhet me anën e një formaliteti. Për këtë punë Shaban Balla ka ardhur edhe një ose dy herë të tjera me qëllim që të fillonim aktivitetin politik mbasi ay e shikonte nën prizmën e grupit të tij të rezistencës, por përgjegja t'eme ka qenë gjithënjë si e para.

Mbasi erdhi nota nga Anglo-Amerikanët për njofjen e Qeveris dhe që kjo ishte e kondicionueme, d.m.th. lihesh shteg edhe për formimin e një opozite, mbas kësaj kohe erdhi Shaban Balla, i cili më tha se e shikon që duhesh punuar më përpara kur unë të kam lajmëruar për të bërë një aktivitet politik për këtë neve vendosëm të bënim një mbledhje në shtëpinë e Shaban Ballës ... Në këtë mbledhje u bisedua për përpilimin e një note.

Dy ditë mbas mbledhjes së parë jemi mbledhur në shtëpinë e Ali Kavajës, dhe unë Musine Kokalari që përfaqësoja Social-Demokraten. ... Nota u përpilua prej meje, Qenanit, Shabanit dhe Samiut, ku të gjithë bëmë nga një notë dhe nga studimi i të gjithavet u përpilua nota që do t'i dërgohesh Misionevet Anglo-Amerikane, nota me sa mbaj mend unë thoshte: Në mbledhjen e sotme, me datën që nuk e mbaj mend, ku janë mbledhur përfaqësuesit e tre Partivet, Social-Demokratë, Rezistencë dhe Monarkista, u vendos dërgimi i notës, e cila ka këto pika: 1) Shtymjen e votavet; 2) Liri shtypi dhe propaganda; 3) Kontrollin e aleatëvet me rastin e votimevet. Mohoj të kemi kërkuar ndërhyrjen e Anglo-amerikanëvet në bazë të parimeve të shpallura nga burra shteti aleat. Nuk është e vërtetë që në notë të jetë përmenur se premtimet e Qeveris që i janë dhënë popullit nuk janë mbajt mbasi Qeverija ka dhënë afat të shkurtër për zgjedhje. 4) Nuk mjafton ardhja e korispondentëvet të huaj për zgjedhje, por duhet një kontroll aleat. Për të gjitha këto kërkohesh shtymja e zgjedhjevet. Në notë shkruhesh se kësaj i bashkangjitesh edhe Programi. Program kishte si titull "Programi aktual i përbashkët" dhe pikat e këtij Programi ishin këto: 1) Miqësi me Shtetet Demokratike dhe sidomos me shtetet fqinjë; 2) Zgjidhja e problemit të Kosovës me anën e plebishitit ose simbas Konferencës së Paqes; 3) Respektimi i të drejtavet të pakicave; 4) Një Qeveri demokratike dhe respektimi i të drejtavet të njeriut; 5) Zbatimi i të gjitha reformave shoqërore në bazë të traditavet; 6) Të lëftohet çdo element fashist e profashist; 7) Garantimin e qetësisë së brendshme. Nota dhe programi u firmuan nga unë Musine Kokalari, Musa Dizdari, Qani Kreka, Neim Babameto, Gjon Kovaçi, të gjithë këta për Grupin Social-Demokrat. Për gruipet e tjera nuk më kujtohet se kush i ka firmuar. Nota dhe program ju dërguan Misioneve Anglo-Amerikane dhe siç mora vesh më von u çuan prej Qenan Dibrës, Shaban Ballës e Sami Çeribashit, të cilët shkuan me maqinën e e Shabanit.

Në muajin Nëndor të vjetit 1945 një ditë erdhi Suat Asllani, i cili më gjeti në Mesagjeri dhe ay më tha se çfarë mendojshe unë për opozitën dhe në këtë mënyrë

fillojti diskutimi se në çmënyrë mund të bëhesh opozita, në këtë kohë kur ay me fliste për opozitë unë i thashë se çfarë program ke dhe çfarë rrugë do të ndjekësh, ay mu përgjegj se është e nevojshëme që neve t'organizohemi mbasi në këtë mënyrë do të kemi përçarje dhe do të na shpërndahet elementi dhe do të kërkojmë që të jemi sa më afër rrugës që ndjek Qeverija. Gjithashtu ai shtojti se mbasi të jenë bërë zgjedhjet dhe opozita t'onë të ketë pa sukses neve do të kemi deputetët t'anë të cilët do të thonë fjalën e tyre në Parlament.

Fl. 216

Sot më datë 1/Prill/1946 ditën e Hënë u muar përsëri në pyetje e pandehura Musine Kokalari, e cila mbasi u pyet dekllaroj: Mbas mbledhjes së Mukajt kam marë pjesë në Ballin Kombëtar si Social-Demokrate dhe kam qenë Përgjegjëse e Gazetës Zëri i Lirisë, në të cilën kam botuar artikuj ku flitesh nga pikëpamje shoqërore, mbi çështjen e Kosovës në bazë të Kartës s"Atllantikut, mbi demokracinë. Mbi demokracinë përshkruhesh në këtë mënyrë: kriteri për të luftuar ishte jo për qëllimin e disa klikavet por për demokratizimin e vëndit. Gazeta botohesh në Shtyp-shkronjën Gutenberg aty ku dilshin edhe gazetat e Ballit. Gazeta shitesh me çmimin 5 lek, dhe disa herë jepesh edhe gratis. Këtë gazetë e merte edhe Balli Kombëtar. Gazeta mbahesh vetëm me rrogën t'eme dhe me disa ndihma që jepte Skënder Muçua. Sektori i punës t'ime në këtë kohë ishte puna me rininë e Ballot Kombëtar tue i këshilluar këta të pritnin mbasi luftën nuk e bënim dot dhe nuk mereshim me prapagandë aktuale.

Kam bërë konferenca nëpër lagjet e Tiranës, por nuk më kujtohet se në çfarë shtëpirash i kam bërë.

Kur Balli Kombëtar u nis për në luftë kundra Ushtrisë Nacional-Çlirimtare Jugosllave (Në Morinë) mohoj që unë të kem dalë e ti kem përcjellë me flamur ose në çdo mënyrë tjetër.

...

Mohoj që organizata t'onë të ket pasur për qëllim rëzimin e Pushtetit Demokratik me forcë dhe marjen e fuqis në dorë. Partija jonë ka patur për qëllim të punojë.

Tiranë, më 1/IV/1946.

AIDSSH, Dosja N. 1081-A, Viti 1961, D. 3.

REPUBLIKA POPULLORE E SHQIPËRISË MINISTRIJA PUNVE MBRENDËSHME
Tepër Sekret

REPUBLIKA POPULLORE E SHQIPËRIS
MINISTRIA P. MBRËNDËSHME
PUNTORIJA Q. ARTIZANATIT
Nr. 301 Prot Tiranë me 9/X/961

L ë n d a: Mbi lirimin nga burgu të Musine Kokalari.

MINISTRIA PUNËVE MBRËNDËSHME
DREJTORIS SIGURIMIT SHTETIT
(Degës IV-tër)

T I R A N Ë

Për njoftim
DREJTORIS PUNËVE MBRENDËSHME

T I R A N Ë

Ju njoftojmë se më datën 8/X/961 u lirua nga burgu Puntoris Qendrore Artizanatit M.P.Mbrendëshme me plotsim kohe e quajtura Musine Kokalari e bija Reshatit e Anushes me dat lindje 1918 lindur në Turqi banuse në Tiranë Ruga Qemal Stafa, e pa martuar, me arsim të lartë, me profesjon libra shitëse sot robaqepse, me origjinë të mesme, me shtesi dhe kombësi shqiptare.

Arestuar me datën 23/I/946 dënuar me 20 vjet me vendim Nr. 5 datë 2/7/946 të Gjykatës Lartë Ushtarake Tiranë për krime kundër shtetit, për arsye se gjatë Luftës N.Ç.L. ka bashkpunuar me Ballin Kombëtar si me Mitat Frashërin, Ali Këlcyrën etj. ka qenë organizatore e gruas Ballit për kundër livizjes N.Ç.L. dhe mbas çlirimit ka qenë pjestare e grupit Shkodrës ku ka bashkpunuar me Sami Qeribashin për rëzimin e Pushtetit Popullor.

Kaq për njoftim.

D R E J T O R I
N/Kol. (Beqir Liço)

AQSH, Fondi 14 (KQ i PPSH), Viti 1947, D. 297, Fl. 2.

Radiogram 258 Tiranë, më 9/8/47
Komitetit Qëndror të P.K.SH.
Shkodër-Gjinal

Me rastin që Kuvendi Popullor i hoqi imunitetin deputetit tradhtar _____, organizoni në rrethin elektoral ku ai ka qene i zgjedhur një meting të gjërë me masën e popullit ku të kërkohet dënimi i tij i shpejtë dhe i reptë. Metingu ka një rëndësi politike prandaj të organizohet mirë, të ketë sa më shumë njerëz dhe të mobilizohet masa e popullit me urejtjet kundra armikut. Nga metingu të dali telegram për sekretariatin e Frontit të nënështkruar prej një komisioni të gjërë të dalë nga populli.

Për komisionin e Agit-Prop-it pranë K.Q. të P.K.SH.
Fadil Paçrami

AQSH, Fondi 14 (KQ i PPSH), Viti 1947, D. 297, Fl. 4.

Radiogram
Nr. 258/1 Tiranë, më 2/9/47

Gjith qarqeve

Të enjte më 4 shtator çelet në Tiranë gjyqi i deputetëve tradhtarë dhe i bashkëpunëtorëve të tyre. Ky gjyq ka një rëndësi jashtëzakonisht të madhe pse aty dalin elementët reaksionarë që kanë qenë në krye të veprimtaris së reaksionit në vendin t'onë. Partia dhe gjithë populli duhet të mësojnë prej këtij gjyqi se cilët janë armiqt e vërtetë të popullit dhe t'atdheut. Gjyqi duhet të shërbejë shumë për forcimin e koshjencës politike në masat e popullit, të urrejtjes dhe të vigjilencës kundra armiqve të brendshëm dhe të reaksionit imperialist amerikan.

Organizatat e Partisë, agjitatorët dhe propagandistët t'onë si dhe organizatat e masave duhet të mobilizohen për këtë çështje. Të bëhen mbledhje të shkurtëra t'aktivëve t'agitatorëve ku të jepet orjentimi i agitacionit në lidhje me gjyqin.

Gjat gjith zhvillimit të gjyqit duhet të organizohet një agitacion i madh në masat e popullit të qytetit dhe në të gjith fshatrat.

Agitatorët dhe gjith antarët e Partisë, kandidatët dhe të rinjtë komunistë duhet të organizojnë për këtë çështje bisedime të lira me popullin. Shënojmë se orientimin dhe materialin për agitacionin në lidhje me gjyqin do t'a gjeni në gazetën Bashkimi sidomos në akt-akuzën e Prokurorit.

Nga ana agitative duhet të dali një urejtje e masave të popullit kundra tradhtarëve dhe të kërkohet nga ana e tyre me telegrame drejtuar Sekretariatit të Frontit dënimi i shpejtë dhe i rreptë i tradhtarëve.

Veçanërisht të bëhen mbledhje të popullit në ato vende ku një pjesë e tradhtarëve kanë qenë përfaqësues të popullit dhe të kërkohet dënimi i tyre i pamëshirshëm.

Për komisionin e Agit-Prop-it pranë K.Q. të P.K.SH.

Fadil Paçrami

AQSH, Fondi 14 (KQ i PPSH), Viti 1947, D. 297, Fl. 5.

Tiranë më 26/9/47

Telegram

Gjith qarqeve

Pretenca e Prokurorit të popullit kundra grupit të tradhtarëve që u gjykuan në Tiranë duhet të punohet në mbledhje të veçanta të Komiteteve të Partis dhe të celulave. Para se të punohet dhe të jenë lexuar individualisht dhe në mbledhje të shpjegohet prej sekretarit të Komitetit, të celulës dhe prej të dërguarit të Komitetit të Partisë. Pretenca do të botohet e tana për pak ditë. Për tani mund të përdorni gazetën bashkimi Dt. 25 shtator.

Fadil Paçrami

2.3 Sigurimi i Shtetit dhe platforma agjenturore e tij

Platforma e punës operative e organeve të punëve të brendshme, Tiranë 1985 (Partia e Punës së Shqipërisë. Byroja Politike e Komitetit Qëndror).

Miratuar në Mbledhjen e Byrosë Politike të Komitetit Qendror të PPSH në datë 12.2.1985

Fq. 3

Organet e punëve të brendshme të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë janë një armë e fuqishme e diktaturës së proletariatit, një repart politik dhe ushtarak i saj që udhëhiqen nga Partia e Punës e Shqipërisë për të zbuluar dhe shpartalluar veprimtarinë armiqsore dhe keqbërëse të armiqve të brendshëm e të jashtëm për të mbrojtur fitoret e revolucionit e atdheun socialist, për të garantuar triumfin e çështjes së komunizmit.

...

Në tërë veprimtarinë e tyre organet e punëve të brendshme udhëhiqen nga politika dhe ideologjia e Partisë së Punës së Shqipërisë, bazohen në Kushtetutën e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë dhe në ligjshmërinë socialiste, ato mbështeten fuqimisht te populli.

f. 10-13

Për të zbuluar, parandaluar, dokumentuar e goditur veprimtarinë e armiqve të jashtëm e të brendshëm të Republikës Populllore Socialiste të Shqipërisë dhe të elementëve keqbërës, vetëm organet e Sigurimit të Shtetit dhe sektorët operativë të Policisë Populllore (i mbrojtjes së ekonomisë socialiste e i ndjekjes së krimeve) kanë të drejtë të ndërtojnë rrjetin sekret informativ të përbërë nga rezidentë, agjentë, informatorë dhe strehues.

Në rrjetin sekret informativ të Sigurimit të Shtetit, si dhe të sektorëve operativë të Policisë Populllore tërhiqen shtetas shqiptarë, shtetas të huaj dhe persona pa shtetësi.

Tërheqja në bashkëpunim sekret bëhet në baza patriotike, vullnetare e detyrimi dhe kurdoherë për qëllime të caktuara operative.

Tërheqja në bashkëpunim sekret me detyrim bëhet mbi bazën e të dhënave operative, kallzimeve ose dokumentave të tjera të vërtetuara, që provojnë se kandidati ka kryer vepër penale.

Tërheqja në bashkëpunim mbi bazë detyrimi bëhet në gjendje të lirë ose arresti. Tërheqja në bashkëpunim sekret mbi bazë detyrimi në gjendje të lirë bëhet nga organet e Sigurimit të Shtetit dhe sektorët operativë të Policisë Populllore në bazë të bashkëbisedimit të lirë me vetë personin.

Tërheqja mbi baza detyrimi në rastet kur vendoset të zbatohet masa e arrestimit sekret, bëhet me miratimi të organeve udhëheqëse të Ministrisë së Punëve të Brendshme. Në këto raste ndalimi për tërheqje bëhet brenda një afati prej 72 orësh.

Organet e Sigurimit të Shtetit, si dhe sektorët operativë të Policisë Populllore, kanë të drejtë të përdorin në rrjetin sekret informativ dhe anëtarë e kandidatë partie, por jo kategori bashkëpunëtorësh, në kuadrin e përgjithshëm të rrjetit informativ të këtyre organeve, duhet të jetë e kufizuar. Ata kryesisht duhet të kryejnë detyrëm e rezidentit e të strehuesit.

Në çdo rast, anëtarët ose kandidatët e Partisë që përdoren në rrjetin sekret informativ duhet të mos kenë funksione partied he, para se të tërhiqen në bashkëpunim, të merret miratimi i sekretarit të parë të komitetit të Partisë të rrethit, ndërsa në ushtri i sekretarit të komitetit të Partisë të divizionit ose njësisë të barabartë me të. Për bashkëpunëtorët anëtarë e kandidatë partie nuk merret dokument (deklaratë) bashkëpunimi.

Ndalohet kategorikisht që bashkëpunëtori anëtar apo kandidat partie t'u raportojë organeve të punëve të brendshme mbi çështjet që mësone diskuton në organizatën-bazë të Partisë.

Ndalohet kategorikisht futja e bashkëpunëtorëve në veprime operative me detyra që janë në kundërshtim me vijën e Partisë, ligjshmerinë socialiste dhe me normat e moralit komunist.

Ndalohet kategorikisht takimi sekret vetëm nga një punonjës i organeve të punës së brendshme me bashkëpunëtore femra.

Puna operative e Sigurimit të Shtetit, si dhe e sektorëve operativë të Policisë Populllore, është një veprimtari e fshehtë dhe përbën sekret shtetëror.

Fq. 15

Në tërësinë e masave operative në drejtim të zbulimit, parandalimit, dokumentimit dhe goditjes së veprimtarisë armiqsore e keqbërëse vetëm organet e punëve të brenshme kanë të drejtë të përdorin edhe këto lloj mjete të punës operative:

1. Të bëjnë kontrollin sekret të korrespondencës post-telefon-telegrafike të të dënuarve, kur shihet e nevojshme edhe korrespondencën e të internuarve e të dëbuarve, personave në përpunim, si dhe çdo correspondence tjetër, ku ka të dhëna me përmbajtje armiqsore e keqbërëse.

Ndalohet kontrolli i korrespondencës që nuk përfshihet në kategorinë e mesipërme.

...

Fq. 17

Gjatë kontrollit të korrespondencës, organet e punëve të brendshme kanë të drejtë të ndalojnë e të konfiskojnë korrespondencën me përmbajtje kundërrevolucionare ose të dyshimtë për veprimtari armiqsore.

Kontrolli i korrespondencës bëhet pa lënë gjurmë e pa penguar shërbimin postar.

2. Të përdorin vëzhgim sekret në drejtim të personave që janë në përpunim ose që dyshohen për veprimtari armiqsore e keqbërëse. Vëzhgimi nuk ndërpritet edhe kur objekti në vëzhgim takohet ose shoqërohet nga persona të tjerë.
3. Të përdorin teknikën operative në drejtim të personave që janë ose që dyshohen për veprimtari armiqësore e keqbërëse. Në procesin e përdorimit të teknikës operative veprimet të mos ndërpriten edhe kur të futen persona të tjerë.
4. Të përdorin veprimet operative sekrete për zbulimin, dokumentimin dhe ndërprerjen e veprimtarisë armiqësore dhe keqbërëse.
5. Të përdorin vërtetimin biografik për interesa operative.

Gjatë realizimit të detyrave oprative organet e punëve të brendshme përdorin fondin sekret (të veçantë).

Rregullore e evidencës operative të organeve të Punëve të Brendshme, Ministria e Punëve të Brendshme, Drejtoria I Sekret, Nr. 01-27 Datë 23.8.1986, Tiranë 1987.

Fq. 4-5

Dosjet që krijohen për bashkëpunëtorët e rrjetit sekret informativ

Për personat që tërhiqen bashkëpunëtorë në rrjetin sekret informativ krijohen këto dosje:

a) **Dosje Personale**, krijohet për bashkëpunëtorët e të gjithë kategorive, në bazë të vendimit përkatës, dhe pasi të jetë bërë raporti përfundimtar i tërheqjes së personit në bashkëpunim. Në dosje vendosen dokumentat e lidhjes nr 1/1.

b) **Dosje pune**, krijohet për agjentët dhe informatorët në një kohë me krijimin e dosjes personale. Për bashkëpunëtorët e kategorisë resident e strehues dhe për informatorët që përdoren si përkthyes, të kontrollit postar e të

teknikës operative, dosja e punës krijohet vetëm kur ata japin të dhëna me interes operativ. Në dosje vendosen dokumentet elidhjes nr. 1/2.

5. Dosja personale dhe e punës e bashkëpunëtorit që merret në përpunim aktiv 2/A për veprimtari armiqësore ose keqbërëse, arkivohen me vendim të rregullt bashkë me kartelat model 2 në Sektorin e Evidencës Operative, duke bërë më parë një relacion përmbledhës në dy kopje, të cilët vendosen në dosjen e përpunimit dhe në atë personale.
6. Degët e punëve të brendshme që përdorin në dhomat e paraburgimit bashkëpunëtorë të marrë nga rradhët e të dënuarve, tërheqin në të njëjtën kohë edhe dosjen e tij personale, të cilën në përfundim e pasurojnë me karakteristikën e punës dhe ia dërgojnë degës së punëve të brendshme të rrethit, ku bashkëpunëtori do të shkojë për të bazhduar vuajtjen e dënimit.

Fq. 7-8

Dosjet e fashikujt që krijohen për elementin armik e keqbërës

7. Për personat që merren me përpunimin e kontroll për veprimtari armiqsore ose keqbërëse, krijohen këto dosje:

a) **Dosja e përpunimit aktiv 2/A**, krijohet për çdo shtetas shqiptar, shtetas të huaj dhe persona pa shtetësi, me banim të përhershëm ose të përkohshëm në RPSSH, të përgjegjshëm, që ka. Mbushur moshën 14 vjeç, kur për të ka të dhëna të vertetuara se zhvillon veprimtari armiqësore ose keqbërëse, në drejtim të të cilit përdoren aktivisht llojet e format e punës operative për të zbuluar në gjerësi e thellësi dhe dokumentuar e ndërprerë në kohë veprimtarinë e tij. Në dosje vendosen dokumentet e lidhjes nr. 1/3.

Kur një person është në përpunim aktiv 2/A për veprimtari keqbërëse dhe merren të dhëna të vërtetuara se zhvillon edhe veprimtari armiqësore, me urdhër të titullarit të organit dosja e përpunimit i kalon sektorit të Sigurimit, i cili ndryshon tendencën dhe për ndjekjen e mëtejshme bën plane masash operative të përbashkët me ato të Policisë.

Personat e arrestuar jashtë përpunimit, në raste të veçanta dhe kur interest operative janë të rëndësishme, merren në përpunim aktiv 2/A gjatë kohës që ndodhen në dhomat e paraburgimit.

b) **Dosja e përpunimit paraprak (PP**), krijohet për çdo shtetas shqiptar, shtetas të huaj e persona pa shtetësi me banim të përhershëm në RPSSH, të përgjegjshëm, që ka mbushur moshën 14 vjeç, për të cilin ka të dhëna të pavërtetuara se zhvillon veprimtari armiqësore ose keqbërëse, saktësia e të cilave duhet vërtetuar duke përdorur llojet e format e punës operative. Në dosje vendosen dokumentet e lidhjes nr. 1/3.

c) **Dosja e kontrollit operativ 2/B**, krijohet për çdo shtetas shqiptar, shtetas të huaj dhe persona pa shtetësi me banim të përhershëm në RPSSH,

të përgjegjshëm të moshës mbi 14 vjeç, kur është vërtetuar se në të kaluarën ka zhvilluar veprimtari armiqësore, për të cilën është dënuar ose jo dhe aktualisht nuk vepron. Për të zbuluar riaktivizimin në veprimtari armiqësore të tij, është i nevojshëm kontrolli i herpashershëm me llojet e punës operative . në dosje vendosen dokumentet e lidhjes nr. 1/3.

Në kontrollin operativ 2/B për tendencën e spiunazhit mbahen të gjithë personat e zbërthyer në gjendje të lirë dhe të dënuarit me pohim për këtë veprimtari (të dënuarit merren në kontroll operativ 2/b, pasi kanë vuajtur masën e dënimit me heqje lirie), kur në ngarkim të tyre nuk ka të dhëna për riaktivizim në veprimtari armiqësore.

AIDSSH Nr. 68, Viti 1982, Dosja ORV, Fl. 47.

Reparti i riedukimit Nr. 301/1 Batër

Plan Masash agjenturoro-operative dhe ushtarake per sigurimin e reparteve te riedukimit 321 dhe 301/1 Bater

Nga disa të dhëna të Drejtorisë së III-të del se Leka Zogu bën përpjekje për të ndërhyrë ushtarakisht në vendin tonë dhe për këtë qëllim ka kërkuar informacion të hollësishëm mbi repartet e riedukimit dhe në mënyrë të veçantë për repartin 321 të riedukimit në BUrrel, mbi rregjimin e hyrjeve dhe të daljeve në to, mbi forcat ushtarake që dislokohen në afërsi të tyre, mbi mënyrën e ruajtjes, etj., duke kërkuar në të njëjtën kohë dhe një skicë të vendvendosjes së këtyre reparteve.

Me qëllim që të zbulojmë, prandalojmë dhe godasim në kohë çdo veprimtari armiqësore e keqëbërëse që mund të ndërmarrë elementi armik në drejtim të reparteve të riedukimit 321 dhe 301/1 – Batër, si dhe në zbatimi të porisive të dhëna nga Drejtoria e Parë e sigurimit të Shtetit me shkresën e saj Nr. 3494 datë 10.9.1982, do të merren këto masa agjenturoror-operative dhe ushtarake:

1. – do të bëhet rivlerësimi I të dhënave që kane të bëjnë me organizimin, për problemin e çentralizuar “Dhelpra” dhe konkretisht të dhënave të bp: “Besniku” dhe “Kasketa” për krijimin e një organi qeveritar në repartin 321 të riedukimit. Kryejnë p.o.p.: B. Budo dhe Vehap Kuka deri më 30.X.1982.
2. – do të bëhet rivlerësimi I të dhënave që bëjnë fjalë për interesim të dënuarëve për lidhjet e tyre jashtë reparteve të riedukimit, sidomos atyre të dhënave që bëjnë fjalë për lidhjet e elementeve antiparti dhe të dënuarve të tjerë politike. Do të drejtohen për këtë qëllim dhe pb: “Butrinti”, “I Penduari”, “Besniku”, “Kasketa”, dhe “Shkëmbi”. Po kështu do të nxirren dhe vlerësohen dhe disa sinjale, parrulla e korrespondenca të objekteve të përpunimit me të dënuar të tjerë, lidhjet e tyre shoqërore e fanmiljare me interesa operative. Kryejnë p.o.p. B. Budo, V. KUka dhe Y. Keta deri më 31.XI. 1982.

3. – Do të drejtohet agjentura në rradhët e ushtarëve dhe të policëve dhe konkretisht b.p.: "Deja, "Ylberi", "Plepi", "Adriatiku", për të na informuar lidhur me mangësitë gjatë kryerjes së kontrollove ndaj të dënuarve gjatë takimit të tyre me familjet e lidhjet e tyre, gjatë hyrjeve dhe daljeve nëpër reparte apo jashtë tyre, kur futen dhe dalin letra, pako, ushqime, me qëllim kapjen e ndonje sinjali, parrulle, korrespoendence me të dënuar të tjerë e lidhjet e tyre jashtë reparteve të evidencuar ose jo si të tillë dhe që hedh sado pak dritë për aktivitet armiqësor ose dyshime në favor të armikut Leka Zogu ose të zbulimeve të huaja.

   Kryejne p.op.: Vehap Kuka, Ymer Keta në vazhdim.
4. – Do të kordinohet puna midis punëtorëve operativë të repartve të riedukimit me punëtorët operativë të zonave dhe konkretsht midis p.o.p.: Vehap Kuka dhe Rexhep Elezi, punëtorëve operativë të tjerë për të dhënat që kanë të bëjnë kryesisht për evidencimin, vlerësimin e lidhjeve të elementave antiparti dhe atyre politikë, si dhe vlerësimin e çdo të dhëne që do të dali në favor të veprimtarisë armiqësore që zhvillon armiku Leka Zogu. Kryejnë p.o.p. të repartve të riedukimit dhe të zonave.
5. – do të bëhet një analizë midis sektorit operativ të reparteve dhe komandës lidhur me zbatimin me korrektësi të kërkesës së rregulloreve për kontrollin e korrespondencës të të dënuarve me qëllim marrjen e masave më efikase për të shmangur jo vetëm parregullsitë, por rritjen sidomos të vigjilencës të personave që do të caktohen për kontrollin e saj.

   Kryejnë komandet e repartve 321 e 301/1 si dhe p.o.p. të këtyre repartve për kontrolin e saj.
6. – do të organizohet një bisedë me ushtarët e shërbimit si dhe policët e reparteve 321 dhe 301/1 me qëllim rritjen e vigjilencës së tyre, forcimin e shërbimit. Në të njëjtën kohë do të porositen edhe ata për të rritur shkallën e informacionit sidomos për rastet kur tentojnë nga ana e të dënuarve të afrohen, krijojnë shoqëri ose të provokojnë biseda për të zbuluar sekrete të punës sonë, ose të dinë për lidhjet e tyre brenda ose jashte reparteve. Kryen Kryetari i degës deri më 30.X.1982.

AIDSSH, Nr. 218 (2.2.1990), Dosja ORV, Kampi I burgut Bënçë, Fl. 55.

Tepelene 12.1.1990
Vendim
Për çeljen e dosjes të objektit të rendesisë së veçantë të Kampit e Burgut Bënçë

Unë punëtori Operativ Jani Paskali, efektiv i Deges së Punëve të Brendshme Tepelenë, i anës së sigurimit të shtetit, pasi studjova materialet që disponojmë për

kampin e burgut të Bencës:

GJETA

Në kampin e burgun Bënçë kohët e fundit kanë ardhur rreth 80 të burgosur që punojnë për të ndërtuar banesa në qytetin e Memaliajt. Nisur nga rëndësia politike e strategjike që ka ky kamp është synim i elementit armik të brendshëm e të jashtëm për të nxitur keta të burgosur të kryejnë veprimtari armiqësore e keqbërëse si dhe për të sjelle çrregullime në këtë kamp.

Duke parë rëndësinë e madhe që ka ky kamp e burg, nga ana jonë do të organizohet puna agjenturore-operative për zbulimin, parandalimin e goditjen e veprimatrisë armiqësore e keqbërëse që mundet të zhvillojë si element armik e keqberës që është i dënuar, ashtu si i brendshëm dhe i jashtëm.

Prandaj, nisur sa sipër dhe në mbështetje të Rregullores se Evidencës operative nr. 01.-27, datë 23.8.1986.

VENDOSA

Të çel dosjen e Objektit të Rëndësissë së Vecantë (ORV) për kampin dhe burgun e Bënçës dhe të organizoj punën agjenturore-operative si brenda me të burgosur dhe për mbrojtjen e kampit nga veprimtaria armiqësore e keqbërëse nga armiqtë e jashtëm dhe të brendshëm. Njëkohësisht të bëj evidencën e saj në sektorin e kartotekës.

Punëtori operativ

Jani Paskali

Zv/Kryetar I Degës P. Brendshme

Yzeir Hoxha.

KAPITULLI III

GJYQET DHE DËNIMET E KLERIT

Arkivi i MPB, Fondi 1, Viti 1947, D. 1513, Fl. 55

QEVERIA DEMOKRATIKE E SHQIPNISË
PROKURORIA PUBLIKE E PREFEKTURËS
V L O R Ë S
Nr. 129 R. Rreshtimeve

Letër-ndalim i PËRHERSHËM

PROKURORI PUBKLIK i PREFEKTURËS VLORËS tue qenë se VISARION XHUVANI, bir i JOANIT dhe i EFTHEMIJËS vjeç 57 nga Elbasani me mjeshtëri Fetar (Dhespot) me shënjat trupore të veçanta që pasojnë: _____

Pandehet për Armik Populli të kryer më _____ dhe të parashikuar prej nenit 3 të ligjës Nr. 372 G.Z.118/94.

U r d h ë r o n

Ndalimin e tij për një kohë të pa caktuem dhe mbylljen e tij në burgun e _____. Çdo fuqi e armatosun ngarkohet me eksekutimin e këtij urdhëni.

Vlorë më 20 të muajit Maj të vjetit 1947.

PROKURORI PUBLIK I PREFEKTURËS

p. (Beqir Isufi)

Arkivi i MPB, Fondi 1, Viti 1947, D. 1513, Fl. 54

REPUBLIKA POPULLORE E SHQIPËRISË
Prokurorija Publike e Prefekturës Vlorës
Seksioni i Sigurimit
Nr. i Aktit 93 R. Themeltar
Nr. 117 Prot.

URDHËNESË PARABURGIMI

Sot me 2 të muajit Qershor të vitit 1943 né Prokurori Publik i Prefekturës Vlorës i ngarkuar me hetime, pasi shqyrtuam çështjen që i përket të pandehunit VISARION XHUVANI, nga Elbasani, vjeç 57, me profesion Fetar (Dhespot) që akuzohet se ka

bashk-punuar me okupatorët gjerman e italian (Armik Populli).

Duke marrë parasysh se nga provat e deritanishme që janë _____ bëhet e besueshme akuza që rëndon mbi të pandehurin në fjalë, duke marrë parasysh se ekzistojnë kushtet e germës _____ të nenit 9 të urdhënesës Pr. Përgjithëshme Nr. 2 dt. 1-XI-946, duke marë parasysh se vepra parashikohet si faj prej nenit 3 të ligjës Nr. ___2 d.12.12.1946. dhe pas-sjell një dënim që kalon në maximum _____ në bazë të paragrafit ____ të nenit 10 po të asaj urdhënese

U R D H Ë N O J M Ë

Paraburgimin e të pandehurit VISARION XHUVANI, nga Elbasani, dhe shoqërimin e tij në burgun e _____

Kopja e kësaj urdhënese bashkë me letër-rreshtimin dorëzohet të pandehurit i cili ka të drejtë kundërshtimi brenda tri ditëve nga e nesërmja e njoftimit, pranë Prokurorit Publik më të lartë.

PROKURORI PUBLIK

p. (Beqir Isufi)

M'u dorëzua kopja e kësaj urdhënese me gjith letër-rreshtimin sot me datë 2 Qershor 1947 në Vlorë.

NJOFTUESI : I PANDEHURI :

Arkivi i MPB, Fondi 1, Viti 1947, D. 1513, Fl. 54.

REPUBLIKA POPULLORE E SHQIPËRIS
MINISTRIJA E P. MBRENDËSHME Sekret
DEGA E P.MBRENDËSHME RRETHIT
KOMANDA E REPARTIT 321
Nr. 757 Matë 27/XI/962

L Ë N D A : Mbi lirimin e një të burgosuri.

MINISTRIS PUNËVET MBRENDËSHME
DREJTORIS II-TË
DEGËS IV-TË

T I R A N Ë

Për dijeni.
DEGES PUNEVET MBRENDËSHME
SEKTO. PASHAPORTIZIMIT
D U R Ë S.

Sotë me datën 24/XI/962, u bë lirimi nga burgu i Burelit, Viserjon Xhuvani, i biri i Janit, dhe i Efemijes, i datëlindjes 1880, lindur në qytetin e Elbasanit, dhe banus në qytetin e Durësit në Hotel Adriatiku, beqar, me arsim të naltë, me profesjon priftë, me shtesi dhe kombësi shqipëtare, rjeth nga një shtres qytetare e mesme.

Arestuar me datë 18/5/47, nga gjykata ushtarake e Elbasanit, dënuar me 20 vjetë privim lirije, me vendim nr. 512 datë 22/12/47 për arsye se ka zhvilluar agjitacjon dhe propagandë kundër Pushtetit Popullor. Dënuar në bazë të nenit 77 të Kodit Penalë. Ka përfituar nga dekreti nr. 2548 datë 24.XI.57 ka përfituar 2 vjetë 4 muajë 13 ditë. Me dekretin 3006 datë 25/XI/59 ja fituar 1 vitë 3 tre muajë 10 ditë. Me dekret nr. 3602 datë 23.XI.62 i falet dënimi që i ka mbetur për t'u vuajtur.

Kaqë sa për dijeni.

NË MUNGES TË KRYE.ME ATU.TIJE____
ZV.KRYETARI I DEGËS P.MBRENDËSHME
K A P I T E N I I-RË
(-FAHRI KRAJA-)

Arkivi i MPB, Fondi 1, Viti 1947, D. 1513, Fl. 113-114.

REPUBLIKA POPULLORE E SHQIPËRISË V.F.L.P.
GJYKATA USHTARAKE E VLORËS
Nr. _____ Regj.Them.Penal.

P R O Ç E S - V E R B A L

Sot ditën e caktuar për Gjykim trupi Gjykues i formuar prej ZZ.

Kapiten'i II-të	Llazi Polena	Kryetar
N/Toger	Vasil Papa	Antar
Aspirant	Arshi Rakipi	Antar

Tue qenë prezent Ndih.Prokurori Ushtarak Toger Mustafa Beqo.

Me asistencën e Sekretarit Kapter Ziver Çamit.

U hap Gjyqi botnisht –

U suall i pandehuri nga burgu dhe tue mos qënë i penguar u vu në vendin e posaçëm dhe Gjyqi filloi faqsisht.

I PANDEHURI Visarion Xhuvani, i biri i Joanit dhe i Efdhimis, vjeç 67, i pa martuar, lindur në Elbasan dhe banues në Vlorë, mbaruar shkollën e Naltë të Theollogjis, me nënështetsi e Kombësi Shqiptare, fetar, gjatë okupacjonit Mitropolit i Beratit, Vlorës dhe Fierit, ka ndihmuar Lëvizjen, me gjëndje ekonomike të keqe, nuk është prekur nga Reformat e Pushtetit, i pa dënuar, s'ka të dënuar dhe as të aratisur, marë në paraburgim më 18 maj 1947 nga Sigurimi i Vlorës.

Ju këndua Akt-Akuza e Prokuroris Ushtarake dhe nuk e pranon.

U-pyet i pandehuri rreth akuzave që pandehej dhe tha se: Kur fashizmi italian okupoi Shqiprinë kam qënë në Tiranë. Ardhjen e tij si okupator nuk e kam pritur mirë. Është e vërtetë se unë së bashku me Fejzi Alizotin e shumë të tjerë nga Parija e vëndit kemi dalë dhe kemi pritur italianët. Mbas 15 ditëve t'okupimit të Shqipërisë kam protestuar kundra fashistave okupatorë me anën e fesë duke i demaskuar si okupatorë dhe jo si çliruesa. Është e vërtetë se unë me Shefqet Vërlacin etj klika të ish Qeveris Kuislinge kemi shpurë Kurorën e Skënder Beut në Romë tek Viktorio Manuele i II-të. Unë nuk kam qënë pro okupimit të Shqipërisë nga fashistat dhe as kam bashkëpunuar me 'ta, porse të gjuitha sa kam bërë i kam bërë nga frika dhe kërcënimet që më ka bërë Qeverija e Vërlacit e Kompanija. Është e vërtetë se fjalime në favorin e fashizmit kam mbajtur nji me rastin e ardhjes së tyre. Në këtë fjalim kam folur duke i mirseardhur, porse nga ana tjetër mbas 15 ditëve kam bërë të kundërtën duke propaganduar në popull kundra tyre duke i cilësuar si agresorë dhe okupuesa. Është e vërtetë se në Gazetën ish "Tomori" është shtypur fjalimi jem i mbajtur me rastin e ardhjes porse ndonji fjalim tjetër nuk është botuar pse nuk kam mbajtur. Është e vërtetë dhe e pranon që kam thënë Rroftë Musolini, porse dhe këtë jam munduar t'a përgënjeshtroja me anën e disa dëftesave që kanë dashur të ma vërtetojnë se e kishja thënë këtë fjalë. Nuk është e vërtetë që të kem propaganduar dhe punuar në mënyrë që të lidhja popullin me fashizmin. Nuk është e vërtetë se në Fier kam mbajtur një fjalim në favor të fashizmit, porse përkundrazi ky fjalim ka qënë pro Lëvizjes së Popullit Shqiptar. Është e vërtetë se kam bërë nji drekë në Fier ku mernin pesë mjaft autoritete të vëndit atjeshme, dhe këtu kam folur me rastin e kësaj dreke duke folur mbi Lëvizjen dhe rezultatet që do të na sillte kjo, ku për këtë jam thirur në Tiranë dhe më është hequr nji vrejtje. Unë jam internuar nga italianët në fushën e përqëndrimit në Tiranë në Rëzën e Malit Dajtit për 6 muaj, dhe mandej do të më dërgonin për në fushat e përqëndrimit t'Italisë si kundërshtar i italianëve dhe rogën që më jepnin ma prenë. Urime, letra dhe telegrame ju kam dërguar ç'do qeverije që hypte në fuqi tue i përgëzuar për pozitat e tyre.

Kur kanë ardhur gjermanët kam qënë i internuar në rëzën e Malit të Dajtit, dhe me ardhjen e këtyre kam punuar për Lëvizjen N.ÇL. me anën e propagandës. Nuk kam qënë antar' i Regjencës. Në Asamblen Kuislinge kam vajtur pse i imponuar nga Qeverija qi ishte në fuqi. Është e vërtetë se unë ka bërë konferenca pro Gjermanëve të cilat m'i ka imponuar Ministrija e Punëve të Brëndëshme. Për të gjitha konferencat që kam bërë e kam lajmëruar Ministrinë, si për konferencën e Nartës, Vlorës, Fierit dhe atë të Beratit për kundra L.N.ÇL. Është e vërtetë se unë kam qënë i lidhur me të gjitha Misat e Qeverive kuislinge, porse këtë m'a donte interesi i jem si fetar që ishja. Me Vizhdan Risilinë nuk kam pasur asnji lidhje, vetëm se me këtë jam takuar nji herë kur i kam vajtur në zyrën e tij. Vizhdani ka qënë Prefekt i Vlorës n'atë kohë, ky më është kërcënuar dhe kështu nuk i kam vajtur prapë në zyrë. Ju këndua letra që i pandehuri i kishte dërguar Vizhdan Risilisë dhe e pranoj. Unë është e vërtetë se kishja marë vesh se ishte vrarë nji prift jugosllav mbas ikjes së gjermanëve, dhe

për këtë kam kërkuar nga autoritetet e vëndit të Fierit për të shkuar në vëndin e ngjarjes. Tue qënë se ndihmat dhe mundësitë m'u dhanë shkova në vëndin e ngjarjes ku ishte vrarë prifti, dhe simbas hetimeve që bëmë, ky ishte vrarë nga disa kriminela. Nuk është e vërtetë se kam shtytur At Ilia Ponen për të kryer këtë vrasje, dhe as që kam qënë në dijeni se kishte nji prift në katundin Pojan. Me Xhaf Balën jam takuar nji herë ku të cilit i shkova në zyrën e tij, ky më ka ngarkuar me detyrë që të shkoja në Manastirin e Ardenicës dhe të shikoja në se kishte forca partizane, këtë detyra e bëra dhe shkova, porse nuk pashë asnji partizan dhe këtë ja kam raportuar Xhaf Balës. Luc Bozon e njof porse nuk e kam raportuar tek Xhaf Bala. Ju këndua Deklarata e At-Dhimitrit dhe nuk e pranon dhe se është mjadt tragjike tha i pandehuri. Me Majorin Cheiger gjerman jam njohur qysh para okupimit të Shqiprisë nga fashizmi në Elbasan, i cili ishte si mbledhës i fjalëve shqipe. Dijeni se ku qëndronte Cheiger nuk kam. Mbasi u-okupua Shqiprija nga nazistat jam takuar në Tiranë i cili më ka thënë se duhet të shkruash kundra Patrikut rus, të cilën vepër nuk e kam bërë. Me Jakomonin kam pasë takime të shpeshta dhe sidomos me rastin e festave, porse të holla prej tij nuk kam marë. Jakomonit i kam bërë shumë telegrame dhe letra përgëzime, pse këtë e kam pasur si zakon tem njerëzor porse jo me qëllim. L.N.Çlirimtare e kam ndihmuar me të holla a ç'do sendi tjetër. Politika jeme që kam bërë në kishat ka qënë: Unë të bashkoja orthodoksët në nji qishë të tyre, nuk kam lejuar kishën orthodokse të bashkëpunonte me kisha të tjera anarshiste, t'u futja gjuhën shqipe aty ku nuk dinin dhe i kam këshilluar të bashkoheshin me myslimat dhe të shikonin e të mbronin Kombin Shqiptar, ndalimin e kishës t'onë për të punuar me atë të Romës. Është e vërtetë se telegrame i kam dërguar Lufti Shehut dhe shumë elementave të tillë porse ma donte interesi. Ju këndua letra e tij drejtuar Lufti Shehut i cili e përgëzonte për punën e tij dhe marjen e pozitës dhe pranon. Është e vërtetë se Lufti Shehu në popullin e Beratit ka bërë shumë krime dhe masakra, porse kjo letër që i kam dërguar ishte me qëllim që t'a zbusija këtë bishë dhe që të mundja të liroja disa të burgosur që ishin arrestuar. Ju lexua telegrami drejtuar Mustafa Krujës dhe e pranojti, dhe tha se të këqija janë veprat e mija që kam bërë, porse i kam bërë me qëllim që të mos shpëtoja disa elementa të Lëvizjes që ishin burgosur. Ju lexua telegrami drejtuar Sekretarit të partis fashiste ku i thoshte se jemi gadi neve dhe i gjithë populli shqiptar për t'ju ndihmuar dhe e pranon. Është e vërtetë që kur shkova si Mitropol i Beratit, Vlorës dhe Fierit kam pritur për nder Armë nga Ushtrija fashiste italiane.

Në sipërfaqe kam shumë faj, porse në esencë jo. Mbas çlirimit të Shqipris nuk kam bërë asnjë, porse kam zhvilluar punën time fetare. Mësimet që ju kam dhënë Kishave ishin po ato që përmënda më lartë. Me Misionet Engleze jam takuar dy herë si me Major Smithin, të cilit i kam raportuar sasin e popullit Orthodoks, të Kishave dhe të Klerikëve, dhe se tjetër herë nuk jam takuar me asnji. Nji herë tjetër kam shkuar në Misionin Englez në Tiranë, por mbasi nuk i gjeta aty ju lashë nji letër dhe ika. Është e vërtetë se në Hotel Dajti jam takuar me disa Englezë porse nuk i njifja dhe as që më kanë dhënë pare, dhe t'u kem dhënë unë ndonji informatë.

Veprimtarija jeme është tradhëti, dhe më mirë ishte të mos ishja mbi dhè. Shkollën Fetare që hapa në Vlorë e kam hapur me inisjativën teme. Riza Danin dhe Shefqet Bejën nuk i kam njohur fare.

Me proçes-verbalet jam pjesërisht dakord.

Për të bërë pretencën e tij të fundit Prokurori Ushtarakë, seanca shtyhet për më datën 24.12.1947.

Vlorë, më 23.12.1947

Sekretari Antar Antar Kryetari

Arkivi i MPB, Fondi 1, Viti 1947, D. 1513, Fl. 111-112.

Sot ditën e caktuar për Gjykim trupi gjykues i formuar prej ZZ.

Kapiten' i II-të	Llazi Polena	Kryetar
N/Toger	Xhevit Memushi	Antar
Aspirant	Loni Gusho	Antar

Tue qënë prezent Ndih. Prokurori Ushtarak Toger Mustafa Beqo.

Me asistencën e Sekretarit Kapter Ziver Çamit.

U hap Gjyqi botnisht.

U suall i pandehuri nga burgu dhe tue mos qënë i penguar u-vu në vëndin e posaçëm dhe Gjyqi filloi faqsisht.

Mbi këtë Ndih. Prokurori Ushtarak u-ngrit dhe bëri pretencën e tij të fundit të cilën mbasi e lexoi vetë para Gjyqit u muar dhe u-bashkue me aktet e tjera të dosjerit relativ.

U pyet i pandehuri për të fundit herë dhe tha se kërkon mëshirë.

Tue qënë se hetimet e çështjes shifen të plotsuara dhe nuk mbetet gjë tjetër për t'u bërë, Gjyqit i jepet fund dhe botnisht u-dha ky,

V E N D I M

Në çështjen penale të regjistruar nën Nr. _____ të radhorit Themeltar të vjetit 1947,

K u n d r a

Të pandehurit Visarion Xhuvanit, i biri Joanit, dhe i Efdhimisë, vjeç 67, i pa martuar, lindur në Elbasan dhe banues në Vlorë, ka mbaruar shkollën fetare, gjatë okupacjonit Mitropol i Beratit, Vlorës dhe Fierit, ka marë pjes me Lëvizjen, me gjëndje ekonomike të keqe, nuk është prekur nga Reformat e Pushtetit, i pa dënuar, s'ka të dënuar dhe as t'aratisur, marë në PARABURGIM më 18 Maj 1947 nga Seksioni Sigurimit Vlorës, sjellur për Gjykim para kësaj Gjykate me Akt-Akuzën e Prokuroris Ushtarake Nr.____ datë 22.12.47, i cili akuzohet sepse me okupimin e Shqiprisë nga fashizmi italian ka dalë dhe i ka pritur ushtrit fashiste. Ka shpurë në Roma Kunorën e Skënderbeut Viktor-Emanuelit III-të. Ka mbajtur fjalime dhe mitingje të ndryshme

në popull dhe ka shkruar herë mbas here artikuj në ish gazetën "Tomori" duke paraqitur Musolinin dhe fashizmin si shpëtimtar të Shqiprisë. Ka mbajtur lidhje të ngushtë me Jakomonin, Mustafa Krujën etj, dhe ka mbajtur lidhje me anën e letrave telegrameve etj. Ka raportuar nëpër organet e fashizmit italian si në Kuesturë, Karabinjeri dhe kanë arestuar elementat _____. Mbas kapitullimit të fashizmit dhe me okupimin e Shqiprisë nga gjermanët është zgjedhur antar' i Regjencës Kuislinge të Mehdi Beut. Ka qënë i lidhur ngushtë me Regjencat dhe qeveritë tradhëtare të Ballit etj. Ka zbatuar të gjitha udhëzimet të mara nga Ministrit e sipërme. Ka mbajtur fjalime në popullin e Nartës, Vlorës, Beratit dhe Fierit për kundra L.N.çlirimtare, duke i paraqitur si anarshistë dhe shkaktarë të vëlla vrasjes. Nën maskën e fesë ka propaganduar në Manastire, Kisha dhe popull që të mos lëftohej okupatori, dhe t'u bindeshin ligjeve të Jezu Krishtit. Ka raportuar Ministrit dhe Qeveri Kuislinge për të gjithë punën e bërë kundra L.N.ÇL. me anën e propagandës dhe të fjalimeve. Ka pasë lidhje të ngushtë me xhelatët e popullit Vizhdan Risilinë, Lufti Shehun etj. Mbas çlirimit të Shqiprisë propagandon për kundra Pushtetit Popullor bashkëpunon me elementa të prekur dhe të pa kënaqur si Shefqet Bejën, Riza Danin, Spiro Stringën, Zef Leshovin etj. Së bashku me Kristofor Kisin kanë shkuar tek Gjenerali Hodgson dhe Smith të cilëve ju kanë kanë raportuar sasinë e orthodoksëve, katolikëve, myslimanëve dhe klerikëve që ndodheshin brënda teritorit shqiptar dhe qëndrimin e klerit. Ka dhënë intervistë gazetarëve englezë në Hotel Dajti. Ka mbajtur lidhje të vazhdushme me Misionarët Englezë dhe Amerikanë në Shqipri. Ka vepruar koshient për interesat e fashizmit, nazismit, Ballit Kombëtar dhe t'imperialistave Anglo-Amerikanë. Ka pasë si qëllim kryesor rëzimin e Pushtetit Popullor dhe sjelljen e nji regjimi shtypës e skllavëronjës në fuqi.

Faj i tij parashikohet prej Neneve 2 e 2 (pika 1, 2, 3, 4, 5, 6, 8, 10 të Ligjës 372 datë 12.12.1946 mbi fajet penale kundra Popullit dhe Shtetit, dhe ndëshkohet prej nenit 2 të Ligjës sipërme.

Në përfundim të proçedimit zhvilluar faqe të pandehurit:

Ndih. Prokurori Ushtarak në bazë të dispozitave ligjore të më sipërme ka kërkuar të dejklarohet fajtor' i pandehuri dhe të dënohet me privim-lirije për JETË dhe bjerjen e të drejtave politike për 5 vjet kohë.

I pandehuri ka kërkuar mëshirë nga trupi gjykues.

Gjykata mbassi shqyrtoi aktet dhe bisedoi çështjen,

K O N S T A T O N – S E

I pandehuri VISARION XHUVANI, element i ritur dhe i brumosur me kulturë e ndjenja fashiste. Ky me ardhjen e fashizmit italian në vëndin t'onë, tue qënë një i tillë, lidhet ngushtë me 'ta dhe ka ushtruar nji propagandë e agjitacjon pro fashizmit duke mbajtur konferenca të ndryshme si në Berat, Vlorë, Fier, Nartë e gjetkë për kundra luftës nacional-çlirimtare që bënte populli shqiptar, fjalime të cilat janë botuar dhe në ish gazetën "Tomori". Së bashku me kriministrin Shefqet Vërlacin e klikën e tij ka shkuar n'Itali ku i kanë shpënë Kurorën e Skërnder-Beut Vitorio-

Emanuelit II-të. Ka qënë i lidhur ngushtë dhe ka pasë relacjone të shpeshta me ish Qeveritë Kuislinge si atë të Mustafa Krujës etj, dhe me Partinë fashiste, të cilëve ju ka dërguar telegrame dhe letra urimi mbi punën që bënin kundra popullit shqiptar. Ka bashkëpunuar me ish kriminelat e popullit si Prefektin e Vlorës Vizhdan Risilinë, Kuestorin e Beratit Lufti Shehun, të cilët i ka ndihmuar dhe falënderuar me anën e letyrave dhe telegrameve për terorin që ushtronin në kuriz të popullit shqiptar. Ka qënë në dijeni të plotë mbi vrasjen e priftit jugosllav që ish i internuar nga fashizmi në Manastirin e katundit Pojanit. Ka qënë antar' i Asamblesë Kuislinge të Shefqet Vërlacit dhe më vonë ka marë pjesë në Regjencë.

Nuk mjafton me kaq, i pandehuri dhe mbas çlirimit të Shqiprisë punon kundra parimeve të popullit duke u-lidhur me spiunazhin Anglo-Amerikan Inteligjent Servicin si me Gjeneralin Hodgson, Majorin Smith etj, të cilëve u ka dhënë informata mbi sasinë e orthodoksëve, katolikëve, klerit dhe qëndrimin e tij në vëndin t'onë.

Faktet e fajtoris tij u provuan plotsisht nga deponimet e tij të bëra si para organeve proçeduese ashtu dhe para kësaj Gjykate direkte dhe indirekte, dhe nga nji sasi dokumentash që ndodhen midis akteve të dosjetit relativ.

Faj i tij në këtë mënyrë parashikohet prej Nenit 2 e 3 (pika 1, 2, 3, 4, 4, 6, 8 e 10) të Ligjës 372 datë 12.12.1946 mbi fajet penale kundra popullit dhe shtetit, dhe ndëshkohet prej Nenit 4 të Ligjës sipërme.

Për këto arsyena:

Gjykata bashkarisht duke parë dhe Nenin 4 të Ligjës 372 datë 12.12.1946 mbi fajet penale kundra popullit dhe shtetit, deklaron fajtor të pandehurin VISARION XHUVANIN për fajet e nalt-treguara dhe në bazë të dispozitave penale të më sipërme e dënon me 20 (NJIZET) vjet privim-lirije, punë të detyrushme dhe bjerjen e të drejtave politike për 5 vjet kohë.

Ky vendim epet me të drejtë kundërshtimi në Gjykatën e Lartë Ushtarake, brënda 8 ditëve nga data e sotme.

Shpenzimet gjyqsore prej 54 lekësh i ngarkohen të dënuarit.

U shpall më 23.12.1947-

Sekretari Antar Antar Kryetar

Arkivi i MPB, Fondi 1, Viti 1947, D. 1513, Fl. 113.

Republika Popullore e Shqipnis
Vdekje Fashizmit
Gjykata Ushtarake e Vlorës — Liri Popullit
Nr. 872 Regj.Themeltar — Nr. 512 i Vendimit

A k t - G j y k i m

N'emën të Popullit Shqiptarë

Gjykata Ushtarake e Vlorës u formue prej:

Kapiten II-të	Llazi	Polena	Kryetar
Toger	Qani	Leka	Antar
Aspirant	Arshi	Rakipi	Antar

I asistuar nga sekretari Shyqyri Cane tue qenë gati dhe prokurori ushtarak Mustafa Beqo

Sot me datë 23.12.1947 u mbëloth për të gjykuar të pandehurit Visarjon Xhuvani dhe dha këtë vendim:

V e n d i m

Në çështjen penale u regjistrua me Nr _____ të Regj. Themelt. kundra të pandehurit Visarjon Xhuvanit i biri i Joanit dhe i Efdhinis, vjeç___, i pa martuar, lindur në Elbasan dhe banues në Vlorë, ka mbaruar shkollën e Naltë të Theollogjis me nënshtetsi dhe kombësi shqiptare, me profesjon fetar, _____ Lëvizjen me gjendje ekonomike të keqe, nuk ësht prekur nga Reformat e Pushtetit, i pa dënuar, s'ka të dënuar dhe as të arratisur, marrë në paraburgim me 12.5.____ akuzën e prokuroris ushtarake Nr. _____ datë 22.12.1947 i cili akuzohet se me okupimin e Shqipëris nga Fashizmi Italjan ka dalë dhe i ka pritur ushtritë fashiste ka shkuar në Romë kunorën e Skënderbeut, votoj (shuhet nji _____ Viktorit Emanuelit II-të, ka mbajtur fjalimin dhe metingje të ndryshme në popull dhe ka shkruar herë mbas here artikuj në ish gazetën Tomorri duke patur si qëllim që të paraqiti Musollinin dhe Fashizmin si shpëtimtarë të Shqipërisë. Ka mbajtur lidhje të ngushta me Jakomonin, Mustafa Krujën e të tjerë, ka mbajtur lidhje me anën e letrave, telegrameve e të tjera. Ka rraportuar ndër organe të L.N.Çl. Mbas kapitullimit të fashizmit dhe me okupimin e Shqipëris nga ushtria e Gjermanëve ësht zgjedhur antar' i Regjencës Kuislinge të Mehdi Beut. Ka bashkëpunuar ngushtësisht me Majorin Vaffcshigef gjerman prej të cilit ka marrë udhëzime dhe direktiva. Ka qenë i lidhur ngushtë me Regjenca dhe Qeverit trathtare të Ballit e të tera. Ka zbatuar të gjitha udhëzimet e marruna nga Ministrit e sipërme. Ka mbajtur fjalime në popullin e Nartës, Vlorës, Beratit dhe Fierit për kundra luftës N.Çl. duke paraqitur si anarshist dhe shkaktar të vëllavrasjes. Nën maskën e fesë ka propaganduar në Manastir, kisha dhe popull që të mos luftohej okupatori dhe t'u bindeshin ligjeve të Jezu Krishtit. Ka raportuar Ministrit dhe qeverin kuislinge për të gjithë punën e bërë kundra L.N.Çl. me anën e propagandës dhe të fjalimeve, ka pas lidhje të ngushtë me xhelatët e popullit Vishdan Risilin, Lutfi Shehun e të tjerë. Mbas shlirimit të Shqipnis propagandon për kundra Pushtetit Popullor, bashkpunon me elementë të prekur dhe të pakënqur si Shefqet Bejën, Riza Danin, Spiro Stringën, Zef Leshovin e të tjerë. Së bashku me Kristofor Kisin kanë shkuar tek Xhenerali Hodgson dhe Smith, të cilëve u kanë rraportue sasin e orthodoksëve, katolikve, muslimanve dhe klerikëve që ndodheshin mbrenda territorrit shqiptar dhe qëndrimin e klerit, ka dhënë intervistë gazetarve englezë në Hotel Dajti. Ka mbajtur lidhje te vazhdueshme me Misjonaret Englez dhe Amerikan ne Shqiperi, ka vepruar me koshience per interesat e Fashizmit, Nazizmit dhe ballit Kombetar e

te imperialistave Amerikan, ka pase si qellimi kryesor rrezimin e Pushtetit Popullor dhe sjelljen e nji regjimi shtypes dhe sklaveronjes ne Shqiperi.

Faji i tij parashikohet preh neneve 2 e 3 (Pika 1; 2,3; 4; 5, 6, 7, 8 e 10 te ligjes me Nr. 37, dt. 12.12.1946 mbi fajet penale dhe ndeshkonjes prej nenit 4 te Ligjes siperme. Ne perfundim te zhvillimit gjyqsore te zhvilluar ndaj te pandehurit. Ndihmes Prokurori Ushtarak ne baze te dispozitave ligjore te siperme ka kerkuar te dekllarohet fajtore i pandehuri dhe te denohet me privim lirije perjete, prerjen e te drejtave Politike dhe Civile per 5 vjet kohe. I pandehuri ka kerkuar meshire nga Trupi Gjykues.

Gjykata mbasi shqyrtoi aktet dhe bisedoj çeshtjen, konstaton se: I pandehuri Visarjon Xhuvani element i rritur dhe i brymosur me kulture dhe ndjenja fashiste. Ky me hyrjen e Fashizmit italjan ne vendin tone tue qene nji i tille lidhet ngushte me ta dhe ka ushtruar nje propagdande e axhitacjon ne favor te Fashizmit dyke mbajtur konferenca te ndryshme si ne Berat, Vlore Fier, Narte dhe gjetke per kundra L.N.Çl. qe bente Populli Shqiptar, fjalime te cilat jane botuar edhe ne ish gazeten Tomorri. Se bashku me kryeministrin Shefqet Verlaci e kliken e tij ka shkue ne Itali dhe i kane shpene kunoret e Skenderbeut Viktor Emanuelit II-te. Ka qene i lidhur ngushte dhe ka pasur rrelacjone te shpeshta me ish Qeverit Kuislinge si ate te Mustafa Krujes e te tjera, dhe me Partin Fashiste te cilve u ka derguar telegrame dhe letra urimi mbi punen qe benin kundra Popullit Shqiptar. Ka bashkepunuar me ish kriminelat e Popullit si prefektin e Vlores Vizhdan Risilin, Kuestorin e Beratit Lufti Shehun, te cilet i ka ndihmuar dhe falenderuar me anen e letrave dhe telegrameve per terrorin qe ushtronin ne kurriz te Popullit Shqiptare, ka qene ne dijeni te plote mbi vrasjen e priftit Jugosllav qe ish internuar nga Fashizmi ne Manastirin e Pojanit. Ka qene antar i asambles kuislinge te Shefqet Verlacit dhe vone ka marre pjese ne regjence. Nuk mjafton me kaq, i pandehuri dhe mbas shlirimit te Shqipnis punon kundra parimeve te Popullit dyke u lidhur me spiunazhin Anglo-Amerikan, Inteligjen sericin si me xheneralin Hodgos, majorin Smith e te tjere, te cileve u ka dhene informata mbi sasin e orthodhkose, katolikve, Klerit dhe qendrimin e tij ne vendin tone.

Faktet e fajtoris tij u provuan plotsisht nga deponimet e tij të bëra si para organeve proçeduese ashtu dhe para kesaj Gjykate direkte dhe indirekte, dhe nga nji sasi dokumentash që ndodhen midis akteve të dosjetit relativ.

Faj i tij në kete menyrë parashikohet prej Nenit 2 e 3 (pika 1, 2, 3, 4, 4, 6, 8 e 10) të Ligjës 372 date 12.12.1946 mbi fajet penale kundra popullit dhe shtetit, dhe ndeshkohet prej Nenit 4 të Ligjes siperme.

Per keto arsyena:

Gjykata bashkarisht duke pare dhe Nenin 4 te Ligjes 372 date 12.12.1946 mbi fajet penale kundra popullit dhe shtetit, deklaron fajtor te pandehurin VISARION XHUVANIN per fajet e nalt-treguara dhe ne baze te dispozitave penale te me siperme e denon me 20 (NJIZET) vjet privim-lirije, pune te detyrushme dhe bjerjen e te drejtave politike për 5 vjet kohe.

Ky vendim epet me te drejte kundershtimi në Gjykaten e Larte Ushtarake, brenda 8 diteve nga data e dekllarimit.

Shpenzimet gjykore lek 54.
Vlore, me 23.12.1947

Sekretari	Antari	Antari	Kryetari
Shyqyri Cene	Arshi Rakipi	Qani Leka	Llazar Polena

Kryetar' i Gjykates Ushtarake
Kapiten I (Myftar Grabocka)

Arkivi i MPB, Fondi 140, Viti 1947, D. 4180, Fl. 4.

P R E T E N C Ë

Sh. Gjyqtarë! I pandehuri Irine Banushi i bir' i Nikollës dhe i Nedos, vjeç 41, lindun në Shkodër dhe banues në Tiranë me profesjon fetar. Për t'ju shmangur akuzës së parë se ka bashkëpunue politikisht me okupatorin në lidhje me Papalilon dhe të tjerë për kondra lëvizjes N.Ç. ai filloj të tregojë nji seri të gjatë takimesh që ka patur me tradhtarin Papalilon, me Regjentin Mehdi Frashëri, me fashistin Xheneral Pariani dhe të tjerë e të tjerë me qëllim për të shpëtue persona të lëvizjes N.Ç. dhe përfundimisht e nxori veten e tija nji anti-fashist të pastërt; por a ka mundësi q'i pandehuri Irine të mashtrojë krenët e fashizmit me pretekste të ndryshme edhe me anë të kësaj rruge të ndihmojë lëvizjen N.Ç. Personat e lëvizjes N.Ç. ishin lark kompromizit qendrojshin lark tradhtarve. Rruga e Irine Banushit dhe takimet e tija me persona të tillë ka qenë ajo e informatorit në favor të fashizmit gja që provohet me deklaratën e Dhimitër Andonit. Kur u pyet i pandehuni se cila ishte arsyeja që ngriti shëndetin e Pandeli Kotokos në shtëpin e nji mikut të tija të quejtun Taqo nga Korça, ai me plot pa-turpësi e mohoj se nuk ishte Pandeli Kotokua ai q'i ngrinte shëndetin po nji tjetër Pandeli miku i jem. Por kjo nuk munt të ngjajë pse s'ka asnji arye që i pandehuni të ngrejë shëndetin për nji mikun e tija të quejtun Pandeli i cili nuk njihet as prej Taqos as prej personave të familjes së tija. Me anmikun e popullit Gjergj Kokoshin i pandehuni ka marrëdhënje familjare me Don Shtjefën Kurtin i pandehuni njifet prej nipit të tija të cilin e ka nxënës në Lice. Që të shpëtosh prej Gjyqeve të popullit ësht vetëm nji rrugë: sinqeriteti; dredhija, mohimi dhe manevrat e ndryshme jo vetëm që nuk të ndihmojnë por rëndojnë fajin. Me inisiativën e tij organizon vajtjen klerikëve orthodoksë, myslimanë dhe katolikë në Kuvendin Popullor për të kërkuar faljen e kriminelëve të luftës, të dënuarë nga gjyqi Special. Në predikimet e tija fetare në kishë ay përdor gjuhën dhelparake dhe gjylpanën e gjalpërit, kështu vepron i pandehuni në Kishën e Shën-Prokopit dhe në Kishën e Durrësit, ai në nji mënyrë rë rrafinuar ka folur për kontradiktat midis Shtetit dhe fesë duke thënë se ndamja e fesë prej Shtetit ësht nji fatkeqësi se nuk ka asnji vend ku të jepet edukata fetare dhe kjo njikohësisht ësht dhe pa-drejtësi dhe duke

u kthyerë me fytyrë nga Perëndija ësht shprehur duke thënë se vetëm tek ti asht udha e drejtë dhe e vërtetë; këto fjalë për masat e popullit nuk janë thjeshtësisht fetare por janë nji helm i vërtetë. Kohën e mbrapshtë bujqësore ai e quen t'ardhun për të vetmen arsye se populli nën Pushtetin Popullor i ësht largue rrugës fetare dhe ka shkuarë në rrugën e vëlla-vrasjes dhe kurvërisë, prandej, populli vuen për bukën e gojës. Këto janë predikimet fetare që ban i pandehuni, që ban në kishë gja që provohet plotsisht me deklaratën e Antonit. Për të ngritur nalt emnin e tradhtarit dhe fashistit Pandeli Kotokos ai trillon gënjeshtra përpara babajt të Telemak Dilos të cilit i thotë se Ministër Konomi më tha që të shkoj në Gjinokastër dhe të mbanj nji fjalim kundër Kotokos, por unë e refuzova masi Kotokon e kam vëlla prej Krishtit.

Fajsija e të pandehunit provohet plotsisht me dy deklaratat q'i bashkangjiten dosjes të Telemak Vasil Dilos dhe Dhimitër Veniamin Antonit, mbasi fajsija e tij e provueme parashifet prej Nen. 7 e 8 të Ligj. Nr. 372 në bazë të këtyne nenevet kërkoj që të vendoset dënimi i të pandehunit me 3 vjet privim lirije, punë të detyruarë dhe humbjen e të drejtave politike e qytetare për aqë kohë.

V.F.L.P. PROKURORI USHTARAK' I GARNIZONIT
Kapiten (Petrit Hakani)

Arkivi i MPB, Fondi 140, Viti 1947, D. 4180, Fl. 4.

REPUBLIKA POPULLORE E SHQIPËRISË
PROKURORIJA USHTARAKE E GARNIZONIT TIRANËS V. F. L. P.
Nr. 211 Regj.Them.

K Ë R K E S Ë

Sikurse do të konstatohet dhe nga proçes-verbali i mbajtun nga Seksioni i Sigurimit të Shtetit Tiranës, që bashkangjitun paraqiten, i pandehuni Irinen Banushi, i bir' i Nikollës, dhe i Nedos, vjeç 41, lindun në Shkodër e banues në Tiranë, me profesion fetar, i arestuarë me 28-X-946, akuzohet se:

1) Në kohë t'okupacionit ka bashkëpunuarë politikisht me okupatorët në lidhje me Papalilon kondra Lëvizjes N.Ç.

2) Nën maskën e fesë e mënyra të tjera ka propagandue e axhitue kondra Pushtetit Popullor duke dash me rivoltue masat për rrëzimin e tij me dhunë. Ka përkrahur vijën e pa drejtë të Neo-fashizmit Grek.

3) Ka qenë në lidhje me armiqt e popullit Gjergj Kokoshin, Dom Shtjefën Kurtin e tje. e në dijeni të veprimtarive t'organizatave fashio-terroriste të Sami Qeribashit e comp.

Mbasi faji i tij parashikohet e ndëshkueshme prej Nen. 7. 8 e 3 par. 6 të Ligj. 372, asht pa e nevojshme të gjykohet.

P r a n d a j ;

Kërkoj gjykimin e tij nga ana e asaj Gjykate dhe mbasi t'i faktohet faji për të cilin akuzohet në përfundim të vendoset ndëshkimi i tij në bazë të nen. sipër-thanun.

Tiranë, me 13 Prill 1947

PROKURORI USHTARAK I' GARNIZONIT TIRANËS

KAPITEN II të (PETRIT HAKANI)

Arkivi i MPB, Fondi 140, Viti 1947, D. 4180, Fl. 5-6.

REPUBLIKA POPULLORE E SHQIPËRISË

GJYKATA USHTARAKE E GARNIZONIT

T I R A N Ë

Nr. ____

P r o c e s V e r b a l

Prokuroria Ushtarake e Garnizonit Tiranës, me akt akuzën Nr. _____ datë 13.4.947 i solli kësajë Gjykate, aktet prosesuale për kondra të pandehurit të rreshtuar Irene Nikolla Banushit nga Shkodra banues në Tiranë Episkop, i akuzuar për shkak se në kohën e okupasionit ka bashkëpunuar politikisht me okupatorët në lidhje me Papalilon kondra Lëvizjes Nacional Çlirimtare. Nën maskën e fesë dhe me mënyra të tjera ka propaganduar e axhitue kondra Pushtetit Populllor duke dashur me rivoltue masat për rrëzimin e tijë me dhunë. Ka përkrahur vijën e pa drejtë të Neo-Fashizmit Grek. Ka qenë në lidhje me armiqt e Populllit Gjergji Kokoshin, Dom Shtjefën Kurti e tj. e në dijeni të veprimevet t'organizatavet fashio-terroriste të Sami Qeribashit e comp. Prandaj kërkonë gjykimin e të pandehurit para kësajë Gjykate, dhe mbasi t'i faktohen fajet që akuzohet të vendoset ndëshkimi i tijë në bazë të nenevet 7-8 e paragraf. 5 të Ligjës Nr. 372.

Aktet si u regjistruan në Nr. ____ të Radh. Themeltar dita e gjyqit u caktua për me datën 15.4.947 ora 8 para dite.

Sekretari. K r y e t a r i

Ditën dhe orën e caktuar për gjykim Trupi Gjykues u formua në mënyrë që shënohet ma poshtë:

KRYETAR MAJOR GJON BANUSHI

ANTAR N/TOGER RUSHIT KANANAJ

ANTAR ASPIRANT VASIL KARAJANI

Duke qenë gati dhe Prokurori Ushtarak Kapiten Petrit Hakani të asistuar nga Sekretari Ilia Xheka u mblodhën në sallën e gjykimevet.

U suall i pandehuri nga burgu rregullisht, i cili si zuri vendin e posaçmë fillojë gjyqi botënisht.

U pyetë cilësia e të pandehurit dhe tha se quhet: Irene Banushi i biri Nikollës dhe i Nedos, lindur në Shkodër, banues në Tiranë, është 41 vjeçë, i pa martuar, i pa dënuar ndonjëherë, me profesion fetar (Episkop), me mësim të naltë. Nuk ka ndonjë prej fare fisit të aratisur ose të dënuar.

U pyetë i pandehuri në se ka ndonjë përfaqësues mbrojtës dhe u përgjegjë se nuk ka emnue.

Trupi Gjykues në konformitet me kërkimin e Prokurorit, i emnon të pandehurit asistues mbrojtës advukat z.

Kështu u thirë dhe erdhi asistuesi mbrojtës i të pandehurit i cili zuri vendin e posaçmë.

U këndua akt akuza e Prokurorisë që përmbajtia e sajë është shënuar në parathanie të këtij procesi.

U kënduan dhe gjithë aktet e tjera që ndodhen midis dosjes.

Thënjet e të pandehurit: U pyetë i pandehuri mbi fajin për të cilin akuzohet dhe dekllarojë: Nuk jam marë as një herë me politikë porse gjithëmonë kam shikuar detyrën t'ime fetare.

Në muajin Shtator të vjetit 946 është e vërtet se unë kam qenë për drekë me rastin e një pagëzimi në shtëpinë e zonjës të quajtur Eleni që i shoqi i quhet Thoma, ka një djal që quhet Liliko dhe një vajzë të martuar tek i quajturi Taqi nga Korça, dhe duke ndryshuar i pandehuri tha se, gabimisht thashë se kam qen tek Eleni por tek i përmenduri Taqi që është dhëndri i Elenës, dhe aty ishin e vjehra e tijë Eleni, i vjehri Thomai, një i quajturi Gaqo dhe të tjerë që nuk i mbajë mendë dhe aty në pirje e sipër kam ngritur një shëndetin e të quajturit Pandeli Martenianit të cilin e kisha mik të ngushtë, dhe arsyeja që unë ngrita shëndetin e këtij ka qenë se n'atë kohë e kisha ndër ment, dhe nuk është e vërtet që të kem ngritur shëndetin e Kotokos. Unë Pandeli Martenianin e simpathizoja shum mbasi ky më kishte bërë shum favore personale e mbasi ky ishte ngarkuar prej Ministrisë Drejtësis mbi shqyrtimin e rrogavet që kishim për të marë neve dhe mua më baheshin të holla për të marë, në atë kohë zonja Eleni më pyeti se cili është ky Pandeli dhe unë ju përgjegja cili ishte mbasi ajo kuptojë për Kotokon dhe i thashë se nuk është ky. Unë Kotokon e kam njojtur këtu në Tiranë në mbledhjen e Sinodhit kur ishte Episkopi i Gjinokastrës.

Gjergji Kokoshin e njoh dhe kemi mardhënje familiare, mbasi vllai im i madhi ka marë për grua një vajzën e dajës së Gjergjit, pos kësajë familja jonë njifet me familjen e Gjergjë Kokoshit prej 30 vjet më parë me anën e babait tem. Po ashtu edhe Mentor Çobon e kam pasur njojtur në Beograd kur ishim nxënës stundent dhe si të huaj që ishim në një vendë tjetër shifeshim njani me tjetërin shpeshë herë, posë kësajë ky kishte shkruar në një gazetë Tomori në vjetin 942-943 për mua mirtë pse unë për këtë kisha folur mirë si stundent që qëndronte në Beograd. Me Irfan Ohrin më ka njohur Mentori tue ma prezantue si dajën e tijë dhe kjo ka qenë në rrugë para Bashkisë në bulevardë dhe nuk e di se ky ç'farë detyre kishte.

Tek Xheneral Pariane kam vajtur një herë me Kryepeskopin dhe antar të

Këshillave Kishëtare për të protestuar kundra një libri që ishte nxjerë prej italianvet ku neve orthodhoksit na quanin të gjithve grek.

Dom Shtjefën Kurtin e njoha e anën e nipit të tijë që ishte nxënës në liset, ku një ditë ky në rrugë më ka prezantue Domin se ishte xhaxhaj i tijë, dhe në këtë rast më pa pyetur Domi se si vinte i nipi në mësime, dhe qysh n'atë kohë jemi njojtur, tek ky kam ngrënë dhe darkë me rastin e vdekjes së Mon Sinjor Thaçit për rënkim ky më mbajti edhe për darkë, këtu kemi biseduar reth çështjevet fetare dhe ju kur politike, po ashtu dhe shum priftërinjt katholik i kam njohur për arsye se na ka takuar rasti në çështje feje.

Është e vërtet se unë kam mbajtur një fjalim në kishë ku ka predikuar mbi fenë, dhe në këtë rast kam përmendur se edhe në revolucionin Frances mësimet fetare u hoqën nga shkollat por më vonë prap u vunë dhe me këtë fjalim nuk kam pasur për qëllim të atakoja Pushtetin. Po ashtu është e vërtet se unë kam mbajtur një fjalim në Kishë tue thënë që të largohen këto re të zeza, dhe këtu e kisha fjalën për Greqin që kërkonte të na coptonte.

Kur janë dënuar nga Gjyqi Special kriminelat e luftës, disa familje prej tyre na kanë ardhur në Krye Episkatën t'onë dhe na janë lutur që të venim dhe të kërkonim një falje ndëshkimi për ta pranë Qeverisë, dhe kështu si Kryepiskopi t'onë, unë, Krye

Miftiu ashtu dhe Kryepeskopi Katholik kemi shkuar në Kuvendin Popullor për të bërë një lutje për faljen e ndëshkimit të dënuarve.

Ju këndua të pandehurit dekllarata e Dhimitër Antonit, dhe si u pyetë tha: Nuk janë as pakë të vërteta për sa dekllaron ay dhe nuk di pse më akuzon në këtë mënyrë.

Ju këndua dhe dekllarata e dhënë prej Telemak Dilos, i pandehuri tha se edhe këto dekllarata të këtijë nuk janë të vërteta, dhe nuk e di pse dekllaron në një mënyrë të këtillë.

Është e vërtet se në kohën e Fashizmit kam qenë tek Kuestori Pandeli Papalilua ku ju jam lutur për faljen e Sotir Sinjarit që sot është Toger, për dhëndrin e Aleksandër Dhimitrit, Pashë Pemën që ishin të arestuar dhe këta janë liruar dhe ndodhen sot në detyra d.m.th. se unë jam përpjekur për njerzit e Lëvizjes. Unë jam falnderuar edhe nga Titua me anën e Ministrit të tijë ku kemi ngrënëdhe drekë me këtë, për përpjekjet që unë kisha bërë për partizanët jugosllav. Mua në kohën e Ballit më kan dashur të më vrasin ku kanë ardhur në Dhioqezë 7-8 persona me bomba që nuk di nga ishin të dërguar, porse kuptohet se unë ndihmoja gjithëmonë Lëvizjen, dhe këta i kishin thënë shërbëtorit se të prezantohesha në Gjindarmari n'orën 4 të asaj dite që erdhën, dhe për këtë kam vajtur drejtë tek Medi Frashëri dhe jam ankuar se unë jam fetar dhe ç'kërkojnë me mua. Unë po të isha fashist nuk thëritesha nga Komandanti Përgjithshëmë në Kongresin e Përmetit që në ka dërguar me anën e Naun Bexhanit.

Arkivi i MPB, Fondi 140, Viti 1947, D. 4180, Fl. 7-8.

PËRMBLEDHJA E AKUZAVE TË PANDEHURIT IRINE BANUSHIT

1) I pandehuri është Dhespot ndihmës i krye Peshkopit këtu në Tiranë, ka mbaruar fakultet n'universitetin e Beligradit gjysmat e mësimeve të gjimnazit i ka bërë në Shkodër në shkollën e françeskanëve.

2) Më tridhjet e tetën që ka mbaruar dhe është këthyer me një herë është emëruar Profesor i Seminarit orthodhoks këtu Tiranë deri në fund të Janarit 1942 (nëntëqint-dyzet e dy) dhe si profesor i Liceut shtetit. Gjatë këtyre kohëve ka qënë disa muaj i internuar si sërbo math, mbasi kishte kryer mësimet atje jo si anti-fashist, mbassi vetë shpjegon i akuzuari se s'është marrë me politikë n'atë kohë.

Tridhjet Janar dyzet e dy (30/I/1942) bëhet në Manastir të Shënaunit Jerodjakon me tridhjet e një Joromonah e Arqimandrit më një Shkurt t'atij viti Episkop.

Qysh n'atë vjet dhe deri në datën e arrestimit ka qënë në Tiranë.

3) I pandehuri është një tip mjaft inteligjent dhe i djallëzuar, ky mbas çlirimit të Shqipërisë dyke parë reformat e mëdha të Pushtetit t'onë që shkojnë përpara me hap dhe që këto reforma natyrisht e prekin edhe dhespotin e bënë këtë që të hidhet n'anën ekstreme, të bashkohet me reaksionarët dhe të vazhdojë rrugën dhe politikën e tyre.

Irine Banushi shok qysh në fëmijëni dhe mik familjar me të dënuarin Gjergj Kokoshin, gjatë çlirimit ky hyn del rri në kafe han dreka e darka e tjera me 'të.

4) Miqësi të ngushtë hyrje dalje darka dhe dreka me krye famullitarin e Tiranës të klerit katolik Dom Shtjefën Kurtin. Miqësi me priftër tjetër katolik në Shkodër pse i ka patur profesor, i ka vizituar dy herë, nji herë në dyzet e dynë kur u-bë Dhespot dhe nji herë në dyzet e pesën që ishte çliruar Shqipërija.

5) Ka patur marrëdhënie të ngushta me elementa rreaksionarë të tatuar – ishin nëpunsa të regjimeve të kaluara dhe pronarë, ka shkuar nëpër shtëpitë e tyre dhe të familjeve të dënuara kriminela luftee dhe i ka kurajuar.

6) Ka ngrijtur lartë Pandeli Kotokon kudo dhe i ka pirë shëndetin me verë, duke cilësuar si njeri të lartë me kulturë dy fakulitete dhe si fetar të mirë. Sa do që i pandehuri kërkon të mbrohet në proces dyke thënur që kam pirë shëndetin e njëj Pandeliut mikut t'im dhe jo Kotokos dhe që Kotokon e kam ngrijt lart si njeri me kulturë dhe fetar i mirë, por kam thënë që është tradhtar i kombit. Kjo së është as pak e vërtetë, por dollin e ka pirë për P. Kotokon dhe ka ngrijtur lartë pa i bërë asnji kritikë politik. Kjo vërtetohet nga personat që na kanë informuar neve nga fjalët e tij indirekt dhe kryesisht nga vet fakti që i akuzuari ka thënur në proces se Kotokon nuk e njohim si tradhëtar dogmatikë, prandaj nuk qe pushuar botërishtë nga sinodi si dhespot i Gjinokastrës deri në dyzet e pesën.

7) Irine Banushi ka marur inisiativën pë t'organizuar vajtjen e klerikëve orthodhoks, muslimanë dhe katolikë në kryesinë e Kuvendit Popullor për të kërkuar faljen e kriminelave të luftës të dënuar nga gjyqi special ky në bashkëpunim me Dom Shtjefën Kurtin. Kjo vërtetohet nga fjalët e tij indirekte.

8) Në predikimet e tija që ka bërë në kishën e Shën-Prokopit dhe në kishën e Durrësit që ka shkuar për mesh a folur hapët kundra Pushtetit.

Duke futur çështjen në fe dhe paraqitur në këtë mënyrë, Shteti ka hapur shumë shkolla për të mësuar fëmijët por ka ndaluar mësimin fetar në to, kjo është një gjë e pa drejtë tha dhe është këthyer nga Krishti ku i ka thënur pse ri o Krisht e na lë të na rrejnë që me ty është e drejta me ty është udha dhe e vërteta.

Këtë e ka thënur duke qënë i revultuar pastaj u ka bërë thirrje popullit që fëmijët e tyre t'i shpinin në kishë për të marrë mësimin fetar.

9) Ka folur për rrevulicionin Frances dhe luftën që i kanë patë bërë fesë, por mà sëfundi feja fitoi se pa atë s'bëhej puna dhe më sëfundi e ka lidhur me gjendjen e këtushme duke thënë se edhe këtu ka t'atilla re të zeza ose mund të vijnë; dhe pastaj e ka këthyer fjalën për ta lustruar se gjoja monarko-fashistat na kërcënojnë Kombin kjo s'është e vërtetë ay e ka krahësuar gjëndjen e Francës me t'onën d.m.th. edhe këtu do të triumfojë feja.

10) Një herë tjetër ka thënë se zëmrën e njeriut dhe veprimet e tija nuk mund t'i dijë kurr njeri qoftë Oficeri Mbrojtjes Popullit apo ndonjë tjetër veçse zoti, prandaj vetëm ai ka të drejtë të dënojë Oficeri Mbrojtjes Popullit ose kushdo që urdhëron për të bërë keq ka setanan frymën e ligë ajo e shtyn t'a bëjë këtë punë. Për t'i larguar këto dhe për të siguruar mbretnin e qiejve kushdo ka nevojë të vijë në kishë të ksenollaiset t'edukohet.

11) Një herë tjetër ka thënë që s'ka asnjë shkencëtar që pa patur ndihmën e fes të munt të kryejë një punë të shkencës.

12) Këtu zoti na mbron vetëm për hatërin e fëmijve pse ndryshe nga mëkatat e shumta që kemi do na kish çdukur fare dhe ju jep shëmbulla se si ka ç'dukur zoti qytete.

13) Ndë një vënt ku ka qënë vizit dhe është biseduar çështja për të mbledhur ndihma për të vobektit, Irinen tha t'i lutemi zotit se është zëmëruar dhe prandaj na bën keq.

14) Ka thënë se mos rënia e shiut është zëmërimi i zotit prandaj s'na jep shi.

Në shtëpinë e Av. Vasil Dilos është takuar me një element grek kundra monarko-fashistave grekër dhe Irinen i ka thënë mbasi është njohur me të që pse nuk shkon në Greqi, ay i ka thënë më vrasin. Dhespoti i ka thënë nuk të vrasin të jap nji letër unë që të veç mirë dhe të të mos të bëjnë gjë. I përmënduri Irinen s'pranon t'i ketë thënë të jap letrë dhe shko në Greqi, por indirekt me fjalët e tij vërtetohet si edhe nga personi që i ka thënur.

I pandehuri siç u tha edhe më sipër është një element shum dinak dhe kërkon që çdo gjë t'a mësheh ndënë maskën e fustanit dhe të mjekërve duke kërkuar t'i ja mështetet fesë se gjoja ka folur në mështetje t'ungjillit dhe të statutit kishëtar që e njeh shteti. Gjërat që s'i përfshin statuti dhe ungjilli kërkon të humbasë dhe s'i pranon ashtu siç janë por kërkon t'i komentojë ndryshe e disa s'i pranon fare.

Po të studjohet procesi i pandehuri indirekt dhe me forma të ndryshme i vërteton akuzat që i bëhen sa do që mundohet t'u heqë kuptimin,

I pandehuri kërkon të paraqitet apolitik sikur nuk ka marrë pjesë fare atij krahu, vetëm është marrun me punë fetare. Kjo s'është aspak e vërtetë, por ndënë maskën

e fesë dhe të petkës të mjekrës ka lojtur rolin me rëndësi po të shikohet mirë me kë ka patur relacion, kush është rrethi i tij. Të shikohen fjalët e tij vrer dhe për Pushtetin, të shikohet ajo që kërkon t'u paraqit popullit se kemi dalur nga udha e tij e zotit dhe jemi plot me mëkat.

Kjo do të thotë që populli të punojë simbas programit të priftit dhe jo Shtetit që të jetë i dashuri i zotit. Dhe kur thotë që njerzit ishtin satonaj për të bërë të këqija pse ata nuk muntedin seç bëj unë ç'mendoj, as Oficeri i Mbrojtj-es P. e as kush tjetër veç zoti dhe ai ka të drejtë të dënojë d.m.th. çdo veprim që të bëhet nga Pushteti dhe nga ligji është i pa drejtë, këtë do të thotë Irinen.

Qëndrimi i tij përpara pyetjeve ka qënë shumë i keq dhe armiqësor, në proces se ka thënur të vërtetën ka kërkuar që të humbiste çdo gjyrmë që atë e përlihen dhe i paraqit të gjitha marrëdhëniet dhe këto çështje të thjeshta personale dhe fetare. Është njeriu më djallëzuar më finak dhe armik i betuar i Pushtetit Popullor dhe i Frontit Demokratik.

Për të gjitha këto bashkë në procesin e tija i drejtohet gjyqit për të marrun dënimin që meriton.

Arkivi i MPB, Fondi 140, Viti 1947, D. 4180, Fl. 9-12.

P R O C E S T V E R B A L

Sot më datën njëzet e shtatë i pari nëntëqint e dyzet e shtatë, ditën e mërkurë, u muar në pyetje i pandehuri Irene Banushi nga Shkodra dhe banus në Tiranë, në burgun e armiqvet të popullit, prej meje Kapiten I-rë Avdul Hakiut, Oficer' i Drejtoris Sig. Shtetit, i ngarkuar me cilsinë e hetusit. I pandehuri akuzohet se ka bërë propagandë kundra Pushtetit Popullor, ka bashkëpunuar me reaksionarët, ka predikuar kudo në popull kundra Ligjevet të Pushtetit, ka ngritur lart Kotokon dhe ka pirë shëndetin e tija, ka dashur t'i japi një elementi me nënshtetësinë greke rekomandim për të shkuar në Greqi. Për të gjitha sa u thanë më sipër pyetet dhe deklaron si më poshtë:

Quhem Irene Banushi i Nikollës dhe i Nedos nga lagja Rus i Vogël i qytetit Shkodër, vjeç dyzet e një, i pa martuar (beqar), profesioni fetar (Episkop). Shkolla fakulitet në Theollogjijë. Mësimet e para dhe gjysmë gjymnaz i kam kryer në Shkodër; në gjymnazin e Fretërvert Françeskanë; në vitin një mijë e nëntë qint e njëzet e pesë. Në këtë datë dhe deri në nënt qint e tridhjet e një, kam mbaruar Seminarin Cetinë (Jugosllavi), po në këtë vit kam filluar mësimet e nalta dhe i kam mbaruar në vitin një mij e nëntë qint e tridhjet e tetë në universitetin e Beligradit. Në gushtin e tridhjet e tetës jam kthyer në Shqipëri, ku mbas një muaji jam emruar Profesor në Seminarin Orthodhoks, në fillim të vjetit shkolluer jam emruar dhe Profesor në Liceun e Shtetit Tiranë, ku kam viju deri sa janë mbyllur shkollat në vjetin njëmij e nëntë qint e tridhjet e nëntë.

Në shtëpi kam dy vëllezër, i mathi quhet Lluka vjeç pesëdhjet, i martuar me tre fëmijë, djali i tij quhet Thanas vjeç njëzet, nënëpunës në radion e Shkodrës, vajzat njëra Nevenka e tjetra Irena, njëra dhjetë vjeçe dhe tjetra pesë vjeçe. Vëllaji tjetër quhet Xhorxhi, i martuar me dy fëmijë, vjeç dyzet e shtatë, djali i tij Dhimitri vjeç shtatëmbëdhjetë, tjetri Isidoni pesë vjeç. Kam dhe pesë mbesa e një nip të vëllajit të math (vdekur) e që quhen mbesa e madhe Marta, vjeçe njëzet e katër, Ana nëntëmbëdhjetë, Ollga shtatëmbëdhjetë, Despina pesëmbëdhjetë, Senka njëmbëdhjetë dhe Nikolla njëzet vjeç, nënpunës në dyqanin e shtetit Shkodër, ka dy klasë të mesme shkollë, vëllezrit shkollë fillore dhe janë që të dy në dyqanin e shtetit, njëri ku shiten liqeret dhe tjetri në dyqanin e koperativavet ku bëhen zhukthat, koshe, shporta, etj. Nipi Aleksandri i vëllajit vdekur njëzet e pesë vjeç punon në B.R.A.SH. shkolla që ka tre klasë gjymnaz.

Unë jam arestuar më njëzet e tetë tetor një mij e nëntë qint dyzet e gjashtë, prej forcavet M.P. Ardhja e okupatorit fashist më ka gjetur këtu në Tiranë, ardhjen e tija e kam pritur keq. Mbas tre muajvet më burgosnë dhe pastaj më internuan n'Itali në katundin Redon desko Provinçe e Mantos. Me ardhjen e fashizmit unë s'kam bërë as gjë dhe as që e di arsyen e internimit. Në fillim të qershorit një mij e nëntë qint e dyzet më kthyen në Shqipëri dhe më lanë të lirë deri në fillim të vitit shkolluer të dyzet e njësë më lanë pa punë. Në fillim po të këtij viti më emruen Profesor deri në pesëmbëdhjetë janar të dyzet e dyshit. Në fillim të shkurtit jamë bërë Dhespot dhe qysh atëhere e deri në kohën që u arestova kam qëndruar këtu në Tiranë pranë Kryesis së Këshillit (prishet një fjalë) Kishës si ndihmës Episkop, me titullin Epishkopi Apollonis. Më dyzet e trenë jam emëruar Episkop' i Strugës por nuk kam shkuar. Gjat kohës t'okupacionit kam qëndruar indiferent, kam shikuar vetëm punën fetare, kundra fashizmit s'kam bërë as gjë. Kur kam qënë profesor' i Seminarit Orthodhoks në mbarim të vjetit një mij e nëntëqint e tridhjetetetë është bërë mbëledhja e sinodhit. Aty kam njohur Pandeli Kotokon epishkiopin e Gjinokastrës, kam shkuar dhe u kam bërë një vizitë gjithë antarëvet të Sinodhit në hotel Internacional. Gjat seancavet të Sinodhit jam takuar edhe dy tre herë me 'të (Kotokon), jemi përshëndetur, kur u takova për herë të parë me 'të më pyeti ku i keshë mbaruar studimet, kë kisha në shtëpi, antarët e familjes kë kisha dhe si i kisha dhe unë ju përgjegja.

Për Kotokon kam pas simpathi si njeri i kulturës dhe si njeri fetar deri në kohën që i largua prej Shqipërije. Unë nuk mbaj mënd që të kemi folë në shtëpinë e Dr. Mihal Angjelit më tetë nëndor të vitit një mij e nëntë qint e dyzet e pesë për Kotokon ose çështje të tjera politike. Është e vërtetë që kam qënë për darkë në shtëpinë e Dr. Angjelit, ka patur emrin dhe aty kemi gjetur edhe persona të tjerë, kemi pirë, ngrënë, kanë kënduar ata që ishin aty shqip, greqisht, por shëndeten e Kotokos unë aty s'e kam pirë dhe as që kam folur për 'të. Personat që ishin aty veç nji Lonit nga Borova e Korçës dhe që punon në spitalë dhe Dr. me të vëllanë nuk njohi tjetër njeri. Ata që ishin aty flisnin shqip dhe greqisht, më duket se grekofonë ishin. Tek doktori kam qënë bashkë me Jani Dadon.

Aty nga muaji shtator i dyzet e gjashtës një ditë kam shkuar për drekë tek një Taqo nga Korça nënpunës në një zyrë ku nuk e di. Taqua rri në shtëpinëe të vëllajit Mustafa Marës në Rr. e Tafajvet. Taqua kish pagëzuar një vajzë dhe më foli për drekë, aty kam gjetur vjehërrin e tija që quhej Thoma dhe të vjerrën që quhej Eleni edhe këta nga Korça. Të shoqen e quanin Agathija. Para se të hanim bukë piva dy tre kupa raki e mbas buke pimë verë. Aty ishin edhe një Gaqo dhe një Ançe si dhe dy kushurira të Taqos. Para se të ngreri kupën e verës Eleni (vjehërra e Taqos) merr një këngë greqisht dhe si mbaroji këngën unë ngre kupën me verë dhe them: "Shëndetja e Pandeliut", kur këjo më pyet se kush është ai Pandeli? Unë i them një miku im, të këndoftë zëmëra i them, shëndetja e të dy popujvet për popullin grek e shqiptar, Perëndija na pruftë një paqe të përgjithshme; ajo tha: "atëhere të na vish në Korçë", unë i thashë të piimë dhe shëndetin e Dhespotit, të cilit Dhespot pyeti Eleni? Të Kotokos! Jo, Dhespotit të Math që do të na çojë në Korçë i them. Me këto fjalë pimë kupën e verës. Mbas këtyre fjalëvet kam thënë unë Kotokoja njeri me kulturë dhe do tëish shumë i dobishmi për kishën t'onë, por iku dhe ra në trathëti. Kotokon si dogmë fetare nuk e dënoj, pse gjatë kohës së tija nuk kish bërë ndo një gjë të keqe dogmatike, por kundra ligjevet kishëtare e dënoj se ka lëngrixhën vetëm në kohë të rrezikut. Largimi i tija ka qënë pa lejen e Sinodhit. Sinodhi Kotokon e ka shkarkuar nga detyra si Epishkop i Gjinokastrës në qershorin e nëntë qint e dyzet e pesës.

Nuk di pse Sinodhi nuk e kishte përjashtuar më parë dhe t'a kishte botuar në fletore ashtu siç e botojti në qershorin e dyzet e pesës.

Me Gjergj Kokoshin kam patur marrëdhënëje familjare, kam shkuar për vizita dhe më ka ardhur, kam ndënjur jashtë në për kafe; çështje politike nuk kam biseduar as një herë me 'të. Një herë kam ndënj në kafe Dajti unë (Irenei), Lluk Kalemi (tregtar nga Durrsi), Gjergj Kokoshi, një inxhinjer italjan, Telmak Qyrko dhe tre katër të tjerë por nuk më kujtohen. Këjo mbledhje ka qënë aty nga vera e dyzet e pesës. Aty s'kemi biseduar as gjë politike, muhabet të pa rëndësishëm kemi bërë. Shkaku i kësaj mbëledhje ish miqësija personale ftuar nga Llukë Kalemi. Ky na e hoqi drekën të gjithëvet. Mentor Çobën e kam patur njohë në Beograd kur ish nxënës i gjymnazit dhe unë isha student i fakultetit; me këtë kemi pat njohje si fetarë në Beligrad. Kur kam ardhur këtu jam takuar me 'të në rrugë, jemi përshëndetur, aty më ka njohur dhe me dajën e tija Irfan Ohrin, mund të jemi takuar dhe një herë apo dy në bulevard, nuk mbaj mënd mirë. Mentorin në vjetin dyzet e dy ose dyzet e tre, ka shkruar në gazetën "Tomorri" një artikull me titullin "Episkop Ilija Banushi", ka folur mirë mbi jetëshkrimin t'im dhe cilësit e mira që kam patur unë si student në Beligrad. Nuk di se si mund të shkruajë një njeri kur nuk ja di afër karakteristikat tjetrit, po them që mund të ketë pyetur. Nuk di pse shkroi këtë artikull. Unë s'di ç'punë kish dhe me se merrej Mentori. Tek Jakomoni (logotenencë) nuk kam shkuar as një herë.

Tek Gjeneral Parjani kam shkuar njëherë me krye-Episkopin dhe këshillat kishëtare për të protestuar pë një libër që kishin qit italjanët se gjoja orthodhoksit e Shqipëris ishin grekër. Krye-Episkopi protestoji duke i thënë nuk është e vërtetë të jemi grekër, por jemi Shqipëtarë.

Është e vërtetë që unë u kam thënë popullit në kishë që Shteti ka hapur shumë shkolla por ka ndaluar mësimet e feesë ndër 'to; prandaj u kam thënë u bëj thirrje që t'i bini fëmijën t'uaj në kishë të marrin edukatë fetare në orë të caktuara. Me Dom Shtjefën Kurtin krye-famulltarin e Tiranës për fenë katolike kam miqësi me 'të, e njoh qysh në vitin një mij e nëntë qint e tridhjet e nëntë me ardhjen (prishet një fjalë) anën e nipit të tija që e keshë nxënës në lice, i kam shkuar për vizita në raste feste, ashtu më ka ardhur edhe ky mua. Kam shkuar një natë për darkë në muajin mars a prill një mij e nëntë qint e dyzet e gjashtë. Këjo vatëje ka qënë me rastin e vdekjes të Mon Sinjor Thaçit. Domi më mbajti për darkë, aty s'kemi biseduar as gjë politike, vetëm çështje fetare. Me shumë priftërinj katolikë të tjerë kam patur njohje, mbasi kam bërë katër klasë gjymnaz në gjymnazin e Françeskanëvet dhe shumë prej tyre i kam patur Profesorë. Personat që njoh janë: At Justin Rrota, At Marin Serdani, At Bernardin Palaj, At Rrok Gurasi, At Frano Kiri, të tjertë kanë vdekur. Këtyre u kam bërë dy vizita gjat kohës që kam qënë Dhespot. Një herë në dyzet e dynë e njëherë në dyzet e pesën. Vizitat të dy herët u a kam bërë në Provincial të Françeskanëvet.

Veç këtyre kam vizituar dhe Patër Justin, e Patër Frano Kirin që rrinin tek Arra e Madhe dhe Patër Marinin në një rast tjetër. Vizitat kanë qënë private, s'kemi biseduar as gjë politikee.

Revolucionin Francez e kam cekur në një predikim që kam bërë kam thënë që dhe në kohën e revolucionit Francez mësimet fetare u hoqnë nga shkolla por prapë u vunë; prandaj edhe këtu kisha është e ndarë nga Shteti dhe mësimet e besimit nuk bëhen më në shkollë. Për këtë u kam thënë dërgoni fëmijët t'uaj në kishë t'u japëm njoftime mbi besimin. Nuk mbaj mënd se si paska ngjarë këjo punë që nga revolucioni Francez dhe feja paskam folur për kërcënimet greke. Unë kam thënë që seç mendon njëri dhe tjetri nuk mund t'i di as Oficer' i Mbrojtjes, as Ministri, as ligji, vetëm një perëndi dhe ai dënon si mbas mejtimevet që kemi dhe veprimevet që bëjmë ne.

Kur janë dënuar kriminelat e luftës nga Gjyqi Special është e vërtetë që unë me krye-episkopin Kristofor Kisin, Kryemiftia i Komunitetit Myslyman, Mon Sinjor Prendushi (Krye-Episkop i katolikvet Durrsit), kemi shkuar në Kuvëndin Popullor për të lutur që të faleshin të dënuarit kriminela lufte dhe armiq të popullit që ishin dënuar nga gjyqi i më-sipërm. Këjo vajtje atje është provokuar në këtë mënyrë: Një ditë më parë unë (Ireneu) kam takuar një prift katolik P. Mushkallën dhe më thotë Krye-Episkopi ka ndërmënd me shkue e me kërkue mëshirë, unë i them nuk di, s'më ka thënë gjë. Ai më tha që bisedo me 'të po qe se shkoni na lajmëroni dhe neve. Të nesërmen shkova në krye-peshkopatë dhe ai pa filluar unë më tha: "Kanë ardhur disa familje orthodhokse dhe më kanë thënë të vete të kërkoj mëshirë pranë Kuvëndit Popullor për të dënuarit". Unë e pyeta do shkoni vetëm apo me ndo një komunitet tjetër se kështu kështu më tha një prift katolik. Ai më tha shko lajmëroji të katolikvet dhe të myslymanvet, kryetarët e komunitetevet, kështu unë shkova dhe i lajmërova që të dy kryetarët e fevet dhe u bëmë bashkë para kishës orthodhokse në bulevard. Krye-miftija me një person tjetër me gjyslyke, i katolikvet me Dom Shtjefën Kurtin, unë me Krye-Dhespotin Kisin. Me tre karroca vajtëm në

Parlament tek Dr. Omer Nishani. Aty u ulëm dhe në emër të klerikëvet foli Hafëz Musaji i komunitetit Myslyman, por Dr. Omer Nishani tha: "Këtë punë e ka gjyqi i Naltë dhe jo neve, ne u kemi dalë borxhit mëparë, atëherë ikëm.

Ne kërkojmë mëshirë gjithinjë për faljen e jetës, kështu ka qënë rregulli në Shqipëri më përpara. Harallamb Shundin e njoh, takohesh gjithmon me 'të, i kam vajtur në shtëpi, e kemi patur arkëtarin e kishës dhe antar' i Këshillit ekonomik. Veç punëvet të kishës s'kemi biseduar gjë tjetër.

Noc Sokolin e njoh, e kam mik, u kam vajtur në shtëpi dhe kam biseduar çështje familjare, hallet e gjëndjes ekonomike. Ky ka punuar në Ministrin e P. të Mbrendëshme por se ku nuk e di në kohën e Kol Bibës, ç'punë ka patur nuk e di, s'jam interesuar t'a pyes. Me këtë njihem qysh në fëmijëni, dhe kam qënë shok me 'të. Më ka ardhur gjithnjë në kishë dhe më kërkonte, shkaku i ardhjes ish pse ky ka qënë në gjëndje të keqe ekonomike dhe unë i kam ndihmuar duke i dhënë të holla, një herë një qint dhe një herë pesëdhjet fr. këto ja kam dhënë nga rroga e ime si vepër ba-mirësije. Të hollat që i kam dhënë mund të jenë dy-treqint franga Shq. Ka takuar që u kam dhënë dhe të tjerëvet por nuk i mbaj mënd. Nuk di a shkonte në kishën katolike, me mua kish njohje qysh njëzet vjet më parë. Ky ka qënë gjithnjë nënpunës në Ministri dhe në bankë dhe sot në bank është.

Alfred Ashikun nga Shkodra e njoh, kam vatur në shtëpi të tij një herë, kam ngrënë edhe një darkë atje. Kemi ndënjur në kafe dhe me këtë kemi biseduar çështje personale, kështu edhe me këtë njihem qysh në fëmijni.

Jani Dadon e njoh është sekretar' i Epishkopatës Gjinokastër e tash shërben si sekretar provizor pranë kryesis së kishës. Me këtë kam pasur ndënjëje dhe bisedime për punët fetare, i kam vatur në shtëpi dhe s'kemi biseduar kurrë as një herë gjëra për politikë dhe as për Kotokon, kështu edhe me Harilla Theodhosin që është Drejtor' i pasuris së kishës.

Fori Vadhanin tregtar e njoh, kam blerë disa nobla, tjetër marrdhënje s'kam pasur me 'të. Unë njoh një Grek me emrin Jani nga Greqija, vëndin ekzakt nuk ja di, jam takuar me 'të në shtëpinë e Avokat Vasil Dilos, aty më ka prezantuar familja e Dilos me 'të dhe më tha: "është grek", unë i fola me shënja mbasi nuk di greqisht e pyeta se kë ke në shtëpi dhe si i ke me shëndet, ai më tha, i kam në Greqi nuk di gjë, kam më tha gruan me dy kalamanj. Me kaqë për këtë herë mbaruam, një herë tjetër kur e takova në shtëpinë e Dilos e pashë tue qa dhe unë e pyeta çke o Jani, ai më tha dhe më tundi dorën, unë e pyeta po letrat a u çon me tha jo. Tjetër s'kam biseduar. Unë s'jam marrë kurrë me politikë veç me fenë.

Tjetër gjë s'kam për të thënë, përsa përmban procesi mbasi m'u kënduan me zë të naltë pranoj që janë të gjitha thënjet e mija të drejta, për vërtetim i nënëshkruaj me shënjën firmën t'ime

I p a n d e h u r i — O f i c e r i Hetues

Irene Banushi

Kapiten I-rë

(Avdul Haki)

Arkivi i MPB, Fondi 140, Viti 1947, D. 4180, Fl. 14-17.

P R O C E S V E R B A L

Sot më datën njëzet e shtatë i pari nëntëqind dyzet e shtatë; ditën e martë në burgun e armiqvet të popullit, para meje Kapiten i I-rë Avdul Hakiut, i ngarkuar me cilsin e hetusit, Oficer i Drejtoris Sigurimit Shtetit, merret në pyetje i pandehuri Irene Banushi nga Shkodra. I pandehuri akuzohet se ka bërë propagandë kundra Pushtetit Popullor ka bashkëpunuar me reaksionin, ka predikuar kudo në popull kundra Pushtetit, ka ngrijtur lart Kotokon dhe ka pirë shëndetin e tija, ka bërë politikën e Kotokos kudo. Ka dashur t'i japi një elementi me nënshtetsi greke rekomandim për të shkuar në Greqi. Për të gjitha këto pyetet dhe deklaron sa më poshtë.

Quhem Irene Banushi i Nikollës dhe i Nedos, nga Lagja Rus i Vogël, i qytetit të Shkodrës, vjeç dyzet e një, i pa martuar (beqar), profesioni fetar Episkop, Shkolla Fakultetit Theollogjis. Mësimet e para dhe gjysëm e së mesmes katër gjymnaz Shkodër, në gjymnazin e Françeskanëvet në vitin njëmijë e nëntëqind e njëzet e pesë. Në këtë datë dhe deri në nëntëqind e tridhjet e një kam filluar mësimet e nalta dhe i kam mbaruar në nëntëqind e tridhjet e tetë n'Universitetin e Beligradit. Në gushtin e tridhjet e tetës jam kthyer në Shqipëri ku mbas një muaji jam emruar Profesor në Seminarin Orthodhoks, në fillim të vjetit shkolluer jam emruar edhe profesor në Liceun e Shtetit Tiranës, ku kam viju deri sa janë mbyllur shkollat në vjetin tridhjet e nëntë. Jam arrestuar me 28 Tetor 1946.

Në shtëpi ka dy vëllezrë, i mathi quhet Lluka vjeç pesëdhjet, i martuar me tre fëmijë, djali i tija quhet Thanas vjeç njëzet nënpunës në Radion e Shkodrës, vajzat njëra Nevenka dhe tjetra Nena, njëra 10 dhjetë dhe tjetra tetë vjeç.

Vëllaji tjetër quhet Xhorxhi i martuar me dy fëmijë vjeç dyzet e shtatë, djali i tija Dhimitër shtatëmbëdhjetë, Isidoni pesë vjeç. Kam edhe pesë mbesa e një nip të vëllajit të math, vdekur, Marta njëzet e katër, Ana nëntëmbëdhjetë vjeç, Olga shtatëmbëdhjetë, Despina pesëmbëdhjetë, Senka njëmbëdhjetë, Nikolla njëzet vjeç nënpunës në dyqanin e Shtetit Shkodër, ka dy klasë Gjymnaz. Vëllezrit shkollë fillore këta janë, njeri është në dyqanin e Shtetit ku shiten likoret dhe tjetri në dyqanin e Koperativavet ku bëhen zhukthat, kosha, shporta, karrike etj.

Nipi Aleksandër i vëllajit vdekur njëzet e pesë vjeç, punon në B.R.A.SH. Shkolla që ka tre klasë Gjymnaz.

Ardhja e okupatorit fashist më ka gjetur këtu në Tiranë. Ardhjen e tij e kam pritur si armik, s'bëra as gjë pse më gjet të mjerum. Mbas tre muajvet më burgosën tre muaj dhe pastaj më internuan n'Itali në Kat.Redondensko Provinçe e Mantovës. Arsyen e arestimit s'ma treguan. Në fillim të Qershorit njëmijë e nëntëqind e dyzet më kthyen e erdha në Shqipëri ku më lanë të lirë deri në fillim të vitit shkolluer të dyzet e njësë më lanë pa punë. Më emruan Profesor tre muaj të vitit njëmijë nëntëqind dyzet e një deri në pesëmbëdhjetë Janar të dyzet e dyshit u mbyll kursi. Po në shkurt po të atij viti u dërgova në Manastir të Shën-Naunit ku u bëra më tridhjet janar Jerodhjakon më tridhjet e një janar Jaromanah e Arqimandrit, më një

shkurt Epishkop. Aty kam qëndruar deri në nëntëqind e të dyzet e dyshit. Më tetë mars kam mbrijt n'Elbasan ku kam qëndruar në Manastir të Vllademirit sa kemi ngrënë drekën mbas drekë jam mbritë në Tiranë. Qysh atëhere e deri në fund, kam qëndruar këtu në Tiranë pranë Kryesis Kishës, ndihmës Epishkop me titull Epishkop i Apollonis, mbasi çdo Epishkop ka një titull. Më dyzet e trenë jam emruar Epishkop i Strugës por nuk kam shku. Gjat kohës t'okupacionit unë kam qëndruar indiferent, kam shikuar punën fetare, e kam kryer shpirtërisht por kundra tij s'kam bërë as gjë. Kur kam qënë Profesor i Seminarit Orthodhoks në mbarim të vjetit nëntëqind tridhjet e tetë ose në fillim të vjetit tridhjet e nëntë (1939) kur është bërë mbëledhja e Sinodhit mblidhen Epishkopët dhe civilat antarët e kshillit mikst dhe ekonomik. Aty kam njohur Pandeli Kotokon Epishkop i Gjinokastrës, ku kam shku dhe u kam bërë një vizitë gjithë antarvet të Sinodhit të Hotel Internacional. Gjat seancavet të Sinodhit jam takuar dy tre herë me të, jemi përshëndetur. Kur u takova për herë të parë me të, më pyeti kur i keshë mbaruar studimet, ku e keshë bërë shkollën, kë kisha në shtëpi antarë të familjes, si i keshë dhe unë ju përgjegja.

Për Kotokon kam patur simpathi si njeri i kulturës dhe si njeri fetar deri në kohën që u largua prej Shqipërije. Unë nuk mbaj mënd që të kem folur në shtëpinë e Dr. Mihal Angjelit më tetë nëntor të vitit 1945 nëntëqind dyzet e pesë, është e vërtetë që kam qënë për darkë në shtëpinë e tija se ka patur emrin. Aty kam gjetur doktorin me zonjën e tij, vëllan e tij, një nga Borova e Korçë, mbiemrin s'ja di, punon në spitalin civil Tiranë dhe tre katër grekofonë të pa njoftur, flitshin greqisht gjithnjë. Aty kam shkuar me Jani Dadon, ish Sekretar i Epishkopatës Gjinokastrës e tash sekretar profizor i Kryekishës, na vamë t'i urojmë emrin, mbasi kishte ditën e emrit, mirë po ay na mbajti për darkë. Aty është pirë raki, kemi ngrënë bukë, kanë kënduar ata unë rrijë, mbas buke kam ikur me gjithë Sekretarin. Nuk më bie ndërmënd të kemi ngrijtur shëndet, nuk më bie ndërmënd të jetë zënë Kotokoja në gojë. Aty nga muaji shtator i dyzet e gjashtës, një natë kam shkuar në shtëpinë e një Taqi nga Korça nënpunës, ku nuk e di. Këta rrinin në shtëpinë e Tafajve shtëpija e të vëllajit Mustafa Marës. Këtij Taqit i kisha pagëzue një vajzë që i kish lindur dhe më ftuan për drekë. Aty kam gjetur vjehërin dhe vjerrën e këtij Taqit që quheshin Thoma dhe Eleni dhe një Gaqo dhe një Anço. Gaqoja më duket punonte në Mbrojtje të Popullit. Këtu kemi pirë raki, ngrënë bukë, kemi pirë verë, kaam mbushur kupën e verës dhe i kam thënë Thomajit dhe pastaj të tjerëvet shëndeti i Pandeliut, të këndofta zëmra i thashë asaj gruas që këndoji një këngë greqisht, shëndeti i të dy popujvet për popullin (grek dhe shqiptar), perëndija na pruftë një paqe, ajo tha atëhere të na viç në Korçë, unë i thash të pimë dhe shëndetin e Dhespotit të cilit Dhespot Kotokos, jo i thashë të Kotokos por të Dhespotit të math që të më transferojë mua në Korçë. Me këto fjalë pimë kupën. Mbas këtyre fjalëvet kam thënë Kotokoja njeri me kulturë dhe do t'ishte i dobishëm për Kishën t'onë por iku dhe ra në trathëti. Kotokon si dogmë fetar – nuk e dënojnë pse gjat kohës së tij nuk kishte bërë ndo një gjë të keqe dogmatik, por kundra ligjevet kishtare e dënojnë pse ka lënë grizhen vetëm në koh të rrezikut. Largimi i tij ka qënë pa lejen ee Sinodhit, Sinodhi Kotokon

e ka shkarkuar nga detyra si Peshkop i Gjinokastrës, nuk ja kishte bërë më parë pse nuk kishte marrë flamurin e trathëtis, tjetër herë s'kam folur për Kotokon. Me Gjergj Kokoshin kam patur marrëdhënje familjare, të hyjtura dhe të dala, me këtë njifem që në kohën që vejëm në shkollë, me këtë kemi qënë gjithnjë të njohur, por puna vetë na kish ndarë, unë shkova në Jugosllavi për studim, ai shkoji n'Itali. Në tridhjet e tetën jemi takuar që u ktheva nga Jugosllavija, gjithnjë marrëdhënje familjare, i vejë për emër, për pashkë, kështu vinte dhe ai kur kisha ndo një urim.

Jemi takuar edhe disa herë jashtë me të, një herë në dyqanin e Ilo Oparit, një herë kemi pirë kafe në kafen London dhe një herë tjetër kemi ngrënë drekë në Hotel Dajti, ku na e ka hequr Lluka Kalemi nga Kavaja e banus në Durrës Tregtar. Këto takimet jashtë kanë qënë në dyzet e pesë në verë.

Lluka Kalemin e kam mik personal, më ka dhënë borxhë pare kur kam patur nevojë dhe ja kam kthyer pak e pak. Në këtë drekë kemi qënë shtatë tetë vetë unë (Irene Banushi), Gjergji, Lluka, një inxhinjer italjan, që nuk ja di emrin, ky ishte me Llukën Telemak, Qirko gjykatës këtu nga Durrsi të tjerët nuk më vijnë ndër mënd. Llukën e takova te kafja Bar-Sahati, aty ka ardhur dhe Telemaku, inxhinjeri ishte me Llukën, për Gjergjin më bie ndërmënd, e gjeta apo më gjeti ai. Lluka më tha mua rri se do shkojmë në Dajti të ham një drekë dhe unë ndënja. Të gjithë tok shkuam në Hotel Dajti dhe ku qëndruam një orë, një orë e gjysmë pimë nga një godë, hëngrëm bukë dhe pastaj morëm nga një godë verë. Qëllimi i kësaj mbëledhje nuk e di, aty kemi biseduar çështje gjelle e çështje vape, aty s'kemi biseduar as gjë politike. Lluka me Gjergjin kishin shoqëri se kishin studjuar bashkë n'Itali. Telemakun e kish durrësak, me italjanin nuk e di, kur dollën, dollëm tok të gjithë dhe kur dollën unë u thashë tunjatjeta dhe ika, ata ç'u bënë nuk e di. Llazar Treskën se mbaj mënd, Mentor Cekën dhe Irfan Ohrin i kam patur njohur. Mentori me Irfanin ish xhajë e nip. Me Mentorin s'më ka prezantuar njeri, e njohi në Beligrad pse ishte studenti shkollës së mesme, unë isha n'Universitet. Me këtë kam patur përshëndetje në rrugë.

S'kam bërë as një herë kundra Pushtetit predikime. Është e vërtetë që në datën shtatë i shtati nëntëqind dyzet e pesë kam folur në kjishën e Shën-Prokopit dhe kam thënë na ka dënuar Zoti katër muaj pa rënë shi pse është larguar populli nga feja. Këtu kam shpjeguar një shëmbull nga fenomenet që bën Zoti dhe kam thënë që në testamentin e vjetër thotë udhëtimi i shënjtës Torini i bëri një vizitë Avramit dhe në kuvënd biseduan mbi fatin e dy qytetevet Sodom e Gonor, ku perëndija prej mëkatit kishte dalë me i mbyt këto qytete, me i djegë, Avrami ju lut Perëndisë që t'i falë këto qytete në qoftë se gjënden njëqind të mirë. Pastaj Perëndia i dogji të dy qytetet nga zëmërimi i njerëzvet që mori në të dy qytetet i bë gur e hi. Këtë morir ja paraqes popullit për t'a kuptuar rëndësinë e perëndis kundra atyre që largohen nga feja. Kam thënë që dhe këtu po të vinte shënjtërija të ri ni, vetëm zëmrat tuaja u thashë fëmiljvet mund t'u dalë përpara që janë pa mëkat se na jemi në mëkat. Mëkat kanë të gjithë njerzit si inividë, pse epshet e tyre i shtyjnë të vrasi, të presin, të trathëtojnë, të mos u binden rregullavet njerëzore, prindërvet, të mos respektojnë kishën, të mos venë në të; të mos kungohen, të mos meshohen, të

mos kunorëzohen, të mos marrin prift kur vdesin, të gjitha këto janë mëkate dhe perëndija zëmërohetë. Po të venë në Kishë, t'i luten zotit u falen të gjitha pse zoti ka thënë, kur e pyet një për vëllanë, sa herë t'a fal shtatë herë, ai i tha jo shtatë e mbi shtatë, shtatëdhjet herë, mbi shtatë t'a falç kur bënet pishmënd. Ksemollosija lutjet u falen të gjitha gabimet.

Unë e kam thënë këtë pse në Turanë ka tetëqind familje dhe nuk vijnë në kishë, vijnë aqë pak sa unë nuk jam i kënaqur. Mos ardhja në kishë vjen nga satanaja. Ky është një frymë e ligë që është larguar përzëmër nga mbretërija qiellore, nga mos bindja, atij ku hynë në zëmër të njerëzvet dhe i lezeton mëkatin njeriut. Ky mund të futet edhe në trupin e priftërvet për-deri sa janë njerëz vetëm Krishti largon. Këjo vjen nga dëfrimet dhe nga mos njohja e ungjillit ndërsa feja më serjozitet në dëfrime.

Në Durrës kam shkuar shumë herë për të meshuar dhe kam banuar në shtëpinë e priftit At Erazmo, kam bërë meshim në kishë, u kam folur popullit të vijnë në kishë dhe u kam thënë për mos rënjen e shiut katër muaj që ish fenomen i zotit, kam thënë që ndo një prej intelektualvet që nuk harrin të njohë ekzistencën e Perëndis dhe të besojë të vijnë tek unë t'ua spegoj. Nuk është e vërtetë që të kem thënë për qeverrinë. Aty kam takuar Petro Spiron, Telemak Nushin, Alfon Dovanën, Vangjel Manushin, Anastas Zabullin, tek këta persona kam shkue për vizita emrash nga dy tre herë në vjet. Tek Llukë Kalemi një herë kam shku, vajtja ka qënë vizitë, s'kemi biseduar as gjë politike veç urim. Është e vërtetë që unë me Kryepeshkopin Kristofor Kisin, Kryemiftija i Komunitetit Myslyman, Monsinjor Prendushi Kryepeshkop i Katolikvet Durrsit kemi shkuar në Kuvëndin Popullor për të lutur që të faleshin të dënuarit kriminela-lufte e armiq të popullit që u dënuan nga Gjyqi Special.

Këjo vajtje atje është provokuar në këtë mënyrë: një ditë më parë unë (Ireneu) kam takuar një prift katolik Patër Mushkallën dhe më thotë Kryepeshkopi ka ndërmënd me shkue e me kërkue mëshirë, unë i thashë nuk di s'më ka thënë gjë. Ai më tha që bisedo me të, po qe se shkon kryepeshkopi na lajmëroni dhe neve. Të nesërmen shkova në Kryepeshkopatë dhe ai pa fillue unë më tha kanë ardhur disa familje orthodhokse dhe më kanë thënë të vete të kërkoj mëshirë pranë Kuvëndit Popullor për të dënuarit, unë e pyeta do shkoni vetëm apo me ndo një Komunitet tjetë se kështu më tha një prift katolik. Ai më tha shkoi lajmëroji të katolikvet dhe të myslymanvet, kështu unë shkova dhe i lajmërova që të dy kryetarët e feve dhe u bëmë tok para kishës orthodhokse në bulevard.

Kështu Kryemiftija me një me gjyslyke, dhe katoliku me Dom Shtjefënin Kurtin. Me tre karroca vajtëm në Parlament tek Dr. Omer Nishani. Aty u ulëm. N'emër të klerikëvet foli Afis Musaji. Por Dr. Omeri tha këtë punë e ka Gjyqi i Naltë dhe jo na, na u kemi dalë borxhit më parë, ne atëhere ikëm. Na kërkojëm mëshirë gjithnjë për faljen e jetës, kështu ka qënë rregulli në Shqipëri më parë.

Këshillin ekonomik të Kryekishës dhe Harallamb Shundin, me këta takohesh gjithnjë, u kam vajtur dhe në shtëpi. Harrallambin e kemi arkëtarin e kishës dhe antar i Këshillit Ekonomik. Me këta veç punëvet të Kishës as gjë tjetër s'kemi biseduar. Noc Sokolin e njoh, e njoh si atë ashtu dhe të vëllan Gjergjin. Kam miqësi,

u kam vajtur në shtëpi, ata më kanë ardhur. Kam theksuar që kam ndënjur në kafe me 'ta, kemi biseduar çështje familjare, halle, trazimin e jetës, çështje ekonomike e çështje tjera s'kemi biseduar, di që ka punuar në Ministri të P. Mbrendshme por se kur nuk e di në kohën e Kol Bibës, ç'punë ka patur s'e di, edhe n'atë kohë kam patur miqësi me të, po s'jam interesuar të pyes. Ky ish nënpunës në Ministrin e Brendshme apo të Jashtmen s'mbaj mënd mirë, mua më lithte me të shkolla që kalamaq kemi qënë bashkë, më ka ardhur gjithnjë në kishë dhe kërkonte mua. Shkaku i ardhjes ishte pse ai ishte në gjëndje të keqe ekonomike dhe unë i kam ndihmuar një herë njëqind fr, një herë dyqind, një herë pesëdhjet. Këto pare ja kam dhënë mund të jenë dyqind, treqind fr. Shqiptare, ka takuar që u kam dhënë dhe të tjerëvet por nuk i mbaj mënd. Nuk di a shkonte në kishën katolike me mua, kish njohje qysh njëzet vjet. Ky ka qënë gjithnjë nënpunës në Ministri dhe në bankë, ky edhe sot nënpunës është, përpara se t'arestohem e kam lënë në bankë. Parat ja kam dhënë kur ish pa punë.

Sa për çështjen e shkollavet që Shteti ka hapur shumë dhe që ka ndaluar mësimin e fesë në to e kam thënë dhe u kam bërë thirrje popullit dhe u kam thënë që t'i bien fëmijën e tyre në kishë për t'u dhënë edukat fetare në orët e caktueme, këtë e kam folur dhe do t'a flas pse ma jep Statuti këtë të drejtë, por nuk është e vërtetë që unë të kem thënë se Shteti na ka bërë pa drejtësi dhe të jem kthyer nga ikona e Krishtit, të kem thënë që ç'bën o Krisht pse rri të na rrejnë. Nga Krishti na si fetarë kthehemi gjithnjë dhe e kërkojmë ndihmën e tija dhe jam kthyer, i kam thënëti je udha, jeta dhe ee vërteta për trashëgimin e mbretëris qiellore dhe i kam thënë na ndihmo dhe i them kurdoherë, por i jam drejtuar për këtë punë dhe e dojë të na bën ashtu siç është firma e ungjillit për besnikët e mi orthodhoksë. Me dom Shtjefën Kurtin Kryefamulltarin e Tiranës për fenë katolike kam miqësi me të, këtë e njoh që në vitin 1939 (nëntëqind tridhjet e nëntë) që kam qënë Professor i Liceut Shtetit, ky kishte nipë nxanësin tim në Lice, me anën e tij u njohmë. Me këtë rast i kam shku për vizita shumë herë me rastin e festavet, më ka ardhur dhe ai dy tre herë me rastin e festavet. Kam shkuar një herë për darkë nga muaji mars-prill nëntëqind dyzet e gjashtë (1946) s'më kujtohet. Unë kam shkuar t'i bëj një vizitë mbasi ish varrimi i Mon Sinjor Thaçit dhe më mbajti për darkë. Aty kemi biseduar ceremonin e varrimit të Mon Sinjor Thaçit. Dogma fetare, histori kishëtar, letër gjik, pagëzime, kunorëzime. Me priftër të tjerë katolikë kam njohje, mbasi kam qënë nxanës në Gjimnazin e tyre, ku kam bërë katër klasë siç kam thënë edhe më parë dhe këtu profesorët ishin priftër që më jipnë mësimet. Personat janë At Justin Rrota, At Zain Serdani, At Bernadin Palaj, At Rrok Gurashi, At Frano Kiri, të tjerët kanë vdekur. Këtyre u kam bërë dy vizita gjatë kohës që kam qënë Dhespot. Një herë në dyzet e dynë (më 942) dhe njëherë në dyzet e pesën (945) që kam shkuar në Shkodër. Këtë ja u kam bërë në provincialin e françeskanëve. Veç këtyre kam vizituar dhe Patër Justinin e Patër Frano Kirin që rinë tek Arra e Madhe dhe Patër Marinin në një rast tjetër, ky ishte sëmurë. Vizita ka qënë private si profesora qi kam patur. Aty nuk është biseduar gjë me karakter politik.

Në Shkodër kam shkuar për çështje private fejesë e një mbese (vajzë e vëllajt), tjetër marrëdhënie s'kam patur.

Alfred Ashikun nga Shkodra e njoh, i kam vatur në shtëpi nji herë për darkë atje, nji herë tjetrë kam vajtur për vizitë tjetër herë s'mbaj mënd. Kam ndënjur njëherë në kafe të Kojes në Bulevard e kemi pirë nga një birë. Me këtë kemi biseduar muhabete personale të pa rëndësishme, me këtë njihem qysh në fimini.

Jani Dadon e njoh është sekretar i Epishkopatës Gjinokastër dhe këtu shërben si sekretar privizor pranë kryesis së kishës. Ky më ka thënë se kaa 27 (njizet e shtatë) vjet si sekretar i Gjinokastrës, këtu në Tiranë ka një vjet. Me Janin qëndrojmë për gjithë ditën brënda, jashtë, i kam vatur në shtëpi, gjithënjë kemi biseduar çështje kishe dhe administrate, gjithënjë çështje ordinere. Për Kotokon s'kemi biseduar asnjë herë politikisht.

Harilla Teodhosin e kemi drejtorin e pasunive të kishës pranë kryesis ku mer dy mijë (2000) fr.Shq. në muaj rrogë dhe me këtë bisedojmë çështje kishe administrate e kurr gjë tjetër. I kam vajtur në shtëpi për emër, ka ardhur ay dy herë në shtëpinë t'ime ku banoj. Nuk e njoh fare Ligor Koloj, s'kam qënë kurrë në shtëpinë e tij. Na predikojmë kudo që t'i lutemi zotit se na zëmërohet.

Fori Vadhanin e njoh tregëtar, kam blerë moble nga Fori, tjetër marrëdhënie s'kam patur.

Revolusion Frances e kam cekur, kam thënë që mbas Revulicionit Frances feja u hoq por prapë më von u vu. Kam thënë që dhe këtu kërcënohen ret e zeza mbi atdheun t'onë dhe lusim zotin që të largohen këto kërcënime, kjo ishte që grekrit kërkojnë të na marrin Shqipërinë. Unë nuk di në se është thënë kjo fjalë në lidhje me mësimin ee besimit të Francës, nuk më kujtohet prandaj s'mund të përgjigjem se si nga mësimi fetar të futet dhe kërcënimi i Greqisë. Për të thënë i kam thënë, por s'më vjen ndër mënd se në cilin predikim. Për Oficerin e M.P. në predikime e kam zënë në gojë, ku u kam bërë thirrje popullit që të pastrojnë zëmrat e tyre, të ishin të pastrët nga mëkati. Për zëmrat e njerzëve se ç'mendojnë dhe ç'ndjenë veç një zot i di. Nuk mund t'i dijë Oficeri i M.P. si ekzekutues i ligjit as kryetari i zyrës ose familjes as Minis Shef i Zyrës, as njëni tjetrit, vetëm perëndija dhe përpara tij lutemi të na japij fuqi të dalim me zëmër të pastrët. Për oficerin që jep urdhrin ekzekutimin s'kam folë fare, s'është e vërtetë që unë të kem thënë që i ka hyjtyr satanaja dhe ay e urdhënon që të bëjë ato punë.

Unë njoh nji grek Jani nga Greqija, vëndin ekzakt s'ja di, me të jam njohur në shtëpinë e avokat Vasil Dilos, aty më kan prezantuar familja, më thanë që është grek dhe unë i fola me shënja mbasi s'di greqisht e pyeta si je, si i ke të shtëpisë me shëndet, kë ke, ay më tha i kam në Greqi nuk i di. Kam më tha gruan dhe dy kalamaq. Me kaq për këtë radhë mbaruam. Nji herë tjetër kur e takova në shtëpinë e zotit Dilos e pashë tue qit lot (qante) dhe unë e pyeta ç'ke o Jani ay më tha dhe më tundi dorën. Unë e pyeta po letër a i çon më tha jo tjetër s'kemi biseduar.

Unë s'jam marrë kurrë me politikë, kam bërë detyrën t'ime që më është ngarkuar fetare. Gabimet e mija perëndija e di unë nuk di. Tjetër gjë s'kam për të thënë, për

sa përmban procesi m'u kënduan me zë të lartër, pranoj që janë të gjitha thëniet e mija të drejta, për vërtetim i nënshkruaj me firmën t'ime.

Oficeri Hetus I pandehuri
Kapiten Ir (Irene Banushi)

Arkivi i MPB, Fondi 140, Viti 1947, D. 4180, Fl. 18.

Biografija e Irene Banushit.

Është i biri i Nikollit dhe i Nedos ka lindur në qytetin e Shkodrës më 1906 dhe banon në Tiranë, mësimet e para dhe katër vjet Gjimnaz në Gjimnazin e Franceskanëve i ka kryer në hkodër dhe mësimet e nalta shkollën e Fakullit Nethollogjisë në Beograd.

Mbas mbaroj mësimet këthehet nga Beogradi në Shqipëri në vitin 1938 ku emrohet profesor i Seminarit dhe më von profesor i Leceut në Tiranë.

Me ardhjen e fashizmit në vëndin t'onë, ky arestohet prej tyre si Sërbo-Math mbasi kish kryer studimet atje dhe jo si antifashist dhe internohet n'Itali në Provincën e Mantovës. Në qershor të vitit 1940 këthehet nga Italija dhe mbasi qëndron një kohë pa punë në Tiranë dërgohet nga ana e Kryepiskopatës në disa manastire dhe në vjetin 1942 emrohet ndihmës Episkop në Tiranë ku qëndron deri në tetor 1946, kohë kjo që arestohet prej organeve të Sigurimit për arsye se: kish zhvilluar aktivitet kundra Pushtetit, mik i ngushtë i Gjergj Kokoshit, ka pas lidhje të ngushta me Dom Shtjef Kurtin kryefamulltarin e klerit katolik në Tiranë, ka pas marëdhënie me elementë reaksionarë ish nënpunsa të regjimeve të kaluara të tatuar etj, ka qënë inisjator në bashkëpunim me Dom Shtjef Kurtin për t'organizuar vajtjen e klerikëve; orthodhoksë, myslymanë dhe katolikë në Kuvëndin Popullor për të kërkuar faljen e kriminelave të luftës të dënuar nga Gjyqi Special dhe ka predikuar nëpër kisha kundra Pushtetit.

Gjatë kohës në burg ka mbajt qëndrim të mirë dhe me faljen që u bë kohët e fundit përfitoj edhe Ireneu i cili qëndron në shtëpi mbasi është i prekur.

Arkivi i MPB, Fondi 140, Viti 1947, D. 4180, Fl. 19.

SEKSIONI MBROJTJES POPULLIT TIRANËS VDEKJE FASHIZMIT
DREJTORIJA E MBROJTJES POPULLIT LIRI POPULLIT
S. E. M. P.-I Tiranë, më 12 korrik 1945
Nr. 1586 Prot.

DREJTORIS MBROJTJES POPULLIT

K Ë T U

Bashka-ngjitur ju dërgojmë nji raport mbi fjalimin e mbajtur nga Peshkopi Irin në

Kishën e Shën Prokopit dhe këtu poshtë ju shënojmë disa fjalë të opinionit publik, mbassi dual nga kisha:

Ç'ju desh peshkopit të folte në këtë mënyrë, përse e shkartis fenë me politikë.

Ai foli në këtë mënyrë sepse nuk mer më subvensione nga Qeverija, dhe ka për të mbajtur shumë familje, roga që mer nga kisha nuk i mjafton.

Që kur u varros Alqi Kondi pa shkue në Kishë, u pa kjartas se Komunistët nuk kanë fe, tash Peshkopu e din mirë se Partija nuk ka gajle ma për fenë dhe se do të vijë dita që në kishë nuk do të vijë më njeri.

Si qenka e mundur kjo fjalë që thotë Peshkopi se në Shqipëri nuk paska as dhe njeri që të besojë perëndi? Po vehten e tij nuk e zë ay, nuk paska besim ay që falet nat e ditë e çpret prej nesh të veshim të gjithë xhuben e zezë?

Nji prift tha se rëshqiti shumë kësaj radhe siç duket u nevrikos se nuk pa popull hiç në kishë.

SEKSIONI MBROJTJES POPULLIT

SHEF' I SEKSIONIT
(Stefo Grabocka)

Arkivi i MPB, Fondi 140, Viti 1947, D. 4180, Fl. 20.

REPUBLIKA POPULLORE E SHQIPËRISË
MINISTRIJA E P. TË BRENDËSHME
DREJTORIJA E SIGURIMIT TË SHTETIT
Nr. 3125 Tiranë, më 7.XII.1946

SEKSIONIT SIG. SHTETIT

D u r r ë s

I arrestuari Beqir Çela në procesin e tij ka thënë se Peshkop Irenea duke predikuar në kishën e Durrsit, ka folur kundra Pushtetit. Irenea duke predikuar mund të ketë folur edhe herë të tjera kundra Pushtetit. Të hetoni rreth bisedimeve dhe predikimeve të tij të ndryshme dhe të merni deklarata nga persona që e kanë dëgjuar ose që dijnë diçka rreth aktivitetit të tij dhe të na dërgohen për të forcuar akuzën kundra tij mbasi qëndron i arrestuar.

MINISTËR' I P. TË MBREDSHME

Arkivi i MPB, Fondi 140, Viti 1947, D. 4180, Fl. 14-17.

DREJTORIJA E SIGURIMIT SHTETIT
SEKSIONI SIGURIMIT SHTETIT
D U R R Ë S
Nr. 1499 Prot.Res.

Vdekje Fashizmit
Liri Popullit

Durrës, më 4.I.1947

DREJTORIS SIGURIMIT SHTETIT

T I R A N Ë

Gjegje shkresës t'uaj Nr. 05-3125 datë 7/XII/946, që bënë fjalë mbi Peshkop Irenën.

Peshkop Irenen, ka ardhë shpesh herë në Durrës, mbasi kish qejf shumë që t'u bënte Peshkop i Durrësit dhe kish lidhje të shpeshta me elementat e prekur nga reformat e Pushtetit si Petro Spiron, Vangjel Manushin, Alfonc Dovanën dhe shumë tregtar të tjerë të cilët janë tatuar; me ta kish familjaritet të math.

Gjatë meshimeve që ay ka bërë në raste festash ka mbajtur dhe fjalime të rastit; tue thënë që kishën duhet ta respektojmë dhe duhet të vini çdo herë që është festë, pse e shifni seç po bëhet në botë dhe për këtë gjë kanë ardhë gjith' kto mjerime.

Në nji fjalim tjetër Peshkopi Ireniu ka thënë: "në nji mënyrë kërcënuese se Qeverrija e sotme nuk njef zot por Peshkop Ireniu tha: "se kush do që fletë në këtë mënyrë është gabim dhe se kush dëshëron të sjkarohet për këtë gjë, le të vij tek mua dhe do të shohij se unë do t'ja mbush mëndjen se kush ka të drejtë".

Sa herë që ky ka bërë meshime ka mbajtur edhe fjalime të rastit, kto fjalime janë shprehur në një mënyrë ironike gjith'monë me mbrapa kuptime kundra Pushtetit.

Shef' i Seksionit Sigurimit

Kapiten II-të
(Lefter Lakrori)

Arkivi i MPB, Fondi 140, Viti 1947, D. 4180, Fl. 22-23.

DREJTORIJA E MBROJTJES POPULLIT
SEKSJONI MBROJTJES POPULLIT
KRAHINËS
Nr. 376 Prot.

VDEKJE FASHIZMIT
LIRI POPULLIT

Shkodër, me 7/X/1945

Drejtoris Mbrojtjes Popullit:

T I R A N Ë

Me dt. 24 shtator 1945 ka ardhë në ket qytet IRINEJ ILIO BANUSHI. Gjatë qendrimit tijë këtu ka bamë mjaftë lëvizje dhe takime të dyshimta. Ka vizitue familje me nji të kalueme jo të mirë dhe ka pasë takime të shpeshta me elemente kundërshtar të Pushtetit t'onë dhe të pa pajtueshëm me té. P.sh. me Vasil Belkov

i cili para pak ditësh asht lirue nga burgu mbasi ka qenë i arestuem i akuzuem si agjent i Gestapos, dhe Vasil Grabovës njeri i pa kënaqun dhe oportunist. Ka pasë takime gadi për ç'do ditë me Aleks Pllumbin i cili ka qenë agjent i Gestapos i lidhun ngushtë me Ernest Koliqin e tash kundërshtar i rreptë i Pushtetit t'onë Demokratik dhe dyshohet se asht agjent i reaksionit ndër-kombëtar. Kudo ka lëshue parulla dhe biseda e tijë ka pasë si pikë-arritje me e godit Pushtetin dhe me shtue shpresat për nji t'ardhun ma të mirë vetëm nga Englezët dhe Amerikanët. Me këto parulla ka synue me e nda Shkodrën nga vendet e tjera të Shqipnis tue paraqitë se Shkodra asht në sy të keq nga Qeverija. P.sh. ka thanë: "Jam takue me Enver Hoxhën dhe Koçi Xoxe dhe u-kam thanë si po e leni Shkodrën mbas dore mbasi Kisha jonë atje ka dhanë kontributin ma të madh për kauzën e sodshme dhe duhet që populli i Shkodrës të merret me të mirë, ato në vend të përgjegjes kanë luejt vetëm kryet". Ky ka përfundue the thanë: Këta janë njerz të squet prandaj duhet me ndej shpesh herë me ta se merren vesht të gjitha çeshtjet e tyne. Në pyetjet që i kanë bamë në se po i pëlqente jeta në Shkodë, ky asht përgjegjë: Në Shkodër nuk paska gjallni mbasi asht qytet pa përkrahje për arsye se këtu nuk ka misione të hueja e nuk ka kush e kontrollon punën. Kurse në Tiranë puna ndryshon mbasi ka misionet Anglo-Amerikane dhe interesohen për punët t'ona e veçanrisht për Klerin.

Për ardhjen e tijë si i deleguem i reaksionit në ket qytet na e përforcon jo vetëm e kaluemja e tijë si mik dhe i lidhun ngushtë me Gjergj Kokoshin por edhe takimi me elemente të Klerit Katolik dhe pritja e përzemërt që i kanë bam nëpër kuvende të ndryshme. Ka vizitue Kuvendin Françeskan në Lagjn Arra Madhe të këti qyteti. Për nji herë e me shpejtësi ka shkue mbas tijë Pater Frano Kiri dhe mbas nji ore kanë dalë të dy së bashku dhe kanë shkue në Kuvendin e Fretënve ku kanë qëndrue për nji kohë të gjatë.

Me dt. 1/X/45 ndërsa po bante vizitë në shtëpi të Din Shallvarit, familje në fillim pro-Lëvizjes N.Ç. por mbas çlirimit e pa kënaqun dhe e pa pajtueshme me Pushtetin, ka shkue prifti Fratel Gjoni (Jezuit) element shumë aktiv (reaksionar) i cili asht ndërlidhës i Klerit me elemente të jashtëm ku ka ndej afro nji orë.

Siç u theksue ma sipër në përfundim arrijmë me thanë se i përmenduni Irnej Ilia Banushi asht dërgue nga reaksioni i ngarkuem me krijue lidhje me elemente t'opozitës e kryesisht me Klerin Katolik. Të njajtin mision siç duket ka edhe SUAD ASLLANI i cili që momentin që ka ardhë asht takue me elemente të dyshimtë dhe mund të thomi me kokën e reaksionit. P.sh. me Rexhep Mborjen e Rrahim Sokolit. Baba i këti të fundit Isuf Sokoli ka qenë për shumë vjet në: Konsullatën Jugosllave. Ka tendenca Masonike, Brahimi element aktiv i Legalitetit dhe Sekretar personal i Sali Myftis (tash ilegal) i cili ka qenë Kryetari Komitetit Qarkor të Legalitetit për Shkodër.

Irinej Ilo Banushi asht takue edhe me Luigj Dajçin me tendenca Masonike e me të quejtunin Jasho Baroviq ky i fundit me kombësi jugosllave dhe që ka qenë nënpunës i Legatës i ish Jugosllavis së Karogjorgjeviqve, i cili ka qenë dhe asht i lidhun ngushtë me Isuf Sokolin. Gjithashtu dhe Jasho që në kohën e regjimit të Zogollit ka pasë tendenca masonike. Nga kjo shifet që të dy kanë ardhë për të njajtin qellim mbasi takohen me elemente të ndryshëm por që janë të lidhun ngushtë me

njeti tjetrin e që ushqejnë të njajtat tendenca.

Mendojmë se po me ket mision që lanë ardhë dy të sipërmit këtu kanë shkue në Tiranë Pater Donat Kurti Drejtor i Liceut të Jezuitve, Pater Benedikt Duna, Dom Gasper Ndoci, Prof. Njac Zamputi (i lidhun ngushtë me Klerin) dhe Prof. Kol Kamsi.

Irinej Ilio Banushi ka pasë takime edhe me elemente që nuk janë dukë në skenën e aktivitetit politik. P.sh. Tom Petriçi i cili ka jetue në Jugosllavi bashkë me Aleks Pllumbin dhe shokë i ngushtë i tijë por deri tash nuk dihet të ketë zhvillue ndonji veprimtari me karakter politik me gjithë që nuk merret me asnji punë si dhe me Paulo Staniq e Miho Mihaili po kështu edhe këta nuk kanë zhvillue ndonji aktivitet politik.

Jo vetëm me ket rast; por në kohët e fundit asht vrejtë nga të gjitha drejtimet nji metodë e ré e punës së reaksionit e ndryshme nga ajo e para tri javëvet. Kudo shifen përpjekje me krijue lidhje të reja p.sh. Riza Kuçi që ban pjesë në grupin e Selim Kerlukut ka thanë: Do të vazhdoj po munda me i shtue lidhjet. Ket mendim e përforcon fakti se elementat e dyshimtë nuk shifen n'aktivitet si grup dhe me elemente të vjetër; por përkundrazi elementet e vjetër janë shpërnda për të zgjanue lidhjet. Si rezultat të kësajë taktike kemi që shumë elemente të rijë që ma parë nuk janë dukë në lëvizje tash shifen të takohen me pjestar të grupeve të ndryshme. P.sh. me Rexhep Mborjen apo me elemente të grupit tijë shifen elemente që nuk janë pa ma parë po kështu ngjet edhe me elemente të grupeve të Gjelosh Lulit e Zef Mirditës etj.

Mbi sa u përshkrue ma sipër del si rezultat se reaksioni përpiqet me nxjerrë në shesh nji opozitë të përfaqsueme nga elemente me tendenca "MASONIKE" mbasi elementet e kësajë tendence me në krye Mirash Ivanaj janë të pa kompromentueme dhe n'anë tjetër si anti fetare (në dukje) paraqitet para popullit rryma ma e afërt me Partinë Komuniste që kjo e fundit ka fillue të gëzojë simpati ndër masa.

Shefi Seks. M. Popullit:

(Zoi Themeli)

Arkivi i MPB, Fondi 140, Viti 1947, D. 4180, Fl. 24.

VDEKJE FASHIZMIT LIRI POPULLIT
Tiranë me 8.7.945

R A P O R T

Mbas mbarimit të meshës së mbrëmjes në Kishën e Shën Prokopit, në ora 9 foli Hirësija e Tij Peshkopi Irin. Fjalimi i tij pati një ton të egër politik dhe një ton të një predikimi fetar. Populli që në fillim u trondit nga fjalët dhe që në fillim shikonin njëri tjetrin me habi. Disa prej grave bënin sikur gërvishnin fytyrën duke thënë me sa të ulët "Ç po flet ky kështu". Raporti jonë mund të paraqitet i thatë, mbasi në një fjalim si ai, rolin më me rëndësi e luante toni dhe mënyra e shprehjes që bënte. Po ju shkruajm disa pjesë të fjalimit. E filloi duke treguar këtë pjesë të ungjillit

- "Një ditë fryma e shenjtëruar, e zemëruar, zbret nga qielli në formë njeriu. Rrugës takon me Avramin, i cili e pyet se ku po shkonte. Fryma e shenjtëruar i përgjigjet duke thënë se po shkonte në një qytet të cilin do ta shfarroste krejt dhe të mos i mbetej as një nishan. Arësyeja ishte sepse populli i atij qyteti nuk besonte ma në Perëndi dhe se në atë qytet bëheshin punë të pa ligjëshme. Avrami ju lut që të kishte mëshirë dhe të mos merrte masa të tilla mbasi në atë qytetë mund të ndodheshin shumë njerëz që besonin në Perëndija. Perëndija atëhere tha se do ta falte qytetin në se aty brenda kish 100 besimtarë të Perëndisë. Avrami i thotë: Po sikur të mos jenë 100 plot por të jenë më pak 90-80-70 e më poshtë a do të kishe mëshirë? Fryma e shenjtëruar pasi u mendua pak tha se do ta kishte falur krejt qytetin sikur atje të ndodhesh një person që të besonte në Perëndia. Të nesërmen gjith qyteti u bë shkrumb e hi dhe nuk mbeti as një frymë e gjallë"-

Po në këtë gjendje paraqiti dhe gjendjen këtu në Shqipëri, duke thënë se këtu populli po bën punë të pa ligjëshme dhe është larguar fare nga Zoti. – "Zoti është zemëruarë shumë për këtë gjendje dhe të vetmit që e mbajnë në këmbë dhe me jetë sot popullin shqipëtar janë fëmija e vogël, të cilët janë krijesa e paqme dhe të pafajshëm mbi çka ngjet në vendin tonë – Për hatër të këtyre, tha Peshkopi, kërkoj që populli t'i dëgjoi këto fjalë, t'i kthente sytë dhe një herë te Perëndija, ndoshta atij do t'i vinte keq dhe mund ta falte popullin fisnik Shqipëtar"-

Pastaj tha: "Po u drejtohem udhëheqësave të popullit, shkencëtarve të këtij vendi, të shikojnë gjendjen kritike në të cilën po mbaron populli i jonë, të forcojnë sa më shpejtë besimin e Perëndisë në popull".

Pastaj në formë lutjeje kërkoi që të ndodhej ndonjë nga misat e Qeverrisë, për të pasur ndonjë e të dëgjonte këto fjalë dhe të rrënjosej prapë në zemrën e tij Besimi te Perëndija (këto fjalë i tha me një zë shumë të fortë dhe me një ton shumë ironik. Populli që i kishte hapur sytë dhe i kish ngulur në gojën e Peshkopit u drejtua si i trembur tek neve dhe priste se ç po bënim, shikonte të gjitha lëvizjet tona. Njëri nga oficerat e Artilerisë desh të shkonte dhe ta kapte Peshkopin prej mjekre dhe t'i përgjigjej fjalëve të tija reaksionare, partizanët që qenë atje u revoltuan dhe u prekën shumë). Peshkopi vazhdoi dhe më gjatë dhe e përfundoi në këtë mënyrë:

- "O krishtenët e mij! A e shifni se si prej katër muaj e gjysëm zoti nuk na ka lëshue as dhe një pikë shi; zoti ka vendosë që neve të na çfarrosë, është zemërue prej neve se pse as njeri prej nesh nuk ka ma besim në të. Le të gjunjëzohemi përpara altarit të Zotit dhe të madhit shejtit tonë Prokop, që të kenë mëshirë për neve, të mos na vdesin urije, dhe të na dërgojnë sa ma shpejtë shi"-

Arkivi i MPB, Fondi 140, Viti 1947, D. 4180, Fl. 26

DREJTORIJA E MBROJTJES POPULLIT — VDEKJE FASHIZMIT
SEKSJONI MBROJTJES POPULLIT SHKODËR — LIRI POPULLIT
S. E. M. P-i
Nr. 1501 Prot. — Shkodër, me 27/XI/946

L a n d a: Dërgojmë akuzat-e Ilia Banushit.

DREJTORIS SIGURIMIT SHTETIT

T I R A N Ë

Ju njoftojmë se ka një vjetë që Irinea (Ilia) Banushi që sot ndodhet në burgun e Tiranës ka qenë në Shkodër.

Ky si mbas informatave të sigurta që kemi del se në shtëpin e tij në Shkodër, kanë shkuar dia herë për vizitë nga priftërinjtë katolik dhe kanë ndejur duke biseduar me nga dy tre orë rrjeshtë. Seç klanë biseduar nuk dihet. Ka ba lëvizje të dyshimta me njerz të dyshimtë si me Aleks Pllumbin e tjerë. Nji nga faktet që na siguron se ky është kundër Pushtetit të sotshëm asht se kur mbesa e tij, Marta ka shkuar në Tiranë për t'u fejuar dhe aty ka ndejur për nji kohë të gjatë, ky e ka ndaluar të shkojë n'organizatën e Grues, këjo (Marta) këtu në Shkodër, ka qenë Kandidate Partije por me frymzimin që i bën ky kësaj, këjo kur vjenë në Shkodër bahet kundërshtare e lëvizjes dhe e organizatës së Grues, e gjithë këjo ka ardhur pse ky e ka ndaluar dhe frymzuar për punën që bënte.

Shefi Sek. Sigur. Shtetit — M a j o r
(Zoi Themeli)

Arkivi i MPB, Fondi 140, Viti 1947, D. 4180, Fl. 27

Drejtoria e sigurimit shtetit
Seksioni sigurimit shtetit
T i r a n ë
Nr. 1204 Prot. — Tiranë, më 3/IV/1946.

DREJTORISË SIGURIMIT SHTETIT

T i r a n ë

Ju njoftojmë se me datën 18.8.1946 në Kishën e Evangjelizmojit u mbajtë nji fjalim nga Peshkopi Irine. Mbas këndimit të ungjillit që tregonte se si një babe i vuante djali nga sëmundja e demonëve ky ju paska lutun Jezu Krishtit për nxjerjen nga trupi i të birit, për të shëruer këtë Krishti paska bërë zakonet e tija dhe e paska shëruar. Irenen duke prurë shembullin e këtij ungjilli tha ndër mjet të tjerave se

edhe në Francë në kohën e revolucionit Frances, kishte hyrë Satanaj në trupin e disa njerëzve dhe bënte ç'mos për të larguem popullin nga Kisha, por nuk ja mbrijtën qëllimit, pse drita e vërtetë e fesë nuk mund të zhduket asnji herë e tje. Ireneu për ta bërë këtë predikim të dy anëshëm tha se edhe në vendin t'onë janë parë ose mund të vijnë disa re të zeza, por këtu e këtheu fjalën duke thënë se Satanaj bën ç'mos që në Konferencën e Paqes të mos na njifen të drejtat t'ona etj.

Tue vazhdue predikimin mbi Satanan tha se ashtë ky që hyn në trupin e njeriut dhe vendos për një punë që ndofta s'duht bërë. Ku mund ta dijë nji Oficer' i Mbrojtjes Popullit se ç'far qëllimi ka njëri ose tjetri, por asht satanaj që hyn në këtë mes, dhe kur nji Komandant' jep urdhën për ekzekutimin e njerit ose tjetrit prapë ashtë satanaj ay që e udhëzon. Por ka shumë njerëz që dërgohen për të kryer të këtilla vepra e çojnë mendjen tek shpëtimtari i jonë që në ç'do rastë nuk mungon për të përkrahun ato që pendohen, dhe vetëm me pendime dhe lutje mundet atij njeriu t'i falen mëkatet kështu sikundër Jesuj ngjalli djalin që përmend ungjilli i sotëm.

Këtu duket qartë se Peshkopi Ireneu kishte për qëllim të diskreditonte pushtetin t'onë tue përzie me predikimin Oficerin e Mbrojtjes Popullit dhe Revolucionin Frances.

Kaq për dijeni.

SHEF' I SEKSIONIT M a j o r :
(Vango Mitrojorgji)

Arkivi i MPB, Fondi 140, Viti 1947, D. 4180, Fl. 28-32.

V. F. L. P.
Mbrojtja e të pandehunit Irene Banushi

Z. Kryetar
ZZ. Gjyqtarë
E nderuara Akuzë

I pandehuni Irene Banushi akuzohet të ket shërbye okupatorin gjat okupacionit, se mbas çlirimit nën maskën fetare të ket propagandue, axhitue kundër Pushtetit Popullor tue dashtun me revoltue masat për rëzimin e Regjimit Popullo me dhunë, të ket përkrahur vijën e pa drejtë të neo fashistëve grekë.

Se ka qënë në lidhje me armiqt e popullit Gjergj Kokoshi etj. e se ka patur dijeni të veprimtaris s'organizatës teroriste të kryesuem nga Sami Qelibashi.

Për sa i takon kohës s'okupacionit, gjat gjith procedimit gjyqsuer, mua nuk më rezulton ndonjë fakt që të provojë bashkëpunimin e të pandehunit me okupatorët nazi fashistë.

Nga deponimet e të pandehunit përkundrazi rezulton se Irene Banushi në kohën e okupacionit ka qënë i burgosun dhe i internue nga fashistët. Gjat asaj

periudhe ay ka kontribue në mënyrë të ndieshme, tue kalue shpesh edhe reziqe, për t'u ardhur në ndihmë elementave aktivë të Lëvisjes N.Çl. Irene Banushi ka mundun me u shpëtue jetën shum luftëtarve të liris shqiptarë dhe jugosllavë. Ay posht e lart me iniciativën e tij, ka mbledhun ndihma për shtetasit jugosllavë të ndjekur nga fashistët barbarë. Për këtë veprimtari i pandehuni ka patur nderin të takohet me Ministrin e Punve të Jashtme të Republikës Federative të Jugosllavis, i cili me rastin e vizitës së tij zyrtare në Tiranë, e ftoj të pandehunin për drekë dhe personalisht i çfaqi përgëzimet dhe urimet e Mareshalit Tito për shërbimin që u kishte bërë jugosllavëve të cilët të ndjekur këmba këmbës nga terori nazi fashist ishin të detyruar të jetonin përkohësisht jashtë vendit të tyne.

Deklarata e Dhimitër Andonit në lidhje me këtë akuzë nuk duhet të meret parasysh mbasi nga faktet që u vunë në dukje në seancat e kaluara të Irene Banushit gjat okupacionit.

Për sa i takon akuzës së dytë, në dosarin e të pandehunit ndodhen një deklaratë

Deklaratë

I nënëshkruari Telemak Dilo nga Gjirokastra banues në Tiranë, deklaroj për të quajturin Episkop Irene Banushi sa më poshtë vijon: Ireneu vinte shpesh tek na mbassi baba ishte antar i Kishës. Nji ditë aty në muajin qershor ose korrik të 1946 jam ndodhur edhe unë prezent aty ndërmjet bisedave që kishin me babën tim Vasil Dilo, Irene, tha: Më foli Ministri Konomi dhe më tha: Do të shkosh në Gjirokastër por do të mbajsh nji fjalim politik kundra Kotokos, unë i u përgjegja nuk mund të mbaj fjalim politik kontra Kotokos se e kam vlla prej Krishtit.

Për këtë shkak nuk më lejuan të shkoj në Gjirokastër. Këto fjalë jam gati në çdo kohë qi tja them në ballafaqim Ireneut.

Tiranë 26-III-47. Deklaruesi
Telemak Dilo

Deklaratë

I nënshkruemi Dhimitër Antoni, i bir' i Veniaminit dhe i Fllorës, i dat-lindies 1922, lindun e banues në Tiranë deklaroj sa vijon mbi Iriné Banushin:

E kam pasë njoftë Irinenë që kur isha student. Q'atëhere ishte njeri me influencë n'organet e okupacionit. Kishte lidhje të ngushta me Kuestorin e policisë Pandeli Papalilo. Babën t'em e këshillonte gjithëmonë që të fliste mua dhe vëllajt t'im qi të hiqnin dorë nga lëvizja.

Kam asistuar në inaugurimin e kishës së ré të Shën Prokopit dhe bashkë me disa oficera dhe partizanë kemi ndigjue predikimin qi mbajti ay (Irineu). Predikimi i tijë ishte krejt kundra pushtetit të sotëm. Krejt të këqijat që na kishin ardhur nga okupacioni fashist si edhe thatësirën që kish ngjarë atë vit nga mos rania e shiut, ay i nxirrte si rrjedhime të pushtetit popullor i cili largonte njerëzit nga besimi ndaj zotit dhe ishte ba shkas të përhapej kurvërija dhe vëllavrasja. Për këte ay tregoj nji ngjarje që kish ndodhur në nji qytet afër Jerusalemit, ku zoti i kish mbytur dhe

djegur të gjithë banorët, duke përfshirë dhe fëmijt e vegjël, nga se ishin largue nga feja, kishin fillue të vrisnin njeni tjetrin etj.

Predikimi i tijë na revoltoj të gjithëve aq sa partizanët deshtën t'i përgjigjeshin aty dhe t'a nxirrnin jashtë me të rrahura; populli i gjithë kafshonte buzën dhe habitesh mbi sa folte Irineu.

Kam ndigjue dhe nji predikim t'Irineut natën e Pashkës së madhe. Ay e paraqiti gjendien si ma parë dhe nxori kushtrimin qi të mblidheshin të gjithë besnikët orthodoksë për të shpëtue krishterimin. Ay çfaqi keq'ardhien për kriminelët e luftës dhe kërkoj që mos të merresh ndonji dënim q'ata të prisheshin trupërisht. Ay bëri lutje që pushteti t'ishte ma dorëgjërë në dhanien e dënimeve. Edhe në këtë rast populli habitesh se si Irineu kishte kurajën të predikonte kundra pushtetit kaq haptas dhe të thonte krejt të palarat për atë pushtet q'u ngrit nga vetë populli që luftoj dhe vuejti aqë vjetë.

Tiranë 10/II/47. Vdekje Fashizmit – Liri Popullit

Deklaruesi
(Dhimitër Antoni)

Arkivi i MPB, Fondi 1, Viti 1953 , D. 3177, Fl. 3.

Në Tiranë më 25.VIII.1952.

1. Emri dhe mbiemri: Irene Banushi.
2. Atësija, amësija: Nikolla dhe i Nedos.
3. Datë lindja, vënd lindja dhe vënd banimi i përherëshëm: Më 1906, në Shkodër, Shënavlashë, Durrës – Tiranë.
4. Vënd banimi i fundit: Shënavlash Durrës.
5. Shtresa:
6. Kombësija dhe nënshtetësija: Shqiptare.
7. Profesioni: Klerik (Episkop).
8. Vëndi i punës dhe detyra: pa punë.
9. Besimi: Orthodhokës.
10. Gjendja familjare, i martuar, beqar ose i divorcuar: I pa martuar.
11. Emrat dhe moshat e grua dhe të kalamajvet: Nuk ka.
12. Në se ka kryer shërbimin ushtarak ose jo, në çfarë repart dhe kohë: Nuk ka bërë shërbim ushtarak.
13. Arësimi dhe sa gjuhë të huaja shkruan dhe flet: Gjashtë Klasë Seminar në Cetina Jugosllavi dhe fakultetin Teollogjik në Beograd, Shqip, Jugosllavisht.
14. Në se është i organizuar A.P., K.P. ose në Rinin Popullore: Nuk është i organizuar.
15. Në se ka bërë pjesë në organizata tradhëtare të regjimeve të kaluara: Nuk ka bërë.

16. Në se është dënuar ndonjë herë, për se nga cili gjyq dhe sa kohë ka vuajtur dënimin: Është dënuar më 1946, nga Gjykata Ushtarake, për aktivitet politik dhe liruar më 1949.

I akuzuari
(Irene Banushi)

Arkivi i MPB, Fondi 1, Viti 1953, D. 3177, Fl. 11.

A P R O V O H E T
ND.MINISTRI P.TË MBRËNDËSHME
N/KOLONEL
(NIKO CETA)

SANKSIONOJ PROK. I PËRGJITHËSHËM
I REPU. POPULLORE TË SHQIPËRIS

Gusht 1952.

U R D H Ë R E S Ë
(Për arest)

Unë oficer i Ministris Punëve të mbrëndëshme (Drejtoris Sig-shtetit) Kapiten I-rë Maliq Jaupi në shikimin që bëra matrijaleve të quajturit Irene Banushit i biri i Nikollës dhe i Nedos, lindur në Shkodër më 1906, me profesjon klerik me gradë Episkopë, me arsim gjashtë klasë seminar në Cetinë Jugosllavi dhe fakultetin e Theollogjis në Beograd, i pa martuar, i dënuar për aktivitet armiqësor në vitin 1946 dhe liruar në vitin 1949 me shtetësi dhe kombësi shqiptare, i fesë orthodhokse.

G J E T A

Irene Banushi për aktivitet armiqësor kundër Pushtetit është arestuar dhe gjykuar më 1946, dhe në vjetin 1949 lirohet nga burgu. Edhe mbas lirimit vazhdon aktivitetin e tija armiqësor; si klerik dhe Episkopë që është ka çfrytëzuar gjith autoritetin dhe influencën e tija për të penguar kishën orthodhokse autoqefale të Shqipërisë që të mos heci në rrugën e Pushtetit popullor dhe të paqes. Në bashkpunim me elementa të tjerë shokë të tija, kanë kurdisur intriga dhe shpifje kundër udhëheqsave të kishës autoqefale të Shqipërisë me qëllim për t'i diskreditуar dhe më në fund për t'i hequr nga posti dhe për ta kthyer kishën orthodhokse kundra vijës që ndjekë sot për të zhvilluar në të aktivitet kundër Pushtetit.

Irene Banushi element armik i Pushtetit dhe që paraqet rrezikshmëri për Republikën tonë Popullore i shtyrë nga urrejtja që ka kundër Pushtetit dhe për t'u shërbyer armiqëve është interesuar dhe ka mbledhur informata të ndryshme në vendin tonë dhe sidomos në portin e Durrësit mbi eksportimet dhe importimet që sjell shteti i jonë nga jashtë, sidomos nga ato që vijnë nga Bashkimi Sovjetikë se mos këto vamporre sjellin matrijal luftarak.

Në mbështetje të fajeve të sipërme :

V E N D O S A
Arestimin dhe kontrollimin e Irene Banushit.

Oficeri Sigurimit
Kap.I- (MALIQ JAUPI)

P Ë L Q E H E T
KOM. REPARTIT 2011
Major (RASIM DEDJA)

Arkivi i MPB, Fondi 1, Viti 1953, D. 3177, Fl. 29.

REPUBLIKA POPULLORE E SHQIPËRISË V.F.L.P.
MINISTRIJA E PUNVE TË MBRËNDSHME Tiranë më____1953
GJYKATA SPECIALE E SIGURIMIT
Nr. 172 Regj. Temeltar
Nr. 17 Vendimit

A K T - V E N D I M
NË EMËR TË POPULLIT SHQIPTAR
GJYKATA SPECIALE E FORMUAR PREJ:
N/Kolonel – Nevzat Haznedari – Kryetar
M a j o r – Muço Salo – Antar
Kapiten' i I-rë – Dhimittër Gjoni – Antar

Duke qënë prezent dhe prokurori i gjykatës speciale kapiten' i I-rë Xhavid Struga si dhe sekretari Aspirant Safet ____ja me datën 9/4/1953.

V E N D O S I

Në padije penale të regjistruar Nr _____ të regjistrit themeltar të vjetit 1952, kundër të pandehurit irine Banushi, i biri Nikollës dhe i Nedos, lindur më 1906 në qytetin e Shkodrës, me profesion Klerik, me gradë Episkop, me arsim 6 klasë seminar në Cetinë të Jugosllavis dhe fakultetin e Theollogjis në Beograd, i pa martuar, i dënuar një herë për aktivitet armiqësor në vitin 1946 dhe i liruar në vitin 1949, me shtetësi dhe kombësi shqiptar i fesë orthodhokse, i paraburgosur më datën 25/VIII/1952.

I – A K U Z U A R – S E :

Ka neglizhuar besimin e dhënë nga organet e sigurimit, dhe ka zhvilluar aktivitet kundër kishës orthodhokse.

G J Y K A T A

Mbasi ndëgjoj proces-verbalin e mbajtur kundër të pandehurit mbasi ndëgjoj apollogjin e të pandehurit, mbasi ndëgjoj pretencën e prokurorit, i cili kërkoi dënimin e tij me 5 vjet privim lirie, mbasi ndëgjoj mbrojtjen e avukatit, mbasi shqyrtoj çështjen në fakt dhe në liq.

K O N S T A T O N – S E :

Ka zhvilluar aktivitet kundër kishës orthodhokse autoqefale të Shqipërisë dhe ka nxitur elementa të tjerë për të shpifur kundër kryesis kishës, me qëllim që të diskretitoj udhëheqjen e saj dhe më në fund për t'a hequr nga posti dhe mandej, për të kthyer kishën orthodhokse autoqefale të Shqipërisë kundër vijës që ndjek sot.

Duke qënë bashkëpuntor i organeve të sigurimit, për nji kohë mjaft të gjatë, dhe asnjë herë, nuk ka dhënë asgjë për organet e sigurimit, por qëllimisht ka neglizhuar dhe përdhunuar besimin e dhënë.

P R A N D A J

Trupi gjykues duke qënë i njëmendimi dhe me kërkesën e prokurorit, i cili kërkoi dënimin e tij me 5 vjet privim lirie.

V E N D O S I

Dënimin e të pandehurit Irine Banushi me 5 vjet privim lirie në bazë të nenit 171 në armoni me nenin 44 të K.P. të Republikës Popullore të Shqipërisë.

KY VENDIM KA FORMËN E PRERË.

U SHPALL MË DATËN 30/V/1953

Arkivi i MPB, Fondi 1, Viti 1948, D. 1302/IIA, Fl. 1-2.

REPUBLIKA POPULLORE E SHQIPNIS
USHTRIJA KOMBËTARE SHQIPTARE — Vdekje Fashizmit
Gjykata Ushtarake e Shkodrës — Liri Popullit

PROÇES – VERBAL

Prokurorija Ushtarake e Zonës Ushtarake të Shkodrës, me akt-akuzën e sajë me Nr. 2 datë 2/I/1948, i solli kësaj gjykate aktetë hetimore të rjedhura kundra të pandehurve: Monsinjor Gjini, Dom Nikoll Deda, Pader Mati Prendushi, Dom Tom Laca, Zef Haxhija, Dom Ndoc Sataçija, Pader Gjon Karma, Pader Mhill Miri, Zhakoj, Zef Pllumbi dhe Dom Shelqeti, për fajin se: Kanë punuar për ardhjen e fashizmit dhe për okupimin e vendit t'onë nga imperjalizmi italjan. Qysh para okupacjonit kanë qenë agjenta politikë dhe spiunaxhi t'imperjalizmit Italjan. Gjat okupacjonit kanë punuar për fashistizimin e vendit. Kanë punuar për të legalizuar okupacjonin armik. Me anë të agjitacjonit dhe të propogandës fashiste janë përpjekur të shuajn ndjesit patriotike dhe nacionale të popullit. Kanë qenë penges serioze e L.N.Ç. Kanë punuar për eliminimin e kësaj lëvizje. Kanë ndihmuar dhe kanë bashkëpunuar me të gjith organizatat kriminale gjat okupacjoneve. Kanë përkrahur dhe ndihmuar tërë qeverit kuislinge të kohës okupacjoneve si dhe politikën e tyre renegate. Kanë praktikuar të gjitha mjetet e mundëshme dhe ç'do lloj metode për të shuar ose penguar deri në fund rezistencën e popullit. Gjat okupacjonit gjerman janë bërë agjenta të gestapos duke denoncuar në zyrat sekrete të saj militantët e L.N.Ç. Kanë ndihmuar repartet dhe

formacjonet armike e bashibozuke kur shkonin ndër krahina për të luftuar partizanët. Mbas Çlirimit të Shqipëris të tmeruar nga Pushteti në dorë të popullit, hidhen me egërsi dhe ma me tërbim kundër Popullit dhe Pushtetit. Me qëllim që të godasin Pushtetin ma me forcë i'a fillojnë organizimit të tyre për mbrenda klerit katolik ndën kryesin e Monsijor Gjinit, Dom Nikoll Dedës, Pader Mati Prendushit, Monsinjor Volaj etj. krerë klerikalë. Organizimin e tyre e fillojnë duke e transformuar gjith klerik katolik në një organizatë fashiste të qujtur Demo-kristjane. Zgjedhin Komitetin Qendror me elementat e sipër përmendur si Monsinjor Gjini, Monsinjor Volaj, Dom Nikoll Deda, Pader Mati Prendushi etj. si dhe civilat Zef Haxhija me shokë. Në vendimet e Komitetit Qendror, kan specifikuar formimin e Komiteteve e N.Komitete të kësaj organizate ndër famullira të ndryshme ndër krahina. Lidhjen me t'arratosur mbrenda dhe jasht shtetit si dhe me ç'do organizatë teroriste mbrenda shtetit. Lidhjen me imperjalistët e huaj dhe me ç'do armik të vendit t'onë. Kordinimin e luftës kundër Pushtetit me ç'do kundërshtar të Pushtetit. Pregatitjen e një kryengritje imediate t'armatosur për kundër Pushtetit. Të gjith këto vendime të pandehurit bashkë me shokët e tyre i kanë vënë në zbatim duke u lidhur me t'arratisurit, duke dërguar memorandume imperjalistëve të huaj. Formuan Komitetin e Përbashkët t'organizatës teroriste për Shkodrën duke u përfaqsuar në këtë organizatë nga Dom Nikoll Deda. Kanë zhvilluar propogand të gjerë për formimin e kryengritjes kundër Pushtetit (karakteristik) përpjekja e 9 Shtatorit 46. Nga të pandehurit Zef Haxhija ka qenë antar i Komitetit Qendror të Demo-kristjanes. Ka trathëtuar besimin e Popullit, si përfaqsues i popullit në Kuvendin Popullor duke u lidhur me organizatat teroriste fashiste e profashiste të cilat ijshin për rrëzimin me dhunë të Pushtetit Popullor. Faje këto të parashikuara prej neneve 2, 3, (pikat 1, 2, 4, 6, 7, 8, e 14) dhe nenit 4 të Ligjës Nr. 372 mbi fajet penale kundra Shtetit dhe Popullit.

Këto akte mbasi u rregjistruan nën Nr. 17 të Radhorit Themelor për dit gjyqi u caktua data 6 Jenar 1948, ditën e Martë, ora 10 para dreke.

Shkodër, me 2/I/1948.-

Arkivi i MPB, Fondi 1, Viti 1948, D. 1302/IIA, Fl. 2-6.

Sekretari Kryetari

Ditën dhe orën e sipërme trupi gjykues u formua si vijon:

Kryetar	Kapiten I.rë	Misto Bllaci
Antar	N/Toger	Anastas Koroveshi
Antar	N/Toger	Xhemal Bejtja

Duke qenë gadi Prokurori Kapiten Naim Qemali dhe Sekretari i Gjykatës Shaban Qamil Dautaj.

U suallën të pandehurit nga burgu.

U pyet identiteti i tyre dhe thanë se quhen:

1).- Monsinjor Frano Pjetër Gjini, i biri Pjetrit, dhe i Dranes, vjeç 62, shqiptar, i pa

martuar, i pa dënuar, i varfër, ka mbaruar Theollogjin, me profesjon Ipeshkv, lindur në Shkodër dhe banues në Shkodër, i reshtuar me datën 15/XI/1946.

2).- Dom Nikoll Zef Deda, i biri Zefit dhe i Ages, vjeç 58, i pa martuar, i pa dënuar, i varfër, ka mbaruar Theollogjin, famulltarë, ka vëllaun në burg dhe një vëlla t'ekzekutuar, lindur në Shkodër dhe banues në Hajmel, i reshtuar me datën 13/X/1946.-

3).- Pader Mati Prendushi, i biri Kolës dhe i Prendës, vjeç 66, i pa martuar, i pa dënuar, shqiptar, i varfër, priftë, ka mbaruar Theollogjinë n'Austri, në burg ka nipin e tij Paolin Prendushin, lindur dhe banues në Shkodër, i reshtuar me datën 15/XI/1946.-

4).- Dom Tom Laca, i bili Palokës dhe i Dranes, vjeç 51, i pa martuar, i pa dënuar, me gjendje ekonomike të mesme, ka mbaruar Theollogjin në Rromë, me profesjon prift, në burg ka djalin e motrës Zef Palin, nga Shkodra, i reshtuar me datën 14/X/1946.-

5).- Zef Kol Haxhija, i biri Kolës dhe i Gjystes, vjeç 58, i martuar me 8 fëmij, i varfër, ka mbaruar shkollën teknike tregtare, mandej ka vazhdue Gjimnazin Ushtarak Turqisht, nga Shkodra, i pa prekur nga reforma, ish deputet, i reshtuar me datën 20/XI/1947.-

6).- Dom Ndoc Sahatçija, i biri Rrokut dhe i Nushes, vjeç 41, i pa martuar, i pa dënuar, i varfër, ka mbaruar Theollogjinë, me profesjon Ipeshkv, lindur në Breg të Matës, i reshtuar me datën 26/6/1947.-

7).- Pader Gjon Karma, i biri i Franos dhe i Diles, vjeç 52, ka mbaruar Theollogjin në Austri dhe Rromë, i pa martuar, i pa dënuar, shqiptar, me profesjon famulltar, lindur në Gur të Zi, i reshtuar me datën 10/XI/1946.- Vdek 1975.

8).- Dom Nikoll Shelqeti, i biri Hilës dhe i Diles, vjeç 55, i pa martuar, i pa dënuar, i varfër, ka mbaruar Theollogjin dhe Fillosofin në Austri, me profesjon prift e famullitar, lindur në Shelqet, i reshtuar me datën 20/XII/46.-

9).- Pader Mhill Miraj, i biri Pjetrit dhe i Prendës, vjeç 39, shqiptar, i pa martuar, i pa dënuar, i varfër, ka mbaruar Theollogjin në Romë, ish profesor e zëvendës famulltar, nga Shkodra, i reshtuar me datën 20/X/1946.-

10).- Zef Gjeto Pllumbi, i biri Gjetos, dhe i Lukës, vjeç 22, i pa martuar, i pa dënuar, lindur në Bogë të Koplikut dhe banues në Mal të Rencit në Lesh, me profesjon xhaku, ka krye të tretin kurs Theollogjik, ka t'ekzekutuar Mark Mirin e Zef Mirin, dhe t'arratisur djalin e dajës, i varfër, i reshtuar me datën 15/X/1946.-

U këndua akt-akuza e Prokuroris, përmbajtja e së cilës është përshkruar në parathënjen e këtij proçesi.

Prokurori përsëriti akt-akuzën.

Arkivi i MPB, Fondi 1, Viti 1948, D. 1302/IIA, Fl. 15-19.

N'EMËR TË POPULLIT SHQIPËTAR

Kshilli Gjykatës Ushtarake të Zonës Ushtarake të Shkodrës i formuar:

Kryetar	Kapiten I.rë	Misto Bllaci
Antar	N/Toger	Anastas Koroveshi

Antar N/Toger Xhemal Bejtja

Duke qenë gati Prokurori Kapiten Namik Qemali dhe Sekretari Shaban Qamil Dautaji.

Në udjencën publike me datë 8/Janar/948, ka dhënë këtë:

V E N D I M

Në çështjen penale të rregjistruarë nën Nº.17 të Radhorit Themelor për vjetin 1948, kundra:

1).- Monsinjor Frano Pjetër Gjini, i biri Pjetrit dhe i Dranes, vjeç 62, shqipëtar, i pa martuarë, i pa dënuarë, i varfër, ka mbaruarë theollogjin, me profesion Ipeshkv dhe Regjent Delegat Apostolik, lindur e banues në Shkodrë, i rreshtuarë në datën 15/XI/946.-

2).- Dom Nikoll Zef Deda, i biri Zefit dhe i Ages, vjeç 58, i pa martuarë, i padënuarë, i varfër, ka mbaruarë Theollogjin, famulltar, ka vëllan në burg dhe një vëlla t'eksekutuarë, lindur në Shkodrë e banues Hajmel, i rreshtuarë me datën 13/X/946.

3).- Padre Mati Prendushi, i biri Kolës dhe i Prendës, vjeç 66, i pa martuarë, i pa dënuarë, shqipëtar, i varfër, prift ka mbaruarë Theollogjin n'Austri, në burg ka mipin e tij Paolin Prendushin, lindur dhe banues në Shkodrë, i rreshtuarë me datën 15/XI/946.

4).- Dom Tom Laca, i biri i Palokës dhe i Dranes, vjeç 51, i pamartuarë, i padënuarë, me gjendje ekonomike të mesme, ka mbaruarë Theollogjin në Romë, me profesion prift, në Itali t'arratisurë ka djalin e motrës Zef Palin, nga Shkodra, i rreshtuarë me datën 14/X/946.

5).- Zef Kolë Haxhia, i biri Kolës dhe i Gjystes, vjeç 58, i martuarë me 8 fëmijë, i vrfër, kambarue Shkollën Teknike Tregëtare, mandej ka vazhduarë Gjimnazin Ushtarak Turqisht, nga Shkodra, i pa prekur nga Reformat, ish Deputet, i rreshtuarë me datën 20/XI/947.

6).- Dom Ndos Sahatçia, i biri Rrokut dhe i Nushes, vjeç 41, i pa martuarë, i pa dënuarë, i varfër, ka mbaruarë Theollogjin, me profesion Ipeshkëv, lindurë në Breg të Matës, i rreshtuarë me datën 26/6/947.

7).- Padre Gjon Karma, i biri i Franos dhe i Diles, vjeç 52, ka mbaruarë Theollogjin në Autri dhe në Rromë, i pa martuarë, i pa dënuarë, shqipëtar, me profesion famultar, lindur në Gur të Zi, i rreshtuarë me datën 10/XI/946.

8).- Dom Nikoll Shelqeti, i biri Hilës, dhe i Diles, vjeç 55, i pa martuarë, i pa dënuarë, i varfër, ka mbaruarë Theollogjin dhe Fillosofin në Austri, me profesion Prift e Famultar, lindur në Shelqet, i rreshtuarë me datën 20/XII/946.

9).- Padre Mëhill Miraji, i biri Pjetrit dhe i Prenës, vjeç 39, shqipëtar, i pa martuarë, i padënuarë, i varfër, ka mbaruarë Theollogjin në Rromë, ish Profesor e Zv.Famulltar nga Shkodra, i rreshtuarë me datën 20/X/946.

10).- Zef Gjeto Pëllumbi, i biri Gjetos dhe i Lukës, vjeç 22, i pa martuarë, i pa dënuarë, lindur në Bogë të Koplikut dhe banues në Mal të Renzit të Leshit, me profesion Xhaku, ka kërryer të tretin Kurs Theollogjik, ka t'eksekutuarë Mark e Zef Mirin të dy dajit e tij, dhe t'arratisur djalin e dajës, i varfër, i rreshtuarë me datën 15/X/946.

T'akuzuarë me akt-akuzën e Prokurorisë Ushtarake me Nº. 2 datë 2/1/948 për fajin se: Kanë punuarë për ardhjen e Fashismit dhe për okupimin e vendit t'onë

nga imperializmi Italian. Qysh para okupasionit kanë qenë agjentë politik dhe spiunashi t'Imperializmit Italian. Gjat okupasionit kanë punuarë për fashistizimin e vendit. Kanë punuarë për të legalizuarë okupasionin armik. Me anë të axhitasionit e propagandës fashiste janë përpjekurë të shuajnë ndiesit patriotike dhe nacionale të popullit. Kanë qenë pengesa serioze të L.N.Ç. dhe kanë punuarë për eliminimin e kësaj lëvizje. Kanë ndihmuarë dhe kanë bashkëpunuarë me gjithë organizatat kriminale gjat okupasioneve. Kanë përkrahurë dhe ndihmuarë tërë Qeverrit kuislinge të kohës okupasionit si dhe politikën e tyre renegate. Kanë praktikuarë të gjitha mjetet e mundëshme dhe ç'do lloji metode për të shuarë ose penguarë deri në fund rezistencën e popullit. Gjat okupasionit gjerman janë bërë agjentë të Gestapos duke denoncuarë në zyrat sekrete të saj militantët e L.N.Ç. Kanë ndihmuarë repartet dhe formacionet armike e bashibuzuke kur shkonin ndër krahina për të lëftuarë partizanët. Mbas shlirimit të Shqipërisë të tmeruarë nga Pushteti në dorë të popullit, hidhet me egërsi dhe me tërbim kundrë popullit dhe pushtetit... Me qëllim që të godasin Pushtetin ma me forcë ja fillojnë organizimit të tyre përmrenda klerit katolik ndënë kryesin e Monsinjor Gjinit, Dom Nikoll Dedës, Pader Mati Prendushit, Monsinjor Volaj e tjerë krerë klerikalë. Organizimin e tyre e fillojnë duke e transformuarë gjithë klerik katolik në një organizatë fashiste të qojturë Demokristjane. Zgjedhin Komitetin Qendror me elementat e sipërpërmendurë si Monsinjor Gjinin, Volaj, Dom Nikoll Dedën, Padre Mati Prendushin e tjerë si dhe civilat Zef Haxhin me shok. Në vendimet e Komitetit Qendror kanë specifikuarë formimin e Komiteteve dhe N/Komiteteve të kësaj organizate ndër famullira të ndryshme ndër krahina. Lidhjen me t'arratisurë brenda dhe jashtë shtetit si dhe me ç'do organizatë teroriste brenda shtetit. Lidhjen me imperialistat e huej dhe me ç'do armik të vendit t'onë. Kordinimin e luftës kundrë Pushtetit me ç'do kundrështar të pushtetit. Pregatitjen e njij kryengritje imediate t'armatosurë për kundra Pushtetit. Të gjitha këto vendime të pandehurit i kanë vënë në sbatim duke u lidhurë me t'arratisurit, duke dërguarë memorandume imperialistëve të huej. Formuan Komitetin e Përbashkët të organizatës teroriste për Shkodrën, duke u përfaqësuarë në këtë organizatë nga Dom Nikoll Deda. Kanë zhvilluarë propagandë të gjerë për formimin e kryengritjes kundrë Pushtetit (karakterike) përpjekja e 9 Shtatorit 946. Nga të pandehurit Zef Haxhia ka qenë Antari i Komitetit Qendror të Demokristjanes, ka trathëtue besimin e popullit si përfaqësues në Kuvendin Popullor duke u lidhurë me organizatat teroriste fashiste e profesioniste të cilat ishin për rrëzimin me dhunë të Pushtetit Popullor. Faje këto që parashikohen prej nenit 2 e 3 pikës 1, 2, 3, 4, 6, 7, 8, 14 të Ligjës 372.

Në procedimin e shvilluarë faqe të pandehurve.

Prokurori Ushtarak ka kërkuarë që të pandehurit të cilësohen fajtorë si mbas neneve 2 e 3 pikës 1, 2, 7, 8, 14 të Ligjës 372 dhe në bazë të nenit 4 po të kësaj ligje ka kërkuarë dënimin e të pandehurve si vijon: Për Monsinjor Frano Gjinin, Dom Nikoll Dedën, Padre Mati Prendushin dhe Dom Tom Lacen me VDEKJE. Për Padre Gjon Karmen me 20 vjeet privim lirie punë të detyruarë. Për Padre Mëhill Miraj me 10 vjet privim lirie e punë të detyruarë. Për Zef Haxhin dhe Dom Nikoll Shelqetin me

nga 5 vjet privim lirie e punë të detyruarë. Për Zef Pëllumbin me 3 vjet privim lirie punë të detyruarë.

Mbasi ndëgjoi fjalën e fundit të të pandehurve.

Gjykata mbasi shqyrtoji aktet dhe bisedoji çështjen konstaton se:

Sikundër u provua gjat shvillimit të gjyqit, klerikët katolik në Shqipëri, dhe sidomos këta të pandehurit kanë qenë gjithëmonë armiq të popullit, të cilët e kanë shtypurë vashdimisht në ç'do rregjim, në ç'do kohë duke rojtur këta në kurris të popullit me një jetë të plotrehatëshme, ndërsa populli vuante të zezat e ullirit dhe sidomos elementi katolik në pjesën e Veriut të Shqipërisë dhe veçanërisht Malsitë.

Të pandehurit klerikë kanë qenë t'atillë që në ç'do kohë e ç'do rregjim nxirrnin njerzit e tyre adapt për të bashkëpunuarë me t'a, ndërsa pjesa tjetër punonte me popullin gjoja për punë fetare, por në të vërtetë ata e mashtronin popullin me veladonin e tyre duke e lënë krejt në prapambetje dhe injorancë në ç'do Sektor dhe për këtë vepër kaqë të poshtër janë përgjegjës direkt të pandehurit.

Kleri katolik qysh në kohën e Turqisë asht munduar t'a përçajë popullin shqiptar dhe i ka hedhur në luftë njërën fe me tjetrën. Në kohën e Austro-Ungarvet kanë qenë të lidhur me t'a, ishin vegla të tyre, punonin për imperjalizmin Austro-Ungarez për të qëndruar në vendin t'onë jo si okupator që ishin në të vërtetë por si çliruesa, prej të cilvet subvencjonoheshin mirë.

Mbas shkatërrimit t'imperjalizmit Austro-Hungarez, kleri mbasi pa patron dhe për këtë kishte nevoj të madhe, pse pa të nuk do të kishte subvencjone. Për këtë u lidhë me një herë me një herë me imperjalizmin italjan pa vones nga ana tjetër axhent të tyre, d.m.th. klerik të ndryshëm nga këta mbanin njëkohësisht lidhje edhe me padron të tjerë si me imperjalistët jugosllavë, me regjimin e Zogut e të tjerë të cilve u shërbenin dhe përveç subvencjoneve që merrnin nga Italija për shërbime që bënin subvencjonoheshin edhe nga këta.

Kleri reaksjonar në Shqipëri, sidomos të pandehurit me një herë mbas lidhjes me imperjalistët italjan janë vënë në shërbim të tij. Në Shqipëri qysh prej kohe ishin axhentat e Italis fashiste si Meloni, Jakomoni e të tjerë me të cilët kleri mbante lidhje të vazhdushme dhe merrte subvencjonet, përveç lidhjeve që kishte e mbante me Vatikanin.

Për shpërblimin që ju jepte Italia të pandehurve u kërkonte dhe shërbimin e tyre në favor të fashismit, dhe siç dihet Italia e ka lakmuarë gjithëmonë Shqipërinë dhe për t'a bërë të vetin duhej të pregatiste terrenin për okupimin e Shqipërisë.

Axhentët kryesorë dhe shërbëtorët më besnik të kësaj poshtërsije u bënë kleri reaksionar katolik, të cilët shumë vjet para 7 Prillit 1939 kishin punuarë për këtë trathëti, duke predikuarë në popull se vetëm Italia e shpëton vendin t'onë e tjera, prandaj duhet t'a duem dhe kur të vijë t'a presim si shpëtimtar dhe jo si okupator.

Fashismi Italian për të paturë edhe më tepër suksese si doktrinë, nëpërmjet Vatikanit qysh në vjetin 936, u lëshon një enciklikë gjith klerikve katolik në botë duke çfaqur rrezikun Komunist, duke e predikuar këtë si më Atheist, Ençiklik e cila kishte për qëllim propogandën kundra komunizmit, pse fashizmi dhe Papa shikonin prej tij

rrezikun e tyre, dhe pse masat e gjera popullore të ç'do shtetit e përqafonin me një herë, Enciklik kjo që u punua nga i gjith kleri katolik në Shqipëri kundra komunizmit, dhe mbasi populli ishte krejt injorant i besonte këto parulla si të vërteta, pse popullit t'on i mungon kultura.

Kleri reaksjonar katolik ka punuar me mish e me shpirt dhe ka pregaditur terrenin për ardhjen e fashizmit Italjan në vendin t'onë, dhe në 7 Prill 1939 u realizua ëndrra e tyre të cilën e qujtin dit fatbardhë për Shqiprin, duke lënë me një anë se Shqipërija u okupua nga i huaji dhe duke propoganduar që të mos luftohesh fashizmi, nga populli.

Klerikët katolik ishin të parët që pritën trupat italjane për mirseardhjen dhe të parët që shkuan në Tiranë për të çfaqur urimet Jakomonit dhe pastaaj me radhë të tjerve.

Mbas 7 Prillit kleri reaksjonar katolik dolli haptas në popull duke predikuar në favor të fashizmit sidomos me propogandë dhe u vue kok e këmbë në shërbim të tija.

Sado që populli shqiptar e luftoj fashizmin qysh në ditët e para, por prap nuk e ndërpreu luftën kundra tij edhe kur dolli lëvizja N.Ç. populli po mobilizohesh rreth sajë për të lëftuar më mirë dhe më i organizuar fashizmin.

Kleri katolik duke parë se lëvizja N.Ç. kishte udhëheqje partinë Komuniste, këta e ndien rrezikun dhe i shtërnguan radhët e tyre në bashkëpunim me okupatorin italjan për të lëftuar L.N.Ç. Kleri ishte në radhë të parë nxitës për mobilizimin e popullit në radhët e Milicies fashiste, karabinjeris, ushtris dhe të tjera, e më vonë nxitës kryesor për vullnetarët të cilët i formonin me qëllim për të çfarosur rezistencën e popullit.

Kleri katolik për t'a larguar popullin nga lufta predikonte e propogandonte si me gojë edhe me anën e shtypit kundra lëvizjes se ata janë komunista, të pa fe, të pa nderë, e të tjera sidomos për të larguar rinin nga lufta kishte krijuar me qëllime të caktuara rrethe ose shoqëri që gjoja fetare, si Antoniane, Dombocho e të tjera, në të cilat epesh krejt edukatë profashizmit dhe për t'i korruptuar në vese të këqija.

Kleri katolik mbas kapitullimit të Italis u lidhë me okupatorin gjerman dhe me të gjith ka bashkë-punuar për të çfaros lëvizjen N.Ç. Klerik të dalluar e sidomos udhëheqsit e tyre kanë bashkëpunuar ngusht me qeverit kuislinge të nji pas njishme dhe me oficera të lartë të okupatorve Italo-Gjerman të cilve u qenë bërë vegla besnike.

Të pandehurit klerik reaksjonar katolik e sidomos në radhë të parë Monsinjor Gjini, Pader Mati Prendushi, Dom Nikoll Deda, Monsinjor Volaj, Pader Palë Doda, Dom Ndoc Sahatçija e të tjerë kanë bërë që Pader Anton Harapi të bëhet Regjent ku për këtë qëllim kanë dhënë aprovimin e tyre, vepër kjo që ishte studjuar mirë prej klerit, të cilët kishin krijuarë me kohë Partin Demokristjane dhe si Antar i Komitetit Qendror të Demokristjanes Pader Anton Harapi do të kishte influencë në Regjencë dhe kështu këjo Parti do të kishte pozitat kyç dhe do të veprohesh si mbas direktivave të tyre, vepër e cila u realizua dhe që dihen të gjitha trathëtit, vuajtjet e mjerimet që ka hequrë populli gjat luftës si konseguencë e Rregjencës dhe e gjithë trathëtisë.

Kleri reaksionar katolik dhe sidomos udhëheqësit e tyre bashkëpunuan ngushtë dhe me organizatat trathëtare Ball Kombëtar, Legalitet, Nacional Indipendent e tjera në

të cilat bashkëpunuan e lëftuan ngushtësisht, porse puna e tyre në përgjithësi dështoji.

Si kundër u provua edhe se:

Kur kleri katolikm e pa se edhe okupatori gjerman bashkë me trathëtarët e organizatave tyre muarrë tatëpjetën, athere u nevojitesh të siguronin një Patron të Ri, dhe qysh kur gjat luftës qëndronin me trathëtarin Abas Kupin Misionarë reaksionarë Anglo Amerikanë, këta me njëherë patën takime me t'a dhe bashkëpunuan, njëkohësisht shtruan problemet sesi do të veprohesh mbasi të shlirohesh Shqipëria nga partizanët dhe mënyrën e punës se si këta do të vepronin.

Të pandehurit e thanë vet gjat zhvillimit të gjyqit se çlirimin e Shqipërisë e pritën me urrejtjen më të madhe pse ishte edhe partija Komuniste që do të merrte pjes në Pushtetin e ri popullor, parti të cilën të pandehurit e urrejn për vdekje për arsye se ajo zhvillon masat e popullit dhe nuk lejon spekullator e parazit në kurris të tij.

Kleri udhëjeqës me njo herë mbas çlirimit lëshoj direktivat mbi mënyrat e punës se si duhej vepruar për të sabotuar krejt punët e Pushtetit Popullor. Në fillim u urdhërua kleri të mos i jepte asnjë ndihmë Pushtetit, pastaj u dhanë udhëzime për të propoganduar kundra tij, për t'i sabotuar punët e tij sidomos reformat si atë Agrare, Arsimore, Tatim-fitime, zgjedhjet e 2 Dhjetorit 1945 e të tjera sabotime dhe punë kjo që kryhesh me ndërgjegje të plot të klerit.

Me një herë mbas çlirimit kleri reakjonar udhëheqës krijoj lidhje me Misionet Anglo-Amerikane dhe Frances në Tiranë të cilëve u raportonin punën dhe merrnin njikohsisht direktiva se si duhesh të punonin dhe njikohsisht nëpërmjet të këtyre me Vatikanin.

Kleri mbas çlirimit ka bërë mbledhje të ndryshme në Kuvend e Arqipeshkvi ku kanë shtruar situatën politike dhe mënyrat se si duhej punuar për t'a përmbysur Pushtetin. Në këto mbledhje kanë vendosur riorganizimin e Demokristjanes ku nën kryesinë e Monsinjor Thaçit, e me vdekjen e tij të Monsinjor Gjinit kanë krijuar Komitetin Qendror të kësaj organizate me antar klerik dhe reaksjonarë civila si Zef Haxhinë, Kol Prelën e të tjerë.

Njikohsisht kanë marr vendime për të krijuar N/Komitetet e Demokristjanes edhe në N/Prefektura e qendra të tjera, N/Komitete këto që krijuar kudo që kishte klerikalë duke caktuar për udhëheqës ose kryetar të këtyre N/Komiteteve vetëm klerikalët. Këto N/Komitete janë krijuar prej të deleguarve të Komitetit Qendror të Demokristjanes dhe kan vazhduar punën e tyre reaksjonare deri në kohën e fundit që u zbuluan dhe u muarrën masa kundra tyre.

Komiteti Qendror i Demokristjanes vendosi njikohsisht që të mos thirresh në këtë emër organizata e tyre por Social-Demokrate për të futur në gjirin e tyre gjith elementat armiq të Pushtetit sidomos pjesën muslimane. Nga ana tjetër kjo organizatë pregatiti kryengritjen e si ajo e Llesh Marashit e cila dështoj duke qenë pjesëtar në të edhe kleri katolik. Më vonë Demokristjanja për të mobilizuar në radhët e veta sa ma shumë armiq të Pushtetit e të popullit krijoj Bashkimin Shqiptar e cila u zbulua shpejt dhe u pa trathëtija që pregatitëte kleri me këtë organizatë duke qenë udhëheqësa trathëtar Pader Gjon Shllaku, Fausti e Dajani.

Demokristjanja ose kleri kishte dhe mbante lidhje të ngushta me kriminelat e arratisur të cilët i ndihmonte materjalisht, i furnizonte dhe i strehonin klerikalët nëpër famullit e tyre, nga ana tjetër propogandonin për të shtuar radhët e tyre, pse këta (t'aratisurit) Demokristjania i konsideronte ushtarë të saj dhe për këtë qëllim ishin ngarkuar klerikalë të ndryshëm të bënin takime me t'arratisurit dhe t'u jepshin udhëzime mbi mënyrën e veprimit.

Demokrisjania për të mundur që të kishte axhentat e sajë edhe në Kuvendin Popullor gjeti njerzit adapt për këtë punë si Kol Prelën, Zef Haxhin, e Riza Danin, të cilët kontrabandë ishin futur në front dhe ishin zgjedhur përfaqsues të popullit, të cilët me punën që bënin në kuvende trathëtojnë interesat e popullit dhe bëjnë punën e demokristjanes.

Demokristjania (kleri) mbante lidhje të regullta dhe me Komitetin Qendror të Ballit Kombëtar e Legalitetit në Tiranë dhe bashkëpunonin, dhe për të kordinuar edhe më mirë veprimet pse kishin një qëllim, përmbysjen e Pushtetit, kur erdhi në Shkodër delegati i Komitetit Qendror të Tiranës trathëtari Abdyl Kokoshi bisedoj me klerikalë si Dom Tom Lacen dhe ranë dakord të formonin Komitetin e Përbashkët për qytetin e Shkodrës, i cili edhe u formua, ku për këtë qëllim janë bërë mbledhje të ndryshme e sidomos, ajo e Dy Korrikut 1946, ku dolli Komiteti i Përbashkët prej Dom Nikoll Dedës i deleguar i klerit (Demokristjania). – Riza Dani, Cin Serreqi, Dulo Kali, Caf Dragusha, Rasim Gjyrezi Pjetër Shan Deda, Guliem Suma e të tjerë, mbledhje e cila u bë në shtëpin e Cin Serreqit ku u vendos mënyra dhe më e mirë e punës, u vendos për kryengritje të shpejt pse kështu i kishin premtimet nga Anglo-Amerikanët se deri me datën 15-16 Shtator 1946 do të bëhesh zbarkimi prandaj njikohsisht duhej bërë edhe kryengritja, e cila ishte caktuar deri me datën 15-16 Shtator 1946, por që kjo u bë me datën 9 Shtator ku u sulmua Shkodra dhe u dëmtua prej sajë populli dhe Pushteti, kryengritje e cila u bë para kohet për shkak se u paraqit rasti oportun kur mobilizoheshin ushtarë nga Pushteti e për të mos shkuar këta u bë kryengritja e cila qe paramejtuar të rezistonte deri me 15-16 Shtator që do të bëhesh gjoja kryengritja e përgjithshme, kryengritje kjo që qe pregatitur nga i gjith reaksjoni e në radhë të parë nga kleri dhe N/Komitetet e Demokristianes të cilat tregonin aktivitetin më të madhë për këtë trathëti të poshtër e cila nuk pati sukses për t'a.

Kleri katolik reaksjonar sikundër që u provua kishte krijuar dhe depo me armë e municjon të cilat i rezervonte për kundra Pushtetit, sasira këto të mëdhaja të cilat i mbante të mshehura nëpër kisha, seminare, e faltore për të cilat vende në popull predikojshin se janë të shenjëta, ndërsa këta vet i përdornin për varrin e popullit.

Veç armëve dhe municjonit u gjendën të fshehura prej tyre edhe sende të tjera si dokumenta të shumta të trathëtarëve Gjon Marka Gjonit, kuestor Papa Lilos, Pader Andon Harapit, e të tjerë, të cilat i mbanin për të përdorur kur t'u nevojiteshin, dokumenta këto shum të vlefshme për trathëtin e tyre si klerikalë e për gjith bashkëpuntorët që kishin.

Veç sa më sipër sikundër u provua kleri edhe mbas shkatërrimit që u bëri populli çerdheve reaksjonare që këta kishin krijuar si Seminare, shoqëri gjoja fetare

e të tjera ku mblidhëshin rinin e të tjerë, por të pandehurit edhe më vonë kishin udhëzuar rinin femnore se për të mundur të afroheshin me njerëz me pozitë të Pushtetit dhe të mirrnin prej tyre sekrete duhet të pranonin edhe shkangullimin (ç'nderimin), mjaft që t'i arrihesh qëllimit që këta kishin paramejtuar por edhe kjo mënyrë për t'a me gjith se u veprua nuk pati sukses.

I pandehuri Zef Haxhija qysh para okupacjonit ka qenë kryetar i shoqëris Burrave (shoqëri gjoja fetare) dhe njikohsisht aantar i Komitetit Qendror të Demokristjanes dhe kontrabandë hyri në radhët e Frontit dhe u zgjodhë përfaqsues i popullit në Kuvendin Popullor ku deshte të bënte punën e reaksjonit por mbasi vunte nga sëmundja nuk mundi të rezistonte në këtë detyrë dhe bëri dorëheqjen, duke mos treguar me as ndonji aktivitet të zhvilluar por kishte dijeni për ç'do veprim të reaksjonit.

I pandehuri Xhakua Zef Pllumbi sa do që nuk e kishte kryer akoma shkollën për priftë por asht treguar besnik dhe antar i klerit duke punuar në ç'do drejtim për t'a, aktivitet që tregohet jo vetëm nga puna e tij në përgjithsi por edhe nga shkrimet që ky ka bërë dhe që tregoj urrejtjen e madhe dhe armiqsin që ka kundra Pushtetit dhe Popullit e që ndodhen të shkruara pjesërisht në dosjerin e tija.

Trathëtija e të pandehurve u provua gjat zhvillimit të gjyqit, direkt dhe indirekt nga pohimet dhe gjysëm pohimet e tyre, nga atribuimet që i bëjnë njëri jetrit, nga proçes-verbalet e mbajtura n'hetuesi, nga ballafaqimet e bëra n'hetuesi, nga atribuimet e bëra nga të pandehurit e tjerë klerikalë si Monsinjor Volaj, e Pader Rrok Gurashi, nga armët e gjetura, nga opinionui publik dhe nga krejt vazhda e trathëtis tyre qysh shum vjet ma parë, duke qenë krye në të trathëtis në ç'do kohë e në ç'do rregjim, ka qen si kryesor e shkaktar për ç'do poshtërsi kleri katolik reaksionar, trathëti dhe vepra këto që kan dëmtuar rëndë interresat e popullit dhe të Pushtetit tija, si gjat luftës Nacional Çlirimtare dhe mbas Çlirimit, kur populli i ësht vënë punës për rindërtimin e Shqipëris së re për t'i siguruar vehtes jetë ma të mirë, më të lumtur, dhe ma të begatshme. Si të tilla shumë të damshme dhe të rezikshme për popullin e Pushtetit konsiderohen faje penale të parashikuara nga nenet 2, 3 pikës 1, 2, 3, 4, 7, 8, 9, 10, 14 dhe nenet 7, 8 të Ligjës Nr. 372 mbi fajet penale kundra Shtetit dhe Popullit, dhe në bazë të nenit 4 po të kësaj ligje gjykata mbasi shikoj të kaluarën, t'ardhshëmen, dhe rezikshëmënin që i paraqesin shoqëris, me vota të përbashkëta, pjesërisht në kundërshtim me kërkesën e Prokurorit vendosi dënimin e tyre si vijon:

1).- Për të pandehurit: Monsinjor Frano Gjini, Pader Mati Prendushi, dhe Dom Nikoll Dedën nga Shkodra me Vdekje, dhe me humbjen e të drejtave politike dhe civile përgjithmonë, dhe me konfiskimin e pasuris tundëshme dhe të pa tundëshme.

2).- Për të pandehurin: Dom Tom Lacen nga Shkodra me privim lirie e punë të detyruar për jetë, dhe me humbjen e të drejtave politike dhe civile përgjithmonë, dhe me konfiskimin e pasuris tundëshme dhe të pa tundëshme.

3).- Për të pandehurit: Pader Gjon Karmen, dhe Dom Ndoc Sahatçin, me nga 15 vjet privim lirie e punë të detyruar, dhe me humbjen e të drejtave politike dhe civile për 5 vjet kohë, dhe me konfiskimin e pasuris tundëshme dhe të pa tundëshme.

4).- Për të pandehurin: Pader Mhill Miraj me 7 vjet privim lirie e punë të detyruar, dhe mee humbjen e të drejtave politike dhe civile për 5 vjet kohë, dhe me konfiskimin e pasuris tundëshme dhe të pa tundëshme.

5).- Për të pandehurin: Zef Haxhin nga Shkodra me 5 vjet privim lirie e punë të detyruar.

6).- Për të pandehurit: Dom Nikoll Shelqeti dhe Zef Gjeto Pllumbi nga 3 vjetë privim lirie e punë të detyruarë.

Të dënumve u ngarkohen 162 lek shpenzime gjyqi.

Ky vendim i referohet Gjykatës Nalt Ushtarake për aprovim për sa u përket të dënumve me vdekje, kurse për të tjerët mundet të bëhet ankim po në Gjykatën e Nalt Ushtarake mbrenda tet ditve nga data 8/I/1948, që u shpallë ky vendim.

Shkodër, me 8/I/1948.

Sekretari Antari Antari Kryetari

Arkivi i MPB, Fondi 1, Viti 1948, D. 1302/IIA, Fl. 20-21/1.

PRETENC.

Akuzat me të cillat u suallën të pandehurit Monsinjor Gjini, Dom Nikoll Deda, Pader Mati Prendushi, Dom Tom Laca, Zef Haxhija, Dom Ndoc Sahatçija, Pader Gjon Karma, Pader Pader Mhill Miraj, Dom Nikoll Shelqetim, dhe xhakoj: Zef Pllumbi, u provuan pothuaj plotësisht, me gjith se këta u munduan me anë dredhidh të ndryshme t'i largohen akuzës dhe fajsis. Orvatjet që bënë të pandehurit për t'i shkarë fajit dhe realitetit, qenë përpjekje dinakërie për t'i shpëtuar fajsis dhe përgjegjësis. Shumë nga të pandehurit u treguan gadi krejt indiferenta karshi akuzavet duke injoruar edhe gjërat më elementare. Shumë nga të pandehurit than se nuk e njifnin fare organizatën fashiste Demo-kristjane dhe shumë gjëra të tjera. Por vallë a thue se duhet pranuar ky pretendim i të pandehurvet si i vërtetë dhe i saktë, a duhet pranuar se këta janë kaq naivë dhe inocentë sikundër tregohen. Jo. Kjo s'ësht e vërtetë. Deponimet e priftërinjve të tjerë, Mosinjor Volaj, Pader Gurashit, Dom Ndoc Sahatçis, Dom Nikoll Shelqetit etj. tregojnë fare hapët aktivitetin e këtyre të pandehurve, nga ana tjetër gjysmë pohimet e tyre dhe vet orvatja për t'iu larguar fakteve pasqyron aktivitetin trathëtar të këtyre të pandehurve.

Të pandehurit e sipërmë janë armiq të vjetër të popullit. T'ushqyer me të holla dhe me frymë fashiste këta bëhen vegla qorre në duar të të huajvet duke shitur vendin dhe popullin.

Të verbuar nga subvencjonet e fashizmit të Duçes janë vënë të pregatisin fushë të favorshme për okupimin e Shqipëris nga imperjalizmi italjan.

Me ardhjen e fashizmit në vendin t'onë këta e vazhdojnë përsri zanatin e tyre t'agjentit dhe të misionit politik fashist duke punue për fashistizimin e vendit dhe të popullit dhe për të legalizuar okupacjonin armik.

Me anë të axhitacjonit dhe të propogandës fashiste janë përpjekur të shuajnë ndisit patriotike dhe nacionale të popullit.

Kan qenë pengesë serioze e L.N.Ç. Kan punuar për eliminimin e kësaj lëvizje. Kanë ndihmuar dhe kan bashkëpunuar me të gjitha organizatat kriminale të krijuaara nga fashizmi në vendin t'onë.

Kanë përkrahur dhe ndihmuar tërë qeverit kuislinge të kohës s'okupacjonevet si dhe politikën e tyre gënjeshtare.

Kanë praktikuar të gjitha mjetet e mundëshme dhe ç'do lloj metode për të shuar ose penguar deri në fund rezistencën e popullit.

Gjat okupacjonit gjerman jan bërë agjenta të Gestapos duke denoncuar në zyrat sekrete të saja militantët e L.N.Ç. Kan ndihmuar repartet dhe formacjonet armike e bashibozuke kur shkonin nëpër krahina për të lëftuar partizanët.

Mbas çlirimit të Shqipëris të tmeruar nga Pushteti në duar të popullit, hidhen ma me egërsi e ma me tërbim kundër Pushtetit të Popullit.

Në Pushtetin e Popullit këta të pandehur shifnin të vdekur të kaluarën e tyre plot rehatllëqe e salltanete. Këta e panë se në Pushtetin e ti nuk u shkonin ma dallaveret e së kaluarës, e pan se nuk kijshin ma të ardhura në saje të spiunazhit dhe t'agjenturës. E panë se Pushteti i Popullit do t'u nxirrte të pa larat në shesh. E pan se do t'u dilte në shesh bashkëpunimi me Italjanët dhe me gjermanët dhe për gjithë këto u hodhën me të gjitha forcat për t'a rëzuar Pushtetin e Popullit.

Me qëllim që t'a godasin Pushtetin e Popullit më me forcë i'a fillojnë organizimit të tyre përmbrenda klerit katolik ndën kryesin e Monsinjor Gjinit, Dom Nikoll Dedës, Mati Prendushit etj. duke e transformuar gjith klerin katolik në një organizatë fashiste të qojtur Demokristjane. Zgjedhin Komitetin Qendror me elementat e sipër përmendur si Monsinjor Gjinin, Pader Mati Prendushi, Dom Nikoll Deda etj. klerikalë si dhe me civilat Zef Haxhija me shokë, ndërsa të pandehurit e tjerë përbënin Komitetet dhe N/Komitetet e Demo-kristjanes ndër krahina dhe famullira të ndryshme. Komiteti qendror i Demokristjanes d.m.th. personat e sipërmë kanë marrë vendime të ndryshme si lidhjen me t'arratisur kriminela, me banda kriminale t'armatosura mbrenda dhe jasht shtetit, lidhjen me ç'do organizatë teroriste, grup terorist dhe ç'do armik e kundërshtar të Pushtetit Demokratik. Lidhjen me imperjaalistët e huaj dhe me ç'do armik të vendit t'onë. Kordinimin e luftës me ç'do kundërshtar të Pushtetit. Pregatitjen e një kryengritje imediade t'armatosur për rëzimin e Regjimit Demokratik.

Këto vendime të pandehurit i kanë vënë në zbatim të plotë duke u aktivizuar të gjith dhe sejcili në sektorin e tij.

Ç'do famulli e bënë një qendër të reaksjonit, në ç'do kish dhe në ç'do messh këto nepërka të fëlliqura helmatisnin ndjenjat e pastërta të fshatarve dhe të qytetarve të pa ngritur dhe naivë. Në ç'do fshatë dhe ç'do shtëpi, në ç'do krahinë dhe me këto që takoheshin këta bënin propogandën e tyre anti-Pushtetit, duke diskreditуar reformat shoqnore dhe gjithshka tjetër.

Këta kanë kërkuar të gjejnë dhe të bëjnë për vehte gjith të pa kënaqurit dhe

të prekurit nga reformat. Këta janë munduar të hedhin në kampin e tyre gjith të lëkundurit dhe të pa skjaruarit.

Puna e tyre bëhesh me sistem dhe e organizuar kudo, si dhe me fshehtësin ma të madhe (kjo e fundit në sajë të konfesjonit fetar).

Në mbështetje të programit të tyre dhe të direktivave të Komitetit Qendror të Demo-kristjanes të pandehurit janë lidhur me t'atarrisurë kriminela të cilët i kanë konsideruar ushtri t'organizuar të Demokristjanes. U kanë siguruar atyre baza strehimi dhe furnizimi si me ushqime e të tjera sendet e nevojshme për të mbajtur të gjallë qëndrimin e tyre n'arati dhe për t'i inkurajuar për kundra Pushtetit. Kan kordinuar me ata veprimtarinë trathëtare për të goditur Pushtetin dhe ç'do ndërmarrje të Pushtetit.

Këta u lidhën me të gjith kundërshtarët e Pushtetit dhe me ç'do organizate teroriste klandestine që kishte për qëllim përmbysjen e situatës në vendin t'onë.

Në bashkëpunim me krerët reaksjonar të Shkodrës dhe duke qenë të përfaqsuar prej Dom Nikoll Dedës kanë formuar Komitetin e Përbashkët t'organizatës teroriste në Shkodër duke u lidhur në këtë mënyrë dhe në Komitetin Qendror t'organizatës teroriste të Tiranës.

Kanë përpiluar dhe dërguar memorandume, informata e raporte reaksjonit të jashtëm me anë të Misioneve të huaja Anglo-Amerikane dhe të U.N.R.A.s. Me këto kanë kërkuar një ndërhyrje të huaj të shpejt për rëzimin e Pushtetit.

Kanë punuar për pregatitjen e nji kryengritje t'armatosur për rëzimin e Pushtetit me forcë dhe me dhunë (karakteristike për këtë ësht përpjekja e 9 Shtatorit 1946). Ishte puna axhitative dhe propogandistike e këtyre të pandehurve dhe e shokve të tyre që pregaditi 9 Shtatorin, qe programi i Demokristjanes dhe i organizatës teroriste që synonte rëzimin e Pushtetit, qenë këto bisha të tërbuara që ëndronin dit dhe natë heqjen e popullit nga Pushteti dhe nga fuqija.

Me qëllim që t'armatosnin kryengritësat këta kanë mbajtur të fshehura arm dhe municjon të cilat u a kishin lënë gjermanët dhe italjanët.

I gjith ky aktivitet sabotazhi terorist dhe e gjith kjo punë shkatërrimtare e këtyre të pandehurve drejtohesh për rëzimin e Republikës Popullore të Shqipris.

Nga të pandehurit Zef Haxhija ka qenë antar i Komitetit Qendror të Demokristjanes. Ka trathëtuar besimin e popullit si përfaqsues i popullit në Kuvendin Popullor, duke u lidhur me organizatat trathëtare teroriste, fashite e profashiste të cilat ishin për kundër At-dheut dhe popullit.

Për të gjitha këto kërkoj që të pandehurit të cilësohen fajtor në bazë të neneve 2, 3 (pikave 1, 2, 4, 7, 8 e 14) të Ligjës Nr. 372, mbi fajet penale kundra Shtetit dhe Popullit, dhe në bazë të nenit 4 po të kësaj Ligje të ndështkohen si vijon:

1) Për të pandehurit: Monsinjor Frano Gjini, Dom Nikoll Deda dhe Pader Mati Prendushin dhe Dom Tom Laca me vdekje.

2) Për të pandehurin: Pader Gjon Karmën me 20 vjet provim lirie e punë të detyruar.

3) Për të pandehurin: Dom Ndoc Sahatçin me 15 vjet privim lirie e punë të detyruar.

4) Për të pandehurin: Pader Mhill Miraj me 10 vjet priivim lirie e punë të detyruar.

5) Për të pandehurit: Zef Haxhin, dhe Dom Nikoll Shelqetin me nga 5 vjet privim lirie e punë të detyruar.

6) Për të pandehurin: Zef Pllumbin me 3 vjet privim lirie e punë të detyruar.

Shkodër, me 8/I/1948.

Prokurori Ushtarak i Z.U.SH.

Kapiten
(Namik Qemali)

Arkivi i MPB, Fondi 1, Viti 1948, D. 1302/IIA, F. 23.

REPUBLIKA POPULLORE E SHQIPËRIS
-GJYKATA E LARTË USHTARAKE-
Nr. 67 i Regj.Them.

Vdekje Fashizmit
Liri Popullit
Nr. 114 i Vendimit.

P R O C E S - V E R B A L

Sot më datën 6/III/1948, Këshilli i Gjykatës së Lartë Ushtarake i formuar prej:

Major Niko Cetës	K r y e t a r,
Kapiten I-rë Nexhat Hysenit	A n t a r,
Kapiten II-të Mustafa Iljazit	A n t a r,

I asistuar nga Kryesekretari Aspirant Thoma Rino, dhe në prezencën e Prokurorit Ushtarak t'Ushtris K. Shqiptare Kapiten I-rë Nevzat Haznedarit, mori në shqyrtim akt-gjykimin Nr. 2 datë 8/I/1948, të Gjykatës Ushtarake të Shkodrës, me të cilën në bazë të Neneve 2, 3 7 e 8 të Ligjit Nr. 372 datë 12/XII/1946, mbi fajet penale kundra Popullit dhe Shtetit, është vendosur ndëshkimi me VDEKJE, humbjen e të drejtave civile e politike të përhershme si dhe konfiskimin e pasurisë së lujtëshme dhe të pa lujtëshme, kundra të pandehurve: 1) MONSINJOR FRON GJINI, i biri Pjetrit dhe i Ranes, vjeç 62, lindur dhe banuës në Shkodër, 2) PADRE MATI PRENDUSHI, i biri Kolës dhe i Prendës, vjeç 66, lindur dhe banues në Shkodër, dhe 3) DOM NIKOLL DEDA, i biri Zefit dhe i Ages, vjeç 58, lindur dhe banues në Shkodër, të akuzuar se: kanë punuar për ardhjen e Fashizmit Italiaan dhe okupimin e vëndit tonë, qysh para okupacionit kanë qënë agjenta politikë dhe spiunë të Imperializmit Italian. Gjatë okupacionit Gjerman, janë bërë agjentë të Gestapos duke denoncuar në zyrat sekrete të saj, militantët e L.N.Çl. kanë ndihmuar repartet dhe formacionet armike dhe bashibozuke kur shkonin për të luftuar kundra partizanëve.

Mbas çlirimit të Shqipërisë fillojnë organizimin e tyre për brenda klerit katolik, me qëllim që të godasin Pushtetin Popullor, organizatë e cila drejtohej prej Monsinjorit Gjinit, Dom Dedës dhe Pader Mat Prendushit, të cilët më von e kthyen gjithë klerin katolik në një organizatë fashiste të qojtur Demokristianë.

Prokurori kërkon të vendoset aprovimi i vendimit të sipërmë, si me vënd dhe i bazuar në ligjë.

K ë s h i l l i:

Mbasi shqyrtoj një nga një të gjitha aktet e dosjes, bisedoj dhe studioj çështjen nga pikpamja e fakteve dhe të ligjit, dha këtë,

V e n d i m:

Nga shqyrtimi akteve rezulton se të pandehurit Monsinjor Frano Pjetër Gjini, Pader Mati Kol Prendushi dhe Dom Nikoll Zef Deda, kanë pregatitur terenin për ardhjen e fashizmit dhe për okupimin e vëndit tonë, nga Imperializmi Italian, për këtë punë kanë marë dhe shpërblime të konsiderueshme në të holla. Gjatë okupasionit kanë punuar për fashistëzimin e Popullit Shqiptar. Me çdo mënyrë janë munduarë të shuajnë ndjenjën Nacionale të Popullit. Janë munduarë të përçajnë popullin Shqiptar; kanë luftuar nën petkun fetar kundra luftës së popullit për liri, kanë ndihmuar dhe kanë bashkëpunuar me të gjitha organizatat kriminale për të shuarë Lëvizjen N. Çlirimtare; kanë përkrahur dhe ndihmuar me shkrime dhe axhitasion në popull që të gjitha Qeveritë kuislinge të kohës s'okupacionit si dhe politikën e tyre reaksionare.

Gjithashtu dhe gjatë okupasionit Gjerman, janë bërë agjenta të Gestapos, duke denoncuar në zyrat e saj sekrete, të gjithë elementet e L.N.Çl. Janë munduar me çdo metodë ndër besimtarët duke helmatosur ndjenjën nacionale. Çlirimi i Shqipërisë dhe marja e Pushtetit në duart e popullit e bënë që këta të vazhdojnë luftën më me tërbim. Për këtë arsye fillojnë një axhitasion në stil të gjërë për të sabotuar të gjitha reformat e Pushtetit Popullor, si reformën agrare, arsimore, tatim fitimet, zgjedhjet e 2 Dhjetorit në vitin 1945 e tjera. Me ardhjen e Misioneve të huaja krijuan lidhjet dhe raportojnë dhe marin direktiva se si duhet të punojn. Me anë të Misioneve Anglo-Amerikanë komunikonin dhe me Vatikanin dhe mernin direktiva herë pas here se si duhet të punonin. Të pandehurit kanë qënë ndër udhëheqësit t'organizatës tradhëtare Demo-Kristiane kanë marë vendime dhe kanë krijuar nën Komitetet të kësaj organizate, duke caktuar si Kryetarë të këtyre N/Komiteteve Klerikalët. Më von Komiteti Qëndror i Demo-Kristianëve për të zgjeruar organizatën dhe ndër elementa muhamedanë, studenta dhe në intelektualë të mykur e ndëron emrin, duke e quajtur partija Social-Demokrate.

Të pandehurit kanë ndihmuar dhe pregatitur kryengritjen e Llesh Marashit; kishin krijuar lidhje e bashkëpunim me organizatën e Ballit. Kanë nxitur dhe pregatitur kryengritjen e 9 Shtatorit 1946.

Nëpër kisha dhe seminaret e tyre janë gjetur depo armësh; municionesh dhe shumë dokumenta të tradhëtarëve Gjon Marka Gjonit, Papa Lilos dhe Padër Anton Arapit. Të pndehurit kanë udhëzuar rininë femnore që t'ju afrohen njerësve të Pushtetit, kanë nxitur dhe të çnderohen kundër vullnetit të tyre mjafton që të vjedhin dokumenta sekrete.

Për sa u tha më nalt konstatohet se trathëtija e tyre, ndaj popullit dhe Atdheut ashtë e vjetër dhe tepër e rëndë.

P r a n d a j:

Për këto arsyena Këshilli i Gjykatës së Lartë Ushtarake. Në bazë të nenevet 10 dhe 17 Nr. 2 të Ligjit Nr. 368 datë 5/XII/1946, mbi organizimin dhe kopetencat e Gjykatave Ushtarake, duke pranuar dhe kërkimin e Prokurorit:

V e n d o s i:

Aprovimin e vendimit Nr. 2 datë 8/I/1948, të Gjykatës Ushtarake të Shkodrës, që përmban dënimin dhënë kundra të dënuarve 1) MONSINJOR FRANO PJETËR GJINI, nga Shkodra, 2) PADËR MATI KOL PRENDUSHI nga Shkodra, dhe 3) DOM NIKOLL ZEF DEDA nga Shkodra, me VDEKJE, humbjen e të drejtave civile e politike të për hershme si dhe konfikimin e pasurisë së tyre të lujtëshme dhe të pa lujtëshme.

Ky vendim është i p r e m ë:

Tiranë më 6/III/1948.

KRYESEKRETARI: ANTARI: ANTARI: KRYETARI:

Arkivi i MPB, Fondi 140d, Viti 1949, D. 60, Fl. 35-37.

R E L A C I O N

Mbi Kristofor Kisin dhe Visarion Xhovanin

I. Kristofor Kisi: Si mbas informatave që kemi në këtë Seksion rezulton që ky të jetë nji element jo i mirë dhe për ma tepër shovinist Grek mbasi ka lidhje të ngushta me elementa shovinista dhe që janë në survejim të vazhdueshmë të këtij Seksioni. Si mbas informatave rezulton gjithashtu që ky të propagandojë në dam të livizjes por gjithmonë në mënyrë që të mos kompromotohet, d.m.th. me marifet, për Rininë gjoja se ashtu tue dalë nga feja prandaj duhet të bajmë çmos për t'a shpëtue. Dyshohet gjithashtu që të ketë marrë pjesë në nji mbledhje në shtëpinë e Lasgush Pogradecit. Ky ka takime të shpeshta me këta elementa: Jorgji Anastasjadhi, Jani Dado i cili bën punën e postjerit Gjirokastër Tiranë, Vangjel Meçin dhe Lame Karecon, këta të fundit bëjnë takime dhe me persona nga të U.N.R.R.-as.

2. Visarion Xhuvani: Simbas informatavet që kemi në këtë seksion rezulton se: Është një element mjaft i dyshimtë. Bën lëvizje të shumta dhe takohet me shumë elementa reaksionarë dhe sidomos me ata që kanë ndjenja Zerviste si: Av. Vasil Lilon, Stefan Shundi, Jorgji Anastasiadhin, Lik Toptatin i dalluar për lëvizjet e shumta dhe shpirtin reaksionar.

Ajo që bie në sy më shumë është, takimet e shumta që ky bën me Anglo-Amerikanët dhe afërsia që tregon me këta sidomos me Smidhin dhe një N/Kolonel Engles. Takimet më të shumta i bën në Hotel Dajti.

Arkivi i MPB, Fondi 140d, Viti 1949, D. 60, Fl. 62/5.

Tiranë më 16 Janar 1956.

I dashur mik,

Ka një kohë të gjatë që nuk kemi këmbyer letra. Ç'ndryshime të mëdha q'athere? Mbani mend përgjigjen t'ime në letrën që më kishit drejtuar shum vjet më parë në lidhje me unifikimin e Kishës shqiptare të Amerikës me qendrën e këtushme, sipas vendimit të kuvendit që u mbajtë aty. Sa për telegramet për të cilat bënit fjalë n'atë letrë, këto nuk më ranë në dorë kurrë.

Ju shkrova athere se vizitova disa herë shokun Manol Konomin, Ministër të Drejtësisë n'atë kohë, i tregova letrën dhe shtova dhe lutjen t'ime personale. Nga bashkfjalimet që pata me Z. Ministër gjatë këtyre vizitavet, rezultonte se Qeverija nuk e pranoi kërkesën e sipërme për hyrjen e Peshkopatës Shqiptare t'Amerikës në juridiksionin e Kishës Autoqefale. Duke marë parasysh se nuk gëzonja fatin të isha persona grata dhe për të mos sjellë pengime në ktë punë, ju shkrova, mbani mend, që t'i u drejtoheni edhe vet qeveritarvet, me shpresë se ndërhyrja juaj personale mund të kishte rezultate më të mira. Pas kësaj, natyrisht, e preva dhe korrespondencën.

Pak kohë pas largimit tim nga Kryesija e Kishës, tue qënë se për punët e Komunitetevet fetare u krijua një komitet i veçantë "Komiteti Fetar pranë Këshillit të Ministravet" vajta një ditë në selin e këtij Komiteti dhe u takuaç me shokun Xhoqe Prifti, anëtar asij kohe për punët e Kishës orthodhokse dhe i theksova edhe një herë nevojën për regullimin e çështjes së Kishës shqiptare të Amerikës" me lutje që t'u transmetohej kompetentvet. Nuk kam asnjë dijeni si përfundoi kjo punë.

Sikurse thash më përpara, pas dështimit të demarshevet të mija e preva dhe korrespondencën për arësyna që kuptohen leht. Por, këto ditë, kur lexova në një gazetë një telegramë që ju kishte drejtuar Shoku Aleksandër Xhuvani, Nënprezident i presidiumit të Kuvendit Popullor, bashk me disa intelektualë të tjerë, me rastin e shtatdhjetepesvjeçorit t'uaj, u menduaç që paska ardhur koha për të përsëritur korespondencën. Fjalët e Z. Aleksandër Xhuvanit janë shum me vënd, se askush nuk mund të mohonj shërbimet tuaja si në veprimtarit e tjera patriotike ashtu dhe në kontributën tuaj shum të rëndësishme dhe të njohur për kulturën shqiptare me kushedi sa shkrime origjinale dhe përkthime të përsosura. Por, sa për né njerzit e Kishës, një rëndësi të veçantë ka kontributa juaj në Kishën t'onë Autoqefale, mbasi të gjitha përkthimet që kemi në përdorim ju detyrohen. Prandaj ju dërgonj dhe un urime të përzëmërta për një jetë më të gjatë dhe aq të frutëshme siç ka qënë gjer sot.

Qëngemi shum afër nga pikpamja e moshës dhe kemi arritur në shkallët e fundit, ku duhet të pritet me rezinjasion dhe filozofie e shkurtëra. Kemi, thot më duket, Spinoza shprehje momentane të panumurta të Qënjes Absolute që vijnë dhe kalojnë si valët e detit. Dikur, kur ishim në bangot e shkollës dhe këndonim libra si ato të Buchnerit, Heckel, Feurbach ett, këto shprehje më bënin përshtypje, mir po

tani, në këtë moshë, nuk më pëlqejnë. Më pëlqen më shum ato që thot Nietsche për një "retour eternel" dhe sidomos Bergsoni, filosofi më i shquar i shekullit t'onë, i cili në njërën nga librat e tij bën fjalë me interesim për doktrinën e filosofvet soicien të vjetërsisë, sipas së cilës botët i përgjajnë një organismi. Ato dalin nga kaosi, lindin, shvillohen, plaken dhe vdesin, duke u kthyer përsëri në laosin primitiv. Por, pas një periodhe të disa shekujve të panumëruar që në amëshim kalojnë si një segondë, ato ridalin nga kaaosi për t'u rilindur dhe për të rifilluar një cycle të ri të jetës së gjithësisë. Kështu ngjarjet e ruzullimit përsëriten në cycle infinite, me një përparim dhe evolusion; Bergsoni që e përshkruan këtë theori nuk thot në mënyrë të qartë që është partizant i saj, po thekson se një konsepsion i këtillë i jetës është "concevable". Gjithçkaja, thot Bergsoni, ka të gjitha veçorit që na japin të drejt t'a quajmë një organismë: unitet, mvartësi e solidarësi të plot të pjesëvet të saj me njëra tjetrën ett". Më pëlqejnë këto pavarësisht në se kanë ndonjë mbështetje.

Pas largimit tim nga Kryesija nuk jam marë me punët e Kishës. Me personat që janë sot në Kishë nuk kam asnjë marrëdhënje; as më vijnë as i u vete. Më është caktuar një dhomë e vogël në shtëpin e Kishës së Shën Prokopit, kishë që u ngrit me kujdesin timë. Marrim një pension prej 3000 lekve në muaj. Për fat të mirë sivjet çmimet e sendevet ushqimore kanë zbritur. Çmimi i bukës zbriti në 48 lek kil, tue qënë e ditur se fetarët, që cilësohen prej theorisë së re si parazitë të shoqërisë, nuk kanë më triska. Gjithashtu ullinj shiten 40 lek kil. Me këto shkojmë si më mir, sepse të tjera i kemi arruar qëkuri.

Sikurse thash, nuk merem më me çështje të Kishës, prandaj nuk kam asnjë dijeni si qëndrojnë këto punë aty. Dikur dilte aty një gazetë shqiptare; këtë nuk e shohim këtu. Do të isha mirnjojtës sikur të më shkronit diçka si venë punët kishëtare aty dhe njëkohësisht të më informonit për marrjen në dorëzim të kësaj letre.

Duke përsëritur urimet mbetem me përshëndetje vllazërore.

Monsegneur Hirësisë së Tij, Fan Noli.

Peshkop i Shqiptarvet t'Amerikës;

Boston.

Ish Kryepiskop' i Shqipërisë

Kristofor.

KAPITULLI IV

IDEOLOGJIA DHE PROPAGANDA

AQSH, Fondi 14-17 (KQ i PPSH), Viti 1981, D. 27, Fl. 2-27.

- Krijimi i Partisë Komuniste Shqiptare me shokun Enver Hoxha në krye si një domosdoshmëri historike dhe faktor subjektiv themelor për hedhjen e masave të popullit në luftën për çlirim kombëtar e shoqëror. Bazat ideologjike e organizative marksiste-leniniste të krijimit të partisë si parti e tipit të ri, si një përgjithësim dhe etapë më e lartë e lëvizjes revolucionare e komuniste në Shqipëri.

- Uniteti i çeliktë i radhëve të partisë i kalitur mbi bazën e marksizëm-leninizmit dhe të interesave të revolucionit. Konsekuenca revolucionare në ruajtjen e pastërtisë ideologjike e organizative, lufta e vendosur e pa kompromis kundër grupeve e pikëpamjeve likuidatore e deviatore si një nga rrugët e forcimit të partisë. Lidhjet e ngushta të Partisë me popullin dhe politika revolucionare e partisë për zbatimin në të gjitha problemet dhe etapat e vijës së masave.

- Strategjia dhe taktika revolucionare e ndjekur nga Partia, në përputhje me interesat dhe kushtet e revolucionit në Shqipëri. Zgjidhja e drejtë e problemit të aleancave duke vënë në bazë aleancën e klasës punëtore me fshatarësinë, krijimin e Frontit si bërthamë e bashkimit të mbarë popullit shqiptar dhe ruajtjen e rolit hegjemon dhe udhëheqës të Partisë në Front. Përcaktimi dhe zgjidhja në format dhe kohën e duhur të detyrave të mëdha të revolucionit me karakter antiimperialist, kombëtar e shoqëror. Këtu do të flitet edhe për format dhe fazat e Luftës Nacionalçlirimtare dhe të krijimit të pushtetit popullor duke u ndalur në vendimet dhe përvojën e Konferencës së Pezës, ku u vunë themelet e Frontit Nacionalçlirimtar dhe të pushtetit popullor, të Konferencës së Parë të Vendit të PKSH mbi përgatitjen e popullit për kryengritjen e përgjithshme të armatosur, të Kongresit të Përmetit etj.

- Programi madhështor i rindërtimit të vendit dhe hyrja në rrugën e socializmit. Planifikimi dhe mobilizimi i burimeve dhe forcave të popullit e të vendit, realizimet e planeve pesëvjeçare. Roli i kongreseve të Partisë në piketimin dhe përcaktimin e drejtë të rrugëve dhe ritmeve të zhvillimit në përputhje me situatat e brendshme dhe ato ndërkombëtare. Veçoritë dhe zhvillimet e secilit kongres si pika kyçe të planit të madh të Partisë për ndërtimin e shoqërisë socialiste e komuniste në vendin tonë.

- Industrializimi socialist i vendit dhe politika e Partisë për ndërtimin e bazës materialo-teknike të socializmit. Masat revolucionare për zhvillimin e shpejtë dhe të harmonishëm të degëve të ndryshme të industrisë për plotësimin e nevojave

të ndërtimit socialist. Zgjidhja revolucionare e problemeve dhe vështirësive të shkaktuara nga prapambetja e trashëguar e forcave prodhuese.

- Kolektivizimi i bujqësisë si një revolucion i madh i kryer nën udhëheqjen e Partisë. Metodat, format e punës dhe largpamësia e planeve dhe direktivave të Partisë në çështjen e kolektivizimit dhe rezultatet e bujqësisë socialiste.

- Lufta e PPSH në frontin ideologjik. Edukimi i vazhdueshëm i masave punonjëse me teorinë marksiste-leniniste. Forcimi i rolit udhëheqës të klasës punëtore, organizimi i kontrollit punëtor e fshatar. Roli i organizatave të masave si leva të Partisë. Lufta e Partisë sonë për emancipimin e gruas. Boshti marksist-leninist si bazë e sukseseve të arsimit, kulturës, artit dhe shkencës sonë. Lufta kundër fesë si një nga fitoret më të mëdha të revolucionit ideologjik dhe politika e drejtë e PPSH për këtë problem.

- Revolucionarizimi i vazhdueshëm i jetës së Partisë dhe të vendit si një nga shprehjet më të qarta të karakterit proletar të partisë dhe të shtetit të diktaturës së proletariatit tek ne. Kuptimi dhe zbatimi i drejtë i luftës së klasave, konsekuenca e luftës në të dy krahët, edhe kundër liberalizmit edhe kundër konservatorizmit. Zbërthimi i shkaqeve që kanë bërë Shqipërinë të vetmin vend në botë që ndërton socializmin në mënyrë korrekte, sipas mësimeve të marksizëm-leninizmit dhe që nuk u moleps nga tradhtia revizioniste. Masat konkrete revolucionare të marra nga PPSH për ngushtimin e dallimeve midis fshatit dhe qytetit, midis punës mendore dhe punës fizike etj., si pjesëmarrja e kuadrove në punën direkte në prodhim, reduktimi i raportit midis pagave të larta dhe të ulta në 1 me 2 etj.

- Mbështetja në forcat e veta si parimi bazë marksist-leninist i zbatuar nga PPSH në revolucionin popullor dhe në ndërtimin e socializmit. Puna kolosale e Partisë për realizimin në jetë të këtij parimi në të gjitha fushat e jetës, politike, ekonomike, mbrojtje, kulturë etj. Përvoja e PPSH në zgjimin e organizimin e potencialit krijues të popullit shqiptar për të ndërtuar socializmin me forcat tona. Rrugët që bënë të mundur që vendi ynë të jetë një vend pa taksa e tatime, që s'njeh papunësi e ngritje çmimesh, një vend që nuk merr kredi e ndihma nga asnjë vend kapitalist e revizionist etj. Një vend i rëndësishëm do t'i kushtohet sidomos periudhës pas vitit 1960, duke evidentuar përparimin e vrullshëm të Shqipërisë në rrugën e socializmit, në kushtet e bllokadës së revizionistëve hrushovianë dhe vitet e fundit të atyre kinezë, si janë kaluar vështirësitë e krijuara etj.

- Zhvillimi dhe programi i revolucionit tekniko-shkencor si një revolucion, që e bëjnë masat dhe që udhëhiqet nga politika proletare. Detyrat që ka zgjidhur ky revolucion në përputhje me nevojat e zhvillimit të shoqërisë socialiste në Shqipëri. Kujdesi i Partisë (plenumet, fjalimet e shokut Enver Hoxha etj.) për orientimin e drejtë të revolucionit tekniko-shkencor tek ne.

- Lufta kundër revizionizmit modern të të gjitha ngjyrave. Përvoja, betejat dhe fitoret e lavdishme të PPSH kundër revizionizmit jugosllav, kundër revizionizmit sovjetik, kundër revizionizmit kinez, kundër eurokomunizmit dhe gjithë revizionistëve të tjerë. Shkaqet e fitoreve, konsekuenca e luftës dhe drejtësia e parashikimeve të

PPSH për degjenerimin revizionist të çdo varianti qoftë.

- Lufta kundër imperializmit dhe qëndrimi parimor i mbajtur përballë ndërhyrjeve dhe intrigave imperialiste, që gjatë Luftës Nacionalçlirimtare e deri në ditët tona. Paraqitja dhe shpjegimi i forcës së PPSH dhe popullit në luftën kundër imperializmit amerikan, socialimperializmit sovjetik, socialimperializmit kinez etj.

- Mbështetja e luftërave revolucionare e nacionalçlirimtare të forcave revolucionare, proletariatit dhe popujve liridashës kudo në botë. Parimet e internacionalizmit proletar si parime bazë të politikës së drejtë të PPSH të zbatuara në gjithë periudhat përkrah popujve dhe partive markiste-leniniste. Jehona e madhe që ka pasur dhe ka në botë qëndrimi internacionalist i PPSH, veprat e shokut Enver Hoxha dhe ndihma për lëvizjet e ndryshme revolucionare e antiimperialiste.

- Mbrojtja e marksizëm-leninizmit dhe pasurimi i tij me përvojën e madhe teorike e praktike të PPSH. Forca e analizës dialektike të ngjarjeve ndërkombëtare dhe aftësia parashikuese e zhvillimit të ngjarjeve të vërtetuara nga jeta. Zbërthimi i tezës së madhe të PPSH se revolucioni është një çështje e shtruar për zgjidhje.

Në këtë rubrikë gjatë 7 muajve do të jepen mbi 60 biseda të ndryshme, për të cilat do të ketë një plan tematik.

2. – Përveç rubrikës së mësipërme, do të përgatiten një numër reportazhesh nga qendrat e mëdha të prodhimit, nga kantieret e ndërtimit, nga kooperativat bujqësore dhe rrethet e ndryshme të vendit për të treguar punën që bëhet, mobilizimin e popullit, arritjet e mëdha dhe transformimet e bëra në qytete e fshatra në kuadrin e 40-vjetorit të Partisë dhe të Kongresit të 8-të të saj.

3. – "SHQIPËRIA SOCIALISTE GJATË 5-VJEÇARIT TË SHTATË"

Në këtë rubrikë do të flitet për perspektivat që i hapen Shqipërisë në 5-vjeçarin e shtatë në të gjithë sektorët e jetës dhe cilat janë karakteristikat kryesore të tij, duke nënvizuar se ky plan realizohet tërësisht me forcat tona pa ndihma e kredi nga jashtë. Do të pasqyrohet dhe diskutimi në popull i direktivave të Kongresit të 8-të të Partisë për planin e 7-të pesëvjeçar. Në këtë rubrikë do të theksohet fort ideja se ç'është në gjendje të bëjë një popull kur është zot i vetvetes, kur mbështetet në forcat e veta, kur ka mundësi të shfrytëzojë burimet ekzistuese. Ideja themelore do të jetë ngjallja e besimit në popujt e tjerë se ç'mund të bëjnë ata po të jenë të lirë e të pavarur, po të kenë pushtetin popullor dhe të udhëhiqen nga një parti marksiste-leniniste.

4. – Për të njohur më gjerë Shqipërinë socialiste do të përgatiten çdo javë në ditë të caktuara tema me karakter njohës gjeografik, historik, ekonomik e kulturor mbi përparimet e gjithanshme të vendit në çdo fushë. Këto tema do të jepen në rubrikën: "JU NJOHIM ME SHQIPËRINË SOCIALISTE" dhe "JU PËRGJIGJEMI PYETJEVE TË DËGJUESVE".

5. – Do të luftohet për ngritjen e nivelit të rubrikës: "PËR NJË KULTURË DHE ART MILITANT REVOLUCIONAR", ku do të propagandohen arritjet e mëdha të artit tonë revolucionar të realizmit socialist, duke bërë edhe analizën e disa veprave tona të

veçanta. Këtu do të trajtohen edhe temat që kanë të bëjnë me traditat letrare e gjuhësore. Do të bëhet edhe kritika e artit dhe kulturës borgjezo-revizionistt, duke e ballafaquar me artin dhe praktikën artistike përparimtare botërore etj.

6. – Gjatë vitit 1981 do të shtohet numri i intervistave të marra nga miq, që vizitojnë vendin tonë, si dhe materialet e shtypit të huaj mbi Shqipërinë, të cilat do të jepen në rubrikën periodike: "ÇFARË PAMË NË SHQIPËRINË SOCIALISTE".

7. – Gjithashtu gjatë këtij viti, do të transmetohet rubrika: "DUKE SHFLETUAR KALENDARIN SHQIPTAR", në të cilën do të përkujtohen një sërë ngjarjesh, datash historike e figurash patriotike e revolucionare nga luftërat për liri e pavarësi, sidomos nga epopeja e lavdishme e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare si edhe periiudha e ndërtimit socialist. Këtu do të futen edhe përkujtimi i figurave të kulturës sonë, të njohura jashtë.

MBI PASQYRIMIN E PROBLEMEVE NDËRKOMBËTARE

Programimi i gjithë qëndrimeve dhe i vijës së drejtë marksiste-leniniste të PPSH në fushën e politikës së jashtme dhe për problemet e ndryshme të marrëdhënieve ndërkombëtare do të zërë, gjithashtu, një vend të gjerë në propagandën për botën e jashtme nëpërmjet Radios. Në këtë kuadër do të vazhdojë zbërthimi i mëtejshëm i tezave dhe i konkluzioneve të shokut Enver Hoxha në veprat "Imperializmi dhe revolucioni", "Eurokomunizmi është antikomunizëm", "Hrushovianët", "Kujtime" etj., duke nxjerrë në pah drejtësinë e qëndrimeve, parashikimeve dhe analizës marksiste-leniniste të Partisë sonë për çështje të ndryshme të zhvillimit ndërkombëtar. Do të evidentohet më mirë ngritja e luftës revolucionare e çlirimtare, forcimi i lëvizjes marksiste-leniniste, demaskimi i imperializmit, socialimperializmit, revizionizmit modern, borgjezisë e reaksionit, deri te kriza e thellë dhe e gjithanshme ekonomike, politike, ideologjike, morale e shpirtërore, që ka mbërthyer sistemin kapitalisto-revizionist. Për t'i paraqitur më mirë këto, do merren këto masa:

1. – Do të shtohen lajmet mbi problemet ndërkombëtare, duke zgjeruar si tematikën, ashtu dhe gjeografinë e tyre, sidomos për disa zona, që tani japim më pak, si për vendet revizioniste, Amerikën Latine dhe Afrikën.

2. – Do të shtohen shënimet politike të ditës për ngjarjet e rëndësishme ndërkombëtare për ta bërë propagandën tonë më të shpejtë, më aktive dhe më efikase. Në këtë kuadër do të hapet edhe një rubrikë e re: "PASQYRA E NGJARJEVE NDËRKOMBËTARE TË JAVËS".

3. – Rubrikat e përjavshme: "Marksizëm-leninizmi – doktrinë gjithmonë e re dhe shkencore", "Rritet dhe forcohet lëvizja m-l nëpër botë", "Partitë marksiste-leniniste – forca udhëheqëse e lëvizjes së sotme revolucionare" dhe "Në luftë për çlirim kombëtar e shoqëror", do të kenë një tematikë vjetore në përshtatje me aktualitetin ndërkombëtar dhe me problemet dhe interesat, që kanë lëvizja marksiste-leniniste dhe forcat revolucionare në botë. Do të luftohet për të ngritur nivelin veçanërisht të rubrikave: "Rritet e forcohet lëvizja marksiste-leniniste nëpër botë" dhe "Në luftë për çlirim kombëtar e shoqëror". Për rubrikën e parë do të punohet për të zgjedhur më

mirë tematikën e materialeve të partive m-l në mënyrë që problemet e trajtuara në të, të kenë interes për gjithë lëvizjen m-l. Gjithashtu do të luftohet për një pasqyrim të gjerë të aktivitetit konkret të partive m-l, sidomos, atyre të reja, si ato të Indisë, Voltës, Togës, Dahomeit, Venezuelës etj. Në rubrikën e dytë, përveç informacionit të plotë mbi aksionet e forcave revolucionare do të ketë më tepër të dhëna gjeografike, historike dhe ekonomike, për të treguar kushtet në të cilat zhvillohet lufta në një vend të caktuar ose zonë, forcat lëvizëse të saj dhe perspektivat e revolucionit.

4. – Për forcimin e specifikës do të synohet që, qoftë materiali i vendit, qoftë materiali ndërkombëtar, të përputhen me kërkesat dhee karakteristikat e dëgjuesve të zonës dhe të gjuhës përkatëse. Çdo ditë në emisionet e Radios së Jashtme do të ketë materiale specifike, lajme, komente, artikuj shtypi etj., për zonat dhe vendet përkatëse.

- Përveç demaskimit të imperializmit, socialimperializmit, revizionizmit modern, borgjezisë dhe regjimeve reaksionare në vendet përkatëse, redaksitë e specializuara do të rrisin numrin e materialeve të drejtuara, që kanë të bëjnë me historinë, traditat dhe luftën e popujve të zonave të tyre. Për këtë qëllim, të gjitha redaksitë, do të zgjerojnë tematikën e rubrikës: "Ngjarje dhe figura të shquara revolucionare", duke futur figura dhe data historike nga tërë vendet e zonës apo vendit, të cilit i drejtohet propaganda jonë.

- Redaksia e Perëndimit do të hapë një rubrikë të re të përjavshme me titull: "FYTYRA E VËRTETË E BOTËS KAPITALISTE", në të cilën do të bëhet një propagandë e përqendruar kundër sistemit kapitalist, plagëve, kontradiktave të tij, duke qëndruar në pamjet konkrete të vendit e fenomeneve të veçanta.

- Redaksia e Lindjes do të ketë në qendër të vëmendjes demaskimin e revizionizmit sovjetik si në politikën e jashtme, ashtu dhe të brendshme. Do të flitet veçanërisht për krizën politike, ekonomike e shoqërore që ka pllakosur BS dhe vendet e tjera revizioniste dhe pasojat e saj, për karakterin e pronës dhe të shpërndarjes, për reformat ekonomike, mbi politikën rusomadhe, mbi karakterin e Partisë dhe të shtetit etj. Për këto do të nxirren fakte dhe argumente të reja nga literatura sovjetike. Gjithashtu do të transmetojë cikle bisedash për të demaskuar tezat e kongreseve të partive revizioniste në BS, Bullgari, Poloni, RDGJ etj., që do të mbahen këtë vit.

- Redaksia e Perëndimit, e Afro-Azisë dhe ajo e Amerikës Latine do të hapin rubrikën: "DUKE SHFLETUAR SHTYPIN REVOLUCIONAR", e cila do të ketë artikuj të shtypit të partive marksiste-leniniste ku i bëhet analizë ngjarjeve të ndryshme ndërkombëtare dhe gjendjes në vendet e tyre. Kjo rubrikë do të transmetohet edhe për vendet e Lindjes kur artikujt e shtypit marksist-leninist analizojnë gjendjen në vendet revizioniste apo ngjarjet ndërkombëtare.

- Redaksia e Afro-Azisë do të zgjerojë planin e saj tematik të ciklit të bisedave për Afrikën, duke shfrytëzuar më mirë kalendarin historik dhe problematikën aktuale të këtij kontinenti.

- Në vendet e Afrikës, Azisë dhe Amerikës Latine do të flitet më tepër për faktorët objektivë e suvjektivë të revolucionit. Për këtë do të përgatisim një cikël bisedash

teorike e ideologjike mbi rrugën e zhvillimit të këtyre vendeve, mbi dialogun veri-jug dhe rendin e ri ekonomik (në kuadrin e konferencës së nivelit të lartë veri-jug, që do të zhvillohet këtë vit në Meksikë) etj.

PROPAGANDA PËR SHQIPTARËT JASHTË ATDHEUT

Gjatë vitit 1981 do të intensifikohet propaganda për shqiptarët jashtë Atdheut për t'u bërë të njohur atyre rrugën e lavdishme të Shqipërisë gjatë 40 vjetëve nga themelimi i partisë. Për të pasqyruar gjerësisht këtë rrugë historike do të hapet rubrike: "TRANSFORMIME NË VITET E PARTISË", në të cilën do të jepet korrespondenca, reportazhe, përshkrime, intervista e biseda, sidomos nga ato rrethe e zona, të cilat janë tipike për shqiptarët jashtë. Po ashtu, në kuadrin e 40-vjetorit do të jepet programi muzikor: "Populli i këndon Partisë".

Në emisionin për shqiptarët jashtë Atdheut vend të rëndësishëm do të zënë edhe sivjet problemet e Kosovës. Do të pasqyrohen gjerësisht traditat patriotike të popullit të Kosovës, ngjarjet e shquara të tij. Për këtë do të shfrytëzohen veç materialeve të përgatitura nga redaksia edhe ato të shtypit, të Radios së Brendshme e të Televizionit, do të jepen më shumë pjesë të dramatizuara.

Do të jepen materiale të ndryshme lidhur me ato probleme që e shqetësojnë popullin e Kosovës, do të jepen materiale ku të flitet se si i ka zgjidhur ato Partia e Punës në vendin tonë si mbi zhdukjen e plagëve të së kaluarës (kurbetit, papunësisë, vëllavrasjes, zakoneve prapanike etj., mbi problemin e gruas, të drejtat që gëzon ajo, problemin e rinisë, të arsimit, kulturës, shëndetësisë etj.).

Në fushën e letërsisë e artit do të jepen vëllime me poezi, tregime, fragmente romanesh të autorëve kosovarë. Gjithashtu do të transmetohen materiale lidhur me trashëgimin e materiale shpirtërore të popullit të Kosovës, do të pasqyrohet krijimtaria gojore e tij.

Në emisionet për shqiptarët jashtë Atdheut do të pasqyrohen aktivitetet që do të zhvillohen në Kosovë, do të intervistohen njerëzit tanë që shkojnë në Kosovë si dhe kosovarë që vijnë tek ne. Një vend të gjerë do të zërë në emision muzika kosovare. Do të shfrytëzohen edhe materialet e shtypit në këtë drejtim.

PËR NGRITJEN E CILËSISË SË MATERIALEVE DHE PARAQITJEN ARTISTIKE TË EMISIONEVE

Duke plotësuar këtë tematikë të zgjeruar, kolektivi i Radios së Jashtme do të luftojë akoma më shumë për ngritjen e cilësisë së materialeve dhe emisioneve, për t'iu përgjigjur më mirë detyrave që shtron Partia për propagandën për jashtë si dhe nevojave të dëgjuesve. Për këtë:

- Do të luftohet frazeologjia në shkrimet, shtampa, ujët e tepërt, mungesa e informacionit dhe e analizës etj.

- Do të luftohet për forcimin e argumentimit shkencor në gjithë materialet, për forcimin e mendimit të partishëm, për një propagandë më realiste, bindëse dhe të efektshme, për materiale më të shkurtra dhe konçize.

- Do të luftohet për forcimin e karakterit radiofonik të materialeve tona, për një përputhje sa më të mirë të tyre me natyrën e mikrofonit dhe kërkesat e dëgjuesve të huaj.

- Do të rritet më tej cilësia e përkthimeve, duke bërë një punë më intensive për pasurimin e fondit të fjalorit në seciilën gjuhë nga ana e përkthyesave, nëpërmjet kartelizimit sistematik të shprehjeve, fjalëve e rregullave të ndryshme morfologjiko-sintaktike të reja.

Disa probleme që dalin në veprimtarinë e Radios së Jashtme
dhe Televizionit pë propagandën me Jashtë

Organizatat bazë të Partisë, Drejtoria e kolegjumi i RTSH në punën e tyre për zbatimin e detyrave të protokollit të Sekretariatit të QK të partisë të 27 prillit 1977 për propagandën me botën e jashtme, janë përqendruar në shtrirjen e emisioneve për vende të tjera e gjuhë të reja, në zgjerimin e tematikës me material nga vendi ynë, nga bota e vendi përkatës si dhe në ngritjen e mëtejshme të cilësisë së këtyre materialeve. Në këtë kuadër janë hapur emisione e rubrika të reja si p.sh. në gjuhën kineze, persiane e suedeze, u zgjerua emisioni në gjuhën shqipe për shqiptarët jashtë atdheut. Jepen emisione të veçanta për Spanjën dhe Amerikën Latine në gjuhën spanjolle e portugeze. Janë hapur një sërë rubrikash të reja, si "Ju njohim me Shqipërinë Socialiste", "Shqipëria gjatë një jave" etj.

Në televizion u krijua një emision i posaçëm për prodhimin e filmave dokumentarë e kronikalë, të cilët janë shfaqur nga dhjetëra stacione televizive të botës. Teledokumentari me ngjyra për zhdukjen e pasojave të tërmetit të 15 prilli 1979 u transmetua me satelit për Evropën, Lindjen e Mesme, Zonën e Pacifikut, Amerikën e Veriut e Jugore; manifestimi i madh fizkulturor i Spartakiadës IV Kombëtare u shfaq në 63 vende të ndryshme të botës etj.

Nga letrat e dëgjuesve të huaj, emisionet e Radio Tiranës për botën e jashtme, vlerësohen si i vetmi burim për informacion të vërtetë e të saktë, jo vetë, për realitetin në vendin tonë, por edhe për gjendjen në arenën ndërkombëtare dhe në vende të veçanta të botës. Në to haset ballafaqimi i gjendjes së rëndë ekonomike e shoqërore në vendet e tyre me realitetin në Shqipëri. Në to botohet vlerësimi i lartë sidomos për veprat e shokut Enver Hoxha dhe i materialeve të tjera të Partisë sonë. Gjithashtu u bëhen vlerësime edhe komenteve e shënimeve politike, lajmeve etj., të cilat çmohen si përkrahje dhe mbrojtje e fortë e interesave të popujve dhe revolucionit. Në letrat që dërgojnë bashkatdhetarët nga vende të ndryshme shkruajnë se i ndjekin rregullisht emisionet për shqiptarët jashtë atdheut, se duke i dëgjuar ato e ndiejnë veten sikur të jenë në Shqipëri, zërin e Radio Tiranës e quajnë kënaqësinë më të madhe të jetës së tyre. Dëgjuesit kosovarë shkruajnë se gëzohen për sukseset e arritura, sepse janë "vëllezër të një nëne, të një flamuri, të një gjaku".

Pa dyshim në këto vlerësime shprehet edhe puna e mirë e komunistëve, kuadrove dhe gjithë punonjësve të RTSH.

I. Me gjithë përmirësimet që janë arritur, si në tematikë ashtu edhe në shtrirje e

emisioneve duhet pranuar se niveli ideologjik, teorik, gazetaresk e propagandistik i emisioneve të përgatitura nga punonjësit e radios, ose dhe nga bashkëpunëtorët, është akoma larg kërkesave që shtron Partia. Ai nuk është kurdoherë e nuk është sa duhet e si duhet në përputhje me atë rol të madh, me rëndësi historike, që po i takon të luajë Partia jonë sot në botë; ky nivel është akoma larg forcës ideore e frymëzuese që ka e që ushtron Partia jonë me dokumentet e saj e me anën e veprave të shokut Enver në lëvizjen marksiste-leniniste, në luftën e klasës punëtore dhe të popujve për çështjen e revolucionit e të planeve agresive të superfuqive imperialiste e socialimperialiste kundër popujve.

Dëgjuesit e huaj presin me interesim zërin e Shqipëeisë, duan të mësojnë për realizimet e saj të mrekullueshme në ndërtimin e shoqërisë së vërtetë socialiste, duan të dinë mundësinë e pikëpamjet e Shqipërisë për probleme të rëndësishme ndërkombëtare, duan të mësojnë të vërtetën mbi fenomenet e mbi ngjarjet në botë, qëndrimin parimor, klasor ee revolucionar të Partisë sonë, analizën m-l që u bën ajo ngjarjeve e fenomeneve të botës, duan të mësojnë rrugët e zgjidhjes së problemeve që preokupojnë sot lëvizjen m-l, klasën punëtore, rininë e shtresa të tjera të shoqërisë së sotme, gjithë popujt e botës.

Duhet pranuar se, me gjithë përmirësimet, niveli i emisioneve nuk është ai që kërkohet e nuk u përgjigjet si duhet kërkesave që shtrohen në protokollin e Sekretariatit të KQ si dhe me porositë e herëpashershme të Partisë.

1. Një detyrë të rëndësishme që cakton Partia për radion e jashtme është që kjo të bëjë sa më të njohur nga të huajt vendin tonë nga çdo pikëpamje, të bëjë të njohur të kaluarën e të tanishmen e tij, historinë e popullit tonë, si dhe politikën e Partisë e shtetit tonë socialist. Për këtë qëllim është përcaktuar dhe një kriter që mbi 50% të materialeve të emisioneve për botën e jashtme ta zënë materialet mbi Shqipërinë. Nga leximi i pjesshëm i disa emisioneve vihet re se ky kriter nuk respektohet, bile raporti i materialeve të brendshme me të jashtmet është 36% me 64%. Jo vetëm kaq, por cilësua e materialeve tona për jashtë lë shumë për të dëshiruar sidomos lajmet mbi arritjet e ndërtimit socialist etj. “Po të transmetohen lajme të parëndësishme, siç ka ndodhur në disa raste, - porosit shoku Enver Hoxha, - atëherë nuk do ta dëgjojë njeri me interesim radion tonë. Prandaj lajmet duhet të përpunohen mirë...”. Për të huajt duhen bërë emisione të përgatitura mirë, - porosit shoku Enver. Për problemet tona duhet që informacionet tona të punohen me kujdes. Të bëjmë të njohur në popujt e botës të kaluarën e lashtë të popullit tonë, historinë e Luftës Nacionalçlirimtare, si dhe luftën për ndërtimin socialist të vendit e arritjet tona në këtë drejtim.

Organizata-bazë e Partisë e Radios për botën e Jashtme duhet të thellohet më shumë me qëllim që të elimonohen të metat që vërehen në propagandimin e vendit tonë, që kjo propagandë të ngrihet në nivelin e kohës dhe të kërkesave për dëgjuesit e jashtëm.

Në përgjithësi lajmet e emisioneve të muajit prill, për arritjet tona, për ndërtimin socialist janë përpunuar dobët. Në mjaft raste ato janë të ngjashme me lajmet që

përdoren për brenda vendit dhe nuk janë marrë parasysh njohuritë, kërkesat dhe interesat e dëgjuesit të huaj ndaj vendit tonë. Lajmet nuk zgjidhen, nuk përpunohen, janë të gjata e të mërzitshme. Kështu p.sh. "inaugurimi i urës në Floqin e Korçës", "arritjet në Finiq e në Spaç", "15 ndërmarrje e sektorë prodhimi në Prrenjas, që kishte para çlirimit një dyqan të vogël për udhëtarë", "Tirana pas çlirimit krijoi 300 parqe e lulishte", "Ekonomia shqiptare po plotëson gjithnjë e më mirë jo vetëm nevojat e vendit, por edhe kërkesat e tregut të jashtëm", "realizimi i planit të kësaj ndërmarrje apo fabrike në 101%" etj., nuk kanë as vlerë propagandistike e as vlerë njohëse për sukseset e ndërtimit socialist në Shqipëri.

Të huajve mund t'i interesojnë shifra të realizimit të planit, por për ta është më interesante në qoftë se flitet për sukseset në tërësi, për aspekte nga jeta e gjallë e vendit, për transformimet e mëdha sociale të popullit tonë, për të drejtat që gëzon qytetari në RPSSH etj. Të huajve u bëjnë përshtypje sukseset e vendit tonë në fushën e shëndetësisë, të emancipimit të gruas etj. Të huajt vlerësojnë arritjet tona për profilaksinë dhe për shërbimin shëndetësor falas, kurse në lajmin që jepet për botën e jashtme nga fjala e delegacionit tonë në konferencën botërore të shëndetësisë flitet në përgjithësi për luftën kundër imperializmit, socialimperializmit e asgjë konkrete mbi arritjet e mëdha të profilaksisë në vendin tonë. Po kështu lajmet mbi arritjet dhe plotësimin e detyrave tona në fushën e bujqësisë në këtë apo atë kooperativë përbrenda vendit ndiqen me interes e nxisin emulacionin në punë, kurse për dëgjuesin e jashtëm lajmet me karakter ekonomik duhet të punohen me kujdes, duke u mbajtur parasysh se ato bëjnë efekt nëse jepen bilance që tregojnë arritjet tona si në krahasim me të kaluarën e vendit tonë, ashtu edhe në krahasim me gjendjen në vendet e tjera e mundësisht në krahasim edhe me vende, të cilave u drejtohet emisioni.

2. Nga leximi i komenteve e shkrimeve kryesore të muajit prill, nga diskutimet me shokët dhe redaktorët e emisioneve për botën e jashtme, duket se janë bërë përpjekje për një përpunim, argumentim më të kujdesshëm të këtyre materialeve. Mund të përmenden komentet e sh. Murrati, disa komente të sh. Vl. Cicani etj., por megjithatë komentet si dhe shkrimet e tjera nga Shqipëria etj., lënë shumë për të dëshiruar në argumentimin e duhur të ideve e të tezave që duam të përhapim me propagandën tonë nëpërmjet Radios së Jashtme. Idetë dhe konkluzionet vihen në shkrime sikur janë të njohura nga dëgjuesit e huaj, nuk ka analizë të thelluar të problemeve, shkrimet vuajnë nga globalizmi e tendenca për t'i thënë të gjitha gjërat në një koment të vetëm. Ka ndonjë rast që në komente jepen argumente jo bindëse, të pasakta, siç është rasti i komentit me rastin e 40-vjetorit mbi rolin udhëheqës të PPSH, ku thuhet se faktorët që e bënë PKSH të ketë rolin hegjemon të udhëheqjes së luftës etj., ishin "dëshira", "mungesa e partive të tjera politike", "situata revolucionare"; apo në komentet e 1 prillit mbi arsimin në BS, ku nxirret konkluzioni se "interesimi minimal i borgjezisë sovjetike për arsimin e ka burimin në etjen për fitime"; ose komenti mbi bujqësinë në BS, ku argumentet nuk janë bindëse lidhur me degjenerimin e saj dhe faktet lidhur me punën private nuk janë

reale. Një propagandë e tillë nuk është bindëse. Prandaj duhet luftuar për cilësi të lartë si në përmbajtje ashtu dhe në formë, të propagandës me botën e jashtme.

Organizata bazë e partisë e Radios së Jashtme duhet të bëjë një punë më të thelluar dhe të organizuar me komunistët e punonjësit që shkrimet dhe komentet për botën e jashtme të jenë të argumentuara e të thella, që asnjë shkrim të mos jetë i zhveshur nga argumentet, se vetëm argumentet kanë forcën e duhur bindëse për të krijuar te dëgjuesi i huaj ato ide revolucionare që mbron e përkrah Partia jonë. Dhe për të mësuar se si duhet shkruar në mënyrë të argumentuar e bindëse për problemet kemi nga të mësojmë. Shkrimet e shokut Enver Hoxha janë një shembull i shkëlqyer i argumentimit teorik, politik, ekonomik e shoqëror të temave të Partisë sonë.

Për të ngritur më lart nivelin e përmbajtjes ideologjike e politike të propagandës së Radios për botën e jashtme, rëndësi ka që redaksitë të zbatojnë detyrat e caktuara për kualifikimin e tyre. Të bëjnë një punë kolegjiale e të vazhduar, të shqyrtojnë e të gjykojnë kolegjialisht shkrimet më të rëndësishme, të bëjnë diskutime teorike e debate për komentet e ndryshme.

Në planin e objektivave të vitit 1981, janë parashikuar drejt disa masa që kanë të bëjnë me kualifikimin e mëtejshëm të redaktorëve e punonjësve të tjerë të redaksive, por këto kanë mbetur në letër. Kështu, p.sh. në objektiva parashikohej që çdo të hënë pasdite, në bazë redaksie, e për raste të veçanta edhe në bazë drejtorie, do të organizoheshin diskutime për problemet më të rëndësishme politike të javës, për tematikën e shkrimeve, ndërsa çdo të martë pasdite redaksitë do të diskutonin dhe analizonin shkrimet e mira e më të dobëta të javës. Nga takimet që ekipi mori me shokët e Drejtorisë dhe të redaksive del se kjo detyrë është bërë me hope ose është neglizhuar fare.

3. Një problem i madh, që ka të bëjë direkt me ngritjen e nivelit të propagandës në botën e jashtme, dhe për të cilin udhëheqja e Partisë ka tërhequr vazhdimisht vëmendjen e punonjësve të Radio Televizionit sidomos Radios së Jashtme është propaganda e diferencuar për zona dhe vende të veçanta, problemi i specifikës në emisionet për jashtë.

Nga shqyrtimi i materialeve të 5-mujorit të parë të vitit 1981, nga diskutimet që bënë shokët e ekipit me shokët e Drejtorisë, me redaksitë dhe me sekretarët e organizatave bazë, del se në këtë drejtim ka përmirësime. Kjo punë bëhet më mirë për vendet ku punojnë shokët e huaj, si p.sh. për Brazilin, për Spanjën, për Portugalinë, për Gjermaninë.

Megjithëkëtë, ky është problem për të cilin organizata bazë e partisë duhet të tregojë kujdes të madh e të vazhdueshëm, sepse akoma ka shumë boshllëqe dhe mungesa të theksuara në realizimin e detyrave që janë shtruar, të cilat mbulohen me arsyetime të pajustifikuara, si "nuk kemi redaktorë përkatës" etj. Si pasojë, emisionet e disa vendeve: Çeki, Rumani, Poloni, Bullgari, pë vendet e Azizë, Afrikës, Amerikës Latine, për vendet skandinave, bile edhe për BS, për SHBA, për Kinën, janë shumë të zbuluara nga dhënia e materialeve të diferencuara, specifike. Kjo arrin deri aty sa edhe për kongreset që zhvilluan partitë e disa vendeve revizioniste

gjatë këtij gjashtëmujori nuk u bë asnjë koment për demaskimin e tezave të tyre, përveç Kongresit të 26-të të BS, megjithëse kjo detyrë parashikohej edhe në planin e vitit 1981. Redaksia për vendet afro-aziatike është mjaftuar me ngjarjet në Lindjen e Mesme, të cilat kanë rëndësinë e tyre, por vendet aziatike dhe afrikane mbeten të zbuluara. Redaksia e vendeve revizioniste, p.sh. për Poloninë, Çekinë, Bullgarinë etj., që kanë pasur plot ngjarje, sidomos Polonia, gjatë muajit prill nuk ka asnjë shkrim apo koment të specifikuar.

Kjo çon patjetër në atë që të bëhet një propagandë uniform për të gjitha vendet dhe një politikë e tillë çon pa dyshim në rënien e interesit të të huajve për të dëgjuar Radion tonë, në uljen e efikasitetit të propagandës sonë nëpërmjet emisioneve të Radios.

Mungesat që vërtetohen në zbatimin e orientimeve të Partisë për propagandën e diferencuar përveç marrjes së masave të menjëhershme për plotësimin e organikave të redaksive nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme duken kërkuar edhe në mospreokupimin e duhur nga punonjësit e redaksive për të siguruar më shumë lajme, shkrime nga ngjarjet e ndryshme të vendeve përkatëse, nga historia, kultura, figurat e shquara revolucionare apo të artit e të kulturës etj. Nuk është e lejueshme që Radio e Jashtme akoma sot, mbas kaq vjetësh, të mos disponojë as muzikën e nevojshme të këtyre vendeve për shoqërimin e materialeve që transmeton në drejtim të tyre.

Një problem që vihet re në këtë drejtim, është se lajmet dhe komentet jepen të vonuara dhe nuk mbahet shumë parasysh aktualiteti.

Dobësitë në propagandën e diferencuar e kanë burimin edhe në punën e dobët e të pamjaftueshme që bëhet nga redaksitë për t'u njohur sa më thellë me problemet dhe me ngjarjet më kryesore të vendeve që ndjekin. Kjo dobësi bën që propaganda të mbetet e përgjithshme dhe të mos zgjojë interesin e duhur te dëgjuesit. Me propagandën tonë duhet t'u drejtohemi dëgjuesve me atë mënyrë që të influencojnë në mendimin e në veprimin e tyre.

Për këtë duhet një shfrytëzim më i mirë i burimeve ekzistuese siç janë p.sh. materialet e ndryshme që i vijnë MPJ, por që akoma nuk shfrytëzohen sa dhe si duhet nga redaktorët. Po kështu duhet të bëhen më shumë përpjekje për shfrytëzimin e literaturës së huaj që vjen në bibliotekat dhe institucionet e ndryshme të kryeqytetit.

Në planin dhe objektivat për vitin 1981 janë planifikuar detyra mjaft të mira, zbatimi i të cilave do ta ngrinte në një nivel akoma më të lartë cilësinë e emisioneve për botën e jashtme duke forcuar punën e diferencuar etj. Kështu p.sh., në plan parashikohet që:

"Çdo ditë të ketë të paktën një material (një temë) nga Shqipëria në përshtatje vetëm për vendet kapitaliste, për vendet revizioniste dhe për "vendet në zhvillim". Kjo detyrë është realizuar vetëm për vendet perëndimore, kurse për vendet e tjera jepet në mënyrë shabllone i njëjti material.

- Për të pasur të paktën një material nga zona dhe vendi përkatës, të zgjerohet tematika dhe gjeografia e tyre. Redaksitë do të përgatisin çdo ditë mbi 10 lajme me burim radio. Nuk është arritur, sidomos për vendet e Lindjes Afrikës, Azisë e Amerikës Latine.

- Çdo redaktor do të përgatisë të paktën një studim gjatë gjashtëmujorit, i cili do të diskutohet në shkallë drejtorie. Në plan janë parashikuar vetëm 5 tema, megjithatë deri tani nuk është bërë asnjë.

- Të hapen kurse për mësimin e gjuhëve të huaja nga redaktorët (frëngjisht, anglisht, spanjisht, gjermanisht, turqisht), të cilat do të drejtohen nga specialistët e huaj të radios. Deri tani është hapur vetëm kursi i turqishtes.

Në planin dhe objektivat parashikohen edhe detyra të tjera si "zhvillimi i bisedave çdo muaj me kuadro e specialistë të institucioneve të tjera";

"Sigurimi i 5 shkrimeve rezervë nga çdo redaktor për materialet që kthehen"; organizimi i një mbledhjeje me bashkëpunëtorët, për të tërhequr mendimet e tyre; përgatitja e shënimeve politike të shkurtra për ngjarjet më të rëndësishme etj., detyra këto që në përgjithësi gjithashtu nuk janë realizuar.

Një qëndrim i tillë pa përgjegjësi dhe formal ndaj objektivave dhe planit të vitit 1981, nuk tregon për punë të dobët, për neglizhenca të palejuara si nga ana e shokëve të drejtorisë, redaktorëve dhe vetë organizatave bazë të partisë? Megjithëse po mbushet gjysma e vitit, asnjë nga organizatat bazë nuk është ndalur dhe të analizojë si po punohet për realizimin e objektivave të vitit 1981. Në punën dhe mobilizimin për realizimin e planeve, objektivave dhe detyrave duhet të kërkojmë në radhë të parë, edhe shkakun e dobësive tona dhe jo të mbetemi në justifikime, në kërkesat e faktorët "objektivë", të cilët edhe mund të kenë ndikuar në ndonjëfarë mase, por që nuk janë determinantët.

4. Një problem tjetër që ngrihet me forcë në materialet e Partisë është problemi i kundërpropagandës. Nga materialet me të cilat patëm mundësi të njihemi, del se ky problem trajtohet më pak, megjithëse siç dihet, propaganda armiqësore kundër vendit tonë nuk ka pushuar asnjëherë.

Mendojmë se ky problem duhet të tërheqë më shumë vëmendjen e organizatës bazë të partisë, të Drejtorisë së Jashtme dhe të redaksive përkatëse dhe të punojnë për forcimin e saj. Rëndësi ka që redaktorët të njihen me shpifjet që bëhen nga radiot e shtypi borgjez e revizionist ndaj vendit tonë, me qëllim që t'i hedhin poshtë duke u vënë përballë realitetin tonë, gjendjen reale të vendit tonë, duke intensifikuar kundërpropagandën, karakterin e saj ofensiv në sulmet dhe shpifjet e tyre.

5. Një detyrë e rëndësishme e organizatës bazë dhe e kolektivit është që të tregohet më shumë vëmendje për emisionet për shqiptarët jashtë atdheut.

Me gjithë punën e mirë që bëhet në këtë fushë, nga një vështrim i shpejtë i materialeve konstatohet tendenca e globalizmit, mungesa e specifikës, transmetimi i materialeve pa një plan e synime të caktuara e të përpunuara, lidhen me qëllimet që duam të arrijmë. Materialet janë pothuajse njësoj si për dëgjuesit e brendshëm, shpesh krahasimet nuk janë të goditura dhe argumentet jo bindëse. Për shqiptarët jashtë shtetit duhet të shfrytëzohen më shumë intervistat e bashkatdhetarëve, bisedat me punonjës të ndryshëm të industrisë, bujqësisë, artit, kulturës etj.

Një punë e posaçme duhet bërë sidomos në drejtim të Kosovës, sipas porosive dhe orientimeve të dhëna kohët e fundit nga KQ. Këtë problem ne e ndeshim më pak

në materialet që ndoqëm, por mendojmë që organizata bazë e partisë, drejtoria dhe gjithë punonjësit duhet të bëjnë planet e tyre të detajuara e me perspektivë për të zbatuar si duhet dhe në lartësinë e duhur detyrat me përgjegjësi që ka shtruar Partia.

II. Në punën për përmirësimin e propagandës me botën e jashtme, detyra të rëndësishme i janë ngarkuar nga Partia Radiotelevizionit tonë në drejtim të përmirësimit të mëtejshëm të programeve, por sidomos prodhimit të filmave e të kronikave për botën e jashtme.

Me gjithë përmirësimet, përpara organizatës bazë, komunistëve, drejtorisë dhe gjithë punonjësve dalin detyra të mëdha për zbatimin e këtyre porosive.

Për këtë çdo vit janë bërë plane dhe programe pune, por ato nuk janë zbatuar. Është e vërtetë, se një nga shkaqet për mosrealizimin e kësaj detyre ka qenë mungesa e lëndës së parë, por ka pasur edhe shumë faktorë të tjerë subjektivë, që me përpjekje, me një organizim dhe mobilizim më të mirë të punonjësve realizimet do të ishin më të mira. Kështu p.sh., konstatohet plogështi për të gjetur treg dhe për shpërndarjen e ofertave, mosorganizimi i duhur i punës me bashkëpunëtorët për skenarët, të cilët nuk i përgjigjen kërkesave të veçanta të propagandës me jashtë.

Zgjerimi i mëtejshëm i kontakteve të Televizionit tonë me botën e jashtme në drejtim të shpërndarjes së dokumentarëve, filmave artistikë dhe programeve të tjera, mbetet një detyrë e përhershme. Për këtë është e nevojshme që organizata bazë të vërë në pozita më luftarake sektorin përkatës që të zgjerohet në përputhje me kërkesat që i shtrohen, që të njohë më mirë kërkesat e tregut, të jetë më operativ në kontaktet me MPJ, në forcimin e lidhjeve dhe të bashkëpunimit me ambasadat dhe shoqatat e miqësisë, në plotësimin e kërkesave dhe dëshirës së disa klientëve të huaj për të vizionuar programe në vendin tonë.

Një fushë tjetër veprimi në të cilën organizata bazë e Partisë dhe Drejtoria e Televizionit duhet të punojnë më mirë në të ardhmen, është ajo e zgjerimit dhe e forcimit të bashkëpunimit me qendrat e ndryshme radiotelevizive. Gjendja aktuale e bashkëpunimit është e pajustifikueshme dhe nuk i përgjigjet as mundësive e as kërkesave të kohës. Për këtë organizata e partisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Radiotelevizionit duhet të ulet dhe të gjejë shkaqet e vërteta dhe rrugët për të dalë nga kjo situatë, sepse siç dihet kërkesat nuk kanë munguar. Mospjesëmarrja e përfaqësesve të RT Shqiptar në disa takime ndërkombëtare, apo mungesa e ndonjë aparature të posaçme, kanë pasur ndikimet e tyre negative, por nuk duhet justifikuar puna jonë e dobët dhe e pamjaftueshme me kaq, sepse vetëm gjatë viteve 1978-1980 RT i janë bërë 39 kërkesa, ndër të cilat kanë marrë përgjigje pozitive vetëm 8 prej tyre.

- Në kushtet aktuale, kur RT i Prishtinës deklaroi zyrtarisht prerjen e çdo marrëdhënieje bashkëpunimi, përpara organizatës bazë të partisë dhe Drejtorisë së RTSH dalin detyra urgjente për të gjetur rrugë e mundësi për një shtrirje e bashkëpunim me qendrat radiotelevizive ku ka kosovarë si në Turqi, Austri, Francë, Zvicër, RFGJ etj.

III. Nga studimi i dokumentacionit, analizat e bëra në byronë e Partisë dhe organizatat bazë si dhe në redaksitë e RT për përmirësimin e mëtejshëm të punës së

propagandës së RT në botën e jashtme, del e nevojshme që krahas mobilizimit më të madh të të gjithë komunistëve dhe punonjësve, del e nevojshme që të studiohet mundësia e zgjidhjes së disa kërkesave:

- Për ngritjen e mëtejshme të transmetimeve pa ndërprerje në gjuhë të huaja, të studiohet mundësia që për secilën gjuhë të ketë tre përkthyes, që edhe përkthyesit e Radios të trajtohen në pagë njësoj si përkthyesit e Ndërmarrjes së Botimeve, që të sigurohen për përkthyesit fjalorë, metoda, gramatika dhe atlasë të rinj gjuhësorë. Të studiohet mundësia e sjelljes së specialistëve të huaj për gjuhën angleze.

- Nga Drejtoria e RT dhe institucionet përkatëse shtetërore, si dhe sektori i shtypit, të ketë parasysh që sipas mundësive të dërgohen jashtë shtetit si gazetarë edhe punonjës të RT.

- Të plotësohen organikat ekzistuese të redaksive për botën e jashtme dhe të studiohet mundësia e zgjerimit të emisioneve për gjuhë të huaja në japonisht, në gjuhën indu dhe suhili për Afrikën.

b. – Për përmirësimin e mëtejshëm të punës së propagandës me RTSH, të studiohet mundësia që gjatë këtij viti të merren këto masa:

- Albimporti të marrë masa urgjente për të sjellë filmin me ngjyra dhe kimikatet e porositura nga Drejtoria e RTSH për vitin 1979, 1980 dhe 1981.

- Të studiohet mundësia e sigurimit të frontit të nevojshëm për të sjellë nga jashtë aparaturën për incizimin e programeve muzikore në "stereo", si dhe aparaturat për kalimin në filmat me vieokaseta.

- MPJ të vihet më shumë në lëvizje për realiizimin e aktiviteteve kulturore të miratuara nga Këshilli i Ministrave për RTSH për vitin 1981 dhe të studiojë mundësinë për zgjerimin e lidhjeve të RTSH me qendra të tjera radiotelevizive.

20 maj 1981

AQSH, Fondi 14 (KQ i PPSH), Viti 1945, D. 15, Fl.18.

VDEKJE FASHIZMIT
LIRI POPULLI

KOMITETI QËNDROR I PKSH — Tiranë më 7/12/1945
Seksioni i Agit-Prop-it

KOMITETIT QARKOR TË PKSH për PESHKOPINË
(Seksionit t'Agit-Propit)

Çështja e ngritjes së aparatit t'Agit-Prop-it, siç u është theksuar edhe herë të tjera, është detyra më urgjente në lidhje me sektorin e Agit-Prop-it për organizatat e Partisë.

Ju e shihni vet se pa patur një aparat t'Agit-Prop-it ska se si të shkojë përpara puna në këtë sektor, prandaj më parë se çdo gjë duhet të mendoni për formimin e shpejtë të komisionit pranë Qarkorit, për ngritjen e aktivit propagandist e t'agitatorëve dhe përcaktimin e përgjegjsave pranë komiteteve të nënprefekturave, nga ata elementë që keni, po duke patur kujdes që të jenë sa më të përshtatshëm për këtë punë.

Për sa i përket çështjes t'elementeve që kanë qenë në komision t'Agit-Prop-it dhe janë larguar me leje e s'kanë në mënt të kthehen, si paraqitet rasti i Nexhat Myftarit dhe Adellës Magjistari, duhet që të interesoheni me anën e organizatës për t'i thirur, sepse në Partinë t'onë ka disiplinë e antarët nuk mund të veprojnë sipas qejfit të tyre.

Në raportin t'uaj të datës 26/X/1945 shkruani se hasni vështirësi për mbledhjen e aktivit t'agitatorëve, pse qendrat e nënprefekturave janë larg nga Peshkopija dhe se shokët që janë nëpër nënprefektura janë të ngarkuar me punë të tjera. Kjo frazë e juaja na jep të kuptojmë se akoma se keni të kjartë se si e ku formohet aktivi i agitatorëve dhe prandaj na duhet t'u japim, me këtë rast, një skjarim: Aktivi i agitatorëve pranë Qarkorit formohet prej antarëve më të mirë për agitacion që ndodhen në qendër. Po ashtu ngrihen aktive t'agitatorëve në çdo nënprefekturë me shokët nga të nënprefekturës. Në qoftë se në një nënprefekturë p.sh. keni 6 shokë të gjithë këta bëjnë pjesë në aktivin e agitatorëve të asaj nënprefekture. Po të kuptohet kështu, s'ka si të hasen vështirësira në mbledhje të aktivit t'agitatorëvet.

Radjua që kërkoni këto ditë u dërgohet.

Presim të na raportoni vazhdimisht gjëndjen e Agit-Prop-it të çdo sektori dhe për çdo sektor, siç u kemi shkruar dhe në nji radiogram, në fletë të veçanata në po atë letër.

Të fala shoqërore

AQSH, Fondi 14 (KQ i PPSH), Viti 1945, D. 15, Fl. 34-36.

MBI GAZETAT E MURIT

Gazeta muri botohen në shumë zyra, këshilla, shkolla dhe vënde punimi, por nuk janë të gjitha në lartësin e duhur dhe pra nuk lozin rolin e tyre n'edukim, nxitjen dhe mobilizimin e masave punonjëse rreth problemeve të mëdha të rindërtimit të vëndit.

Në përgjithësi gazetat e murit në vëndin t'onë çalojnë sepse:

1) Nuk lidhen ngushtë me problemet, jetën dhe realizimet e vëndit ku botohen.

2) Botohen vetëm nga një redaksi 2-3 vetash dhe nuk janë frut i punës së përbashkët.

3) Nuk botohen rregullisht dhe

4) Nuk kanë përgatije teknike të mirë

ROLI DHE QËLLIMI I GAZETAVE TË MURIT

Ndërsa organet centrale trajtojnë programe në shkallë nacionale dhe japin vijën e përgjithëshme të politikës s'onë kombëtare, gazetat e qarqeve i trajtojnë këto probleme në kuadrin e qarkut të tyre duke i lidhur me jetën dhe interesat e atij qarku.

Gazeta e murit duke qënë organ i atij kolektivi njerëzish ku botohet meret me problemet e vënd-punimit dhe kolektivitetit ku botohet dhe lidh problemet e mëdha të vëndit me realizimin e tyre në vënd ose me oshëtimën që kanë prodhuar atje.

1. Duke lexuar mbi problemet e tij imediate, masa puntore do të mësohet të lexojë dhe gazetat e qendrës, broshurat etj. dhe, duke shkrojtur mbi kto puntori, fshatari, nëpunsi ose studenti do të zhvillohen dhe do të mësohen dhe t'i konkretizojnë idet e tyre.

2. Duke sjellë si shembël rezultatet e mira, duke lëvduar iniciativat e dobishme dhe puntorët më të mirë gazetat e murit do të bëhen mjetet më të mira të emulasionit në punë dhe të shtimit e përmirësimit të prodhimit.

3. Duke i lidhur problemet e mëdha kombëtare me interesat personale të njerëzve ku del gazeta, kjo bëhet mobilizonjëse e mirë e masave punonjëse rreth problemeve t'ona të mëdha. Veç kësaj gazeta e murit duke nisur që nga problemet që kanë lidhje direkt me punëtorin, shkollarin, nëpunësin ose fshatarin e bëjnë t'interesohet edhe kur këto probleme kanë karakter kombëtar dhe kështu i formojnë atij ndërgjegjen e punës, ndërgjegjen politike e kombëtare.

KU DHE KUR DEL GAZETA E MURIT

Gazetat e murit duhet të dalin në çdo vënd pune e ku prodhohet:

a) Në të gjitha kështillat e frontit të katundeve, të lagjeve dhe vëndpunimeve.
b) Në të gjitha shkollat fillore, të mesme dhe konvikte.
c) Në gjithë dikasteret, kështillat e prefekturave, nënprefekturave dhe zyrat e tjera.
ç) Në gjithë klubet, shtëpitë e kulturës etj.
d) Në puntoritë, kantieret e punimeve, fabrikat etj.

dh) Në zyrat e organizatave: sindikata, B.R.A.SH., Grua dhe në gjithë vëndet ku ka grumbullime njerzish, ferma, miniera etj.

Gazetat e murit duhet të dalin rregullisht dhe në datë të caktuar: një herë në javë, një herë në dhjetë ditë ose një herë në pesë ditë sipas mundësive.

Kur një gazetë muri del rregullisht në një kohë të caktuar dhe nuk mbetet në mur deri sa verdhet, siç ka ngjarë deri më sot, atëherë lexuesit qëndrojnë të lidhur me të dhe presin të dalë siç presin p.sh. "Bashkimin" ose gazetën e qarkut.

PËRMBAJTJA

Është gabim të rahen probleme të përgjithëshme në gazetën e murit, jo vetëm pse ato do të jenë një imitim i shtrembër u artikujve të shtypit qëndror por edhe pse artikujt të lidhur me problemet dhe interesat e tyre do të kuptoheshin më mirë prej njerëzve

ku botohet gazeta. Problemet e mëdha mund të trajtohen prej gazetës së murit po kjo në vend që të merret me anën teorike dhe të përgjithëshme të problemit meret me zbatimin praktik në vënd duke veçuar detyrë konkrete e masës ku del gazeta e murit, p.sh. organet qëndrore ngrehin problemin e 1 Majit, të mbjelljeve, për kursimin dhe për rivendikimet greke. Gazeta e murit e një fabrike e trajton problemin duke treguar me fakte dhe me shifra rezultatin e garave të 1 Majit në fabrikë ose duke shkrojtur kujtime dhe idera të ndonjë nga nëpunësi në fabrikë që ka ndihmuar grekët në luftën e tyre kundra Italis ose nga lufta e puntorëve të fabrikës kundra okupatorëve etj.

Për probleme të tjera me rëndësi kombëtare si p.sh. një fjalim i Komandantit, çpallja e Republikës, gazeta e murit e një fabrike mund të përshkruajë gëzimin e puntorëve, si e pritnë, si e komentojnë etj.

Fusha e shkrimeve në gazetën e murit është aq e gjerë sa janë edhe vetë problemet t'ona. Aty mund të flitet:

a) Si ngrihet e si përmirësohet prodhimi në fabrikë, si perfeksionohet metoda e punës dhe e administratës, si mësohet një lëndë në shkollë më shpejt.
b) Si punohet për kalimin e normave të vjetra të punimit, kush punon më shumë orë punë vullnetare, cili njësit pune sjell rezultate më shumë.
c) Si kursehet më shumë, respektimi i orarit, disiplina në punë.
d) Si goditet e si duhet të goditet spekullimi.
e) Si përmirësohet niveli i jetesës së puntorit, nëpunësit etj. me kooperativat e konsumit, mensat etj.
f) Cila janë shkaqet dhe shkaktarët që një punë ka ecur keq
g) Cilat janë gabimet që duhen ndrequr e që nuk duhen përsëritur, shembujt që duhen ndjekur e lavdëruar etj. Dhe të gjitha problemet që janë ose që çfaqen në një fshat, fabrikë, shkallë etj.

Të gjitha këto probleme e të tjera që dalin nuk mund të rahen mirë dhe nuk do të kenë dobi po nuk u ilustruan me shembuj konkretë, me emrat e personave, me shifra dhe me data.

FORMA E SHKRIMEVE

Zakonisht forma e shkrimit që duhen përdorur është proza: artikuj, humor, skica letrare por kur shkruhen mirë edhe vjershat shijohen.

Gazetat e murit duhet ta kenë të zakonshme:

a) Rubrikën për kritikën konstruktive në punë
b) Rubrikën e jetës së brëndëshme kurse, klube, dëfrime etj.
c) Puna ose shoku që duhet sjellë si shembëll i mirë ose i keq gjat javës etj.

Për puntorët më të mirë në punë, më të ndërgjegjshëm mund të vihen edhe fotografit e tyre (sidomos në fabrika e miniera).

Nuk duhet harruar kurrë lufta e jonë e çlirimit.

Në radhë të parë një dëshmor puntor, nëpunës ose student duhet të përkujtohet nga gazeta e murit e vëndit ku ay ka shërbyer. Dhe jo vetëm të shkruhet por në përvjetorin e vdekjes së tij të vihet edhe fotografija e tij.

Në gazetën e murit puntorët, nëpunësit, nxënësit e fshatarët mund të shkruajnë kujtimet e tyre në lidhje me luftën N.Çl. dhe në lidhje me vuajtjet e regjimeve shtypës të kaluara.

Duhet pasur kujdes që kritikat dhe vrejtjet të kenë për qëllim ndreqjen e gabimeve dhe të mos përfundojnë në polemikë dhe mërira personale.

REDAKTIMI

Për botimin e gazetës së murit zgjidhet një redaksi e përbërë prej 3-5 vetësh e cila në radhë të parë meret me shqyrtimin dhe konceptimin e lëndës dhe botimin në rregull të gazetës.

Do t'ishte gabim që gazetat e murit të shkruheshin vetëm prej kësaj redaksije qoftë sikur përbërësit e saj të shkruajnë shumë mirë e të jenë të lirë për të shkrojtur. Në këtë mënyrë këto do të mos lidheshin me masat dhe shkrimet e tyre dhe do t'ishin të lidhur me problemet dhe punën e masës.

Suksesi i gazetave të murit është kur në redaktimin e tyre marin pjesë të gjithë. Ashtu edukohet populli i ynë pse mëson t'i konkretizojë mejtimet e veta, t'interesohet për problemet kolektive dhe ashtu do të dali edhe gazeta më e mirë, përveç që në këtë mënyrë do të shtyhen të gjithë të shkruajnë e të lexojnë.

Mbasi ata që nuk kanë shkruajtur ndonjë herë nuk kanë guxim të shkruajnë, redaksija e ka për detyrë t'i nxiti. Një kuti e mbyllur për të hedhur artikujt e vendosur afër gazetës së murit do të lehtësonte edhe më shumë punën.

Në lidhje me gazetat e murit iu rekomandojmë të studjoni artikullin e botuar në gazetën Bashkimi Nr. 381 datë 24 mars 1946, faqe 3.

PARAQITJA TEKNIKE

Gazetat e murit duhet të vihen në një vënd të dukshëm të lokalit ku botohet në mënyrë që t'a lexojnë edhe shokët që punojnë atje edhe vizitorët e ndryshëm.

Çdo gazetë duhet të ketë emrin e vet të shkrojtur bukur dhe e përdorshme përgjithmonë dhe numrin renduer dhe datën e botimit.

Lënda shkruhet me daktilografi dhe vetëm në vëndet ku mungon maqina daktilografike shkruhet me bukurshkrim të qartë e të këndueshëm.

Për t'i dhënë lehtësi lexuesit lënda ndahet në rubrika dhe e njëjta lëndë vendoset gjithmonë në të njëjtin vënd. P.sh. shtylla humoristike vihet në një vënd të caktura, vrejtjet në një vënd tjetër e kështu me radhë.

Mbasi gazetat e murit lexohen që më këmbë duhet që artikujt të jenë shumë të qartë e të kuptueshëm e të mos jenë të gjatë.

Titujt duhet të jenë sugjestivë, të shkurtër dhe mjaft spjegues që të tërheqin lexuesin për të lexue edhe lëndën.

Kur ka mundësi gazeta e murit ilustrohet me skica, fotografi dhe dekorohet.

Për t'u dhënë udhëzime të vazhdueshme, duke filluar që prej këtij muaji të na dërgohet nga një kopje e gazetave të murit më me rëndësi që botohet a'atë qark.

AQSH, Fondi 722 (Fronti Demokratik i Shqipërisë), Viti 1980, D. 30, Fl. 1-3.

RELACION
MBI GJENDJEN E ELEMENTIT KULAK DHE PA KARTË FRONTI PËR VITIN 1980

Organizatat e Frontit Demokratik dhe forumet e tyre në rrethe duke patur kurdoherë në qëndër të vëmendjes mësimet e Partisë, orientimet e udhëzimet e saj, edhe gjatë vitit 1980, kanë treguar një kujdes të veçantë të lidhur me studimin e gjendjes së elementit kulak e pa karta fronti, për punën e veçantë edukative me ta e për të bërë diferencime në radhët e tyre. Ashtu si dhe vitet e tjera, edhe këtë vit organizatat e Frontit, sidomos ato të rretheve Korçë, Kukës, Skrapar, Gjirokastër, Mat, Pukë etj., për këto probleme kanë organizuar studime e analiza si dhe kanë nxjerrë detyrat e tyre për një punë më të diferencuar me njerëzit e kësaj kategorie. Organizatat e Frontit në gjithë punën e tyre për vënien në jetë të vendimeve të Kongresit të 7-të të Partisë, të detyrave të pleniumeve të KQ të Partisë e të Kongresit të 5-të të FDSH kanë punuar edhe për uljen e numurit të elementëve pa karta fronti duke e parë këtë në këndin e detyrës kryesore, forcimit të unitetit të popullit rreth Partisë. Në këto drejtime mbahen përgjithësisht qëndrime të drejta, lufta e klasave zhvillohet sipas mësimeve të Partisë e të shokut Enver Hoxha, si dhe është rritur vigjilenca revolucionare ndaj punës e veprimtarisë së elementëve kulak e pa karta fronti. Dhënia e kartës së frontit për elementët e kësaj kategorie bëhet vetëm mbasi shikohet mirë qëndrimi që mbajnë vazhdimisht ndaj punës e pronës socialiste, sjelljet dhe mendimet që manifestojnë në shoqëri e kudo.

Nga të dhënat që kanë dërguar kryesitë e Frontit të rretheve rezulton se për vitin 1980 në krahasim me vitin 1979 kemi një ulje të numrit të familjeve në përbërjen e të cilave janë edhe elementët e cilësuar kulakë, të familjeve me qëndrim të keq politik si dhe të pjestarëve të këtyre familjeve. Kështu në vitin 1980 në gjithë vendin ishin 1100 familje me pjestarë të cilësuar kulakë me 4117 persona (mbi moshën 16 vjeç) nga 1199 familje të tilla me 4465 persona që ishin në vitin 1979; 2562 persona me qëndrim të keq politik me 5164 persona (mbi moshën 16 vjeç) nga 2617 familje të tilla me 5355 persona që ishin në vitin 1979. Këto ulje kanë ardhur si rezultat i heqjes së cilësimit kulak nga Byroja e Partisë në rrethe për disa nga elementët e kësaj kategorie si dhe nga ndarja prej tyre e familjeve të reja e diferencimi që është bërë në pjestarët e familjeve, sidomos në moshat e reja. Gjatë vitit 1980 u është dhënë karta e frontit 373 pjestarëve të familjeve me elementë kulakë dhe 276 pjesëtarëve të familjeve me qëndrim të keq politik. U është hequr karta e frontit 37 personave për qëndrim të keq politik e 123 personave për faje të tjera.

Me gjithë rezultatet e arritura në drejtim të punës me elementët kulakë e pa karta fronti, në organizatat e Frontit vihen re edhe të meta e dobësi që vijnë si rezultat i mosnjohjes sa duhet të mësimeve të Partisë e të shokut Enver për këto probleme, si qëndrime të pakujdesëshme, liberale e sektare punë me fushata etj. Këto të meta e dobësi janë vënë re si në analizat që kanë bërë vetë rrethet ashtu

edhe nga letrat që janë dërguar gjatë këtij viti Kryesisë së Këshillit Përgjithshëm të FDSH. Kështu organizatat e Frontit nuk ndjekin si duhet lëvizjen e elementëve pa karta fronti, martesat, ndarjen, largimin për punë etj., në mënyrë që të mund të bëjnë edhe diferencimin në radhët e tyre. Kjo ka bërë që disa organizata Fronti në rrethe të ndryshme megjithëse kanë, në krahasim me organizatat e tjera, një numur të konsiderueshëm elementësh pa karta fronti, për vite me radhë nuk kanë bërë asnjë propozim për dhënie karte fronti ndonjërit prej këtyre elementëve si p.sh. në organizatat e Frontit të fshatrave Jub-Sukth e Manzë si dhe në qytetet Kavajë e Durrës të rrethit të Durrësit, në organizatat e Frontit të fshatrave Hoshëtimë, Kaninë, Serishtë, Velçë e Gumenicë të rrethit të Vlorës etj. Ka edhe rrethe si ai i Durrësit, Fierit e Lushnjes që për tre vitet e fundit nuk kanë bërë asnjë ndryshim në gjendjen e elementit kulak.

Në disa raste vazhdojnë të mbahen qëndrime sektare lidhur me paisjen me karta fronti të pjesëtarëve të tjerë të familjeve të kulakëve, të ripajisjes me karta fronti të atyre që janë dënuar me heqje lirie për faje të ndryshme etj. Kështu në organizatat e Frontit të fshatrave Lubonjë, Poja, Pirg, Boboshticë e Floq të rrethit të Korçës, në organizatat e frontit të fshatrave Kuç e Mal (Vërhezhë) të rrethit Skrapar në disa organizata të rrethit të Dibrës etj., ka ngurime për t'u dhënë kartat e frontit pjesëtarëve të këtyre familjeve e sidomos atyre që janë në moshë të re e që plotësojnë të gjitha kushtet në bazë të kritereve të caktuara; në disa organizata fronti të rrethit Gramsh ngurohet t'u jepen kartat e frontit stërnipërve e stërmbesave të kulakëve, ndërsa në rrethin e Elbasanit karta e frontit u jepet pjestarëve të familjeve të kulakëve qofshin këta edhe stërnipër vetëm mbasi u është hequr cilësimi kulak nga Byroja e Partisë në rreth. Në rrethin e Pukës në organizatat e Frontit të fshatrave Kushnen e Dedaj nuk u jepet karta e Frontit pas kryerjes së dënimit dy personave të dënuar me heqje lirie përkatësisht për 6 e 12 muaj për kundravajtje në peshkim e për rrahje.

Veç qëndrimeve sektare që në shumicën e rasteve mbahen duke u nisur nga mendimi "për të qënë brenda" në disa organizata Fronti janë mbajtur edhe qëndrime oportuniste liberale. Raste të tilla ka në organizatat e Frontit të disa qyteteve si Tiranë, Korçë etj., në organizatat e Frontit të sektorit Gjazë të NB Savër, në sektorin Çermë të NB "29 Nëntori" të rrethit të Lushnjes, në organizatën e Frontit të fshatit Gjorm të rrethit Krujë etj.

Organizatat tona të Frontit nuk diskutojnë me inisiativë për heqjen e kartës së frontit personave të dënuar për veprimtari armiqësore kundër pushtetit apo për krime të tjera. Këto raste nuk njihen nga organizata e Frontit por edhe mbas dhënies së dënimit ajo nuk mblidhet për të bërë demaskimin e veprimtarisë së këtij personi si dhe të propozojë përjashtimin e tij nga organizata.

KAPITULLI V

JETA NË KOMUNIZËM

5.1 Kultura dhe arti

AQSH, Fondi 14 (KQ i PPSH), Viti 1946, D. 138, Fl. 2.

KOM.QARKOR I P.K.SH.
GJIROKASTËR

VDEKJE FASHIZMIT
LIRI POPULLIT
Gjirokastër më 13/maj/1956

KOMITETIT QËNDROR TË PARTISË KOMUNISTE SHQIPTARE
Tiranë
(seksionit t'Agit-Popit)
P.Telit Nr. 306, Prot.dt.10/V/1946

Shoqëria për lidhjet kulturale me Bashkimin Sovjetik, nuk është ngritur akoma, po në këtë drejtim ka filluar puna dhe është caktuar një komision inisjator, i cili po merret me përpilimin e listës s'anëtarëvet dhe me rregullimin e lokalit. Brenda javës do të zgjidhet edhe Këshilli Administrativ.

Në Gjirokastër është çelur Shtëpia e Kulturës dhe Klubi Kultural, por nuk frekuentohen, mbasi do të vepërohet sipas udhëzimevet që do të përmbajë rregullorja, e cila nuk na ka mbritur akoma. Veç kësaj janë hapur Klubi i Oficerëvet, i Sindikatavet Punëtore dhe i rinis.

Në Sarandë është hapur shtëpia e Kulturës dhe Klubi i Punëtorëvet, por nuk frekuentohen rregullisht, e para. Klubi i Oficerëvet dhe ay i punëtorëvet frekuentohen mirë.

Në Delvinë është çelur Klubi i Kulturës dhe Shtëpia e Kulturës dhe në Përmet Klubi i Oficeravet dhe i N/punësvet. Në Libohovë është çelur Klubi i Sindikatavet. Janë duke u krijuar Klubet në Këlcyrë e Tepelenë. Në Konispol është çelur një klub popullor, që po frekuentohet në rradh të parë nga ata që janë të Sindikuar. Janë mbyllur kudo në Qark qendrat e ndryshme të korrupsionit (kafene, pijetore).

Salla leximi nuk janë hapur për arsye se nuk janë organizuar mirë Shtëpit e kulturës dhe Klubet. Vetëm në Sarandë është hapur një sallë leximi. Nuk kemi asnjë grup theatral të përhershmë dhe të rregulltë, vetëm se ka të tilla të rastit në Lice, në shkollën Unike të Përmetit dhe n'organizatën e rinis nëpër N/Pref., që me rastin e festavet të ndryshme kanë bërë çfaqje të rastit dhe atë që na kini dërguar.

Ka 3 grupe korale (Qendër, Përmet e Sarandë), por jo t'organizuara mirë. Banda muzikore në Qendër dhe një orkestër në Përmet kërkojnë një fond për vegëla, etj që të jenë organizuar siç duhet. Shpresojmë se puna ka për të dhënë përfitime të mira n këtë drejtim kur të krojohet zyra e Kulturës dhe e Artevet.

Mungon lënda theatrale dhe kërkohet vazhdimisht.

Për Komisjonin e Agit-Propit

Aleksi Njatru

AQSH, Fondi 14 (KQ i PPSH), Viti 1946, D. 138, Fl. 11-12.

MBI ORGANIZIMIN DHE FUNKSJONIMIN NË QARQE TË SHOQRIVE PËR LIDHJE KULTURALE ME B.SOVJETIK DHE ME JUGOSLLAVINË

Me qenë se vendosja e këtyre lidhjeve në lokale të veçanta për sejcilën është e pamundur për arsye të mjeteve financjare, duhet që këto lidhje ta kenë qendrën e tyre pranë shtëpive të kulturës dhe të funksionojnë si Degë të vecanta të sajë: Dega për lidhje kulturale me B.Sovjetik dhe dega për lidhje kulturale me Jugosllavinë.

1. Krijimi i këtyre shoqnive.-Pranë shtëpisë së kulturës krijohet një Komitet inisjator prej 20-30 vetash. Ky Komitet merr përsipër të mbledhi Asamblenë për themelimin e shoqnis në qark. N'Asamblenë, komiteti inisjator paraqet rëndësinë e marrëdhënieve të vendit t'onë me B.R.S.B. dhe R.P.F. të Jugosllavisë, qëllimet e shoqërisë dhe statutin ose rregulloren e sajë. Zgjidhet nji kryesi e shoqërisë e përbërë prej 7 antarësh (Kryetar, N/Kryetar, sekretar, tre anëtarë dhe një arkëtar).

2. Funksionimi dhe aktiviteti.- Nga pikpamja administrative dhe e lokalit Degët e këtyre shoqërive në Qendrën e Prefekturës mvaren dhe bëjnë pjesë në shtëpinë e Kulturës së kësaj qendre.

Aktiviteti i këtyre degëve zhvillohet në bazë të një plani dhe në bazë t'udhëzimeve e në bashkëpunim me qendrat e Lidhjeve përkatëse. Për zbatimin e planit Degët koordinojnë punën me këshillin e shtëpisë së Kulturës. Shpenzimet e këtyre në qark mbulohen nga fondet e shtëpijavetë Kulturës n'atë qark. Duhet theksuar se degët në fjalë janë të pa mvaruna nga pushteti e prandaj krejt aktivitetin e tyre nuk e zhvillojnë n'emët t'shtëpijave të Kulturës ose të Frontit, por n'emër të shoqnive respektive: për lidhjen kulturale me B.S. ose për Lidhjen Kulturale me Jugosllavinë, si degë nëpër qarqe.

Në qendrat respektive Degët mbajnë lidhje të vazhduarshme dhe korespondencë të regulltë.

3.- Antarësija.- të gjithë ata që marrin pjesë në asamblenë themelonjëse të shoqërisë konsiderohen si anëtarë dhe angazhohen të veprojnë simbas parimeve të Statutit dhe të Rregullores së Shoqnisë.

Antarë të shoqërisë duhet të jenë ata njerëz që duan B.S. dhe Jugosllavinë, shokët t'onë, puntorë që interesohen për B.S. e Jugosllavinë, nëpunsa e mësuesa të

ndershëm, teknikë e njerëz të kulturës që janë përparimtarë. Antarët duhet të jenë të rregullt dhe pajisen me triskën e antarsisë që dërgohet nga qendra. Gjithashtu antarët e këtyre do të paguajnë rregullisht- pranë arkës së Degës- kuotën mujore t'antarësisë. Këto të holla dërgohen në qendrat e shoqrive në Tiranë.-

4. Të ndryshme

a) Në zgjedhjen e kryesive të sejcilës Degë të këtyre Shoqrive duhet pasë kujdes që të dalin autoritetet e vendit; shokë të Frontit, Rinisë, Gruas, Sindikatave dhe të Agit-Popit si dhe njerëz të tjerë të ndershëm- antarë të Frontit. Disa prej këtyre duhet të kenë mundësi që të merren me punët e Degës.

b) Në Statutin e Lidhjeve Kulturale me B.Sovjetik e Jugosllavinë do të vrejmë se parashikohet krijimi i shumë seksjoneve. Kjo i referohet vetëm qendrave të këtyre shoqnive, ndërsa në Degët për sekksjone mund të përdorin ato që krijohen nga shtëpija e kulturës, frekunetuesit e të cilëve kanë për të qenë edhe antarë të këtyre Degëve. Për këtë arsye në qarqet nuk është nevoja të krijohen seksjone.

c) Degat- siç shifet nga sa thamë më lart, nuk do të kenë personel teknik të veçantë; personeli teknik i shtëpijave të kulturës do të kryejnë edhe punën e ktyre.

Të krijohen sa më parë Degët e të dy shoqnive në qarqet dhe atje ku janë krijuar duhet të zhvillojnë punën e tyre në bazë t'udhëzimeve të sipërme.

AQSH, Fondi 14 (KQ i PPSH), Viti 1946, D. 138, Fl. 4-6.

MBI SHTËPITË E KULTURËS, KLUBET DHE SHTËPITË POPULLORE TË LEXIMIT

Në lidhje me përhapjen sa më të madhe të kulturës në masën e popullit punonjës, pushteti ka pregatitur një plan veprimi. Partija bashkë me organizatat rreth sajë (Rini, Grua, Sindikata) do të bëhet faktori kryesor që shtëpit e kulturës, klubet dhe shtëpitë popullore të leximit të bëhen qendra të vërteta të nji aktiviteti të gjërë kultural dhe të losin kështu një rol të madh në përhapjen e kulturës dhe në edukimin e masave popullore në vijën e Partisë.

I. ORGANIZIMI I SHTËPIVE TË KULTURËS; KLUBEVE DHE SHTËPIVE POPULLORE TË LEXIMIT

1. Shtëpitë e Kulturës.- Këto ngrihen në qendrat e Prefekturave dhe në qendra e K/Prefekturave të mëdha ku shihet e nevojshme ngritja e shtëpisë së Kulturës, Fieri, Delvina, Kavaja etj. Shtëpitë e kulturës nuk mund të ngrihen në N/Prefekturat e vogëla si Konispoli, Tropoja etj.

Shtëpitë e kulturës janë qendrat kryesore në qark ku zhvillohet një aktivitet i gjërë kultural për edukimin e gjith masës së popullit. Këto shtëpi janë për të gjithë popullin, pra nuk kanë antarësi dhe nuk paguan njeri kuotizacjon. Këtu qëndron karakteri i tyre vërtet popullor. Kështu ndihmohen praktikisht masat e popullit që të edukohen.

Shtëpit e kulturës e zhvillojnë aktivitetin e tyre në të gjithë sektorët me anën e seksjoneve të ndryshme që krijohen në këtë shtëpi, të cilat do ti shofim më poshtë. Duhet pasë kujdes që mos të ngrihen të gjithë seksjonet që do të shënojmë më poshtë në çdo shtëpi kulture (sidomos të jemi të matur për shtëpitë e n/pref.) edhe kur këto praktikisht nuk do të kenë asnji mundësi të funksionojnë, d.m.th. kur këto s'do të jenë të nevojshme.

2. Klubet ose shtëpitë e Kulturës në bazë të profesjonit.

Këto ngrihen në kantier e fabrika të mëdha ku ka më tepër se 40 punëtorë që banojnë në këto qendra punimi.

Të këtillë klube ngrihen edhe në qytet sipas bashkimit sindikal të vendit. Për të ngritur një klub të këtij lloji lipset të jenë 100 punëtorë të një profesjoni; në rast të kundërt mund të bashkohen 2-3 bashkime sindikale dhe formojnë një klub të vetëm. Në vendet ku nuk ka bashkime sindikale këto nuk ngrihen. Puntorët që mund të jenë aty duhet ta zhvillojnë aktivitetin e tyre në shtëpitë popullore të leximit.

Këto klube drejtohen dhe administrohen nga Bashkimet Sindikale. Për të zhvilluar aktivitetin kultural edhe këtu ngrihen seksjone simbas nevojës.

Në klubet e Bashkimeve Sindikale nuk ka antarësi të posaçme hyjnë këtu gjith puntorët që kanë teserën e bashkimit sindikal dhe kuotizacjoni që paguajnë në organizatë vlen edhe për klubin.

3. Klubet ose shtëpitë e kulturës s'organizatave të ndryshme.

Organizatat si ajo e Rinisë, Gruas, Sportit dhe e Pionierëve kanë shtëpitë e tyre. Këto klube duhet të ngrihen simbas nevojave të këtyre organizatave në qendra të Prefekturave dhe në disa N/Prefektura. Drejtohen e administrohen nga organizatat respektive.

Për çështjen e seksjoneve dhe të antarësisë të veprohet në të njëjtën mënyrë si u theksua për klubet e puntorve.

4. Shtëpitë popullore të leximit. – Këto ngrihen në fshate dhe në lagje ku ka përmbi 800 banorë. Të këtilla ngrihen edhe në qendrat e N/Prefekturave të vogla si Konispol, Gramsh etj. Përsa i përket ngritjes së këtyre në lagje e fshate duhet të keni kujdes që të ngrihen aje ku mund të zhvillojnë një aktivitet, ku ka mundësi pra që të ngrihen.

Shtëpitë popullore të leximit kanë po atë funksjon që kanë shtëpitë e kulturës, por në një shkallë më t'ulët. Këto do të jenë të përbashkëta për aktivitetin e Frontit, Të Rinisë, të Gruas, të Sindikatës (atje ku nuk ka klube). Për këtë arësye duhet koordinuar mirë puna që aktiviteti i një organisatës mos të ndalojë aktivitetin e tjerave.

Mund të veprohet kështu p.sh. caktohet dita kur do të zhvillojë një konferencë Gruaja, kështu edhe për të tjerët.

Në shtëpitë popullore të leximit nuk ka antarësi, i gjithë populli i mëhallës, i fshatit duhet të ketë shtëpin e tijë.

Në shtëpitë popullore të leximit mund të edhe seksjone simbas rasës- po të jetë e mundur që të ngrihen vetë seksjonin. Shtëpitë popullore të leximit janë bërthamë e shtëpive të kulturës që do të ngrihen më vonë në këto vende.

Shënim.

1. Për ngritjen e këtij rrjeti të gjërë shtëpish kulture, shtëpish popullore leximi, klube etjera në qark, shokët duhet të kenë kujdes që këto të organizohen në bazë të nevojave por edhe në bazë të mundësive praktike që kanë për aktivizimin e pajisjen e tyre. Këto ku të ngrihen duhet t'aktivizohen në të gjitha drejtimet dhe mos të mbeten sa për emër.

Prandaj çdo qark duhet të bëjë planin e tij konkret dhe të studjuar e të caktuar mirë.

II. DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I SHTËPIVE TË KULTURËS ETJ. ETJ.

1. Shtëpitë e kulturës dhe shtëpitë popullore të leximit administrohen nga shteti. Këto kanë një administrator që paguhet nga shteti. Shteti mund të japë edhe ndonjë ndihmë të vogël për mbajtjen e tyre.

Klubet e ndryshme që përmendëm sipër administrohen nga organizatat respektive.

2. Shtëpitë e kulturës, shtëpitë popullore të leximi dhe klube drejtohen në këtë mënyrë:

a) Pranë çdo shtëpi kulture dhe shtëpisë popullore të leximit formohet- me inisjativën e pushtetit- një këshillë drejtonjës e përbërë prej administratorit të shtëpisë, përfaqësonjësve të organizatave të frontit, gruas, rinisë, sindikatave etj. dhe kryetarëve të seksjoneve të ndryshme që krijohen pranë shtëpisë.

Përfaqësonjësit e organizatave duhet të jenë shokë nga të komisjoneve t'agit-prop-it të këtyre organizatave, sa për Kryetarët e seksjoneve është mirë që të jenë a.p. por kur nuk janë këta bëjnë pjesë prapë se prapë në këshillin drejtonjës. Kështu koordinohet puna mes pushtetit e Partisë, dhe Partija i jep gjithë tonin punës. Këjo për shtëpin e Kulturës. Në këshillin e shtëpisë popullore të leximit në lagje fshat si përfaqësues të organizatave duhet të jenë a.p. në lagje e fshat që merren me punën e këtyre organizatave. Në rast se nuk ka a.p. mund të jenë në kto vende të r.k. ose njerës të ndershëm të Frontit.

b) Klubet e ndryshme.- Këto drejtohen nga organizatat respektive në atë mënyrë që këto organizata e kanë parë të drejtë. Për këtë cdo organizatë do të bëjë një rregullore për drejtimin e klubit.

c) Pët të koordinuar gjithë punën e shtëpive të kulturës, shtëpive popullore të leximit e klubeve në n/prefekturë interesohet këshilli arsimtar për n/prefekturën.

d) kurse, për çdo Prefekturë krijohet këshilli i shtëpive të kulturës dhe shtëpive popullore të leximit që bashkon e koordinon veprimtarinë e tyre. Ky këshill ka për kryetar referentin e kultuës pranë seksionit arsimit të Prefekturës (që është përgj.

i kult. në Komisjonin e A.Propit) dhe si antarë një përfaqësonjës të shtëpive e të klubeve më me rëndësi. Ky këshillë që mblidhet rallë ka për detyrë të koordinojë mirë planet e gjith organizatave e të gjith shtëpijave të ndryshme për aktivitetin kultural.

Mbasi në këta këshilla janë shokë të Partisë këtu shtrohet plani i Agit-Prop-it për kulturën dhe Partija është kështu në krye të punës: drejton dhe kontrollon gjithë aktivitetin.

III. SEKSJONET E NDRYSHME

Seksjonet që do të radhiten më poshtë ngrihen pranë shtëpisë së Kulturës në qendrën e prefekturës. Të tilla, simbas nevojës e mundësive, duhet të ngrihen edhe pranë shtëpive të Kulturës që e kanë qendrën në n/prefekturë si edhe në klubet e ndryshme e shtëpitë popullore të leximit.

Këta kanë një rëndësi shumë të madhe, mbasi me anën e këtyre shtëpitë e kulturës e tjerat do të zhvillojnë një aktivitet të gjërë kultural.

Seksjonet më me rëndësi janë këto:

Seksjoni teatrit që përmbledh

1. Grupin theatral: pranë shtëpisë së kulturës formohet grupi theatral që përgatit pjesë teatrale, skeçe etj. sipas aftësisë së tyre.

Seksjoni i muzikës që përmbledh:

2. Grupin koral dhe orkestral: Herë pas here, në bazë të planit të shtëpisë e tjera, organizojnë dhe ekzekutojnë këngë e pjesë revolucionare dhe popullore.

3. Rrethi i shkrimtarëve: pranë shtëpisë kulturës formohet rrethi i shkrimtarëve që janë antarë të lidhjes së shkrimtarëve të Shqipërisë. Kurse pranë klubeve të rinisë etj. formohen rrethet e letrarëve të rinj. Këta bashkëpunojnë me të parët.

Këta marrin pjesë në konkurset letrare, punojnë për mbledhjen e folklorit të luftës e të vjetrin, bëjnë përkthime në bazë të sugjerimeve të Lidhjes së Shkrimtarëve, bëjnë ekspozita të librit e të shtypit, (7) mbrëmje letrare, shkojnë në fshate, në fabrika, shkolla etj. Atje organizojnë recitime të tjera.

Shëtitje të tilla për të zhvilluar aktivitet kultural bëjnë edhe grupet teatrale e korale.

4.Rrethi i piktorëve dhe i skulptorëve (diletantë me talent e profesionistë).

Pranë shtëpisë kulturës formohet rrethi i piktorëve dhe i skulptorëve. Këta përgatitin kuadro, buste etjera dhe marrin pjesë në konkurse të këtij lloji. Me këto organizohen edhe ekspozita të vogla. Duhet të kemi kujdes që këto të jenë një element pozitiv, d.m.th. të pasqyrojnë luftën t'onë dhe realitetin t'onë sot, të jetës t'onë. Të luajnë një rol propagandistik.

5. Kurset e ndryshme (seks. i kurseve): pranë shtëpive të kulturës etj. ngrihen këto kurse:

a) kurse specializimi për profesjone që ngrihen dhe në klubet profesjonale ose të bashkimeve sindikale. Këto kurse duhet të organizohen mirë, të kemi plan pune të caktuar. Duhet të kemi si objektiv që këtyre kurseve t'i japin ndonjë mjeshtëri atij që merr pjesë në to. Njerzit këtu duhet të jenë të caktuar dhe të marrin këto kurse formën e një shkolle të vërtetë. Gjithashtu të kemi parasysh që funksjonimi i kursit mos të shkëpusë nga prodhimi të regjistruarit. Prandaj të bëhen jashtë orarit të punës,

sidomos natën. Për këto kurse duhet patur lidhje të ngushta me pushtetin. Në shtëpitë e Rinisë mund të çilen kurse për të ndihmuar nxënësit që kanë mbetur në provime.

b) Kurse gjuhësh rusisht e jugosllavisht: Këto kurse ngrihen në bashkëpunim me degët e Lidhjeve për bashkëpunim kultural me B.Sovjetik e Jugosllavinë. Duhet të funksionojnë në rregull e të marrin pjesë sa më shumë shokët t'onë, të rinj komunistë, puntorë e tjerë.

c) Kurse kundra analfabetizmit. Organizohen kurse kundra analfabetizmit me puntorë, të rinj, gra, punohet me nji plan të caktuar dhe me rregull.

6. Grupi i valleve. Pranë shtëpive të kulturës etj. organizohet grupi i valleve të vendit, i cili kërcen vallet e krahinës dhe i perfeksjonon këto. Të meren vallet më të bukura, më të gjalla dhe të gjënden kostumet e vendit si dhe gjëra të tjera karakteristike për pajisjen e tyre.

7. Seksjoni i sportit e i piknikëve. Në vendet ku nuk ka klube sportive, këtë punë mund t'a bëjne edhe shtëpitë e kulturës duke krijuar seksjonin e sportit, mbasi aty janë vetë drejtonjësit e sportit. Në rast se ka klub sporti atëherë në shtëpinë e kulturës etj. zhvillohet një aktivitet sportiv duke organizuar loja ping-pongu-u, shahu, volejbolli etj.

T'i jepet rëndësi e veçantë piknikëve, të cilët duhet të lozin- në vendet ku venë- një rol politik e kultural.

8. Seksjoni i ekspozitave. Organizohet një seksjon i ekspozitave që organizon ekspozita të ndryshme mbi dëshmorët dhe luftën e qarkut, mbi përpjekjet e aktivitetin e popullit në rindërtimin e vendit, mbi shtypin (gazetat e murit, të qarkut etj.), mbi aktivitetin kultural (sport, literatyrë etj.), të cilat vihen në dukjeme anë fotografish, me shënime, me anë statistikash etj.

9. Biblioteka. Në shtëpitë e kulturës etj. duhet të ketë një bibliotekë të vogël ku të lexojë populli. Në këtë bibliotekë të ketë libra të kontrolluara dhe me frymën t'onë. Librat me frymë profashiste e reakcjonare të hiqen. Duhet të jenë gjithë librat e rinj që janë botuar këtu mbas çlirimit.

10. Gazeta e murit. Në shtëpi të kulturës etj. duhet të dalë gazeta e murit një ose 2 javë një herë. Formohet për këtë një redaksi me 6-7 vetë. Gazeta e murit të pasqyrojë aktivitetin e shtëpisë, të kritikojë të metat dhe të nxjerrë në shesh suksseset duke u bërë një faktor nxitës për punë sa më të mira.

Këto seksjone duhet të ngrihen me një herë dhe t'organizohen mirë. Ka rëndësi që këto seksjone të ngrihen me numër aq sa është e nevojshme. Jo të ngrihet seksjoni i leteratyrës në një vend ku nuk ka fare shkrimtarë.

Shënim:

1. Në sejcilin nga seksjonet e sipërpërmendura mund të regjistrohen elementë të ndryshëm simbas prirjes së tyre, p.sh. disa regjistrohen në seksjonin e theatrit, disa në atë të letërarëve etjerë, kështu që secili seksjon zgjërohet dhe përmbledh në gjirin e vet të gjithë artistat a dilentantët e qendrës së qarkut ose letrarët e tjerë. Kjo asht e nevojshme që seksjonet të jenë në gjëndje të zhvillojnë një aktivitet sa më të gjërë.

2. Në krye të çdo seksjoni ka një këshillë, numuri i të cilit mvaret nga të regjistruarit në seksjon. Zakonisht mund të jetë prej 3-5 vetë. Ky këshillë udhëheq seksjonin. Ky ka një kryetar i cili pastaj bën pjesë në këshillin drejtues të shtëpisë së kulturës që përmendëm më sipër.

Është mirë që kryetari të jetë a.p. ose njeri i besuar i Frontit.

IV. AKTIVITETETI KULTURAL

1.Shtëpitë e kulturës, Klubet, dhe shtëpitë popullore të leximit duhet të bëhen qëndra me rëndësi grumbullimi dhe mjete të fuqishme për përhapjen e kulturës në masat e gjëra të popullit. Aty poulli të shikojë se mëson me të vërtetë. Të kuptojë qartë se aty punohet në bazë të nnjë plani që synon për edukimin e tijë në të gjitha anët.

E gjith kjo varet nga puna e jonë e matur dhe e sistemuar, vetëm kështu populli do të shkëputet nga jeta e kafeneve dhe e pijetoreve për t'u pajisur me dije e edukatë të shëndoshë.

2. Ajo që ka rëndësi të madhe është se këto qendra kulturore duhet të shërbejnë për rindërtimin e vëndit. Veçanërisht theksohet zhvillimi i secilit nga ana e kulturës profesionale. Kjo mund t'arrihet me anë kursesh të zanateve në bazë të një plani. Gjithashtu një rol me rëndësi do të lozin edhe kurset kundra analfabetzmit etj.

Prandaj është detyra e shokëve të partisë që ti bëjnë ndihmëse të rindërtimit këto qendra kulturore.

3. Këto qendra kulture të jenë një vënd me rëndësi për edukimin ideologjik e politik të popullit t'onë. Është detyra e organizatave të Partisë që në to të edukohet populli me frymën e Partisë dhe me ideologjinë e revolucionit t'onë popullor. Në lidhje me këtë këtyre duhet t'u jepet një karakter i theksuar antifashist. Kështu përveç konferencave me karakter kultural duhet të organizohen konferenca me karakter politik rreth problemeve të mëdha dhe të ditës të vëndit. Lokalet të zbukurohen me fotografin e shokut Enver, me yje të kuq, me parulla si Vdekje Fashizmit- Liri Popullit, parulla mbi literaturën, etj.

4. Shtëpitë e kulturës, klubet, sallat popullore të leximit do të jenë basa për përhapjen dhe zhvillimin në popull të arteve të bukura, të literaturës, teatrit, muzikës, pikturës, skulpturës, të cilat me forma të ndryshme të jenë të bazuara në frymën t'onë dhe ti shërbejnë rindërtimit të vëndit. Por njëkohësisht këto qendra kulture duhet të jenë dhe një vënd dëfrimi dhe çlodhje për popullin. Prandaj në programin e tyre këto duhet të kenë muzikë, sport, etj.

5. Në këto qendra duhet t'organizohet shplodhja dhe dëfrimi. Prandaj këtu duhet të ketë një bufe të vogël dhe t'organizohen mbrëmje dëfrimi. Këtu duhet pasë kujdes që mos të marrin shtëpitë e kulturës ngjyrën e kafenesë.

<u>Puna e jonë e madhe kulturale e edukative të lozi një rol kryesor dhe t'i japë tonin jetës në shtëpitë e klubet</u>.

<u>V. Veprimtarija zhvillohet në bazë të një plani</u>

Çdo shtëpi kulture, klub e shtëpi popullore leximi duhet të ketë një plan konkret

tre mujor mbi gjithë aktivitetin e sajë. Në të caktohet p.sh. se ç'punë duhet të bëjnë kurset e ndryshme, sa këngë do mësojë kori, sa mbrëmje letrare do të bëhen, mbi çfarë do të flitet, sa konferenca shkencore, edukative e politike do të mbahen etj. Që puna të kryhet mirë në qendrën e N/Prefekturës planin e koordinon këshilli arsimor i N/Prefekturës që është edhe këshilli koordinues, kurse në gjith qarkun puna koordinohet prej këshillit të Kulturës së Qarkut.

Ky plan i gjërë pune duhet të jetë plani i punës së seksjont kulturës i pregatitur nga komisjoni i agit-propit të Komitetit Qarkor. Ky ndihmohet në punë nga Komisjonet e Agit-Propit t'organizatave antifashiste në qark.

Shënim.

1. Nga seksjoni i Agit-Propit të K.Qendror herë pas here do t'u vijnë referate, pjesë teatrale etj. Për të ju ndihmuar në punë. Por edhe vetë komisjoni i Agit-Propit në qark t'interesohet të gjejë vetë ose të pregatisë referate etjera në bazë të udhëzimeve t'ona ose kur t'i nevojiten.

2. Çdo shtëpi kulture, klub e shtëpi popullore leximi duhet të kenë nga një rregullore të brëndshme. Për klubet, organizatat përkatësie ia përshtatin simbas nevojave e konditave që kanë.

VI. FINANCIMI

Shtëpitë e kulturës dhe shtëpit popullore të leximit do të kenë nji fond të vogël nga shteti.

Shtëpitë e organizatave të ndryshme do të mbahen vetë, prej organizatave përkatëse.

Për të plotësuar nevojat e ndryshme, shtëpitë e kulturës, klubet, shtëpitë popullore të leximit duhet:

1. T'organizojnë fushatën në popullin e vendit

2. Të merren t'ardhurat e çfaqjeve theatrale, të mbrëmjeve të dëfrimit, të ekspozitave etjera.

3. Të bëhet që njerëz nga populli të dhurojnë libra e sende të tjera për këto qendra edukimi.

-Me anën e punës s'onë dhe t'aktivitetit të gjithanshëm të arrijmë që populli të mësohet dhe t'edukohet për mirëmbajtjen e këtyre.

AQSH, Fondi 14 (KQ i PPSH), Viti 1945, D. 15, Fl.19.

VDEKJE FASHIZMIT
LIRI POPULLI

KOMITETI QËNDROR I PKSH Tiranë më 11/12/1945
Seksioni i Agit-Prop-it

KOMITETIT QARKOR TË PKSH për SHKODRËN

(Seksionit t'Agit-Propit)

Në letrën t'uaj të fundit që na dërgoni na shkruani se akoma s'keni ngritur aparatin e Agit-Prop-it.

Çështjen e ngritjes së aparatit të Agit-Prop-it, siç u është theksuar edhe herë të tjera, është detyra më urgjente në lidhje me sektorin e Agit-Prop-it për organizatat e Partisë. Ju e shifni vetë se pa patur nji aparat të Agit-Prop-it s'ka se si të shkojë përpara puna në këtë sektor; prandaj më parë se çdo gjë duhet të mendoni për ngritjen e aktivit t'agitatorëve dhe për caktimin e përgjegjësve t' Agit-Prop-it nëpër komitetet që u mungojnë dhe nëpër gjithë celulat, nga ata elementë që keni, po duke patur kujdes që të jenë sa më të përshtatëshme për këtë punë.

Nga Gjovalini muarëm vesh se keni ndër mënd të nxirrni një revistë. Çuditemi se si mund të mendoni për nji gjë të till kurse ju ankoni për mungesë lënde dhe fondi për gazetën "Koha e Re". Sikurse u shkruanim në nji radio-gram pezulloni çdo veprim në lidhje me revistën dhe na njoftoni si mendoni t'ia delni mbanë nji pune të tillë.

Na shkruani se keni gati teatrin Juda Makabej, dhe se sigurisht gjer tashti do t'a keni lozur, po s'thoni asgjë për "Deputetin" që u a dërguam ne për t'a pregaditur dhe për t'a lozur para zgjedhjeve. Të lozin Judën Makabej dhe të mos lozin deputetin, për arsye se populli i Shkodrës nuk i pëlqen teatro me subjekt social, siç është folur, është të bijesh në pozitat e popullit. Ne duhet ta mësojmë popullin me subjekte të tilla dhe jo të drejtohemi në punën t'onë nga dëshira e popullit kur këjo s'është me vënd dhe të bëjmë tërheqje të pa vënd.

Përsa i përket teorisë ju vazhdoni si gjer tani. Interesohuni të hapni nga ndonji kurs fare elementar nëpër nënprefekturat, tashti që u mbaruan zgjedhjet. Edhe në qytet në kuadrin më të ulët pregaditni nji kurs të tillë për natën. Së shpejti do t'u dërgojmë nji plan për kursin e qarkut dhe për kurset elementare si dhe referatet që do të zhvillohen në kurset e ulëta.

Presim të na raportoni vazhdimisht gjendjen e Agit-Prop-it të çdo sektori dhe për çdo sektor, siç u kemi shkruar dhe në nji radiogram, në fletë të veçanata në po atë letër.

Të fala shoqërore

Nako Spiru

5.2 Indoktrimi i fëmijëve dhe të rinjve

Gaçe, Bekim (1970), Dashuria e pionierëve për Partinë shprehet edhe në aksionet, lëvizjet dhe iniciativat revolucionare të tyre duke vënë në jetë mësimet e Partisë dhe porositë e shokut Enver. Në Materiale në ndihmë të kuadrove që punojnë me pionierët (Kumtesa të mbajtura në sesionin shkencor të BRPSH), Tiranë, 14-26.

fq.17-18

....

b) si lind dhe si zhvillohet ndjenja e dashurisë për partinë

Dashuria e fëmijëve tanë për partinë lind që në moshat më të vogla. Në formën e saj më fillestare ajo nis të lindë nën nxitjen e familjes, të ngjarjeve festive, të transformimeve përreth, të ilustrimeve e të tregimeve. Ajo shprehet në brohoritjet, duartrokitjet, recitimet, këngët... Kur fëmijët hyjnë në kopsht kjo ndjenjë pasurohet nga shëtitjet, lojrat tematike etj. Në këtë periudhë vihet re shprehja e dashuria për objekte konkrete si për shokun Enver, për partizanët, punëtorët, heronjtë e ditës, etj. Në grupet e larta të kopshteve arrin deri në fushën e sjelljeve nën shembullin e komunistëve duke imituar ata, sidomos të disa figurave historike që ofron koha. Pra, kalohet tek kërkesa e rëndësishme e imitimit të shembullit pozitiv, për t'u bërë ashtu siç kërkon partia. Kjo hyn edhe në botën e lojrave: ata bëhen ndërtues, si heronjtë e rritur, ata sillen me shokët, punën, veglat, si heronjtë e rritur. Nga gjithë kjo punë ata pasurohen me veti të tilla morale, ku më vonë do të mbështetet veprimtaria e tyre për të vënë në jetë kërkesat e partisë, për të konkretizuar ndjenjën e dashurisë për të.

...

fq. 19

Në moshën e pionierëve kjo ndjenjë rritet, merr një kuptim të plotë, gradualisht kalohet nga një ndjenjë e përgjithshme mirënjohje në një kuptim më historik të partisë si forcë udhëheqëse e vendit, si domosdoshmëri historike, pa të cilën nuk mund të fitohej liria, nuk mund të ndërtohej Shqipëria e re, socializmi. Mbi këtë kuptim dhe mbi këtë ndjenjë ngrihet detyra ndaj partisë, bindja. Në moshat më të rritura të pionierëve fillon zgjerimi i kuptimeve abstrakte nga një varg shembujsh konkretë, kuptimi i rolit të partisë rritet përmes njohjes nga afër të rolit të saj në jetën e fshatit, shkollës, qendrës së punës ku janë lidhur në miqësi, repartit ushtarak ku stërviten, ndryshimeve përreth, jetës së përditshme deri në shkallë kombëtare dhe ndërkombëtare.

fq. 20-22

c) Aksionet, lëvizjet dhe iniciativat revolucionare- si shprehje e dashurisë për partinë

Dashuria e fëmijëve për partinë shprehet edhe në entuziazmin e tyre politik dhe në veprimtarinë për të vënë në jetë mësimet e saj. Pikërisht në luftën për të vënë në jetë mësimet e saj, shohim shkallën më të lartë të kësaj ndjenjë. Aksionet, lëvizjet dhe iniciativat revolucionare lidhin më mirë ndjenjën e dashurisë me kuptimin e detyrës. Fëmijët e ndjejnë veten në radhët e luftëtarëve, në barrikadat e partisë.

Edhe më parë ka patur aksione, lëvizje, iniciativa, por në vitet e fundit ka një rritje të dukshme të tyre, sidomos cilësore. Kjo është e lidhur me stadin e sotëm të zhvillimit të revolucionit në vendin tonë, me luftën e partisë kundër imperializmit dhe revizionizmit, me një kuptim edhe më të drejtë, revolucionar për fëmijët, jo thjesht si "lule të jetës", por para së gjithash e mbi të gjitha si ushtarë të nesërm të revolucionit, si vazhdues të veprës së madhe të komunistëve; kjo është e lidhur me luftën kundër restaurimit të kapitalizmit dhe rrezikut të degjenerimit borgjezo-

revizionist, pra, me problemin e perspektivës; kjo është e lidhur me fazën e sotme të zhvillimit të shkollës sonë dhe me detyrat e mëdha që shtroi para saj Komiteti Qendror i Partisë.

Kështu, zhvillimi dhe thellimi i dashurisë për partinë është i lidhur edhe me thellimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të një varg aksionesh, lëvizjesh, iniciativash që janë ndezur në çetat e pionierëve në tërë vendin.

Si shprehet kjo ndjenjë në lëvizjet, iniciativat dhe aksionet e pionierëve? Si duhet thelluar dhe zgjeruar më tej? Si fitojnë përmes kësaj lufte tiparet e revolucionarit, të komunistit? Këto janë disa nga çështjet për thellimin e kuptimit dhe ndjenjës së dashurisë për partinë.

Dhe këto nuk mund të arrihen me moralizime, vetëm me biseda e takime, ku flitet për tërë vendin, shpesh duke përdorur shifra e fakte pak të kapshme për përvojën jetësore dhe fuqinë mendore përfytyruese të fëmijëve.

Fëmijët duhet të kapin e të prekin faktet që u shtojnë njohjen dhe emocionet, duke i sjellë këto fakte e emocione nga puna e tyre aktive e jo duke luajtur rolin dëmtues të papagallit apo atë të spektatorit.

Kohët e fundit në mjaft çeta pionierësh, ka nisur mbarë një punë e menduar mirë për njohjen e vendlindjes, për njohjen e historisë së partisë. Kjo njohje bëhet në mënyrë aktive nga pionierët. Në mënyrë të afërt, konkrete ata njihen me to duke krijuar këndet muze apo shtëpitë muze, duke u pregatitur për sesione shkencore me tematikë historiko-shoqërore, duke hartuar historikun e fshatit, duke zhvilluar udhëtime imagjinare në rrugën e çetës, dëshmorit, kooperativës... Dhe këtu, kryesorja qëndron në atë, që pionierët nuk janë më dëgjues, atyre nuk u vinë në vesh fjalë e fraza që s'i kapin dot me përvojën dhe të menduarit konkret, ata nuk ndeshen me shifra e krahasime të përgjithshme, të pakapshme për fuqinë e tyre mendore, por ata vetë rindërtojnë në mendje përmes njohjes së fakteve, dokumentave, dëshmive, relikeve, gjurmëve, pjesëmarrësve... tablonë e ngjarjes, të heroit, të fshatit dhe shohin luftën e klasave, rolin e partisë. Pra, ata njohin historinë e partisë në jetën e gjallë, pasurojnë emocionet. Kështu fuqizohet kuptimi për partinë, dashuria për të, fëmijët e ndjejnë veten brenda kësaj historie, brënda këtyre ngjarjeve, ata zbulojnë, prekin fijet e shumta që lidhin jetën e tyre me partinë. Përmes fantazisë jetojnë vitet e ngjarjet historike, me veprimet e tyre futen në ngjarjet e mëdha të ditës. Dhe për këtë ata kanë shumë dëshirë. Detyra dhe zotësia qëndron në atë se sa e zbulojmë këtë dëshirë dhe se si e drejtojmë atë. Një provë e mirë janë aksionet, lëvizjet, iniciativat.

Në to pionierët po derdhin vrullin, mendimet, fantazinë, emocionet e tyre. Qëllimi i përbashkët i aksioneve, i iniciativave dhe i lëvizjeve revolucionare është: në fusha të ndryshme, në drejtime të ndryshme, me mjete të përshtatshme për moshën, duke marrë parasysh dëshirat, interesat, kërkesat e të vegjëlve, me forma që të krijojnë kushte për vetëveprim, të arrihet kalitja revolucionare, komuniste e fëmijëve. Arritja sa më e plotë e këtij qëllimi është tregues i lartë i shprehjes së dashurisë për partinë.

fq. 25-26

ç) përfundime të përgjithshme, fillestare

Kjo ishte një përpjekje modeste për të sjellë diçka në këtë temë, ndaj, duke sjellë disa përfundime, nuk mund, veç t'i quajmë: paraprake ose fillestare.

- Dashuria për partinë tek fëmijët tanë është një ndjenjë historikisht e re, që lindi në zjarrin e luftës, nga shëmbujt konkretë në veprimtarinë konkrete, që u rrit dhe u zhvillua mbi trungun e atdhedashurisë nga viti në vit, pranë komunistëve, në zjarrin e betejës.
- Në mosha të ndryshme kuptimi dhe shprehja e dashurisë për partinë është e ndryshme, në përshtatje me shkallën e njohjes dhe psikologjinë. Ajo shprehet përmes brohoritjeve, duartrokitjeve deri në hedhjen në veprimtari për të vënë në jetë idetë, detyrat e saj. Vetëm njohja nga afër e fëmijëve, ndjekja e dinamikës së pasurimit të njohjes dhe ndjenjës për partinë, na lejojnë të ndërtojmë një punë më të efektshme.
- Kjo punë kryhet në dy drejtime kryesore: përmes punës verbale, agjitative-propgandistike dhe veprimit mbi fëmijët të transformimeve përreth përmes hedhjes së tyre në aksione, lëvizje, iniciativave revolucionare. Kalimi nga shprehja verbale e këtyre ndjenjave në format konkrete të kuptimit të detyrës politikisht dhe i dhënies së shembullit personal e më vonë i luftës së të gjithë kolektivit të pionierëve për të qenë në veprimtari komuniste është i lidhur si me rritjen në moshë, si me ndikimin e jetës përreth, i jetës politiko-shoqërore, ashtu edhe me ndërtimin e një pune të shkallëzuar rritëse mbi bazën e dëshirave, interesave, kërkesave të fëmijëve dhe nevojave të edukimit të tyre.
- Aksionet, lëvizjet, iniciativat janë një mjet i fuqishëm i edukimit të kësaj ndjenje, një provë e kësaj ndjenje. Afrimi në përmbajtje dhe veçanërisht në formë me botën e fëmijëve, me psikologjinë e tyre siguron një ndikim edukativ më të fuqishëm.
- Duke jetuar në valët e revolucionit, edhe pse fëmijë, duke jetuar pranë shembujve më pozitivë, duke i imituar ato në përputhje me botën fëminore rritet shumë vlera e këtij edukimi.

Myzejen Kalaja (1970), Futja në stil të gjerë e metodës së aksionit në jetën e organizatës së pionierit dhe në edukimin e fëmijëve, në përgjithësi në shkollë e jashtë saj, është e domosdoshme për revolucionarizimin e punës dhe metodës së punës edukative me fëmijët. Në Materiale në ndihmë të kuadrove që punojnë me pionierët (Kumtesa të mbajtura në sesionin shkencor të BRPSH), Tiranë, 34-43.

fq. 34-37

Të vegjëlit, duke jetuar në atmosferën revolucionare që ngjallën në popull vendimet historike të Kongresit V dhe fjalimet propagandistike të shokut Enver, ndërmorën një varg aksionesh, të cilat, nga karakteri ideologjik e pedagogjik, përfaqësojnë një valë të re të fuqishme në procesin e revolucionarizimit të mëtejshëm të shkollës sonë.

Duke punuar së bashku me pionierët, në aksione, duke ndjekur hap pas hapi zhvillimin e tyre, do të mundohem të analizoj në këtë kumtesë fuqinë e madhe edukuese të aksionit, që e bën të domosdoshme futjen në stil të gjerë të kësaj metode në punën me fëmijët.

Vlerën e madhe edukuese të aksionit e gjejmë:

Së pari, në thelbin e kësaj metodë, që është shpërthimi i pashëmbullt i energjive revolucionare të fëmijëve, rritja e besimit ndaj forcave të tyre, edukimi aktiv, nxitja e iniciativës. Vetëm ata, që panë nga afër aksionin e luftës kundër mbeturinave fetare e ideologjisë së huaj që zhvilluan pionierët, kuptojnë se ç'energji revolucionare shpërthejnë pionierët, kur gjejnë rrugët dhe sigurohet terreni për zhvillimin e tyre. Pionierët e nisën me guxim e vendosmëri këtë aksion me karakter ideologjik, bënë propozime të drejta, kryen vepra të vlefshme me iniciativën e tyre. Një pasqyrë e kësaj pune janë edhe mbledhjet e çetave, ku pionierët analizonin rezultatet e arritura. Diskutimet në mbledhje nuk kishin të mbaruar. Pionierët diskutonin lirshëm për luftën që i bënë mbeturinave fetare dhe caktonin detyra të reja. Kur i shikoje, mendoje: A janë këta pionierë, që në mbledhjet e mëparshme të çetave mezi ngriheshin për të diskutuar, megjithëse ishin të paralajmëruar dhe të përgatitur për të? Fillimi i aksionit i entuziazmon fëmijtë dhe shkaku i këtlj entuzizmi është besimi dhe respekti ndaj forcave të tyre.

Së dyti, në aksion realizohet uniteti i teorisë dhe i praktikës në luftën ideologjike, krijohet mundësia për të provuar se deri në ç'shkallë pionieri, nxënësi dhe udhëheqësi i pionierëve bashkon fjalën me veprën. Kjo përbën një problem më vete në betejën e madhe të edukimit të pionierëve. Mosha e tyre karakterizohet nga dëshira për të marrë zotime, për të premtuar dhe zbatimi i tyre duket më së miri kur hidhen në aksion konkret.

Së treti, aksioni gjallëron jetën e brendshme të organizatës, rrit numrin e aktivistëve, duke e zhdukur njëherë e përgjithmonë elitën që rrethonte udhëheqësin profesionist. Gjatë zhvillimit të aksionit krijohet një përgjegjësi e madhe për detyrën. Të gjithë e quajnë veten ushtarë, dhe në të njëjtën kohë edhe komandantë të aksionit. Kjo është kaq e theksuar, saqë pionierët e quajnë veten në aksion të gjithë anëtarë shtabi. Hedhja e të gjithë pionierëve në veprim nxjerr në pah aftësitë krijuese, zotësitë dhe talentet që kanë akumuluar me kohë, si dhe ato që i fitojnë në çast në aksion e sipër. Në këtë mënyrë lulëzojnë talentet organizative, që shërbejnë për një drejtim më të organizuar dhe më të pavarur të punës në organizatën e pionierit.

Së katërti, aksioni influencon për rritjen e forcës së kolektivit, frymës së kritikës dhe të autokritikës si dhe zgjerimit të këndit të të parit kundrejt të metave që vërehen në jetën e pionierëve, në shkollë, familje e shoqëri. Siç dihet qëllimi kryesor i aksionit që ka marrë organizata e pionierit është formimi i koncepteve, i pikëpamjeve dhe bindejeve të thella marksiste-leniniste të pionierëve kundër gjithshkaje të huaj për ideologjinë e pikpamjet tona, kundër atyre tendencave dhe mbeturinave mikroborgjeze që shfaqen tek disa në sjelljen dhe qëndrimin e tyre ndaj jetës. Në fillim, kur pionierët hidhen në aksion, nuk i kanë parasysh të

gjitha këto mbeturina, por në veprim e sipër i zbulojnë dhe i godasin me anë të fletërrufesë, kritikës, autokritikës etj.

Së pesti, aksioni krijon mundësinë për një unitet më të madh të punës së organizatës së pionierit me shkollën e organizatat e masave dhe ndihmon për mënjanimin e metodave të vjetra të punës me pionierët, ku kishte shfaqje të theksuara shabllonizmi, formalizmi dhe burokratizimi.

Të gjitha këto janë rrjedhime të metodës së aksionit, si një aspekt i veprimtarisë së pionierëve. Plenumi VIII porositi dhe një herë për rritjen e mëtejshme të vetëveprimit të organizatës së pionierit. Kjo arrihet, në qoftë se do të aplikojmë më shumë metodën e aksionit në të gjithë procesin e edukimit, sepse baza e zgjidhjes marksiste të problemit të edukimit të fëmijëve që në vogëli është pjesëmarrja e tyre në praktikën revolucionare të jetës, duke ruajtur karakterin psikologjik të saj. Në këtë drejtim organizata e pionierit ka një terren të pakufizuar mundësish. Por nuk dua ta absolutizoj metodën e aksionit, ta konsideroj atë baraz me metodën. Përkundrazi, kjo metodë është efektive kur gërshetohet dhe lidhet me metodat e tjera të edukimit. Në radhë të parë duhet siguruar lidhja e saj harmonike me metodën e bindjes.

...

Pionieri, Nr.24/ 29 dhjetor 1980, fq. 4

Nga aksioni në aksion

Aksionet janë bërë metodë pune për pionierët e çetës së shkollës 8-vjeçare "Xhevdet Doda" në Bulqizë.

Pasi përfundoi me aksion rregullimi i ambienteve brenda shkollës e rreth saj, pionierët e çetës u hodhën në aksion për grumbullimin e kromit nga stogjet e sterilit të minierës. Duke punuar me emulacion e sedër revolucionare, të gjitha kompanitë e çetës sonë arritën të grumbullonin 130 tonë krom. Kur përfundoi ky aksion, nga drejtoria e shkollës dhe shtabi i çetës u nderuan me fletënderi e fletëlavdërimi disa kompani, si kompanitë e klasave Vid, VIIa, Va etj. Po ashtu u nderuan edhe mjaft pionierë të dalluar për punë shembullore.

Duke ndjekur metodën e aksioneve zinxhir, të gjithë pionierët e çetës sonë u hodhën në një aksion tjetër po aq të rëndësishëm, në aksionin e zhveshjes dhe të magazinimit të misrit në kooperativën bujqësore të Fushë-Bulqizës.

Pionierët mblodhën në të gjitha parcelat edhe kallinjtë e fundit, dhe nuk lanë asnjë kokërr misri në arë.

Shtabi i çetës ka qëndruar në ballë të këtyre aksioneve jo vetëm duke ngarkuar me detyra konkrete çdo anëtar të shtabit, por edhe duke e tërhequr masën e pionierëve nëpërmjet shembullit personal të tyre. Këto aksione zinxhir e kanë pasuruar më tej përvojën tonë në organizimin e aktiviteteve. Gjatë këtyre ditëve janë zhvilluar mjaft biseda tërheqëse dhe interesante me minatorë e kooperativistë të pararojës, heronj të punës socialiste, veteranë, etj.

Arjan Lami
Anëtar i shtabit të çetës së shkollës 7-vjeçare "Xhevdet Doda" Bulqizë.

Pionieri, Nr.24/ 29 dhjetor 1980, fq.2

Vit i ri, ç'gëzim të pret te ne

Viti i Ri, ja erdhi përsëri
Shihni sa i bukur po na vjen!
Vepra, dritë, këngë, lumturi
Anembanë Shqipërisë gjen.

'80, kur erdhe ne të pritëm
Me gëzim fitoresh, si gjithmonë.
Me ty shtratin dhe më shumë ua rritëm
Veprave të pesëvjeçarit tonë!

Ndaj tani me festë të përcjellim,
më të fortë u bëmë, më kryelartë!
Viti i Ri plot vepra do të sjellë:
Me të nisim Pesëvjeçarin e Shtatë.

Mirë se erdhe, pra, o Vit i Ri,
hej, ta dish çgëzim të pret te ne!
Nëna jonë, e shtrenjta jonë Parti
Ka sivjet të madhin jubile!

Vitet presim ne gjithmonë krenarë,
se punojmë, mbrojmë, jetojmë me nder,
se marshojmë përpara fitimtarë
me Partinë, me xhaxhin tonë Enver!

Adelina Mamaqi

Pionieri, Nr.24/ 29 dhjetor 1980, fq. 13

Në bjeshkët e Kelmendit

.....
Shkolla e mesme buzë Cemit
Tamara është si mozaik i rrallë midis malesh. Dhe një ndër ndërtesat më të

bukura të këtij fshati, ngritur midis shtëpive, pranë një brinje malore në afërsi të rrjedhës së Cemit, është shkolla e mesme zooteknike „11 Janari“. Në korridoret e territorin e pastër të saj ka përherë gjallëri. Në hyrje të portës kryesore është vendosur portreti i udhëheqësit tonë të dashur, shokut Enver Hoxha. Ndërsa në muret e korridoreve shikon stenda të shkruara bukur, ku janë afishuar plane pune iniciativa e mjete të shumta figurative, që i tregojnë vizitorit se këtu vihen plotësisht në jetë porositë e Kongresit të 7-të të PPSH për harmonizimin e tre komponentëve të shkollës: mësim, punë prodhuese dhe edukim fizik e ushtarak.

Me forcat e tyre, mësues e nxënës kanë ndërtuar kabinetet e lëndëve përkatëse, të cilat i mirëmbajnë dhe i pasurojnë herë pas here.

Në këtë shkollë zhvillohen një sërë aktivitetesh të larmishme nga nxënësit përherë të qeshur e të gëzuar. Gëzohen të gjithë për sukseset që ka arritur Kelmendi në të gjitha fushat e jetës, shprehin mirënjohjen e thellë ndaj Partisë dhe shokut Enver.

Kolë Progni

Pionieri, Nr.24/ 29 dhjetor 1980, fq. 21.

Puna në kooperativë

Gruri i pjekur si flori
Fëshfërin në arë
Korr kombajna plot kallinj,
pret hambari i gjerë.

Dhe këndon fshatari,
për lumturinë merr këngën,
grur e misër, rrush i mbarë,
seç u ngrohka zemrën!
U buron nga zemra kënga,
me çifteli ia thonë,
burrërore vallja hidhet
për Partinë tonë!

Xhuljeta Thano
Nxënëse
Klasa VIII shkolla 8-vjeçare “Jani Bakalli” Fier

Pionieri, Nr.24/ 29 dhjetor 1980, Fq. 20

Nëna jonë trime!

O Parti e dashur,
nëna jonë trime,
shqipja Shqipëri,
me ty nis fluturimet.
Zemrat tona të vogla
Rrahin plot dashuri
Për xhaxhin Enver,
për nënën Parti.

Brunilda Dema
Nxënëse shkolla "Konferenca e Labinotit" Tiranë

Pionieri, Nr.24/ 29 dhjetor 1980, fq. 22-23

Arrita në Shqipërinë socialiste

Arrita në mes jush,
të dashur pionierë,
më priti Shqipëria
e bukur si pranverë.
Partia trimëreshë
Sa lart, sa lart e ngriti,
e gjeta Shqipërinë
të fortë shkëmb-graniti!

Ju rroni të gëzuar
Në këtë vend të lirë,
sa gjak u derdh të zhduken
mjerim dhe errësir,
sa djersë që po derdhet
mbi tokën shqipëtare
të ngrihen veprat lart
me vrull ndër pesëvjeçarë!

E bukur anembanë,
ashtu si thotë Partia,
kështjellë e pamposhtur

të jetë Shqipëria;
rrethimin ta dërrmojë,
të bëhet më e fortë,
kala e Socializmit
të jetë ajo në botë.

Dhe sa më bëhet qejfi
Kur ju shikoj çdo orë
Të zellshëm në mësime,
të urtë e punëtorë,
të sjellshëm dhe të dashur,
të zotë dhe të thjeshtë.
E ndjej gëzimin tuaj
Dhe zemra s'mund të heshtë...

Të parët në aksione
Dhe të palodhur kurrë,
stafetën kur ta merrni,
të ngrini lart flamurë!
Përpara të sulmoni
Në krahët e diturisë,
si bij të kësaj toke,
ushtarë të Partisë!

Ju hidhni shtat të lumtur,
u jep hov Socializmi,
filiza të një toke
ku rritet heroizmi,
filizat e një toke
të lirë, legjendare,
që përballon stuhitë
e fortë dhe krenare!

Që nuk ia zgjat kurrë dorën
Për ndihm askujt në botë.
Ndonjë le të çuditet,
habinë le ta thotë,
ndonjë të llomotisë
sa t'ia mbajë "takati",
ndonjë le të pëlcasë,
po deshi, "nga inati"...

Karvani shkon përpara,
oh, ç'pamje madhështore,
çdo vit ju më të fortë
marshoni me fitore,
çdo vit më të pamposhtur
kudo buçet jehona:
„Ndërtojmë Socializmin
Vetëm me forcat tona!"

Dionis Bubani

Grillo, Dhimitër (1981), Edukata morale dhe politike (Për klasën e 7-të), maket, Tiranë.

....
fq. 10

3. Tiparet e njeriut të ri revolucionar

Njeri të formuar, revolucionar, ne quajmë atë njeri, i cili ka përvetësuar mësimet e Partisë, që merr pjesë gjallërisht në jetën dhe punën e përditshme, që është i aftë të kryejë detyrat me nder dhe që lufton për t'i kryer ato me nder.

Të jesh revolucionar, do të thotë të mbrosh dhe të përhapësh çdo sjellje dhe çdo veprim që ndihmon për ndërtimin e socialzmit, të luftosh me vendosmëri çdo shfaqje që bie në kundërshtim me interesin e përgjithshëm.

Nuk është revolucionar ai që tregohet indiferent ndaj ngjarjeve dhe armikut, pasiv, i frikshëm, ai që sheh sjellje e veprime që pengojnë e dëmtojnë ndërtimin e socializmit dhe nuk lufton për t'i asgjesuar ato.

...
Fq. 13-16
RRUGËT E EDUKIMIT REVOLUCIONAR TË RINISË

1. Parulla jonë e ditës: të mendojmë, të punojmë, të jetojmë si revolucionarë

Tek ne tregohet kujdes i vazhdueshëm për edukimin e të gjithë punonjësve. Kujdes tregohet veçanërisht për edukimin e rinisë, në mënyrë që ajo të qëndrojë kurdoherë në ballë të punës për forcimin e pushtetit popullor, për ndërtimin e socialzmit dhe për mbrojtjen e Atdheut. Parulla e Partisë, që është bërë parulla e gjithë popullit, e gjithë rinisë, është: "Të mendojmë, të punojmë, të jetojmë si revolucionarë". Duke studjuar materialet e Partisë dhe mësimet e shokut Enver, kudo po lindin e zhvillohen inisiativa e aksione revolucionare për të punuar, luftuar e jetuar si revolucionarë në rrethim, për të shpartalluar çdo rrethim e bllokadë imperialisto-revizioniste, për të ndërtuar socializmin me forcat e veta.

II. Rrugët nëpërmjet të cilave edukohet rinia

1. Nëpërmjet mësimit

Rinia e jonë është hedhur në sulm të përgjithshëm për ndërtimin e socialzmit. Këtë ajo e tregon me punën e saj. Mirepo ajo nuk do të jetë në gjendje të ecë mirë në ballë, në qoftë se nuk çmon sa duhet mësimin, punën, kalitjen.

Në qoftë se një pionier, një i ri, e kupton se di pak, ai përpiqet të mësojë më shumë. Por, në qoftë se ai thotë se nuka ka ç'i duhet të mësuarit, sepse ai i di të gjitha, ai nuk do të qëndrojë kurrë në ballë të luftës për ndërtimin e socialzmit, bile ai nuk do të bëhet një ndërtues i mirë i socializmit.

Për ta ndihmuar rininë që të mësojë, në fshatra dhe qytete janë hapur shkolla të shumta pa shkëputje dhe me shkëputje nga puna dhe funksionojnë kurse e institucione të tjera.

Krahas mësimeve të tjera, rinia mbi të gjitha përvetëson mësimet e Partisë. Ju, në shkollën tetëvjeçare, i përvetësoni këto mësime nëpërmjet lëndës së edukatës morale dhe politike dhe lëndëve të tjera si dhe nëpërmjet aktiviteteve jashtëshkollore. Këto mësime do t'ju ndihmojnë të bëheni ndërtues të aftë të socializmit.

2. Nëpërmjet pjesëmarrjes në luftën e klasave

Gjatë Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare rinia u hodh në luftë kundër fashistëve e tradhëtarëve. Pas vendosjes së pushtetit popullor, rinia luftoi kundër zakoneve prapanike dhe besimeve fetare. Sot rinia lufton kundër ndikimeve borgjeze dhe revizioniste, shfaqjeve të huaja. Ajo lufton për krijimin e zakoneve të reja socialiste. Rinia është forcë e madhe për ndërtimin e socializmit dhe mbrojtjen e atdheut.

Pa marrë pjesë gjallërisht në luftën e klasave, rinia nuk mund të bëhet me të vërtetë revolucionare. Gjendja e brendshme e vendit tonë është forcuar e çelnikosur nëpërmjet një lufte klasore të mprehtë të cilën Partia e populli e kanë zhvilluar kundër veprimtarisë të rrezikshme armiqësore nga disa elementë armiq të Partisë, shtetit, popullit tonë. Në tërë këtë luftë Partia ka dalë fitimtare, është forcuar e çelnikosur më tej. edhe rinia është kalitur në dallgët e luftës klasore. Lufta e klasave në vëndin tonë zhvillohet kundër armiqve të brendshëm, të jashtëm e mbeturinave të huaja.

3. Nëpërmjet pjesëmarrjes në punë në prodhim

"Vetëm duke punuar bashkë me punëtorët dhe fshatarët, - ka thënë Lenini, - mund të bëhesh komunist i vërtetë". Kjo do të thotë që puna në prodhim i edukon njerëzit me frymë revolucionare, i bën ata të jenë luftëtarë kundër ideologjisë borgjeze dhe revizioniste.

Partia i mëson njerëzit e punës mendore që të marrin pjesë drejtpërdrejtë në punën në prodhim dhe lufton që dallimi midis këtyre të dy lloj punëve të ngushtohet sa më shumë, deri në çdukje.

Duke vënë në jetë mësimet e Partisë, rinia u është përveshur aksioneve të mëdha të ndërtimit socialist, të cilat janë kthyer në një shkollë të madhe. Këtu të rinjtë e të rejat edukohen për të çmuar si punën mendore, ashtu dhe punën fizike dhe, njëkohësisht, i japin shtytje të fuqishme përpara të gjithë jetës së vendit. Pjesëmarrja drejtpërdrejtë në punë si punëtor, minator, kooperativist, blegtor etj. është detyrë e nderuar.

4. Duke u hedhur në luftë për fitoren e interesit të përgjithshëm mbi atë vetjak

Partia vazhdimisht ka luftuar që njerëzit të edukohen me frymën e nënshtrimit të interesit vetjak ndaj interesit të përgjithshëm.Këtë mësim të Partisë e ka bërë të vetin i gjithë populli. Kështu shpjegohet gadishmëria e njerëzve tanë, e rinisë sonë, për të shkuar atje ku e do e mira e Atdheut, për të sakrifikuar edhe jetën për mbrojtjen e tij. Tregoni disa nga inisiativat e shumta që kanë si shtytje kryesore vënien e interesit të përgjithshë mbi atë personal.

5. Duke mësuar atë që, pranë librit dhe kazmës, të mbajë edhe pushkën.

Krahas miqve të shumtë në botë, populli ynë ka edhe armiq të egër, të cilët s'lënë gjë pa bërë për të na penguar dhe për të na dëmtuar, për të rrëzuar pushtetin popullor dhe për të rivendosur në vendin tonë regjimin kapitalist. Këta armiq janë imperialistët, me ata amerikanë në krye, revizionistët moderë, si ata sovjetikë, jugosllavë, kinezë etj si dhe armiq të tjerë.

Prandaj rinia, kudo që ndodhet, në kufi apo në njësitë e ushtrisë, në shkollë, në fabrikë apo në arë, pranë librit dhe kazmës, mban edhe pushkën, për të mbrojtur Atdheun, mban lart vigjilencën revolucionare.

6. Duke e edukuar atë me ndjenjat e internacionalizmit proletar

Partia e mëson rininë që t'i dojë popujt e tjerë, të solidarizohet me luftën e tyre për liri e pavarësi, për socializëm. E mëson gjithashtu se lufta e saj për ndërtimin e socializmit dhe mbrojtjen e Atdheut është shprehja e internacionalizmit proletar, sepse qenia dhe përparimi i Shqipërisë është ndihmë dhe shembull për popujt e tjerë. Shqipëria është i vetmi vend socialist në botë.

Këto janë disa nga rrugët, nëpërmjet të cilave edukohet rinia jonë që të mendojë, të punojë dhe të jetojë si revolucionare si në rrethim, për të mposhtur çdo bllokadë e veprimtari armiqësore të armikut të brendshëm e të jashtëm.

Fq. 117-119
THJESHTËSIA NË JETESË
....

2. Modë që të shëmton

Ka disa njerëz, të cilët i kushtojnë një kohë të gjatë dhe një kujdes të tepruar paraqitjes së tyre të jashtme dhe, veçanërisht, veshjes. Por kjo kohë e humbur dhe ky kujdes nuk përdoren për të vënë në pah gjithçka të bukur që ka njeriu. Përkundrazi, përdoren për t'u shëmtuar. Sepse nuk është gjë tjetër veçse shëmtim të vishesh në mënyrë ekstravagante, me lloj-lloj zbukurimesh dhe gjëra të tjera, që nuk pajtohen me shijet e ndërtuesve të socializmit.

Ata që vishen kështu thonë se ndjekin modën.

Kuptohet që të rinjtë, në veshjen e tyre, në shijet e tyre, sigurisht që duhet të ndjekin modën. Në këtë mes s'ka asgjë të keqe. Por, të ndjekësh modën, do të thotë të vishesh thjeshtë dhe bukur, të sillesh në mënyrë të kulturuar dhe jo të tërheqësh vëmendjen e të tjerëve dhe përçmimin e tyre.

Veshja me zbukurime të palejueshme dhe gjëra të tjera të tepruara, si dhe shfaqjet e papëlqyera nuk flasin për një njeri të edukuar, por për një njeri të çoroditur, që kërkon të imitojë botën e huaj, i cili gjithë vëmendjen e tij e ka të përqëndruar te pantallonat, te bluzat me lule-lule, te rripat e mesit; flasin për një njeri që i pëlqen vetja.

3. Shfaqje të tjera që e shëmtojnë njerinë

Njerëzit që vishen në mënyrë ekstravagante përvetësojnë edhe vese të tjera të këqija, të cilat i largojnë përherë e më shumë nga populli ynë që bën një jetë të thjeshtë, por me kulturë.

Ata mbajnë flokë të gjata, që u mbulojnë qafë dhe veshë, bile, edhe gjithë ballin; ata nuk dinë se ç'është krëhëri; ecin si kapadainj, duke u krekosur e duke u tundur, duke fërshëllyer e duke gërthitur; ata e vështrojnë bashkëbiseduesin sikur vetë të ishin, kush e di, njerëz që qëndrojnë mbi të tjerët; nuk respektojnë njeri, nuk ua vënë veshin këshillave dhe kanë një të folur të vrazhdët; kur flasin me më të mëdhenjtë, ata s'përdorin kurrë fjalën "ju", por i drejtohen tjetrit sikur ta kishin shok e moshatar; duke folur, ata bëjnë gjeste me duar e këmbë; nuk lënë njeri pa trazuar e pa marrë nëpër gojë...

Atyre u duket se kanë arritur kulmin e përsosmërisë, se ata dhe vetëm ata dinë gjithçka dhe se të tjerët mbeten gojëhapur përpara tyre, kurse në të vërtetë të tjerët tundin kokën me keqaqrdhje.

Ata i ka pushtuar vetëkënaqësia.

Njerëz të tillë nuk janë të vlefshëm për shoqërinë tonë. Ne kemi detyrë të punojmë me durim e këmbëngulje me ta, që t'i sjellim në rrugë të drejtë.

fq. 136-139

GJITHSHKA PËR ATDHEUN

2. Detyrat tona ndaj atdheut

Pra, edhe ne kemi detyra ndaj atdheut.

Detyrat tona, të nxënësve, janë më të thjeshta se ato të prindërve, motrave

e vëllezërve tanë më të mëdhenj, të cilët janë futur në radhët e ndërtuesve të socializmit dhe prodhojnë të mirat materiale, pa të cilat shoqëria nuk do të jetonte asnjë ditë.

Detyrat tona s'kanë të bëjnë drejtpërsëdrejti me prodhimin. Por janë shumë të rëndësishme, sepse nga zbatimi i mirë i tyre do të varet, në të ardhmen, përparimi dhe lulëzimi i atdheut, mirëqënia e tij.

- detyra e parë dhe më kryesorja për nxënësit është mësimi. vetëm duke mësuar, duke përvetësuar njohuritë që marrim nëpërmjet lëndëve të ndryshme, ne do të pregatitemi mirë dhe do të bëhemi të aftë për të ecur në ballë të luftës për ndërtimin e shoqërisë socialiste.
- Pjesëmarrja në punën e dobishme shoqërore, kudo që të paraqitet nevoja, pa na e kërkuar njeri ndihmën, por me inisiativën tonë, është një detyrë tjetër e rëndësishme.
- Krahas mësimit dhe pjesëmarrjes në punën e dobishme shoqërore ne duhet të luftojmë për të kalitur trupin në mënyrë që të jemi të shëndetshëm dhe të fortë. Një fjalë e urtë thotë "mendja e shëndoshë në trup të shëndoshë".
- Detyra të tjera janë sjellja e kulturuar që duhet të na dallojë, respekti për njeriun, nderimi për më të mëdhenjtë, pjesmarrja në luftën e klasave, lufta kundër zakoneve prapanike dhe mbeturinave fetare, disiplina e shëndoshë.

  Nga ne kërkohet që kujdesit atëror të partisë t'i përgjigjemi duke kryer me përpikmëri detyrat tona, sepse jemi gjymtyrë të rëndësishme të atdheut. Vetëm atëherë do të kemi nderin të quhemi atdhetarë të mirë.

3. Ata që kërcënojnë atdheun

Që të ndërtojmë socializmin ne kemi nevojë të jetojmë në paqe. Mirëpo në botë ka forca, të cilat nuk e duan paqen. Për këto forca ne kemi dëgjuar të flitet: janë imperializmi me atë amerikan në krye, social-imperializmi sovjetik dhe forcat e tjera reaksionare në botë, si revizionistët jugosllavë, kinezë e armiq të tjerë.

Këto forca kërcënojnë popujt e ndryshëm, kërcënojnë edhe vendin tonë dhe përpiqen si e si ta gjunjëzojnë dhe të futin hundët në punët tona, mundësisht edhe të na grabisin lirinë e pavarësisë, të na skllavërojnë. Kjo do të thotë që ne të humbasim të gjitha fitoret a arritura, të heqim dorë nga gëzimi i jetës sonë.

4. Mbrojtja e Atdheut- detyrë mbi detyrat

Në qoftë se do të ndodhte një gjë ë tillë, për ne nuk do të kishte më arsye për të jetuar. Por ne e duam jetën, duam atdheun tonë të dashur, duam natyrën tonë të bukur, duam lirinë. Për këtë kemi arsyet tona vetjake dhe të përgjithshme, prandaj jemi të gatshëm t'i mbrojmë me çdo çmim. Këtë e kemi treguar jo vtëm në një rast. Ne e kemi çarë rrugën e historisë me shpatë në dorë. Jemi matur me armiq të fuqishëm dhe s'jemi turpëruar. Janë dëshmitarë malet e fushat tona tona të përgjakura. Kujtime të hidhura duhet të ruajnë edhe sot ata që në të kaluarën janë përpjekur të na nënshtrojnë.

"Neve s'na lejohet dhe nuk duhet që pushka të na zërë ndryshk, as sot e as gjatë shumë brezash të tjerë", na porosit shoku Enver Hoxha.

Duke zbatuar porositë e shokut Enver, populli ynë, krahas kazmës, mban në dorë edhe pushkën, njeh artin luftarak dhe kalitet, është vigjilent dhe godit aty për aty çdo veprimtari që bie në kundërshtim me interesat e atdheut.

5. Detyrat tona në mbrojtjen e atdheut

Edhe nxënësit kanë detyra për mbrojtjen e atdheut. Pikësëpari ata duhet të dinë pse do të luftojnë dhe kundër kujt do të luftojnë, të përvetësojnë mësimet e Partisë, të jenë vigjilentë dhe të kaliten fizikisht. Ata duhet të jenë të shëndetshëm dhe të fortë. Ndikojnë për kalitjen fizike gjimnastika e mëngjesit, vrapimet, kërcimet, noti, shëtitjet në ajër të pastër, turizmi etj.

Atdheu ynë është i vogël, por i fortë. Gjatë shekujve mbi të janë përplasur stuhi të egra e të furishme. Gjokset e bijve e të bijave të tij i kanë përballuar dhe i kanë sprapsur. Vetëm në Luftën Nacionalçlirimtare populli ynë dha 28 mijë dëshmorë. Ai është mësuar të mos e kursejë në asnjë rast jetën, kur është fjala për mbrojtjen e atdheut.

Ministria e Arësimit dhe e Kulturës, Drejtoria e arësimit parashkollor (1970). Vjersha, përralla, tregime dhe lexime për fëmijët e moshës parashkollore (Në ndihmë të edukatorëve të kopshteve të fëmijëve), Tiranë.

Fq. 10

Ferhat Cakerri

ZEMRA IME

Në të voglën zemrën time
Ka një mal me dashuri,
Për Enverin; për Partinë
Dhe për mëmën Shqipëri.

Fq. 10

STËRVITEM

Po stërvitem
Dhe kalitem
Që me pushkë
Të qëlloj.

Shqipërinë
Atdheun tim,

Nga armiqtë
Do ta mbroj.

Fq. 15

Robert Grabocka

PORSI PARTIZAN

Me pushkën e vogël
Ai do mësojë
Më von' kur të rritet
Atdheun të mbrojë.

Në duart e vogla
Një pushk' djali mban
Dhe ecën krenar
Porsi partizan.

Fq. 44

Bekim Gaçe

PËR TY JAM USHTAR

"Partizan i vogël"
Babi më thërret.
E nderoj me grusht,
Trupin e mbaj drejt.

"Partizan i vogël"
Mami përsërit.
Pushkën mbaj në krah,
Ylli më shëndrit.

"Partizan i vogël"
Them me krenari.
Për ty, jam ushtar,
Nëna Shqipëri!

Fq. 51
Petraq Samsuri

ENVERIT

Në çdo tetor më gjashtëmbëdhjetë
Dit-lindjen tuaj ne kujtojmë,
Nga zemra jonë për mot e jetë,
Gjithnjë shëndet ne ju urojmë.

Lulet e freskëta plot me erë
Për ju i zgjedhim në këtë datë,
Nga gjith fëmijët shoku Enver
Pranoni urim për jetë të gjatë.

5.3 Gruaja dhe jeta familjare gjatë sistemit komunist

AQSH, Fondi 14 (KQ i PPSH), Viti 1946, D. 45, Fl.16-18.

KOMITETI QARKOR I P.K.SH.
PËR SHKODRËN
Nr. 45/6

VDEKJE FASHIZMIT
LIRI POPULLIT
Shkodër më 17.V.1946

Komitetit Qëndror të P.K.Sh.
Tiranë

Të dashur shokë,

Këtu poshtë ju jap një relacion në lidhje me Gruan Antifashiste të qarkut t'onë:

1. Si lëvizje gruaje në qarkun t'onë mund të themi se kemi diçka në qendrë, Koplik, Lesh dhe Pukë. Në Mirditë e Dukagjin ndodhemi shumë prapa dhe as që kemi prespektiva tashti për tashti, të bëjmë diçka. Kjo pse tereni është shumë i prapambetur, organizata shumë e dobët dhe shoqet mungojnë fare. E vetmja punë që mund të bëhet atje sot për sot është me anë të ekipevet. Për këtë ne organizuam dhe nisëm dje një ekip prej 16 grashë. Ky ekip do të përshkojë mundësisht të gjitha fshatrat e qarkut t'onë. Filloi dje dhe do ta vazhdojë punën gjatë gjithë verës. Çdo 15-20 ditë ekipi do të kthehet në qytet dhe do të niset përsëri pas 4-5 ditve. Gjatë kësaj kohe do të ndrohen ato gra që e ndjejnë vehten të lodhur, ose që kanë punë të tjera. Si përmendim edhe në raport, ky ekip do tu mësojë grave katundare mbi bukën, pastrimin e shtëpis, ritjen e fëmijës, punën vullnetare etj.

Në qytet lëvizja e gruas është vrejtur në pjesmarrjen e saj në punë vullnetare

(ku janë dalluar shtresat e ulta, sidomos ato muhamedane) ku kanë mbritur të marrin në një aksion edhe gjer më 300-400 gra; në pjesmarrjen e kurseve kundra analfabetizmit (qytet e katunde) ku sot frekuentojnë 377 gra e vajza të rregullta e me vullnet. Theksojmë se në katundin Dajç të Bregut të Bunës, 26 vajza kanë mësuar të shkruajnë e të këndojnë dhe tashti marrin njohuri të ndryshme shtëpijake dhe shkollore. Në qytet e më katunde kemi 26 kurse kundra analfabetizmit. Në qytet kemi dhe një kurs robaqepsie ku marin pjesë 117 veta nga të cilat 80 të rregullta. Nga këto kanë mësuar të presin e të qepin 17 vajza; të tjera janë në specializim e sipër. Kemi dhe një kurs qylymash me 27 veta, vajza të reja më tepër që janë në mësim e sipër. Në konferenca e mitingje është dalluar gruaja muhamedane dhe pjesërisht edhe ajo katolike (shtresa e ulët), kurse shtresa e mesme katolike dallohet fare pak ndërsa e larta qëndron indiferente ose kundra nesh. Për gruan katundare të rretheve të qendrës, kemi nxjerrë disa ekipe gjatë Prillit dhe Majit në lidhje me axhitacionin për punën vullnetare. Puna e tyre ka qënë e pakët dhe pjesmarrja e grave katundare në punë ka qënë e vogël. Po ne mendojmë se me vazhdimin e një pune të tillë, do të kemi përmirësime.

Në Lesh vetëm kohët e fundit ka filluar një farë hovi në lidhje me lëvizjen e gruas. Dërguam atje nj'a dy shoqe të ardhura nga jugu, të cilat në bashkpunim me shoqen e gruas në Lesh, mundën të nxjerrin nja 20 e ca gra çdo të dielë në punë vullnetare, mundën të ngrenë një kurs robaqepësije me nj'a 10 veta dhe nj'a 6 kurse kundra analfabetizmit me 90 veta (të rregullta 56). Pjesmarrja e grave nëpër konferenca nuk mund të themi se është diçka koshjente pse ato nuk janë akoma në gjendje t'ua kuptojnë rëndësin. Po ato të pakta shoqe që janë atje mundohen të punojnë diçka dhe organizata herë pas here nxjerrë katundeve ekipe të shkurtra prej 4-8 grash për pak ditë, për sa thamë më lartë dhe për të ndihmuar në ngritjen e kurseve kundra analfabetizmit.

Në Koplik kemi diçka më tepër, sidomos në krahinën e Buzës Ujit ku gati të gjitha gratë janë në punë vullnetare (mbledhje kolektive, luftim karkaleci etj.). Në këtë nënprefekturë kemi nj'a 10 kurse kundra analfabetizmit me një frekuentim prej 200 vetash gati të gjitha të rregullta. Këto kurse i mbajnë shoqet ose ndonjë mësuese e lidhur me ne. Pjesmarrja e gruas së kësaj nënprefekture në punë vullnetare (punime kanalesh, pastrim tokash, mbjellje kolektive, luftim karkaleci etj.) arrin në 35 %. Edhe në konferenca e mitingje, pjesmarrja e gruas është diçka më e gjallë këtu se në Lesh e Pukë.

Në Pukë kemi fare pak punë. Një pakicë grash dallohet në Qeret (katund) në punë vullnetare, një pjesmarrje gjër më 20-25 gra në ndonjë konferencë dhe dy kurse kundra analfabetizmit me 30 veta gjithsejt. Kohët e fundit u krijuar dhe një kurs robaqepsije, me nj'a 5 veta.

Në katunde dhe në nënprefektura e pengon daljen e gruas vetë burri dhe fanatizma. Për këtë është parë e nevojshme një kombinim i punës me frontin: çelulat kanë shtruar në plan dhe veprojnë duke futur në lëvizje farefisin, miqt, duke theksuar nëpër mbledhje fronti rëndësin e gruas etj. Dhe me këtë mënyrë kemi

mundur të bëjmë diçka; kemi mundur të aktivizojmë të paktën një pjesëgrash, mëmash ose mortrash e kushërirash të shokëve t'anë, se ndryshe me këtë numër të pakët të antarëve të Partis që kemi ne, nuk i delet lehtë. Ne, këtë mënyrë veprimi e vazhdojmë. Përveç punës nëpër konferenca, për mobilizimin e gruas na ka ndihmuar axhitacioni i vogël, mbledhjet e ngushta nëpër rrugica me 5-10 gra ose dhe mbledhje më të gjera me 10-20 gra, në formë muhabeti, po duke prekur gjithmonë problemet e reja (kurset, peçen, punën vullnetare, parullat e armikut, dyqanet e shtetit etj). Është mbritur të zbulohen një sasi femrash. Për t'a shtuar këtë numër, mundohemi që vajza musulmane, afër nesh, t'i fusim në punë nëpër fabrika ose dyqane, kështu që ajo zbulohet duke nxitur dhe të tjerat. Po kështu veprojmë dhe me vajzat e varfëra katolike, për t'i shkëputur krejt nga influenca e klerit.

Një ndihmë gjër diku të mirë na japin mjaft mësuese, të cilat përveç se mbajnë kurset e ndryshme, herë pas here, ditët e pushimit, dalin nëpër katundet në formë ekipesh.

2. Për shoqatën "Nana e Fëmija".- Gjer më sot në qarkun t'onë janë regjistruar afro 300 anëtare, në pjesën më të madhe në qytet (260); janë mbledhur disa ndihma në të holla, ose veshmbathje, sidomos në qytet, Pukë e Lesh. Është krijuar një kopësht fëmijësh në qytet me 71 fëmijë dhe brënda muajit parashikohen të bëhen edhe dy kopshte të reja. Kemi në plan që brenda një kohe të shkurtër, të ngremë kopshte fëmijësh në çdo sektor të qytetit t'onë. Është ngritur një kopsht fëmijësh në Lesh (në mbarim e sipër) dhe së shpejti mendohet të formohen kopshte të tilla nëpër katundet e Leshit; janë ngritur katër kopshte në Koplik (Buzë Ujit, Bajzë, Qendër, Grumirë-Grudë).

Është bërë një farë pune e vogël kulturale në qytet, Lesh e Koplik (konferenca mbi rregullimin e shtëpisë, mbi pastërtin, mbi ritjen e fëmijëve, është bërë dhe vazhdon të bëhet axhitacion për lyerjen e shtëpive me gëlqere, në gjithë qarkun t'onë. Në këto punë mundohemi të aktivizojmë arsimtarët ose ndonjë doktor ose gratë antifashiste të mira e të zhvilluara. Rivista "Shqiptarja e Re" nuk para shitet, prandaj në kemi udhëzuar organizatën që t'a shtrojë punën në këtë drejtim, duke u përpjekur që artikuj të ndryshëm nga kjo rivistë t'u këndohen grave qytetare dhe katundare. Ka gra psh në qendër e Lesh që e kërkojnë këtë rivistë, po këto janë më tepër nëpër shtresat e mesme e të larta se sa në shtresat e ulta. Kjo edhe pse s'dinë shkrim këndim.

3. Antaret e Partis dhe kursistet kandidate.- Ne kemi fare pak antare partije dhe nga këto gjysma janë më tepër formale (në raportin e fundit të muajit do të dërgojmë një pasqyrë të të gjithë shokëve të qarkut t'onë, me karakteristikat e tyre). Mungesa e një shoqeje të mirë në qarkor na pengon mjaft. Zenepja mundohet të bëjë diçka, po pa qenë në qarkor çalon puna e gruas. Shihet nevojë e domosdoshme ardhja e një shoqeje të aftë për gruan në Komitetin Qarkor. Ne këtej nuk kemi asnjë të tillë dhe shoqja e Komitetit të Qendrës, ndodhet sot në muajin e 8-të me barrë, kështu që pas disa ditësh del jashtë aktivitetit, të paktën për disa muaj. Disa shoqe të tjera të mira, janë të sëmura (Shqiponja Novosela u bë operacion nga apendiciti, Adile

dhe Vehibe Xhabija me barrë në muajin e fundit, Elma Frashëri në Pukë e sëmurë etj.) kështu që puna është përqendruar në mënyrën e veprimit të shokëve si thamë më lartë dhe në ato pak shoqe të tjera që na mbeten. Janë shtuar kohët e fundit nj'a 4 antare të reja aktive dhe të mira nga kurset, parashikohet të shtohen muajin që vjen dhe nj'a dy të tjera, po pastaj numri i tyre kufizohet, pikërisht pse kemi fare pak kursiste kandidate të afta. Në qytet p.sh. kemi 13 kandidate nga të cilat, gjysma nuk vlejnë dhe do të mbeten mikesha të Partisë. Kemi nj'a dy kandidate në Lesh dhe nj'a dy në Koplik. Kemi dhe 10 kandidate në Vrakë, po që janë më tepër mike partie. Vetëm nja dy mund të vlejnë nga kta.

Për këtë arsye organizatës i është shtuar puna me gruan, sidomos me vajzën fshatare e puntore, për të shtuar rradhët t'ona.

Me riformimin e Komisionit të gruas, pranë qarkorit shpresojmë të kemi një farë përmirësimi. Me gjith'atë e vetmja mënyrë pune që do na japi fryte sot për sot në qarkun t'onë është aktivizmi i krejt organizatës (motrat, nënat, gratë e shokëve), aktivizimi i grave të lidhura me ne dhe i nënave ose motrave të dëshmorëve t'anë, aktivizimi i grave antifashiste të mira nëpër kështillat e gruas. Kjo punë është duke u bërë dhe në do të mundohemi t'a zgjerojmë sa më tepër.

4. Reaksioni në grua.- Në qytet dallohet në gratë e shtresave të larta. Këto lëvizin nëpër shtëpit e reaksionarëve, hedhin parulla, mundohen të sabotojnë mbledhjet e lagjeve. Në Lesh, Koplik e Pukë strehojnë dhe ilegalë, bëjnë lëvizje edhe nëpër fshatra (Iballë, Zadrimë, Shkrel etj). Lëvizjet e tyre janë të pakta, po janë tek tuk.

Puna e jonë kundrejt këtyre grave është survejimi dhe demaskimi i parullave të tyre.

Gratë reaksionare nëpër katundet janë ose ato që kanë lidhje familjare me të dëmtuarit ose t'aratisurit, ose gra të dexheneruara që janë përdorur për nevoja seksuale nga vetë këta kriminelat.

5. Në vëndet e punimit kemi një sasi femrash, gra dhe vajza. Në punishtet e duhanit kemi më tepër se 60 që drejtohen nga antare partije dhe disa të reja komuniste, nj'a 8-10 gra në fabrikën e Pagut? Ku punon një antare partije dhe nj'a 20 e ca vajza e gra në fabrikat e cingareve ku punon një antare partije, nj'a dy kandidate e të reja komuniste. Këtu përveç punës së rregulltë, bëhet edhe nga një orë në ditë punë vullnetare për pushtetin dhe në kohët e pushimit bëhen konferenca e diskutime të ndryshme. Këtu ne mendojmë dhe do t'mundohemi të nxjerrim një frytë konkret. Këtu ka femra katolike dhe muhamedane që punojnë bashkë, të gjitha të shtresave të ulta.

6. Në lidhje me të renë.- Puna e bërë nga Rinija dhe nga shokët, ka filluar të ngjalli në të renë musullmane dëshirën e heqjes së çarçafit. Insistojnë të ndërhyjë pushteti pse ato druhen nga prindërit, po shihen vajza që vazhdimisht heqin çarçafin. Ne u kemi spjeguar shokëve dhe atyrve të rinisë se çarçafi nuk do të hiqet më tepër me dekret të pushtetit, po me punën e palodhur dhe vullnetin e vetë vajzavet.

Sa për të renë katolike, ka një farë afrim në shtresat e varfëra (por fare pak të organizuara) kurse shtresat e mesme rrinë akoma indiferente dhe shtresat e larta lëvizin kundra nesh, sidomos vajzat e pasura të shkollës.

7. Më 1 maj inauguruam këtu në qendër shtëpin e maternitetit. Shtëpija është në një vend të mirë, mbahet pastër dhe ka ngjallur një kënaqësit në gratë e qytetit. Do t'mundohemi që këtë shtëpi t'a popullarizojmë sa më tepër.

P.Komitetin Qarkor të Partisë

Spiro Pane

AQSH, Fondi 14 (KQ i PPSH), Viti 1946, D. 45, Fl. 76-83.

UDHËZIME PËR PUNËN EDUKATIVE ME MASAT E GRUAS

Puna e madhe që ka për të bërë organizata e Gruas dhe detyra kryesore e saj është edukimi i masave të gjera të gruas. Një punë të tillë Organizata e gruas e ka bërë, por puna e saj në lidhje me gjëndjen në të cilën ndodhet gruaja në Shqipëri, ka qenë shumë e vogël. Ne kemi nevojë për një punë të madhe dhe intensive në këtë drejtim. Ne duhet të përdorim mjete dhe mënyra të ndryshme pune për edukimin e gruas.

Tashi që Organizata e jonë ka forma të reja organizimi ne mendojmë se me ato forma dhe me funksionimin e rregullt të tyre dhe puna për edukatën e gruas do të bëhet më e madhe dhe e organizuar mirë; edukimi i masës së gruas është gjëja kryesore që duhet të preokupojë Organizatën që në bazë.

Për këtë me këtë letër po ju dërgojmë udhëzime për mënyrat e punës në lidhje me edukimin e gruas.

1) Konferenca për edukimin e elementit udhëheqës t'Organizatës.

Që puna e Organizatës të shkojë mirë e drejt ne kemi nevojë që veçanërisht elementi udhëheqës të jetë i edukuar; për këtë arsye me këtë element duhet të organizohen konferenca edukative të vazhdueshme dhe të lidhura njëra me tjetrën.

Në qytet të gjitha përgjegjëset e blloqeve, antarët e presidiumit, ndihmëset e blloqevet që janë të mira, ndonji grua tjetër aktive i mbledhim të tëra në këto konferenca edukative. Për të lehtësuar punën dhe për të patur më frut bëjmë ndarjen e këtij elementi në 2-3 grupe simbas kategorisë dhe për sejcilën grup caktojmë një plan edukativ në lidhje me nivelin e tij.

Shoqet që do të zhvillojnë konferencat në këto grupe duhet të zgjidhen adapte (qofshin këto shoqe që punojnë vetëm me Organizatën e Gruas, ose shoqe që punojnë në Pushtet e gjetiu). Konferencieret e këtyre grupeve grash duhet të mblidhen më përpara, të shtrojnë planin bashkë me përgjegjësen e gruas në qark (kryetares ose sekretares) dhe të përgatiten mirë për konferencën.

Konferencat me këtë element duhet të bëhen të rregullta në dit e kohë të caktuara të marin formën e kursit. Këto mund të bëhen një herë në javë ose në dy javë simbas gjendjes t'organizatës.

Për edukimin e elementit udhëheqës në fshat duhet të përkujdeset shoqja që punon në rajon të caktuar fshatrash, dhe në raste të ndryshme, në mbledhje

të të gjitha përgjegjseve, ku janë për t'u shtruar punë të tjera të bëhet edhe një konferencë edukative.

Në krahina ku katundet janë afër njëri tjetrit puna e edukimit të udhëheqseve në fshat mund të bëhet duke mbledhur 10 a 15 fshatra në një vënd një herë në dy javë. Me këtë grup fshataresh mund të punohet si në qytet, duke zhvilluar me to një program të caktuar.

2) Konferencat në masën e gruas.

Konferencat që do të bëjmë në masën e gruas do të kenë karakter të ndryshëm: janë konferenca politike dhe edukative, konferenca për fshat e për në qytet. Këto do të bëhen:

1) Me gratë e të gjith bllokut e fshatit
2) Me gratë e gjith lagjes
3) Me gratë e gjith qytetit
4) Vetëm me aktivistet

Konferencat do të bëhen në kohë të caktuar. Themat do të punohen do të jenë të dërguar që nga kryesija ose thema që ka vet qarku në lidhje me problemet e tij.

Masa e gruas ku do te zhvillohet konferenca duhet të jetë e caktuar p.sh. një themë politike "Të ruajmë frutet e luftës" e zhvillojmë në bllok, në fshat, ndërsa gruaja në "Bashkimin Sovjetik" e zhvillojmë në një konferencë të gjerë me gjith gratë e qytetit.

Kur masën e gruas kemi nevojë t'a skjarojmë për disa gjëra aktuale, disa herë bëjmë konferencë vetëm me aktivistet e blloqeve, të sejcilit bllok, fshat, ose të 3-4 fshatrave ose blloqeve bashkë. Aktivistevet ju ngarkohet si detyrë që atë që muarën në atë konferencë t'a çojnë në masën e grave me agitasion dhe me grumbullime të vogla grash.

.....

IV) Edukimi i gruas në kurse të ndryshme.

Organizata e jonë duhet të përkujdeset për hapjen e kurseve të ndryshme për gruan, të drejtuara këto nga vetë ajo ose nga Pushteti. Ajo duhet të bëjë që pjesëmarrja e gruas të jetë sa më e madhe.

a) kurset kundra analfabetizmit

Kurse të kësaj kategorije ne duhet të kemi të ngritura në çdo fshat, në çdo bllok. Në fshat drejtimin e këtij kursi duhet t'a marrë mësuesja e fshatit, në mungesë të saj gruaja që di të shkruajë e të këndojë, ose një nga Këshilli i Frontit në fshat. Në bllok mund të kemi 2-3 kurse, edhe këta duhen të drejtohen nga të reja, nga gra aktive, nga mësuese, por këto t'a kenë këtë punë të caktuar. Për aktivitetet e bllokut kjo duhet të jetë një nga detyrat kryesore. Mbledhja e kursit duhet të jetë sa më e shpejtë por të mos jetë kurrë më pakë se dy herë në javë.

Kurse kundra analfabetizmit duhet të hapin në vëndet e punës për gruan, në fabrikë, në kooperativë, në vënde të ndryshme ku ka grumbullime të gruas për punë.

Kurse që hap arësimi për këtë punë duhet të frekuentohen dhe nga gruaja.

Duhet të kemi kujdes që në këto kurse të marrin pjesë të gjitha gratë, e sidomos gratë e reja dhe vajzat.

.....

Kurset e shkollat që hap Pushteti.

Në të gjitha kurset që hap Pushteti e sidomos n'ato që janë adapte për gruan ne duhet të kemi kujdes që pjesëmarrja e femrës ndër to të jetë sa më e madhe. Për këto organizatat duhet të jenë në lidhje me Pushtetin, të dinë kurset që do të hapen dhe të gjejnë elementin që duhet të marrë pjesë n'ato kurse. Për një punë të tillë organizata duhet të tregojë një kujdes të veçantë.

V) Puna për kulturë të përgjithëshme, zhdukjen e paragjykimeve zakoneve prapanike.

Biseda të lira.- Me këto grumbullime ne mundohemi t'i japim gruas t'onë njohuri për një kulturë të përgjithëshme. Në këto ne mund të bëjmë: Historinë e Shqipërisë, Historia e lëvizjes së gruas, Historia e lëvizjes punëtore në Shqipëri. Thema për Histori Natyre: Mësim jete si p.sh. si bije shi, krijimi i stinëve, gjëndja e dheut, njerzit e kohrave të vjetra, tërmetet etj.

Të tregohet si bëhet jeta në Bashkimin Sovjetik, jeta në kolkozë. (?) në shkolla, në familje, fabrika etj. Njohuri të përgjithëshme. Këto bëhen në formë konference ose duke e lënë të lirë gruan të pyesë dhe të përgjigjet konferencierja. Në një orë bisede të tillë mund të bëjnë p.sh 3-4 pyetje.

Biseda të lira bëhen në bllok, fshat në vende grumbullimi të gruas, vend pune dhe në mbarim të kursit (p.sh. mbasi të ketë mbaruar mësimi për kursin kundra analfabetizmit mund të bëhet dhe gjysmë ore bisedë e lirë për njohuri të përgjithëshme me ato gra) etj.

Shoqet që do të bëjnë këtë punë do të jenë ato që bëjnë pjesë në aktivin e konferencave të gruas, ose drejtuese të kurseve, në rast se këto janë në gjendje.

Leximet kolektive.

Këto organizohen në të gjitha vendet e punës, në bllok, fshat, në fabrikë, në kooperativë, në kurs, në shkolla, institute të ndryshme etj. Në lexime kolektive lexohen artikuj të rekomanduar nga qendra dhe artikuj kryesorë të revistës. Bëhen edhe lexime të botimeve të thjeshta dhe të lehta. Ajo që bën leximin duhet t'a ketë lexuar dhe më parë në mënyrë që të jetë në gjendje të bëjë edhe komente të shkurtra dhe me vend.

Puna me theatrin, sportin, muzikën. Theatri, muzika dhe sporti lozin një rol me rëndësi në edukimin e masave të popullit dhe sidomos në masat e gruas t'onë që është izoluar nga kjo anë e jetës kulturale.

Deri tashti organizatat t'ona nuk e kanë shtruar këtë problem duke e gjetur si të zorshëm një organizim të tillë në gratë edhe sepse nuk është çmuar vlefta dhe përfitimi i tij. Por në qoftë se ne do të kuptojmë mirë rolin dhe rëndësinë e madhe që lozin këto në ngritjen e gruas t'onë, në qoftë se i vihemi me kujdes punës do të kemi si kudo rezultate të mira pune.

Theatri ne do të na ndihmojë shumë në këtë drejtim. Çfaqjet theatrale skeçe

të vogla që do të lozin në gratë do të kenë këtë karakter: Të ngrehim shkurt e thjeshtë problemet e gruas, të godasin shumë në luftën e paragjykimeve dhe ideologjis së vjetër, të bëjnë të kjartë nën to luftën për spekulatorët, për mbrojtjen e indipendencës, e punën për rindërtimin e realizimet e Qeverisë s'onë. Të popullarizojnë në gratë miqtë e popullit shqiptar dhe armiqtë e tij. Të popullarizojnë në ato vende si në Veri ku nuk njihet, luftën për çlirim.

Lëndën për këto pjesë theatrale do t'a kërkojnë t'a gjejnë shoqet që punojnë me Agit-Propin e gruas. Në gjetien dhe krijimin e lëndës do të kemi kujdes që t'i përshtatet ambjentit të gruas t'atij vendi.

Nga qendra do t'u vijë lëndë e tillë, të cilën juve dhe mund t'a adaptoni. Për të shkuar drejt organizimit sa më të mirë të theatrit ne do t'ja nisim punës në organizimin e grupeve theatrale të vogla.

Grupet theatrale të organizohen në lagje, në katunde, fabrika, në kurset e ndryshme të gruas. Këto grupe do të krijohen nga gra të shkathëta t'afta për të kryer këtë punë dhe sidomos nga vajza të reja. Për këtë do të na ndihmojë shumë bashkëpunimi me organizatën e rinisë në qarqe.

Organizata e gruas në qarqe do të ketë gjithënjë përpara organizimin e nji grupi të mirë theatral të gruas, për të lojtur në grumbullime të mëdha të gruas.

Pjesët theatrale do të luhen në katund, në lagje, në fabrika, në klube të gruas, në kurset e ndryshme dhe në grumbullime të ndryshme.

Grupe theatrale të organizuara ne qytet është mirë që të dalin të luajnë në gratë fshatare. Me ekipet e gruas që dalin nëpër katunde të kemi kujdes që të dërgojmë edhe grupe të vogla theatrale. Ato ndihmojnë jo vetëm për skjarimin e gruas fshatare por edhe për grumbullimin dhe dëfrimin e tyre. Mandej në të gjitha fshatrat t'ona ne nuk do të kemi mundësitë të ngrehim grupe theatrale me gjëndjen në të cilën ndodhet gruaja e fshatit. Kështu që lëvizja e grupeve theatrale do të ndihmojë shumë.

Në qoftë se ne organizojmë mirë punën do të kemi rezultate të mira, duke punuar kështu për ngritjen e gruas t'onë, dhe në vendet e ndryshme të grumbullimit të gruas dhe punës.

....

VI) Rrethi letrar i gruas.

Ky organizohet pranë çdo shtëpije të gruas në qark. Ky drejtohet nga përgjegjësja e Agit-Propit të gruas ose nga një shoqe që është në gjendje t'a drejtojë.

Këtu marrin pjesë gra: mësuese, profesore, gra të tjera të reja, maturante që janë në gjendje të shkruajnë. Këto bëjnë mbledhje të rregullta nji herë në muaj dhe caktojnë plan pune.

Këto shkruajnë pjesë të ndryshme për rubrikat e revistës Shqiptarja e Re, mbledhin material për folklorin e gruas, këngë, poezi, episode historike të gruas shqiptare.

Mbledhin dhe punojnë materialin për heroina të luftës, për dëshmore dhe gra të dalluara në punë.

Mbledhin shkrime për të bërë dhe botime të vogla: novela, me tregime të grave në qark. Bëjnë material gadi për libra në formë broshure ku të vihet aktiviteti i gruas së qarkut për një kohë të caktuar.

Bëjnë përkthime të ndryshme, përkthejne libra të vogla që flasin për gruan, artikuj që vlejnë të vihen në faqen e III-të të gazetës së qarkut etj.

Gjithë materialin e punuar ia komunikojnë qendrës dhe për pjesë që mund të botohen në formë broshure, ia dërgojnë qendrës që të botohen nga biblioteka Shqiptarja e Re.

Një punë e tillë bën që ne të ngrejmë dhe të vëmë në punë dhe cilësi të gruas që janë lënë mbas dore, do të ngjallim dashurinë për letërsi dhe shpirtin letrar dhe do të hedhim hapat e para për një letërsi t'onën.

VIII. Mbrëmje kulturale e letrare dëfrimi të gruas.

Të tilla ka mundësi të bëhen më tepër në qytet, dhe në qendra N/Prefekture. Këto bëhen për dëfrimin e gruas dhe për të përfituar dhe ajo diçka. Mbrëmjet për gruan organizohen në shtëpinë qëndrore të gruas. Kto organizohen në raste të ndryshme: ditë feste, përvjetorësh etj. Këto bëhen me një program të caktuar dhe fillojnë në orën e caktuar duke u munduar të ketë rregull. Këto bëhen me ftesa ose pa ftesa si mbas konditave që paraqiten.

Në një mbrëmje të tillë mund të bëhen: Recitime të pjesëve të ndryshme, poezi por gjithënjë të kemi përpara që jemi me masën e gruas. Aty mund të lexohen pjesë të bukura zbatonjëse dhe edukuese për gruan. Të jetë pregatitur një program muzikor: p.sh. luhen pjesë nga gra që dinë t'u bijen veglave, të këndohet ndonji këngë prej ndonji gruaje që di të këndojë ose ndonji grupi koral të gruas etj.

Në organizimin e tyre duhet të kemi kujdes që të zgjedhim orën e përshtatshme për gruan dhe t'i bëjmë të shkurtra jo të gjata që të mërziten gratë dhe veç kësaj të kemi kujdes të math që të mos ketë konfuzion.

VIII. Shtëpija e gruas.

Shtëpija e gruas është një qendër pune e gruas. Aty punohet për organizatën. Por shtëpija e gruas së qendrës mund të bëhet fare lehtë dhe një qendër ku të bëhet puna kulturale, të jetë një lloj klubi kultural për gruan. Shtëpitë e gruas organizohen, drejtohen, administrohen dhe mbahen me shpenzime nga organizata e gruas.

Këtu sekretarija teknike e organizata përkujdeset për anët administrative të shtëpisë. Për arsyet e ndryshme është përgjegjësija e gruas ndërsa për seksionet në lidhje me punën kulturale që do të krijohen tashti është përgjegjëse shoqja që punon me agit-propin ose ajo e kulturës. Këto përkujdesen për mbarëvajtjen dhe funksionimin e seksioneve, bëjnë dhe organizimin e seksioneve.

Seksionet e shtëpisë së gruas për ngritjen kulturale të gruas janë:

1) Seksioni i teatrit
2) Seksioni i kurseve
3) Seksioni i konferencave

Ç'do seksion ka antaret e tija të cilat interesohen për punën që përmbleth ay seksion. Seksioni ka një përgjegjëse e cila duhet të jetë ajo që jep e punon më tepër për atë seksion.

1) Seksioni i theatrit. Ky përmbledh gjith punën që do të zhvillohet për artin, muzikën, sportin, rrethin letrar.Ky punën do t'a bëjë me anën e antareve të tija. Të gjitha ato gra që punojnë për këtë seksion janë antaret e tija. Antaret e seksionit interesohen që të ngremë sa më shumë grupe theatrale, të bëjnë një grup theatral koral të qendrës, interesohen që rrethi i letrareve të derdhë aktivitetin e tij, të vihen në levizje etj. Mundohen të shkruajnë vetë skeçe teatrale.
2) Seksioni i kurseve. Ky interesohet për mbarëvajtjen e kurseve. Ka anëtare të tija të gjitha ato që drejtojnë kurset e ndryshme të gruas dhe me anën e tyre interesohet të shtojë numërin e kurseve në degë të ndryshme, interesohet për pjesëmarrjen e gruas sa më tepër në kurset e ndryshme që çel pushteti për specializimin etij.
3) Seksioni i konferencave. Ky interesohet për zhvillimin e konferencave të ndryshme dhe për organizimin e mbrëmjeve, mbasdreke dëfryese kulturale.

Ky seksion ka antare të tijën gjithë aktivin e konferencierëve dhe gjithë ata që meren me punimin e dispensave etj. Aty ato mblidhen herë mbas here, bëjnë punimin e konferencave, shohin se si shkuan konferencat që janë zhvilluar, bëjnë sygjerime dhe propozime të ndryshme për forma të reja pune për edukatë, sygjerojnë për thema që duhen zhvilluar etj.

Shtëpija e gruas veç seksioneve dhe ndonji kursi që mund të bëhet aty, duhet të ketë kujdes që kur të organizojë një punë të tillë të mos ketë konfuzion dhe çrregullim, zhurmë që të mos punohet qetë.

Duhet të jetë lokal i mbajtur pastër, i mobiluar thjeshtë dhe aq sa duhet. Oborri dhe kopshti në rast se ka, të jenë të punuar të jenë me të vërtetë vëndi simbol i punës.

AQSH, Fondi 14 (KQ i PPSH), Viti 1946, D. 45, Fl. 84-89.

UDHËZIME TË NDRYSHME MBI PUNËN QË DO TË BËJË ORGANIZATA ME AGITACION DHE PROPAGANDË

Puna që ka bërë organizata e jonë deri tashi në këtë drejtim nuk ka qenë e plotë. Ajo ka patur shumë mungesa që kanë rrjedhur nga mosorganizimi i mirë dhe mungesa e formave të përshtatëshme për një punë të tillë.

Tashi me organizimin e ri, ne mendojmë që agitasioni e propaganda që të bëhet (përveç punës të gjërë me konferenca e agitasion të vogël për të cilat u flitet në udhëzimet e punës për edukimin e masave) dhe me këto mënyra pune.

Gazeta e murit duhet të dalë në të gjitha vëndet e punës së gruas: në shtëpit e gruas, në fabrika, kooperativa ku ka vetëm gra puntore, në kurse e tjera.

Për gazetën e murit duhet të ketë një redaksi 3-4 veta dhe të drejtohet prej një shoqeje të aftë për këtë punë dhe që është aktive e organizatës së gruas. Kjo redaksi nxjer gazetën nji herë në javë ose në dy javë nji herë.

Gazeta e murit duhet të pasqyrojë aktivitetin e vëndit të punës, të gruas, të kritikojë gjith mungesat; gabimet dhe të verë në shesh sukseset duke u bërë faktor nxitës për punë sa më të mirë.

Në të shkruen artikuj të shkurtër dhe të thjeshtë dhe këto në gradë që ndodhen gratë. Në gazetë muri për t'a bërë atë më tërheqëse mund të vëmë fotografi skica të ndryshme. Në të duhet të dalin emrat e grave që punojnë më shumë, sasit e punës së tyre dhe shpirtin sulmues. Që gazeta e murit të ngjallë emulacionin në gratë, në të të vihen lajmërime të ndryshme.

Duhet patur kujdes që gazeta e murit të mos rrije muaj të tëra në mur se humbet fare rëndësinë e saj. Shoqet e organizatës ato që e nxjerrin këtë duhet të paramendojnë që përpara se të dalë të jenë në gjendje t'a mbajmë.

Gazetë muri duhet të ketë dhe emrin e saj të përshtatshëm për vëndin e punës.

ORA E GRUAS

Në të gjitha qarqet ku ka radio duhet që organizata të organizojë dhe orën e gruas. Ora e gruas bëhet nji herë në dy javë, caktohet nji ditë veç të premtes.

Për të shkuar kjo më mirë pranë shtëpisë së gruas në qendër organizohet një redaksi e cila mund të jetë ajo që nxjer gazetën e murit dhe kjo pregatit gjithë materialin për orën e gruas.

Ora e gruas duhet të verë në dukje aktivitetin e gruas, të verë në dukje elementa që punojnë më mirë. Në atë duhet të flitet për probleme t'organizatës, për probleme të vëndit t'onë por në prizmin e punës për gruan. Kur ka raste të veçanta të flasi dhe përgjegjësja e gruas për ndonji problem të organizatës. Me anën e orës së gruas duhet të bëhet emulacioni për punë në gratë.

Të nxiten gratë për punën që kanë mare të bëjnë për angazhimet e atyre në lidhje me planin e shtetit dhe për premtimet e tyre që dhanë në Kongres. Ora e gruas në radio për qark duhet të jetë ora e gruas së qarkut, e puntores, fshatares, nënpunëses. Duhet patur kujdes që dhe ana teknike e Radios të mos kalojë, të gjënden pjesë muzikore të bukura dhe të përshtatshme dhe spikeri i orës të jenë adapt për atë punë.

KORRESPONDENCA

Në punën e madhe për rindërtimin organizata e jonë ka angazhime të mëdha dhe këto ajo vetë i ka marrë përsipër t'i kryejë. Shtypi i jonë duhet të jetë mjeti edukus i organizatës për të kryer një punë të tillë, por që shtypi të lozë një rol të tillë duhet që të dijë se çbëhet në gjithë organizatën, të njohë problemet e ndryshme të çdo krahine.

Kështu ay do të jetë në gjëndje të bëjë një kritikë të shëndoshë e konstruktive gjithë punën që bën organizata e jonë. Do të jap eksperiencën e një qarku qarkut tjetër, do të nxisë dhe do të shtojë emulacionin në punë. Për t'ia mbrijtur kësaj

duhet të kemi një korespondencë të vazhdueshme nga gjith organizata.

Organizata e jonë pavarësisht nga korespondentet e tjera, në çdo vend pune (fabrikë, kurs, kooperativë) në çdo bllok lagje e fshat duhet të ketë korespondentet e saja të cilat lidhen direkt me redaksionë e saj duke ja dërguar korespondencën me anën e presidjumit të qarkut, të cilit i dërgon dhe nji kopje tjetër që mbetet atje.

Korespondenca duhet të niset me nji herë se për ndryshe humbet aktualitetin e saj. Përgjegjësja e komisionit të Agit-propit e cila është dhe përgjegjësja e korespondencës së qarkut dërgon korespondencën në rregull redaksisë Shqiptarja e re dhe jep korrespondencë të përditëshme koresp. A.T.SH. që është në qark.

Format e ndryshme të shkrimit janë këto:

1) Artikulli. Kondita e parë për të shkruar në artikull është të njohish mirë problemin në të cilin shkruan.

   Në artikull rrihet një çështje e vetme dhe e studjon mirë pa fraza të kota, serjoze pa ironi pa enthusiazmë.

   Në artikull ngrihet nji problem me rëndësi kombëtare, ose për krahina si p.sh. tharja e liqenit të Maliqit; rruga Kukës-Peshkopi e tje.

   Përsa i përket artikujve në lidhje me gruan ne do të ngrejmë çeshtje që kanë rëndësi për gjith organizatën si p.sh. mund të ngrihet në formë artikulli heqja e perçes që bëhet pas vendimeve të Kongresit në Peshkopi. Këtu bëhet një krahasim me të kaluarën duke theksuar ndryshimin që ka bërë gruaja dhe si arin të zbatojë vendimet e Kongresit dhe si përfundim rëndësinë që ka heqja e perçes.

2) Korespondenca. Korespondenca e cila paraqet të gjitha aspektet në të gjitha sektorët e ndryshme të jetës t'onë të përditëshme, duhet të jetë aktuale dhe të flasi vetëm për nji çeshtje, pa koment, të ketë numra ekzakte, të përmbajë fraza dhe fjalë të popullit mbi çështjen që do të shkruaj.

   Në korespondencë është mirë të vihen të metat e punës, po ajo qi ka më tepër rëndësi është që për çdo çështje të shkruajmë vazhdimisht.

   Korespondencën duhet të na i shkruajë ajo shoqe që sheh nga afër punën. Nuk mund të jetë e saktë nji korespondencë nga puna e gruas në Maliq kur na i shkruan nji shoqe që ri në Korçë.

   Në rast se Korça p.sh. do të na dërgojë korespondencë është mirë që të dërgojë për një ditë një shoqe që të shkruaj gjëra egzakte nga Maliqi e kështu për çdo rast tjetër.

   Kështu duhet të ndodhë kur duam të shkruajnë për qendrat e punimit të gruas, kooperativa, fabrika, institute femrore e tjera.

Reportazhi. Në reportazh ndryshon puna dhe ky duhet të përmbajë një çështje të vetme dhe të vërtetë që nuk është nevoja të jetë aktuale sa korespondenca po jo dhe të bëhet bajat. Në reportazh duhet të vihen në dukje shembëlla korekte në punë, të metat në punë, pa kujdesija, plogështija, tarafllëku të cilat të bëhen

mësimë për të gjithë.

Reportazhi ndryshon nga korespondenca se me reportazh mund të bësh kritikë për një çështje të punës që nuk shkon, mund të sugjerosh e të çfaqish mendimet e tua p.sh. kooperativën e robaqepësve në Vlorë kur shkruan u hap në këtë datë, folën kështu, janë kaq antare etj. Është korespondencë dhe është reportazh kur ti bën kritikën e punës, sugjeron ç'ndiejnë gratë që bëjnë pjesë në të e tje.

Informata. Kur skemi kohë për të shkruar gjatë dërgojmë informata mbi një ngjarje. Të vemë numra egzakte dhe jo si ndodh shpesh herë që thuhet muarën pjesë 200 veta dhe në realitet ishin 50. Të shkruhet pse u bë kjo mbledhje, kush foli, çpërfundim pati e tjera.

Telegramet. Këto bëhen kur grumbulli i grave falenderon premton karshi organizatës Frontit, Komandantit. Po rëndësija qëndron këtu që neve nuk duhet të na shpëtojnë këto raste.

Pyetje e përgjigje. Është shumë e nevojshme që të na vijnë pyetje të ndryshme nga gratë dhe organi qendror dhe me anë të përgjigjeve ka për t'u sqaruar të gjith gratë njëkohësisht.

Në bazë të këtyre udhëzimeve ju duhet të ngrini një rrjetë korispondentësh në qarkun tuaj në këtë mënyrë.

Përgjegjësija e Agit-Propit në Sekretariatin e Qarkut do të jetë drejtuesja e korespondentëve të qarkut dhe e qytetit që do ti dërgojë direkt Shqiptaren e Re.

Përgjegjëset e gruas në N/Prefektura janë njëkohësisht korespondente për N/Prefekturën. Mundësisht të caktohen dhe korespondentet në fshat dhe që praktikisht këtë mund ta kryejnë arsimtaret.

Se korespondentja e qarkut është njëkohësisht dhe e qytetit si ajo e N/Prefekturave edhe e fshatrave do të dërgojnë shkrimet e tyre direkt redaksisë të Shqiptares së Re, pa u ndaluar në qark që të shkaktojë vonesë.

Këto korespondente duhet të furnizojnë me lëndë dhe gazetën e qarkut për aktivitetin e gruas.

"Shqiptarja e Re"- Shpërndarja e saj dhe e gjith shtypit t'onë.

Është organi qendror i Bashkimit të Gruas Shqiptare që ka për qëllim të edukojë gratë, të shkëmbejë eksperiencë.

Në faqet e para të revistës vihen artikuj kryesorë që mund të jenë drejt për drejt probleme t'organizatës ose probleme të vëndit. Këto qrtikuj mbasi ti ketë studjuar përgjegjsja e shtypit duhet ta vërë në dijeni organizatën për punimin e tyre në

mënyrë që artikujt e revistës të jenë edukues dhe sqaronjës për masat e grave për organizatën.

Pjesë tjetër me rëndësi është kritika konstruktive dhe aktiviteti i paraqitur në formë për shkëmbim eksperience, e cila duhet të shihet me vrejtje nga organizata dhe që kjo rubrikë të jetë më e vlefshme, është e nevojshme të furnizohet herë mbas here.

Në revistë ka dhe reportazhe: për këtë qarqet duhet të dërgojnë herë mbas here reportazhe të ndryshme në lidhje me punën e gruas.

Në pjesën letrare të revistës shkruhen përshkrime, letra, poezi dhe episode të luftës të gruas dhe dëshmorëve. Qarqet duhet të dërgojnë material dhe për këtë pjesë.

Kronikat e tjera- kultura, gruaja në fshat dhe lajmet e jashtëme duhen të lexohen me vëmendje dhe herë mbas here të dërgohet material për këto e sidomos mbi paragjykimet dhe zakonet prapanike. Shkrime të tilla janë të domosdoshme për kronikën e kulturës.

Në revistë vihet një numër i math fotografish prandaj duhet që të dërgohen dhe fotografi të ndryshme.

Shpërndarja e revistës dhe botimeve të ndryshme.

Gjer më sot, në shpërndarjen e revistës dhe të çdo materiali tjetër që ka nxjerrë shtypi ynë, e kemi bërë me anën e mesagjerisë së përgjithëshme të shtypit. Kjo ua ka dërguar degëve të saj nëpër prefektura dhe ato janë interesuar, si për shitjen, ashtu dhe për shpërndarjen e aboneve. Nga rezultatet e gjer më sotshme, kemi vënë re vazhdimisht se, me anën e Mesagjerisë, rivista nuk është shitur po thuaj se fare dhe abonetë nuk janë shpërndarë në regull. Mesagjerija nuk mund t'i shkojë ç'do gruaje në shtëpi dhe të shesi revistën, ajo i ekspozon atje në dyqan, u jep edhe pionjerve të cilët mjaftojnë të thërasin disa herë rrugës dhe kur të mos u shiten t'i kthejnë prapë atje ku i muarën. Një punë me sistem, do bëjë vetëm organizata e gruas, e cila është interesuar direkt më shumë se kushdo tjetër që revista të shkojë në dorën e çdo gruaje.

Ne, si shpërndarjen e aboneve, si shitjen, mendojmë këtej e tutje, t'a bëjmë vetë në këtë mënyrë.

Porsa të dalë revista do tu dërgojmë abonetë me emrin dhe adresën e sejcilës (në bazë të listave t'uaja) si dhe një numër të caktuar për të shitur. Me tu ardhur revista, përgjegjësja e Agit-Propit, duhet të mbledhë me nji herë sekretaret e lagjevet dhe t'u japë abonetë që i përkasin sejcilës lagje si dhe nga një numër të caktuar për të shitur. Sekretaret do t'a bëjnë këtë punë me anën e Përgjegjësve të blloqeve, të cilat duhen të përpiqen të shesin sa më shumë në bllokun e tyre dhe t'a bëjnë në rregull shpërndarjen. Kuptohet se kjo punë nuk duhet të zgjati javë, por të kryhet me një herë, me shpejtësi, shkathtësi e ndërgjegje. Në qoftë se ndonjërës që është abonuar nuk i vjen revista, sekretaret e lagjeve të lajmërojnë me një herë përgjegjësen e Agit-Prop dhe kjo të na lajmërojë neve duke na dërguar emrin dhe

drejtimin që të interesohemi e t'ia dërgojmë.

Në sekretaret e lagjeve dhe përgjegjëset e blloqeve të ngjallet emulacioni dhe ndërgjegja më e madhe për këtë punë. Ato të jenë vazhdimisht në garë me njëra-tjetrën se cila lagje e se cili bllok do shesi dhe do abonojë më tepër gra në revistën e tyre. Nga ana tjetër, përgjegjësja e Agit-Propit, duhet të dijë mirë dhe t'a ketë parasyshë kurdoherë se kjo është një ndër detyrat e saj më të rëndësishme që duhet t'a kryej me ndërgjegje dhe për të cilën ka përgjegjësi të madhe.

Për sa u përket N/Prefekturavet, përgjegjëset e Agit-propit do të dërgojnë abonetë dhe një sasi për të shitur. N/Prefekturat do t'a bëjnë shpërndarjen me anën e shoqeve përgjegjëse në fshat.

Në fshat me qenë se parja mungon- është mirë që të rregullohet shitja në natyrë: për shembull një revistë të shitet 5 vezë dhe fshati të bëjë blerjen e katër a pesë revistave dhe t'i japë gjithë fshati 20-30 vezë për çdo muaj. Këto që mblidhen i shiten të gjitha kooperativës të konsumit dhe t'i dërgohen organizatës të holla.

Që të mos shkaktohet konfuzion, sidomos në çështjen e llogarisë- që është një gjë me rëndësi dhe që n'asnjë mënyrë nuk duhet të dalin deficit- ju duhet t'a kryeni brënda kohës sa më të shkurtër shitjen dhe shpërndarjen e aboneve. Nga N/Prefekturat të kërkoni llogari të regullt e të shpejtë dhe të hollat për gjith qarkun, të shumtën brenda dy javëve të na i dërgoni pa tjetër. Nuk lejon n'asnjë mënyrë shpërndarje falas, për cilin do që të jetë, as llogari e prapambetur. Varet nga organizimi i mirë që do të bëni ju për këtë punë me kaq rëndësi që ajo të hecë në rregull, pa pengesa.

Përgjegjësja e Agit-Propit do ketë kontrollin e përgjithëshëm për qarkun mbi këtë punë, duke patur statistika të regullta për shitjen dhe duke vepruar me anë të agitacionit që kërkesat për revistën të venë duke u shtuar. Gjithashtu, përgjegjësja e Agit-Propit duhet të jetë në lidhje me degën e Mesagjerisë në qark dhe të shohë se si interesohet ajo për shitjen e revistës. T'i sugjerojë degës mënyra të ndryshme për shitjen p.sh. duke u shfrytëzuar çdo rast grumbullimi (metinge, sport, kinema, theatër) duke u dërguar revista në çdo qendër pune.

Ekspozita dhe fotografi. Organizata e gruas në qarqe duhet t'organizojë ekspozita herë mbas here. Ajo për të bërë këtë duhet të mbledhë material simas llojit t'ekspozitës. Duhet të mbledhë artikuj të ndryshmë nga puna e gruas (punë dore, qylym, qendisje etj.). Nga profesionet e saj: rrobaqepse, etj. Nga vizatime e pikturat e saja, këngë të kompozuara prej ndonjë gruaje etj. Fotografi dhe jetshkrime të grave dëshmore o të dalluara në punë. Fotografi dhe jetshrime të grave heroina në punë, të dekoruara për shpirtin sulmues në punë. Fotografi dhe jetshkrime të grave që kanë bërë një rritje shembullore të fëmijës. Të fotografohen gra në punë kolektive: në korrje, mbjellje, prashitje, në fabrikë, në kooperativë, në zyra të pushtetit, në kurse, shkolla, maternitete, në konferenca e metingje të ndryshme.

Fotografija kur të merret duhet patur kujdes. Një herë duhet dijtur se kush të merret dhe me cilin moment se ndryshe e humb krejt vleftën e saj. Dhe fotografitë

kur ekspozohen duhet të shihen edhe nga kjo anë: që të jenë fotografuar gra dhe masa të grave që me të vërtetë vlejnë t'ekspozohen. Të keni kujdes të mos ekspozojmë njerëz-gra që s'janë më me ne.

AQSH, Fondi 14 (Komiteti Qendror i Partisë së Punës së Shqipërisë), Viti 1958, D. 339, Fl. 1.

Relacion i Komitetit të Partisë së Punës së Shqipërisë në Moskë, dërguar KQ të PPSH dhe korrespondencë e ambasadës sonë në Pragë me KQ të PPSH:

- Mbi martesat e studentëve tanë me shtetas të huaj.

Shoqja Liri,

Unë mendoj që ose të kërkojmë të zbatojmë ligjet, ose të shohëm mbajtjen e këtij ligji në fuqi, njërën nga të dyja. Duhet të merrni masa (ta studiojnë Mihali me Beharin). Për sa u përket atyre që martohen dhe i lënë gratë, unë mendoj meqë kemi shumë raste mund t'i bëhet një letër nga K. e që të punohet në organizatën e partisë dhe të rinisë që çdo student të respektojë ligjet dhe njëkohësisht në bazë të ligjeve kur lidh martesë duhet të pendohet kur ka raste që e bëjnë për të shkuar kohën, gënjejnë, të goditen nga organizata ku bëjnë pjesë.

PARTIA E PUNËS E SHQIPËRISË
Komiteti Partisë
M O S K Ë
Nr. 0012 Pro
5.2.1958

Sekretarit të K.Q.P.P. Shqipërisë
(Shokut Hysni Kapo)

Ministrit të Punve të Jashtme
(Shokut Behar Shtylla)

T I R A N Ë

Një problem që ka dalë edhe më përpara dhe që po na del edhe më shumë këtë vit është çështja e martesave që po bëhen nga studentët tanë civila dhe ushtarakë. Këto martesa në të shumtën e rasteve jo vetëm që janë të rastit, por mbi të gjitha po bëhen duke shkelur vendimet, udhëzimet dhe regullat e shtetit tonë. Po bëhen celebrime, dhe disa studenta venë dhe jetojnë në shtëpitë e tyre, pa marrë dhe bile pa bërë as kërkesën për aprovim nga ana e shtetit tonë.

Nga disa janë shkelur dhe po shkelen në mënyrë të ndërgjegjëshme vendimet e Qeverisë. Kështu p.sh. ndërsa nga vendimet e qeverisë t'onë ndalohet martesa me të huaja për studentët që pregatiten për Ministrinë e Punve të Jashtme, studentët tanë janë martuar dhe po martohen dhe asnjë masë nuk po meret. Për këta studentë,

siç thuhet këtu, është njoftuarë disa herë Ministrija e Punëvet të Jashtme dhe asnji herë nuk po përgjigjet se si duhet vepruar për këto shkelje të hapura të vendimeve të qeverisë tonë. Kështu është studenti M.S., komunist, dhe Th.Ç. që studjojnë në Institutin e Marëdhënjeve Ndërkombëtare, të cilët me gjith paralajmërimet e her pas herëshme të ambasadës, ata janë martuar dhe i pari ka edhe fëmij.

Përpara nji fakti të tillë, të lëshimeve në shkeljen e vendimeve, janë inkurajuar shumë studentët e instituteve të tjera që nuk e kanë të ndaluar martesën, por që duhet më përpara të bëjnë kërkesën dhe mbasi të marin aprovimin e shtetit tonë të bëjnë martesën. Këto udhëzime po shkelen nga mjaft studenta civila dhe ushtarakë. Kështu p.sh. është martuar pa pritur aprovimin studenti P.M. në Leningrad; nuk kan bërë asnji kërkesë dhe kan bërë martesa studentët M.V., F.J. dhe këto ditë N.L. në Moskë; F.D. në Leningrad etj. Janë bërë më shumë se dhjetë martesa nga shokë ushtarakë. Po nga ushtarakët kemi katër raste që kanë krijuar marëdhënje me vajza sovjetike, kanë lindur edhe fëmijë dhe kur vjen fundi largohen dhe i lënë. Kështu p.sh. është rasti i ushtarakut H.D. që është këthyer në Shqipëri, dhe e ëma e vajzës i është drejtuar me nji letër edhe K.Q. të P.K. të B.S. duke kërkuar që H. të mos ja lerë të bijën në Leningrad mbasi ai është martuar me të, ka lindur fëmij dhe i është premtuar asaj se do ta merte në Shqipëri.

Ne mendojmë se nuk duhet lejuar këto shkelje të vendimeve, të udhzimeve dhe të regullave të shtetit tonë, prandaj mundësisht të shqyrtohet kjo çështje sa të jetë e mundur më parë, dhe të njoftohet ambasada mbi masat që duhet dhe mund të meren në këtë drejtim në rrugë shtetnore.

Për Komitetin e Partisë
S e k r e t a r i
(Halil Vasjari)

AQSH, Fondi 14 (Komiteti Qendror i Partisë së Punës së Shqipërisë), Viti 1958, D. 339, Fl. 6.

4.6.58
Drejtorija e Jashtme
Mbi kapiten Hajro Shytin.

MINISTRIS MBROJTJES POPULLORE
(Drejtoris Politike)
Shokut Sadik Bekteshit

T I R A N Ë

Bashkëngjitur ju dërgojmë një informacion që na ka dërguar ambasada e jonë në Pragë, i cili bën fjalë për kapiten H.Sh. që kërkon të ndajë të shoqen me të cilën është martuar para një viti. Ajo është qytetare Çekosllovake dhe nga një familje me qëndrim shumë të mirë.

Veç përmbajtjes së informacionit, jemi njoftuar nga shokë oficera që kanë qenë për pushime në Çekosllovaki se familja e saj i kishte ftuar në shtëpi dhe kishte shprehë ndjenja dashurie dhe respekti të thellë për popullin tonë, gjë që i shtyri të aprovonin me kënaqësi këtë martesë.

Sjelljet e H. dhe të familjes së tij janë një ofezë e rëndë për familjen e të shoqes. Ay nuk duhet të harojë se ky gjest i ulët ofendon rëndë figurën e komunistit, të oficerit dhe të familjes së tij.

Ne mendojmë se ay nuk ka asnjë arsye justifikuse për ndarjen e të shoqes. Për këtë duhet të ndihmohet që të regullojë mardhëniet me të shoqen.

Lutemi të shqyrtohet çështje e tij dhe të na njoftohet përfundimi duke na kthyer edhe informacionin e ambasadës.

DREJTORI DREJTORIS JASHTME
Mihal Prifti

5.4 Zhvillimet në fushën e ekonomisë

AQSH, Fondi 14 (KQ i PPSH), Viti 1946, D. 158, Fl. 5-6.

Nr. 192 11 mars 1946
Koçi Xoxes

Në lidhje me urdhnin e Kryeministris mbi konfiskimet dhe rekuizimet e pasunive të klerit katolik, ne mendojmë të rekuizojmë dhe muzeun e bibliotekën françeskane mbasi ka shumë gjëra të vlefshme. Ne i kemi bllokuar tash për tash po para se të fillojmë inventarin e tyre presim përgjigje nga ju.

Spiro Pano

Nr. 405
Datë 14/3/946
Radiogram Spiro Panos
Shkodër

Gjegje radiogramit t'uaj nr. 192

Veproni në bazë t'udhëzimeve të Kryeministris. Bllokimin e krejt pasunisë pa përjashtim të klerit katolik.

Koçi Xoxe

AQSH, Fondi 14 (KQ i PPSH), Viti 1946, D. 158, Fl. 33.

Nr. 1043, Datë 26 qershor 946 TEPËR URGJENT

RADIOGRAM
GJITHË KOMITETEVE QARKORË TË PKSH

Nga ana e Ministrisë Botore janë lajmërue Komitetet Ekzekutivë, që të regjistrojnë të gjitha automjetet private. Komiteteve Ekzekutivë u është thënë se ky regjistrim bëhet për arësye financiare, por në të vërtetë regjistrimi bëhet për t'i shtetëzuar, prandaj ju duhet të interesoheni që regjistrimi të bëhet komplet. Nuk do t'u shtetëzohen vetëm atyre privatëve që i kanë si mjet jetese.

Listat si të atyre që duhet t'u shtetëzohen edhe atyre që s'duhet t'u shtetëzohen, të na i keni dërgue këtu, para pesë korrikut. Të mbahet konspiracioni më i madh.

Me ndihmën e organizatës së Partisë dhe organizatave tjera antifashiste, ju duhet t'interesoheni që rregjistrimi të bëhet sa më shpejt, komplet dhe drejtë.

GOGO NUSHI

AQSH, Fondi 14 (KQ i PPSH), Viti 1946, D. 158, Fl.15-16.

KOMITETI QARKOR I PKSH VDEKJE FASHIZMIT
PËR SHKODRËN LIRI POPULLIT
Komitetit Qëndror të P.K.Sh.
Tiranë

Të dashur shokë,

Në lidhje me raportin e Marsit, ju jap disa njoftime rreth sektorit ekonomik të shtetit, përsa i përket dyqanit dhe fabrikave të shtetzuara:

1. Dyqani i shtetit. Filloi punën më 20.3.46 dhe që atëherë vazhdon të tërheqi gjithmonë edhe më tepër myshterinj. Xhiroja mesatare arrin te 24.000 fr. Po ka patur ditë që ka kaluar edhe 45.000 fr.shq. Xhiroja do t'ishte më e madhe sikur të kidhte mall të kohës, shumica e mallit tashti është e stinës së dimrit e nuk para shkon dhe aq. Me furnizimin e tij nga dyqanet e konfiskuara do të kemi një shtesë të mirë xhiroje. Në këtë dyqan vijnë punëtorë, fshatarë, shtresa të mesme. Gjër më sot nuk kemi konstatuar të rishiten plaçkat nga blerësit. Tregëtarë dhe njerëz pasanikë nuk lejohen të blejnë. Ndonjë fshatar i pasur edhe na ka shkarë, po shokët e dyqanit i kontrollojnë mirë triskat dhe disa i kanë diktuar dhe ia kanë dorzuar pushtetit për ndjekje. Organizata është njoftuar për të patur kujdes që të mos blejnë në dyqanin e shtetit njerëz spekullatorë, pasanikë etj.

Puntorët, katundarët dhe në përgjithësi ata që blejnë atje e kanë pritur shumë mirë dyqanin. Shpesh herë dëgjohen nga goja e tyre urime për Qeverinë e sotme.

Ka disa nëpunsa me shpirt të vjetër që duan të marrin më tepër se ç'u takon, po nëpunësit e dyqanit qëndrojnë mirë. Në tregun privat shihet një ulje çmimi, sidomos n'ato plaçka që ka dyqani. Tregtarët u munduan të krijojnë opinionin se gjoja me mbarimin e plaçkave të UNRA-s dyqani do të mbyllesh. Po pas demaskimit që ne iu bëmë parullave të tyre, pas inventarizimit të dyqaneve të konfiskuara, pas burgosjes së tregtarëve që nuk paguan tatim fitimet, përpjekja e tyre shkoi bosh dhe masat po lidhen gjithnjë edhe më tepër me ne. Një faktor tjetër në kurriz të tregtarëve qe bllokimi i bezes oksfordit etj sende të para manifakture të nevojshme për fshatarët.

Po bëhen përpjekje për hapjen edhe të një dege tjetër të këtij dyqani në qytet si dhe nga një degë në të gjitha nënprefekturat e këtij qarku. Kjo do të ketë shumë efekt se vetë katundarët i kërkojnë këto dyqane me insistim, aq sa në disa vende, si në Mirditë p.sh. i janë përveshur punës për ngritjen e një barake postafat për këtë punë, vullnetarisht. Në Lesh e Koplik u çelën dhe dyqanet e ushqimeve që ndan pushteti. Një dyqan i tillë çelet këto ditë në Pukë dhe së shpejti edhe në nënprefekturat e tjera.

Personeli i dyqaneve përbëhet nga anëtarë partije, të rinj komunistë (të reja sidomos) dhe prej antifashistësh të ndershëm. Gjer tani nuk kemi ankime kundrejt personelit. Ata punojnë edhe jashtë orarit, sillen mirë dhe mundohen t'a kënaqin popullin. Ne i udhëzojmë herë pas here.

Përsa u përket dyqaneve të tregtarëve të tatuar, vazhdon bërja e rregulltë e inventarëve, po këto dyqane janë shumë kurse ne njerëzit i kemi të pakët. Jemi në mbarim e sipër t'inventarit të Ulqinakut. Sot filluan punën një seri komisionesh për të marrë në dorëzim materialin e dyqaneve të tjera të konfiskuara. Së shpejti do të çelet këtu farmacija e Luigj Simonit, tregëtar i tatuar.

Tregtarët e tatuar, veç se i nxuarëm nga shtëpit, i futëm dhe në burg dhe sot i kemi vënë të punojnë. Kjo do të vazhdojë. (Ata që s'kanë paguar).

2. Fabrikat. Marrja e fabrikave të ndryshme nga ana e shtetit është pritur mirë nga gjithë puntorët, me përjashtim të ndonjërit që është far'e fis i fabrikantit. Kjo tregohet nga vetë interesimi që tregojnë puntorët për të përmirësuar e shtuar prodhimin, për të punuar jashtë orarit, për të marrë pjesë në kurse që çelen në 'to etj. Si përgjegjsa në to janë antarë partije dhe këta shokë shihet t'interesohen për fabrikën e tyre: vijnë p.sh. në pushtet dhe sugjerojnë për këtë ose për atë nevojë, edukojnë puntorët në konferenca, kurse etj, interesohen për ruajtjen e maqinerisë etj.

Puntorët janë interesuar për të pastruar maqinat, të lëna pas dore e plot me pluhur përpara, janë çelur kurse specializimi për maqinat dhe për lëndën (p.sh. në fabrikat e sapunit, për të mësuar maqinat dhe për të mësuar si bëhet sapuni; në atë të makaronave për maqinat dhe për të mësuar si fabrikohen më mirë makaronat etj), kurse kundra analfabetizmit etj. Të tilla kurse janë çelur gati në çdo fabrikë që punon dhe tashti ne do t'i shtojmë kursistat edhe me puntorë të tjerë, të dërguar nga jashtë postafat për të mësuar zanatin. Në kurset e maqinerisë marrin pjesë më tepër ndihmësat që ne i kemi nxitur për të mësuar, në ato të specializimit të punës të gjithë puntorët, në ato kundra analfabetizmit, të gjith' ata që nuk dijnë shkrim këndim.

Shihen përpjekje për të rregulluar jetën e fabrikës p.sh. në ish fabrikën Pogu

kanë çelur një menzë kolektive ku hanë 22 veta, një bibliotekë me 132 libra, një kor me dy zëra etj.

Në fabrikat e makaronave Dragusha e Ulqinaku përpara punonin nga 10-12 puntorë në një turn, kurse tashti punojnë 20-24 puntorë në dy turne, ditë e natë. Përpara prodhoheshin nga 4 kv makarona në 8 orë kurse tashti me hovin e punës ka mbritur të prodhohen gjër më 9 kv makarona në të njëjtën kohë dhe parashikohen shtime.

Përsa i përket fabrikave ish Pogu dhe ish Hoti, ne do të studiojmë një shkrirje të tyre në një lokal të vetëm (në atë të Hotit që është krejt modern). Tashti për tashti do të shtrojmë çështjen e personelit të tyre: të shkurtojmë personelin administrativ. Për këtë do të merremi vesh me Ministrin e Ekonomisë.

Përsa u përket fabrikave të cingareve që akoma s'kanë filluar nga puna për mungesë bobinash, si dhe për ndonjë tjetër ne jemi të interesuar të pastrohen maqinat, të rregullohet ndonjë mungesë, në mënyrë që të jenë gati në çdo çast. Kjo bëhet më tepër me punë vullnetare të puntorëve që janë aty ose të ndonjë fabrike tjetër.

Mungesa e lëndëve të para e kufizon numrin e puntorëve, por se të ardhëshmen parashikohen shtesa puntorësh p.sh. në fabrikën Pogu sot punojnë 20 veta por mund të punojnë gjër më 70-80 veta.

3. Diçka mbi fabrikën Dragusha (makaronash): EAD-i nga Tirana i ka dhënë leje pjestarit privat të fabrikës (që ka 1/3) të tërheqi çdo muaj nga 30 kg makarona për vehten e tij. Ne na duket se kjo nuk është e drejtë, prandaj fabrika nuk ia dha ato makarona. Bile vet puntorët refuzuan t'ia japin. Është mirë të shihet kjo, pse EAD-i i dha këtë të drejtë atij. Duke marrë parasysh nevojën e kësaj fabrike për popullin, ne mendojmë të rekuizohet edhe pjesa që i mbetet pronarit privat. Kështu që kjo fabrikë të kalojë krejt nën kontrollin e shtetit.

Diçka mbi atë të çimentos: Në arshivat e Bankës këtu, figuron një ipotekim kundrejt Zogut prej 108.300 fr.ari. Një ipotekë tjetër figuron kundrejt shoqëris gjermane MIAG prej fr.ari. 175.736,68. Nga ky borxh është paguar me anën e kleringut në janar të 43 116.000 fr.shq. (kurse borxhi është në franga ari). Rezulton se fabrika e çimentos është debitore kundrejt shoqëris MIAG për kusurin. Këto dy arsye na duken neve se mjaftojnë që kjo fabrikë të kalojë e tëra në duart e shtetit, duke i likuiduar punët me aksionistat privatë. Më vonë do ju dërgojmë një raport tjetër mbi këtë.

Diçka mbi fabrikën e Dan Hasani. Edhe për këtë figuron një ipotekë gjyksore për fr.zvicere 79054 në favor të shoqëris gjermane MIAG. Po ashtu figuron dhe një ipotekë tjetër kundrejt shoqërisë gjermane GEZELSCHAFT për Reich mark flori 3569. Këto borxhe nuk i ka paguar Dan Hasani, prandaj llogjikisht është debitor kundrejt shtetit. Prandaj ne mendojmë shtetëzimin e kësaj fabrike, jo vetëm pse ka bashkpunuar me gjermanët, por edhe pse është debitor kundrejt shoqërish naziste, pasurija e të cilave në Shqipëri është në duart e shtetit. Edhe për këtë do t'ju raportojmë më gjërë nesër.

Të fala shoqërore

P.Komitetin Qarkor të Partis

Spiro Pano

AQSH, Fondi 14 (KQ i PPSH), Viti 1946, D. 4, Fl. 42-43.

Komiteti Qendror
Partisë Komuniste Shqiptare

REZOLUCION

Në mbledhjen e tij të jashtëzakonshme të mbajtur më 18-20 Dhjetor 1946, Plenumi i K.Q. të Partisë, i zgjeruar me pjesmarjen e udhëheqsave të qarqeve dhe nga Qendra, mori në bisedim Konventën Ekonomike të nënshkruar në Beograd më 27 Nëntor 946 në mes të Shqipërisë dhe Jugosllavisë, e cila konsiston në:

1) Koordinimi i Planeve t'ona Ekonomike
2) Heqjen e kufijve dhe taksave doganore
3) Parifikimin e monedhës s'onë me monedhën Jugosllave dhe konstatoj se:
    1. Me nënshkrimin e kësaj konvente vendi i ynë hyn në një fazë të re historike. Shqipërija, vendi ku ka triumfuar Revolucioni Popullor, ku masat punonjëse kanë marrë fuqinë në dorë, sot ka nji Pushtet Politik nga më të përparuarit dhe nga më të fortit, por ekonomija e vendit t'onë është për tokë, shumë e mbrapa-mbetun dhe e dëmtuar rëndë nga lufta. Në mes të Pushtetit t'onë Politik dhe të gjendjes s'onë ekonomike ka nji hapsirë të madhe që bën rrezikun për dobsimin e Pushtetit t'onë. Vetëm me fuqit t'ona, t'izoluar ekonomikisht, ne nuk mund të ngushtojmë dhe të zhdukim këtë hapsirë.

Në këtë konventë, hidhen baza kryzesore për ngritjen dhe zhvillimin e shpejtë dhe të sigurtë t'ekonomisë s'onë, për eliminimin e kësaj hapsire dhe forcimin e Pushtetit t'onë Popullor.

2. Konventa Ekonomike me Jugosllavinë është pasoja llogjike e traktatit t'aleancës dhe ndihmës reciproke; është një hap i ri që forcon marëdhanjet vllaznore midis dy popujve. Populli Shqiptar gjatë Luftës Çlirimtare gjeti mbështetjen dhe përkrahjen më të madhe te poopujt e Jugosllavisë që luftonin të njëjtin armik dhe inspiroheshin nga të njëjtat parime: të merrnin Pushtetin dhe të vendosnin nji demokraci progresive. Këto mardhanje vllazërore u konkretizuan me traktatin e aleancës për të mbrojtur sukseset e luftës çlirimtare dhe për të përballuar tentativat dhe sulmet e reaksionit.

Konventa Ekonomike, plotson ndihmën e madhe që Popujt e Jugosllavisë i japin popullit shqiptar për t'a forcuar Pushtetin e tij, për t'a siguruar t'ardhëmen e tij dhe për të qenë nji forcë përparimtare në Ballkan.

3. Konventa Ekonomike, është konseguente e vijës së Partisë t'onë. Partija e jonë, ndërmorri veprën e madhe për mobilizimin e masave të popullit në luftën kundra fashizmit dhe për shkatërrimin e Pushtetit të Vjetër. Marëdhënjet me popujt e Jugosllavisë kanë qënë të shëndosha gjatë Luftës Nacional Çlirimtare, se rruga në të cilën hecnin këta

ishte e njëjtë dhe në këtë rrugë inspiroheshin nga Bashkimi i Madh Sovjetik. Fitorja e ktyre dy popujve u arrit se në krye të masave ishin Partitë t'ona Komuniste. Popujt t'anë mbas çlirimit ndoqën të njëjtën rrugë përforcimin dhe konsolidimin e Pushtetit Popullor dhe me këto Pushtete Popullore, popujt t'onë shkuen drejt nji bashkimi të fortë që u konkretizua me aleancën t'onë të madhe dhe me Konventën Ekonomike e cila plotson këto mardhanje.

4. Konventa Ekonomike me Jugosllavinë do të bëjë që për herë të parë në vendin t'onë, ekonomija e jonë të zhvillohet me plan. Zhvillimi i ekonomisë s'onë me plan do të dërmojë më shpejtë ekonominë kapitaliste, mbeturinat e Feudalizmit dhe çdo pengesë tjetër që ndalon mbarëvajtjen e vendit t'onë. Nji ekonomi e planifikuar që shkon përherë drejt zhvillimit dhe zgjerimit të sajë, që ecën paralelisht me Pushtetin politik, do të na çojë pa tjetër në SOCIALIZËM.

Prandaj:

Duke pasur parasysh se ne rrëzuam Pushtetin e vjetër, morëm fuqinë në dorë, çdukëm sistemin feudal, dhe me Reformën Agrare i dhamë tokën fshatarve të varfër, shtetzuam Bankën, fabrikat, tashti lypset që ne të zhvillojmë dhe të ngrejmë ekonominë t'onë në nji ekonomi të përparuar, në nji ekonomi socialiste, pse nuk duhet të ekzistojë hapsira e madhe në mes Pushtetit t'onë t'avancuar dhe t'ekonomisë së mbrapambetur.

Në zbatimin e kësaj vepre të madhe ne do të hasim pengesa, megjithse kapitalizmi nuk ka qenë i zhvilluar në vendin t'onë dhe lufta e popullit t'onë ka goditur rëndë feudalizmin dhe latifondistat politikisht dhe ekonomikisht.

Lufta mund të jetë e ashpër ose më pak e ashpër, kjo është e lidhur me situatën e vendit t'onë, me të shkruarën e vendit t'onë dhe pse të shpronësuarit në bashkëpunim me elementat e tjerë të pakënaqur me intelektualë me kulturë fashiste nuk do të rrijnë duar kryq dhe do të na luftojnë, pse taman zgjidhja e problemit ekonomik në këtë mënyrë është vdekja e tyre.

Partija duhet të kuptojë rëndësinë ë bashkëpunimit të ngushtë me Jugosllavinë, rëndësin e zbatimit të këtij akordi dhe të kuptojë të gjitha detyrat dhe përgjegjësit që rjedhin prej tij, rolin e organizimit dhe të drejtimit, rolin e lidhjes me masat.

Partija duhet të ketë të kjartë se me këtë Konventë pozitat e Demokracisë në vendin t'onë forcohen dita ditës. Çështja ekonomike është problemi kryesor, por asnji herë s'duhet haruar se ky problem duhet të qëndrojë paralelisht me çështjen politike dhe nuk duhen kuptuar kurrë të shkëputur.

Partiaj e jonë duhet të vërë të gjitha forcat për realizimin e këtij plani. Çdo antar Partije me nji sens të shëndoshë duhet të kuptojë se nji ekonomi e tillë do të thotë forcim i pushtetit, prandaj Antari i Partisë duhet të lidhet me masat e popullit për realizimin e tij.

Partija duhet të jetë e zgjuar, në mënyrë që Konventa të kuptohet drejtë dhe të mos i lihet terren punës së reaksionit.

Partija duhet të mobilizojë masat e popullit se kështu do të zbatohet programi i sajë.

PLENUMI I ZGJERUAR I KOMITETIT
CENTRAL TË P.K.SH.

AQSH, Fondi 14 (KQ i PPSH), Viti 1946, D. 165, Fl.10.

KOMITETI QËNDROR I PARTISË
KOMUNISTE SHQIPTARE
Nr. 44

VDEKJE FASHIZMIT
LIRI POPULLIT
Tiranë, më 28/VII/946

KOMITETIT QARKOR TË P.K.SH.
BERAT

Zbatimi i plotë i reformës agrare në nënprefekturën e Lushnjës, ka një rëndësi të madhe për gjithë vëndin, e veçanërisht për atë nënprefekturë. Për këtë arsye juve duhet t'a çfrytëzoni këtë sukses të madh për të mobilizuar masën rreth çështjeve aktuale më me rëndësi.

Për këtë duhet:

1) T'organizohen festa vënçe në një krahinë, ose dy a tre fshate së bashku, sipas rastit
2) Atje të flitet shkurtazi nga shoku që do të ngarkohet për këtë punë, dhe pastaj të ngrihen njerëz nga populli të flasin (po edhe këta shkurt) mbi çka ndjejnë ata që tokën e ka ay që e punon
3) Nga mbledhja t'i dërgohen telegrame ose letra Komandantit mbi pjesmarrjen t'onë në Konferencën e Paqes, mbi zbatimin e reformës agrare, mbi regjistrimin në rregull të bereqetit, etj.
4) Këto manifestime të bëhen që të lindin vetiu nga fshatarët dhe në to të ketë mjaft enthuziazëm (munt të ketë saze, etj.)

Si argumenta që do të përdori shoku që do të ngarkohet të flasi atje dhe rreth të cilave duhet të nxiten të flasin edhe fshatarët, do të jenë:

1) Ç'mund të bëjë pushteti kur asht në duart e popullit (këtu flitet për reformën agrare, shtetëzimet, dyqanet e shtetit, e të tjera reforma të pushtetit t'onë)
2) Regjistrimi i bereqetit dhe grumbullimi i tij është në dobi të popullit, pra edhe të fshatarit (pse ndalon spekullimin, kur shteti ka statistika në rregull munt të ndihmojë popullin në rast nevojash ushqimore, etj.)
3) Ne duhet të marrim pjesë në Konferencën e Paqes në bazë të sakrificave t'ona (kjo munt të zhvillohet sipas radiogramit që u kemi dërguar në lidhje me këtë çështje). Dhe kjo të dalë si një nevojë nga vetë fshatarët.

Për Komisjonin e Agit-Prop-it të K.Q. të P.K.SH.
Niko Opari

AQSH, Fondi 14 (KQ i PPSH), Viti 1946, D. 165, Fl.16-18.

KOMITETI QARKOR I PKSH
PËR PESHKOPIN Peshkopi, më 16.8.946

KOMITETIT QËNDROR TË PKSH
TIRANË

Të dashur shokë!

Këtu poshtë po ju dërgojmë një raport të kërkuar me radiogramin t'uaj nr.extra datë 14.8.946.

Përpara se t'u përgjigjemi kërkesave t'uaja e shofin t'arsyshme t'u njoftojmë mbi problemet kryesore të planit që ende nuk janë shtruar. Ne planin t'onë janë si problema (aksione) të dorës parë hapja e kanaleve Klos-Burrel, kanali i Veleshicës, ngritja e gjymnazit dhe e konviktit dhe çentrali elektrik. Nuk kemi filluar nga puna për kanalet nga mungesa e një gjeometri hydraulik sa për të bërë matjet. Mos fillimi qysh t'ani nuk do të jenë të gatshëm për vitin e ardhshëm. Populli i pret, ka mbledhur ndihma dhe ka premtuar për punë.

S'kemi filluar gjymnazin, konviktin dhe çentralin nga mungesa e planit. Populli ka dhënë për gjymnazin më tepër se 20000 franga të reja, 40 kv. bereqet dhe premtim për punë.

Mos fillimi i tyre për disa çështje teknike shkakton humbje politikisht. Janë popullarizuar dhe kur s'fillojnë ngjallin mos besim në popull, të cilët i presin. Fillimi i këtyre aksioneve të mëdha do të bëjë, përvec interesave ekonomike, që populli i këtyre krahinave të mobilizohet rreth aksioneve të mëdha dhe të thyej mos besimin që ekziston në forcat e tyre.

Reforma agrare nuk shtrohet si një problem kryesor në qarkun t'onë. Tokat që posedohen nga pronarët në përgjithësi nuk kalojnë të 5 ha. Janë shumë të pakët ato pronarë që kanë përmbi 5 ha. Gjithashtu dhe entet fetare nuk kanë sasira të mëdhaja. Në N/Prefekturën e Burrelit ka një sasi toke e cila është mjaft e gjerë ku mund të vendosen deri në 2-3 katunde. Kjo tokë sot gjenden në livadhe për arësye se nuk ka ujë për të qënë tokë buke. Me hapjen e kanalit të Klosit përshohet dhe ndrrohet në tokë bujqësore. Kjo është e pakë personave. Një pjesë e të cilëve janë të dënuar si kriminelë lufte, një pjesë janë t'arratisur dhe një pjesë tjetër gjenden në shtëpi por që preken nga ligja e reformës agrare.

Zbatimi i reformës agrare gjen më fort vend:

a) Në nenin 1 të dekret ligjës, pse këtu shumë toka punohen nga bujq, pronarët e të cilave gjenden në vende të ndryshme
b) Në tokat e të dënuarve armiq të popullit dhe në tokat e t'arratisurve kriminela. Për ndarjen e sa më shpejt të këtyre tokave u formuan komisione pranë komiteteve ekzekutive të Prefekturës dhe të N/Prefekturave, të cilët zavëndësojnë zyrat e Reformës Agrare. Këta kanë fillue nga puna dhe

vazhdojnë të punojnë. Kanë regjistruar një pjesë të tokave të bujqve. Nq N/Prefekturën e Qendrës deri sot u është dhënë tokë 120 buqërve që përfshin një sasi toke prej 255 ha. Komisionet vazhdojnë të punojnë.

Teknikët bujqësorë, me gjithë që në këtë rastë, nuk luajnë ndonjë rol kryesor kanë munguar. Janë transferuar, por akoma nuk janë paraqitur në detyrë.

Si pengesë në këtë drejtim kemi se komisionet nuk dinë se ç'sasi toke duhet t'u lihet familjeve të kriminelave, të dënuarve e t'arrtisurve mbasi akoma kjo nuk është caktuar nga komisioni i konfiskimeve.

Sasija e ndarjes së tokës nuk dihet mirë mbasi si shifet këto janë toka të vogla. Nga qëndra nuk na është dhënë ndonjë ndihmë, por as edhe ne nuk kemi kërkuar në këtë drejtim.

Komitetet e fshatarëve janë formuar në çdo katund por nuk funksionojnë si duhet. Këta përbëhen nga fshatarë të varfër dhe të mesmë. Nuk janë në gjendje të lozin rolin e tyre si duhet nga niveli i ulët.

Ndonjë të metë në këtë drejtim nuk ka vetëm se duhen nxitur komisionet që të kryejnë punën sa më parë, dhe tu vijë në ndihmë ndonjë teknik sa për t'i udhëzuar për mënyrën e punës.

Rindërtimi i shtëpijave të djegura dhe shkollave në qarkun t'onë paraqitet si më poshtë: Në planin tonë kemi shtruar për ngritjen e 300 shtëpijave dhe 53 shkollave fillore të reja, gjithashtu meremetimin e 23 shkollave fillore dhe dy unike. U formuan komitetet e rindërtimit në vendet e djegura, duallë nga vetë ata se cilat shtëpi, ç'punë nevojitej, materiali, ç'ndihmë do tu jepnim ne, dhe ç'duhet të bënte populli.

Për shkollat u bë një plan në Komietetin Ekzekutiv ku duhej të ngriheshin, me sa dhoma mësimi, u përpjestua fondi në bazë të gjendjes së fshatit dhe të madhësis së ndërtesës.

Katundarët me pakë përjashtime e kanë plotësuar lëndën si për shtëpit ashtu edhe për shkollat. Një pjesë e materjalit që skishin mundësi katundarët është plotësuar nga fondi i rindërtimit. Nga materjalet, na mungojnë gozhda, menteshe e xhama që ska fare në qarkun tonë, dhe këto na i ka premtuar Ministrija e Botores. Kemi mungesë për transport. Në të gjithë qarkun është vetëm një kamjon në dispozicjon të rindërtimit.

Nji pjesë e shtëpijave dhe të shkollave i kemi filluar për ngritjen në fillim të muajit gusht dhe vazhdojnë punimet. Tani kemi mobilizuar gjithë muratorët afër 400 veta dhe i kemi shpërndarë skuadra skuadra në shtëpit dhe shkollat e gjithë qarkut. Në qoftë se do të na vijë materjali që s'ka në qarkun tonë si gozhda, xhama, menteshe që brenda shtatorit do të kemi realizuar ngritjen e 300 shtëpijave dhe 53 shkollave të reja, gjithashtu dhe meremetimet.

Përsa i takon furrnizimeve dhe tregëtisë në qark gjendja paraqitet si më poshtë. Këtu tregu gjithëmonë ka qënë i vogël. Me bllokimin që u bë përgjithësisht tregtarët falimentuan. Shumica e tyre i kanë mbyllur fare. Në pakë dyqane që kanë ngelur gjinden vetëm pakë vogëlsira që nuk nevojiten për popullin. Tregëtarët nuk përpiqen

të bijen mallra nga tregjet e tjera nga shkaku i çmimeve që janë ulur.

Prodhimet bujqësore skanë dalë në treg në rregull. Bulmeti (djathë, tlyn, gjizë etj) kanë munguar krejtësisht. Arësyeja kryesore është pse qumështi i gjithë staneve u ble nga kooperativa e përgjithshme. Kështu që tregjet kanë qënë shumë të varfër. Kërkesat e popullit kanë qënë të shumta dhe prodhimet që dalin në treg blihen nga populli. Kuptohet vetvetiu se materjali i dalë në treg si industrial dhe bujqësor nuk janë të mjaftueshëm në krahasim me kërkesat. Në radhë të parë populli kërkon, tlyn, vaj, djathë, mish, sapun, patkoj, manifaturë, beze, dhe çdo gjë e nevojshme për të. Dyqanet e shtetit kanë çelur në çdo N/Prefekturë si për ushqime, për vesh-mbathje e për vegla bujqësore.

Nga ana administrative funksionojnë mirë, por gadi në të gjithë dyqanet mungojnë lëndët kryesore, p.sh. dyqanet e ushqimeve kanë vetëm sheqer, kafe, krypë dhe vajguri. Gjithësej vetëm njëherë sapun ka ardhur. Me falimentimin e tregut privat dhe me madhësin e popullsisë dyqanet s'janë në gjendje të plotësojnë kërkesat e popullit. Shifet e nevojshme hapja e dyqaneve të kinkalerisë dhe krijimi i degëve të dyqaneve të vesh-mbathjes. Kjo mungesë vjen dhe nga shkaku i mos organizimit të kooperativavet për kordinimin e lehtësimin e punëve.

Kooperativat e shit-blerjes janë ngritur në 9 qendra, kanë dhënë aksionet por akoma nuk kanë filluar nga puna.

Çelja e dyqaneve të shtetit, ka influencuar për uljen e çmimeve por në përgjithësi sektori privat falimentoj: Nga bllokimet dhe nga ulja e çmimeve që u bë nga ana e pushtetit.

Mos furnizimi në rregull i dyqanevet dhe për bereqet, ka ngjallur në disa raste dhe pakënaqësira në popull.

Me shkëmbimin e monedhës plaçkat kanë zbritur në përpjestim 5 me 1. Populli ka besim në paren e re, kur e cilëson thotë pare e mirë dhe pare e ligë. Ajo që e ngatërron është çështja e monedhës së vogël që nuk u ndrua e gjithë, mbasi nuk janë në gjendje të bëjnë llogari dhe ngatërrohen. Kështu që llogarin katundarët e bëjnë në franga të vjetra.

Ne nuk kemi konstatuar gjë në lidhje me kondrabandën e floririt. Kjo ka të ngjarë nga frika e krijuar prej masavet të marruna. Në qoftë se ngjet, bëhet në rrethe shumë të ngushta. Në fillim fshatarët nuk nxirrnin asgjë në treg, kohët e fundit kanë filluar të nxjerrin sende që s'durojnë, ndërsa sendet ushqimore si gjalpë e djathë mungojnë kryesisht. Sektori i shtetit nuk është në gjendje t'i përballojë këto nevoja jo nga mungesa e administratës por nga mungesa e furnizimeve që nuk bëhen në rregull.

Për Komitetin Qarkor të P.K.SH.

Gaqi Nesho

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Pandelejmoni, Enriketa
Aspekte të historisë së komunizmit në Shqipëri
përmes materialeve arkivore dhe burimeve sekondare :
tekst për përdorim në arsimin parauniversitar / Enriketa
Pandelejmoni, Gentiana Kera, Valentina Duka.
– Tiranë : Maluka, 2020
314 f. : me il. ; 16x23 cm.
ISBN 978-9928-260-36-9
I.Kera, Gentiana II.Duka,Valentina

1.Historia 2.Sundimi komunist, 1945-1991
3.Tekste mësimore

94(496.5) .091 (075)